

ENVER HOXHA

VEPRA

49

PROLETARE TE TE GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNII

ENVER HOXHA

VEPRA

BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TË
SHQIPERISE



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

ENVER HOXHA

VELLIMI

49

MAJ 1972 – DHJETOR 1972

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANË, 1986

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 49-TË

Vëllimi i 49-të i Veprave të serisë të shokut Enver Hoxha përfshin materiale të periudhës maj-dhjetor 1972, pjesa më e madhe e të cilave botahen për herë të parë.

Thelbin kryesor të këtij vëllimi e përbën thellimi i mëtejshëm i punës së Partisë për të vënë në jetë vendimet e Kongresit të 6-të historik të Partisë dhe ide-të e rëndësishme të sjalimit programatik të shokut Enver Hoxha, mbajtur në Mat në shkurtin e vitit 1972. Në disa nga materialet theksohet edhe një herë me forcë domosdoshmiëria e lidhjes më të mirë të teorisë me praktikën, të ideve revolucionare me veprimtarinë e gjallë të Partisë dhe arrihet në konkluzionin se zbatimi në praktikë i direktivave të Partisë kërkon kuptimin dhe zërthimin teorik të tyre.

Ky vëllim hapet me fjalën në Kongresin e 7-të të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë. Boshtin kryesor të këtij fjalimi e përbën parimi i madh marksist-leninist i rritjes gjithnjë e më shumë të rolit të klasës punëtore, i pjesëmarrjes së saj në drejtimin e jetës së krejt vendit, sepse «askush dhe asgjë nuk duhet të mbetet jashtë rolit të saj drejtues e kontrollues», nënvizon shoku Enver Hoxha.

Karakteristikë dalluese e këtij vëllimi është tema-

tilka e larmishme e tij. Mjaft materiale kanë për objekt probleme e detyra politike, ideologjike e organizative të Partisë, që synojnë dhe kërkojnë përsosjen e mëtejshme të metodës e të stilit drejtues të saj. Tehu i punës së Partisë drejtohet kundër shfaqjeve të burokratizimit në të gjitha aspektet për një punë konkrete me njerëzit, për t'i bërë këta të ndërgjegjshëm në punë, për t'i organizuar e për t'i udhëhequr në aksione, në luftë për zbatimin e detyrave që shtronte koha, duke prirë në ballë, si gjithnjë, komunistët, me shembullin e tyre pararojë.

Shumë materiale të këtij vëllimi hapin një horizont të gjerë për probleme që lidhen me politikën ekonomike të Partisë, për plotësimin e detyrave të planit të shtetit. Duke analizuar me sy kritik një sërë mosrealizimesh, zbulohen edhe shkaqet subjektive dhe vihet theksi në nevojën e forcimit të mëtejshëm të organizimit, të drejtimit e të planifikimit të ekonomisë, duke bërë më shumë përpjekje për njohjen dhe zbatimin e ligjeve objektive ekonomike të socializmit. Në këtë kuadër, hidhet dritë në probleme konkrete që kërkojnë një zgjidhje më të mirë siç janë: rritja e efektivitetit të ekonomisë, forcimi i rentabilitetit të ndërmarrjeve, normimi i punës, i cili lidhet ngushtë me kualifikimin tekniko-profesional të punonjësve, ruajtja e raporteve të drejta në shpërblimin ndaj punës, rishikimi i kategorizimit e i pagës së punëtorëve etj.

Ndër problemet kryq që shtjellohen në këtë vëllim janë edhe ato të bujqësisë. Fjala në Plenumin e 2-të të KQ të PPSH (20 qershor 1972), orienton për një varg detyrash, të cilat kanë edhe rëndësi aktuale. Përparimi e modernizimi i bujqësisë, theksohet në vëllim, nuk

mund të arrihet pa luftuar konceptet, praktikat e vjetra, empirizmin, pa i zëvendësuar këto me metoda dhe dituri shkencore, duke përfshirë edhe eksperimentimin shkencor, pa përhapur gjerësisht përvojën e përparuar. Realizimi i planit në bujqësi, rritja e rendimenteve të prodhimeve bujqësore, kërkojnë punë, organizim, zbatim, kontroll, shkencë, ndryshe nuk ka rrugëdalje tjetër për të ngritur nivelin e jetesës së popullit.

Në të njëjtën kohë, në vëllim trajtohen edhe probleme për një degë me rëndësi jetike të bujqësisë, siç është blegtoria, analizohen disa nga të metat serioze që ekzistojnë në këtë sektor, çelen perspektiva për rritjen e krerëve të lopëve, pa nënvleftësuar të imëtat, ngulet këmbë në kuptimin dhe në zbatimin e drejtë të direktivave për zhvillimin e blegtorisë, në harmonizim me bujqësinë në tërësi.

Materialet e këtij vëllimi rrezatojnë edhe në çështjen e madhe të mbrojtjes së atdheut, të cilat trajtohen nga këndi i punës së Partisë, të lidhura ngushtë me situatën politike. Interes të veçantë paraqit në këtë drejtim sidomos këmbëngulja me të cilën shoku Enver Hoxha nën vizor rolin udhëheqës të Partisë në ushtri, domosdoshmërinë e edukimit ideopolitik të kuadrove e të ushtarëve me teorinë marksiste-leniniste, nevojën e përvetësimit të Artit Ushtarak të Luftës Popullore.

Një numër materialesh të këtij vëllimi u kushtohen problemeve të zhvillimit botëror dhe të lëvizjes marksiste-leniniste. Në fjalime publike, në artikuj, në biseda me miq të Shqipërisë socialiste e përfqaqësues të partive marksiste-leniniste, afirmohet edhe një herë politika e drejtë parimore e Partisë dhe e shtetit tonë me ven-

det e tjera, qëndrimi i palëkundur revolucionar ndaj zhvillimeve të ndryshme politike ndërkomëtare; demaskohet thelbi reaksionar i politikës agresive të dy superfuqive, të imperializmit amerikan e të socialimperializmit sovjetik, si armiqëtë më të egër të lirisë e të pavarësisë së popujve të botës; denoncohet me forcë aleanca e tyre kundërrevolucionare. Duke mbështetur dhe inkurajuar luftën e drejtë të popujve të Vietnamit, të Kambozhias, të Palestinës dhe të vendeve të tjera që luftojnë për çlirim kombëtar e shoqëror, në mjaft shkrime nënvizohet edhe një herë konkluzioni i Kongresit të 6-të të Partisë sonë se tendenca e përgjithshme e zhvillimit është revolucioni.

Në biseda me përfaqësues të partive marksiste-leniniste spikat ai kujdes i veçantë i udhëheqësit të dashur e të paharruar të Partisë e të popullit tonë për forcimin e lëvizjes revolucionare botërore. Brendinë themelore të këtyre bisedave e përbën përvoja e Partisë së Punes të Shqipërisë për çlirimin e atdheut dhe ndërtimin e socializmit, lufta e vendosur kundër imperializmit dhe revisionizmit modern, hrushovian e titist dhe variante të tjera të tij, puna e vazhdueshme për edukimin e anëtarëve të Partisë me teorinë marksiste-leniniste, lidhjet e ngushta me masat e gjera të popullit, zbatimi i parimeve dhe i normave revolucionare të Partisë.

Përbajtja politiko-ideologjike e këtij vëllimi, problemet e mprehta që trajtohen në shkrimet e tij, aktuatiliteti dhe vlerat teoriko-praktike të tyre, përbëjnë një armë tjetër për edukimin dhe mobilizimin revolucionar të komunistëve, të kuadrove dhe të mbarë masave punonjëse të vendit tonë, në luftën e madhe për ndërti-

min e plotë të socializmit për të shkuar në Kongresin e 9-të të Partisë e në 45-vjetorin e themelimit të saj me fitore të reja.

Vëllimi është i pajisur me tregues.

FJALA E KLASËS PUNËTORE, MENDIMI DHE VEPRA E SAJ JANË VENDIMTARE NË GJITHË JETËN E VENDIT

Përshëndetje në emër të KQ të PPSH në Kongresin e 7-të të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë

8 maj 1972

Shokë dhe shoqe,

Për mua, ashtu si për tjerë udhëheqjen e Partisë e tij shtetit tonë, është një ndër i madh dhe kënaqësi e veçantë që sot ndodhem midis jush, shokë delegatë, në këtë Kongres të organizatës suaj militante e luftarake. Më lejoni t'ju sjell juve, delegatëve, gjithë klasës sonë punëtore heroike, përshëndetjet e zjarrta e revolucionare të Komitetit Qendror dhe të mbarë Partisë, t'ju uroj punë të mbarë e sukses të plotë!

Ky kuvend i madh i organizatës së klasës punëtore dhe i punonjësve të tjerë të vendit tonë po mbolidhet në një kohë kur kanë kaluar vetëm disa muaj nga Kongresi i 6-të i Partisë. Në këtë Kongres, Partia mori vendime të rëndësishme, caktoi një program të madh pune e detyra të reja për zhvillimin e mëtejshëm ma-

terial e shpirtërор тë shoqërisë sonë. Realizimi i tyre do ta fuqizoје akoma më shumë atdheun, Shqipëria do të ecë më shpejt në rrugën e kthimit në një vend industrialo-bujqësor, jeta e popullit do të bëhet më e gëzuar, ndërtimi i plotë i socializmit do të hedhë një hap-tjetër të madh përpara.

Kjo perspektivë e ndritur ka ngjallur në gjithë punonjësit tanë në qytet e në fshat, në fabrika e në miniera, një entuziazëm të paparë dhe një vrull të ri-pune e përpjekjesh. Klasa punëtore është hedhur në sulm. Ajo ka ndërmarrë e po zbaton iniciativa të shumta revolucionare për të vënë në jetë vendimet historike të Kongresit të 6-të dhe detyrat e planit të pestë pë-sëvjeçar.

Komiteti Qendror i Partisë është i bindur se punimet e Kongresit të 7-të të Bashkimeve Profesionale dhe vendimet që do të marrë, do t'i jepin një shtytje të re veprimtarisë së gjithanshme të organizatës profesionale, do ta ngrenë më lart hovin dhe mobilizimin në punë të klasës punëtore, ndërgjegjen dhe aksionin e saj revolucionar. Ne jemi të sigurt se në këtë Kongres do të buqasë i fuqishëm zëri i klasës punëtore. Nga tribuna e tij ajo do të thotë fjalën e saj me peshë për të gjitha çështjet e jetës së vendit, do të vërë në dukje sukseset e shkëlqyera të arritura, eksperiencën e madhe të fituar, iniciativat revolucionare të përparuara, që duhet të ndiqen e të zhvillohen, do të vërë si duhet në dukje vlerën e madhe të kolektivit e të njerëzve të mrekullueshëm, që bëjnë çudira në punë, do të kritikojë hapur e me guxim të metat e dobësitë, konceptet e praktikat burokratike, çdo gjë të vjetër e të huaj

që pengon marshimin përpara të shoqërisë sonë socialiste.

Fitore shumë të mëdha, realizime të jashtëzakonshme kanë arritur Partia dhe populli ynë në të gjitha fushat e ndërtimit socialist. Në krenohemi për industrinë tonë socialiste, për kombinatet, uzinat e hidrocentralet që janë ngritur me duart e arta të klasës punëtore dhe që drejtohen e shfrytëzohen prej saj me aq astësi e zgjuarsi. Në transformimin socialist të fshatit dhe në zhvillimin e bujqësisë ne shohim edhe kontributin e madh që ka dhënë klasa punëtore, ndihmën e saj të paçmuar për përparimin e fshatit tonë të ri. Roli i klasës punëtore është vendimtar në tërë sukseset madhështore që janë arritur në zhvillimin e arsimit e të kulturës, në revolucionarizimin e gjithë jetës shpirtërore të vendit.

Në arritjen e këtyre fitoreve me shumë rëndësi, kontribut ka dhënë edhe inteligjencia jonë popullore, e cila, së bashku me të gjithë punonjësit, nën drejtimin e Partisë e të klasës punëtore, ka vënë në shërbim të aldeut dhe të çështjes së socializmit gjithë astësitë e saj krijuese dhe ka punuar pa u lodhur për zhvillimin e për organizimin e prodhimit, për përparimin e arsimit, të shkencës, të kulturës etj.

Kudo, çdo vepër dhe çdo fitore jona mban vulën e punës krijuese, të energjisë së pashtershme, të mendjes dhe të shpirtit të sakrificës së klasës punëtore, mban vulën e ideologjisë së saj revolucionare.

Në luftën e shumanshme e të ndërlikuar, plot vështirësi e pengesa, që ka bërë klasa punëtore së bashku me gjithë punonjësit e tjerë për të kapërcyer pra-

pambetjen e trashëguar dhe për të ndërtuar atë ekonomi e kulturë socialiste që kemi sot, është rritur e kallitur edhe vetë klasa. Ndërgjegjja dhe organizimi i saj janë ngritur në një shkallë më të lartë. Klasa punëtore është bërë më e pjekur politikisht dhe ideologjikisht, më e përgatitur dhe më e aftë për të përballuar detyra të reja të mëdha, për të kryer më mirë rolin dhe misionin e saj historik si forcë udhëheqëse e pazëvendësueshme e gjithë jetës së vendit, që mban në dorë puhitetin politik dhe fatet e vendit.

Këto rezultate janë të pandara nga puna e madhe drejtuese e organizuese e Partisë dhe nga kujdesi i saj i gjithanshëm për ta armatosur klasën punëtore me teorinë marksiste-leniniste, për ngritjen e saj ideopolitike, arsimore e kulturore, për aftësimin e saj profesional. Edhe në të ardhmen Partia do të punojë pa u lodhur për ta çuar vazhdimisht përpara edukimin e klassës punëtore, për rritjen e frysës së saj luftarake, për kalitjen e saj ideologjike e politike.

Realizimi i detyrave të mëdha që qëndrojnë tanë përpara nesh është vazhdim i luftës së pandërprerë e vetëmohuese që bën populli ynë për ndërtimin e socialistimit. Klasa punëtore me Partinë e saj në krye qëndron, si gjithnjë, në ballë të kësaj lufte.

Në gjirin e saj kanë shpërthyer lëvizje të tillë të mrekullueshme si «Flamurtarë të ideve të Kongresit të 6-të të Partisë», «Sulmues i vitit 1972 dhe i pesëvjeçarit të pestë», iniciativa për të plotësuar detyrat e pesëvjeçarit me fuqinë punëtore të vitit 1970, për të fituar titullin «Shembull në disiplinën dhe në edukatën proletare në punë», për mekanizmin e proceseve të punës,

për përmirësimin e cilësisë së prodhimit, për kursimin e vlerave materiale e financiare etj., etj. Nga radhët e saj kanë dalë punëtorë të pararojës, si shoferi i dalluar Spiro Lera, traktoristi Shyqyri Kanapari, brigadier i gjeologjisë Ismail Nika, arsimtari Hysen Mezini, në gjurmët e të cilëve ecin qindra e mijëra të tjerë, kolektiva të tërë si ai i Minierës së Bulqizës, i Mborje-Drenovës, i Memaliajt, i Ndërmarrjes së Shpim-Kërkimit të Naftës nr. 2 në Patos, i Uzinës «Traktori», i Uzinës Metalike në Gjirokastër, i Uzinës së Superfosfatit në Laç etj., apo i NB-ve të Maliqit, Sukthit e Kamzës, të cilat janë bërë shembull për punë të vendosur e të devotshme për të mirën e popullit e të socializmit.

Sa herë që Partia ka shtruar detyra dhe ka çelur perspektiva të reja për ndërtimin e socializmit, fjala e klasës punëtore, mendimi dhe vepra e saj kanë qenë gjithnjë vendimtare për realizimin e tyre. Dhe kjo nuk ka ndodhur rastësisht. Ajo është klasa që me ndërgjegjen dhe me fryshtën e saj të lartë revolucionare, me shpirtin krijues dhe me punën vetëmohuese çon përpëra fitimtar revolucionin tonë, ndërtimin e Shqipërisë së re socialiste. Prandaj Partia dhe Qeveria gjithnjë e ndiejnë të domosdoshme të këshillohen me ju, shokë punëtorë, dhe me gjithë popullin për problemet që nxjerrin vazhdimishtjeta dhe ndërtimi socialist i vendit, t'i shqyrtojnë bashkërisht dhe së bashku të gjejë më rrugën më të drejtë për zgjidhjen e tyre.

Vendi ynë është ngjitur në një shkallë të re e më të lartë të zhvillimit ekonomik e shoqëror, arsimor e kulturor. Por ky zhvillim do të ndeshet, siç është e natyrshme, me kontradikta dhe me vështirësi të ndry-

shme të irritjes, të cilat duhet të mënjanohen dhe të kapërcchen nga ana jonë. Faza e tanishme e ndërtimit tonë socialist nuk mund të bashkëjetojë dhe të mbartë me vete koncepte të vjetra artizanale për prodhimin, për kualifikimin profesional, për organizimin e punës e për rutinën burokratike që pengojnë drejtimin e ekonomisë mbi baza më shkencore. Këto të meta e dobësi e frenojnë startin tonë të ri dhe vështirësojnë zgjidhjen e detyrave që ai shtron, të cilat janë më të niëdha e më të komplikuara.

Prandaj nga ne të gjithë, nga punëtorët, organet e ekonomisë, të pushtetit e të Partisë kërkohet të jemi në krye të punës, të kemi një ndërgjegje më të lartë e një disiplinë më të fortë, kërkojen një metodë e stil revolucionar në punë.

Klasa punëtore dhe partia e saj kanë të drejtë dhe detyrë të kërkojnë nga organet e Partisë, të pushtetit dhe të ekonomisë, nga të gjithë drejtuesit, që të marrin tërë masat e duhura dhe ta organizojnë punën në mënyrë të tillë që energjitet, përpjekjet dhe afësitë e punonjësve të japid rezultate sa më të mëdha.

Për organizimin dhe për drejtimin e ekonomisë dhe të tërë jetës sonë shoqërore Partia dhe pushteti popullor kanë nxjerrë ligje, kanë krijuar organizmat e nevojshëm, u kanë dhënë atyre kompetencat përkatëse. Të gjitha këto janë të domosdoshme, kanë kuptimin dhe rëndësinë e tyre. Ato duhen zbatuar me rigorozitet, sepse përndryshe i hapet rruga anarkisë, subjektivizmit, arbitraritetit, spontaneitetit. Por sado të drejta të janë dhe sado t'i përsosim këto ligje e organizma, ata nuk mund t'i zgjidhin vetveti problemet e mëdha

që na shtrohen. Këto probleme nuk mund të zgjidhen as edhe duke fryrë aparatet e organikat, duke bërë pa fund organizime e riorganizime.

Çelësi për përmirësimin e punës duhet kërkuar, në radhë të parë, në forcimin e ndërgjegjes së njerëzve, që ata t'i kuptojnë drejt ideologjikisht e politikisht detyrat, duhet kërkuar në forcimin e përgjegjësisë, të disiplinës dhe të kontrollit në punë.

Klasa punëtore është e interesuar drejtpërdrejt dhe në mënyrë jetike për shtimin e prodhimit, për rritjen e shpejtë dhe në përmasa sa më të mëdha të forcave prodhuase të shoqërisë. Për këtë qëllim duhet që, në radhë të parë, vetë klasa punëtore, çdo punëtor të jetë shembull i një discipline të fortë, të luftojë për një punë të organizuar me rendiment e cilësi të lartë dhe këtë ta kërkojë me rigorozitet të madh edhe nga të tjerët.

Këto tipare të domosdoshme për një metodë dhe stil revolucionar në punë, Partia i kërkon nga të gjithë, punëtorë e drejtues, punonjës të administratës ekonomike e shtetërore. Disiplina, rregullat shkelen si nga disa punëtorë, ashtu edhe nga disa drejtues. Por thyerja e disiplinës nga këta të fundit është me pasojë më të rënda. Prandaj këtë çështje ta vlerësojmë me seriozitetin më të madh dhe forcimin e disiplinës e të rregullit ta kërkojmë që nga punëtori i thjeshtë, nga punonjësi i administratës e deri te drejtuesit e organeve më të larta të Partisë, të pushtetit e të ekonomisë.

Sic kërkohet për punëtorët që të prodhojnë në sasi, në cilësi dhe me qmim të lirë, po me atë rigorozitet

klasor kërkohet që edhe inteligjencia e punonjësit e tjerë të punojnë pastër, me cilësi të lartë dhe me efektivitet. Kjo do të thotë që ata të punojnë me rendiment dhe jo duke fryrë organikat e duke grumbulluar në një vend kuadro e nëpunës që më shumë pengojnë njëri-tjetrin sesa krijojnë. Aparatet e rënda e hallkat e shumta nuk mund t'i shërbejnë as racionalizimit të punës, as përparimit të teknikës e të prodhimit, as edhe drejtimit të vërtetë shkencor.

Ne me të drejtë themi se disiplina e planit është ligj. Mirëpo ç'ndodh? Pa u tharë mirë boja në planin e aprovuar, atij i bëhen ndryshime nga dikasteret, dhe kolektivat punonjës vihen para faktit të kryer, pa u quajtur e nevojshme të merret edhe mendimi i tyre. Me një të rënë të kalemit lëvizin disa herë si pa gjë të keq fonde e mjete themelore nga një objekt në tjetrin, nga një ndërmarrje në tjetrën. Veprime të tilla e çorientojnë bazën, i krijojnë vështirësi suplementare, ndikojnë për të keq në punën e saj. Ato u hapin rrugën çregullimeve dhe thyerjeve të disiplinës së planit edhe nga instancat më të ulëta të administratës. Kur një drejtor ndërmarrjeje sheh se ministri në plan bën ndryshime që kapin miliona lekë, atëherë edhe ai e quan një gjë të lehtë të bëjë ndryshime në planin e ndërmarrjes, të vendosë për të prodhuar ose për të mos prodhuar disa assortimente, të mbajë mbi planin e caktuar për ndërmarrjen e tij naftë, hekur, çimento ose materiale të tjera, të shkelë plotësimin e kontratave.

Natyrisht, plani nuk është një gjë e paprekshme. Sado drejt që të jenë parashikuar gjërat në plan,jeta sjell ndryshime dhe dikton nevojën për korrigjime.

Mund të ndodhë, për një arsy e ose për një tjetër, që një studim të mos jetë bërë i saktë. Gjithashtu, mund të lindin vështirësi e rrrethana të paparashikuara, për këpucimin e të cilave duhen marrë masa të reja. Në këto e në të tjera raste çështjet që lindin nuk mund t'i lihen spontaneitetit, por duhet të shqyrtohen e të zgjidhen gjithmonë brenda rregullave. Ndryshe bëhen gabime, dobësohen përgjegjësia dhe disiplina e planit.

Në punën për realizimin e planit, kolektivat punonjës pengohen shpeshherë nga mosfurnizimi i rregullt me materiale dhe me lëndë të parë. Kjo ngjet sepse ka edhe vështirësi, por më shumë ka çrregullime, mosorganizim dhe mungesë përgjegjësie. Këto çrregullime dëmtojnë tërë ekonominë e vendit dhe pakësojnë në ndonjë rast edhe të ardhurat e punëtorit, sepse, siç dihet, në bazë të rregullave nö fuqi, kur, për mungesë furnizimi të materialeve të planisikuara, punëtorët mbeten pa punë, ata nuk marrin pagë të plotë.

Unë do të sugjeroja që kjo çështje të rishikohet. Nuk është e drejtë që punëtorët të dëmtohen jo përfajin e tyre, dhe, për më tepër, të dëmtohen vetëm ata. Në qoftë se në bazë të vendimeve bëhet një gjë e tillë, atëherë duhet që gjithë aparati i ndërmarrjes, si dhe të gjithë ata që janë përgjegjës për këto çrregullime, deri në dikastere, të pësojnë të njëjtat pasoja si punëtorët.

Kjo, mendoj, do t'i vërë njerëzit në pozita më luftarake për t'i kryer më mirë detyrat që u ngarkohen.

Përgjegjësia për të metat e dobësitë që përmendëm më lart bie mbi të gjithë ata që nuk zbatojnë me seriozitet detyrat e planit. Këta përpinqen që t'i mbulojnë

ato me lloj-lloj justifikimesh, duke ia hedhur sajin herë transportit e herë importit, herë prodhimit dhe herë shpërndarjes. Mirëpo ky labirint justifikimesh nuk u hyn në punë punëtorëve. Ata duan që fabrika, uzina e çdo vend pune të furnizohet sipas grafikut të vendosur, me qëllim që të plotësojnë detyrat e caktuara. Kur punëtorëve u mungon furnizimi dhe nuk prodhojnë, ata kanë të drejtë të vijnë e të ankohen në ministri e deri në Komitetin Qendror të Partisë.

Por e drejta dhe detyra e tyre nuk janë vetëm që ata të ankohen. Klasa punëtore duhet të ngrihet vetë në këmbë dhe t'u thotë «ndal» çrregullimeve. Ajo duhet të kërkojë llogari një për një e deri në fund, të vëré para përgjegjësisë cilindor, pavarësisht nga posti që ka, të ngulë këmbë për zbatimin e sanksioneve ligjore dhe të marrë masa deri në shkarkimin nga puna të atyre që janë të pandreqshëm.

Partia ka kërkuar dhe kërkon me të drejtë që planet tonë të realizohen e të tejkalojen. Kjo është për të mirën e popullit, të vetë klasës punëtore e të socializmit. Dhe klasa punëtore, duke iu përgjigjur thirrjes së Partisë, ka punuar kurdoherë me velëmohim e entuziazëm, e ka çuar përpara zhvillimin e ekonomisë nga njëri pesëvjeçar në tjetrin. Por në ekonominë tonë të planifikuar çdo gjë duhet bërë me llogari, e matur dhe e peshuar mirë. Nga kjo pikëpamje jo çdo tejkalim i planit është gjithnjë i justifikueshëm dhe i pranueshëm. Kur plani tejkalohet duke ngrënë rezervat, kur harxhohen materiale më shumë nga sa janë planifikuar, kur prodhohen mallra vetëm e vetëm për të rritur globalin dhe jo ato për të cilat populli ka më shumë nevo-

jë, të tilla tejkalime nuk i duhen ekonomisë sonë dhe vëtë klasës punëtore.

Në kushtet e tanishme të zhvillimit të vrullshëm të ekonomisë, të kulturës dhe të gjithë jetës së vendit është rritur shumë vëllimi i punës që duhet të përballojë secili punonjës e drejtues. Problemet dhe detyrat që na dalin jo vetëm që janë shtuar, por janë bërë edhe më të komplikuara. Por ne i kemi të gjitha mundësitet t'i bëjmë ballë punës dhe t'i zgjidhim me sukses problemet. Partia ka përgatitur me durim e me kujdes shumë kuadro të aftë, të kalitur ideologjikisht e politikisht, besnikë të klasës punëtore dhe të çështjes së socializmit. Ajo që kërkohet më shumë tanë është forcimi i përgjegjësisë së secilit për detyrën e ngarkuar sipas kompeteneave që i janë dhënë.

Përnirësimet janë të dukshme kudo, por jo në atë shkallë që do të dëshironim të ishin. Në organe të ndryshme të pushtetit dhe të ekonomisë, nga baza e deri në dikasteret qendrore, përgjegjësia personale dhe kërkesa e llogarisë nuk janë kurdoherë në lartësinë e duhur. Nuk është as e drejtë, as edhe parimore që për të gjitha gjërat të përgjigjet vetëm një njeri, të themi ministri apo drejtori i ndërmarrjes.

Këta, sigurisht, nuk duhet dhe nuk mund t'i shpëtijnë përgjegjësisë së tyre të drejtpërdrejtë. Por në ministri ka edhe një zëvendësministër që drejton sektorë të caktuar, ka drejtorë e kryetarë degësh që janë në krye të tyre, ashtu siç ka në ndërmarrje edhe kryeinixhier apo kryeagronom, shef të planit e të tjera, që janë të ngarkuar me punë të përektuara qartë. Cilidho duhet të mbajë përgjegjësi të plotë për detyrën e

ngarkuar dhe t'i kërkohet llogari deri në fund për kryerjen e saj. Asnjeri të mos mbetet jashtë përgjegjësisë dhe kontrollit të Partisë, të shtetit dhe të klasës punëtore, të masave punonjëse.

Te ne, në rendin tonë socialist, nuk ka kontradikta midis masave dhe pushtetit të tyre. Shteti ynë është shteti i punëtorëve dhe i fshatarëve. Prandaj klasa punëtore e fshatare, masat punonjëse duhet dhe janë të interesuara që ta forcojnë vazhdimisht shtetin proletar, pushtetin e tyre, nëpërmjet luftës kundër shtrembërimeve burokratike, kundër dobësive e gabimeve të njerëzve.

Kur klasa punëtore dhe masat punonjëse kërkojnë llogari, kritikojnë e dënojnë zvarritjet burokratike, çrrregullimet, mungesën e përgjegjësisë, të kontrollit, të metat dhe vënë përparrë përgjegjësisë njerëzit e organeve dhe të aparateve shtetërore, ato nuk ngrihen as kundër Partisë dhe as kundër shtetit të tyre. Me vepprime të tillë revolucionare ato nuk i «mohojnë», nuk i «mbytin» funksionet administrative të shtetit, të domosdoshme për drejtimin e ekonomisë dhe të shoqërisë, por bëjnë që njerëzit që punojnë në to të kryejnë mirë detyrat e tyre.

Kuadrot, drejtuesit janë njerëz të klasës, të edukuar nga Partia me frymë të shëndoshë dhe të tëra energjitë, astësitë e dijet e tyre i derdhin për të mirën e popullit e të vendit. Por midis tyre ka edhe të tillë, që, pasi molepsen nga burokratizmi, u rritet mendja, bëhen arrogantë, qëndrojnë larg masave të popullit, mendojnë se dinë çdo gjë dhe nuk kanë nevojë të pyesin njeri, se pikëpamjet që ata kanë për këtë ose atë problem janë të pagabueshme dhe veprimet e tyre janë

të pakritikueshme. Ata arrijnë deri atje sa të mendojnë se janë të pazëvendësueshëm. Kjo i çon ata edhe në gabime. Të kryejnë edhe veprime arbitrale në kundërshtim me ligjet e shtetit dhe direktivat e Partisë, të mos përfillin vullnetin dhe mendimin e kolektivit punonjës. E keqja më e madhe është se jo rrallë këto sjellje e veprime paraqiten prej tyre sikur bëhen në emër të Partisë dhe për të zbatuar direktivat e saj, në emër të interesit të përgjithshëm, të luftës kundër ndjenjës së interesit të ngushtë personal, për të kultivuar gjoja shpirtin e sakrificës dhe fryshtën revolucionare etj., etj.

Partia nuk ka lejuar dhe nuk do të lejojë asnjeri, cilido qostë, që, me dashje ose pa dashje, të vihet mbi Partinë dhe mbi klasën, t'u imponojë masave vullnetin e tij, të marrë nëpër këmbë ligjet e shtetit e të drejtat e punonjësve, të mos përfille zërin e masave. Është detyrë e gjithë punonjësve, sidomos e klasës punëtore, të ngrihen me guxim dhe të dënojnë ashpër çdo shfaqje të burokratizmit, të vënë nën kontrollin e tyre gjithë veprimtarinë e organeve të pushletit, të ekonomisë dhe të Partisë, të komunistëve, të kuadrove dhe të nëpunësve kudo që punojnë. qofshin të zgjedhur ose të emëruar. Mendimi se «ka kush i shikon dhe ka ku shikohet puna e tyre» nuk është mendim i Partisë. Asnjë veprim i padrejtë nuk mund t'i shpëtojë syrit dhe gjykimit të klasës punëtore, të popullit. Burokratizmi ngre krye e gjallërohet atje ku nënveftësohet dhe kur dobësohet lufta kundër tij. Ai struket e paloset kur buçet zëri i masave, kur ushtrohet fort kontrolli i tyre, kur mbi të godit i fuqishëm grushti i klasës punëtore dhe i Partisë së saj.

Shokë dhe shoqe,

Detyrat e mëdha që shtroi Kongresi i 6-të i Partisë për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës dhe problemet e shumta e të ndërlikuara që lindin nga zhvillimi ynë i vrullshëm nuk mund të zgjidhen as vetëm duke i bërë thirrje ndërgjegjes së njerëzve, as edhe vetëm duke marrë masa administrative. Organizimin, drejtimin dhe planifikimin e ekonomisë duhet t'i vëmë mbi baza më shkencore, që të harmonizojmë më drejt kombinimin e interesave shoqërorë, kolektivë e personalë, duke mbajtur kurdoherë parasysh njohjen dhe zbatimin e ligjeve objektive të socializmit. Partia jonë gjithnjë ka ecur në këtë rrugë, prandaj janë arritur edhe të tëra këto fitore historike dhe janë çelur perspektiva madhështore. Tani na vihet detyra që sistemin tonë të drejtimit të ekonomisë ta përsosim më tej, duke u mbështetur në mësimet e marksizëm-leninizmit dhe në përvjën që kemi fituar gjatë gjithë këtyre vjetëve të ndürtimit socialist.

Interesat e ekonomisë sonë, të vetë klasës punëtore dhe të popullit kërkojnë që jo vetëm të prodrojmë sa më shumë, por edhe të prodrojmë duke harxhuar sa më pak punë, mjete materiale e financiare, të prodrojmë lirë dhe me cilësi sa më të mirë. Në këtë drejtim përmirësimet e bëra janë të mëdha. Por sukseset e arriitura nuk duhet të na bëjnë që të mos shohim ato defekte që kemi në këtë fushë. Dhe në këtë rast, para së gjithash, sjala është për të rritur efikasitetin e ekonomisë, për të forcuar rentabilitetin e ndërmarrjeve, hoz-

rashotin dhe për të përmirësuar më tej përdorimin e levave ekonomike.

Për këto probleme është folur edhe herë të tjera. Por deri kur do të lejojmë që disa ndërmarrje industriale e bujqësore të dalin me humbje për vite me radhë? Pse tejkalohen fondi i pagave, harxhimi i materialeve dhe i lëndëve djegëse dhe këto nuk shoqërohen me rritjen përkatëse të prodhimit? Si mund të pranohet që ulja e kostos të bëhet në dëm të cilësisë, apo të prodhohen mallra që nuk kërkohen e nuk pëlqehen nga populli? A nuk është shumë i dëmshëm dhe i dënueshëm fakti që ka ndërmarrje të cilat mbajnë pa i shfrytëzuar plotësisht ose të tepërtë makineri e pajisje të blera me valutë nga jashtë? Pse të nxiten ndërmarrjet tonë të rendin pas realizimit të «globalit» dhe të lënë pas dore prodhimin e mjaft assortimenteve të planifikuar, të të ashtuquajturve artikuj të vegjël, apo plotësimin e kontratave me të tjerët?

Për këto fenomene, me të cilat dikasteret dhe administratat e ndërmarrjeve ndeshen çdo ditë, duhet të ndërmarrin studime të thella, të gjithanshme dhe t'u dalin Partisë e Qeverisë me propozime konkrete përmasat që duhen zbatuar. Jo më pak e interesuar përmënjanimin e këtyre defekteve është e duhet të jetë edhe vetë klasa punëtore. Në këtë kuptim është detyrë e çdo kolektivi punonjës të luftojë që hozrashoti të zbatohet me rigorozitet kudo, në të gjitha hallkat e ndërmarrjes, që nga reparti e deri në brigadë, që çdo ndërmarrje të jetë rentabёl dhe të mos lejohet që ajo të dalë me humbje, veçse në raste të jashtëzakonshme dhe me vendim të posaçëm të Qeverisë. Parimet e hozrashosit

dhe kërkesat e tij t'u bëhen të njohura gjithë punëtorëve, me qëllim që të luftojnë për zbatimin e tyre, të marrin pjesë aktive në drejtimin e ndërmarrjes dhe të ushtrojnë kontrollin e vet mbi tërë veprimtarinë e saj.

Objekt i një kujdesi të vazhdueshëm e të madh të Partisë e të Qeverisë kanë qenë dhe mbeten problemet e organizimit dhe të shpërblimit të punës. Këto janë çështje me rëndësi jetike për zhvillimin e ekonomisë, për vetë jetën e punonjësve. Ato kanë një përbajtje e kuqtim të thellë ideopolitik, ekonomiko-shoqëror dhe nuk janë çështje thjesht administrativo-teknike.

Le të marrim çështjen e normave të punës. Klasa punëtore është treguar e galshme dhe ka marrë iniciativa të shumta për ngritjen e normave, për të kaluar në norma më të larta progresive e teknike. Kjo është një shprehje tjeter e ndërgjegjes së lartë socialiste të klasës punëtore, e frysës së shëndoshë revolucionare që e karakterizon atë, e kuqimit të thellë të faktit se ngritja e normave është për të mirën e përgjithshme dhe të sajën. Sa më mirë e me rendiment të lartë të punohet, aq më tepër do të shtohet prodhimi, do të rritet mirëqenia e popullit, e çdo familjeje punëtore e fshatare.

Normimi i punës është një çështje delikate e me përgjegjësi. Ai duhet të mbajë medoemos parasysh kushtet e krijuara, futjen e teknikës dhe të teknologjisë së përparuar, përsosjen e organizimit të punës dhe rritjen e kualifikimit të punëtorëve. Këtu nuk lejohet nxitim, as marrje masash e vendimesh të nisura nga dëshirat. Çdo ndryshim duhet bërë i peshuar mirë e i studiuar thellë.

Kur themi të jemi të matur dhe të mos ngutemi në çështjen e normave, kjo nuk do të thotë të pajtohem i me gjendjen ekzistuese. Përse duhet t'i mbajmë akoma normat eksperimentalo-statistikore, kur ka më se njëzet vjet që punohet me to? A nuk ka qenë e mjastueshme gjithë kjo kohë për t'i eksperimentuar ato dhe për të vendosur pastaj norma të reja, të studiuara e të bazuara teknikisht? Është e vërtetë se në mjaft ndërmarrje e procese pune janë vendosur norma progresive. Por këto janë ende mjaft të kufizuara.

Detyra e vendosjes së normave teknike nuk është e re, për të është folur edhe herë të tjera. Por çuarjen deri në fund të kësaj çështjeje e pengojnë dhe e zvarritin konservatorizmi e burokratizmi. Kjo nganjëherë justifikohet edhe me pretekstin se gjoja vendosja e normave teknike «zenièron» klasën punëtore dhe «cenon» interesat e saj. Ky nuk është justifikim dhe klasa punëtore nuk e pranon atë. Ajo e di fort mirë që çdo gjë te ne bëhet për të mirën e saj. Vendosja e normave teknike mund të prekë vetëm ata që marrin pa të drejtë më shumë se puna që kryejnë, por nuk prek dhe nuk duhet të prekë ata që punojnë mirë, që marrin aq sa u takon, sipas sasisë dhe cilësisë së punës.

Studimi dhe vendosja e normave të reja duhen bërë kurdoherë në fryshtën e klasës, në rrugën e klasës dhe në interes të klasës punëtore e jo sipas pikëpamjeve të mykura, duke mbajtur normia të vjetruara, të kapëreyera nga koha, vetëm e vetëm «për të mos u prishur qejfin» atyre që përpilen të zhvatin nga shoqëria e të futin në xhepin e tyre ndonjë lek më shumë. Këta njeruz vetë punëtorët duhet t'i bindin se s'janë në

rregull, se kështu nuk mbrohet, por dëmtohet interes i klasës.

Mbajtja e normave eksperimentalo-statistikore ka krijuar edhe disa shpërpjesëtime të pajustifikueshme në shpërblimin e punës së punëtorëve të degëve të ndryshme të ekonomisë. Nuk është aspak e drejtë që një punëtor i industrisë ushqimore, për shkak të tejkalimit të madh të normave të ulëta, të marrë një pagë të barabartë apo më të madhe se minatori që punon nën tokë e në kushte të vështira.

Gjithashitu nuk mund të përputhet me parimin tonë socialist të shpërblimit fakti që punëtorët e së njëjtës kategori të marrin pagë të njëllojtë si kur punojnë ditën, ashtu edhe kur punojnë natën.

Po marr edhe një rast tjetër. Si mund të pranohet që një djalë i ri, i cili sapo ka dalë nga bankat e shkollës, të marrë një pagë të përafërt ose të barabarië me atë të një punëtori të vjetër e me eksperiencë që ka 15-20 vjet stazh pune?

Çrregullime të tjera krijohen në sistemin e sotëm të pagave edhe për arsyen se, në mjaft raste, shumë punëtorë me kategori personale më të ulët punojnë në vende pune me kategori më të lartë. Si rrjedhim, një punëtor me kualifikim më të ulët merr në këtë rast pagë të barabartë me një punëtor tjetër, me kualifikim më të lartë. Kjo dëmton cilësinë e punës e të prodhimit, ul rendimentin dhe dobëson përpjekjet, interesin për të ngritur kualifikimin.

Shoqëria jonë është shumë e interesuar që njerëzit të rritin vazhdimisht kualifikimin në punë, aftësitë e njohuritë e tyre tekniko-profesionale, të bëhen mje-

shtër virtuozë e të pasionuar në profesionin e tyre. Te ne janë të hapura të tëra portat për cilindro që dëshiron të punojë e të mësojë. Veç në këtë punë duhet vënuë më shumë rregull e disiplinë, të rriten kërkesat. Të mos lejohet dhënia formale e kategorive më të larta, pa ia nënshtruar dijet dhe aftësitë e situara një verifikimi e kontrolli të rreptë. Qdonjërit t'i jepet vetëm kategoria që meriton me të vërtetë. I them këto sepse në këtë punë ka edhe shfaqje të liberalizmit e të sentimentalizmit. Këto shfaqen edhe në përgatitjen e kuadrove të lartë në universitet, ku disa të rinj marrin tituj e diploma me të shtyra. Kjo nuk është në interes të klasës punëtore e të popullit.

Të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sistemin e pagave, të kategorizimit e të kualifikimit duhen parë në mënyrë komplekse e jo të njëanshme, sepse ndryshe mund të lindin pasoja të padëshirueshme ekonomike, politike e shoqërore. Në studimin dhe në zgjidhjen e këtyre problemeve të tregohet kujdes i veçantë për të ruajtur përpjesëtime të drejta në shpërblimin e punës së kualifikuar, më pak të kualifikuar e të pa-kualifikuar, dhe punës së rëndë e të lehtë, punës në degët më të rëndësishme e më pak të rëndësishme të ekonomisë, në sektorët kryesorë e ndihmës etj.

Të metat e dobësitet që kritikojmë janë të pjesshme e të veçanta. Ato nuk janë karakteristikë e zhvillimit tonë, nuk mund të errësojnë punën e mirë e plot rezultate të organeve të Partisë e të pushtetit, të kuadrove dhe të punonjësve. Jetën, zhvillimin e ekonomisë e të kulturës, ndërtimin tonë socialist e karakterizojnë eeja e vrullshme përpara, transformimet dhe sukseset

e mëdha që janë fryshtatë i punës së ndërgjegjshme e plot vjetëmohim të klasës sonë punëtore heroike, të fshatarësisë kooperativiste, të inteligjencies popullore, të komunistëve dhe të kuadrove drejtues, të organizuar dhe të paorganizuar në Parti. Ne i kritikojmë të metat e dobësitë dhe nuk mund të pajtohem me to, për shkak se na pengojnë në marshimin tonë fitimtar, frenojnë hovin dhe punën krijuese të masave, nuk na lejojnë të arrijmë ato rezultate që i kemi të gjitha mundësitë për t'i arritur. Ne i luftojmë ato sepse duam të ecim më shpejt dhe gjithnjë përparrë.

Shokë e shoqë,

Në këtë Kongres të klasës punëtore dhe të të gjithë punonjësve janë ftuar të marrin pjesë edhe shumë kooperativistë, përsaqësues të fshatarësisë sonë. Kjo është një gjë shumë e mirë që dëshmon për aleancën e fortë e të ngushtë që e lidh klasën punëtore me fshatarësinë. Klasa punëtore dhe fshatarësia jonë kanë ecur e do të ecin gjithnjë krah për krah, do të shkëmbejnë eksperiencën e do të ndihmojnë njëra-tjetrën, sepse ndjekin të njëjtën rrugë dhe kanë të njëjtin qëllim.

Para fshatarësisë qëndrojnë sot detyra të mëdha për zhvillimin e bujqësisë, për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale që janë aq të domosdoshme për ekonominë dhe jofën e popullit. Plotësimi i këtyre detyrave do të jetë vendimtar për të mbyllur me sukses gjithë planin e pestë pesëvjeçar. E ndërgjegjshme për

këto detyra, fshatarësia kooperativiste po punon me vrull dhe entuziazëm të ri që të arrijë objektivat e caktuar, që ta bëjë fshatin tonë socialist më të bukur e më të lulëzuar. Në të tëra këto përpjekje që do të bëjë fshatarësia, ajo do të ketë si kurdoherë përkrahjen, ndihmën e drejtëpërdrejtë, të pakursyer e të gjithanshme të klasës punëtore.

Të shumita janë detyrat që duhet të përballojë industria jonë në ndihmë të fshatit. Ajo duhet t'i japë bujqësisë më shumë plehra kimike, insekticide e herbicide, makineri e vegla pune, materiale ndërtimi e mallra të përdorimit të gjerë. Një ndihmë të madhe pret me të drejtë fshatarësia nga kësaja punëtore lidhur me përsosjen e organizimit e të drejtimit të ekonomisë kooperativiste, me forcimin e ndërgjegjes, të disiplinës dhe të rregullit në punë. Partia ka besim të plotë se kësaja punëtore do t'i përmbüshë me nder detyrimet e saj ndaj fshatarësise dhe do të luajë, si kurdoherë, rolin e vet drejtues për ndërtimin e socializmit në fshat, ashtu si dhe fshatarësia nga ana e saj do të plotësojë detyrat dhe zotimet ndaj klasës punëtore dhe punonjësve të qytetit.

Shokë e shoqe,

Kongresi juaj mblidhet në një kohë kur në botë ndodhin ngjarje të mëdha, nga të cilat ne nuk jemi të vëçuar dhe të paprekshëm. Por, si kurdoherë, Partia, Qeveria dhe gjithë populli ynë analizojnë me kujdesin e duhur zhvillimin e situatës ndërkontinentare dhe mbaj-

në atë qëndrim që përputhet me mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së atdheut dhe të ndërtimit të socializmit në Shqipëri, që ndihmon çështjen e revolucionit dhe të çlirimit të popujve në të gjithë botën.

Pozita ndërkombëtare e Shqipërisë socialiste është e fortë dhe e patundur. Në sajë të luftës dhe të veprimtarisë së tij revolucionare, të politikës së drejtë internacionliste dhe të qëndrimit të vendosur antiimperialist e antirevizionist, vendi ynë ka fituar simpatinë e popujve përparimtarë e paqedashës të botës, ai ka bërë miq të shumtë e të fuqishëm, që i duan gjithnjë të mirën dhe e ndihmojnë pa kursyer...

Klasa punëtore, ashtu si mbarë populli shqiptar, gjëzohet pa masë kur shikon se në të gjitha vendet kapitaliste e revizioniste këto vitet e fundit po rritet me shpejtësi veprimitaria revolucionare e punonjësve e bashkë me të edhe ndërgjegjja e tyre klasore.

Ndërsa borgjezia dhe revizionistët modernë, me ata sovjetikë në krye, janë të mbërthyer nga një krizë e rëndë që ka përfshirë si sferat ekonomike ashtu edhe ato të ideologjisë e të politikës, klasa punëtore, ku më parë e ku më pas, ku më me vendosmëri e ku më me pak forcë, po zbret në fushën e betejës dhe kërkon të marrë në duart e saj atë pushtet dhe atë rol që i ka caktuar historia. Është e sigurt se intensiteti, ashpërsia dhe shkalla e ndërgjegjes politike e ideologjike e lëvizjes revolucionare botërore do të vijnë gjithnjë duke urritur e duke u thelluar. Revolucionin nuk mund ta ndalojnë kurrë as shtypja e borgjezisë, as tradhtia revizioniste.

Tendencë e papërbajtshme e historisë në kohën

e sotme është bërë edhe lëvizja e fuqishme e popujve për çlirimin kombëtar nga zgjedha imperialiste, kolonialiste e neokolonialiste. Fitoret e shkëlqyera që ka arritur populli i Vietnamit kundër agresionit imperialist amerikan tregojnë se një popull që lufton me heroizëm për pavarësinë e tij është i pamposhtur.

Po bëhet më shumë se një muaj që kur luftëtarët heroikë të Vietnamit të Jugut po vazhdojnë me sukses sulmet e tyre të guximshme, më të mëdhatë dhe më të fortat që nga ofensiva e vitit 1968. Ata kanë arritur të çlirojnë shumë qytete, krahina, të mbërthejnë në darën e pamëshirshme të rrëthimit bazat e mëdha ushtarake amerikane dhe t'i shkaktojnë armikut dëme të pamatshme. Strategjia «vietnameze» e Uashingtonit është tronditur thellë. U provua se as tanë, as kurrë nuk mund të ketë «vietnamizim». Për Niksonin ka vëtëm një rrugë, të largohet sa më parë nga Vietnami, t'i lërë vietnamezët dhe gjithë indokinezët t'i zgjidhin vetë punët e tyre në liri e pavaresi të plotë nga çdo agresion dhe ndërhyrje e huaj. Këmbënguljet e qeverisë amerikane në vazhdimin e dhunës ushtarake dhe të manovrave politike për të arritur atë që ajo nuk mund ta realizojë në fushën e betejës, janë të destiguara të dështojnë me turp, ashtu siç ka ndodhur deri tanë. Vazhdimi i agresionit nuk mund ta ndalojë kurrë popullin vietnamez të çlirojë vendin e tij dhe të realizojë aspiratat e veta kombëtare. E ardhmja e Vietnamit dhe e popujve të tjerë të Indokinës është e sigurt. Këtë ata po e ndërtojnë me luftën e tyre të shenjtë përliri e pavaresi, me gjakun dhe sakrificat e tyre të panumërtë.

Klasa punëtore dhe populli shqiptar, të bindur në fitoren e tij të pashmangshme, kanë qenë dhe do të jenë deri në fund solidarë me popullin vëlla vietnamez dhe do t'i japin atij gjithë përkrahjen e tyre.

Populli shqiptar është plotësisht solidar dhe mbështet, gjithashtu, pa rezerva luftën e drejtë të popullit vëlla palestinez dhe të të gjithë popujve të tjerë arabë kundër agresionit izraelito-imperialist.

Luftha e popullit vietnamez, ashtu si edhe ajo e popujve të Azisë, të Afrikës e të Amerikës Latine, kundër imperializmit e, në radhë të parë, kundër atij amerikan, dëshmojnë se asnjë fuqi grabitqare, sado e madhe dhe e fortë që të jetë, nuk mund ta shuajë hevin e çlirimt kombëtar të popujve, nuk mund të ndalojë përmbysjen e raporteve të vjetra të vartësisë, shtypjes e të shfrytëzimit imperialist.

Popujt e botës janë ngritur tanë dhe po kundërshtojnë më me vendosmëri politikën e dhunës e të hegemonizmit që ndjekin imperialistët amerikanë e socialimperialistët sovjetikë, përpjekjet që ata bëjnë përzgjerimin e zonave të influencës dhe të ndarjes së botës, politikën e diktatit e të arbitraritetit të dy superfuqive imperialiste. Në mënyrë të veçantë masat punonjëse kundërshtojnë demagogjinë dhe parullat mashtruese të imperialistëve të vjetër e të rinj, të cilët, duke u hequr sikur preokupohen për paqen e sigurinë ndërkombëtare, kërkojnë të vënë në gjumë vigjilencën e popujve, të ndalojnë bashkimin e tyre në një front të përgjithshëm antiimperialist e antirevizionist, të çarmatosin ideologjikisht e politikisht të gjithë kundërshtarët e tyre revolucionarë.

Por përpjekjet e imperializmit amerikan e të socialimperializmit sovjetik, të të gjithë reaksionarëve, nuk mund ta ndalojnë marshimin fitimtar të punonjësve të botës, të klasës punëtore ndërkomëtare drejt emancipimit kombëtar e shoqëror, drejt revolucionit. Socializmi është e ardhmja e njerëzimit, prandaj ai as mund të ndalet, as mund të mënjanohet.

Fitoret e mëdha historike që po arrijnë në luftën e tyre kundër imperializmit dhe borgjezisë kombëtare punonjësit e vendeve kapitaliste e revisioniste, përbëjnë për të gjithë nc një tjetër burim frymëzimi të fuqishëm, një tjetër nxitje të madhe për të punuar akoma më me hov në vendin tonë, për të arritur të gjitha objektivat e caktuar, për ta çuar gjithnjë e më përpara çështjen e ndërtimit të socializmit në Shqipëri.

Më lejoni, të dashur shoqë e shokë delegatë, të përfitoj nga rasti për të përshëndetur përsaqësuesit e sindikatave të vendeve vëllezër dhe të punëtorëve revolucionarë, që asistojnë në Kongresin tuaj dhë nëpërmjet tyre klasën punëtore dhe gjithë punonjësit e vendeve nga kanë ardhur ata, t'u uroj suksese e fitore në luftën fisnike që ata bëjnë.

Klasa punëtore e Shqipërisë, gjithë punonjësit tanë, si deri sot, do të luftojnë për ta forcuar pa ndërprerje solidaritetin internacionalist me vëllezërit e tyre të klasës në vendet e tjera dhe do të përkrahin me vendosmëri luftën e punonjësve të të gjithë botës kundër imperializmit e shfrytëzimit kapitalist për çlirimin kombëtar, demokraci e drejtësi shoqërore, për fitoren përfundimtare të çështjes së madhe të proletariatit, socializmit.

Le të ngremë, të dashur shokë e shoqe, në një shkallë më të lartë frymën tonë revolucionare e disiplinën proletare, të përballojmë me guxim vështirësitë, të shmagim të metat, të ecim përpara në të gjitha frontet! Le të shpërthejnë të fugishëm vrulli dhe hovi i klasës sonë heroike punëtore, i masave punonjëse të qytetit e të fshatit, i grave dhe i të rinjve tanë, për të plotësuar e tejkaluar planin e vitit 1972 dhe të gjithë pesëvjeçarit, për ta bërë atdheun tonë socialist më të bukur e më të lulëzuar!

Rrofë Partia e lavdishme e Punës!

Rrofë klasa jonë punëtore heroike!

Rrofshin Bashkimet Profesionale të Shqipërisë socialistë!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i popullit»,
nr. 111 (7403), 9 maj 1972*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Raporte e fjalime
1972-1973», f. 89*

SOLIDARITETI INTERNACIONALIST KALITET
NË LUFTË KUNDER IMPERIALIZMIT
DHE REVIZIONIZMIT

*Nga biseda me delegacionet e huaja që morën
pjesë në punimet e Kongresit të 7-të të Bashkimeve
Profesionale të Shqipërisë*

11 maj 1972

*Në takimin me delegacionet e huaja, në pushimin
midis seancave të Kongresit të 7-të të Bashkimeve Profesionale
të Shqipërisë, shoku Enver Hoxha, pasi u
uroi shëndet të gjithëve, zhvilloi me ta një bisedë. Ndër
të tjera, Ai tha:*

Për ne üshtë ndër i madh që erdhët për të marrë
pjesë në punimet e Kongresit të 7-të të Bashkimeve
tona Profesionale dhe ju falënderojmë nga zemra për
ndihmën e madhe që po na jepni me vizitën në vendin
tonë të vogël socialist. Kjo do ta forcojë më tej luftën tonë
të përbashkët kundër imperializmit, me atë amerikan
në krye, kundër revizionizmit modern, me revisionizmin
sovjetik në krye, si dhe kundër të gjithë reaksionarëve.

Unë ju siguroj, të dashur shokë, se fjalët tuaja aq

të zjarrta e të sinqerta, që shprehët në adresën tonë në Kongres, do t'i mobilizojnë e do t'i frymëzojnë më shumë masat e popullit tonë në luftën kundër armiqve tanë të përbashkët. Solidariteti ynë internacionalist është shpëtimtar, prandaj le ta kalitim atë gjithnjë e më shumë në luftëra e në beteja revolucionare kundër imperializmit e revizionizmit! Populli shqiptar, që ka luftuar brez pas brezi, do të vazhdojë të luftojë me vendosmëri gjer në fitoren e plotë kundër kapitalizmit, i cili sa më afër fundit të jetë, aq më i egër bëhet.

Komunistët dhe të gjithë revolucionarët, patriotët dhe demokratët gjatë gjithë kohës e kanë ndier në kurrizin e tyre shtypjen e armiqve dhe e kanë të qartë se këta nuk i lëshojnë lehtë armët. Lufta e armatosur është një mjeti vendimtar për arritjen e fitores, por bashkë me luftën, duhet edhe politika. Ata që bëjnë luftë të ashpër e pa kompromis kundër armiqve të klasës, ata dinë të bëjnë njëkohësisht edhe politikë shumë të drejtë në interesin e revolucionit dhe nuk shkelin lehtë në dhogë të kalbur. Kjo do të thotë se ata nuk u bëjnë asnjë lëshim imperializmit, kapitalizmit dhe miqve të këtyre. Po t'u bënин qoftë edhe në një rast të vetëm lëshime, kjo do t'i ndihmonte armiqlë të risitonin terren të humbur.

Ka 28 vjet që ne e kemi çliruar vendin dhe tani po ndërtojmë socializmin. Natyrisht, këtë po e bëjmë duke përballuar shumë vështirësi, por ka rëndësi që ne ecim me vendosmëri në rrugën tonë, duke u qëndruar besnikë mësimive të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit dhe, duke i zbatuar në përshtatje me kushtet tona, sepse kushtet ndryshojnë nga vendi në vend. Të tjera

kushte ka pasur në Rusi kur u bë revolucioni, krejt ndryshe janë sot ato në Austri, në Algjeri, në Kili e gjetkë. Doktrina jonë marksiste-leniniste na ndriçon rrugën dhe na mëson si të veprojmë në rrethana të vecanta, ajo është projektori që nuk shuhet kurrë, që na orienton si t'i shfrytëzojmë situatat.

Doktrina marksiste-leniniste nuk u shërben vetëm komunistëve. Ajo është pasuri e të gjithë njerëzve që e duan popullin dhe luftojnë për interesat e tij. Partia jonë, në bazë të mësimeve të marksizëm-leninizmit si-kundër po e shikoni edhe në këtë Kongres, thekson se socializmin e ndërtojnë masat, prandaj marksizëm-leninizmin duhet ta përqafojnë edhe ato e jo vetëm Partia, pararoja e klasës punëtore, e cila do të jetë e fortë, në qoftë se armatat pa mbarim të masave të popullit do të jenë me të dhe do të luftojnë në rrugën e saj duke qenë të ndërgjegjshme ideologjikisht dhe politikisht.

Në fushën ndërkombëtare Partia jonë është me gjithë shpirt dhe me të gjitha forcat e saj me ju, me luf-tën e të gjithë popujve, që luftojnë për liri e demokraci. Nuk është aspak demagogji nga ana jonë kur deklarojmë se ne do të luftojmë deri në sakrificën e fundit, derisa çdo popull të çlirohet nga cilido shfrytëzues, qof-të imperialist, revisionist apo kapitalist. Për interesin e socializmit, të popullit tonë dhc të të gjithë popujve, ne do të vazhdojmë t'i demaskojmë pa u ndalur armiqtë e klasës, do t'i luftojmë ata deri në fund pa mëshirë, me ato forca e mundësi modeste që kemi. Edhe sikur tū na sulmojnë, ne përsëri do të luftojmë dhe kemi besim të patundur se do t'i mundim. Ne dëshirojmë

që të gjithë të mendojnë e të veprojnë në bazë të marksizëm-leninizmit, sepse vetëm atëherë do t'u vihen barrikada të pakapërcyeshme imperializmit amerikan dhe revizionizmit sovjetik.

Me këtë në asnje mënyrë nuk dua të them sikur jemi ne, shqiptarët, të vetmit që luftojmë kundër armiqve të popujve, sepse ka edhe shumë popuj të tjerë që luftojnë heroikisht, shembulli i të cilëve të frysmezon dhe të jep kurajë. Të tillë popuj që luftojnë janë ai i Vietnamit, i Laosit, i Kambozhias, i Palestinës, popujt e vendeve arabe në përgjithësi, popujt e Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine, proletariati i të gjithë botës, që lufton në kushte të vështira.

Për të zbutur, në mos pér ta shuar fare kundërshtimin e popujve, armiqtë përpiken t'i mashtrojnë këta, duke u dhënë njëfarë «lirie» e «demokracie». Me këtë taktkë ata synojnë të zbulojnë e t'i njohin forcat revolucionare atje ku janë, që pastaj t'i godasin e t'i asgjësojnë më lehtë. Por, me gjithë manovrat e mëdha të armiqve, popujt në vendet tuaja, të dashur shokë e vëllezër, bëjnë kudo një luftë heroike, pér të cilën ne u jemi shumë mirënjohës, sepse ajo ndihmon e lehtëson luftën e popullit tonë pér të mbrojtur lirinë, pavarësinë e socializmin. Liria dhe pavarësia e atdheut, ndërtimi i socializmit në Shqipëri varen, në radhë të parë, nga uniteti, forca dhe lufta jonë, por ato varen, gjithashtu, edhe nga lufta e popujve, nga lufta e klasës punëtore në tërë botën, nga lufta juaj. Kjo vërteton tështë pavdekshme të Leninit, sipas së cilës faktori i jashtëm, kryesisht lufta e proletariatit ndërkombëtar, lufta e popujve, është një nga kushtet kryesore pér çlirimin e

çdo populli. Ekzistencë e një faktori të tillë na krijon bindjen e plotë se, me luftë të vendosur e të përbashkët dhe në unitet marksist-leninist me njëri-tjetrin, do t'ua shkatërrojmë themelët imperializmit, kapitalizmit dhe revizionizmit.

Në luftëra të pandërpërra kundër imperialistëve, kundër kapitalistëve të ndryshëm, kundër revizionistëve, të gjithë ne, në unitet marksist-leninist, përbëjmë një forcë të madhe të fuqishme në mbrojtje të revolucionit. Pikërisht këtë forcë, që ka dalë në mbrojtje të të gjithë popujve, imperialistët me ata amerikanë në krye, revizionistët, me ata sovjetikë në krye, dhe të gjithë reaksionarët, përpiken ta godasin, ta dëmtojnë.

Në botë, mjerisht, ka akoma njerëz që i quajnë leninistë revizionistët sovjetikë. Por si mund të jenë leninistë ata që kryejnë akte agresioni dhe kërcënojnë vendet e tjera? Hitleri bënte gjëra të tillë. Stalini s'vepronte kurrë kështu. Stalini ishte njeri i madh. Revizionistët i hodhën pluhur, bënë shumë shpifje të ulëta kundër personit të tij, por ata nuk e atakojnë dot atë as në parimet e as në teoritë e tij. për arsyec se veprat që ai ka shkruar njerëzit i kanë në dorë dhe i lexojnë, se gënjeshta i ka këmbët e shkurtra dhe njerëzit shohin se çdo gjë që ka thënë Stalini, është vërtetuar.

Nuk po ju përmend këtu ato që ka thënë Partia jonë kundër titistëve, të cilat kanë qenë të gjitha të drejta dhe të vërtetuara e nuk i lëviz as topi, por, besoj se keni dëgjuar që vetë Titoja me gojën e tij ka deklaruar, botërisht, në një fjalim të kohëve të fundit, se partia e tyre është mbushur me armiq, se në Jugosllavi ka ngritur veshët nacionalizmi, janë pasuruar kulakët,

persona të veçantë kanë grumbulluar kapitale etj. Pikerisht këto ka thënë Stalini në kohën e vet për Titon dhe të gjitha janë të shkruara. Si marksist-leninist që ishte, ai i këshillonte në atë kohë udhëheqësit e Jugosllavisë të shikonin gabimet e tyre, t'i korrigjonin ato, mirëpo ata vazhduan ashtu si e kishin nisur, dhe përfunduan si buharinistë e trockistë, ashtu si e kishte parashikuar Stalini. Tani flasin edhe vetë për situatën e keqë që është krijuar në Jugosllavi. Kjo ndodhi se Titoja nuk eci sipas mësimave leniniste. Kurse Stalini, siç e dimë të gjithë, iu përmibajt gjer në fund mësimave të Leninit, veproi dhe luftoi për zbatimin e ideve e të këshillave të tij.

Imperializmi dhe revizionizmi modern ndodhen sot në kushte shumë të vështira. Vala e revolucionit është në ngjitje dhe koha punon për popujt. Në Vietnamin amerikanëve u ka ardhur thika në grykë. Ju jeni në dijeni se kohët e fundit ata bllokuan portet detare të Vietnamit. Po çfarë do të nxjerrin nga kjo? Çfarë do të nxjerrë Niksoni, ky kriminel lufte, nga bombardimet që vazhdojnë të bëhen me urdhër të tij në Vietnam? Asgjë! Populli i Vietnamit ka shumë vjet që po lufton. Ai ka fituar një eksperiencë kolosale në luftë, kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës po pësojnë humbje të mëdha jo vetëm ushtarake, por sidomos politike dhe ekonomike. Aviacioni është i vetmi mjet që u ka mbetur, por vietnamezët kanë një eksperiencë aq të madhe në luftën kundër imperialistëve amerikanë, saqë edhe aviacioni i tyre i fuqishëm është pa efekt përballë ofensivës së popullit vietnamez që ecën me sukses përpara, në një kohë kur kukullave saj-

goneze nuk u mbahen këmbët. Kukulla, tradhtarë të atdheut, kemi njohur edhe ne në vendin tonë. Ne i quanim ata ballistë. Kur ballistët ishin krah për krah me divisionet e armikut, krekoreshin, por, kur ne i thyenim sulmet e pushtuesve, ata ua mbathnin këmbëve, derisa më në fund i hodhën armët. Kështu po ndodh sot edhe me reaksionarët e Sajgonit. Nga ana tjetër, jemi të sigurt se ndihma nga ana e miqve për Vietnamin, për luftën e popullit të tij heroik, kurrë nuk do të ndërpritet, kurrë nuk do të mungojë.

A mund të çojë tanë Niksoni ushtarë të tjerë në Vietnam? Ai natyrisht mund të çojë, sepse nga imperializmi çdo gjë të keqe mund të presësh. Por, fundja, çfarë do të bëjë ai atje me ta? Deri para pak vjetësh ai kishte qindra mijë ushtarë në Vietnam, po ç'fitoi? Asgjë! Vietnamesezët i grinë. Prandaj, edhe sikur të dërgojë përsëri akoma më shumë, nga ana ushtarake s'ka ç'bën, lëre pastaj humbjen e madhe, të mëtejshme, politike që do të pësojë. Është për këtë arsyec që imperialistët amerikanë, me anën e revizionistëve sovjeticë, po përpilen të bëjnë dallavere, të kurdisin kurthe e të organizojnë komplotë, por ne jemi të bindur se vietnamezët, që kanë derdhur kaq gjak në këtë lustë të madhe çlirimtare, do të dinë edhe t'i mbrojnë fitoret e arritura. Ata janë vetë të zotë të vendosin për fatin e tyre, kurse të gjithë ne, miqtë e vërtetë dhe völlezërit e tyre, do t'i ndihmojmë të fitojnë. Ata janë në gjendje ta bëjnë vetë politikën dhe mendojmë se e bëjnë drejt dhe kjo duket në faktin se po u jatin dru imperialistëve amerikanë për ta mbajtur mend për tërë jetën. Me luftën e tyre heroike, vietnamezët po u tre-

gojnë popujve të tjerë se edhe një fuqi e madhe imperialiste mund të përballohet me sukses, kur ekziston vendosmëria dhe kur luftohet për një çështje të drejtë.

Edhe ne e mundëm Musolinin, e mundëm Hitlerin, sepse luftuam për një çështje të drejtë. Për një qëllim të tillë ne jemi në gjendje t'i mundim edhe imperialistët amerikanë, po të na sulmojnë. Shihni, pra, ç'besimi të madh krijon në forcat tona lufta e popullit heroik të Vietnamit, ç'frymëzim, ç'dashuri e simpati të madhe ngjall për të kjo luftë e tij e drejtë.

Prandaj ne, shokë të dashur, e forcojmë gjithnjë e më shumë dashurinë ndërmjet nesh për të realizuar qëllimin tonë të madh. Qëllimi ynë, politika jonë e goditjes, është luftë kundër kapitalizmit. Në këtë drejtim ne duhet të dimë të mobilizojmë klasën punëtore në çdo vend, të kalitim përherë e më tepër unitetin e saj të çeliktë në luftën kundër kapitalizmit, jo vetëm në sferën ekonomike, por gradualisht edhe në fushën politike, deri në përgatitjen e kushteve përmarrjen e pushtetit politik. Natyrisht, kjo nuk mund të realizohet në një ditë, ajo duhet përgatitur dhe diku do të vijë më përpara, diku më pas, sepse diku lëvizja qëllon të lëkundet, diku afirmohet më shpejt e më me vendosmëri.

Në këtë luftë ka rëndësi zgjuarsia dhe kujdesi përtë dalluar intrigat e armiqve të klasës dhe të lirisë së popujve, sepse armiqtë janë dinakë në politikë dhe në metodat e luftës kundër nesh, ata kanë një eksperiencë të madhe në këtë drejtim. Prandaj ne duhet t'i kundërshtojmë ata me energji akoma më të madhe, duke u udhëhequr nga pikëpamje të qarta politiko-ideologjike. Në këtë drejtim ka rëndësi të dorës së parë

edhe çështja e organizimit. Më kujtohet se në një nga veprat e tij Marksi ka thënë se proletariati botëror duhet të shtrëngojë radhët e veta, të forcojë unitelin dhe organizimin, pasi ata janë e vetmja armë e tij, që do ta ndihmojë për të penguar e për të shkatërruar sulmin e kapitalit. Pra, kur ne ecim kështu, me radhë të shtrënguara fort, armiku nuk ka ku depérton.

Por në radhët e proletariatit ndërkombëtar sot ka përqarje, që shkaktohet nga kapitalizmi e revizionizmi, nga ideologjia e tyre që paraqitet me maska nga më të ndryshmet, për tu dukur «demokratike», bile edhe «komuniste», por që në thelb është reaksionare. Revisionistët modernë s'lënë rast pa propaganduar me të madhe sikur janë komunistë. Por për ne është e qartë se ata s'janë aspak të tillë, ata janë antikomunistë, janë të shitur hapur te borgjezia ndërkombëtare dhe te qeveritarët e saj.

Ne duam të bëjmë aleancë me të gjithë njerëzit e ndershëm dhe me forcat patriotike, që janë hedhur në luftë kundër imperializmit dhe kundër gjithë atyre që e ndihmojnë atë, pra edhe kundër revisionistëve, të cilët për tu maskuar, përdorin vazhdimisht parulla marksiste, por në fakt bëjnë lidhje e aleanca me kapitalistët dhe me të gjithë reaksionarët. Pra, nuk mund të bëhet krahasim midis politikës së marksistë-leninistëve të vërtetë dhe politikës tradhtare të revisionistëve. Pikërisht këtu ndahemi ne me revisionistët.

Ka njerëz që mendojnë të bëjmë një front të përbashkët antiimperialist me të gjithë, pa dallim, duke përfshirë edhe revisionistët modernë. Po si mund ta bëjmë ne këtë front antiimperialist me të gjithë? Të

bëjmë front antiimperialist me revizionistët sovjetikë dhe lakenjtë e tyre, që janë në ujdi pikërisht me imperializmin më të egër, me atë amerikan dhe me gjithë kapitalistët e tjerë të botës, që shtypin dhe shfrytëzojnë popujt? Kurrë nuk mund të bëjmë ne një aleancë të tillë¹! Ne mund të bëjmë aleanca vetëm me ata që luftojnë kundër imperialistëve, pavarësisht se nuk janë komunistë, me të tilla forca antiimperialiste mundet dhe duhet të bashkohemi kundër armikut të përbashkët, imperializmit dhe, në radhë të parë, atij amerikan.

Politika e shtetit tonë bazohet në parimet e patundura të marksizëm-leninizmit, ajo s'mund të pajtohet me propozimet që bëjnë disa shtete, propozime që ne, duke u bazuar në faktet, mendojmë se nuk janë realiste. Ne, sfala vjen, mendojmë që në detin Mesdhe të mos ketë as flotë amerikane, as sovjetike. Ky qëndrim është shumë i drejtë. Vendi ynë për këtë çështje nuk ka vepruar vetëm me fjalë. Të gjithë e dinë se 10-12 vjet përpëra disa nëndetëse sovjetike qëndronin në bazën e Vlorës sipas marrëveshjes së Traktatit të Varshavës, por kur Partia jonë zbuloi kursin tradhtar të revizionistëve sovjetikë dhe pa se ata nuk ishin aleatë, por armiq, Republika Popullore e Shqipërisë u tha atëherë me plot gojën dhe pa u druajtur «Jashtë!», ngriti topat kundër tyre dhe flota e Hrushovit menjëherë u detyrua të largohej. Kurse flota amerikane nuk i ka parë kurrë portet e vendit tonë.

Në qoftë se të gjitha vendet e Mesdheut nuk do

1. Aluzion për pikëpamjet e gabuara të udhëheqjes kineze.
(Shih: Enver Hoxha, «Shënimë për Kinën», vëll. I, f. 116-124.)

të lejonin flotat amerikane dhe sovjetike të futen në portet e tyre, atëherë ato do të detyroheshin të dilnin nga Gjibraltari dhe Dardanelet se do të mbeteshin si peshku pa ujë. Por kjo nuk po bëhet, sepse shtetet që bëjnë pjesë në NATO janë kthyer në baza të përherëshe navale të amerikanëve. Disa shtete të tjera, megjithëse nuk e duan flotën sovjetike në portet e tyre, për disa arsyë e lejojnë atë të qëndrojë dhe të furnizohet, kurse disa të tjerë si Titoja, që hiqen të paangazhuar, herë pas here pranojnë t'u vizitojnë portet kryqëzorët sovjetikë dhe amerikanë. Po përse vijnë këto anije në këto vende, për vizita miqësore? Ato janë anije lufte, sillen si piratë, krijojnë rreziqe për luftëra e agresione kundër popujve. Në këto kushte nuk mund të mblidhemi e të bisedojni, siç thotë një ministër i Titos, për të diskutuar «dëbimin» e flotave sovjetike dhe amerikane nga Mesdheu. Në mbledhje të tillë mund të bëhen vetëm llase për të gënjer popujt dhe opinionin ndërkombëtar. Jo, të dashur shokë, ne nuk mund të bëjmë një gjë të tillë, por u themi armiqve: «Larg duart nga vendet tonë!». Është e domosdoshme që popujt të bëhen më parë të ndërgjegjshëm për të mos i pranuar këto flota në vendet e tyre, duke ua bërë të qartë se ato përbëjnë një rrezik të madh për ta.

Ne jemi të bindur se do të vijë dita që anijet sovjetike edhe nga Aleksandria do t'i ngrenë plaçkat¹, sepse popujt arabë nuk mund të gënjen nga disa

1. Në prill të vitit 1976 Egjipti anuloi lehtësitetë portuale për flotën sovjetike dhe urdhëroi largimin e rusëve nga porti i Aleksandrisë.

armë që u japid sovjetikët, nga këta revizionistë që përpiken t'i frenojnë për të mos realizuar ëndrrën e tyre të çlirimtë tokave që u përkasin. Nuk mund të gjenjchen luftëtarët palestinezë nga fjalët e Brezhnjevit ose të armiqve të tjera, sepse ata kanë me dhjetura vjet që vuajnë jashtë territorit të atdheut të vet edhe për bukën e gojës. Disa thonë se perspektiva e fitores së luftës së këtyre popujve nuk është aq e afërt. Por perspektiva bëhet e afërt në rast se intensifikohet lufta. Kush lufton, ai medoemos do të fitojë. Liria nuk dhu-rohet, atë s'ta jep njeri, por fitohet. Kur lirinë e fiton vetë, atëherë di edhe ta mbrosh. Kështu mendon dhe thotë populli shqiptar.

Ka njerëz që nuk i kuptojnë drejt qëndrimet tona dhe pyesin: „More, mos janë të marrë këta shqiptarët që veprojnë kundër të gjithë armiqve?.. Ne jemi kundër dhe do t'i luftojmë të gjithë ata që duan të na shkelin tokat e atdheut, edhe po të na sulmojnë një nga një, edhe sikur të na sulmojnë të gjithë së toku. Populli shqiptar i ka bërë mirë llogaritë, ai ka shpallur solemnisht se për të jetuar i lirë, për të nuk ka tjetër rrugë, veç luftës. Prandaj kush nuk e merr parasysh këtë, le t'i prekë kufijtë e vendit tonë, por duhet ta ketë të qarti se nuk do të fitojë kurrë, se asnjë ditë nuk do të qëndrojë i qetë dhe pa u gjakosur nga një popull i armatosur mirë moralisht, politikisht, ideologjikisht, dhe ushtarakisht, siç është populli ynë.

Disa thonë se ata kundër të cilëve ne flasim, janë fuqi të mëdha që mund të bashkohen edhe së toku kundër vendit tonë. Le të bashkohen! Shqipëria vërtet është vend i vogël, por për armiqtë ajo do të jetë si

vrima e gjilpërës. Forcat e tyre, sado të mëdha, do ta kenë të vështirë të kalojnë këtu. Partia jonë do të ndjekë për këtë qëllim një taktikë dhe një strategji të tillë që kushdo që do të orvatet të vëré këmbë në tokën tonë, nuk ka pör të dalë i gjallë. Askush, sado i madh të jetë, s'ka ç'bën në Shqipëri, i rrofshin divizionet! Edhe nga ajri po të vijnë ata, malet tona s'duan t'ia dinë. Populli dhe Partia jonë i kanë marië masat e mbrojtjes në çdo drejtim.

Ne jemi gati të bëjmë tregti me cilindo që dëshiron të rrojë në marrëdhënie të mira me Shqipërinë, por ta kenë të gjithë të qartë se politikisht dhe ideologjisht ajo do të vazhdojë të demaskojë cilindo armik që vepron kundër interesave të njerëzimit. Kjo nuk është aventurë, por një qëndrim i vendosur që mbështetet në një logjikë të fortë marksiste-leniniste, që mbështetet në luftën për mbrojtjen e atdheut dhe për ndërtimin e socializmit dhe synon t'u vijë në ndihmë proletariatit ndërkombëtar, revolucionit dhe popujve që luftojnë për liri. Lufta jonë, në kuadrin e përgjithshëm, është modeste, por atë që kemi mundësi, ne e bëjmë dhe do ta bëjmë deri në fund. Për këtë të jeni të sigurt, shokë dhe miq të dashur.

Rroftë uniteti internacionalist midis popujve të vendeve tona!

Gëzuar të gjithëve! Të rroni ju! Për shëndetin tuaj!
Ju saleminderit shumë të gjithëve!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimive të mbajtura në këtë
takim, që gjenden në AQP*

**PAGAT QË MERREN, TË MERITOHEN
ME PUNE**

S h ë n i m e

17 maj 1972

Pagesa e punëtorëve është një problem ekonomik dhe politik me shumë rëndësi. Ky problem e ka preokupuar vazhdimisht udhëheqjen tonë, janë bërë studime, janë marrë vendime, herë pas here mbi to janë bërë edhe korrigjime. Por jeta ka provuar se në disa periudha kohe, kur janë vërtetuar shumë faktorë si: zgjerimi i ekonomisë, rritja e industrisë, vënia në shfrytëzim e makinerive moderne me një teknologji të përparuar, zhvillimi i arsimit dhe i kulturës së punonjësve, zhvillimi me sukses i revolucionit tekniko-shkençor, zhvillimi dhe vendosja e normave të reja progressive e teknike, kërkohet një rishikim i gjithanshëm jo vetëm i librave të kategorizimit të punës së punëtorëve dhe të pagave të tyre, por edhe një rishikim i plotë, i harmonishëm, i balancuar dhe jo i pjesshëm i të gjitha kategorizimeve të punonjësve të republikës, duke përfshirë këtu edhe punonjësit me rrogë në kooperativat bujqësore.

Byroja Politike ngarkoi, shumë muaj më parë, Qe-

verinë ta studionte këtë problem dhe të na e paraqiste për të vendosur në muajin qershori. Studimin ma dhanë më parë, që ta shihja, të jepja mendimin dhe vërejtjet e fundit, para se ai t'i paraqitej Byrosë Politike. Unë e studiova me vëmendje këtë material, i cili kish-te mjaft boshllëqe, bëra një sërë sugjerimesh për t'u thelluar më tej studimi dhe për t'u paraqitur më i plotë, jo në qershori, por në shtator-tetor të këtij viti.

Cilat ishin vërejtjet e mia?

Aktualisht ekziston edhe kategorizimi i proceseve të punës, edhe kategorizimi personal i punëtorëve, sipas aftësive në punë dhe arsimimit të tyre, duke synuar drejt unifikimit të klasave të të dy kategorizimeve, domethënë, atij të punës dhe të punëtorëve. Ndërkohë shpërblimi i punës bëhet duke u mbështetur, si rregull, në tarifën e pagës për kategorinë e punës që kryen punëtori.

Unë sugjerovala të studiohej varianti që të ketë vetëm kategorizim të punës, ndërsa kategorizimi personal të hiqet dhe të zëvendësohet me një nocion më të gjerrë, me atestimin zyrtar kulturor e profesional, që t'i korrespondojë kategorizimit të punës ku do të punojë punëtori. Atestimi kulturor e profesional nuk do të paguhet, po do të zbatohet kriteri i pagesës sipas punës që kryen punëtori, domethënë sipas kategorisë së vendit të punës. Natyrisht, kjo nuk mund të jetë e pandryshueshme. Po qe se në të ardhmen, me shtimin e madh të kontingjenteve të rinisë në prodhim, do të lindë nevoja të nxitet më mirë kualifikimi i punëtorëve, mund të shikohet edhe kalimi në formën e pagesës, sipas shkallës së atestimit të punëtorit (përkohësisht ose për një

kohë më të gjatë), atje ku ai punon në procese pune me kategori më të lartë se atestimi që i është dhënë.

Çdo punëtor do të synojë të ngrihet në kategorinë e punës, të punojë në procese pune me kategori më të lartë, por ai e di që më parë se, për t'ia arritur këtij qëllimi, duhet të kualifikohet, të fitojë shkallën e nevojshme të atestimit kulturor e profesional. Punëtori që nuk është interesuar të marrë kualifikimin e përshtatshëm, duhet t'ia lërë vendin atij që është kualifikuar dhe vetë të zgresë në kategorinë e punës që i përket. Në këtë mënyrë bëhet e qartë për punëtorët që punojnë në kategori më të larta nga sa i kanë atestimet e tyre, se këtu janë provizorë, derisa nuk kanë specializimin që kërkohet.

Ngritja kulturore e profesionale, atestimi, kualifikimi dhe vjetërsia në punë janë faktorë të rëndësi shëm, nga të cilët varet realizimi si duhet, në sasi, në cilësi, në kosto dhe në kohë i prodhimit. Prodhimi dhe puna e imbaruar kanë vlerën e provimit; nëse të gjitha këto çështje punëtori i ka përvetësuar dhe i ka realizuar, ai edhe paguhet më shumë. Koha, eksperienca në punë, kanë rëndësi të madhe, por edhe kultura, teoria ka po ashtu rëndësi të madhe, prandaj ne nuk duhet të lejojmë lëshime, që njëra të eliminojë tjetrën, që njëra të nënveftësojë tjetrën. Ne duhet të punojmë e të synojmë që punëtori, sidomos rinia, të ketë horizont të gjerë, të ketë interesa të shumtë, të përgatitet në mënyrë të gjithanshme për prodhimin, por të ketë njohuri edhe për drejtimin e kontrollin e punëve në ndërmarrje, edhe për vijën e Partisë dhe politikën ekonomike të shtetit tonë socialist.

Në lidhje me këto parime ne duhet të studiojmë më thellë këto dy çështje:

1. — A i përgjigjen si duhet aktualitetit kategorizimet e sotme të punës, a duhet të qëndrojmë me këtë shkallëzime, a duhet të ecim duke i ngushtuar apo duke i zgjeruar shkallët e kategorizimit të punës?

2. — A u përgjigjen kërkesave të reja të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës të njerëzve tanë kërkesat aktuale të kualifikimit për kategoritë e ndryshme të punës?

Në lidhje me këto, kualifikimi i punëtorëve duhet të ndryshojë drejt përmirësimit në brendi dhe për këtë duhet të ndryshojnë edhe format aktuale të vlerësimit të tij. Unë mendoj se ne nuk duhet të mbajmë një kualifikim «të thërrmuar» që t'i përgjigjet në mënyrë strikte kategorizimit të punës dhe që, megjithëse «i përshtatet» kategorisë së punës, është i pamjaftueshëm. Kjo formë është shumë liberale, subjektive dhe njerëzit ngjiten në kategori me një shpejtësi të madhe. Rrjedhimisht në një kohë të shkurtër arrihet të merren paga të larta të pajustifikueshme në lidhje me punën që bëhet dhe me prodhimet pa cilësinë e duhur apo skarco, që dalin nga duart e tyre.

Ne duhet të kemi kurse ose shkolla (siç mund t'i quajni, kjo s'ka rëndësi) një-dy ose trevjeçare, ku të mësohen ato dijeni që u duhen punëtorëve për të fituar ato kategori personale të grupuara (shkallë atestimi), që u korrespondojnë kurseve dhe kualifikimeve permanente dhe kështu, brenda një kohe të caktuar, punëtori të kualifikohet për sa kategori që do ai dhe për të cilat ka nevojë edhe shteti. Kualifikimin shteti ia jep

gratis punëtorit, bile, i bën edhe favorizime, prandaj ky duhet ta kuptojë vetë interesin e madh që ka personalisht, si edhe shteti i tij, për kualifikimin e tij, që duhet të atestohet dhe ky atestim të dokumentohet për çdo etapë të ngritjes së tij, e cila bëhet në mënyrë shumë më të organizuar dhe më me kërkesa shkencore.

Krahas kësaj, ne duhet të vazhdojmë edhe edukimin e kualifikimin e përditshëm në çdo punë: në fabrika, në ara, në zyra, në shkolla, me lloj-lloj formash. Ky kualifikim nuk kërkon atestim kulturor e profesional, por e para e ndihmon të dytën, ajo hyn në perfektionimin e përditshëm që fuqizon studimin për kualifikimin, në kurse o në shkolla, siç do t'i quajmë. Asnjë nuk duhet të mendojë dhe të thotë: «Unë mësova, prandaj duhet të paguhem», por duhet të thotë: «Unë punoj, prandaj paguhem dhe që të punoj si duhet, duhet të mësoj».

Në lidhje me studimet që do t'i paraqiten Byrosë Politike u rekomandova shokëve, që do të vazhdojnë të plotësojnë studimin, të kenë parasysh se çështja e kategorizimit të punës nuk duhet të bëhet e veçuar nga pagat e nëpunësve e të specialistëve. Baza e kategorizimeve dhe e diferencimeve në paga duhet të jetë ajo e punëtorëve dhe, mbi këtë bazë, të rregullojmë gjithë proporcionet e pagave të nëpunësve, duke përfshirë këtu edhe ata që punojnë në kooperativa. Atestimi i nëpunësve duhet të kuptohet dhe të shërbejë njëlloj si edhe për punëtorët, domethënë paguhet vendi i punës dhe jo diploma ose atestimi, por diploma ose atestimi duhet t'i korrespondojë vendit të punës.

Me këtë rast ne duhet të studiojmë e të zbulojmë

anomalitë që ekzistojnë në sistemin aktual, vendimet e rastit e të pjesshme që kemi marrë herë pas here të shtyrë nga rr Ethanat. Rr Ethanat dhe gjynahet e vjetra mund të jenë ferra të pakapërcyeshme edhe tash, por për to mund të marrim disa vendime speciale që ferrat t'i spastrojmö dhe të mos na pengojnë të vendosim një sistem të shëndoshë ideologjikisht, politikisht, ekonomikisht dhe organizativisht të përshtatshëm me zhvillimin aktual të gjendjes së vendit tonë.

Studimi që më paraqitën jo vetëm që kishte bo shllëqe, por ai nuk tregonte as arsyet që na shtynin ta bënim, pse këndej duhej të dilnin edhe metodat e ndjekjes për studimin e problemeve dhe të variantave të ndryshme. Metoda e përdorur vërteton cektësinë e studimit.

Duhet të kemi parasysh se sistemi që do të vendosim dhe ndryshimet që do të bëjmë në përgjithësi, të mos e ulin nivelin aktual të jetesës së punonjësve, por edhe pagat që merren, të meritohen me punë, të vlerësohen djersa, zotësia, vjetërsia, kualifikimi e kultura, vështirësitë në punë dhe çdo njeri që paguhet, të nxjerrë punë të pastër në sasi, në cilësi, në kosto, në kohë.

Botohet për herë të parë si-pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PËR THELLIMIN E DEMOKRACISË SOCIALISTE NË FAMILJE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

24 maj 1972

Do të them edhe unë disa fjalë për çështjen që po shqyrtojmë në këtë mbledhje të Sekretariatit. Para së gjithash dëshiroj të shpreh kënaqësinë për diskutimet e mira dhe të pjekura të shoqeve të rrëtheve që punojnë në Organizatën e Bashkimit të Grave. Jam shumë i gëzuar që Partia ka përgatitur me një punë të palodhur të tillë shoqe të asta, të cilat janë në gjendje të kup-tojnë thellë dhe të zbatojnë drejt në jetë vijën e saj. Nuk kam asnjë dyshim se si shoqet që dëgjuam, në Parti ne kemi me qindra e mijëra të tjera, që duhet të

1. Në këtë mbledhje u diskutua rrëth raporteve të komitetave të Partisë të rrëtheve të Elbasanit, të Mirditës dhe të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm të BGSH, si dhe informacioneve të shoqeve përgjegjëse të Organizatës së Bashkimit të Grave të rrëtheve të Përmetit, të Shkodrës, të Mirditës dhe të Elbasanit për rezultatet e arritura dhe masat për të zhvilluar më tej lëvizjen për thellimin e demokracisë socialiste në familje.

vlerësohen, të inkurajohen dhe të përkrahen nga të gjithë, nga Partia në radhë të parë, për punën e mirë që bëjnë. Ato duhet të përkrahen jo në mënyrë sentimentale e në kuptimin mikroborgjez, se janë gra dhe «gruaja është seks i dobët», as për arsyen se «kështu thotë Partia», por sepse problemi i gruas është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Gruaja nuk ka vetëm funksionin që të përtërijë jetën, ajo është një krijesë shoqërore me të cilën janë të lidhur jeta dhe gjithë përparimi i shoqërisë njerëzore në çdo hallkë e në çdo pikëpamje që mund ta marrësh.

Partia jonë, që kur është krijuar, tanë dhe vazhdimisht në të ardhmen, ka luftuar, lufton dhe do të luftojë për çlirimin e plotë të gruas. Ajo e bën këtë jo vetëm pse gruaja përbën gjysmën e shoqërisë, por sepse ky qëndrim i saj rrjedh nga politika parimore që ndjek Partia për çlirimin e të gjitha masave të popullit. Qyllimi i Partisë sonë dhe i komunizmit është çlirimi i të shtypurve, i gjithë atyre që vuajnë nga shfrytëzimi ekonomik, nga mungesa e lirive demokratike dhe, përgjithësisht, nga të gjitha format dhe mbeturinat e parazisë shoqërore. Gjithë lufta e Partisë ka synuar të çlirojë të gjithë punonjësit e Shqipërisë, burra e gra, të rinj e të reja, pleq e plaka. Kjo luftë vazhdoi derisa njerëzit u çliruan dhe fituan liritë politike, shoqërore dhe ekonomike.

Që të konsolidoheshin fitoret e arritura, nbi baza dhe parime të reja u organizuan, me shumë përpjekje e sakrifica, ekonomia, edukimi ideopolitik e moral i njerëzve, arsimi, kultura etj. Partia, pasi i dha pushtetin popullit, sot qëndron në krye të tij për të ndërtuar je-

tën e lumtur, shoqërinë socialiste. Jeta' jonë po ecën përpara me një vrull të madh, revolucioni ynë zhvillohet pa ndërprerje dhe po thellohet në të gjitha suhat, ne luftojmë që niveli material dhe kulturor i masave punonjëse të përmirësohet vazhdimesht më tej. Por duhet të kuptojmë mirë se në këtë zhvillim, me gjithë përmirësimet e arritura, që janë të pakrahasueshme me të kaluarën, ka dhe dallime, ka disnivele, siç është, për shembull, ai lidhur me gjendjen ekonomiko-shoqërore e kulturore midis qytetit dhe fshatit. Ne shikojmë që qendrat e punëtorëve dhe qytetet furnizohen më mirë se fshati me mallra të konsumit të gjerë. Me gjithë përpjekjet që bëhen për ngushtimin e këtij dallimi, si dhe të dallimeve të tjera, prapëserapë jemi larg «mbylljes së gérshërvë», sepse nuk kemi arritur akoma t'i japim popullit ato për të cilat ka më shumë nevojë, në sasi dhe cilësi.

Sikurse dihet, lufta e Partisë synon që të gjithë njerëzit tanë të pajisen me arsim dhe me kulturë marksiste-leniniste, por edhe në këtë fushë ka një disnivel, që, në kushtet e sotme, është i natyrshëm. Do të vijë një kohë, pas shumë brezash, kur në vendin tonë nuk do të ketë më dallime të theksuara në këto drejtime, kur vërtet do të ketë njerëz më pak të mësuar, të mësuar dhe më shumë të mësuar, po nuk do të ketë më analfabetë dhe gjysmanalfabetë. Pra, me gjithë ndryshimet që do të ekzistojnë midis njerëzve, ne do të arrijmë një nivel të përgjithshëm arsimor e kulturor shumë më të lartë se në kohën e sotme. Kjo gjë, natyrisht, do të vijë si rezultat i zhvillimit të madh ekonomik të vendit, si rezultat i zhvillimit të arsimit dhe të kultu-

rës sonë. Këto suksese do të shërbejnë si bazë për përmirësimin e mëtejshëm të jetës së njerëzve, të kushteve ekonomike dhe të nivelit kulturoro-arsimor të tyre dhe, si pasojë e këtyre përmirësimeve, do të ngushtohet më tepër sfera e veprimit të mbeturinave të shumta shekullore në ndërgjegjen e njerëzve, mbeturinave mikroborgjeze, moralit dhe ideologjisë borgjeze e revizioniste. Në këtë mënyrë do të ndriçohet më tej kuptimi marksist-leninist i çdo problemi. Ky disnivel ekziston edhe në raportin burrë-grua.

Kur flasim për pabarazinë në marrëdhëniet midis burrit dhe gruas, për shtypjen dhe rrugën për çlirimin e plotë të kësaj të fundit, vetëkuptohet se nuk duhet të përfytyrojmë atë lloj pabarazie dhe shtypjeje klasore që u bëhet njerëzve në formacionet ekonomiko-shoqërore parasocialiste. Rruja për emancipimin e plotë të gruas, në kushtet tona, realizohet nën drejtimin e Partisë. Ashtu siç po luftojmë «për të mbyllur gërvshërrët» e dallimit ekonomik midis qytetit dhe fshatit, në të njëjtën mënyrë «do të mbyllim gërvshërrët» e dallimeve edhe në marrëdhëniet midis burrit dhe gruas, për barazinë e tyre të plotë jo vetëm me ligj, por edhe në jetë. Kjo çështje themelore është me rëndësi të dorës së parë për ndërtimin e socializmit.

Partia, duke u mbështetur në mësimet e marksizëm-leninizmit, ka bërë dhe po bën përpjekje të mëdha në luftën për çlirimin e plotë të gruas. Pjesëmarraja e gruas në punën prodhuese ka luajtur një rol të rëndësishëm në zgjerimin e lirive ekonomike të saj, por, në të njëjtën kohë, ky fenomen përmban në brendinë e tij një cefkt të madh politik e ideologjik dhe ka sjellë si

pasojë një shndërrim rrënjosor në drejtim të ngushtimit të dallimeve midis burrit dhe gruas. Partia, si organizatë politike që udhëheq proletariatin, që fryshtëzon të gjithë njerëzit kudo që janë, nuk mund të realizojë me sukses të plotë asnjë veprimitari drejtuesc, pa pjesëmarrjen e gjerë të gruas, pse problemi i saj është i lidhur me çdo gjë. Nuk mund të thuhet se ky ose ai problem politik, ekonomik, shoqëror, kulturor etj., u takon vetëm burrave, duke përjashtuar gratë, të cilat përbëjnë atë pjesë me rëndësi të shoqërisë që jo përfaj të saj ka mbetur më prapa nga zhvillimi kulturoro-arsimor.

Lufta për çlirimin e plotë të gruas nuk duhet të harrohet për asnjë çast, pse ka të bëjë me ngushtimin e dallimeve ekzistuese në fushat ekonomike, arsimore e kulturore midis njërsës pjesë të popullit me pjesën tjetër, midis burrit dhe gruas. Ky orientim i madh i Partisë duhet kuptuar në lehtësimin e gruas nga punët e loddhshme të rritjes dhe të edukimit të fëmijëve, në nevojën dhe domosdoshmërinë e sigurimit të mallrave të konsumit e gradualisht edhe në shtrirjen e pajisjeve elektro-shtëpiake, të domosdoshme për shkurtimin e kohës së punës për shërbimet imediate të familjes, të cilat, me gjithë këmbënguljen e Partisë për t'u bërë nga të gjithë pjesëtarët e familjes, vazhdojnë akoma të mbeten punë pothuaj vetëm për gruan. Po kështu edhe në kujdesin e çdo organizate-bazë partie e të çdo organi shtetëror, kooperativist, shoqëror, të çdo ndërmarrjeje, institucioni dhe të çdo njeriu, kudo që punon, për zhduken e dallimeve ekzistuese në marrëdhëniet midis burrave dhe grave. Të gjithë të mendojnë për ngushtimin

e këtij disniveli, ashtu sikurse mendojnë e veprojnë për ngushtimin e dallimeve midis qytetit dhe fshatit. Shqet tona më të ngritura politikisht, ideologjikisht e nga ana arsimore-kulturore, që janë në gjendje ta kuptojnë e ta njojin më thellë këtë disnivel, duhet të jenë elementi kryesor, kudo që punojnë, për të ngritur para kolektivit sa detyrat e grave ndaj shoqërisë, aq edhe ato të shoqërisë ndaj grave. Të tilla shoqe kemi sot jo vetëm në qytet, por edhe në fshat.

Jeta ka provuar vazhdimisht se, kur një çështje e nierr në dorë Partia dhe për realizimin e saj mobilizon masat, çdo gjë, sado e vështirë të duket, arrihet. Kështu, kur Partia bëri të gjitha përpjekjet, u arrit heqja e taksave dhe e sistemit të grumbullimit të detyrueshëm të prodhimeve bujqësore e blegtorale. Kur Partia shtroi me të madhe elektrifikimin e gjithë fshatrave të vendit tonë si një nevojë absolutisht të domosdoshme, për arsyen se nuk mund të ndërtohej socializmi duke pasur fshatin në errësirë, kjo detyrë u realizua me sukses të plotë. Edhe për çlirimin e plotë të gruas Partia të njëjtën gjë po bën, por, për të pasur përfundime më të mira në këtë fushë, që ka të bëjë sidomos me revolucionin ideologjik e kulturor, duhet të insistojmë fort, me qëllim që të gjithë njerëzit, në çdo hap të jetës së tyre, të kenë parasysh mësimet e Partisë që çështja e çlirimt të plotë të gruas të bëhet problem i të gjithë popullit.

Lufta revolucionare, siç na ka mësuar Partia, bën që të zhduken të gjitha këto mbeturina të vjetra që ekzistojnë në ndërgjegjen e njerëzve, si dhe pasojat e këtyre mbeturinave që rëndojnë më shumë mbi gratë.

Gratë janë të rënduara më shumë jo pse janë të «dashuruara» pas mbeturinave, por për shkak të koncepteve prapanike të trashëguara nga e kaluara, të cilat i kanë kultivuar për interesat e tyre klasat sunduese, duke përdorur pushtetin e tyre, pushtetin e fesë dhe pushtetin e burrit. Burrat kurrë të mos mendojnë se e duan lirinë më shumë se gratë, edhe pse këto kanë më pak arsim e kulturë. Njerëzit që nuk janë krejt të barabartë me të tjerët, e ndiejnë më shumë peshën e shtypjes dhe e duan lirinë më tepër se kushdo tjetër. Kjo është aq e vërtetë edhe në sferën e marrëdhënieve familjare sa është i vërtetë fakti që skllavi e do lirinë më shumë se skllavopronari, bujkrobi më shumë se feudali dhe proletari më shumë se borgjezi.

Ne duhet të futemi thellë në botën e brendshme shpirtërore të atyre vajzave që «shiten» nga baballarët patriarkalë, konservatorë e prapanikë, ose të atyre grave, që, me gjithëse robtohen në punë më shumë se burrat, nganjëherë mbi to rëndon sharja, bile edhe rrähja e bashkëshortëve. Po të futemi thellë në ndërgjegjen e gruas, do të shikojmë çfarë revolte e madhe zien në shpirtin e saj në rastet që përmenda dhe çfarë dëshiron të pakufishme ka ajo për t'i kërkuar Partisë së saj që ta çlirojë! Partia duhet të gjejë forma, mjete dhe mënyra të përshtatshme për t'i realizuar kërkuesat e grave jo vetëm nga ana ekonomike, por edhe nga ana arsimore, kulturore etj. Këtë mision fisnik e kemi për detyrë ta kryejmë në radhë të parë ne komunistët, që jemi pjesëtarët më të përparuar e më të ndërgjegjshëm të shoqërisë, sepse ne jemi më revolucionarë, jemi të pajisur me idetë marksiste-leniniste, me kulturën so-

cialiste dhe me mësimet e Partisë sonë, që na orientojnë, na ndriçojnë rrugën dhe veprimet tona dhe nuk na lënë të biem në qorrsoqë. Puna e Partisë për edukimin tonë ideopolitik, arsimor e kulturor është një faktor me rëndësi për ndërtimin e socializmit dhe na ka bërë më të astë të ndeshemi me pengesat, t'i luftojmë dhe t'i mundim ato, duke ecur kurdoherë përpara.

Shkalla e kuptimit të shumë çështjeve është e ndryshme edhe për arsyen e shoqërinë e përbëjnë njërej të brezave e të shtresave të ndryshme. Një prej tyre është edhe brezi i vjetër, i cili, me gjithë përparrimet që ka bërë në procesin e edukimit dhe të riedukimit, me gjithë meritat e mëdha që ka dhë respektin e veçanti që gjzon, sepse bëri revolucionin, akoma nuk është spastruar në masën e duhur nga idetë dhe mendimet e vjetra feudale, konservatore e mikroborgjeze. Kjo duket sidomos në fushën e marrëdhënieve familjare dhë konkretisht në raportet midis burrit dhe gruas. Në qoftë se Partia nuk do ta kuptonte këtë realitet, atëherë ajo nuk do të ishte në binarë të drejtë dhe nuk do të kishte mundësi të përqendronte forcat përrarritjen e atyre ndryshimeve progresive që imponon vetë etapa e re e zhvillimit historik të vendit tonë — ndërtimi i plotë i shoqërisë socialiste. Në qoftë se kënaqemi me fjalë të përgjithshme, duke deklaruar se ne i kemi dhënë lirinë gruas nga ana politike, juridike dhe shoqërore dhe mbyllim sytë para ekzistencës së dallimeve ekonomike, kulturore, morale apo politike që ekzistojnë në familje midis saj dhe burrit, Partia nuk mund të mobilizohet si flamurtare e luftës për çlirimin dhe shpëtimin e të shtypurve, për të nxjerrë plotësisht

nga kjo situatë të gjithë masën, veçanërisht gruan që në shekuj ka qenë më e shtypur.

Çështja e ngritjes së mëtejshme të nivelit arsimor dhe kulturor në vendin tonë ka rëndësi të jashtëzakonshme për të gjithë, veçanërisht për brezin e kaluar, në radhët e të cilit bëjnë pjesë një numër i madh njerëzish, që kanë një kulturë më të paktë se ata të rinj e të reja që u edukuan dhe u rritën në kushtet e shoqërisë socialiste. Gjyshërit dhe prindërit e të rinjve të sotëm janë rritur para Çlirimtare, çlirimi i vendit dhe puna për ndërtimin e socializmit bënë që një pjesë e njerëzve të brezit të shkuar në moshë të spastrohet nga njegulla e kulturës që kishte marrë prej shoqërisë së vjetër dhe në procesin e riedukimit të pajiset me kulturën e rendit të ri shtetëror e shoqëror. Ky fenomen i spastrimit nga ndikimet negative të kulturës borgjeze filloi të shfaqet në brezin e intelektualëve tanë që në fillim të Çlirimt, kurse në masat e gjera të popullit, që nuk kishin as shkollën fillore, kjo ishte e vështirë.

Partia duhet të mendojë që ky transformim i realizuar te brezi i intelektualëve që përmenda më lart të shtrihet absolutisht edhe te pjesa tjetër e popullsisë së brezit të moshuar, pse të gjithë me veprimet e qëndrimet e tyre ndikojnë shumë në formimin e brezit të ri. Brezi ynë i ri rritet me ndjenja të pastra, me kulturë të gjerë socialiste dhe jeton, punon e lufton në socializëm, pra është i interesuar t'u hapë rrugë kudo normave tona socialiste, por mbeturinat mikroborgjeze, të cilat ushqehen nga ideologjia borgjeze e revisioniste

dhe pasqyrojnë konceptet dhe mendimet e botës së vjetër, të përbysur nga revolucioni ynë e që transmetohen nga brezi më i vjetër, pengojnë progresin shoqëror, ato bëhen pengesë sidomos në rrugën e çlirimt të plotë dhe të përparimit të gjithanshëm të të rinxve dhe të grave. Në luftën kundër shumë mbeturinave patriarkale, feudale, mikroborgjeze e borgjeze merr një rëndësi të veçantë përhapja e arsimit dhe e kulturës socialiste në masën e gjerë të grave. Të gjithë njerëzit e moshuar që banojnë në fshat dhe në qytet kanë mundësi të riedukohen, ashtu si dhe shumë shokë të tyre, që i ka bindur e i ka mësuar Partia. Ata që nuk do të kenë mundësi të ecin me të njëjtin vrull, siç ecën brezi i ri, ta mbështetin atë dhe të mos bëhen pengesë, sidomos për të rejat dhe gratë, dëshira e të cilave është të ecin gjithmonë përpara.

Me të drejtë BGSH, sipas vendimeve të Kongresit të Partisë, e konsideron ngritjen e nivelit arsimor e tekniko-profesional të grave një nga detyrat e saj kryesore. Këto dy elemente, shkalla e arsimit dhe shkalla e marrëdhënieve socialiste në familje, përcaktojnë edhe shkallën e emancipimit të gruas pas fitoreve të arritura në prodhimin shoqëror dhe në fushën politiko-shoqërore, prandaj Partia, organizatat e masave, si ajo e bashkimeve profesionale, e rinisë, e Frontit etj., për arsyet që përmenda, ta vlerësojnë më tepër rëndësinë e ndjekjes së shkollave të të gjitha shkallëve, veçanërisht për gratë. Pse them veçanërisht për gratë? Sepse ka njerëz ndër të cilët ekziston akoma pikëpamja e vjetër që «gruas nuk i duhet shkolla». Ky koncept reaksionar është thyer tek të rintjtë. Tani pothuaj nuk mbe-

tet e re pa mësuar në shkollë, një pjesë e mirë e tyre ndjekin shkollat e mesme dhe të larta. Ky është një sukses i jashtëzakonshëm i punës së madhe të Partisë që nuk e kanë arritur të tjerët. Sot vajzat tona janë të mira në çdo pikëpamje, të forta, të shkathëta, të kulturuara, punëtore, të pastra nga ndjenjat dhe të zonjat për të kuptuar drejt çështjet e politikës së Partisë. Të gjitha këto karakteristika i ka edukuar tek ato Partia.

Ne kemi shumë shkolla, duke filluar nga më të ulëtat e deri te më të lartat, të cilat duhet t'i ndjekin me zell të madh të rinxjtë dhe të rejat tona në bazë të orientimeve të dhëna, por duhet të bëjmë përpjekje edhe për zhvillimin kulturor të brezave më të rritur, se tek ata ekzistojnë dallime të mëdha për sa i takon nivelit kulturor. Nuk mendoj që grave të moshuara në fshat t'u bëjmë thirrje për të ndjekur shkollën, se kjo kërkesë do të ishte e vështirë të plotësohej nga të gjitha, por është e domosdoshme të gjejni formë e metoda pune që arsimi, dhe sidomos kultura, në mënyrë të koncentruar, të futen thellë në gjithë popullin, veçanërisht në gratë. Po të bëhet mirë kjo, po të ngrihet më lart niveli kulturor i grave të moshave pak a shumë të shkuara, atëherë para syve tanë do të shohim të realizohen ndryshime të mëdha për sa i përket ngushtimit gjithnjë e më të madh të disnivelit kulturor midis tyre dhe do të jemi në gjendje të luftojmë më me efikasitet kundër mbeturinave, që, në një masë të madhe, e kanë buri min në paditurinë e njerëzve. Në këtë mënyrë edhe udhëzimet, direktivat e Partisë e të organizatës së gruas do të kuptohen më mirë e më lehtë, nuk do të jetë më nevoja që në këto direktiva të shprehemi hollësisht

e për çdo gjë, qoftë edhe për çështje fare të vogla ose për çështje me rëndësi që kanë të bëjnë me marrëdhëniet familjare brenda në shtëpi. Pse tani jemi të detyruar të flasim me hollësi për shumë gjëra se aktualisht gratë, bile edhe burrat, në fshat nuk janë të formuar të gjithë në shkallën e duhur nga pikëpamja kulturore dhe shpesh bëhen pengesë për vendosjen e normave të reja socialiste, sidomos në familje.

Ne i themi të tëra të metat në punë, shfaqjet e huaja e mbeturinat e vjetra, ashtu siç u thanë bukur këtu, por kur vjen puna i quajmë gjëra të veçanta me të cilat duhet të merret vetëm organizata e gruas. Unë do të thosha se këto çështje, me të cilat merret organizata e gruas, nuk janë specifike, por probleme shumë të mëdha, kapitale. Në situatën e Ballabanit të rrethit tuaj¹, fjala vjen, thyerja e pikëpamjes së komandimit dhe të epërsisë së burrit është problem me rëndësi për Partinë. Ju thatë që, kur merrni vendime, shokët e organizatës së Partisë nuk jua vënë veshin sa duhet për ndihmën që duhet t'ju japid në plotësimin e kërkuesave dhe të detyrave që shtroni. Unë mendoj se që t'ju vënë mirë veshin këta njerëz, herë-herë mund edhe të ftohen në këshillin e gruas edhe burra, natyrisht jo për të shndërruar organizatën e gruas në organizatë Fronti, po për të ballafaquar mendimet tuaja me ato të burrave, për të thyer epërsinë e burrave, siç thyhet ky edhe në organizatat e tjera të masave.

Si thua ti, shoqja Liri, a e gjeni të rregullt që

1. I drejtohet shoqes Liri Miti, në atë kohë përgjegjëse e organizatës së gruas të rrethit të Përmetit.

në mbledhjet e organizatave të Partisë, të bashkimeve profesionale, të rinisë e të Frontit bëjnë pjesë edhe burra, edhe gra, kurse në mbledhjet e organizatës suaj, sidomos në ato të organeve të saj drejtuese, ka vetëm gra? Pse të mos ketë edhe në mbledhjet e kësaj organizate burra ose të rinj, për të diskutuar bashkërisht me gratë, duke ballafaquar pikëpamjet nëpërmjet debatesh?!

Shumë mirë the ti se në jetë ekziston koncepti që burri duhet të ecë më përpara nga ana e intelektit dhe e shkollës. Edhe vetë gruaja, e ndikuar nga ky koncept, i krijon kushte dhe e shtyn burrin të ecë përpara, duke e marrë gjithë peshën e punëve të shtëpisë mbi supet e saj. Kjo është shumë e rëndë. Në qoftë se ne nuk e thyejmë këtë pikëpamje, atëherë do ta kemi vështirë për të zhdurur me atë ritëm që duam zakonet e këqija që përmende ti.

Unë, kur të pyeta për çështjen e arsimimit të grave, nuk kisha parasysh vetëm arsimin shkollor që marrin të rejat, por interesohem sidomos për kulturën që merret jashtë shkollës. Përhapjen e kulturës në jetë e në punë organizata e gruas e bën nëpërmjet disa formave që, sado të mira dhe efektive të jenë, nuk mjaf-tojnë për përhapjen e gjerë të kulturës në masën e grave që nuk janë në shkollë. Kështu, duke gjetur forma e metoda pune të zhđervjellëta, do të zhvillohen intelekti i grave, kultura e tyre. Në këtë mënyrë, nëna, që rri brenda dhe bën punët e shtëpisë, do të dijë ta edukojë djalin e saj, i cili është i ri, me kulturën e vet, me qëllim që ai ta ndihmojë atë në punët e shtëpisë, jo vetëm nga ana sentimentale, por ta kuqtojë si detyrë.

Në kuadrin e zhvillimit të grave duhet të shikojmë edhe anën tjetër, që ato të merren më shumë me problemet shqetësuese të kohës e të jetës.

Burrat, tradicionalisht, kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë epërsi në këtë drejtim. Kjo epërsi e burrave në jetë nuk ka lindur menjëherë, po është krijuar përnjë kohë shumië të gjatë. Sundimi i burrit në familje, në të shumtë rastev, vjen për arsyen se ai ka bërë një jetë sipas botëkuptimit të kohës, duke jetuar edhe jashtë familjes. Ai merrej me punë, me rritjen e kafshëve, me shitjen e bagëtive, bënte pazarin etj. Burri, edhe pse pa shkollë, është marrë me punë jashtë shtëpisë, me probleme të prodhimit shoqëror e të politikës shoqërore që kanë qenë të ndërlikuara. Atij i është dashur të zgjidhë shumë probleme për të përballuar nevojat e familjes dhe në këtë proces është ngritur, ka mësuar, ka përparuar, ka afirmuar dhe vlerat e aftësitë e tij, kurse gruaja jetonte brenda shtëpisë.

Ne duhet të bëjmë përpjekje të mëdha që gruaja t'i kërkojë vetë burrit që ai jo vetëm të mbushë ujë, por të përpinqet që të barazohet me të në marrëdhëniet familjare e në problemet shoqërore. Gruaja, edhe kur s'ka shkollë, duhet të dalë ngajeta e myllur e saj në shoqëri, në atë gradë, siç dilte burri i saj kur nuk kishte nivelin kulturor që ka sot.

Duhet që jo vetëm burri, por edhe gruaja të mësojë ngajeta dhe t'i përballojë problemet që nxjerr ajo. Sot jo vetëm në qytet, po edhe në fshat, burrat diskutojnë për çështje shtetërore, politike, morale, parimore etj. dhe nuk kanë kohë të merren me gjëra të vogla. Po gruaja? Shumë kushte janë krijuar dhe për atë. Gruaja

te ne merr pjesë në punën prodhuese-shoqërore e në jetën politiko-shoqërore; tani ajo ka një botë më të pasur shpirtërore; ka aspirata të militojë kudo, si dhe burri, dhe deri në një shkallë edhe ajo i tregon aftësitë e saj. Por akoma ajo, pasi bën mirë punën në makinat e uzinave, në laboratorë etj., vete në shtëpi, ku i duhet të merret me punët e lodhshme të shtëpisë dhe kësh-
tu, natyrisht, pak kohë i mbetet për të menduar jashtë kuadrit të ngushtë familjar.

Disa burra që diskutojnë për probleme të mëdha ekonomike, politike etj., kur kthehen në shtëpi, kërkojnë të kenë gati gjellën dhe të gjitha shërbimet e tjera, pastaj ia futin gjumit, pa marrë «mundimin» që t'i bise-
dojnë edhe me bashkëshortet problemet e mëdha të ko-
hës, ashtu sikurse kanë biseduar me shokët ose siç kanë lexuar në shtyp. Këta burra shpesh përtojnë t'u komunikojnë të tjerëve bisedat e konkluzionet e Partisë për nevojën e sundimit të normave të reja në familje, gjë që do të ndikonte sa te gruaja, aq edhe tek të moshuarit ose tek të rinjtë. Burri, edhe kur nuk ka pasur shkollë, i kuptonte çështjet; ai jepte mendime, fliste në shtëpi edhe për problemet jashtë familjes. Burri, aktualisht është ngritur nga ana kulturore, kurse grua-
ja, megjithëse ka përparuar, prapë është ngritur më pak se burri. Diferenca nö shkallën e ngritjes së nivelit kulturor e bën gruan të sundohet akoma. Ky dallim midis burrit dhe gruas duhet thyer. Shembullin duhet ta japid të rinjtë dhe të rejat, për arsyen se ata kanë kul-
turë shkollore dhe jashitëshkollore. Të rinjtë nuk duhet t'i bëjnë lëshime njëri-tjetrit në ruajtjen e mbeturinave mikroborgjeze.

Të gjithë burrat e gratë që kanë shkollë dhe që i kuptojnë problemet e jetës njëloj, duhet të luftojnë e të realizojnë plotësisht barazinë në marrëdhëniet familjare. Në qoftë se burri është shumë i ngarkuar me punë, gruaja duhet ta ndihmojë me të tëra mundësitë që ka për ta lehtësuar atë, t'i krijojë kushte të mira çlodhjeje etj. Por, të njëjtën gjë duhet ta bëjë edhe burri për gruan e tij, kur kjo do të jetë e rënduar më tepër se ai me punë.

Për këtë qëllim duhet të ndikojë fort shkolla jonë te brezi i ri, i cili të pajiset me një kulturë të shëndoshë e të shumanshme. Puna e bërë për demokratizimin e marrëdhënieve në familje, megjithëse është përmirësuar, nuk është e mjaftueshme. Këtë gjë duhet ta organizojë e ta drejtojë në radhë të parë Partia. Komunistët, para të gjithëve, duhet të japid shembullin pozitiv në familjet e tyre. Nuk mund të jetë komunist i mirë ai që nuk diskuton në rrugën e Partisë me gruan, me nënën, me motrën, me djemtë e me vajzat e tij. Mundet që edhe komunisti të mos ketë shkollë të mjaftueshme, por ai këto çështje i kupton më mirë, pse është udhëheqës i masave, që militon në pararojë të tyre dhe lufton për zbatimin e vijës së Partisë. Në qoftë se komunisti nuk e bën këtë punë në shtëpinë e tij, nuk mund ta bëjë as në shoqëri. Në një rast të tillë puna e komunistit bëhet formale dhe nuk mund të ketë një bashkërendim të gjallë midis organizatës së gruas, si organizatë e masave, dhe organizatës së Partisë që udhëheq. Duhet të marrë fund koncepti i komandimit që duket te burrat, si dhe prirja e tyre për t'u thënë të tjerëve: «Hajde, bëjë ti këtë, se e ke për detyrë!».

Ndodh që burri, duke e nënvleftësuar nevojën e ngritjes ideopolitike, kulturore dhe profesionale të gruas, e pengon atë ndonjëherë që të marrë pjesë edhe në kurse e konferenca, se ka pikëpamje të gabuara për marrëdhëniat bashkëshortore e familjare. Ky qëndrim i këtyre burrave nuk pajtohet me vijën e Partisë, është prapanik, patriarchal e konservator.

Bashkëshortët dhe pjesëtarët e tjerë të familjes duhet të komunikojnë e të diskutojnë së bashku për shumë probleme. Në këtë drejtim burrat nuk kanë përsë të hezitojnë të flasin me gratë, ashtu si me njëri-tjetrin, sepse, ato, që bisedojnë jashtë familjes, nuk janë qësh-tje sekrete. Po të ishin gjëra të fshehta, ata nuk do t'i bisedonin as me shokët e tyre, që nuk bëjnë pjesë në një organizatë-bazë partie. Në qoftë se ne arrijmë që të gjithë komunistët dhe njerëzit e tjerë të paorganizuar në Parti, të kuptojnë rëndësinë e madhe që ka komunikimi i kulturës në familje, veçanërisht për gruan, motrën, vajzën, por edhe për të moshuarit etj., atëherë do të ngremë në një shkallë më të lartë kulturën massive dhe kjo do të sjellë, si pasojë, zhdukjen e shumë dallimeve që vihen re midis burrit dhe gruas, pra do të sjellë zgjidhjen me sukses dhe në mënyrë të harmonishme të problemieve që shqetësojnë familjen. Me vendosjen e këtyre marrëdhënieve, çdo problem do të zgjidhet me mirëkuptim, sepse të gjithë do të udhëhiqen nga të njëjtat parime.

Edhe për problemet ekonomike brenda familjes, siç janë administrimi i të ardhurave të përbashkëta, shpenzimet, kursimet etj., etj., burri dhe gruaja do të vendosin bashkërisht dhe sa më drejt. Ata, duke gjy-

kuar nga të ardhurat që realizojnë, nga numri i fëmijëve që kanë, nga nevojat që u paraqiten etj., do të veprojnë ashtu si u duket më e arsyeshme dhe të blejnë ato sende që u duhen për lehtësimin e punëve të shtëpisë, për një mirëqenie materiale e kulturore gjithnjë e më të lartë. Kështu veprohet në shumë familje, ku mësimet e Partisë janë kuptuar drejt dhe niveli kulturor i bashkëshortëve është ngritur. Atij burri që kërkon të imponojë vullnetin e tij kundër interesave të gruas dhe të fëmijëve, që përpinqet të hajë e të pijë vetë, pa pyetur për nevojat e të tjerëve, i mungon ndjenja e përgjegjësisë bashkëshortore dhe prindërore.

Këto çështje do t'i zgjidhim drejt vetëm kur gratë t'i kemi bërë të ndërgjegjshme për të këmbëngulur në të drejtat që u takojnë dhe për të punuar intensivisht që të ngrenë nivelin e tyre ideopolitik dhe kulturor. Nuk mund të ketë shoqëri dhe familje të vërtetë socialistë, nuk mund të ketë një jetë të këndshme në gjirin e familjes, pa u kuptuar nga të gjithë që marrëdhëniet midis burrit dhe gruas duhet të karakterizohen nga detyrime dhe të drejta reciprokisht të barabarta, nga besimi, respekti dhe dashuria reciproke midis tyre. Ndërtimi i këtyre marrëdhënieve të drejta do të ndikojë shumë në rritjen dhe edukimin e fëmijëve, që këta të fundit të bëhen qytetarë të denjë të shoqërisë sonë. Kjo është një detyrë absolute që nuk mund të realizohet në rast se nuk interesohemi për gruan, për nënën, për motrën dhe për vajzën që kemi në shtëpi.

Ngritja e personalitetit të gruas dhe komunikimi i kulturuar me çdo pjesëtar të familjes do të frenojë shumë koncepte të burrave prapanikë që i pengojnë

të rejat në punën e tyre si aktiviste shoqërore pasi ato martohen, do të frenojë shumië prindër, që, të ndikuar nga mbeturinat e theksuara patriarkale, i «shesin» vajzat me para, duke lidhur martesa me shpërblim etj. Formimi i botëkuptimit të ri, bindja për drejtësinë e marrëdhënieve të reja familjare do të bëjë që burri të mos e shikojë gruan, vajzën apo motrën e tij si një kriesë inferiore që «kështu ka lindur dhe kështu do të vdesë».

Botëkuptimi i vjetër, me të cilin pleksen shumë pikëpamje e mbeturina, ka ndikuar dhe ka lënë gjurmë në trajtimin e keq të grave nga disa burra. S'ka asnë dyshim se të gjithë prindërit dëshirojnë që vajza apo djali i tyre të bëhet i ndershëm e punëtor. Çdo prind dëshiron që vajza të gjejë një burrë të mirë, por konservatori, që mundohet shumë nga pikëpamjet e vjetra, nuk ka besim te vajza, ai ka frikë se burri që martohet me bijën e tij me dashuri, më vonë do ta braktisë dhe pastaj mbi familjen do të rëndoje «barra e turpit për bijën e kthyer». Ndërsa për djalin është fakt se konservatorët kanë tjetër konsideratë, ai mund të ndajë disa gra dhe kjo gjë mund të harrohet, sepse opinioni shoqëror akoma i paformuar mirë nuk ka kërkesa morale të barabarta si për djalin edhe për vajzën.

Kur Partia të krijojë një situatë të tillë që në çdo familje të punohet politikisht, që prindi ta trajtojë të bijën jo si kriesë të bindur ndaj rreptësisë së «pushtetit atëror», por si shoqe, duke u futur së bashku me të në diskutimin e problemeve politiko-ideologjike, kulturore, morale etj., atëherë vajza do të jetë e zonja ta zgjedhë vetë shokun besnik të jetës. Një vajzë e tillë

jo vetëm do të dijë të zgjedhë atë që duhet, dhe babai s'do të ketë pse të shqetësohet, por me punën e mendimin e saj do të tregojë aftësitë e vërteta dhe s'do të guxoje njeri ta trajtojë atë si inferiore.

Në këtë drejtim, Organizata e Bashkimit të Rinisë duhet të luajë një rol shumë të madh, pse rinia përbën pjesën më dinamike të shoqërisë sonë socialiste. Të gjitha këto që thashë do t'i bëjnë edhe të vjetrit, por më shumë do t'i realizojnë të rinxjtë, që kanë më pak mbeturina se njerëzit në moshë më të shkuar. Vetë rinia është e pastër nga ndikimet e së kaluarës, por brezi më i vjetër, në shumë mënyra, me dashje ose pa dashje, i transmeton dhe i «ngjit» asaj disa nga mbeturinat e veta. Prandaj organizata e rinisë duhet të ndikojë sa më shumë tek anëtarët e saj, me qëllim që çdo i ri të kuptojë se çfarë roli duhet të luajë ai në mbrojtjen e të drejtave të motrës e të nënës së tij. Në qoftë se të rinxjtë nuk e kuptojnë që në jetë, në dashuri dhe në marrëdhëniet me shoqet duhet të jenë seriozë dhe të sillen në përputhje me normat e moralit proletar, në qoftë se ata nuk bëhen përkrahësit e normave të reja në qëndrimet ndaj nönave e motrave të tyre, atëherë nuk do të merrnin kurrë fund disa shfaqje që frenojnë dhe ndrydhin vajzat, besimi ndaj tyre nga ana e disa prindërve do të arrihej më me vështirësi dhe për një kohë shumë më të gjatë.

Këtu e kam fjalën për një kuptim të drejtë të vendit dhe të rolit të vajzës e të gruas, por edhe të marrëdhënieve të pastra e të sinqerta të shoqërisë, miqësisë dhe dashurisë midis të rinxjeve e të rejave. Ne jemi marksistë-leninistë dhe, si të tillë, e kuptojmë realisht

zhvillimin e jetës. Ky transformim i madh dhe i vrullshëm përpara që bëhet si në tërë jetën e shoqërisë, edhe në atë të rinisë, natyrisht, do të vërtetojë edhe ndonjë gabim në jetën dhe marrëdhëniet midis të rinjve e të reja. Kjo gjë e rrallë nuk është ndonjë «katas-trofë», siç duan ta paraqitin me keqdashje konservatorët, sepse jo vetëm disa të rinj, por ka edhe të vjetër, që kanë një eksperiencë të madhe e megjithatë bien në gabime. Ka njerëz të moshës së kaluar, bile midis tyre edhe ndonjë komunist, që nuk e kuptojnë mirë zhvillimin e jetës dhe, kur ndodh ndonjë rast i papël-quier, pa u thelluar, bëjnë përgjithësim pa asnë bazë, duke u shprehur se «rinia u prish» etj. Po pse t'ia hedhim fajin vetëm rinisë kur edhe të vjetrit gabojnë? Pse u prishka rinia dhe pleqtë, që i transmetojnë asaj gjithfarë mbeturinash, qenkan në rregull?

Komunistët dhe patriotët duhet të kuptojnë se gabimet në jetë ndodhin, prandaj, për të pasur sa më pak gabime, kërkohet zbatimi i drejtë i vijës së Partisë. Atij që flet keq për të rinjtë e të rejat do t'i themi: Ç'ke bërë ti për çlirimin e plotë të gruas? Pse je mjaf-tuar për këtë problem kaq jetik vetëm duke folur disa fjalë në një mbledhje dhe nuk ke dhënë shembullin personal në marrëdhëniet brenda familjes tënde? Pse nuk ke kritikuar rreptë shfaqjet dhe qëndrimet e shëmtuara ndaj gruas, por ke preferuar më shumë të rënkoksh që «qenka prishur rinia»? Pastaj këtë njeri do ta kritikojmë se është konservator dhe nuk bën përpjekje të mjaftueshme për të kuptuar thellë vijën e Partisë.

Shoqëria jonë ka bërë një përparim të madh, që vajzën e bëri shoqe të barabartë me djalin. Nga një kohë kur të rinjtë nuk takoheshin e nuk njiheshin fare para martesës, tani punojnë bashkë, janë shokë të mirë dhe në procesin e punës e të njohjes shoqërohen, miqësohen, mund të dashurohen dhe të martohen, duke krijuar kështu një familje të re socialiste, ku zotëron dashuria e singertë dhe respekti reciprok. Në këtë zhvillim mund të vërtetohet edhe ndonjë përfundim i papëlqyer, por një ose disa raste të hidhura kurrë nuk mund ta përlyejnë rininë tonë.

Rinia është e ardhmja e shoqërisë sonë. Nësër të rinjtë dhë të rejat do të jenë baballarët dhe nënët e një rerie më të përparuar nga ç'ishim ne dikur ose nga ç'janë të rinjtë sot. Për këto arsyë ju, shokët e rinisë, së bashku me shoqet e organizatës së gruas, duhet t'i vini rëndësi shumë të madhe bashkëpunimit ndërmjet organizatave tuaja për forcimin e familjes sociale. Pavarësisht se jeni organizata të veçanta masash dhe secili nga ju ka veçoritë e punës së vet, në këtë drejtim duhet të jeni jashtëzakonisht të lidhur. Që nga ngritja e më shumë çerdheve dhë kopshteve për fëmijët, deri te problemet më të ndërlikuara, siç është shoqërizimi i ekonomisë shtëpiake, që do të arrihet pasi të sigurohet një bazë materialo-teknike shumë e zhvilluar e socializmit, ka vështirësi. Ne të tëra këto i kuptojmë, veçse ka edhe gjëra që nuk kanë mbetur pas për shkak të vështirësive objektive, por janë zvarritur nga një kuplrim shumë i cekët në zbërthimin e parimeve, pra për shkaqe subjektive. Prandaj proble-

mi i çlirimt të plotë të gruas ka të bëjë mbi të gjitha me kuptimin dhe zbatimin e drejtë e të plotë të parimeve e direktivave që ka shtruar Partia.

*Botuar për herë të parë me
ndonjë shkurtim në librin:
Enver Hoxha, "Raporte e
fjalimec 1972-1973", f. 115*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, "Për gruan
(Përmbledhje veprash)
1942-1984", f. 529*

TREGTIA VARET SHUMË EDIHE NGA Ç'I JEP PRODHIMI

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

26 maj 1972

Jam dakord me diskutimet që u bënë. Për Ministrinë e Tregtisë u bënë mjaft kritika. Siç u tha këtu, puna e Kiços [Ngjela] që drejton këtë dikaster ka të meta, të cilat ne i kemi kritikuar dhe prapë po i kritikojmë.

Por të mos harrojmë se tregtia varet edhe nga ajo se çfarë i jep prodhimi. Në asnjë mënyrë ne nuk mund ta mënjanojmë përgjegjësinë e bujqësisë dhe të industrisë, si dy sektorë të rëndësishëm që furnizojnë tregtinë. Në qoftë se këta dy sektorë të ekonomisë do të ishin në rregull me prodhimet, s'ka asnjë dyshim se edhe në tregti do të zhdukeshin shumë të meta dhe do-

1. Në këtë mbledhje u diskutua rrëth raportit të paraqitur nga Ministria e Tregtisë mbi masat e marra për një furnizim më të rregullt me artikuj ushqimore në qytet e në fshat dhe për një shërbim më të kulturuar e higjenik në rrjetin e ushqimit social.

bësi. Shpesh përdoren fraza të tilla, si: «Do t'i japim popullit më shumë mish, në qoftë se arrihet majmëria e gjedhit dhe rritja e shpendëve», «Do t'i japim popullit më tepër peshk, në rast se do të bëjmë këtë dhe atë» etj. Por, realizimi i këtyre ka të bëjë me disiplinën e planit në Ministrinë e Bujqësisë e në atë të Industrisë. Tani pyes: Çfarë interesimi të veçantë tregon Ministria e Tregtisë për këto prodhime? A mendon ajo që të krijohen mundësi për zbatimin e zotimeve reciproke të konkretizuara me kontrata, midis ndërmarrjeve të bujqësisë dhe të industrisë, që ato t'i mbajnë zotimet e tyre? Apo do të vazhdohet puna qesim: «Prodho sa të mundësh, zër peshk aq sa mund të zësh, pa në Qeveri themi se nuk e zumë dot peshkun për këtë ose atë arsyen dhe kalojmë vetëm me një kritikë, përderisa asnjë sanksion nuk merret për ministrinë ose ndërmarrjen që shkel detyrimin?!» C'mendim keni ju, a mund të vazhdohet kështu si gjer më sot apo do të gjej- më disa forma të tjera pune?

Kur planifikojmë që të kemi kaq pula e kaq vezë, duhet të parashikojmë edhe sigurimin e bazës ushqimore. Unë nuk e kuptoj si veprohet me zogjtë që u jepen kooperativave. Qëllimi është që këta zogj të na japidin mish e vezë, por, në qoftë se kooperativat i mbajnë ata në kushte të papërshtatshme, nuk i arrihet qëllimit. Me sa shikoj unë, në këtë mënyrë si veprohet po bëjmë vetëm një gjest teorik, pa ndonjë dobi praktike. Ne kërkojmë të ndërtojmë inkubatorë. Mirë, mund të shtojmë edhe të tjerë veç atyre që kemi, por nuk kuptoj për ç'arsye nuk e organizojmë punën në mënyrë të tillë që të gjithë zogjtë që nxjerr inkubatori t'i rritim

aty dhe të mos i shpërndajmë andej-këtej? Faktet na kanë treguar se për vite të tëra kooperativat bujqësore nuk kanë pasur mundësi t'i rritin zogjtë e inkubatorit.

Po për pulat pse nuk është mbajtur koncentrati që kemi caktuar? Në këtë mënyrë do të vazhdojmë të ecim, shokë? Jo, nuk duhet të ecim më tej kështu. Toka jonë është pjellore, klima jonë është e mirë. Ne i kemi bërë tokës gjithë këto kanalizime, drenazhime etj., etj. dhe, në qoftë se vazhdojmë kështu, kot që sjellim inkubatorë. Përse duhen këta kur nuk sigurojmë koncentratin me të cilin do t'i ushqejmë zogjtë e pulat? Ne tash caktojmë një minimale koncentrati, kurse pjesën tjetër të ushqimit shpendët e marrin në natyrë. Por e keqja është se as këtë sasi të caktuar koncentrati nuk e sigurojmë dot. Në këto kushte, si do të bëjmë me milionat e zogjve të inkubatorit?

Para 70 vjetëve, në Gjirokastër, ka qenë një kusar që e quanin Filo Diko. Ai ishte vjedliës specialist. Ndër të tjera, vidhite edhe pulat e mëhallës, të cilat i gënjente duke i ndjellë në arën e tij të mbjellë me grurë. Sa herë ankoheshin njerëzit e dëmtuar, Filo Dikon e mbanin dy muaj të paraburgosur, pastaj e nxirrin të pafajshëm «për mungesë provash». Kur dilte nga burgu, ai u thoshte autoriteteteve: «M'i shkruani këto që bëra për herë tjetër!», se e dinte ai që do të hynte prapë në burg, kur të vidhite pulat e tjera. Ai i ushqente në arë pulat e vjedhura, por pa pasur koncentrat, shiste vezët dhe fitonte. Kurse neve na shkundet gruri në arë, e megjithatë, në Ndërmarrjen Bujqësore të Sukthit nuk gjen pulë që të kullotë në to, pse thuhet që «na i ha dhelpra», «na i vjedhin kusarët», «ikin andej, bëhen kështu, bë-

hen ashtu» etj. Populli do vezë, prandaj kini kujdes që të mos na vini prapë me plan të parealizuar, si tani. Po kështu edhe për peshkun që u sol këtu. Dihet se deti ynë ka peshk, bile shumë, sepse, e para, peshku ushqehet në detin tonë nga lumenjtë; e dyta, se peshku në detin tonë nuk helmohet nga ujërat industriale, siç ndodh në vende të tjera që kanë det; e treta, se peshku në detin tonë nuk është i shqetësuar në lëvizjet e tij, në pjelljen dhe në gjithë mënyrën e jetesës, siç shqetësohet, gjithashtu, në vende të tjera. Ne jemi të detyruar t'i japim popullit peshk, duke përfshirë të gjitha llojet që kemi, prandaj duhet të merren të gjitha masat në det, në rezervuarë, në lumenj, në liqene e kudo. Të bëhet një luftë e fortë për sigurimin e ushqimit të popullit.

Çështja tjetër, që po e dëgjojmë vazhdimisht se nuk po ecën mirë, është se në ushqimin social përdoren shumë makarona, fasule etj., në vend që të përdoren më tepër perime. Kush do ta organizojë realizimin e kësaj detyre, ne apo ju drejtuesit e Ministrisë së Tregtisë? Më duket se në Byronë Politike nuk duhet të na serviren fraza. Ajo kërkon që ju ta zbatoni këtë orientim. Në qoftë se në restorantet gatuhen vetëm fasule dhe makarona, fajin për këtë e keni ju, Kiço. Meqë erdhi fjala te makaronat, desha të ndalem pak te prodhimi i tyre.

Me sa di unë, jashtë prodhohen shumë lloje makaronash. Unë mbaj mend nënën time që bënte një lloj makaronash që u thoshim «roshnica»; të gjithë bënин në shtëpitë e tyre nga këto lloje makaronash e lloje të tjera. Po ne, tani, çfarë presim që nuk bëjmë lloje të

ndryshme makaronash në fabrika? Unë nuk them të mos kemi oriz, po nuk është e drejtë të mbetemi vetëm me një lloj makaronash dhe të mos i prodhojmë ato në një gamë më të madhe. Ne kemi gjetur rrugën e shkurtër: të sjellim kaq mijë tonë oriz etj. Kështu nuk duhet të ecim, prandaj ta zgjerojmë këtë gamë prodhimesh:

Ne nuk ju kërkojmë llogari çfarë konsumon çdo familje në shtëpi, po çfarë konsumohet në restorantet dhe në mensat duhet të na e thoni. Këto gjëra na i shpregoni mirë e me përgjegjësi dhe jo duke na derdhur këtu fraza të përgjithshme dhe duke u ardhur rrotull punëve pa rezultate. Veç realizimit të planit nc duhet të vendosim cdhe sanksionet që duhet të merren ndaj prodhuesve. Në qoftë se uzina «Traktori», ta zëmë, nuk prodhon në sasinë e nö cilësinë e duhur veglat e ndërrimit për traktorët etj., duhet të përgjigjet për këtë konkretisht. Edhe kur nuk realizohet në kohën e duhur sasia e domateve, duhet të merren masa kundër prodhuesit që shkel detyrën e planit për faj të tij. Ne nuk mund të ecim gjithnjë duke u justifikuar se s'kemi këtë e s'kemi atë, se nuk bëhen perimet etj. Pra, duhen sanksione, por duhet edhe punë politike e organizative.

Sigurisht edhe drejtuesit e tregtisë kanë fajet e veta. Nuk mund të përjashtohen të metat në organizimin e punës, në gjithë rrjetin, në shitjen, në shpërndarjen etj. Të gjitha këto dobësi ciklistojnë. Por, format e punës që janë zbatuar në të gjithë vendin, siç na u paraqiten në raport, tregojnë se nuk ka diferenca të mëdha në furnizimin midis rretheve në përpjesëtim me populatën e secilit rreth. Ndryshimet në këtë drejtim janë

fare të vogla e kjo është një gjë e mirë. Tirana, natyrisht, ka pak diferenca në krahasim me rrëthet e tjera, por këtu duhet të shikojmë edhe rritjen e madhe të popullsisë së kryeqytetit, shkollat dhe shumë institucionë të tjera. Vështirësitet e krijuara vijnë vetëm për arsyec të mosrealizimit të planit, gjë që duhet të na shqetësojë.

Ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm, që edhe sikur ta realizojmë planin, prapë kërkesat do të jenë në rritje. Për këtë duhet të shtojmë përpjekjet dhe iniciativat që, jo vetëm ta realizojmë planin, por edhe ta tejkalojmë atë, sepse, fjala vjen, nuk mund t'i themi popullit që «kaq e realizuam planin e vezëve, prandaj kënaquni duke ngrënë vetëm nga kaq kokrra vezë në javë!». Kemi ne mundësi të japid më shumë? Po, kemi, por duhet të çalltisim, të vrasim mendjen. Në analizat që po bëjmë për çdo sektor dhe për çdo problem shikojmë që kemi mjaft të meta në organizimin e punës, në shkallën e rritjes së ndërgjegjes, në planifikim dhe në shumë drejtime të tjera, të cilat, në qoftë se do t'i shikojmë me syrin kritik dhe do të gjejmë forca për t'u hedhur me vrull në punë, në rrugën e drejtë të Partisë, do t'i mënjanojmë.

Në raport flitet për zgjerimin e rrjetit, po në Tiranë, nga sa na kanë njoftuar, ka lagje të reja prej mijëra banorësh pa një dyqan për shitjen e bukës ose për sendet e tjera të vogla të përditshme, për blerjen e të cilave banorët duhet të venë deri në qendër të qytetit. I shikoni ju, shokë të tregtisë, këto gjëra? Mirë është të ndërtojmë nga një dyqan në çdo fshat, po në lagjet e reja ku banojnë mijëra veta, ngritja e dyqaneve është më e domosdoshme. Unë mendoj se ia vlen që të

ngrihen një apo dy apartamente më pak dhe në vend të tyre të ngrihen disa dyqane. Plani që është aprovuar për të ndërtuar dyqane nën apartamentet, le të vazhdojë në rregull. Por, hëpërhë, le të hapen sa më parë disa baraka, ku të shiten nga tregtia artikujt për të cilët ka nevojë përditë populli.

Për t'u bërë të gjitha këto punë duhet shkathëtësi dhe manovrim. Për shembull, për sa i përket mishit, unë mendoj se po të shitet i paketuar, do të kënaqen të gjithë. Kjo gjë do të bëjë që mishi të përdoret më me kujdes, nuk do të sulen të gjithë te mishi i shtrenjtë, por edhe te llojet e tjera. Kështu si veprohet tanë, një qytetar ne të njëjtin çmim merr mish më të mirë ose më të keq se një tjetër. Kjo nuk është e drejtë, sepse çmimi i caktuar gjithnjë duhet t'i korrespondojë cilësisë së mishit. Unë nuk jam kundër paketimit, por them që kategoria e parë e mishit të futet e veçantë dhe jo në një pako me atë që s'është e cilësisë së parë. Siç e shikoj unë, ju shokët e tregtisë, të gjitha çështjet i ngri ni në atë mënyrë që të vazhdoni shitjen e mishit siç e keni bërë gjer tanë. Po të veprohet kështu si themi ne, nuk ka pse të dalin shumë lloje çmimesh. Për shembull, mishi i viçit të mos ndahet në kualitet të parë me 4-5 lloj çmimesh, po kështu edhe ai i kualitetit të dytë dhe të tretë; edhe mishi i lopës të jetë një kualitet e jo i ndarë në të parë, të dytë e të tretë. Pastaj secila pjesë, sipas ndarjes anatomike, të ketë çmime të veçanta.

Ju, shokët e industrisë, e realizoni planin në të gjithë sektorët. Kjo, natyrisht, është një gjë e mirë, por duhen marrë iniciativa të mëtejshme. Qeveria, Byroja

Politike dhe Komiteti Qendror i kanë përkrahur iniciativat që janë marrë. Por nuk shtrohet problemi që të merren vëlënë iniciativa për qindra milionë lekë ja-shtë fondeve të caktuara, por edhe brenda fondeve, duke bërë, sipas rastit, ndonjë spostim të nevojshëm, ndonjë avancim, ose pakësim në një drejtim dhe shtim në një tjetër etj.

Pa u zgjatur në këto çështje, desha të vë në dukje se më shumë nga të gjithë, bujqësia duhet të bëjë përpjekje kolosale. Këto përpjekje nuk duhen kufizuar vetëm në Ministrinë e Bujqësisë, por të shtrihen në gjithë Partinë, në gjithë popullin. Pra, nevojitet një mobilizim më i madh dhe i përgjithshëm.

Edhe unë jam i mendimit që Qeveria ta shikojë problemin e rikrijimit të arbitrazhit. Jam dakord me mendimin që u shpreh këtu se institucioni i arbitrazhit nuk ka karakter thjesht administrativ, por ka të bëjë me forcimin e kontrollit, të disiplinës, të planit, të kontratave etj. Duhet gjetur një mjet më i efektishëm shtetëror për zbatimin e kontratave dhe të detyrave që mund të dalin në marrëdhënicët midis ndërmarrjeve sozialiste. Me këtë rast mund të rishikohet ligji që gjobat e vëna nga arbitrazhi të mos i paguajë vetëm shteti, por, pjesërisht, edhe personat që kanë përgjegjësi për mospërmbushjen e rregullt të detyrimeve kontraktuale.

Mua më duket se kjo mbledhje ia arriti qëllimit, çështjet u thanë hapur dhe të gjithë shokët janë të ndërgjegjshëm për detyrat që kanë. Ne jemi të bindur se shokët e dikastereve nuk rrinë duarkryq, por punojnë e luftojnë me vështirësitë, vetëm duhet të njohim se

që të gjithë kemi të meta në punë, bëjmë lëshime etj., prandaj edhe kritikojmë në fryshtën e Partisë. Këto gjëra i kemi thënë dhe duhet t'i theksojmë vazhdimisht, pasi i shërbejnë luftës sonë të përditshme për ndërtimin e socializmit. Ne shpresojmë se të gjitha këto që u thanë këtu do të vihen në jetë shpejtë e në mënyrën më të fryshtshme.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

PROFILAKSIA — FAKTOR ME RËNDËSI PËR RUAJTJEN E SHËNDETIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

26 maj 1972

Në radhë të parë, mendoj se e kemi për detyrë të punojmë vazhdimesht që çdo njeri të kuptoje nevojën për t'u bërë mjek i vetvetes. Në këtë çështje ne duhet të bëjmë kthesë në masë. Kjo është një detyrë, pa realizimin e së cilës do të jetë vështirë të arrijmë ato rezultate që presim nga mjekësia jonë. Njerëzit tanë, në përgjithësi, nuk i vënë rëndësi shëndetit, e marrin këtë si një çështje të dorës së fundit. Kjo vërtetohet me faktin se, të shumtën e rasteve, mjeku thirret vetëm për të ngjitur «kupën» që thyhet. Mirëpo, duhet të merren masa që «kupa» të mos thyhet. Jo vetëm kaq, por te mjeku të vehet edhe kur ajo «gërvishjet» sadopak. Pra, për ruajtjen e saj sa më gjatë, duhet të bëhet kujdes i vazhdu-

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rrëth raportit të paraqitur nga 'Ministria e Shëndelësisë për shkaqet e ekzistencës dhe të përhapjes së sëmundjeve infektive dhe masat për parandalimin dhe luftimin e tyre.

eshëm nga ai që e përdor. Kjo do të arrihet kur gjithë secili ta vlerësojë dhe të interesohet vazhdimisht për shëndetin, ndryshe mund të preket nga çdo lloj sëmundjeje.

Mos dua të them me këtë që çdo njeri të njohë përbërjen anatomike të pjesëve të trupit, ashtu siç i di një mjek specialist në këtë fushë? Natyrisht, jo, kjo nuk është e mundur. Por, po të tregohet kujdesi që thashë, duke u mbështetur edhe në instinktin e vetëmbrojtjes, ka mundësi që kushdo ta ruajë shëndetin e vet dhe të shhangë, të paktën, ata faktorë të dukshëm që dëmitojnë organizmin.

Para së gjithash, për këtë qëllim duhet shfrytëzuar eksperienca e popullit. Kjo eksperiencë ka kristalizuar në mendjen e njerëzve mjaft nocione që u tërheqin vëmendjen atyre çdo ditë për t'u ruajtur nga disa faktorë negativë të ambientit, ndryshe mund të preken nga kjo ose ajo sëmundje. Shprehja e njohur popullore «kujdes mos ftohesh» është sintezë e asaj eksperience të gjatë që jeta u ka mësuar njerëzve se në disa organë të trupit, kur këto goditen nga era ose ambiente me temperaturë të ulët, zhvillohen në organizëm sëmundje si ato të grykës, të bronkeve, të mushkërive etj., etj., se, po të qëndrosh nëpër korrentet e erërave kur je i djersitur, mund të marrësh bronkopneumoni, ashtu si kurse u ka mësuar se, po të hash shumë, jashtë masës dhe nevojës që ka organizmi për ushqim, të fryhet barbu, nuk të zë gjumi ose, edhe po të zuri, nuk fle mirë, shikonëndrra të frikshme e plot e plot gjëra të tillë që shqetësojnë njeriun dhe dëmitojnë organet e tretjes.

Njerëzit i njohin këto e, megjithatë, ka shumë që veprojnë në kundërshtim me ato që dinë. Prandaj, sikur edhe në baza empirike t'u tërhiqet atyre vëmendja që të bëjnë kujdes, kjo do të ndihmonte shumë për mbrojtjen e shëndetit të tyre. Por, natyrisht, një punë e tillë nuk është aspak e mjaftueshme, ne në asnjë mënyrë nuk mund të kufizohemi, duke ecur vetëm në këtë rrugë.

Për mbrojtjen e shëndetit të masave është e domosdoshme të zhvillojmë një propagandë të vazhdueshme e të organizuar mirë nëpërmjet këshillave mjekësore nga më të ndryshmet. Këtë propagandë ne e bëjmë në forma të shumta me anën e mjeteve e mundësive që kemi krijuar, me shtyp, me radio, me konferanca mjekësore etj., etj. Por mendoj se gjer tani kjo punë nuk është e kuptueshme sa duhet e me nivel, për të zgjuar e forcuar në masat atë ndjenjë të fortë të vetëruajtjes nga sëmundjet, sepse shpesh bëhet me formulime shkencore të rënda.

Disa mjekë propagandistë nuk marrin parasysh se gjuha e tyre s'kuptohet nga njerëzit e thjeshtë. Prandaj është e nevojshme që cilësia e propagandës shëndetësore, sidomos në drejtim të masave profilaktike, të rritet dhe të zhvillohet kurdoherë me një gjuhë të thjeshtë popullore e të qartë për çdo njeri, gjë që kërkon heqjen dorë nga termat e panjohur për masat, siç janë shumë fjalë të rënda shkencore latine, franceze apo italiane. Masave t'u flitet me gjuhën e tyre sc, fjala vjen, ngrënia e tepërt e çdo lloj ushqimi, e bukës, e yndyrës, e mishit, e sheqerit, e perimeve, e frutave etj. sado me vlerë që të jenë, shkakton jo vetëm fryrje stomaku,

por në rast se vazhdon, me kohë, çon në rrjedhime të pandreqshme. Këto njerëzit i kanë jetuar ose i kanë dëgjuar, prandaj nuk janë të pakuptueshme për ta. Profilaksia ka rëndësi shumë të madhe.

Neve duhet të na tërheqë vëmendjen pikëpamja që ekziston aty-këtu për shkak të mendjemadhësisë së disa mjekëve, sikur ky sektor nuk paska rëndësi. Fjala vjen, për prodhimet ushqimore industriale të dala jashtë cilësisë kanë përgjegjësi ata që i prodhojnë, por edhe tregtia që i pranon e i vë në shitje, gjë që është akoma më e rrezikshme. Pse pranohen të tilla prodhime? Pranohen për arsy se njerëzit duan të justifikohen, pse kanë harxhuar materialin e të tjera. Por për këto kanë përgjegjësi, në radhë të parë, organet e shëndetësisë, që i lejojnë të shiten këto prodhime. Mirëpo, kjo është shumë më e rrezikshme nga rasti i këpucëve kur dalin me cilësi të keqe. Prandaj, për këta artikuj duhet të jemi shumë më të rreptë dhe rreptësia mund të vendoset nga organet e shëndetësisë. Rreptësia duhet të vendoset, në radhë të parë, në furnizimin e ushqimeve me cilësi më të mirë. Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë të jepet urdhër kategorik që, ata artikuj ushqimorë mbi të cilët vë dorën inspektoriati sanitari jo tū mira, të mos shiten. Por, çështja qëndron sa bëhen lëshime dhe sa njerëzit e ngarkuar me këto punë lejojnë të hyjnë në dyqanet e shtetit prodhimet me cilësi të keqe. Po kështu edhe ndjekja e higjenës së mishit mbasi del nga thertorja, i takon shëndetësisë. Edhe veterineri, nga ana e vet, duhet ta perfektionojë punën e kontrollin derisa të dorëzohen bagëtitë në thertore. Sëmundjet që konsiderohen si të prejardhura

nga kafshët duhet të luftohen, por, njëkohësisht, kujdes duhet treguar për ruajtjen e mishit në kushte të mira pasi del nga thertorja, që të mos preket nga mizat e tij.

Por, problemi i profilaksisë nuk duhet kuptuar në një prizëm shumë të ngushtë, vetëm sa për të kontrolluar prodhimet ushqimore që shiten në treg. Profilaksia është një kompleks i tërë që ka të bëjë me masat që duhen marrë me kohë për ruajtjen e shëndetit të njerëzve, që këta të mos na sëmuren. Prandaj t'i kushtojmë vëmendjen që i përket këtij sektori.

Propagandës për domosdoshmérinë e marrjes së masave profilaktike ne duhet t'i japim rëndësi të madhe. Me anë të saj, të ndihmojmë që punën për ruajtjen e shëndetit secili ta ndiejë si një detyrë shoqërore të dorës së parë. Mirëpo te ne ka shumë njerëz që as pyesin fare nga kjo anë. Bile disa e quajnë «trimëri të madhe» të rrinë me net të tëra pa gjumë, edhe kur nuk e lyp nevoja, duke shkatërruar me këtë mënyrë nervat e tyre dhe, si pasojë, largimin para kohe nga shërbimi aktiv në dobi të shoqërisë. Një propagandë e organizuar mirë do t'i bëjë të qartë çdo njeriu që të kuptojë se, po të mos tregojë kujdes çdo ditë për ta ruajtur të shëndoshë sistemin nervor, kjo pakujdesi bëhet shkak i një moric sëmundjesh. Atëherë, punonjësit kohën e nevojshme për gjumë nuk do ta shpenzojnë për gjëra të kota, po do ta vlerësojnë e do ta kuptojnë se ajo është më e dobishme se buka, duke u bërë të ndërgjegjshëm se edhe me këtë mënyrë ata jatin kontributin e tyre për ndërtimin e socializmit e për mbrojtjen e atdheut. Ata do të tregojnë kështu më shumë kujdes në këtë drejtim.

Le të marrim tani çështjen e mjekëve, pa punën e të cilëve masat nuk mund të edukohen e të bëhen të ndërgjegjshme për ruajtjen e shëndetit. Ajo që është bërë gjer tani për përgatitjen e kuadrove të sektorit të shëndetësisë mund të konsiderohet një hap i rëndësishëm. Megjithatë del detyrë të punohet akoma më mirë në këtë drejtim, duke filluar që nga puna për zgjedhjen e përgatitjen e studentëve që vazhdojnë studimet për mjekësi, të cilët që gjatë vazhdimit të fakultetit duhet ta marrin punën me seriozitetin më të madh dhe të përgatiten sistematikisht. Por, krahas kësaj, edhe pedagogët duhet, gjithashtu, të punojnë me shumë seriozitet në hartimin e teksteve, në punën për përgatitjen e tyre për dhëni e mësimit, në udhëheqjen e praktikave mësimore etj. Ndonjë vërejtje konkrete apo kritikë për programet dhe tekstet e Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, nëse këto janë të përshtatshme dhe parashikojnë t'u japid studentëve të mjekësisë njohuri të plota e serioze për profesionin e tyre, nuk mund të bëj, por e theksoj se në këtë fushë nuk është njësoj si me prodhimin e artikujve industrialë të konsumit të gjerë, si të këpucëve, stofave, enëve etj., etj., të cilët, edhe në rast se nuk dalin aq të mirë, fundi i fundit mund t'i hedhim në treg me një çmim më të lirë ose mund t'i zëvendësojmë. Kurse një mungesë përgatitjeje e shëndoshë c me seriozitet të madh e kuadrove në shëndetësi, përbën një problem të rëndësishëm që na kushton shtrenjtë, se jeta e njerëzve nuk mund të krahasohet me asgjë. Ky mision i lartë humanitar duhet të kuptohet thellë nga

studentët, pedagogët e Fakultetit të Mjekësisë dhe gjithë punonjësit e shëndetësisë.

Për studentët e mjekësisë njojja e hollësishme e organizmit të njeriut duhet absolutisht të zërë vendin kryesor gjatë studimeve, jo vetëm për të marrë njojuri të plota për vendin që ka në organizëm dhe funksionin e çdo organi të veçantë të trupit, por edhe për interferencat dhe ndërlirimet që mund të shkaktojë një çrregullim apo sëmundje në atë organ, në një grup organesh ose edhe në gjithë organizmin. Kjo edhe bëhet, por unë e vë në dukje, mbasi nuk jam në dijeni të të gjitha këtyre çështjeve dhe duke gjykuar se kjo është absolutisht e domosdoshme. Mjekët e rindërtuar në Fakultetin e Mjekësisë, duhet të mësojnë se ç'reaksion shkakton kjo ose ajo sëmundje në një organ të caktuar apo në një pjesë të trupit, për ç'arsye reagon, cilat janë shenjat klinike të sëmundjes, cilat janë shenjat e jashtme dhe cilat mjete apo barna duhen përdorur që të shërohet, në radhë të parë, nga sëmundja bazë dhe jo nga ajo që ka ardhur si pasojë e së parës. Logjika e lyp që të kurohet e të shërohet në fillim sëmundja e parë që ka infektuar organin, që e ka gjymtuar ose atrofizuar atë, pastaj të luftohen pasojat e saj në organet e tjera ose në krejt organizmin. Të gjithë e dimë se sëmundja kryesore, në shumë raste, mund të godasë dhe të dëmtojë drejtpërdrejt, veç organit që ka prekur, edhe organe të tjera.

Mundet që gabohem, po mendoj se mjeku i ri, që porsa mbaron fakultetin, nuk mund t'i dijë menjëherë të tëra dhe plotësisht këto gjëra, me kohë ai fiton njojuri plotësuese dhe eksperiencë, megjithatë, në një përf-

qindje të madhe këto çështje duhet t'i dijë. Mirëpo përgatitja e kuadrove tanë të njekësisë në këto drejtime lë akoma pér të dëshiruar, prandaj të mos e flemë mendjen se njekët dhe punonjësit e tjerë ndihmiës apo të niveleve më të ulëta të shëndetësisë përgatiten ashtu si duhet.

Edhe kur shkollat tona mjekësore të arrijnë t'i përgatitin mirë kuadrot e shëndetësisë të të gjitha niveleve, të kemi parasysh se këta, edhe pse marrin diplomën, janë akoma nxënës që porsa kanë mbaruar mësimet. Mjekët e rinj, fjala vjen, që porsa mbarojnë fakultetin vërtet quhen «mjekë», por akoma nuk e kanë praktikën dhe përvojën e nevojshme të mjekut. Prandaj, duke qenë se kanë të bëjnë me një punë me përgjegjësi të madhe, të punohet shumë që edhe pas përfundimit të fakultetit ata të ndihmohen vazhdimisht e në mënyrë këmbëngulëse. Për këtë qëllim t'u krijojen mundësi c'tu vihen në dispozicion të gjitha mjitet që kemi pér ngritjen e nivelit të tyre-tekniko-profesional. Duke vepruar kështu, me kohë ata do të pajisen me eksperiencën e nevojshme, c'ila nuk fitohet në një ditë. Unë jo më kot e bëra pyetjen, nëse ju si dikaster¹ keni plan edukimi pér gjithë këtë mori kuadrosh të shëndetësisë që kanë mbaruar si mjekë, ndihmësmjekë, farmacistë e infermierë që janë shpërndarë në fshatra dhe qytete. Keni programe të caktuara pér kualifikimin pasuniversitar të mjekëve ose pas shkollës së mesme që bëjnë ndihmësmjekët si, bie fjala, kurse njëditore, pesëditore ose edhe me af-

1. U drejtohet përfaqësuesve të Ministrisë së Shëndetësisë.

te më të gjata? Unë mendoj se këto forma kualifikimi të kuadrove të shëndetësisë luajnë rol të madh. Organizohen apo nuk organizohen mirë këto forma? Kam përshtypjen dhe shoh tek ekspozeja juaj që nuk ka një përcaktim të qartë e të vendosur, se po na thoni bëhen këtu e bëhen atje. Kur themi që këto kurse bëhen në rrethe, për shembull, në këtë apo në atë rreth, ta dimë që kemi një kurs 3-mujor ose 6-mujor, ku po përgatiten apo po kualifikohen kaq mami apo infermierë. Kjo ka shumë rëndësi se ne mund të kemi vendosur që këtë tremujor të kalojë ky kontingjent të cilin do ta zëvendësojë ai kontingjent tjetër etj. Ose, për shembull, këtu, në Tiranë, në Spitalin nr. 1 nuk mund të vijnë të tërë mjekët për specializim. Prandaj disa të kalojnë për specializim edhe në rrethe.

Mjekët tanë ne duhet t'i mësojmë që të kenë besim, kryesisht, në forcën e vetë organizmit të njeriut për ta mposhtur sëmundjen. Personalisht nuk jam kundër barnave që jepen, sepse dihet që këto, kur rekomandohet të përdoren me kriter, luajnë rol dhe bëjnë efekt në shërimin e shumicës së sëmundjeve, por edhe vetë organizmi, në qoftë se tregohet kujdes, mund të përballojë sëmundje. Prandaj edhe mjeku t'i japë rëndësi më shumë vitalitetit të organizmit dhe jo vetëm barnave. Mendimi im është që të mos besohet qorrazi, siç ndodh me disa mjekë, vëtëm në barnat që këshillohet të përdorin të sëmurët. Besimin e arsyeshëm në forcat e vetë organizmit të të sëmurit mjeku do ta ketë kur të jetë përgatitur si duhet që në fakultet. Megjithatë, puna aty nuk mund të jetë e përsosur. Ajo që merret në shkollë është vetëm një bazë e shëndoshë,

që do të pasurohet më vonë me përpjekje të mëtejshme individuale dhe në mënyrë të organizuar për të zgjegruar njohuritë e për tu kualifikuar me eksperiencën e jetës gjatë ushtrimit të profesionit.

Farmakologjia vërtet ka karakter shkencor dhe barnat e panumërtë, që ekzistojnë sot, kanë vërtet fuqi shërucese, por s'duhet harruar se në vendet kapitaliste ilaqet prodhohen edhe për qëllime tregtare e spekulimi. Duke filluar që nga tabletat më të thjeshta, siç është aspirina, e gjer te barnat më të rëndësishme e të ndërlikuara, firmat që i prodhojnë synojnë t'i shesin për të nxjerrë prej tyre sa më shumë fitime. Nuk përjashtohet që shumë prej tyre janë pa efekt, prandaj, duke mos qenë të përgatitura siç reklamohen, një përdorim i tyre pa i njohur si duhet, apo pa kriter, mund t'i shkaktojë dëme të rënda të sëmurit. Mirëpo, më duket se bazat e farmakologjisë nuk mësohen në nivelin e duhur nga ana e personelit tonë mjekësor. Kjo çështje i lihet në dorë ndonjë specialisti që mban përpara një kodeks dhe vepron sipas tij. Po të ishte puna këtu, këtë kodeks mund ta përdorë edhe një që s'është mjek, mjaft të dijë gjuhën në të cilën është shkruar ai. Kështu, një të sëmuri me migrenë, për shembull, kushdo, pasi të lexojë kodeksin, mund t'i rekomandojë të marrë këtë osc atë ilaç për t'i lehtësuar dhimbjen. Edhe mjekut i nevojitet kodeksi, medoemos, por është e domosdoshme që qysh në bankat e universitetit ku mësohen shkencat mjekësore, ai që përgatitet të dalë patolog, kirurg etj., etj. edhe farmakologjinë ta studiojë dhe ta njohë mirë, natyrisht, në lidhje të ngushtë me terapeutikën. Këtë ju e dini shumë më mirë se

unë dhë fjalën nuk e kam për mjekët me eksperiencë, të cilët jeta i ka mësuar dhe kanë dijeni të gjera edhe në këtë fushë, po më shumë e kam për mjekët e rinj, që në fillim e kanë më të vështirë. Ata nuk kanë dijeni të mjaftueshme për ndërlikimet që mund të ndodhin në organizëm nga përdorimi i barnave të ndryshëm gjatë kurimit të sëmundjeve. Është pikërisht mungesa e eksperiencës që shpesh një mjek i ri, pasi i jep pacientit një sasi tabletash, akoma pa filluar të japë efekt ky mjekim në përmirësimin e gjendjes, i ndryshon ato dhe jep barna të tjerë. Kjo ndodh tek ai që nuk ka afirmuar akoma besimin në ato që ka mësuar, që nuk e njeh efektin e mjekimit që ka rekomanduar, c që ka edhe frikë, pse nuk e ka të qartë aq sa duhet edhe atë që organi i sëmurë nuk mund të rigjenerohet brënda një kohe të shkurtër.

Një përdorim i tillë i barnave nga ndonjë mjek ndodh shpesh edhe për arsyet e padurimit të ndonjë pacienti, i cili kërkon të shërohet shpejt, sido që dihet nga të gjithë se sëmundja vjen shpejt, po nuk shërohet aq lehtë. Duke qenë, pra, edhe nën presionin e të sëmurit, mjeku lëkundet dhe, akoma pa parë efektin e kurës, e ndërron atë dhe jep barna të tjerë. Mirëpo dihet se ka barna që në organizmin e disa njerëzve bëjnë reaksion, gjë që, disa mjekë, nuk e kanë parasysh kurdoherë.

Është shumë me vend edhe ajo që tha shoku Petrit Gaçe për të ngritur nga ana profesionale në nivelin e detyrës delikate që kanë, veç mjekëve, edhe ndihmës-mjekët, infermierët, laborantët e të tjerë. Është e qartë se pa punën e personelit ndihmës nuk mund të bë-

hen mirë dhe saktë analizat, nga të cilat varet shumë përcaktimi i diagnozës nga mjeku dhe prej këndeje rruga që duhet ndjekur për kurimin e të sëmurit. Në rast se analizat bëhen në mënyrë shumë të kujdeshshme dhe me kërkesa të rrepta shkencore, sëmundjen e zbulon më lehtë, si rrjedhim edhe receta, mjekimi apo çfarëdo procedure tjetër, që do të nevojitet për t'i bërë të sëmurit, përcaktohen më lehtë. Ndryshe, bëhen gabime, që në mjekësi kushtojnë shtrenjtë. Mendoj se një rishikim i këtyre çështjeve duhet pasur parasysh.

Le të marrim gjendjen e laboratorëve. Për pajisjen e institucioneve tona mjekësore me laboratorë janë bërë përparime. Mjekësia jonë në këtë drejtim, mund të themi, ka hyrë në rrugën e modernizimit, me gjithatë, jemi akoma mbrapa nga objektivi që synojmë të arrijmë. Ka ardhur koha të marrim masa që edhe laboratorët, sidomos nëpër rrethe, t'i plotësojmë me pajisjet e nevojshme, qoftë edhe pse mund të na kërkohet të bëjmë ca sakrifica në drejtime të tjera, mba-si këtu është fjala për ruajtjen e shëndetit të popullit. Por, laboratori, sado i pajisur mirë që të jetë, nuk vlen në rast se nuk përgatitim më parë ata që do të punojnë në të, laborantët. Me sa di unë, laborantë kemi shumë pak, por ka edhe nga ata që nuk janë të përgatitur si duhet, pavarësisht se nuk u mungon dëshira të punojnë. Përgatitjes dhe kualifikimit të tyre t'u vëmë rëndësinë e duhur. Pastaj, të kemi parasysh se shumicën e popullsisë e kemi nëpër fshatra, prandaj është e domosdoshme të parashikojmë pajisjen e laboratorëve në çdo rreth me të gjitha mjetet e duhura për analizat. Mirëpo qëllimit nuk mund t'ia arrijmë,

në rast se nuk përgatitim në një nivel të mirë laborantët, që të janë në gjendje ta kryejnë me saktësi shërbimin. Laboranti është syri, është krahu i djathtë i mje-kut. Analiza e kryer mirë i jep mjekut pasqyrën me të dhënat që do ta ndihmojnë të njohë, të zbulojë dhe të përcaktojë drejt sëmundjen.

Analizat mjekësore dihet se janë nga më të ndryshmet dhe kjo është një punë me shumë përgjegjësi. Kjo kërkon, në radhë të parë, që t'i krijojmë këto mu-nësi, të sigurojmë institucionet tona shëndetësore me mjetet më të domosdoshme.

Lidhur me këtë desha të shtroj problemin nëse janë sjellë me kritere të shëndosha aparaturat e ardhura nga jashtë dhe që na kushtojnë valutë të madhe? Me fjalë të tjera, pyes nëse për blerjen e aparaturave jashtë shtetit mbahet parasysh që ato të kryejnë një shërbim të përgjithshëm dhe shumë të domosdoshëm për profilaksinë dhe për ruajtjen e shëndetit të ma-save të popullit, apo janë sjellë aparatet të kushtueshme shumë që duhen vetëm për disa sëmundje të kufizuara, në një kohë kur nuk kemi akoma siç duhet laborato-rë për të bërë analiza të përsosura e të domosdoshme për depistimin e sëmundjeve? E kam fjalën, janë sjellë aparatura që vlejnë për luftimin e sëmundjeve shumë të përhapura, apo vetëm për disa sëmundje më të rrezikshme, por të rralla, duke qenë të nxitur nga disa mjekë specialistë? Unë nuk them të mos sillen aparatet për sëmundjet shumë të rrezikshme, qofshin edhe të rralla, por, brenda mundësive dhe kushteve tona të sotme, duhet t'i jepet prioritet në fillim asaj që është më e domosdoshme.

Njëkohësisht, ne duhet të përgatitim edhe ata që do t'i përdorin këto mjete, ndryshe do të çalojmë. Një laborant duhet të dijë, fjala vjen, si ta marrë gjakun, si ta klasifikojë atë dhe, me shpejtësinë më të madhe, ta çojë nga vendi ku ndodhet i sëmuri në fshat, për shembull, në laboratorin e rrëthit. Aty puna duhet të jetë e organizuar mirë, në mënyrë që analiza të bëhet me kujdes jashtëzakonisht të madh dhe jo siç ngjet në shumë raste, kur bëhen analiza apo jepen ilaçe në farmaci pa kurrsfarë përgjegjësie. Do të përmend një rast të tillë.

Një infermiere, më tregoi se kishte pasur nënën të sëmurë nga zemra dhe e çoi te mjeku, i cili, pasi e vizitoi, i lëshoi recetën për të térhequr barnat përkates. Pasi i mori në farmaci, kur po bëhej gati t'ia jepte s'ëmës barnat e rekomanduar, ç'të shihte?! Nuk ishin ata që i kishte dhënë mjeku(!). Qëlloji ta konstantonte këtë, se ishte vetë infermiere dhe kishte ca dijeni nga farmakologjia. Kur vuri re që ilaçet nuk qenë ato që kishte rekomanduar mjeku, mbasi s'kishin të bënин fare me natyrën e sëmundjes së nënës, e shqetësuar, u kthyje përsëri në farmaci, ku kërkoi të kontrollohej receta. Atje u verifikua se ilaçet e dorëzuara nuk përputheshin fare me ato të recetës. Farmacistja vuri duart në kokë kur pa gabimin që kishte bërë, duke përgatitur barna tjetër për tjetër. Po të mos kishte hapur sytë e bija, e ëma e infermierës do të ishte dëmtuar, në mos po do ta kishte pësuar fare.

Ngjarje të tillë të dëmshme, si kjo për të cilën fola, mund të ndodhin fare lehtë edhe nëpër laboratori, në rast se nuk tregohet kujdes i jashtëzakon-

shëm. Epruvetat, mbushur me gjak ose me materiale të tjera të nevojshme për tu analizuar, që do të vijnë nga pikat sanitare të fshatrave në laboratorin e qendrës së rrithit, mund të ngatërrohen, po të mos ketë një organizim e disiplinë të rreptë në punë. Një gjë e tillë mund të ndodhë edhe nëpër spitalet që kanë farmaci dhe vetëm një person për të kontrolluar përgatitjen e qindra barnave në ditë për të sëmurët e gjithë pavijoneve, prandaj, në rast se farmacisti-kontrollor nuk bën kujdes në këtë drejtim, mund të ndodhin fatkeqësi të pandreqshme.

Krahas përgatitjes së mirë të kuadrit të ri dhe përpjekjeve për të pajisur gradualisht me mjetet e nevojshme laboratorët, t'u vihet, gjithashtu, kujdes i madh edukimit dhe kualifikimit të vazhdueshëm të të gjithë punonjësve të mjekësisë: mjekëve, ndihmësmjekëve, infermierëve, laborantëve etj., etj. pasi akoma nuk i kemi në masën dhe në nivelin e dëshiruar për të depistuar kudo dhe kurdoherë sëmundjet që ekzistojnë. Kjo punë të merret me shumë seriozitet, duke punuar në mënyrë sistematike në këtë drejtim me qëllim që t'i shërbejmë popullit nga ana shëndetësore më me efikasitet.

Mjekët e rinj, ndihmësmjekët dhe gjithë personelit jetër sanitar që përgatitim nü shkolla e kurse, edhe kështu si punohet, mirë dalin, se në përgjithësi bëjnë përpjekje të mëdha për të mësuar, po edhe ca më shumë duhet të punohet në këtë drejtim jo vetëm gjatë viteve të shkollës, por edhe pas mbarimit të studimeve. Të kujdesemi e të marrim masa që deri mjekët me eksperiencë të gjatë t'i specializojmë vazhdimisht në degët për-

katëse, pse, në qoftë se duam të depistojmë e t'i shërojmö si duhet sëmundjet e ndryshme, deri edhe ato më të ndërlikuarat, duhet të punojmë që të përgatitim edhe mjekë specialistë. Tani nuk kemi akoma sa duhet specialistë të përgatitur mirë për çdo degë, por është koha të marrim masa për këtë punë, pra, të përgatitim në nivel të mirë të rinxjtë, por edhe të specializojmë më tej ata që kanë një stazh pune të gjatë.

Jam dakord me masat që kemi marrë e mund të marrim akoma edhe në të ardhmen për të sjellë mjete të tjera moderne për diagnostikimin e sëmundjeve, por, meqë aparaturat e ndërlikuara e moderne i kemi edhe të kusizuara në numër, nuk mund t'i çojmë hë-përhcë nëpër rrethe, sigurisht ato do të mbeten këtu, në Tiranë. Specialistëve, që u janë besuar t'i përdorin, u vihet detyrë që t'i përvetësojnë mirë, t'i shfrytëzojnë plotësisht e t'i mirëmbajnë. Kjo kërkon nga këta që të mësojnë me zell e të specializohen dita-ditës për zotërimin më së miri të tyre në dobi të shëndetit të njerëzve. Kështu, kryeqyteti, ku do të vendosen e do të sillen vazhdimisht të tilla aparate moderne, ku këto mjete do të jenë në duar të specialistëve me kompetencë, të bëhet qendra kryesore që do të presë të sëmurë nga i gjithë vendi për t'u vizituar e për t'u përcaktuar me saktësi diagnozën dhe kurat që do të bëjnë. Por atyre që i kanë në dorë këto mjete, përveç detyrës së dorës së parë, që të mësojnë vetë sa më mirë për t'i njojur e shfrytëzuar, u vihet detyrë të mbajnë rrëth vetes edhe kuadro të tjerë të rinj për t'i përgatitur që t'i zëvendësojnë në çdo kohë, si edhe

për të qenë në gjendje që nesër të marrin menjëherë
në duar mjetet e reja, që në të ardhmen do të vijnë
vazhdimi shkurtër duke u shtuar.

Botuar për herë të parë,
me disa shkurtime, në li-
brin: *Enver Hoxha, «Për
shkencën (Përmbledhje ve-
prash)», vëll. I, f. 474*

Botohet i plotë sipas tekstit
të nxjerrë nga procesverbali i
mbledhjes së Byrosë Politike
të KQ të PPSH, që gjendet
në AQP

NJE ETAPË E RE E STRATEGJISË GLOBALE SOVJETO-AMERIKANE KUNDËR LIRISË E PAVARËSISË SË POPUJVE

Artikull i botuar në gazetën „Zëri i popullit“

27 maj 1972

Kurrë ndonjëherë propaganda imperialiste e Shteteve të Bashkuara dhe ajo revizioniste e Bashkimit Sovjetik nuk u kanë rënë kaq shumë kambanave, siç po bëjnë tani për të lavdëruar «vizitën historike» të Niksonit në Moskë¹. Aleatët dhe satelitët e të dy vendeve janë vënë në garë kush ta duartrokasë e ta glorifikojë më shumë Niksonin, përfaqësuesin numër një të imperializmit amerikan, armikun më të madh të gjithë

1. Nga data 22 deri 30 maj 1972 bëri një vizitë zyrtare në Bashkimin Sovjetik Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Nikson. Lidhur me këtë vizitë në Ditarin e Tij Politik shoku Enver Hoxha shkruante: «Revizionistët sovjetikë janë aq të etur për aleancën me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. janë aq të interesuar për miqësinë e tyre, saqë asgjë nuk i përmban. Për ta s'kanë vlerë as opinioni i popullit sovjetik dhe ndjenjat e tij, as ai botëror dhe as zemërimi i ligjshëmi i popullit heroik të Vietnamit që vritet e digjet. Ja ç'janë revizionizmi dhe revizionistët».

popujve dhe kreun e të tërë reaksiionit botëror. Moska revizioniste po e trajton me një respekt të theksuar. Udhëheqësit e Kremlinit nuk ia kursejnë mburrjet dhe përpiqen që vizita e tij në Bashkimin Sovjetik të marrë pamjen jo vetëm të një triumfi të politikës së jashtme të administratës së tij, por edhe të një suksesi të shquar personal.

Kremlinin, që për të gjithë komunistët e popujt ka qenë simboli i revolucionit e i komunizmit, vendi ku ka jetuar e punuar Lenini i madh dhe ku janë marrë vendime historike për revolucionin e socializmit, revizionistët sovjetikë e kanë kthyer në një hotel ku vijnë antikomunisti i tërbuar Riçard Nikson dhe suita e tij.

Idili imperialisto-revizionist ka arritur kulmin. Të dyja palët po e përmbytin opinionin publik botëror me një lumë të madh demagogjie, që ka për qëllim të largojë vëmendjen nga komplotet që thuren këto ditë në Moskë dhe që vendimet e dy superfuqive «për fatet e botës» të pranohën si mesazhe hyjnore për shpëtimin e «njerezinit mëkatar».

Megjithëkëtë, nuk është vështirë të shihet që bisidimet sovjeto-amerikane në Moskë nuk paralajmërojnë ndonjë mbarësi. Prapa këtij diversioni të madh diplomatik e propagandistik fshihen përpjekjet e imperialisteve amerikanë dhe të revizionisteve sovjetikë për të larguar vëmendjen e popujve nga kërcënimet e rreziqet që shkakton bashkëpunimi i tyre reaksionar kundër lirisë e pavaroisë së popujve, çështjes së revolucionit e të socializmit në botë.

Një nga masat më të shquara revolucionare të Leninit, të cilën ai e shpalli që ditën e parë të fitores së

Revolucionit të Tetorit, ishte dënimi i diplomacisë së fshehtë dhe i marrëveshjeve sekrete të carëve e të mbretërve të Evropës. Por udhëheqësit sovjetikë, që i kanë profanuar Leninin dhe mësimet e tij, u kthyen në diplomacinë e carëve dhe të presidentëve borgjezë, në diplomacinë e prapaskenave e të komploteve për t'i goditur popujt në besasi e pas shpine. Për ditë e orë të tëra Niksoni e Brezhnjevi bisedojnë kokë më kokë në prani vetëm të një përkthyesi.

Përbajtja e këtyre bisedimeve mbahet krejtësisht e fshehtë, pasi ajo çka diskutohet e vendoset aty drejtohet kundër lirisë e sovranitetit të popujve. kundër të drejtave dhe barazisë së tyre në jetën ndërkombëtare. Dhe pikërisht ato vendime e marrëveshje që nuk shpalllen, që mbahen sekrete e që nuk i dinë popujt, kanë edhe pasojat më të rënda. përbëjnë rreziqet më të mëdha.

Tanimë është e dukshme se të dyja supersfuqitë i lidhin interesa tëpër të ngushtë, të cilët nuk marrin parasysh dhe nuk respektojnë asnjë të drejtë të popujve, asnjë parim ndërkombëtar, asnjë normë morale botërore. Ngjarjet e përditshme, midis të cilave edhe bisedimet e tanishme sovjeto-amerikane në Moskë, vërtetojnë gjithnjë e në mënyrë më bindëse se as natyra e imperializimit amerikan nuk ka ndryshuar, as tradhtia e revisionistëve sovjetikë nuk ka pushuar. Të dyja palët janë jo vetëm ato që kanë qenë, por e kanë intensifikuar edhe më shumë politikën dhe veprimtarinë e tyre kundër revolucionit, lirisë e pavarësisë së popujve.

Kur Niksoni urdhëroi minimin e porteve dhe të ujërave të RD të Vietnamit, si dhe rifillimin e bombar-

dimeve ajrore masive në Veri¹, pati njerëz që filluan të besojnë se jo vetëm takimi sovjeto-amerikan në Moskë mund të hidhej në erë, por bashkë me të edhe paqja e siguria e të gjithë popujve. Të gjithë e pamë se nuk ndodhi asgjë. Punët ecën si sahat, bllokada e SHBA-së vazhdon, bombat amerikane bien pa pushuar mbi fëmijët dhe popullsinë e pafajshme të Vietnamit, Niksoni pritet si bartës i paqes në Moskë.

Është e qartë se të dyja palët kanë rënë dhe janë në ujdi për ato që ndodhin tani në Vietnam. Fakti që Niksoni vendosi bllokadën dhe bombardon Vietnamin dhe revisionistët sovjetikë e presin atë në vendin e tyre, është më shumë se një provë.

Disa vjet më parë, Kosigini pati deklaruar publikisht se «për sa kohë që do të vazhdojë lufta në Vietnam, për sa kohë që bombat do të bien mbi popullin e pafajshëm, një takim i nivelit të lartë sovjeto-amerikan nuk do të jetë i mundshëm». Tani jo vetëm kjo deklaratë, por edhe të tjera, shumë më dramatike, janë harruar. Zonja Nikson u dhuron topa basketbolli shkollarëve sovjetikë dhe mikpritësit e saj s'dinë si ta falënderojnë për këtë «surprizë të këndshme». Por të dyja palët dhe gjithë bota e dinë se po në të njëjtën kohë topa të tjerë amerikanë bien mbi Vietnamin, shkatërrojnë shkollat dhe vrasin kalamajtë e kopshteve, u heqin gëzimin fëmijëve dhe u këputin zemrat nënave.

Në takimin sovjeto-amerikan në Moskë, siç është bërë e ditur, do të diskutohen problemi vietnamez dhe gjendja në Indokinë. Se të çfarë natyre do të jenë dhe

1. Në Vietnamin e Veriut.

ku do të synojnë këto bisedime, mund të merret lehtë me mend. Ato janë bisedime midis armiqsh të popullit vietnamez dhe të luftës së tij, bisedime që kanë për qëllim ta sabotojnë luftën çlirimitare dhe t'i shpëtojnë agresorët amerikanë nga disfata e pashmangshme. Por populli vietnamez nuk pranon që çështja e luftës së tij të bisedohet atje dhe që të tjerë të vendosin për fatot e tij. Vetëm Vietnamitë dhe populli i tij kanë të drejtën sovrane të diskutojnë dhe të vendosin për çështjet që u takojnë vetëm atyre dhe askujt tjetër.

Për të qenë me të vërtetë solidarë me Vietnamin nuk mjafton të japësh disa ndihma materiale, siç bëjnë sovjetikët. Për këtë nevojiten qëndrime parimore konsekutive e korrekte.

Ne e kemi thënë, dhe jeta e provoi, se «përkrahja» për Vietnamin në anën e jashtme pör revizionistët sovjetikë ka qenë një mjet propagandistik për të ruajtur aparenat «antiimperialiste», ndërsa nü praktikën e përditshme një objekt për pazarllëqet sovjeto-amerikane lidhur me ndarjen e zonave të influencës dhe me sundimin e botës.

Krerët sovjetikë, duke filluar që nga Hrushovi e duke përfunduar te Brezhnjevi, janë treguar të gatshëm ta bëjnë kurdoherë sli Vietnamin, po që se interesat e tyre hegemonistë kompensohen në një sektor tjetër. Cilësimi që Presidenti i Sovjetit Suprem të BRSS u bëri marrëdhënieve sovjeto-amerikane si «jo vetëm të mira, por edhe të përzemërtë», në një kohë kur presidenti amerikan porsa ka urdhëruar minimin e porteve të Vietnamit të Veriut për të ndaluar hyrjen e çdo materiali, tregon se lufta dhe ngjarjet në Vietnam nuk ushtrojnë

asnjë influencë në raportet dhe në lidhjet tëpër të ngushtë midis Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik.

Nga kjo del sheshit jo vetëm tradhtia e revizionistëve sovjetikë, por edhe fakti që imperialistët amerikanë u imponuan revizionistëve sovjetikë pozitën e forcës, gjë që nuk mundën ta bëjnë ndaj luftëtarëve heroikë vietnamezë. Prandaj për popullin vietnamez, për luftëtarët vietnamezë, qëndrimi dhe veprimi i udhëheqësve sovjetikë është krejtësisht i pabesë dhe thellësisht tradhtar.

Vizita e presidentit të SHBA-së në Bashkimin Sovjetik, gjë që u duk edhe në fjalimet që Podgorni e Niksoni mbajtën në darkën e shtruar në Kremlin, është shprehja më e qartë dhc më kulminante e përpjekjeve të të dyja superfuqive për të vendosur sundimin e kontrollin e tyre në jetën politike, ekonomike e ushtarake kombëtare të të gjitha vendeve, për të ndarë midis tyre pushtetin botëror imperialist.

Për këtë arsy popujt e botës bisedimet e fshehta sovjeto-amerikane i shikojnë jo vetëm me mosbesim, por edhe me bindjen se në Moskë tanë po përkufizohet më qartë e më thellë mbarë strategjia imperialisto-revizoniste për të ardhmen. Duke kritikuar rreptë takimin e Moskës, në shtypin e huaj shprehet haptazi frika se ky takim mund të përfundojë në një marrëveshje që të krijojë një imperializëm të përbashkët amerikano-sovjetik. Ky opinion është plotësisht i justifikuar. Në formë zyrtare është bërë e ditur se në Moskë, përvëç problemeve të marrëdhënieve dypalëshe, do të trajtohen çështje që prekin gjithë kuadrin e sotëm botëror të ma-

rrëdhënieve ndërkombëtare, që, në këtë ose atë mënyrë, me këtë ose atë peshë, prekin gjithë popujt e botës.

Por çfarë zgjidhje mund t'i japin imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë, për shembull, konfliktit arabo-izraelit, për të cilin, siç është bërë e ditur, do të bisedojnë në Moskë? Në radhë të parë, ky konflikt është nxitur e mbahet gjallë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat as që mund të mendohet se, me vetë dëshirën e tyre, do të pranojnë të heqin dorë nga përkrahja e Izraelit dhe nga ndërsimi i tij kundër popujve arabë. Shtetet e Bashkuara janë armiqjtë më të cgër të arabëve, grabitësit më të mëdhenj të tokave dhe të pasurive të tyre. Ato do të përpiken nëpërmjet Izraelit, me anë të dhunës e të diplomacisë, t'i ruajnë sa të jetë e mundur më gjatë pozitat e tyre strategjike në zonën e Lindjes së Mesme. Nga ana tjetër, imperialistët e rinj sovjetikë kanë vrapuar në Lindjen e Mesme, jo për të ndihmuar arabët dhe për të zgjidhur konfliktin, po për të përfituar sa më shumë dhe për të shfrytëzuar momentin që të hedhin thonjtë dhe të vendosin aty influencën e tyre. Të dy fuqitë imperialiste janë përpjekur dhe përpiken të shfrytëzojnë konfliktin për t'u ngulur në Lindjen e Mesme dhe tragjedinë e popujve arabë ta përdorin në dobi të interesave të tyre agresivë e ekspansionistë. Qëllimisht ato i mbajnë këtu urët të ndezura, që, në këtë ose atë mënyrë, të justifikojnë ndërhyrjen dhe qëndrimin e tyre në këtë zonë. E shtrenjtë për imperialistët nuk është liria e arabëve, por plasdarmet e Lindjes së Mesme për ekspansionet e ardhshme, që ata planifikojnë në drejtim të Afrikës e të Azisë. A mund të mendojë njeri se

tani në Moskë imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë do t'i shuajnë këto urë?

Si mundet vendet arabe të kenë besim te sovjeto-amerikanët kur imperializmi amerikan mban në këmbë dhe armatos Izraelin kundër popujve arabë, ndërsa revizionistët sovjetikë frenojnë arabët për të fituar të drejtat e tyre dhe forcojnë potencialin njerëzor të Izraelit me dërgimin e çifutëve sovjetikë, për të shtuar radhët e ushtrisë izraelite dhe për të kolonizuar tokat e pushtuara arabe? Revizionistët sovjetikë mund ta minimizojnë çështjen, të paraqesin justifikime të ndryshme, por ato nuk janë bindëse. Ose duhet pranuar që në Bashkimin Sovjetik ndiqet një politikë shoviniste nacionaliste dhe çifutët janë të detyruar të emigrojnë, ose Bashkimi Sovjetik është në komplot me Izraelin dhe ka rënë në ujdi me të për emigrimin. Në fakt, të dy këto aspekte të emigrimit në masë të çifutëve sovjetikë drejt Izraelit janë të vërteta për Bashkimin e sotëm Sovjetik.

Në formën më cinike dhe më arrogante, bisedimet sovjeto-amerikane në Moskë po zhvillohen nën shenjën e së drejtës që të dyja superfuqitë i jepin vetes për tu bërë arbitra të të gjitha çështjeve ndërkombëtare, që qëndrimet dhe marrëveshjet e tyre të janë diktat për të tjerët.

Këtë koncept imperialist të fuqisë së madhe e shprehu fare qartë Podgorni kur tha se «përfundimi i marrëveshjeve dhe i traktateve të rëndësishme ndërkombëtare», ose «mundësitet për zgjidhjen e konflikteve e të situatave» bëhen të mundura kur «gjendet një ekuilibër i arsyeshëm i interesave të të dy vendeve».

Kjo do të thotë që, po të biem dakord në mes tonë, ne, dy të mëdhenjtë, dimë si të veprojmë me lëvizjet revolucionare, nacionalçlirimtare të popujve etj.

Për më tepër, imperialistët amerikanë dhe ata sovjetikë kërkojnë që teorinë e tyre të «domosdoshmërisë së ruajtjes së ekuilibrit midis superfuqive» ta kthejnë në një normë të detyrueshme ndërkombëtare dhe të ngulitin në mendjet e njerëzve se koncerti amrikano-sovjetik është faktori vendimtar i ruajtjes së paqes botërore, i cili jo vetëm duhet pranuar pa ngurrim, por duhet bërë edhe çmos që, për «hir të paqes e të sigurisë ndërkombëtare», ai të ruhet e të forcohet me çdo kusht.

Sipas tyre, popujt nuk duhet të ngrihen kundër sundimit imperialist, as të kundërshtojnë planet e tij aggressive, pasi prishet ekuilibri i fuqive, gjë që do të çojë në shkatërrimin e botës, në luftën totale bërthamore. Prandaj, për të ruajtur këtë ekuilibër, vendet e tjera duhet të bëjnë sakrifica në dëm të sovranitetit dhe të interesave të tyre më të lartë kombëtarë. Niksoni e parashtroi hapur qëndrimin e përbashkët sovjeto-amerikan kur tha se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik duhet «të ushtrojnë një influencë mbi kombet e tjera në gjendje lufte ose krize, në mënyrë që ato të moderojnë politikën e tyre». Kjo është thirrje e hapët për të mbetur çdo luftë revolucionare e çlirimtare të popujve, çdo protestë e revoltim kundër imperializmit.

Fjalimet e udhëheqësve dhe të zëdhënësve sovjetikë e amerikanë këto ditë janë të mbushura me fjalët «bashkekzistencë paqësore», «paqe botërore», «ulje tensio-

ni», «bisedime të dobishme për forcimin e sigurimit ndërkombëtar» etj. Nuk është hera e parë që ata kanë folur për paqe dhe kanë shpërthyer luftën, kanë ngritur lart sigurinë e kombeve dhe kanë sulmuar popujt. Por tani këto parulla kërkojnë t'i shndërrojnë edhe në mekanizma ideologjikë të alcancës së tyre për ruajtjen e interesave të vet imperialistë dhe zgjerimin e sferave të influencës. Kushdo e kuption se, sipas konceptit sovjeto-amerikan, paqe botërore do të thotë paqe e ulje tensioni ndërmjet dy superfuqive, ashtu si bashkekzistencë paqësore do të thotë bashkësundim imperialist mbi botën.

Imperialistët amerikanë dhe revisionistët sovjetikë kanë shumë vjet që spekulojnë me të ashtuquajturin çarmatim të përgjithshëm, të pjesshëm, ose zonal e që në Moskë duan t'i japid një fryrje të re me nënshkrimin e marrëveshjes rrëth të ashtuquajturit kufizim të armëve strategjike. Me anën e tij ata duan të krijojnë një psikologji të përgjithshme botërore nënshtimi e fataliteti të pashmangshëm, t'i përgatitin popujt ideologjikisht që të institucionalizohet monopolii ushtarak i zakonshëm e bërthamor i dy superfuqive, që popujt të angazhohen edhe juridikisht për të mos u armatosur. Me një fjalë, ata duan të vendosin kontrollin e armatosur të pushtetit të tyre imperialist mbi gjithë botën.

Marrëveshjet filluan të nënshkruhen në Moskë. Dy të parat kanë të bëjnë njëra me ambientin rrethues dhe tjetra me bashkëpunimin në fushën e studimeve mjekësore. Por ç'vlerë ka për paqen botërore marrëveshja sovjeto-amerikane për studimin e sëmundjes së kancerit? Po Franca, Kina, Gjermania e të tjera, që nuk

e kanë këtë traktat, mos vallë do të rrinë duarlidhur dhe nuk do të punojnë kundër kancerit? Këto marrëveshje përfundohen për qëllime demagogjike, për të gënjer popujt që të besojnë se në takimin sovjeto-amerikan diskutohen gjërat më të pafajshme, «vendosja e paqes», «lufta kundër sëmundjeve e ndotjes së natyrës», «përhapja e kulturës e përparimi i teknikës» etj. Marrëveshjet sovjeto-amerikane filluan me këto dy dokumente «humanitare» që bota të mos shikojë ato që vijnë pas e që do të kenë të bëjnë me vrasjen e popujve dhe skllavërimin e tyre.

Me të drejtë të gjithë vëzhguesit vërejnë se marrëveshjet e reja kulturore dhe ekonomike që do të përfundohen ndërmjet dy vendeve, edhe pse do të marrin shunië bujë e reklamë, nuk janë ato që do të karakterizojnë tanit dhe në të ardhmen marrëdhëniet sovjeto-amerikane. Revisionistët e çuan Bashkimin Sovjetik në një shkallë të tillë saqë nga nevoja e madhe që kanë për ndihmë ekonomike e teknike nga Shtetet e Bashkuara, të detyrohen t'u jasin koncesione të mëdha kapitalistëve amerikanë dhe të ndajnë me ta fitimet. Por megjithëkëtë, tanit për tanit të dyja palët i kanë dhënë e do t'i jasin epërsi e prioritet anës politike e ushtarake të bashkëpunimit të tyre. Kjo ka lidhje me nxitimin për të fituar kohë përpëra se të demaskohen planet e tyre monstruoze dhe përpëra se popujt të bëhen plotësisht të ndërgjegjshëm për rrezikun e madh që u kanoset. Në karakterin e saj ushtarak qëndron edhe një nga anët më të rrezikshme të aleancës sovjeto-amerikane për lirinë e pavarsinë e popujve. Si më parë edhe tanit, në politikën dhe në planet agresive

të të dyja superfuqive, ato që do të dominojnë do të jenë interesat dhe konsideratat politiko-ushtarake.

Në fjalimet që po mbahen dhe në deklaratat që po bënë tanë në Moskë, të dyja palët sikur janë vënë në garë për të tronditur botën me rrezikun e një lufte bërthamore që mund të shkaktojnë të dyja superfuqitë dhe me thirrjet patetike që ato i bëjnë njëra-tjetrës për të mënjanuar këtë rrezik. «Të shpëtojmë brezin e tanishëm dhe të ardhshëm nga rreziku i një konflikti bërthamor», thërret Podgorni. «Le të përbahen fuqitë bërthamore nga çdo krizë dhe le të ndërmarrin hapa pozitivë, me qëllim që të ndalojnë konfliktin e drejtpërdrejtë», i përgjigjet Niksoni.

Por, duke u hequr mbulesën demagogjike këtyre deklaratave, nuk është vështirë të vihet re se ajo që i shqetëson më tçpër Uashingtonin e Moskën nuk është mundësia teknike që kanë dy superfuqitë për të shkatërruar njëra-tjetrën, por zbutja e rivaliteteve dhe arritja e marrëveshjeve të përbashkëta për ndarjen dhe sundimin e botës.

Bisedimet e Moskës dhe rendi i ditës së tyre dëshmojnë se palët përpiken të harmonizojnë qëndrimet dhe të koordinojnë veprimet për çështjet kryesore ndërkombëtare dhe problemet kyç të politikës së tyre të jashtme. Një vend të posaçëm ka zënë aty i ashtuquajturi sigurim evropian, i cili është fryt i marrëveshjeve që Moska ka bërë me imperializmin amerikan dhe i lëshimeve të saj ndaj revanshistëve gjermanë. Por çfarëdo që të diskutojnë dhe të vendosin Niksoni e Brezhnevji për Evropën, ato do të janë në dobi të luftënxitësve imperialistë, të aleancës kundërrevolucionare sovjeto-

-amerikane, në dëm të socializmit, të Shqipërisë e të mbarë popujve. «Sigurimi» që kërkojnë imperialistët amerikanë dhe revisionistët sovjetikë është sigurim i zonave të tyre të influencës në Evropë, nënshtrim politik e ekonomik i kontinentit tonë, sigurim i krahëve për ta drejtuar tehun e agresionit të tyre në vende e zona të tjera të botës.

Ka njerëz e qeveri që mburrin takimin e amerikanëve e sovjetikëve në Moskë dhe, nga ana tjetër, kërkojnë largimin e flotave të tyre nga Mesdheu. Të tilla qëndrime dhe të tilla kërkesa nuk janë as reale, as konsekuente. Bisedimet e Moskës nuk janë as në favor të Francës, as të Beneluksit¹, as të ndonjë vendi tjetër të Evropës, siç mburr takimin Nikson-Brezhnjev shtypi i djathëtë evropian, kur dihet mirë se me intrigat sovjeto-amerikane fuqizohet potenciali i këtyre dy superfuqive, të cilat do të mbështetin ato shtete që do të pranojnë diktatin e tyre.

Përveç sigurimit evropian, ndër çështjet e tjera që shqyrtojnë Niksoni e Brezhnjevi zënë vend marrëdhëni e drejtpërdrejta të dy vendeve, problemet lidhur me SALT-in, qëndrimi i dy supersfuqive ndaj konfliktit arabo-izraelit, problemi i Vietnamit, marrëdhëni me Kinën dhe, më në fund, ajo që në SHBA e BRSS e quajnë efektshmëria e Kombeve të Bashkuara. Jashtë kësaj liste mbeten mjaft çështje të tjera botërore, rëndësia e të cilave nuk është e vogël, por për imperializmin

1. Beneluks — Grupim ekonomik i përbërë nga Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu, krijuar në bazë të marrëveshjes së nënshkruar më 1958 që hyri në fuqi më 1960.

amerikan dhe atë sovjetik ato nuk paraqesin ndonjë ngutësi, pasi nuk marrin pjesë në harmonizimin e interesave të përbashkët amerikano-sovjetikë, që kanë gjithë prioritetin. Ata diskutojnë për ato probleme që kanë të bëjnë me pazarllëqet për ndarjen e zonave të reja të influencës, me përpjekjet për të vendosur në botë diktaturën sovjeto-amerikane, që kanë të bëjnë, më në fund, me përcaktimin e një politike dhe me koordinimin e veprimeve të përbashkëta në luftën kundër revolucionit, lëvizjes nacionalçlirimtare e socializmit, gjë që përbën edhe esencën kundërrevolucionare të kësaj aleance.

Vizita e Niksonit në Moskë dhe bisedimet e tij me udhëheqjen e Kremlinit dëshmojnë se aleanca dhe rivaliteti sovjeto-amerikan sot është një realitet me të cilin popujt ndeshen çdo ditë dhe drejtëpërdrejt. Tani dhe për një kohë të gjatë kjo mbetet rreziku kryesor për lirinë e pavarësinë e të gjitha vendeve, për të ardhmen e mbarë njerëzimit. Reziqet që paraqesin ato janë të mëdha, por akoma më të mëdha janë forcat e popujve që mund t'u kundërvihen. Çështja është që ndaj tyre të ruhet kurdoherë e mprehtë vigjilencia dhe të luftohet me vendosmëri si kundër imperializmit amerikan e socialimperializmit sovjetik, ashtu edhe kundër të dyve së bashku.

Botuar për herë të parë në gazeten «Zëri i popullit», nr. 127 (7419), 27 maj 1972

Botohet sipas librit: „Zëri i popullit“ kundër imperializmit dhe revizionizmit, vël. I, f. 76

ÇDO NËNVLEFTËSIM NË PUNËN PËR EDUKIMIN E RINISË ËSITË I DËMSHËM PËR TË ARDHMIN E ATDHEUT

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit
të Kuvendit Popullor¹*

29 maj 1972

Jam dakord me raportin e paraqitur nga Prokuroria e Përgjithshme, si dhe me vërejtjet që ka bërë për të aparati i Presidiumit të Kuvendit Popullor.

Shokët bëjnë përpjekje dhe shqetësohen për t'i kryer sa më mirë detyrat e ngarkuara me ligj. Natyrisht, krahas sukseseve në punë, ka edhe të meta që i njohin, prandaj edhe më shumë duhet kujdes për t'i zhdukur.

Organet hetimore² duhet ta përqendrojnë vëmendjen në zbulimin e shpejtë të krimeve, nü përcakti-

1. Në këtë mbledhje u shqyrta rapporti i paraqitur nga Prokuroria e Përgjithshme për procedimet dhe arrestimet përviti 1971 dhe për tremujorin e parë të vitit 1972.

2. Në vitin 1972, hetuesia ishte e paunisikuar. Ekzistonte hetuesia e Prokurorisë dhe ajo e organeve të MPB; secila hetonte një kategori të caktuar veprash penale. Me vendim

min e shkaqeve të tyre dhe në zbatimin e përpiktë të ligjeve në fushën e procedimeve penale, të arrestimeve etj.

Për zbulimin e burimit të krimave, si dhe për luftën kundër tyre duhet të mobilizojmë gjithë popullin, Partinë, organet e pushtetit dhe organizatat e masave sipas një plani të ndërtuar me kujdes e të koordinuar.

Pavarësisht nga rritja ose nga ulja relative e numrit të disa krimave që vihet re nga viti në vit në rrethet e ndryshme të vendit tonë, nga raporti i paraqitur rezulton se përsëri ka probleme që duhet të na shqetësojnë. Unë do të flas pikërisht për disa nga këto, siç janë kujdesi dhe puna që na bie detyrë të bëjmë për një edukim më të mirë të fëmijëve dhe të rinjve, sidomos nga prindërit, qëndrimi më i ashpër që duhet mbajtur ndaj përvetësuesve të pasurisë socialiste dhe të qytetarëve, lufta që duhet bërë kundër disa shfaqjeve të indiferentizmit ndaj akteve të rrugaçërisë e vagabondazhit, detyra e respektimit të përpiktë dhe pa asnjë lëshim të ligjshmërisë sonë socialiste nga komunistët, nga kuadrot, nga masat etj., prandaj shokët le të më falin, në qoftë se nuk do t'i përbahem ngushtësisht vetëm problemit që parashikon rendi i ditës.

Në radhë të parë, duhet të na preokupojë seriozisht fakti i pjesëmarrjes së disa të rinjve në krim, të cilët duhet t'i edukojmë për t'i tërhequr sa më parë nga kjo rrugë. Duke e shqyrtuar këtë problem me kujdes, nuk

të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH nr. 73, datë 8.6.1983, organet e hetuesisë u riorganizuan dhe u vëguan nga organet e MPB.

mund të arrihet në përfundimin e gabuar që «rinia jonë ka hyrë në rrugë të keqe», sepse në përgjithësi ajo është e pastër, e ndershme dhe besnike e Partisë, por disa shfaqje negative të disa të rinjve nuk lejohet të nënvliftësohen.

Ka shokë, bile edhe anëtarë partie, të cilët, të prekur nga veprimet e gabuara të disa të rinjve, dalin me konkluzionin e nxituar dhe krejt të padrejtë sikur «rinia e sotme nuk është në rregull». Në qoftë se Partia interesohet jashtëzakonisht shumë pér edukimin e rinisë, këtë e bën jo pse rinia, siç thonë ata, «po prishet», por sepse kërkon që të rinj me sjellje jo të mira, qofshin edhe në një numër të kufizuar, të ruhen para se të kryejnë akte që formojnë vepra shoqërisht të rrezikshme. Po ta gjykojmë thellë dhe objektivisht këtë çështje, do të arrijmë në përfundimin e saktë se nuk janë fajtorë vetëm ata të rinj që kryejnë vepra të dënueshme penalisht, por, në këtë drejtim, kanë përgjegjësi edhe shumë njerëz të tjera, si dhe institucionet shtetërore e shoqërore që kanë detyra të posaçme pér edukimin e brezit të ri.

Në radhë të parë, pér parandalimin e krimeve të kryera nga të miturit kanë detyra dhe përgjegjësi të madhe prindërit. Familja nuk mund të qëndrojë indiferente ndaj problemit shumë të rëndësishëm të rritjes dhe të edukimit të fëmijëve, duke u nisur nga mendi-mi se meqenëse jetojmë në shoqërinë socialiste, e cila kujdeset që ata të edukohen nëpërmjet shkollës, organizatës së rinisë etj., nuk paska asnje rrezik pér edukimin e tyre, prandaj familja, sipas tyre, s'ka përsë të shqetësohet dhe të kujdeset veçanërisht pér këtë çështje. Ky

gjykim dhe kjo shhangje nga kujdesi i duhur për këtë problem me kaq përgjegjësi, janë krejtësisht të gabuar. Lufta e klasave, që vazhdon edhe pas likuidimit të klasave shfrytëzuese e gjer në fitoren e plotë të komunizmit në shkallë botërore, zhvillohet në të gjitha frontet. Kjo luftë në kohën e sotme ka marrë një rëndësi veçanërisht të madhe në frontin ideologjik. Lufta e klasave në këtë front ndeshet kudo: në shoqëri, në punë, në familje, në zbatimin e ligjshmërisë revolucionare dhe në çdo problem që na del përpara. Armiqtë e vendit tonë, nëpërmjet ideologjisë së tyre borgjeze e revizioniste, përpiken të çoroditin mendjet e të rinjve dhe t'i nxitin ata në veprime antishoqërore dhe kriminale, me qëllim që të rrezikojnë ndërtimin e socializmit në Shqipëri, tash dhe në të ardhmen, prandaj çdo nën-vleftësim në punën e edukimit të rinisë është jashtëzakonisht i dëmshëm për interesat e Partisë dhe për të ardhmen e sigurt të atdheut.

Të rinjtë e Shqipërisë socialiste edukohen nga shoqëria, nga organizata e tyre e rinisë etj., nën kujdesin dhe vëmendjen e posaçme të Partisë. Për edukimin e tyre Partia dhe populli kanë forca kolosale, të cilat janë në gjendje të frenojnë ata faktorë regresivë që i çojnë disa individë në rrugën e keqe të krimit. Në shoqërinë tonë socialiste luftohen me rreptësinë dhe me energjinë më të madhe prapambetja, obskurantizmi, konservatorizmi dhe të gjitha mbeturinat e ideologjisë feudale, borgjeze dhe revizioniste.

Po ta shikojmë çështjen e njohjes, të shoqërisë, të miqësisë, të dashurisë dhe të martesës në marrëdhëniet midis të rinjve me pikëpamjen e konservatorëve, del

se liria e të rinjve në këto drejtime duhet kufizuar, por kjo do të ishte krejtësisht e gabuar. Në qoftë se kon-servatorët gabojnë në këtë drejtim, disa të tjerë, midis tyre edhe disa të rinj të paformuar, që nuk i kuptojnë drejt këto raporte, gabojnë në drejtimin tjelër, ata shkojnë nga e djathia ekstreme, drejt një liberalizmi të shëmtuar. Sido që të rinj të kësaj kategorie janë pak dhe sjellja e tyre nuk është karakteristikë e rinisë sonë, gjersa ka të tillë, duhet të shqetësohem. Kundër ve-primeve të shëmtuara të njerëzve të tillë duhet të ve-projë me gjithë forcën e tij tërë opinioni shoqëror, gjithë populli, Partia, pushteti dhe organizatat e masave.

Për ruajtjen e figurës së pastër morale të të rinjve duhet të kemi parasysh edhe plotësimin e disa nevojave dhe kërkesave të arsyeshme që u dalin atyre nga vetëjeta e përditshme. Prindërit, përgjithësisht, i njojin këto nevoja dhe i plotësojnë, por ka edhe disa prej tyre që nuk çajnë kokën pér këtë gjë. Nuk mund të thuhet se këta prindëri nuk kanë mundësi ekonomike pér të plotësuar disa kërkesa modeste të të rinjve, siç janë, pér shembull: të hollat e biletës pér të vajtur në kinema, në stadium, pér të blerë njëëmbëlsirë, një akullore, një stilolaps, një stilograf etj. Të rinxjtë i kërkojnë këto, sepse u duhen, ata shkojnë njëri-tjetrin dhë se shumë nga shokët e tyre i kanë. Pakujdesia e treguar nga disa prindëri pér t'ua plotësuar të tilla kërkesa fëmijëve, është një shkak që i shtyn këta të hidhen në akte rrugaçërie, në fillim në vjedhje të sendeve me vlerë të vogël. Fëmija, që është fare i mitur, nuk e kupton rëndësinë e veprimeve që kryen, por prindërit duhet ta kuptojnë se këto akte «të vogla» janë shumë të

rrezikshme dhe ndikojnë keq në formimin e tyre, me pasoja për të ardhmen e tyre e të shoqërisë. Ai që vjedh sot diçka të vogël, mësohet me këtë ves të mbрапshtë dhe, po të mos punohet me këmbëngulje për ta riedukuar, nesër mund të zhytet më thellë në rrugën e krimit. Prandaj, në radhë të parë, prindërit e kanë për detyrë të jenë shumë të vëmendshëm në këtë drejtim. Me këtë nuk dua të them që babai ose nëna të hidhen në anën e kundërt, duke u treguar dorëlëshuar ndaj kërkesave të tepruara, ndaj tekave të fëmijëve ose të të rinjve. Për formimin e shëndoshë të tyre dhe në plotësimin e kërkesave të tyre të veprohet me takt, duke gjykuar me drejtësi, me logjikë, me urtësi dhe me kontroll.

Ka edhe raste qëndrimesh nga ana e disa prindërve që duhet të na shqetësojnë. Megjithëse mund të jenë me qëndrim të mirë politik dhe nga shumë anë të tjera, disa prej tyre, po të guxosh t'u thuash një fjalë ose po t'u bësh ndonjë vërejtje ose qortim për sjelljet jo të mira të fëmijëve, të presin me këmbët e para e të thonë: «Arrite dhe ti të marrësh nëpër gojë dhe të na qortosh fëmijën?!». Bile në ndonjë rast, në vend që të falënderojnë për ndihmën që u jep, mund të presësh edhe fyterje. Ky nuk është qëndrim i drejtë. Në kohën tonë mësuesi u fliste, bile ndonjëherë, u tërhoiqte veshin ose edhe u binte me shufër fëmijëve. Në sot, me të drejtë, nuk lejojmë qëndrime të tilla antipedagogjike ndaj fëmijëve, por ama kur shikojmë që një fëmijë vepron keq, duke thyer, fjala vjen, llambën elektrike të shkallës së pallatit ku banojmë ose duke bërë ndonjë faj tjetër në lagje, në rrugë e në shkollë, nuk duhet të

heshtim. Prindërit në këto raste duhet të jenë vetë shumë më kërkues ndaj fëmijëve të tyre, por dhe t'u jenë mirënlohës atyre që i sinjalizojnë me kohë për dobësitë e të vegjelje, me qëllim që të merren masa me kohë dhe këta të edukohen mirë.

Eshtë e tepërt të përmendim pastaj sjelljet e padjenja të disa prindërve të pandërgjegjshëm, të cilët, në vend që t'i edukojnë fëmijët, i shiyjnë të kryejnë krime. Sigurisht këta janë shumë-shumë pak, prandaj nuk po flas gjatë për ta, por ndaj tyre duhet të mbahet qëndrim i ashpër, duke i goditur me gjithë rreptësinë e ligjeve tona të diktaturës së proletariatit.

Me gjithë moralin e shëndoshë proletar që ekziston, përsëri ka njerëz, sidomos në qytetet e mëdha, që e mërzitin shoqërinë me veprimet shoqërisht të rrezikshme që kryejnë.

Puna e vazhdueshme për edukimin e gjithanshëm moralo-politik të rinisë, lufta parandaluese kundër veprimtarisë së elementit keqbërës, si dhe masat shtrënguese me qëllim edukimi, që zbatojnë rast pas rasti organet e drejtësisë, do të ndikojnë patjetër në edukimin e rinisë dhe në tërheqjen e të rinjve nga rruga e keqe. Për të rintjtë, duke përfshirë edhe ata që shkelin ligjet e shtetit dhe normat e moralit proletar dhe që janë relativisht të paktë në numër, po të shpreheshim në mënyrë figurative, mund të thoshim se janë si një lastar i njomë, të cilin, edhe kur ka marrë një drejtim të shtrembër, mund ta drejtojmë si të duam, ta ngremë në këmbë dhe, me kujdes, disa herë me një ndihmë të posaçme, ta bëjmë një fidan të fortë e të drejtë si tërë fidanët e tjerë.

Në vartësi të rrezikshmërisë së krimeve nga personat që i kryejnë, të llojeve dhe të përhapjes së krimeve në një kohë të caktuar, duhet të orientohet edhe politika e dënimive. Kështu, për shembull, të tëra llojet e vjedhjeve duhet t'i dënojmë rreptë dhe pa mëshirë, por edhe në këtë drejtim duhen bërë diferencimet e nevojshme, gjë që duhet ta kenë parasysh gjykatat në gjykimin e çështjeve penale, organet e tjera të pushtetit, Partia dhe opinioni shoqëror. Në bazë të cilësimit juridik të veprës, të shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të vjedhjes dhe të vjedhësit etj. të caktohet drejt lloji dhe masa e dënimit, të zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Penal, pa bërë lëshime që burojnë nga sentimentalizmi mikroborgjez.

Edhe ne, në Presidiumin e Kuvendit Popullor, kur ushtrojmë të drejtën e faljes, të jemi shumë më të rezervuar ndaj vjedhësve që dëmtojnë rëndë interesat e popullit, të Partisë dhe të ndërtimit të socializmit. Edhe vuajtja e plotë e dënimit nga kjo kategori njerëzish të mos shikohet thjesht si zbatim i masës së dënimit të dhënë nga gjykata, por në një prizëm të thellë politik. Këta njerëz duhet t'ia paguajnë popullit deri në një dëmet që i kanë shkaktuar.

Ka disa persona që kanë kryer shumë herë krimin e vjedhjes në dëm të pasurisë socialiste ose të qytetarëve. Këta, sa herë që gjykohen, si dhe gjatë kohës që vuajnë dënimin, paraqiten si të penduar, premtojnë se do të heqin dorë nga rruga e pandershme ku ishin futur etj., por, sa plotësojnë dënimin, vazhdojnë përsëri të vjedhin vetë ose shtyjnë të tjerët. Prandaj unë mendoj që sidomos kundër tyre gjykatat të jenë shumë të rre-

pta në caktimin e masës së dënimit, kurse Presidiumi i Kuvendit Popullor të jetë dorështrënguar në pranimin e kërkesave që i drejtohen për falje.

Vendi ynë zhvillohet me një hov të madh e të parë revolucionar. Në këtë vrull shquhen shumë iniciativa e lëvizje jashtëzakonisht pozitive që kanë shpërthyer kudo nga punëtorët, fshatarët dhe inteligjencia, jonë popullore. Këto lëvizje revolucionare e çojnë përpëra para punën tonë në shumë drejtime. Por, krahas përparimit në drejtimet që përmenda, bie në sy dhe bën përshtypje jo të mirë indiferentizmi i disa njerëzve ndaj sjelljeve të këqija në shoqëri. Kjo është antiteza e qëndrimit revolucionar, është shprehje e presionit të ideologjisë borgjeze dhe revisioniste që u bëhet njërzve të shoqërisë sonë.

Si mund të quhen revolucionarë ata që qëndrojnë në heshtje kur shikojnë disa rrugaçë që fyejnë dhe shtyjnë fatorinon e autobusit urban, e cila, në përbushje e sipër të detyrës së saj, kërkon t'i paguhet vlefta e biljetës së udhëtimit? Si mund të durohet qëndrimi i tridhjetë të tjerëve në autobus që e shikojnë ngjarjen, pa e bërë qejfin qeder? Njerëzit që udhëtojnë janë punëtorët ose nëpunësit tanë. Në mbledhjen e organizatës profesionale, të kolektivit punonjës ose të organizatës-bazë të Partisë, ku bëjnë pjesë, ata diskutojnë dhe i kritikojnë shokët e tyre për të metat në punë, për qëndrimin jokorrekt në familje etj., ndërsa në autobus, megjithëse e shikojnë qëndrimin e padenjë të disa të rinjve të pasjellshëm që nuk përfillin rregullat elementare të sjelljes, qëndrojnë indiferentë! Përse të mos ngrihet në raste të tilla cilido që udhëton e t'i thotë:

shoferit: «Të lutemi ndaloje pak autobusin!» dhe pastaj, së bashku me të tjerët ta marrë për krahu rrugaçin e ta detyrojë të zgresë poshtë. A duhet të druhen njerëzit nga disa persona me karakter të dobët që janë të prirë të shkaktojnë situata të papëlqyera? Ata që qëndrojnë indiferentë ndaj veprave të keqbërësve, tregohen frikacakë. Indiferentizmi, veç të tjerave, përmban në vete edhe ndjenjën e frikës.

Ne themi që keqbërësve t'u krijojmë kudo një ambient të padurueshmëm, është e drejtë të presim që ata t'i kapin vetëm organet e Policisë Popullore? Sigurisht, këto organe do ta kryejnë detyrën e tyre, ashtu sikurse po e kryejnë, por njerëzit tanë edukohen me frymën e Partisë, e cila na mëson të gjithë që t'i godasim kudo keqbërësit, sepse vetëm kështu do të mbrohen si duhet ligjet e shtetit, nderi, dinjiteti e paprekshmëria e qytetarëve.

Siq jemi në dijeni në rrëthim e Dibrës nga organet kompetente ishin bërë disa shkelje në kundërshtim me një vendim që kishin marrë. Njerëzit nuk i shihnin të drejta këto masa arbitrale, prandaj ishin ankuar, por ankimet e tyre nuk qenë vlerësuar. Ligjet shkeleshin në mënyrë flagrante, ndërsa drejtuesit e Partisë e të pushtetit në rrëth, që i dinin këto gjëra, qëndronin indiferentë ndaj shkeljeve! Këto qëndrime indiferente janë të palejueshme dhe ndikojnë negativisht. Por Partia dhe shteti janë në gjendje t'u vënë fre cenimeve të ligjshmërisë sociale, kryesisht nëpërmjet punës politike dhe ideologjike. Për të ngritur nivelin ideopolitik dhe profesional të komunistëve, të kuadrove dhe të tërë punonjësve duhet bërë një punë e zellshme edhe për mbro-

jtjen e ligjshmërisë sonë socialiste, që shpreh interesat e klasës punëtore dhe të masave të tjera punonjësc dhe mbron nga çdo cenim rendin tonë shoqëror dhe shtetëror, si dhe të drejtat e ligjshme të shtetasve.

Disa çështje me rëndësi parimore është praktike që dolën nga kjo mbledhje duhet t'i shikojmë më me hollësi, bile ato mund të analizohen edhe në Këshillin e Ministrave e në Komitetin Qendror, pasi të studiohen më gjërë, duke i parë të lidhura me problemet që dalin nga situata e krijuar, siç ishte rasti i Dibrës.

Nuk është i drejtë qëndrimi i heshtur që mbahet gjoja për ruajtjen e kuadrove edhe atëherë kur shikohet që disa prej tyre i shkelin vetë ligjet ose qëndrojnë indiferentë para shkeljeve që bëjnë të tjerët. Po pse kur bën gabim një punonjës i thjeshtë u dashka dënuar, kurse kuadri, që ka një nivel ideopolitik më të ngritur dhe duhet të gabojë më pak, nuk u dënoka? Kur ndonjë kuadër, për shkak të gabimeve që bën, meriton të ulet nga përgjegjësia që ka, le të shkarkohet pa hezitim, pse nga ky qëndrim s'kemi asnje humbje, përkundrazi dobi. Kur kuadri ka bërë faje të tillë që përbëjnë krim në detyrë, le të dërgohet në gjyq dhe të dënohet në bazë të ligjit si gjithë punonjësit e tjerë, sepse të gjithë shtetasit përgjigjen njëloj përparrë ligjit. Kjo gjë është thënë shpeshherë nga Partia dhe është parashikuar shprehimisht në legjispcionin tonë.

Në qoftë se kërkohet nga të tjerët që të kenë respekt për komunistët dhe kuadrot, duhet që edhe këta të fundit të kenë shumë respekt për të tjerët. Në qoftë se kërkohet respektimi i ndërgjegjshëm i ligjeve nga masat e gjera punonjëse, këtë duhet ta bëjnë pa asnje

lëshim, në radhë të parë, komunistët dhe kuadrot. Në këto drejtime kërkesat e Partisë dhe të shtetit duhet të jenë të forta.

*Botuar për herë të parë me
pak shkurt time në librin:
Enver Hoxha, «Për rininë
(Përmbledhje veprash)»,
vëll. II, f. 315*

*Botohet i plotë sipas tekstit
të nxjerrë nga procesverbali i
mbledhjes së Presidiumit të
Kuvendit Popullor, që gjendet
në AQP*

CILIDO QË BËN PADREJTËSI ZBULOHET, DHE VETË POPULLI E DEMASKON

*Nga biseda me komunistin dhe veteranin
e Luftës Nacionallirimitare, shokun
Agush Gjergjevica*

1 qershor 1972

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë se erdhe, si je me shëndet, xha Agush?

SHOKU AGUSH GJERGJEVICA: Mirë jam. Posi je Ti, o dritë e Partisë? Të rrojnë Partia dhe Ju! Më ka përtërirë Partia në moshë, djalë më ka bërë fare dhe me gjithë të mirat!

SHOKU ENVER HOXHA: Sa më gëzove, xha Agush, me ardhjen tënde!

SHOKU AGUSH GJERGJEVICA: Tani që të pashtë edhe një herë, do të më shtohet edhe 10 vjet të tjerrë ymri.

SHOKU ENVER HOXHA: Dje më njoftuan shokët e aparatit të Komitetit Qendror se ka ardhur Agush Gjergjevica dhe kërkon të takohet. Të vijë menjëherë xha Agushi, u thashë shokëve, se do të takohem nesër me të.

Po si ke qenë me shëndet? Nga familja si i ke? Kë ke në shtëpi?

SHOKU AGUSH GJERGJEVICA: Kam një djalë në Korçë, nëpunës, djali tjetër punon në Tiranë.

Të më falni, shoku Enver, që ju shqetësoj me ardhjen time, por një ngjarje e hidhur më detyroi ta bëj një gjë të tillë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po pse, çfarë të ka ngjarrë, more xha Agush?

SHOKU AGUSH GJERGJEVICA: Nuk ka shumë kohë që m'u dogj shtëpia në Korçë. Tri herë në jetën time më üshtë djegur shtëpia. Herën e parë m'u dogj nga greku, herën e dytë nga fashistët, ashtu siç iu dogj dhe shumë të tjerëve si unë, po nga bisha fashiste gjëra të tillë pritnim, pse kudo që shkeli këmba e pushtuesve, vau, dogji, shkretoi çdo gjë që i dilte përpara. Tani së fundi shtëpia m'u dogj përsëri.

SHOKU ENVER HOXHA: Po si ndodhi kjo? Ku e ke shtëpinë në Korçë ti, xha Agush?

SHOKU AGUSH GJERGJEVICA: E kam mbi klubin e oficerëve. Ditën që u dogj shtëpia ime nuk u ndodha, kisha shkuar për gjah, se kam merak pas tij. Ishte ora 9 e mëngjesit, kur një person shkoi për të fshirë oxhakun e komshisë, pastaj megjithëse në shtëpi ishte nusja e djalit, ai hyri pa leje. Kur e pyeti nusja për se kishte ardhur, ai i tha për të fshirë oxhakun. Mirëpo jo vetëm që atë nuk e pastroi mirë, por i hodhi dhe gaz, kështu oxhaku mori flakë dhe m'u dogj tërç shtëpia...

Kur u ktheva pasdreke në shtëpi nga gjahu, ajo akoma vazhdonte të digjej. Më erdhi shumë keq, megjithatë e mbajta veten, zemrën e bëra gur, siç na mëson Partia, qëndrova si komunist.

Por ajo që më shqetësoi, bile më zemërci më shumë, është fakti se, pasi m'u dogj shtëpia, Mihallaq Ziqishti¹, të nesërmen, në vend që të më pyesë, të paktën për fatkeqësinë që më ndodhi, shkoi në dasmë te një farefis i atij që më dogji shtëpinë. Për të shkuar në dasmë ai kishte kohë, kurse për mua nuk e gjeti kohën.

Më vonë hapa gjyq për punën e djegies së shtëpisë, por në gjyq thirrën vetëm nusen e djalit nga ana jonë, kurse mua nuk më njoftuan fare, nuk thirrën, gjithashu, as atë që i vuri zjarrin shtëpisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Si, nuk ishte ai gjatë zhvillimit të gjyqit?

SHOKU AGUSH GJERGJEVICA: Jo, shkaktari nuk ishte. Shkaktarin që dogji shtëpinë e quajnë L. Sh., njeri me përbërje jo të mirë politike, një ish-ballist. Unë kërkova ç'është kjo që bëhet. Më vonë u paraqit edhe shkaktari... Meqenëse nuk u binda për drejtësinë e gjykatës së rrethit, u drejtova më lart. Pata rast të takohem, megjithëse në këmbë, me Kadri Hazbiun, i fola atij për këtë çështje, por më kot.

SHOKU ENVER HOXHA: Bërc shumë mirë që crdhe, xha Agush, se të kemi pasur dhë të kemi patriot e komunist.

Ke hyrë në shtëpinë e re tani?

SHOKU AGUSH GJERGJEVICA: Po, hyra. Mora borxh nga banka, e rregullova shtëpinë dhe tani dalingadalë do ta shlyej.

1. Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë. Më vonë u zbulua se ishte armik dhe si i tillë mori dënimin e merituar nga gjyqi i popullit.

Unë tërë jetën kam luftuar, kur erdhi greku, luftova që në fillim kundër Zogut, bile që në kohën e Ismail Qenalit. Kam qenë edhe me Avni Rustemin.

SHOKU ENVER HOXHA: Ja, ky, sekretari im¹, është nipi i Avni Rustemit.

Si mbahet Rizai²?

SHOKU AGUSH GJERGJEVICA: Këq është, po ai vajti 105 vjeç, çshtë 26 vjet më i madh se unë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ti je akoma i ri, xha Agush, derisa të vesh 110 vjeç, ke akoma shumë kohë përpara për të jetuar.

SHOKU AGUSH GJERGJEVICA: Ne, si popull kemi luftuar vazhdimisht edhe më përpara, shoku Enver, po ç'fituam? Asgjë. Partia i bëri të gjitha këto e ç'nuk ka bërë! Ja çfarë ka bërë Partia dhe Ju, të tëra të mirat keni bërë ju për popullin shqiptar.

SHOKU ENVER HOXHA: Me këto masa që po marrim këtë pesëvjeçar do të bëhen gjëra akoma më të mira.

SHOKU AGUSH GJERGJEVICA: Janë bërë plot dhe Partia jonë jo vetëm që ka nderuar Shqipërinë, por gjithë njerëzit përparimtarë të botës.

SHOKU ENVER HOXHA: Vazhdimisht po flasin shumë mirë njerëzit për Partinë tonë në vende të ndryshme të botës.

SHOKU AGUSH GJERGJEVICA: E kam kënduar të tërë fjalën tënde në Konferencën e Moskës më 1960, i ke goditur mirë e paq atje imperialistët dhe revisionistët.

1. Haxhi Krol.

2. Riza Kodheli.

SHOKU ENVER HOXHA: Janë mësimet e Partisë që na bënë t'i demaskojmë armiqjtë.

Mos u mërzit xha Agush, do t'i shikojmë çështjet që më the.

SHOKU AGUSH GJERGJEVICA: Vetëm puna e Partisë të vejë mbarë, se dhe hamall të më dërgojnë, do të vete edhe pse jam në këtë moshë.

SHOKU ENVER HOXHA: Jo, xha Agush, unë e kuptoj që ti i thua këto me qëllim që të mos ngjasin gjëra të këqija, të papëlqyera, tamam për këto për të cilat Partia flet vazhdimisht.

Tash po bëhen mjaft mbledhje e diskutime në popull dhe cilido që bën padrejtësi, zbulohet, vetë populli këta që sillen keq me të, që vjedhin, shajnë njerëzit, që nuk sillen mirë, i demaskon dhe i vë në vend. Kjo bëhet me qëllim që ose të ndreqen, ose të venë në vendin që u takon. Është e domosdoshme të bëhet kjo, xha Agush, se pastaj ngjasin gjëra të këqija, nga të voglat, thotë populli, vijnë të mëdhatë. Në qoftë se e lë njeriun të vjedhë, qoftë edhe një grosh, në fillim ai mësohet, pastaj vazhdon të vjedhë me qindra napolona. Po ta lësh të djegë një shtëpi, ai të djeg nesër gjithë qytetin. Po të bësh një gënjeshtë pa dashje, arrin pastaj të gënjesht vazhdimisht Partinë dhe popullin gjersa të zbulohesh.

Ja si ndodhi në Bashkimin Sovjetik. Pse u rrokullisën gjithë këto gjëra të këqija atje? Se nuk u kontrolluan njerëzit që vepronin keq, se nuk i thanë popullit të hapte sytë, të fliste pa frikë kundör atyre që shkelnin vijën e partisë. Populli i shikon të gjitha, prandaj kush nuk dëgjon popullin, ai bën gabimin më të madh.

SHOKU AGUSH GJERGJEVICA: Është e drejtë kjo dhe këtë e theksove fort në Kongres. Kështu, ai që shikon një gjë dhe nuk e vë në dukje, bëhet njeri i keq. Unë, për shembull, kur shikoj në Korçë një gjë jo të mirë dhe nuk e them, bëj gabim. Ligjet i ka bërë Partia, i ka bërë Enver Hoxha, nuk i kam bërë unë, prandaj duhet ta them atë që ndodh, pse kështu e ndihmoj Partinë, po të mos bëj këtë, kam bërë gabim.

SHOKU ENVER HOXHA: Do ta shikojmë çështjen tënde, prandaj mos u mërzit.

SHOKU AGUSH GJERGJEVICA: Të faleminderit shumë, unë nuk mërzitem. Të na rrosh sa malet. Mjafton një herë që të pashë me sy, se nuk më vjen keq edhe pse u dëmtova, bile edhe sikur në rrugë të mbetesha farc.

SHOKU ENVER HOXHA: Ç'thuas ashtu, nuk të lë Partia në rrugë ty.

SHOKU AGUSH GJERGJEVICA: Nuk ka vend tjetër përmua, se ku t'i qaj këto halle vec në Parti. Unë dëgjoj fjalët e Partisë, kështu u thashë shokëve në Korçë. Edhe nesër për Partinë unë njëlloj siç kam luftuar do të luftoj, në një llogore.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë u ke thënë, ashtu është, këto që thua janë fjalë partie.

SHOKU AGUSH GJERGJEVICA: Të kemi pasur në konsideratë, më thonë, po ku e kanë konsideratën?

Shoku Enver, nuk kam asnje gënjeshtër nga këto që të thashë, unë jam komunist, pastaj në familjen tonë gënjeshtër nuk e kanë pasur zakon as gjyshi, as babai, as unë nuk e kam zakon. Ne jemi pleq, kemi edhe

ca mbeturina dhe zakone jo të mira, po ama për të gënjyer, s'gënjejmë.

SHOKU ENVER HOXHA: Kemi zakone të mira, kemi edhe të këqija, ato që janë të mira duhet t'i mbajmë.

SHOKU AGUSH GJERGJEVICA: Materializmin dialektik e historik që më ke pyetur edhe një herë tjetër, unë e kam studiuar mirë dhe e di ç'është shteti socialist dhe ç'është shteti kapitalist.

Por të më falësh, se të pengova. Të të kemi me ymër e të na rrrosh sa malet!

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk më pengove, përkundrazi u kënaqa shumë që më erdhe.

SHOKU AGUSH GJERGJEVICA: Kam pasur shumë dëshirë të të takoja.

SHOKU ENVER HOXHA: Prandaj bëre shumë mirë që erdhe. Me këtë rast do të të jap edhe një libër (*shoku Enver i dhuron librin «Raporte e fjalime 1969-1970», duke i lënë në faqen e parë të brendshme këtë mbi-shkrim*: «Shokut të vjetër të Lustës Nacionalçlirimtare, komendantit veteran, me kujtimet e mia në të mira»).

SHOKU AGUSH GJERGJEVICA: Të saleminderit shumë! Të rrojë Partia! Edhe një herë të më falësh që të pengova, o dritë e Partisë! Të kesh shëndet e të na rrrosh sa malet për të mirën e popullit e të Partisë!

SHOKU ENVER HOXHA: Kur të vij ndonjëherë në Korçë, do të bisedojmë përsëri bashkë, do të diskutojmë përsëri.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP.

**TE DEMASKOJMË DHE TE KUNDERSHTOJMË
ME TE GJITHA FORCAT ALEANCËN
KUNDËRREVOLUCIONARE
SOVJETO-AMERIKANE**

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

4 qershor 1972

Bisedimet e Moskës janë përfundimi i një procesi të gjatë atrimi e bashkëpunimi sovjeto-amerikan, i lëshimeve të mëdha politike, ideologjike e ekonomike të revizionistëve sovjetikë, i shtrirjes së dorës dhe i përkrahjes së vijës revizioniste të restaurimit kapitalist nga imperialistët amerikanë. Marrëveshjet e përfunduara në kryeqytetin sovjetik janë, nga ana e tyre, rezultat i kapërcimit të mjaft rivaliteteve në çështje konkrete botërore që të dyja fuqitë i kanë bërë për hir të interesave të përbashkët imperialistë dhe në dobi të qëllimeve të tyre hegemoniste.

Gjatë vizitës së Niksonit në Moskë u vu re se gjithçka ishte e orkestruar që më parë dhe se atje u dha vetëm shfaqja. Kjo ishte një tjetër dëshmi se midis dy superfuqive ekziston jo vetëm rivalitet e bashkëpunim, por edhe një unitet interesash imperialistë, sigurimi i të cilëve kërkon veprim të përbashkët.

Sigurisht, marrëveshjet e shpallura në kryeqyte-

tin sovjetik nuk pasqyrojnë gjithë të vërtetën dhe bilanci i dhjetëra orë bisedimeve në Kremlin është shumë më i madh nga sa iu bë e ditur publikut. Marrëdhëniet sovjeto-amerikane tani u ngritën në një shkallë shumë më të lartë, për herë të parë ato u legalizuan botërisht dhe u vunë mbi një bazë të gjerë juridike. «Parimet bazë të marrëdhënieve reciproke midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike», që u përfshinë në një dokument të veçantë dhe që u paraqitën në formën e një traktati, përbëjnë një platformë politike e ushtarake të përcaktuar qartë, që ka për qëllim t'i vërë të gjitha marrëdhëniet e sotme ndërkombëtare nën kontrollin imperialist të të dyja superfuqive, për ta vendosur gjithë botën nën urdhrat dhe diktatin e tyre. Ato shprehin qëllimin dhe vullnetin e të dyja superfuqive për të vënë mbi çdo të drejtë e mbi çdo normë morale ndërkombëtare interesat e ngushtë imperialistë dhe egoizmin e fuqisë së madhe.

Kryesore në vizitën e presidentit Nikson dhe në bisedimet e tij me krerët e Kremlinit është se ato spastruan rrugën për marrëveshje të reja imperialiste, më kërcënuese e më të rrezikshme për paqen e sigurinë e popujve.

Me «Parimet bazë të marrëdhënieve...» krerët revisionistë të Bashkimit Sovjetik, përveç të tjerave, bëjnë edhe një orvatje monstruoze për të na rehabilituar edhe imperializmin amerikan, për të na e paraqitur atë në dritën më paqësore, si mbrojtës të popujve dhe kundërshtar të agresioneve, që për lirinë e të tjerve sakrifikon veten. Kushdo që e lexon këtë dokument nuk

mund të mos pyesë: Ç'u bë ai imperializëm amerikan që në një mijë e një dokumente partie e shtetërore, fjalime, libra e artikuj të revisionistëve sovjetikë është quajtur «xhandar i reaksionit ndërkombëtar», «armik i proletariatit dhe i luftërave nacionalçlirimtare», «shtylla e sistemit kapitalist botëror» etj., etj.? Ç'u bë ai imperializëm amerikan që deri një ditë më parë se të vinte Niksoni në Moskë ishte agresor i popujve të Vietnamit, shtypte Afrikën dhe shfrytëzonte Evropën? Si pas fjalimeve që kërrot revisionistë mbajtën për të lavdëruar Niksonin dhe dokumenteve që nënshkruan me të, një imperializëm i tillë nuk ekziston më. Ky imperializëm tani qenka zbutur, bile qenka angazhuar me firmën e Niksonit të zbatojë pikë për pikë të gjitha parimet e bashkekzistencës paqësore, të frymëzojë dhe të mbrojë paqen, lirinë dhe pavarësinë e popujve.

Përhapja e të tillë opinioneve e iluzioneve ndaj imperializmit është një tradhti tjelër që revisionistët sovjetikë i bëjnë çështjes së proletariatit e të revolucionit. Për t'i sheshuar rrugën imperializmit, ata kërkojnë t'i bindin popujt se nuk ekziston më një imperializëm amerikan që po vret e po pret në Vietnam, se nuk ekziston më as imperializma të tjerë, as revanshizëm gjerman, as militarizëm japonez, as reaksiun indonezian, as fashizëm në Spanjë, as mbret Hysein e as regjim racist në Rodezi. Ata duan ta bëjnë botën të besojë në demagogjinë e hipokrizinë e Niksonit, që hiqet sikur tronditet kur mëson historinë e Tanjës së vogël, që vdiq nga bllokada naziste në Leningrad, ndërsa vetë sapo ka urdhëruar bllokadën e RD të Vietnamit, me qëllim që të vdesin të gjitha Tanjat e fëmijët e Vietnamit. «S'ka im-

perializëm, prandaj s'duhet të ketë as luftë klasore, nuk duhet të ketë as përpjekje për të bërë revolucion, për të fituar lirimë e pavarësinë» — ja ç'duan të thonë revisionistët sovjetikë, këta sabotues dhe zjarrfikës të zellshëm të revolucionit dhe të luftës çlirimtare të popujve.

Por demagogjia, cinizmi dhe hipokrizia e revisionistëve sovjetikë dhe e miqve të tyre amerikanë, sado me bollëk e shpesh të përdoren, nuk e kanë atë fuqi magjike për të mashtruar gjithë botën, siç mund të mendojnë në Moskë e në Washington.

Dokumentin «Parimet bazë të marrëdhënieve...», ashtu si edhe dokumentet e tjera që u nënshkruan në Moskë, imperialistët amerikanë dha revisionistët sovjetikë e kanë veshur me një frazeologji që të duket si i frysmezuar nga parimet e njoitura të bashkekzistencës paqësore dhe të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Por në qoftë se i hiqet kjo lëvozhgë demagogjike, del se ai nuk është tjetër veçse një kod i rregullave të egra imperialiste, i sigurimeve dhe i zotimeve reciproke për të ruajtur zonat e influencës dhe për të sunduar botën.

Ata përmendin aty shekullin e atomit dhe, si imprerativ të tij, bashkekzistencën paqësore. Ky është një avaz i njojur dhe nuk është vështirë të kuptohet se në ç'raport ata duan t'i vënë atomin dhe pagën. Nën kërcënimin e shantazhit atomik, imperialistët amerikanë dhe revisionistët sovjetikë duan t'i imponojnë botës konceptin e një nënshtimi të pakondicionuar e fatalist ndaj dy superfuqive. Ata kërkojnë që, për hir të ruajtjes së «bashkekzistencës paqësore» midis dy superfuqive, popujt të bëjnë fli në altarin e saj, pjesërisht ose tërësisht, interesat e tyre më të lartë kombëtarë, liri-

në e pavarësinë, të drejtën për të gjykuar e për të vepruar sipas vullnetit të vet në jetën ndërkombe të.

Niksoni e shprehu fare pa doreza këtë koncept të diktaturës botërore imperialisto-revisioniste kur, në fjalimin e tij në televizionin e Moskës, deklaroi se «si fuqi të mëdha ne mund dhe duhet të përdorim ndikimin tonë për të mos lejuar të futemi në luftë pa e pasur ndër mend atë me anë të konflikteve midis vendeve më të vogla». Presidenti amerikan e di mirë se vendet e vogla, edhe sikur të duan, nuk kanë asnjë mundësi praktike t'i tërheqin në një luftë shtetet e mëdha imperialiste e të shkaktojnë një përlleshje botërore. Përralla e këtij lloj «rreziku» është tanimë tepër e vjetër dhe e demoduar. Atë e nxorën Çembërleni e Daladiei kur, për të justifikuar Munihun, akuzonin Çekoslovakinë se refuzimi i saj për të pranuar diktatin e Hitlerit rrezikonte paqen botërore. Por, si Niksoni, ashtu edhe krerët sovjetikë, që folën mjaft për «përgjegjësitë e veçanta të vendeve të mëdha», me anë të këtij lloj arsyetimi duan të tregojnë se Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovjetik, në çdo rast dhe mbi të gjitha, do të vënë kurdoherë interesat e përbashkët imperialistë dhe se asnjë konsideratë tjetër nuk do t'i largojë nga rruga që po ecin. Paqja, për të cilën krerët amerikanë e sovjetikë bëjnë fjalë në dokumentet që nënshkruan në Moskë, është një paqe e kondicionuar nga marrëdhëni e Shteteve të Bashkuara të Amerikës me Bashkimin Sovjetik dhe nga marrëveshjet sovjeto-amerikane.

Krerët sovjetikë dhe amerikanë, në fjalimet e në dokumentet e Moskës, proklamuan se ata i përbahen e do t'i përbahen rreptësisht parimit të mosndërhyrjes

në punët e brendshme të vendeve të tjera, se ata do të bëjnë q'është e mundur që të mos shkaktohen konflikte dhe që të mos rritet tensioni ndërkontëtar. Sikur të mos njiheshin politika që ndjekin në praktikë të dyja fuqitë e mëdha dhe ngjarjet e përditshme, ndokush mund edhe të besonte. Por kur imperialisto-revisionistët flasin për mosndërhyrje, ata nuk kanë aspak ndër mend veprimtarinë dhe praktikën e tyre shoviniste e hegjemoniste.

Për ata, sigurisht, agresioni në Vietnam nuk është ndërhyrje, ashtu si nuk është e tillë as pushtimi i Çekoslovakisë. Imperialistët organizojnë me dhjetëra grushtë shteti dhe për ta kjo qenka e lejueshme, ashtu siç qenka e natyrshme të mbajnë në këmbë me para e me armë regjimet reaksionare në vende të ndryshme. Imperialistët amerikanë dhe revisionistët sovjetikë, që janë neokolonialistët më të mëdhenj, grabitin pasuritë dhe shfrytëzojnë punonjësit e vendeve të tjera, por atyre nuk u pëlqen që kjo të quhet ndërhyrje brutale në punët e brendshme të të tjerëve, shtypje e skullavërim i popujve.

Me «mosndërhyrje» në kontekstin e dokumenteve të Moskës duhet kuptuar zotimi reciprok për të njohur zonat përkatëse të influencës dhe për të mos ndërmarrë ndonjë aksion që mund të shkaktojë turbullirë. Ajo duhet kuptuar si njohje e së drejtës që secila palë mund të bëjë çfarë të dojë në zonën dhe me klientelën e vet.

Niksoni e karakterizoi shpesh gjendjen aktuale të marrëdhënieve sovjeto-amerikane si mbarimin e «epochës së ballafaqimeve dhe fillimin e epokës së bisedimeve». E përkthyer në gjuhën e zakonshme, ai do të thotë

se ka marrë fund ajo kohë kur Bashkimi Sovjetik komunist i luftonte dhe i kundërshtonte Shtetet e Bashkuara të Amerikës si fuqinë kryesore imperialiste botërore dhe kur Amerika antikomuniste luftonte dhe doante të shkatërronte shtetin e parë e të madh socialist. Tani që këto baza dhe motive janë zhdukur, ka filluar koha e bisedimeve, domethënë e pazarllëqeve për ta ndarë e për ta sunduar botën.

Perëndimi kapitalist dhe Lindja revizioniste janë këto ditë në kulmin e entuziazmit e të euforisë nga rezultatet e vizitës së presidentit të SHBA-së në Bashkimin Sovjetik. Gëzon borgjezia e madhe evropiane se tani edhe formalisht nuk do të ketë më një dorë të Moskës që do të vinte në rrezik regjimin e saj. Krerët sovjetikë dhe miqtë e tyre revizionistë në Evropë jo vetëm që nuk luftojnë më për ndonjë revolucion, por sot ata janë bërë garantët më të mirë të rendit borgjez, minuesit e lëvizjeve revolucionare të proletariatit, përhapësit dhe mbrojtësit e iluzioneve borgjeze. Gëzojnë sundimtarët e Bonit, të cilët shohin t'u rritet roli i tyre në Evropë dhe të ndriçohet horizonti i ëndrrave të tyre revanshiste. Gëzon Vatikani që po i hapen në Lindje jo vetëm dyert e kishave, por edhe zemrat e njerëzve për të futur ideologjinë e tij obskurantiste. Gëzohen të gjithë reaksionarët që Bashkimi Sovjetik, ish-qendra e madhe e revolucionit, u shndërrua në qendër të kundërrevolucionit, që ish-mbështetja e fuqishme e luftërave nacionalçlirimtare u bashkua me imperializmin amerikan për të shuar vatrat kryengritëse të popujve për lirinë dhe pavarësinë e tyre.

Propaganda borgjeze e revizioniste po i reklamon

bisedimet e Moskës si përpjekje të të dyja superfuqive që «synojnë të gjejnë rrugët për zgjidhjen e problemeve ndërkombe». Por fakt është se për të gjitha çështjet e diskutuara e që paraqesin një interes jetik për shumicën e popujve të të gjitha kontinenteve, Niksoni e Brezhnjevi kanë vendosur e kanë diskutuar prapa mureve të larta të Kremlinit, në fshehtësinë më të madhe, pa i pyetur fare popujt dhe pa marrë fare pëlqimin e tyre. Këtu nuk kemi të bëjmë me një çështje formale, por me një theksim të ri të tendencës së vjetër për t'i akaparuar të gjitha problemet botërore dhe për t'i zgjidhur pastaj sipas interesave të alcancës sovjeto-amerikane.

Sado që të mundohen krerët sovjetikë e amerikanë për të bindur opinionin publik botëror se marrëveshjet e përfunduara nuk prekin interesat e të tjerëve, ata nuk bindin njeri. Fjalët që thuhen në «komunikatën e përbashkët» janë zgjedhur me qëllim pikërisht për t'i mbuluar këto komplotë, për të mashtuar popujt dhe për të ulur vigjilencën e tyre. Niksoni nuk shkoi në Moskë për të dëgjuar nga Brezhnjevi se «pa la sovjetike është solidare me luftën e drejtë të popullit vietnamez». Ai shkoi atje që, me gjakun e popullit vietnamez, të bëjë pazarllëqe me krerët sovjetikë; ai shkoi atje që këta ta ndihmojnë të dalë nga qorrskaku indokinez.

Revisionistët sovjetikë e kanë tradhtuar prej kohësh luftën e popullit vietnamez. Për ta ajo ka qenë një farë biznesi, i cili i ka ndihmuar që, me pak shpenzime e me shumë reklamë, të mbajnë maskat antiim-

perialiste dhe të bëjnë tregti me amerikanët për ndarjen e ruajtjen e zonave të influencës.

Lufta në Indokinë, as dje, as sot, siç u provua edhe tani së fundi, me rastin e vendosjes së bllokadës detare kundër RD të Vietnamit, nuk ka ushtruar asnje inflencë në marrëdhëniet sovjeto-amerikane. Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë llogaritur dhe e llogaritin Moskën si një faktor që ushtron një presion të vazhdueshëm mbi Vietnamin dhe që bën një punë sabotuese pér ta detyruar atë të pranojë kushtet poshtëruese që kërkon të diktojë Uashingtoni. Pér rolin «moderues» të sovjetikëve në Vietnam nuk flitet pér herë të parë tani që shkoi Niksoni në Moskë. Ky rol përfaqëson një politikë të tërë në favor të imperialistëve amerikanë, që e inauguroi Hrushovi dhe që po e vazhdon Brezhnjevi.

Në takimin Brezhnev-Nikson është e sigurt se lidhur me Vietnamin janë marrë disa vendime që akoma mbahen sekrete. Me sa duket, ato kanë të bëjnë me pazarllëqe të mëdha, që nuk janë zgjidhur në të gjitha detajet dhe që pritet të zbatohen në praktikë pér t'u dhënë formën përfundimtare.

Sigurisht, këto janë llogari të armiqve të Vietnamit dhe të luftës së tij heroike. Pér sa i përket popullit vietnamez, ai ka ditur t'u bëjë ballë me trimëri si dhunës së agresorëve, ashtu edhe intrigave të miqve të rremë. Interesat e lartë të atdheut të tij, gjaku i derdhur dhe sakrificat mbinjerëzore e kanë mësuar atë që, me gjithë mjegullën e madhe që i krijojnë përreth imperialistët amerikanë dhe revizionislët sovjetikë, të

gjejë rrugën e drejtë dhe ta çojë luftën e tij çlirimtare drejt suksesesh gjithnjë e më të mëdha.

Përpara takimit të Moskës shumë nga ata që akoma venin me shpresë se fuqitë e mëdha mund t'i zgjidhin grindjet e sotme ndërkombëtare, mendonin se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik do të gjenin ndonjë rregullim për konfliktin arabo-izraelit.

Por realiteti tregoi se imperialistët amerikanë dhe revisionistët sovjetikë, që janë përgjegjës të drejtpërdrejtë për gjendjen e krijuar, nuk duan dhe nuk janë të interesuar as që konflikti të marrë fund, as që popujve arabë t'u kthehen të drejtat e grabitura. Përkundrazi, siç del edhe nga komunikata e Moskës, të dyja palët kërkojnë ta shfrytëzojnë tragjedinë e arabëve për të ruajtur e për të zgjeruar pozitat strategjike që kanë zënë në këtë sektor.

Eshtë e vërtetë se njëfarë rivaliteti sovjeto-amerikan në Lindjen e Mesme ekziston, por ai edhe fryhet qëllimi i nga të dyja palët, për të justifikuar praninë e tyre në këtë zonë dhe për t'u bërë arbitra të gjendjes. Prandaj konflikti në Lindjen e Mesme nuk është një konflikt vetëm midis arabëve e izraelitëve, por edhe midis arabëve dhe dy superfuqive. Pa u dëbuar këto nga Lindja e Mesme, çështja arabe nuk mund të zgjidhet, liria dhe pavarësia do të jenë vazhdimisht të kercënura dhe në rrezik.

Konservimi i statukuosë, që Niksoni e Brezhnevë kërkojnë ta sanksionojnë, është një goditje tjetër që dy fuqitë imperialiste u japin popujve arabë dhe luftës së tyre të drejtë. Por këta me siguri do të dinë t'i hedhin

poshtë iluzionet rreth rezolutës së vitit 1967 të Këshillit të Sigurimit dhe misionit të Gunar Jaringut që Moska e Uashingtoni kërkojnë t'u imponojnë dhe, siç theksonte me të drejtë gazeta egjiptiane «Al Akbar» lidhur me bisedimet sovjeto-amerikane, «arabët duhet të mbështeten në veten e tyre, në unitetin dhe në forcat e tyre».

Në komunikatën e përbashkët thuhen mjafë fjalë edhe për Evropën dhe problemet e saj. Pas lëshimeve të mëdha që bëri Bashkimi Sovjetik në favor të Bonit, që u konkretizuan në marrëveshjen mbi Berlinin e në «traktatet e Lindjes», Shtetet e Bashkuara të Amerikës tanë e dhanë vizën për thirrjen e konferencës mbi të ashtuquajturin sigurim evropian, aq të dëshiruar e të shumëpritur nga revizionistët sovjetikë.

Me parulla demagogjike, të ëmbla në dukje, por helm në të vërtctë, si «sigurim i Evropës», «garantim i kufijve», «nxitje e bashkëpunimit ekonomik», «zgjerimi i shkëmbimeve kulturore, shkencore, teknologjike» etj., ata duan të krijojnë një ndjenjë detyrimi dhe përuljeje të popujve të Evropës, një nënshtrim të përjetshëm ndaj dy «bamirësve të mëdhenj».

Me anë të këtij «sigurimi», të dyja superfuqitë kërkoijnë të sigurojnë reciprokisht zonat e tyre të influencës, të sigurojnë një ndikim të përhershëm në punët e Evropës dhe të bëhen arbitra të problemeve të saj. Ato kërkoijnë ta mbajnë Evropën të nënshtuar ekonomikisht e politikisht, që ajo të rrojë në hijen dhe në mëshirën e dy të mëdhenjve të fuqishëm. «Qetësia» që ata pretendojnë se do të krijojnë këtu nuk është qetësia e Evropës, por qetësimi i krahëve të tyre për t'u për-

qendruar në Lindje, dhe kryesisht kundër Kinës, qilrimi i një pjese të konsiderueshme të mjeteve ushtarakë e financiare për t'i përdorur kundër forcave revolucionare e çlirimtare në rajone të tjera të botës.

Vizita e presidentit të SHBA-së në Bashkimin Sovjetik u mbyll me nënshkrimin e Traktatit Sovjeto-Amerikan mbi kufizimin e armëve strategjike. Rreth kësaj marrëveshjeje janë drejtuar tanë të gjithë projektorët e propagandës imperialiste e revisioniste. «Kjo marrëveshje tregon se q'mund të bëhet në të ardhmen», thotë Niksoni. «Kjo është një sukses i madh në rrugën e frenimit të garës së armatimeve», i përgjigjet Kosigini.

Imperialistët e revisionistët ka kohë që, me qëllim, i kanë mistifikuar armët bërthamore, po ashtu siç e kanë fryrë edhe mitin e çarmatimit. Tani ata duan t'i mbushin mendjen botës se marrëveshja e Moskës rreth armëve strategjike është një sukses i madh e i pa-shenibullt në fushën e çarmatimit, një çlirim nga barra e rëndë e frikës së lustës atomike, një frenim i garës së armatimeve, tendencë e uljes së tensionit etj., etj.

Në realitet, e gjithë kjo zhurmë është një blof që ka për qëllim të qetësojë opinionin publik e të mashtrojë popujt, të krijojë përshtypjen se superfuqitë po çarmatosen dhe të largojë vëmendjen e popujve nga politika agresive dhe e forcës së superfuqive, ta bëjë botën të mos shikojë planet e errëta që ato përgatitin kundër lirisë e pavarësisë së popujve.

Duhet thënë që në fillim se marrëveshja e Moskës nuk shënon as frenim të garës së armatimeve, as kufizim dhe as ndalim të armëve atomike ose të armëve të

tjera. E vjetmja gjë që kanë bërë dy superfuqitë është marrëveshja për të mos dalë asnjëra përpara e për të mos mbetur asnjëra pas në garën e armatimeve. Ato vunë tani rregull për t'i harxhuar më mirë forcat e imjetet në këtë vrapim dhe për të rritur efikasitetin e tyre. Fakt është se dy vendet janë të lira të bëjnë perfekcionimt dhe ndryshimt cilësore në sistemin e armëve të tyre strategjike, gjë që mund ta rritë shumë më tepër fuqinë nga ç'mund të ishte një shtim i thjeshtë numerik.

Konventa mbi armët ofensive nuk përmban asnjë kufizim për sa u përket skuadriljeve të bombardierëve strategjikë të të dy vendave, bombave bërthamore të quajtura «orbitale» dhe numrit të mbushjeve bërthamore. Mosaktimi i një niveli për mbushjet bërthamore e la, pra, të paprekur problemin e raketave me shumë mbushje dhe, si pasojë, çdo vend është i lirë ta shtojë numrin e tyre në çdo raketë. Raketa me rreze të mësme veprimi mbeten, gjithashtu, jashtë kufizimeve.

Marrëveshja e Moskës mbi armët strategjike fikson ekuilibrin ushtarash midis dy superfuqive, por në të njëjtën kohë ajo tregon se të dyja superfuqitë kanë caktuar edhe distancën që ato bashkërisht do të mbajnë nga vendet e tjera. Në këtë qëndron edhe rëndësia e kësaj marrëveshjeje, që këtë mund e do të lindin edhe pasojat e saj të rrezikshme. Mbajtja e kësaj distancë i detyron të dyja fuqitë të caktojnë edhe një vijë të përbashkët politike e ekonomike ndaj të tretëve, të një kodi të përbashkët sjelljesh dhe të një rregulloreje të qartë ndalimesh e kusizimesh. Ruajtja e epërm

sisë në armatimet qysh tani i ka çuar të dyja superfuitë, dhe në të ardhmen do t'i çojë edhe më tej, në krijimin e një monopolit përbashkët tekniko-shkençor, në një luftë të përbashkët për dobësimin kulturor e arsimor të vendeve të tjera.

Luftha e përbashkët për ruajtjen e monopolit të armëve moderne, që u nxit edhe më shumë me marrëveshjen e Moskës, e bën të pashmangshme edhe luttën për mbajtjen e përbashkët të kontrollit mbi gjithë aktivitetin e brendshëm e të jashtëm të vendeve të tjera. Ajo e bën të domosdoshëm bashkimin e pushteteve ushtarake amerikane e sovjetike dhe fillimin e përpjekjeve për vendosjen e një kontrolli të armatosur të dy të mëdhenjve mbi tërë botën, vendosjen e një regjimi të përbashkët ndërkombëtar për ruajtjen e ekuilibrit të tyre politik, ekonomik e ushtarak dhe të drejtimit të përbashkët të çështjeve botërore.

Midis marrëveshjeve të shumta që krerët amerikanë e sovjetikë nënshkruan gjatë qëndrimit të presidentit të SHBA-së në Bashkinin Sovjetik, ishte edhe ajo që u quajt marrëveshje «Mbi bashkëpunimin në studimin dhe në shfrytëzimin e hapësirës kozmike për qëllime paqësore». Ajo kaloi disi pa shumë zhurmë, por vëzhguesit nuk mbetën pa vënë re se ajo kishte të bënte më shumë me pushtimin e tokës sesa të qiejve. Kjo marrëveshje, ashtu si dhe ajo mbi shkëmbimet reciproke në fushën e shkencës, teknologjisë, arsimit e kulturës, éshtë shprehje e formulimit tani të një vije të përbashkët për vendosjen e një monopolit teknologjik jo vetëm në fushën e armëve, por edhe në drejtimet kryesore të teknikës e të shkencës moderne,

për vendosjen në botë të një kolonializmi teknologjik sovjeto-amerikan.

Qëllimi final i të gjitha këtyre marrëveshjeve, të hapëta dhe të fshehta, është ndarja e zonave të influencës, akaparimi i tregjeve të vendeve të mëdha e të vogla. Ato kanë për qëllim të shtojnë pasuritë dhe fitimet e tyre, të grabitin dhe të shfrytëzojnë popujt.

Kjo strategji e përbashkët sovjeto-amerikane do të godasë në radhë të parë popujt dhe vendet e varira dhe të paarmatosura, që kanë qenë edhe më parë gjahu i neokolonialistëve. Por këtij rreziku nuk do t'i shpëtojnë as vendet e zhvilluara, aleate të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Sovjetik. Në këtë aspekt do parë edhe pakësimi i ushtrive të vendeve të Evropës, që amerikano-sovjetikët kërkojnë ta futin brenda «sigurimit evropian» dhe që ka për qëllim t'u heqë shteteve evropiane mundësinë dhe forcën e vetëmbrojtjes. Në këtë mënyrë, të dyja superfuqitë mendojnë se do të kenë partnerë të dobët, të cilëve mund t'u imponojnë më lehtë ligjet e veta.

Aleanca sovjeto-amerikane, e përforcuar me traktatet e reja, do t'u diktojë këtyre vendeve kushtet e veta, sepse potenciali ekonomik i të dyja superfuqive, i mbështetur në potencialin ushtarak, do t'ë shfryjë medoemos mbi të tjérët. Këtu qëndron edhe rreziku kryesor i këtyre marrëveshjeve. Kjo perspektivë shpjegon edhe euforinë e tanishme të Moskës e të Uashingtonit për marrëveshjet e arritura.

Në takimin sovjeto-amerikan të Moskës u hodhën bazat për një bashkëpunim të ngushtë ekonomik dhe për shkëmbime tregtare që do të arrijnë deri në 5 mi-

liardë dollarë në vit e më shumë. Është parashikuar që kapitalet amerikane të vërshojnë në Bashkimin Sovjetik dhe lënda e parë sovjetike në sasi kolosale të kalojë oqeanin.

Por nuk është kjo themelorja. Niksoni me Brezhnjevin krijuan një komision të përbashkët ekonomik sovjeto-amerikan. Ky nuk do të merret me përsundimin e një akordi të zakonshëm ekonomik dhe të një marrëveshjeje të thjeshtë tregtare. Ky komision i lartë u krijua për të diskutuar si, ku e në ç'masë do të shfryjë potenciali i përbashkët i këtyre dy superfuqive, në ç'zona do të ndërhyjë kapitali amerikan e ku kapitali sovjetik, si do t'i përballojnë kundërshtimet dhe konkurrencën e aleatëve të tyre, që do ta ndiejnë veten të kërcënuar. Ky, mendojmë ne, është problemi më i koklavitur dhe më i rrezikshëm për imperializmin amerikan dhe socialimperializmin sovjetik, pasi, përvëç kontradiktave të pashimangshme që do të lindin midis tyre, si midis dy grabitqarëve, në zbatimin e strategjisë së tyre globale, të marrëveshjeve të hapëta dhe sekrete, ato do të hasin në kundërshtimin e të gjithë popujve e, bile, edhe të aleatëve të tyre.

Të dyja superfuqitë, të cilat kërkojnë të bëjnë shinun e diellin dhe që janë në marrëveshje për çdo gjë, bëhen pak merak për interesat e të tjerëve. Por a do të pranojnë shtetet dhe bota që ato të luajnë me fatet e tyre? Ne parashikojmë se jo. Euforia e Moskës dhe e Uashingtonit nuk do të zgjatë shumë. Kontradiktat do të acarohen. Popujt nuk mund të pranojnë diktatin politik dhe shfrytëzimin ekonomik sovjeto-amerikan. Ata do të revoltohen kundër dy superfuqive, si dhe ku-

ndër atyre klikave sunduese që nuk reagojnë përmbrojtjen e interesave kombëtarë, por shesin pasurinë, nderin dhe lirinë e vendit të tyre. Por jo vetëm popujt; as qeveritë e shumë vendeve, të Anglisë, të Francës, të vendeve skandinave, të Amerikës Latine ose të Lindjes së Largët nuk mund të janë indiferente. Ato, në një mënyrë ose në një tjeter, kanë shprehur dyshimet e tyre dhe i druhën sundimit të dyfishtë sovjeto-amerikan.

Këto ka filluar t'i shqetësojë fakti se miqtë e tyre të mëdhenj jo vetëm që njëri-tjetrin e konsiderojnë si të vetmin bashkëbisëdues të vlefshëm për çështjet e mëdha botërore, por në mënyrë sekrete merren vesh edhe për çështjet që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me vendet e tyre. Sidomos shumë i shqetëson fakti se bisidimet dhe marrëveshjet e SALT-it, nga të cilat janë përjashtuar të gjithë, po shndërrohen në një vijë të përbashkët strategjike amerikano-sovjetike, në një marrëveshje të madhe globale, së cilës duhet t'i nënshtronët në mënyrë të bindur e të përulur të gjithë aleatët.

Politika dhe veprimtaria e dy superfuqive tanimë nuk godet interesat e vetëm një vendi, ose të disa vendeve të veçanta. Ajo prek zona e kontinente të tëra, prandaj edhe revoltimi e kundërshtimi i saj bashkon në një front të përbashkët antiimperialist e antisocial-imperialist popuj të tërë.

Popujt e botës ndodhen tani përpara një sulmi të ri e të gjithanshëm të imperialistëve amerikanë e sovjetikë. Atij mund t'i bëhet ballë duke demaskuar e duke kundërshtuar me të gjithë forcën përbajtjen reaksionare të alcancës sovjeto-amerikane, si dhe pla-

net e saj shtypëse e grabitqare. Është e nevojshme, sidomos, të hidhen poshtë iluzionet pacifiste, gënjeshtrat e mashtimet imperialisto-revizoniste me të cilat ata po mbytin botën.

Bashkimit kundërrevolucionar të të dyja supersufqive popujt e botës duhet t'i kundërvënë bashkimin e tyre revolucionar, luftën e tyre të vendosur e dhëmb për dhëmb, që të bëjnë të dështojnë komplotet e reja drejtuar kundër lirisë e pavarësisë së popujve, për të minuar e për të shkatërruar tërë strategjinë globale sovjeto-amerikane.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i popullit»,
nr. 134 (7426), 4 qershor 1972*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Kundër revizio-
nizmit modern (Përmbledhje
reprash) 1971-1975», f. 251*

PA PARTINË MARKSISTE-LENINISTE KLASA PUNËTORE NUK MUND TA BEJË DHE TA ÇOJË GJER NË FUND REVOLUCIONIN

Nga biseda me një mik nga Suedia

10 qershor 1972

*Pasi i uroi mirëseardhjen mikut suedezi, ky i shpreh
hu shokut Enver Hoxha keqardhjen që nuk dinte të
fiste shqip ose frëngjisht, por vëtëm pak rusisht. Duke e marrë fjalën, shoku Enver Hoxha tha:*

Edhe unë e di pak rusishten. Rusishtja është gjuha në të cilën ka folur e ka shkruar aq vepra gjeniale Lenini i madh, është gjuha e vazhduesit besnik të veprés së tij, Stalinit, është gjuha e popullit heroik sovjetik, prandaj ne, marksistë-leninistët, nuk jemi kundër kësaj gjuhe, por kundër Hrushovit, kundër Brezhnevit dhe kundër gjithë tradhtarëve të tjerë të marksizëm-leninizmit, të revolucionit, të socializmit.

Jam i güuar që po njihem sot për së afërm mi me ju në këtë takim shoqëror. Partia jonë ushqen respekt për popullin suedezi, por edhe për ju personalisht që jeni i vjetër jo vëtëm nga mosha, por sidomos nga eksperienca dhe nga e kaluara juaj revolucionare.

Ju keni jetuar, punuar dhe luftuar që në kohën e Kominternit dhe jeni mirë në dijeni të veprimitarissë së tij të lavdishme. Sado të përpiken revizionistët modernë dhe, në mënyrë të veçantë, ata hrushovianë, socialdemokratët dhe gjithë tradhtarët e tjerë të klasës punëtore për të njollosur veprën e madhe të Leninit, veprën e nxënësit të tij besnik, Stalinit dhe, përgjithësisht, veprën e Kominternit, ata kurrë nuk do të mundin t'ia arrijnë qëllimeve të tyre armiqësore. Të gjithë këta tradhtarë e luftojnë me egërsi veprimitarinë e Kominternit, për arsy se, në përgjithësi, ajo ka qenë e drejtë, se fryma internacionaliste dhe proletare e tij është edhe sot burim i madh fryshtimi për komunistët e vërtetë dhe proletarët kudo në botë.

Revizionistët modernë, në mënyrë të veçantë ata hrushovianë, duke pretenduar për «gabime të mëdha» të bëra nga Kominterni, përpiken, në radhë të parë, të likuidojnë parimet e shëndosha politike, ideologjike dhe organizative mbi të cilat mbështeten partitë e vërteta marksiste-leniniste dhe shpresojnë se në këtë mënyrë do t'i këputin kokën revolucionit.

Po a mund të ketë bërë gabime Kominterni? Nuk përjashtohet që ai të ketë bërë ndonjë gabim taktik, por si dhe sa janë gabimet e tij, nga ana jonë asgjë nuk themi dot, sepse nuk ia lejojmë vetes të flasim pa fakte, pa dokumente. Ne, luftëtarët e revolucionit proletar, anëtarët e partive marksiste-leniniste, kemi të drejtë të japim gjykimin tonë, por edhe detyrë që ta japimi atë jo në mënyrë subjektive e të njëanshme, por në bazë të faktave të pakundërshtueshme. Doku-

mentet e Kominternit, për të parë në hollësi veprimitarë e tij të gjithanshme, nuk i kemi ne, ato i kanë revisionistët në Moskë, që i manipulojnë siç dëshirojnë, në interes të vijës së tyre tradhtare. Prandaj nuk mund të mbështetemi kurrsesi në pretendimet false të revisionistëve mbi të ashtuquajturat gabime të Kominternit. Ca mië tepër ne nuk mund të mbështetemi në këto pretendime, duke marrë parasysh se faktet e njohura botërisht tregojnë që në kohën e Kominternit iu dha impuls revolucionit, krijimit dhe forcimit të partive leniniste të asaj kohe.

Ne e dimë që aktualisht kushtet e Suedisë nuk janë aq të favorshme për një zgjerim të radhëve të komunistëve, sepse borgjezia kapitaliste e vendit është mjaft e fortë, e organizuar dhe me eksperiencë. Partitë e saj, partia socialiste, ajo socialdemokrate etj., kanë punuar me kohë për çoroditjen e mendjeve të njerëzvë, tek të cilët pikëpamjet e tyre kanë rrënje të thella. Megjithatë, ne kemi besim te komunistët suedezë, për arsyese, me gjithë kushtet e vështira, ata do të luftojnë, do të ecin përpara dhe do të fitojnë vazhdimi shëndetësor.

Në ngjarjet që janë zhvilluar në Suedi nuk mund të mos kihet parasysh karakteri i popullit tuaj. Popujt tanë nuk kanë pasur rast të kenë kontakte të ngushta me njëri-tjetrin, por ne e kemi lexuar historinë e vendit tuaj dhe dimë se populli suedez është i zgjuar dhe i ndershëm, i matur e punëtor. Nga ana e temperamentit ai nuk u përngjet popujve të Jugut, është i getë. Gjatë historisë së vet, natyrisht i udhëhequr nga pikëpamjet e kohës, populli suedez edhe ka luftuar

me guxim. As për Engelbrektin¹ apo mbretin Gustav Vasa² nuk mund të thuhet që s'kanë qenë njerëz të guximshëm. Por ne jemi të bindur se idetë e mëdha të marksizëm-lininizmit, këtë popull që është kaq bujar, i zgjuar, trim e punëtor, do ta bëjnë edhe luftëtar të çështjes së madhe të socializmit.

Duke e marrë fjalën, miku nga Suedia, ndërmjet të tjerash, shprehu konsideratën e tij për Partinë e Punës të Shqipërisë dhe për shokun Enver Hoxha, duke i uruar popullit shqiptar suksese të reja në ndërtimin e socializmit.

Pastaj e mori përsëri fjalën shoku Enver Hoxha:

Ne ju jemi shumë mirënjosë dhe ju falënderojmë për konsideratën që keni për Partinë tonë dhe për vlerësimin marksist-leninist që i bëni ndërtimit të socializmit në Shqipëri. Kjo na vë detyrën që të punojmë akoma më shumë për të kryer kurdoherë me ndër detyrat tona ndaj çështjes së revolucionit dhe kështu ta meritojmë besimin e vlerësimin e shokëve dhe të miqve tanë jashtë Shqipërisë. Ne, ashtu si gjer tani, edhe në të ardhmen do të ecim me vendosmëri e pa u lëkundur në rrugën marksiste-leniniste.

Dihet se për ndërtimin e socializmit faktori i brendshëm ka rëndësi vendimitare, por dihet, gjithashtu, se ne nuk mund të rrojmö dhe të ecim përpara pa një unitet internacionalist me popujt e tjerë vëllezër, me

1. Engelbrekt (1390-1436) — figurë politike suedeze, udhëheqës i kryengritjes në Suedi në vitet 1434-1436 kundër sundimit danez.

2. Gustav I Vasa (1496-1560) — sundoi në Suedi nga viti 1523 deri më 1560.

masat revolucionare të proletariatit ndërkombëtar, me marksistë-leninistët e vërtetë në të gjithë botën. Ne e kemi shumë të qartë këtë çështje, prandaj bëjmë çmos që lidhjet e marrëdhëniet tona me të gjitha forcat revolucionare të botës të jenë sa më të ngushta, të afërta, të singerta, kontaktet sa më të shpeshta për të këmbyer reciprokisht me njëri-tjetrin mendimet dhe eksperiençën e përbashkët. Marksizëm-leninizmi dhe Partia jonë na kanë mësuar dhe edukuar të mos na shkojë kurrë në mendje që marrëdhëniet me shokët tanë marksistë-leninistë të partive motra t'i shikojmë «së larti» vetëm e vetëm se ne kemi avancuar, kemi marrë pushtetin, kemi likuiduar klasat antagoniste në vendin tonë dhë tani jemi duke ndërtuar socializmin. Pürkundrazi, ne e dimë se, duke u mbështetur fort në parimet e marksizëm-leninizmit, fitoret tona mund të bëhen një forcë lëvizëse, në qoftë se ato do të lidhen ngushtë me veprimtarinë e përbashkët të të gjitha partive të tjera marksiste-leniniste, në qoftë se ne do të thithim prej tyre edhe eksperiencën që kanë grumbulluar ato. Ne me ato mundësi që kemi do të përpiqemi të japim eksperiencën tonë modeste dhe kështu, të gjithë së bashku, me radhë të shtrënguara, të krijojmë një unitet të vetëm mendimi e veprimi marksist-leninist kundër armiqve tanë të përbashkët kapitalistë dhe revizionistë.

Me këtë nuk dua të them që edhe sot të ngrihet problemi i rikrijimit të Kominternit, por çështjen e kam te mbrojtja e ideve të tij të mëdha, që janë idetë e Leninit. Kohë përpara, qysh kur jetonte Lenini, kur socialdemokracia tradhtoi kauzën e proletariatit, marksistët e vërtetë braktisën rrugën e saj dhe krijuan par-

titë e reja të tipit leninist. Edhe tani që revizionistët modernë tradhtuan marksizëm-leninizmin, ka ardhur koha që jo vetëm të krijohen kudo parti të reja të vërteta marksiste-leniniste, por gradualisht të forcohen ato. Këtë mësim të madh na e ka thënë Lenini dhe Kominterni në kohën e vet e ka zbatuar atë më së miri.

Një mësim tjetër i madh leninist është ai që, pa partinë marksiste-leniniste në udhëheqje, klasa punëtore nuk mund ta bëjë e ta përfundojë me sukses revolucionin. Armiqtë revizionistë bëjnë të gjitha përpjekjet për të krijuar mjegull për sa i përket kuptimit të parimeve leniniste të ndërtimit të partisë. Ata përpipen t'i bëjnë këto «të shkrifëta» dhe pastaj, po të kenë mundësi, t'i likuidojnë fare, në mënyrë që klasa punëtore të gjendet pa shtabin e saj udhëheqës dhe e çarmatosur. Prandaj është detyra jonë të punojmë pareshtur për konsolidimin e unitetit të Partisë në bazë të parimeve leniniste. Se çfarë veprimtarie të dendur minuese ndjekin revizionistët modernë në këtë drejtim, këtë e dini mirë ju, këtë e dimë edhe ne.

Një konfuzion i madh ideologjik ekziston sot në mjaft vende; kudo po krijohen gjithfarë grupesh me lloj-lloj pikëpamjesh, por jo me pikëpamje marksiste-leniniste. Gjithfarë emrash u vënë antimarksistët grupeve të tyre, i quajnë ato «të majta», «revolucionare», bile «ultrarevolucionare». Borgjezia dhe revizionistët modernë e nxitin me qëllim krijimin e këtyre grupeve, për të larguar forcat e gjalla të proletariatit botëror nga rruga e revolucionit, për të shtuar konfuzionin ideologjik.

Jo vetëm kaq. Armiqtë e proletariatit kudo po

përpiqen të krijojnë edhe grupe e shoqëri sekrete sipas traditave të shoqërive të vjetra, që kanë lulëzuar dikur në Evropë apo edhe në kontinente të tjera. Frannmasoneria¹ e vjetër është bërë frannmasoneri e re, karboneria² e vjetër është shndërruar në karboneri të re, deri edhe mafia përpinqet t'i veshë vetes një ideologji ultramajtiste. Njeriu, që bën pjesë në këto shoqëri apo grupe sekrete, duhet të jetë si një kufomë në duart e atij që drejton, sipas motos së vjetër latine *perinde ac cadaver*³. Është e njojur në këtë drejtim teoria e Buonarotit⁴ dhe e karbonarëve. Tani drejtuesit e këtyre shoqërive betohen se gjoja luftojnë kundër kapitalizmit dhe borgjezisë, ndërsa në të vërtetë ata ndihmojnë armiqitë e klasës punëtore dhe përpinqen t'i vënë

1. Franc-maçonneie (frëngjisht) — rrjmë fetaro-filosofike, lindur në fillim të shekullit të 18-të në Angli dhe e përhapur në vende të tjera; bënte thirrje për dashuri e vëllazëri të përgjithshme në kushtet e rendit ekzistues. Sot ajo përfaqëson një nga lëvizjet reaksionare në vendet kapitaliste dhe është armike e lëvizjes punëtore revolucionare.

2. Lëvizje politike në Itali në çerekun e parë të shekullit të 19-të për çlirim kombëtar nga zgjedha franceze dhe ajo austriake. Kjo lëvizje u përhap edhe në Francë në vitet 1820-1830 kundër dinastisë së Bourbonëve. Ndiqte taktilën e marrëveshjeve në rrethe të ngushta dhe ishte e shkëputur nga masat popullore.

3. Si një trup i vdekur. Ka kuptimin e të qenit i bindur dhe i disiplinuar verbërisht.

4. Filip Buonaroti — revolucionar italian, pjesëmarrës në lëvizjen revolucionare në Francë e në Itali në fund të shekullit të 19-të. Bashkëpunëtor dhe propagandist i ideve të Babëfit, përkrahës i taktilës komplotiste.

një barrikadë të rreptë luftës së drejtë që zhvillojnë partitë tona marksiste-leniniste.

Në këto kushte kaq të ndërlikuara, detyra jonë është të luftojmë për krijimin dhe konsolidimin e partive marksiste-leniniste, të bëjmë të ndërgjegjshme masat, klasën punëtore, fshatarësinë dhe inteligjencien se rrugët që ndjekin të gjithë ata që përmenda, janë larg mësimeve leniniste dhe duhet të braktisen, sepse kurrë nuk çojnë në socializëm. Natyrisht, kjo kërkon përpjekje të mëdha nga ana e të gjithë marksistë-leninistëve. Në mënyrë të veçantë ju keni mjaft vështirësi për të kapërcyer në këtë drejtim.

Po të studiohen me vëmendje historia e popullit shqiptar dhe ajo e Partisë sonë, mund të vihet re lehtë se ne nuk kemi vuajtur nga rryma të tillë. Eksperiencia e Partisë sonë është e vogël dhe, për këtë, ne, shqiptarët, jemi të ndërgjegjshëm, prandaj dëshirojmë që shokët e vendeve të tjera ta vlerësojnë atë në masën e duhur, jo më tepër.

Dihet se Partia e Punës e Shqipërisë ka qenë dhe është në kundërshtim të papajtueshëm, në luftë të hapët dhe pa kompromis me tradhtarët revizionistë modernë e, në mënyrë të veçantë, me ata sovjetikë, që e heqin veten marksistë-leninistë, prandaj i kemi demaskuar dhe i demaskojmë publikisht e pa mëshirë në fushën ideologjike, në politikën e tyre të brendshme e të jashtme, në fushën ekonomike e në çdo drejtim tjetër.

Ju e vini re edhe vetë se Shqipëria, nga pikëpamja e zhvillimit industrial dhe bujqësor, është më prapa në krahasim me vendin tuaj dhe me vendet e tjera të

industrializuara të botës. Suedia ka një industri të madhe, nga më modernet dhe, pavarësisht nga pozita dhe struktura gjeografike e vendit, atje edhe bujqësia është e një niveli të lartë. Por, megjithëse kjo ekonomi e zhvilluar e vendit tuaj është krijuar me mundin dhe djersën e punëtorëve e të Ishatarëve, frytet e saj nuk i gjëzojnë këta, por borgjezia, sepse nijetet e prodhimit janë në duart e saj, sepse kjo ka të drejtën e pronësisë mbi ndërmarrjet ekonomike, mbi tokën etj.

Vendi ynë gjatë luftërave të pandërprera është djegur e zhuritur sa e sa herë. Edhe pas Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare popullit shqiptar i është dashur ta fillojë rindërtimin e vendit nga e para. në kushtet e një varfërie e të një mjerimi të madh, në errësirë e padituri. Me punën e tij të palodhur, nën udhëheqjen e Partisë, populli ynë ka arritur një sukses, duke ruajtur në të njëjtën kohë edhe lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin kombëtar. Prandaj ai u gjëzohet së tepërtmi gjithë këtyre sukseseve ekonomike që ka arritur gjer më sot. Realizimeve tona u gjëzohen, gjithashtu, edhe miqtë e vendit tonë dhe marksistët, që e kuptojnë drejt zhvillimin materialist të shoqërisë, ndërsa imperialistët dhe revisionistët me qëllime të paraçaktuara përpinqen t'i errësojnë e t'i mohojnë ato. Duke hedhur vështrimin mbi përparimet që janë arritur në vendin tonë në kushte kaq të vështira të rrëthimit armiqësor imperialisto-revisionist dhe brenda një kohe kaq të shkurtër, për ne është e qartë se këto sukses mund t'i realizojë vetëm një popull që udhëhiqet nga një parti marksiste-leniniste.

Partia jonë i ka gjuhën dhe duart të lira. Atë as-

kush nuk mund ta pengojë për të thënë hapur ato që mendon, për të parashtruar hapur qëllimet dhe rrugën e saj. Prandaj miqtë na duan me gjithë shpiri, bile dhe armiqtë janë të detyruar të na respektojnë, megjithëse nuk janë dakord me ne.

Përse na respektojnë ne armiqtë? Për arsyet se kemi kurajën të flasim hapur, para cilitdo, në mbrojtje të parimeve të politikës dhe të ideologjisë sonë marksiste-leniniste. Është fakt se shumë prej tyre dëshirojnë t'i shfaqin mendimet dhe kontradiktat që kanë me njëri-tjetrin, por nuk veprojnë dot kështu, nuk dalin dot hapur, sepse i kanë duart të lidhura. Armiqtë nuk janë në gjendje të kuptojnë se ku e ka burimin guximi ynë, ndërsa shokët dhe miqtë tanë, si dhe komunistët e vërtetë e kuptojnë, sepse edhe ata luftojnë kundër imperializmit dhe revizionizmit. Në këtë luftë të lavdishme komunistët janë aq të vendosur e të guximshëm sa nuk përfillin as vdekjen, po që se këtë e kërkojnë interesat e revolucionit.

Populli shqiptar ka marrë parasysh të luftojë gjer në fund e pa u lëkundur aspak kundër çdo armiku që do të guxojë ta prekë. Gjithë populli, me Partinë e Punës në krye, është në këmbë për mbrojtjen e pavarësisë dhe të lirisë së vet.

Armiqtë imperialisto-revisionistë kërkojnë ta shkrijnë dhe ta bëjnë një të vetme bashkekzistencën gllabëruese niksoniano-brezhnjeviane, kurse ne jemi kundër marrëveshjeve të arritura nga ana e tyre. Ne luftojmë kundër tyre sepse shikojmë realisht rreziqet dhe pasojat që rrjedhin nga bashkëpunimi imperialisto-revisionist në kurriz të popujve. Në këtë luftë ba-

shkë me ne janë gjithë popujt e botës, partitë motra marksiste-leniniste dhe revolucionarët e vendeve të ndryshme të të gjitha kontinenteve. Ne kemi miq kudo në botë. Në këto rrethana ne e ndiejmë se përbëjmë një forcë të konsiderueshme dhe luftojmë së bashku për një ide të madhe të pamposhtur, prandaj me siguri do t'i mposhtim armiqjtë. Frika që u ngjall lufta e popujve për liri e pavarësi, revolucioni, idetë e marksizëm-leninizmit, i trondit armiqjtë imperialisto-reviziونistë. Prandaj ata merren vesh me njëri-tjetrin, bien dakord të organizojnë gjithfarë komplotesh kundër popujve, kundër revolucionit, kundër marksizëm-leninizmit.

Ne mësojni shumë nga eksperienca e marksistë-leninistëve kudo në botë. Marrëdhëniet tona me ta i karakterizon sinjeriteti dhe rruga marksiste-leniniste, që është e vetmja rrugë, e cila të udhëheq për të gjetur shokë dhe miq të mirë. Kjo rrugë, natyrisht, shërben shumë edhe për konsolidimin e partive dhe të lëvizjes marksiste-leniniste.

Sukseset tona në ndërtimin e socializmit i kemi bërë të njobura, por dëshiroj t'ju them se edhe vështirësitë kanë qenë të shumta. Kur nisëm luftën për ndërtimin e socializmit ne e konceptonim që do të kishim vështirësi, por nuk mendonim të ishin aq të mëdha. Duke luftuar, në punë e sipër, mësuam se ç'gjëra të tjera duhej të bënim akoma dhe sa përpjekje kërko-heshin më tej. Çdo vepër e kemi ndërtuar me shumë djersë e mund.

Në radhë të parë e, mbi të gjitha, i kemi vënë rëndësi luftës për edukimin e njeriut të ri, për arsyen se

vetë eksperienca e Partisë sonë na ka mësuar që kjo çështje është kyçi për zgjidhjen revolucionare të problemeve. Është e vërtetë se populli shqiptar në të kaluarën ka jetuar në varfëri dhe në errësirë, se ai është trim, punëtor, bujar dhe i thjeshtë, por krahas cilësive shumë të mira, ai ka trashëguar në ndërgjegjen e tij edhe mbeturina të së kaluarës, zakone, shprehi e mentalitete të huaja me origjinë borgjeze, mikroborgjeze, bile feudale dhe patriarkale, që i qepen si ferrat nëpër këmbë. Për zhdukjen e këtyre mbeturinave, me gjithë luttën që është bërë dhe sukseset që janë arritur, kërkohet, në radhë të parë, akoma punë e vazhdueshme ideologjike dhe politike, që do të ndikojë në ndërtimin e ekonomisë socialiste dhe në zhvillimin e kulturës së re socialiste. Në këto drejtime ne filluam nga e para dhe, siç thashë, kemi pasur suksese, por Partia jonë nuk ka ushqyer dhe nuk ushqen iluzione se lufta për formimin e njëriut të ri me ndërgjegje dhe me botëkuptim socialist është e përfunduar. Përkundrazi, lufta për edukimin komunist të punonjësve është e gjatë dhe shumë e vështirë, atë do ta vazhdojnë breza të tërë. Ne jemi të sigurt se çdo brez i ri që do të vijë, do të jetë më i mirë në të gjitha drejtimet, pra, do të jetë më i pastër, më i vendosur, më i zgjuar e më i kulturuar, me një ndërgjegje më të lartë ideologjike dhe politike. Ne jemi të ndërgjegjshëm që në këtë drejtim kemi shumë për të bërë, por kemi besim në fitoren tonë, sepse udhëhiqemi nga marksizëmi-leninizmi.

Lidhjet tona me Suedinë po përpiqemi t'i forcojmë, t'i shtojmë, sidomos marrëdhëniet tregtare. Në vendin tuaj gjer tani kemi blerë disa makineri të mira e moderne.

Në Suedi duhet të jetë e zhvilluar industria e letrës, megjithëqë nuk di shumë gjëra, por këtë e them nga fakti se te ju ka mjaft pyje. Kurse ne kemi ca vështirësi në drejtim të prodhimit të letrës, por, për të siguruar nevojat që kemi për këtë artikull, kemi ngritur dy fabrika.

Për sa u përket pyjeve në Shqipëri, jemi mjaft shtrënguar, sepse armiqqtë, pushtuesit e ndryshëm, në të kaluarën na i kanë dëmtuar rëndë, i kanë djegur dhe i kanë prerë. Prandaj sot i kushtojmë kujdes të vëçantë çështjes së pyllëzimit. Në shumë zona po ngrihen, për këtë qëllim, breza të tërë pyjorë, por duhet të kalojë njëfarë kohe që ato të vihen në shërbim të industri-së. Tani po përpinqemi të futim në përdorim sa të jetë e mundur më shumë lëndët plastike, që do t'i prodhojmë në vend me ngritjen e fabrikës së re të plastmasit.

Ju keni qenë edhe herë tjetër në vendin tonë dhe e dini që industria te ne ka filluar gati nga asgjë dhe kur ndërtojmë ndonjë fabrikë, gjëzohemi shumë, prandaj mos u çuditni me kënaqësinë që ndiejmë kur ndërtojmë fabrika e uzina. Në i ngremë ato me duart tona dhe jo ashtu siç ngjet në vende të tjera, si në Jugosllavi e gjetkë, ku ato që ndërtohen, nuk janë të tyret, por të amerikanëve, të kapitalit gjermanoperëndimor etj.

Ne i kushtojmë kujdes të madh edhe zhvillimit të kulturës së re socialiste. Ja, për shembull, këtë vit, shokët që merren me kulturën do të organizojnë një konferencë¹ për ilirët, paraardhësit tanë. Shkencëtarët

1. Është fjala për Kuvendin e Parë të Studimeve Ilire që u mbajt në Tiranë më 15-20 shtator 1972.

tanë kanë bërë shumë studime interesante në këtë drejtim. Prej kohësh ata po bëjnë kërkime e gërmime dhe kanë nxjerrë shumë materiale të çmueshme. Në këtë konferencë, përveç referateve e kumtesave, do të organizohen edhe ekspozita të veçanta me dokumente ilire. Janë ftuar për të marrë pjesë në këtë ngjarje 50 shkencëtarë, studiues në fushën e ilirologjisë, nga vendet e Evropës dhe deri tani na janë përgjigjur pozitivisht 25 prej tyre.

Ju falënderojmë në mënyrë të veçantë për punën e palodhur që bëni me masat e popullit suedezi për njohjen e Shqipërisë socialiste dhe të Partisë së Punës. Ne i kuptojmë mirë dëshirën dhe përpjekjet tuaja për të botuar në gjuhën suedeze tekstin e Historisë së Partisë sonë. Për këtë gjest internacionalist neve na vjen mirë, jo sepse është fjala për tekstin e Historisë së Partisë sonë, por për arsy se shokët komunistë dhe punëtorë suedezi, nëpërmjet këtij teksti, do të kenë mundësi të njojin luftën dhe eksperiencën tonë modeste. Natyrisht, dihet se kushtet e dy vendeve tona nuk janë aspak të njëllojta, por eksperiencën e njëri-tjetrit do të dimë ta zbatojmë në bazë të kushteve konkrete të secilit vend.

Ne, gjithashtu, ju falënderojmë për interesimin që tregoni për gjithçka që patë dhe dëgjuat në vendin tonë. Ne, përveç jush, falënderojmë për këtë edhe të gjithë shokët tuaj që kanë ardhur në Shqipëri. Me këtë rast dëshiroj t'ju shpreh ndjenjat tona të pastra dhe respektin e madh për pritjen e ngrohtë familjare e shumë miqësore që u është bërë shokëve tanë që kanë pasur rastin të vijnë herë pas here në Suedi. Ata

që kanë vajtur nga Shqipëria në vendin tuaj, kanë mbetur shumë të kënaqur nga mikpritja juaj.

Besoj se do të vini përsëri për punë dhe pér të pushuar në Shqipëri, që është një vend i bukur, me diell shumë, por e bukur është edhe Suedia, me natyrën e saj të mbushur plot liqene e pyje me pisha e drurë të tjera.

Ju uroj shëndet, suksese në punën tuaj revolucionare. Shumë të fala shokëve!

*Botohet sipas shënimave të
mbajtura në këtë takim, që
gjenden në AQP*

KA ARDHUR KOHA TA KRIJOJMË AKADEMINE E SHKENCAVE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

15 qershor 1972

Të törë jemi dakord me propozimin që bëhet për ngritjen e Akademisë së Shkencave. Edhe unë, si gjithë shokët, mendoj se ka ardhur koha ta krijojmë këtë institucion me rëndësi, pse e kërkon nevoja që shkencat tona të ngrihen në një nivel akoma më të lartë. Pastaj, tani ekzistonjë edhe kushtet për ta ndërmarrë këtë hap që po bëjmë, pse kemi kuadro, natyrisht, jo të shumtë, po të mjaftë për t'ia filluar kësaj pune të rëndësishme. Sot jemi në gjendje që këta t'i zgjedhim, veç të kemi parasysh që këtë punë të mos e nisim më një dëshirë të madhe e të pabazuar, duke u përpjekur të përfshijmë në akademi të gjitha institutet ekzistuese.

Së pari, unë mendoj të marrim një vendim, në parim, për krijimin e Akademisë së Shkencave. Një-kohësisht, të ngarkojmë shokët kompetentë për të pér-

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për krijimin e Akademisë së Shkencave të RPSH.

fshirë në të, në fillim, në bazë të kritereve që na janë parashtruar, ato institute që mund të futen tani për tanë dhe kuadrot më të përgatitur që do të jenë anëtarët e këtij institucioni.

Unë jam dakord me vërejtjet që bëri këtu profesor Androkli Kostallari, por mendoj, që institutet shkencore që kemi sot të mos i futim të tëra në Akademinë e Shkencave, duke e fryrë këtë me përfshirjen e tyre në gjirin e saj. Në gjithë botën, nga sa dimë, ka anëtarë të akademive që bëjnë pjesë drejtpërsëdrejti në institutet që kanë ato në vartësinë e tyre, por ka edhe anëtarë që nuk janë punonjës të këtyre instituteve. Këta anëtarë bëjnë, gjithashtu, studime shkencore nën drejtimin e akademisë, pavarësisht se punojnë nëpër institutet që nuk i përfshin ajo. Prandaj, ne mund të ndjekim rrugën që të mos i shkrijmë të tëra institutet ekzistuese të studimeve në akademi; përkundrazi, edhe atyre që do të mbeten jashtë saj t'u japim ndihmë, që të bëhen me të vërtetë organizma të lartë shkencorë në shërbim të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës, pse tërë «ujërat» e tyre atje do të rrjedhin, në shërbim të ekonomisë e të kulturës së vendit tonë në tërsi.

Kështu, në Akademinë e Shkencave që po krijojmë, ne mund të futim ato institute që sot e kanë me të vërtetë kërkesë të domosdoshme të bëjnë pjesë në të. Të tjerat t'i forcojmë dhe t'i drejtojmë në mënyrë që të punojnë në një nivel edhe më të lartë se gjer tanë, sepse pikërisht për këtë qëllim e krijojmë edhe akademinë: t'i çojmë shkencat tona gjithnjë e më lart dhe në këtë drejtim, ajo mund të japë ndihmën e nevojshme. Fryti i veprimtarisë shkencore që do të zhvillojnë aka-

demia dhe institutet do të shkojë deri poshtë në bazë, nëpërmjet punonjësve tanë të shkencës që do të bëjnë pjesë në to, si dhe të atyre që punojnë në dikastere etj., me qëllim që ajo të vlejë për të ngritur në një nivel më të lartë e për të rritur gjithnjë më mirë veprimtarinë shkencore në vendin tonë, deri në byrotë teknologjike të ndërmarrjeve. Në këtë mënyrë mendimi shkencor që do të zhvillohet në akademi dhe në institutet e tjera, do të shkojë poshtë i zbërthyer, në mënyrë që të përtypet nga baza, nga masa e punëtorëve, e teknikëve dhe e specialistëve tanë.

Në qoftë se do ta ngremë akademinë, duhet të mendojmë mirë jo vetëm se si do të punojë ajo, por edhe si do të ndihmojë institucionet e tjera, veçanërisht universitetin, në përgatitjen e kuadrove. Veçse kjo çështje duhet kuptuar drejt. Të mos ngarkohen kuadrot e kualifikuar me shumë detyra, ashtu sikurse veprohet tani, se atëherë ata s'kanë si të merren me shkencën. Kjo gjë duhet shikuar me kujdes, se kuadrot që do të punojnë në akademi, po të vijnë të punojnë po me aq ngarkesë edhe në universitet, nuk do t'ia dalin dot punës mësimore dhe shkencore. Prandaj orari i dhënies së mësimit në universitet do të jetë i reduktuar, nga puna e tyre të ndihmohen edhe të tjerët, kuadrot e rinj. Kështu duhet kuptuar kjo çështje.

Të mos shqetësohem aspak për çështjen se pjesa më e madhe e instituteve që do të bëjnë pjesë në akademinë që po krijojmë do të përbëhet nga ata të shkencave humanitare. Përkundrazi, kjo është diçka shumë pozitive dhe një domosdoshmëri e madhe për vendin tonë, për arsy se shkencat humanitare, në mënyrë të veçantë, kanë

qenë më parë krejt të braktisura e të panjohura. Në këtë fushë aktualisht ne nuk marrim dhe nuk mund të marrim dot asnjë ndihmë nga jashtë. Të vetmen eksperiençë që mund të marrim nga të tjerët është ajo që të shohim si është organizuar puna në këto drejtime. Këto degë të shkencës janë të domosdoshme për ne, pse kanë të bëjnë me ideologjinë, kurse shkencat natyrore dhe teknike kanë edhe ato rëndësi të madhe në drejtim të zhvillimit në përgjithësi të ekonomisë sonë, të industri-së, të bujqësisë etj., por, në këto drejtime ne mund të marrim e të shfrytëzojmë, pa ndonjë pasojë, edhe eksperiencën e të tjerëve që kanë bërë zbulime kolosale në fusha të ndryshme më parë nga ne. Shkencat natyrore dhe teknike atje kanë bërë përparime të mëdha. Me këtë nuk dua të them se puna në këta sektorë të akademisë do të mbështetet plotësisht dhe vetëm në shpikjet që bëhen jashtë vendit. Por, ta kemi të qartë se kuadrot tanë të shkencave të natyrës dhe të shkencave teknike, po të mos vihen vazhdimisht në korent për zhvillimin shkencor, industrial e teknik të botës së përparuar, do të shterojnë dhe akademia jonë do të kthehet kështu në një instrument me rendiment shumë të ulët. Prandaj, në këto dy drejtime, më duket mua, duhet të mendojmë mirë.

Kisha edhe një propozim lidhur me problemin që po shqyrtojmë. Mua më duket se nuk duhet të shpejtohem i me caktimin që në fillim të një numri të madh anëtarësh të akademisë. Natyrisht, akademinë ne do ta krijojmë me shkencëtarët tanë më të mirë dhe mendoj se për këtë tanë kemi plot njerëz të talentuar. Por, në këtë drejtim, të mos nxitohemi, bile të jemi pak të shtrënguar,

jo vetëm për faktin se vetë titulli «anëtar i akademisë» është i rëndësishëm, por për ne nuk ka më shumë rëndësi titulli, sesa brendia dhe perspektiva e ecjes së kuadrit përpara. Prandaj, mendoj t'i lëmë rrugë edhe perspektivës. Po ta krijojmë akademinë që tani me një numër të madh anëtarësh nuk është puna se do t'ua mbyllim krejt dyert e perspektivës kuadrove të rinj, por, për mjaft kohë, do të detyrohem i të jemi shumë të shtrënguar për gjithë brezin e ri të kuadrove që është përgatitur e do të përgatitet në të ardhmen e afërt. Pastaj, edhe kuadrot që kemi përgatitur deri tani, të kemi parasysh se prapë të rinj janë. Unë nuk kam akoma një ide plotësisht të formuar se kush do të jetë anëtar i akademisë. Por, brezi i ri, që është shumë i zoti e që i vëmë detyrën të luftojë për të bërë vazhdimit hapa përpara në fushën e përvetësimit të shkencës etj., për një kohë do t'i ketë të mbyllura dyert e akademisë, po të nxitohemi në fillim. Ne duhet të ecim me kujdes që nga koha në kohë ta rritim numrin e anëtarëve të akademisë, natyrisht me kriter, në mënyrë që ata që do ta marrin këtë titull, ta meritojnë me të vërtetë.

Për të gjitha këto arsyenë jam i mendimit që në fillim të kemi më pak anëtarë në Akademinë e Shkencave, disa kuadro nga më të shqarrit në fusha të ndryshme. Me kohë, nga ana e Komitetit Qendror do të shikojmë e do të përeaktojmë nomenklaturat për titujt; do të përpunojmë rregulla e kriterë se kush do të bëhet anëtar i akademisë, natyrisht me propozimin e vetë asaj. Këtë problem mund ta shohim e ta shqyrtojmë më vonë, ndoshta brenda vitiit, kur të kenë mbaruar të gjitha studimet dhe propozimet.

Pastaj, të kemi parasysh edhe një gjë: praktika na ka treguar që të tilla instituteve, orientimet ne ua përcaktojmë në parim, por në fakt, i përdorim shpesht në mënyrë shumë administrative. Kështu, kur i bie ndonjërit në mendje ose i del një problem për dikasterin që drejtton, ai urdhëron institutin përkatës ta shikojë, ta studiojë etj. Tani që krijojmë akademinë, shokë, duhet t'i jepet fund një praktike të tillë. Akademia do të ketë planin e vet vjetor të aprovuar nga Këshilli i Ministrave dhe jashtë këtij plani, akademisë të mos i bëhen ngarkesa të tjera, sipas dëshirës e nevojës që mund të dalin në sektorë të ndryshëm. Të gjitha institutet e tjera të studimeve, që do të ushtrojnë veprimtarinë shkencore jashtë akademisë, siç janë Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë Komitetit Qendror të Partisë, universiteti ose institutet që varen nga disa prej ministriteve etj., për këtë ose për atë problemi nuk mund të thonë «le t'i kalojë akademisë për ta studuar!», meqenëse akademia do të grumbullojë në gjirin e vet personalitetet shkencore më të larta, pra, shkencëtarët tanë më me autoritet. Kjo praktikë duhet të marrë fund. Akademia, siç e thashë, do të ketë programin e vet, prandaj nuk mund të përdoret, siç është vepruar gjer tani me institutet e ndryshme të studimeve.

Në parim, pra, të gjithë jemi dakord të krijohet Akademia e Shkencave. Të japim asat që deri në fund të vitit, çdo problem që ka lidhje me të, t'i paraqitet Byrosë Politike për shqyrtim dhe aprovim, duke filluar që nga organizimi, numri i anëtarëve, personeli administrativ, rregulloret dhe të gjitha çështjet e tjera me radhë. Duke marrë parasysh se rëndësia e krijimit të kë-

tij institucioni është mjaft e madhe për vendin tonë, vendimin e Byrosë Politike për krijimin e Akademisë së Shkencave mendoj t'ia paraqitim edhe Plenunit të ardhshëm të Komitetit Qendror¹, për ta marrë në shqyrtim dhe për të vendosur përsfundimisht.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

1. Këtë vendim të Byrosë Politike e miratoi Plenumi i 2-të i KQ të PPSH, që u mblohdh më 19-20 qershor 1972.

DISA VËREJTJE PËR RAPORTIN QË DO TI PARAQITET KONGRESIT TË RINISE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

15 qershor 1972

Në lidhje me luftën që duhet të bëjmë për edukimin e rinisë, mendoj se duhet shkruar diçka, natyrishët në formë të përshtatshme dhe për një luftë më të vendosur kundër shfaqjeve të huaja në rini.

Në tezat, më duket se nuk del mirë përgjegjësia që i bie familjes për edukimin e fëmijëve. Për patriarkalizmin dhe të gjitha mbeturinat e tjera, për të cilat bëhet fjalë në to, të mos flitet në vija të përgjithshme, duke e marrë patriarkalizmin vetëm si një mbeturinë e së kaluarës. Fakti është se kundër patriarkalizmit luftohet, por, kur nuk punohet si duhet, ai prapë ngre kokë, merr forcë, gjallërohet. Një gjë e tillë vërehet edhe të njerëzit tanë, bile edhe në komunistë, që, si marksistë-leninistë, janë kundër patriarkalizmit.

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për projekttezat e raportit të Kongresit të 6-të të BRPSH.

Ndaj disa prej atyre të rinjve ose të reja ve, që përpinqemi të edukojmë, kur dëgjojmë se dalin nga normat morale të shoqërisë sonë, ne me të drejtë revoltohemë përnjëherësh, pse këtë çështje e shikojmë në mënyrë parimore. Por, kujdes duhet të bëjmë edhe ndaj elementit të moshuar. Këtu nuk e kam fjalën vetëm për 70-80-vjeçarët, po edhe për ata të moshave 40-50-vjeçare, nga të cilët ka që nuk janë akoma sa duhet të ngritur ideologjikisht e politikisht, por që kujdesen për ruajtjen e moralit familjar, të vajzave e të djemve. Të tillë njerëz, kur shikojnë ose dëgjojnë për sjellje jo të rregullta të disa të rinjve e të reja ve, në përgjithësi nuk kanë dhe aq besimi te rinia, bile ndodh që disave prej tyre u humbet besimi edhe për rrugën e edukimit që ndjek Partia me rininë. Prandaj, duhet punuar vazhdimisht që familjet të interesohen në mënyrë shumë serioze dhe të vazhdueshme për edukimin e fëmijëve të tyre në vijën e Partisë, që nga koha kur fillojnë e dalin në rrugë e derisa piqen, se, në këtë drejtim, ka edhe lëshime. Kjo ishte çështja e parë.

Çështja e dytë që doja të prekja ka të bëjë me përgjegjësinë e shkollave për këtë problem. Edhe në shkolla duhet të luftohen si tendencat e patriarkalizmit, ashtu edhe ato të sektarizmit. Një punë më e madhe edukuese dhe një ndihmë më e organizuar duhet t'u jepet të rinjve e të reja ve nga ana e shkollës. Kjo është absolutisht e domosdoshme. Në këtë drejtim mund të thuhet se ka prirje për të mos ua hedhur fajin vetëm atyre që manifestojnë shfaqje të tillë, por rinisë në törësi. Për edukimin e saj kemi përgjegjësi ne, më të rriturit, familja, shkolla, mbarë shoqëria. Kur flasim për familjen

dhe shkollën, patjetër ne nuk mund të injorojmë shoqërinë, fshatin, lagjen, qendrat e punës që kanë në gjirin e tyre të rinj e të reja.

Për sa i përket punës së organizatës së rinisë kam mendimin se kjo nuk është gjithmonë në atë nivel që dëshirojmë. Nga sa shohim e dëgjojmë, del se ajo nuk është aq e gjallë e luftarake. Organizatat e rinisë, në përgjithësi, kanë suksese të mëdha në punën e tyre. Por, për një punë akoma më të mirë e më me rezultate, është e domosdoshme t'u jepet atyre nga ana e komunistëve, nga organizatat e Partisë e nga shkollat, një ndihmë në atë frymë dhe me pjekuri të tillë që këto të jenë në gjendje të kapin problemet, t'i transmetojnë rinisë eksperiencën e pasur të luftës ideologjike dhe në çdo drejtim tjetër, që ajo të bëhet me të vërtetë një organizatë e gjallë e luftarake. Por, të kupto hemi, jo të punohet në organizatat e rinisë me ato metoda që përdoren në organizatat-bazë të Partisë, por, duke u mbështetur në format e punës dhe në normat që ka rinia, organizatat e saj të bëhen sa më luftarake dhe të merren si duhet me çdo shfaqje negative që ndodh.

Këto kisha për të thënë. Jam dakord me vërejtjet që bënë shokët. Sugjerimet për mënyrën se si duhet të veprohet në të ardhmen, nga ana e Byrosë Politike, para se të bëhet çdo kongres rinie ose i bashkimeve profesionale, janë shumë të drejta. Edhe çështja e madhësisë së raportit, po t'i shtohen atij edhe disa faqe akoma, nuk ka pse të sjellë ndonjë pengesë. S'ka asgjë të keqë që kongresi të qëndrojë edhe një orë ose një orë e gjysmë më shumë; kjo nuk i rëndon delegatët. Bile ka pasur raste, kur ka qenë nevoja, që ne kemi ndenjur me

ditë të tëra. Çështja është të dalë një raport me të vërtetë i shëndoshë që t'i shërbejë rinisë. Kjo ka rëndësi.

SHOKU RAMIZ ALIA: Kongresi i ardhshëm i rinisë mendohet të bëhet në Durrës.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë, s'kemi asnjë kundërshtim për këtë, le të bëhet në Durrës. Pse të mos bëhet një kongres i tillë në rrethe? Kjo do të vlejë për t'u dhënë rëndësi edhe organizatave të rinisë të rretheve të tjera.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

UNITETI KRIJOHET KUR KA NDESHJE MENDIMESH

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

17 qershor 1972

Disa herë komunistët, duke u nisur nga parimi i drejtë që problemi të shtrohet në organizatë, nuk bëjnë fletërrufe dhe nuk zhvillojnë sa duhet kritikën dhe autokritikën e hapët në masën e gjerë të popullit. Por, nuk mund të injorohet fakti që punonjësi i paorganizuar në Parti ka të drejtë t'i vërë një fletërrufe komunistit që gabon ose ta kritikojë atë në mbledhje. Ai nuk e di që komunisti do ta shtrojë apo nuk do ta shtrojë problemin në organizatë. Prandaj, nuk ke si i shpëton kësaj çështjeje. Pavarësisht nga qëllimi dhe dëshira e komunistit, për t'i diskutuar çështjet në mbledhjen e organizatës, fletërrufesë do t'i japësh përgjigje medoemos, pa pri-

1. Në këtë mbledhje u diskutua për rolin aktiv të komunistëve në jetën e Partisë. Ishin thirrur në raport edhe komitetet e Partisë të rretheve Gjirokastër, Kukës dhe të Qytetit Stalin.

tur të mblidhet organizata. Punonjësi i paorganizuar në Parti nuk di se kur do të bëhet mbledhja e organizatës; ai e ngrë problemin atëherë kur e gjykon me vend. Kjo është një gjë logjike që duhet pasur parasysh.

SHOKU KRISTO SHARRA¹: Disa thonë se nuk duhet të veprohet kështu, mbasi nuk është mirë të kritikohet komunisti publikisht, se thyhet uniteti.

SHOKU ENVER HOXHA: Cili unitet thyhet? Uniteti krijohet kur luftohet, ai forcohet kur ka ndeshje mendimesh dhe jo kur heshtet para gabimeve. Unitet në qyp s'mund të ketë, një unitet si ky do të ishte fals. Këto pikëpamje ekzistojnë si mbeturina të metodës së vjetër të punës. Gabimin që bën komunisti jashtë mbledhjes, në mes të popullit, në brigadë etj., duhet ta korrigojë po atje, para atyre njerëzve në sy të të cilëve ka gabuar. Në qoftë se themi që komunisti të jetë pararojë, ai duhet të jetë pararojë në të gjitha drejtimet. Është ndryshe çështja kur komunisti gabon në mbledhje të Partisë. Në një rast të tillë ai do të diskutojë në mbledhje të organizatës.

Nga ana tjeter, vetë komunisti duhet të jetë shumë aktiv e parimor, të mos pajtohet me shkcljet e gabimet dhe të kritikojë rreptë atë që shkel normat e Partisë, kushdo qoftë ai. Këtu u thanë shumë gjëra, por për kritikat në adresë të komiteve të Partisë e të drejtuesve të tyre nuk na u tha gjë. Po për komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve çfarë problemesh janë ngritur? Ka pasur shfaqje të arrogancës në marrëdhë-

1. Në atë kohë sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit të Gjirokastrës.

niet me njerëzit nga ana e punonjësve të këtyre aparatave? Ne i njohim shokët që punojnë në to. Ata vërtet janë shokë të mirë e besnikë, por dhe në punën e tyre mund të kenë edhe shfaqje negative.

Eksperiencia tregon se jo kudo komunistët janë në rolin e tyre pararojë. Këtu u sollën disa shembuj për mosrealizime plani dhe, në të njëjtën kohë, u thanë fjalët më të mira për rolin aktiv të komunistëve që punojnë në këta sektorë. A nuk kemi të drejtë ne, t'i pyesim këta shokë: Po pse jeni keq me realizimin e planit në bujqësi, kur komunistët qenkan kaq aktivë? Vërtet se kohët e fundit, sidomos pas Kongresit të 6-të të Partisë dhe pas diskutimit të materialeve të Kongresit, roli i komunistëve është bërë më i gjallë, më aktiv, por, për sa kohë që komunistët nuk i çojnë masat përpara për realizimin e planit, roli i tyre udhëheqës nuk ka si të jetë aq i gjallë, siç u tha këtu.

U përmend këtu rastli i atij pensionistit nga Gjirokastra që kritikonte tregtinë e qytetit dhë që kishte përmendur edhe disa shembuj të tregtarëve të paraçlirimit. Ju, shokët me autoritet të Partisë e të pushtetit në rreth, duhet t'u thoni pensionistëve që, kur i kritikojnë këto të meta në dyqanet e shitjes, nuk prish punë se po përmenden edhe disa shembuj të mirë të ish-tregtarëve tanë të vegjël, të cilët i shitnin zarzavatet të freskëta. Ne duhet të përfitojmë nga eksperiencia e mirë e së kaluarës. Sigurisht pemëshitësit e paraçlirimit vepronin kështu se me këtë mënyrë i hidhnin xhepit më shumë para, por shitësi i pushtetit popullor duhet t'i bëjë shërbimet e duhura mallit, duke u nisur nga që-

Ilime shumë më të larta e fisnike që populli të hajë mirë, lirë dhe vazhdimisht.

Unë kam jetuar vetë në Gjirokastër, në kohën e Xhemali Shtinos dhe të Janaq Shkarpit¹. Küta, bashkë me lunxhiotët që shitnin deri edhe gorricat, ushqenin Gjirokastrën. Xhemali Shtinoja ose Janaq Shkarpi nuk linin asnje bimë t'u prishej. Si njëri, edhe tjetri ngrihen shin që në mëngjes, i ujitnin e i pastronin zarzavatet disa herë. Ata i freskonin prodhimet me kujdes, i ruanin dhe i qëronin. Sot, disa nga punonjësit tanë të tregtisë së frutave dhe të zarzavateve janë larg asaj që kërkohet. Ka akoma shitës që e konsiderojnë pasurinë sociale mall belik si dikur.

Sipas disa njerëzve, që janë kundër çdo gjëje të kohës së kaluar, qoftë edhe të mirë, gjithë eksperiencën e madhe që kanë kapitalistët në fushën e tregtisë dhe në disa drejtime të tjera, ne nuk duhet ta marrim, bile nuk duhet as ta zëmë në gojë. Po si mund të mos flasim e të mos përfitojmë nga eksperiencia e mirë botërore? Po automobilin, aeroplanin dhe shumë mjete të tjera, kush i ka nxjerrë, Qatoja²? Janë të arsyeshme këto?! Ne duhet të jemi realistë, të mësojmë dhe të përfitojmë shumë nga realizimet e mëdha të njerëzimit në fushën e ekonomisë, të shkencës, të teknikës etj. Për shembull, shokët folën këtu për rendimentet në bujqësi dhe përmendën sasinë e plehut që hidhet për hektar, sasi që nuk

1. Para Çlirimt ishin kopshtarë dhe tregtarë të perimeve dhe frutave në qytetin e Gjirokastrës.

2. Para Çlirimt ka qenë farkëtar në qytetin e Gjirokastrës.

është e paktë, po ta krahasojmë me atë që hidhet në vendet e tjera. Po a e dini amia sa grurë marrin jashtë, për çdo hektar, kur i hedhin fjala vjen 5 kuintalë pleh? Marrin jo më pak se 45 kuintalë, kurse te ne ndodh që hedhin afro kaq pleh dhe kënaqen me rendimente të ulëta. E ç'të keqë ka që t'i referohemi në këtë rast edhe eksperiencës së të tjerëve?! Edhe ato që thuhen se gjoja në zonat malore bima paska nevojë për 13 muaj kohë që të zhvillohet, janë llafë. Bota jashtë mbjell edhe gjer në 2 000 metra lartësi. Duhet gjetur se çfarë bimësh mund të mbjellim, që t'i përshtatemi klimës malore, cikleve. Ndoshta nuk duhet mbjellë grurë në lartësi të mëdha dhe të lihen patatet. Këtu u tha: «Nuk mund t'i mbjellim, se na zë bora dhe nuk ka kush i shkul!» Po sa metra mbi nivelin e detit është Shishtaveci? 1 600 metra. Në një lartësi të tillë duhet të mbillet medoemos patatja, ose bimë të tjera për ushqimin e kafshëve. Nuk mjafton të na thuhet se këto janë të drejta, kur në praktikë rezulton se nuk kuptohen sa duhet këto gjëra. Në qoftë se as misër, as patate, as foragjere nuk prodhohet në këto zona, atëherë edhe lopë nuk do të kemi në to. Të gjitha këto arsyetime mund t'i quash të drejta, por, po nuk u veprua sipas tyre, ato nuk mund të të nxjerrin në rrugën e dëshiruar.

Patate duhet të sigurojnë medoemos për shitje dhe për tëngrënë. Nuk mund të ecet me marshin 10 km në orë. Nuk është i drejtë ky qëndrim, sepse njerëzit në republikë shtohen dhe, natyrisht, shtesa e popullsisë rrit nevojat për të ngrënë.

Nuk mund të kënaqemi me atë sasi prodhimesh

që kemi marrë jo më 10 vjet përpara, por edhe këtu e 5 vjet më parë, ndryshe do të mbeteshim edhe pa bukë.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

PËR FUTJEN E BUJQËSISE NË RRUGËN E MODERNIZIMIT DHE TË ZHIVILLIMIT TË GJITHANSHËM TË SAJ

Fjala në Plenumin e 2-të të KQ të PPSH¹

20 qershor 1972

Jam dakord me raportin që u paraqit në këtë Plenum të Komitetit Qendror për bujqësinë, si edhe me diskutimet që u bënë rrëth këtij reporti. Siç shihet, detyra të rëndësishme e të shumta na vihen për ta çuar bujqësinë tonë përpëra, detyra të reja imediate e të perspektivës që ne duhet t'i kryejmë më mirë se deri tani për zgjidhjen e problemeve të rëndësishme që shtruam këtu.

Sigurisht ne kemi suksese nü bujqësi, çdo vit kemi bërë përmirësimë, prandaj nuk ka vend aspak përpesimizëm. Por, për të qenë realistë, nuk ka vend, gjithashtu, as për një optimizëm pa bazë, aq më tepër

1. Ky Plenum, që u mblohdh më 19-20 qershor 1972 diskutoi rrëth raportit të Byrosë Politike të KQ të PPSH «Të mobilizohemi me të gjitha forcat për të përgjithësuar sistematikisht eksperiencën e përparuar në frontin e prodhimit bujqësor».

për vetëkënaqësi. Vetëm fakti se, me gjithë rritjen e prodhimeve, planet e vendosura nuk realizohen dhe nevojat në rritje të popullit dhe të industrisë sonë nuk plotësohen, duhet të na bëjë të mendohemi më thellë, të punojmë, të mësojmë dhe të organizojmë akoma më mirë se deri tanë punët në bujqësi, që është baza e ekonomisë sonë socialiste.

Që ka vështirësi në bujqësi, këtë e dimë të gjithë. Këtë askush nuk mund ta mohojë. Shpeshherë thuhet se bujqësia është një «industri pa çati». Kjo është një figurë reale, me konsekuenca, por prapa saj në asnje mënyrë nuk duhet të fshihen të metat, padija, prapambetja, mungesa e organizimit dhe ruajtja e metodave të vjetra të kuptimit dhe të zbatimit të kërkesave të agroteknikës. Po nuk i thyem përfundimisht dhe vendosmërisht të gjitha këto dhe t'i zëvendësojmë sistematikisht me botëkuptime, me metoda shkencore dhe me formia organizative moderne, ecja jonë përparrë në këtë lëmë kaq jetik të ekonomisë do të na çalojë, ne do të kemi vazhdimisht telashe në sigurimin e prodhimeve bujqësore për popullin dhe në ngritjen e mireqenies së tij.

Agrikultura është një shkencë që ka bërë përparrime të mëdha, kurse te ne, për arsyet e njoitura, ajo ndodhet prapa. Sidomos në disa drejtime ruhen koncepte të vjetra, dije empirike dhe organizime primitive që nuk u përshtaten kushteve të jctesës aktuale, nevojave dhe shijeve në rritje të popullit. Megjithatë vendi ynë ka hyrë tanë në rrugën e një bujqësic të përparruar socialiste, por kjo kërkon nga ne përpjekje shumë të mëdha, të organizuara e të disiplinuara për të

konsoliduar atë që kemi fituar, për t'i zhvilluar më tej fitoret e arritura. Pa përpjekje të mëdha e të vazhduese shme përparimi nuk mund të vijë. Ky përparim do të vijë me punë të palodhur dhe me mësimi.

Të mësosh agrikulturën do të thotë të prodhosh mirë, të drejtosh mirë dhe të tregtosh mirë në format dhe në frymën e socializmit. Agroteknikën duhet ta mësojmë dhe ta zbatojmë shkencërisht dhe në mënyrë të organizuar. Kjo është e lehtë për ta thënë, por e vështirë për ta bërë si duhet. Empirizmin në bujqësi dhe në çdo proces të saj duhet ta zëvendësojmë me metodat shkencore dhe me dituritë shkencore. Me këtë, natyrisht, nuk kuptohet vetëm dituria libreske e shkëputur nga toka, nga bimët, nga kafshët, kjo përmban edhe eksperimentin shkencor rigoroz, pa të cilin nuk mund të ketë dituri agroteknike. Vetëm kjo e kthen bujqësinë nga një «fabrikë pa çati» në një «fabrikë me çati».

Disa çështje që unë do të ngrë nuk janë të panjohura. Për kundrazi Partia i ka thënë ato vazhdimisht. Por unë mendoj t'i ritheksoj shkurtimisht, pse mund të na shërbejnë për një punë dhe studim më të organizuar. Specialist i bujqësisë nuk jam, por detyrat që na ka ngarkuar Partia na kanë shtyrë të mësojmë dhe të preokupohemi çdo ditë e çdo vit për bujqësinë tonë, të mësojmë nga eksperiencia që ajo na jep, të mësojmë nga sukseset dhe nga gabimet tona në këtë sektor, të studiojmë dhe të mësojmë edhe nga eksperiencia e mirë e të huajve.

Hyrja e bujqësisë sonë në rrugën e modernizimit synon ngritjen e rendimenteve të bimëve të arave, të frutikulturës, rritjen e numrit të kafshëve etj., për të

plotësuar sa më mirë nevojat e njerëzve tanë. Ky zhvillim i ri has në kontradikta me të vjetrën dhe kërkon të afirmohet. Problemet lypin zgjidhje të drejta frontale dhe jo të shkëputura njëra nga tjetra, pse problemet bujqësore janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, ndikojnë për mirë ose për keq mbi njëra-tjetrën. Ujitja, për shembull, u bën mirë bimëve, ajo është jetike për to, por ujët e shumtë u bën keq. Nuk mund ta ndash zhvillimin e blegtorisë nga bujqësia, të mendosh për delen dhe të harrosh lopën dhe pulën, nuk ke as mish, as qumësht etj.

Në zgjidhjen e drejtë të këtyre problemeve hasim në kontradikta me të vjetrën, sikurse hasim në kontradikta tani me bashkimin e kooperativave, në lidhje me organizimin e ri e më të përshtatshëm të kulturave, që do të thotë largim sa më parë nga rritja e kulturave të shumta, që praktikohej përpara në ekonomitë private, të cilat u kthyen në një formë më të përparuar kur u bë kolektivizimi, por që tani kjo formë më e përparuar e ekonomisë bujqësore kolektive kërkon edhe një specializim më të përsosur, sepse këtë e do nevoja e zhvillimit, e ngritjes së rendimenteve dhe e faktorëve të tjera objektivë të tokës, të klimës, të progresit.

Shumë probleme lidhur me zhvillimin modern të bujqësisë ne jo vetëm që i kemi kapur, por kemi ecur edhe përpara, si për shembull në sistemin e tokave që u arrit si rezultat i bonifikimit në shkallë të gjerë të fushave, në mekanizimin e punimeve bujqësore, në zgjerimin e sistemit të ujitjes, në prodhimin dhe në përdorimin e plehrave kimike etj. Por, për cilindo nga këto probleme dhe për të tjera që rezultojnë prej tyre

ose që janë të varura nga ato, ne duhet të thellohem i për zgjerimin e dijeve dhe për format e përdorimit sa më të efektshëm, për të arritur rendimente të larta, për një bujqësi intensive. Jemi kështu në rrugën edhe të zhvillimit të mëtejshëm, por edhe të përmirësimit cilësor.

Në këtë vështrim problemi i pedologjisë, i studimit dhe i njohjes së tokave, është baza e çdo aktiviteti bujqësor. Duhet të dimë se për sa i përket njohjes së tokave te ne ka ekzistuar dhe ekziston akoma empirizmi. Kështu aktiviteti bujqësor, me gjithë përparimet e bëra, bazohet në këtë empirizëm tradicional që nuk mund t'i përshtatet më një bujqësie socialiste moderne, kulturave të reja, farërave të reja, metodave të reja të punimit, të plehërimit, të ujitjes dhe të kërkesave të tjera në rritje të bujqësisë. Nuk mund ta konsiderojmë më tokën si diçka në inerci dhe të mbajmë të njëjtat qëndrime dhe kuptime, siç mund të ishin në të kaluarën lënia djerrë e saj për disa vjet «për çlodhje» ose qarkullimet tri apo katërvjeçare. Këto nuk mund të jenë më të leverdishme në kohën e sotme të punimeve me traktorë, të plehrave kimike e të faktorëve të tjerë që kanë revolucionarizuar agrikulturën.

Toka nuk është më dhe nuk duhet lejuar të konsiderohet si diçka e panjohur. Pedologjia na e pasqyron gjendjen e tokës si në pëllëmbë të dorës. Ajo na mëson se toka është vendi ku takohen veprimet biologjike të provokuara nga rrënjet e bimëve, nga dekompozimi organik i materieve, nga mikroorganizmat dhe nga teknikat kulturore. Analizat fizike të tokave punonjësin e bujqësisë e vënë shkencërisht në dijeni, se argjilet, fjalë vjen, janë toka të rënda, të zorshme për t'u punuar,

ku edhe qarkullimi i ujit bëhet me vështirësi, ajri, gjithashtu, qarkullon me vështirësi. Tokat e mira ose lymoret punohen kollaj, uji dhe ajri në to qarkullojnë lirisht, ndërsa tokat ranore nuk e mbajnë ujin etj.

Duke i njojur vetitë e llojit të tokave, dihet gjithashtu se të gjitha masat agroteknike synojnë që tokës t'i përmirësojmë strukturën. Roli i veçantë i lëndëve organike për strukturën e tokës, si, për shembull, rrënjët e bimëve, kashta e grurit ose e misrit të grirë dhe c futur në tokë, plehërimi i gjelbër është element i rëndësishëm për pasurimin e tokës.

Këto që thashë më lart janë abëcëja e specialistëve të bujqësisë. Ata, veçanërisht për pedologjinë, dinë shumë gjëra të thella shkencore, ndërsa këto që përmendë unë, i gjen në manualin më të thjeshtë bujqësor. Por kam një qëllim tjetër pse i zura këto në gojë, pikërisht për të ardhur në atë që ne kemi tanë një hartë pedologjike dhe agrokimike të vendit, përgatitja e së cilës duhet të lavdërohet dhe për këtë meritë u takon atyre punonjësve të talentuar që punuan me vite të tëra në shi, në vapë e në të ftohtë për këtë hartë monumentale, busull orientuese aq e nevojshme dhe e domosdoshme për bujqësinë tonë.

Në bazë të kësaj pune u mobilizuan punonjësit shkencorë të bujqësisë, specialistët dhë punonjës të tjerë bujqësorë, të cilët ia filluan kudo në vendin tonë studimit pedologjik dhe kimik të parcelave të kooperativave. U krijuan laboratorë, të thjeshtë tanë në fillim, u përgatitën shpejt e shpejt edhe laborantë dhe puna në këtë drejtim po vazhdon.

Tani shtroj çështjen: Do ta çojmë ne deri në fund,

shkencërisht, në mënyrë të gjërë e të thellë, këtë problem bazë për bujqësinë, kaq të madh e të koklavitur, vazhdimisht në zhvillim e në transformim, apo do ta lëmë në mes të rrugës? Sigurisht të gjithë jemi dakord që ta çojmë deri në fund. Por vetëm me fjalë dhe me zotime kjo punë nuk kryhet. Disa ditë më parë lexova një artikull ku, ndërmjet të tjerash, shkruhej se ka dhe ndonjë kryetar kooperative bujqësore, i cili, kur punonjësit tanë shkencorë shkojnë për studimin në vend të këtij problemi, u thotë: «Ama edhe ju e gjetët kohën për këto punë, tani që po merremi me misrin...». Sikur këto punë nuk kanë të bëjnë me shtimin e prodhimit. Prandaj them se në këtë drejtim, si në çdo gjë e më shumë se në çdo gjë, puna duhet të organizohet seriozisht, të drejtohet shkencërisht, dhe të edukohen vazhdimisht me qindra e mijëra kuadro të bujqësisë për këtë çështje. Unë mendoj dhe propozoj që edukimi i këtyre kuadrove të merret mirë në dorë nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe nga organet e pushtetit në rrethe për arsyse se këta njerëz që do të merren me këtë punë nuk duhet të jenë dhe nuk duhet të mbeten laborantë të thjeshtë, por, në radhë të parë, të kenë njohuri të mira për bujqësinë. Me një kurs të thjeshtë nuk mund të kalohet, nuk mund të bëhen analizat, nuk mund të lexohet harta, nuk mund të interpretohen fenomenet e natyrës dhe të rekomandohen masat përkatëse.

Analiza e tokave shoqërohet vazhdimisht me një kërkim shkencor rigoroz dhe jo një herë e përgjithmonë, siç mund të mendojnë disa që këtë çështje e konsiderojnë të mbaruar një herë e përgjithnjë. Për të parë

hap pas hapi tokat ku është bërë analiza, atje duhet të hapet një hendek 50 cm i thellë, pingul brazdave, në mënyrë që të duken horizontet e tokës së mbjellë, përtë parë si shpërndahen rrënjet e bimëve, si qarkullon ajri dhe uji dhe ç'shenja kanë lënë veglat e punës. Duke i analizuar këto, specialisti i bujqësisë mund të përcaktojë teknikat kulturore që duhet të përdorë, sasinë e llojin e plehut që duhet të hedhë, nevojën e drenazhit, thellësinë e punimeve etj., etj. Duke i vëzhuuar të gjitha këto në mënyrë të vazhdueshme e shkencore, kooperativistët do të marrin masa që të përmirësojnë kushtet në të cilat do të zhvillohen bimët. Kjo ka rëndësi vendimtare.

Shumë veprime sot në bujqësi ne i bëjmë, por pa njojur plotësisht nevojat dhe arsyet. Të marrim për shembull ujitjen. Ne themi të mos ujitim me përmbytje. Mirëpo kjo u duhet shpjeguar shkencërisht kooperativistëve. Unë s'dua të bëj leksion, por fshatarët duhet të dinë shkencërisht se bimët nga pikëpamja organike përbëhen prej 90-95 për qind ujë. Nevoja për ujë është, pra, e përditshme për përbërjen e bimës, por edhe për evaporimin, për transpiracionin dhe për të gjitha ato transformime atmosferike që shkakton ky veprim. Pra, bima luan rolin e një mjeti komunikues në mes tokës dhe ajrit. Uji i vazhdueshëm dhe në masën e duhur është kështu i dobishëm, ndërsa uji i tepërt është i dëmshëm. Çështja e ujitjes është një dituri dhe art i vëçantë, që lidhet me njojen e tokës dhe të bimëve, pra, nuk mjafton të dish vetëm sa të hapësh e të myllësh hauzin.

Edhe përdorimi i plehrave kimike, i pesticideve

është i lidhur ngushtë me njohjen e tokës dhe të biologjisë së bimëve. Prandaj na vihet si detyrë imediate dhe serioze t'i zhvillojmë në mënyrë të organizuar shkencërisht këto probleme.

Ne rekomandojmë numrin e biniëvc për hektar që duhen mbjellë për çdo kulturë, shërbimet që u duhen bërë atyre, sasinë e plehrave që duhet t'i hidhet gjithse cilës etj. Ministri i Bujqësisë tha se për këto gjëra ne kemi edhe kodin agroteknik, edhe manuale speciale të veçanta. Bukur, këto i kemi, por nuk na lejohet të jemi dogmatikë dhe të arritmë në konkluzionin se, për këtë shkencë kaq të gjerë në zhvillim, na njaftojnë ato dijeni të pakta parimore që kemi dhënë, e që me siguri janë të pamjaftueshme. Duke pasur për qëllim që ta modernizojmë bujqësinë, udhëzimet që kemi dhënë e që po japim, duhet vazhdimisht t'i kontrollojmë e t'i ballafaqojmë me të dhënat e shkencës dhe të eksperimentimit shkencor. Vetëm duke marrë parasysh disa faktorë të rëndësishëm, siç kanë qenë dhe janë njohja jo si duhet e përbërjes së tokës, mungesa e sistemimit të saj si duhet, mosplotësimi i nevojave që ka toka për plehra dhe kripëra të shumëllojshme, mungesa e përmirësimit të vazhdueshëm dhe në mënyrë shkencore të strukturës së tokave etj., ne mund ta shikojmë kur doherë me sy kritik shkencor përcaktimin e shumë udhëzimeve që japim.

Unë nuk kërkoj idealen në zbatimin e shkencës agroteknike dhe jam për ato udhëzime që janë dhënë dhe jepen në bujqësi për bimët e ndryshme, por ngul këmbë në atë që këto udhëzime agroteknike t'u përshtaten të dhënavë shkencore, të cilat të bëhen dhe

të jenë të kuptueshme nga të gjithë punonjësit e bujqësisë. Ne luftojmë për ngjitje në bujqësi dhe në këtë ngjitje kërkojmë stabilitet në rendimente dhe jo sprapsje e luhatje shumë të ndjeshme. Pseve të shumta, që bëjnë punonjësit tanë akoma të prapambetur në çështjen e bujqësisë, duhet t'u jepet përgjigje me njohjen mirë, në praktikë dhe në teori, të të gjitha proceseve.

Në e dimë, dhe në raportin që u mbajt këtu, si dhe në diskutimet e shokëve, u dhanë shumë shembuj të shkëlqyer, se ka brigada dhe kooperativa që kanë arriput rendimente të larta në kultura të ndryshme. Kjo është jo vetëm e lavdërueshme, por edhe shumë inkurajuese për bujqësinë, gjë që tregon rrugën e drejtë nëpër të cilën duhet të ecim ne me vendosmëri dhe ç'rezerva të mëdha ka në bujqësinë tonë, të cilat është e domosdoshme t'i zbulojmë e t'i shfrytëzojmë si duhet. Sukseset e arritura nga punonjësit e pararojës të bujqësisë duhet të sistemojen në atë eksperiment shkençor aq të nevojshëm për shkencën agroteknike të vendit tonë, që lypset të shpërndahet e të zbatohet kudo.

Duhet të kuptojmë se faktori punë e kujdeshshme e punonjësve të dalluar të bujqësisë luan një rol shumë të madh, por edhe përpjekjet e tyre për njohjen në atë shkallë relative të dijeve agroteknike, që përmenda më lart, nuk duhen nënveftësuar. Sikur ne t'i nxitim dhe t'i ngremë vazhdimisht në një nivel akoma më të lartë diturie, këta njerëz do të bëjnë mrekulli. Por, kur flasim për njerëz të pararojës, kuptojmë se krahas tyre ka edhe të prapambetur, kur themi e reja ecën përpara, krahas saj është edhe e vjetra që na frenon. Mirëpo punonjësit e pararojës që janë shembull,

janë udhërrëfyes, janë akoma të paktë, kurse ne duhet të punojmë që të gjithë punonjësit e bujqësisë t'i ngrëmë që të ecin në rrugën e tyre.

Ne e dimë mirë të gjithë si e formuluam planin tonë pesëvjeçar, dimë, gjithashtu, si detajohet plani i kulturave dhe kërkesat e rendimenteve të tyre. Këto metoda më duket janë të drejta, janë përparimtare. Atëherë pse dalin gjithë ato arsyetime të pabazuara nga rrrethet dhe nga baza? A mos vallë nuk është vënë në dukje se realizimi i planit kërkon punë, kërkon organizim, kërkon aplikim, kontroll dhe shkencë? Jo vetëm është thënë, por është bërë e qartë se nuk ka tjetër rrugëdalje për të ngritur nivelin e jetesës së popullit.

Si mund t'i quajmë ata punonjës, ata kooperativistë, që jo vetëm nuk realizojnë planet në kulturat që përmenda, por me një mungesë përgjegjësie të madhe thonë: «Të na hiqet pambuku, të na hiqet orizi, të na hiqet lulëdielli» etj. Të gjitha këto kultura rriten në vendin tonë dhe rriten mirë, por vetveti këto nuk mbijnë. Na mungon eksperienca, thonë disa. Po ç'u bë eksperienca që na u dha në Shkodër e në Sarandë, nga e cila morëm një rendiment prej gati 90 kuintalë oriz për hektar, këtu në tokën dhe në klimën tonë? Këtë eksperiencë e mori era. Dhe fjalën nuk e kam vetëm për këtë eksperiencë, po për të gjitha eksperiencat e tjera të përparuara. Jo, shokë, kështu nuk mund të ecim përpara! As baza, as Ministria e Bujqësisë nuk lejohet që punët t'i lënë të ecin në këtë mënyrë. Çdo detyre, praktike dhe teorike, duhet t'i shkohet deri në fund. Çdo sukses duhet të konsolidohet dhe kurdoherë të punohet që të ecet përpara dhe jo prapa. Çdo eksperiencë

e përparruar duhet të zhvillohet më tej dhe të përhapet. Çdo copë tokë duhet studiuar e mbjellë me kulturat e përshtatshme dhe të shfrytëzohet racionalisht.

Bashkimi i kooperativave të vogla në ato më të mëdha ishte një hap përpara. Ky u bë me qëllim që, duke kombinuar në mënyrë të frytshme e racionale forcat dhe mundësitë natyrore të përbashkëta, nëpërmjet një pune të organizuar mirë nga çdo pikëpamje, ta çonin prodhimin edhe më lart e të rriteshin kështu edhe të ardhurat për ditë-punë të kooperativistëve. Në këtë drejtim janë bërë hapa përpara, por duhet të jemi realistë, jemi akoma larg një organizimi të shëndoshë dhe shfrytëzimit si duhet të mundësive të mëdha që ekzistojnë. Këtë e vërtetojnë vetë rezultatet e mira dhe ato jo të mira në brigada e në sektorë të ndryshëm të çdo kooperative.

Bashkimi i kooperativave në vetvete, pastaj në plan rrathi dhe republike, kërkon, përveç të tjerave, edhe rajonizimin edhe specializimin e bimëve. Por ky rajonizim dhe specializim duhet të kuptohet drejt nga punonjësit e bujqësisë në bazë dhe nga udhëheqësit e Partisë dhe të shtetit. Kuptimi i drejtë që duhet të ndjekim e të zbatojmë ne për rajonizimin e kulturave është ai që përmbush edhe me teprica rezervash nevojat e republikës për prodhime bujqësore të të gjitha llojeve. Këto prodhime do t'i bëjë toka jonë e studiuar imtësish në bazë të përbërjes së saj fizike dhe kimike, në bazë të regjimit të ujërave, të klimës, të rreshjeve, të lagështirës dhe të thatësirës, si edhe të një sërë faktorësh të tjera.

Çdo kulturë duhet të gjejë tokat e saj të përshtat-

shme dhe të mos mbillet me hamendje sikurse vendos në disa raste ndonjë kryetar kooperative pa pyetur as pedologun, as agronomin, as veterinerin apo zooteknikun.

Nga ky Plenum i Komitetit Qendror ne duhet t'u bëjmë thirrje komunistëve dhe gjithë punonjësve të bujqësisë që t'i duan, t'i respektojnë dhe t'i dëgjojnë me vëmendje këshillat që u japid teknikët dhe specia-listët e bujqësisë, të lartë e të mesëm. Ne i kemi në përgjithësi të mirë jo vetëm agronomët, por edhe zooteknikët e veterinerët, të cilëve në shumë raste nuk u vihet veshi. Harrojnë disa shokë se këta specialistë për punonjësit e bujqësisë janë pikërisht si mësuesi për nxënësin. Prandaj, në qoftë se flasim për shkencë, është e domosdoshme që njerëzit tanë të mësuar, të cilët janë që të gjithë të gatshëm të shkojnë për të dhënë kontributin e tyre nëpër ara, mes tufave të bagëtive e ku-do, të dëgjohen me kujdes të madh. Mbjellja e bimëve do t'ë bëhet duke marrë parasysh nevojat e republikës për prodhime, planin e shtetit si dhe prioritetin e bimëve që përcaktojnë orientimet. Ndryshe ka anarki në bimët e në prodhime, biem në pikëpamjet subjektive të disa drejtuesve dhe në interesat e ngushtë të kooperativave ose të çdo rrathi. Mbi këto baza duhet të gërs hetohen fort gjithë çështja agroteknike, përmirësimi i tokave, kullimi, plehërimi, ujitja, farërat e zgjedhura, mekanizimi i çdo lloji, fuqia punëtore etj. Kështu do të dimë, si nikoqirë të mirë, jo vetëm ku i kemi vendosur kulturat, por edhe ku duhet t'i vendosim, çfarë shërbimi duhet t'i bëjmë çdo kulture e çdo toke përkatëse, shërbimet biologjike për metabolizmin e bimës, ku duhet të përqendrojmë mekanizmat dhe fuqinë pu-

nëtore sipas nevojës, sipas rëndësisë, sipas stinës. Unë mendoj se duhet vendosur një disiplinë e fortë për këto çështje, të bënë këto një jetë e dytë për gjithë punonjësit e bujqësisë që të mund të kthehet kjo në një «industri me çati», pse ky duhet të jetë synimi ynë. Kjo do të thotë të kesh një bujqësi moderne, që të mos lihet në mëshirën e fatit, por të jetë në dorën dhe në mendjen e njerëzve tanë.

Dëshiroj të bëj disa vërejtje të përgjithshme në lidhje me farërat. Nuk mund të them se kemi mbetur në vend në këtë problem bazë të bujqësisë sonë. Edhe në këtë drejtim ne si kudo kemi ecur përpara, kemi arritur suksese dhe rezultate. Punohet me vullnet dhe jo pa kompetencë në këtë çështje, kemi dalë nga anarkia dhe nga spontaneiteti. Ne kemi krijuar institute të veçanta për farërat, për rritjen e prodhimit të farërave hibride dhe për kontrollin shkencor të tyre. Këto institute punojnë mirë, prandaj ne i përgëzojmë punonjësit e tyre, ata e meritojnë t'i falënderojmë dhe t'u urojmë akoma më shumë vullnet, pjekuri, dituri dhe disiplinë shkencore në këtë çështje, ku shprehja popullore «ç'do të mbjellësh, do të korrësh», shpjegon gjithë filozofinë dhe praktikën e kësaj pune. Por nö asnje mënyrë nuk na lejohet të mendojmë se e kemi zhdukur përgjithmonë anarkinë në këtë problem të madh, se kemi zhdukur rutinën, pikëpamjet e vjetra të bujqësisë që ndikojnë shumë në këtë drejtim, trajtimin burokratik nga ana e ndërmarrjeve të farërave dhe të vetë kooperativave. Të gjitha këto të meta mund të krijohen lëkundje dhe dyshim në trajtimin shkencor të pro-

blemit. Ne duhet të jemi shumë, shumë rigorozë në këtë çështje.

Ne kemi farëra vendi që janë ambientuar, por që japid rendimente të ulëta. Edhe këto farëra të vjetra të vendit ne duhet t'i ruajmë dhe t'i riprodhojmë, pse do të na duhen për krijimin e hibrideve tona. I tillë është rekondimi i veçantë i Ministrisë së Bujqësisë, por ne duhet të punojmë për të zgjeruar sidomos farërat e reja. Nuk është e thënë që të gjitha farërat e vjetra të zhduken nga fushat me dekrete nga lart. Kjo gjë duhet të bëhet në mënyrë të studiuar.

Por e ardhmja e farërave të drithërave u përket atyre që kemi sjellë nga jashtë e që japid rendimente shumë të larta, u përket hibrideve të importuara dhe atyre që prodhojmë e do të prodhojmë edhe vetë në vendin tonë. Ne kemi futur gjerësish në fushat tona një numër jo të vogël nga këto lloje farërash, si ato të grurit, të misrit dhe të misrit hibrid. Këto lloje farërash ne i kemi futur gradualisht, të detyruar edhe nga mungesa e fondeve në devizë të huaj, por i kemi futur gjithashtu pa i rajonizuar, sepse, e para, këto ishin shumë më rentabël nga farërat e vjetra dhe, e dyta, ishin më provë. Tani ne kemi fituar një eksperiencë më të madhe dhe rezultatet e kërkimeve shkencore na kanë armatosur që të bëjmë rajonizimin e farërave të grunjërave e të misrave, duke ndjekur parimet e përgjithshme që thashë më lart dhe ato speciale të specifikës së veçantë të çdo lloj fare. Unë jam dakord me atë që tha një diskutant, veçse kjo të mos bëhet në mënyrë të paorganizuar nga secila kooperativë bujqësore, por e drejtuar mirë, ndryshtë krijuhet anarki. Unë mendoj se

ka ardhur koha që kjo të bëhet në mënyrë më të studiuar e megjithatë prapë nuk do të jetë definitive, por do të na japë mundësi të krijojmë një stabilitet më të madh në rendimentet. Kur them nuk do të jetë definitive, kjo është dialektike, pse shumë nga këto farëra do të kërkojnë një kohë sa të ambientohen, do të bëjnë ndryshime sasiore dhe cilësore. Prandaj, me të gjitha këto masa, kujdesi në kërkimt shkencore të zhvillimit të tyre duhet të jetë vazhdimisht i madh.

Trajtimi i farës duhet ngritur me forcë, si një problem nga më të rëndësishmit e bujqësisë sonë, pse në çdo hallkë të këtij trajtimi vërehen të meta e gabime serioze, veçanërisht dua të theksoj në hallkën kryesore, vendimtare: në fushë, në irritje, në korrje dhe deri në depozitimin e farës nga kooperativistët, si dhc nga kuadrot e specialistët. Unë nuk do t'i numëroj këto se ju i dini të gjithë, por ngre çështjen se duhet të merren masa serioze që të zhduket indiferentizmi që na bën ta konsiderojmë dhe ta trajtojmë drithin për farë, si dhe çdo lloj fare tjetër, njëlloj me atë që hamë.

Gjithashtu ne duhet të marrim veçanërisht masa të rrepta që ndërmarrjet e farérave të mos kthehen më, sikurse janë kthyer, në dyqane ku shiten penjë e spango. Në to duhet të vendoset kontrolli shkencor rigoroz i ruajtjes, i shpërndarjes dhe i tregtimit. Fara duhet ruajtur kudo në kushtet e përshtatshme që kërkon ana biologjike e saj dhe, kur hidhet në fushë, t'i bëhen të gjitha shërbimet, siç thamë, të mbylllet cikli dhe të rifillojë ai si duhet. Këto janë masa të domosdoshme që do ta kthejnë bujqësinë tonë në një «industri me çati».

Për të gjitha këto probleme janë krejt të pamja-

tueshmë masat e përgjithshme dhe dituritë e sipërfaqshme. Për zgjidhjen e tyre me sukses kërkohet thellimi, aplikim dhe zbatim serioz e i vendosur në gjithë vargun e proceseve.

Në qoftë se i kemi vënë rëndësi agrikulturës, në qoftë se bëjmë kujdes dhe kemi rezultate në drejtim të saj, nuk mund të themi se i kemi vënë të njëjtën rëndësi edhe blegtorisë, degë kjo shumë e rëndësishme dhe jetike për bujqësinë tonë. Në këtë sektor, shokë, ne po ecim me ngadalë, pse na pengon e vjetra, nuk kemi mundur as seriozisht, as shkencërisht ta kapim dhe ta zhvillojmë si duhet këtë sektor. Orientimet nuk i kemi aspak të gabuara dhe në ato ndërmarrje shtetërore e kooperativa bujqësore ku janë kuptuar mirë nga punonjësit dhe nga drejtuesit, këto orientime janë zbatuar mirë dhe kanë dhënë rezultate të shkëlqyera, që janë bërë shembull dhe rrugërrëfyes për të gjithë. Por pjesa më e madhe e punonjësve të këtij sektori nuk ecën si duhet në këtë rrugë.

Rëndësia ekonomike e rritjes dhe e zhvillimit të lopës ka filluar të kuptohet mirë kudo; edhe në kooperativa janë arritur rezultate të mira në përmirësimin e racave. Shteti ka bërë dhe vazhdon të bëjë investime të konsiderueshme në këtë drejtim, por, megjithëkëtë, ka vetëkënaqësi të palejueshme, pas së cilës fshihen të meta serioze në trajtimin e lopës që e pengojnë këtë të japë maksimumin e mundshëm të prodhimit. Vetëkënaqësia është e rrezikshme, ajo shkakton që të ngelim kurdoherë në deficite përpëra nevojave në rritje të popullsisë, që edhe kështu furnizohet në sasi të vogla në vit me prodhime blegtoriale.

Për delen dhe për dhitë mund të themi se nuk jemi në rregull. Ka rënie dhe nuk është arritur përmirësimi i nevojshëm që kërkohet. Kjo vjen se direktivat e lëshuara në këtë drejtim e që janë të drejta, nuk janë kuptuar si duhet, ato nuk janë zbatuar mirë, sidomos për dhitë, janë zbatuar keq.

Fushata e madhe për përmirësimin e racës së deles nëpërmjet ndërimit artificial, investimet e konsiderueshme që u bënë, nuk u justifikuan, nuk dhanë rezultatet që pritnim, pse e vjetra s'na shqitet, ajo është kryenece. Ne ngelëm në 40-45 kilogramë qumësht në vit për dele dhe mezi kemi arritur të marrim 1,70 kilogram lesh për kokë, pa lëre pastaj çështjen e mishit që na shkakton kokëçarje të mëdha. Megjithatë edhe në këto prodhime ka shembuj shumë të mirë, si për qumështin, për leshin, ashtu edhe për mishin.

Për sa u përket dhive, direktiva e Partisë nuk është kuptuar drejt, bile ka njerëz të cilët mendojnë që, po të jetë e mundur, të zhduket kjo «murtajë». Ta kuptosh kështu direktivën është e gabuar. Dhia nuk është «murtajë», po një kafshë me vlerë, që, po t'i bësh shërbimin e duhur, të jep 150-250 kilogramë qumësht në vit, kurse djathi i prodhuar me qumështin e saj është nga më të mirët. Mishi e lëkura e dhisë janë, gjithashtu, të dobishme.

Por, sigurisht, po të mos tregohet kujdes, dhia i démon ton pyjet. Pikërisht kjo e ka shtyrë udhëheqjen të lëshojë udhëzime për të qenë të vëmendshëm në këtë drejtim. Një shok këtu diskutoi shumë drejt për problemin e kullotës së dhive. Por sa vende kemi ne akoma ku dhia mund të ushqehet fare mirë pa bërë asnjë

dëm dhe të vihet kështu në shërbim të njerëzve? Për çdo lloj kafshe që rritim, ne duhet të shikojmë leverdinë ekonomike, por t'i krijojmë këto leverdi dhe të mos skartojmë para kohe njëren, pa e zëvendësuar mëtjetërën që është më ekonomike, që jep prodhim me cilësi më të mirë e më të lirë, por edhe në sasinë e nevojshme për të cilën kanë nevojë populli dhe republika.

Kështu është çështja edhe për derrin, me rritjen e të cilit ne kemi ecur ca përpara, por jemi akoma larg asaj që duhet të arrijmë. Ne prodhojmë mish derri me kosto të lartë, pse mundësitet e mëdha që ekzistojnë nuk i shfrytëzojmë plotësisht. Sa vende pjellore kemi ne për prodhim patatesh, që na rrinë djerrë, me pretekste se janë zona malore e na i zë bora, se nuk transportojmë dot prodhimet e të tjera e të tjera arsyen. Atëherë le të çojmë atje derra dhe t'i rritim me këtë prodhime. Këtë nuk e bëjmë dhe preferojmë më mirë t'i hamë lopës ushqimin në fushë ose koncentratin palllogari, jashtë çdo norme.

Të mos flasim pastaj për pulat, ku jemi për faqe të zezë. Shokë, kështu si po ecim, nuk mund të sigurohet sasia e nevojshme e mishit dhe e vezëve. Ne duhet të krijojmë të atilla kushte që të mos kemi më nevojë për ato kokrra vezë që prodhohen në oborret e kooperativistëve. Ekonomikisht është jashtëzakonisht e dëmshme për një vend si yni, me tradita blegtoriale, të sjellë me devizë mish pule dhe vezë nga jashtë.

Prandaj patjetër duhet ta kthejmë fytyrën seriozisht edhe nga blegtoria. Në qoftë se në drithërat e bukës dhe në bimët industriale ne i jemi futur një revolucion i të madh, duhet të bëjmë e të zhvillojmë, gjithçka

thashtu, një revolucion po aq frytdhënës edhe në sektorin e blegtorisë.

Bujqësi pa blegtori nuk ka, por po ta shikosh se si zhvillohet te ne ky binom, atëherë do të dalë se nuk veprohet si duhet, nuk i vihet sa duhet rëndësi blegtorisë. Ne flasim për foragjeret, për kullotat, për konvejerin e gjelbër dhe në fakt punohet për to, por në krahësim me mundësitë që kemi, jemi akoma larg asaj që duhet të realizojmë.

Kullotat tona s'kanë nevojë vetëm t'u qërohen gurët, të spastrohen nga ferrat apo të ndërtohen në tolera, megjithëse as këto punë nuk bëhen mirë dhe në masë të mjaftueshme. Sipërsfaqet e tokave të kullotave tona nuk përtërihen kurrrë ndonjëherë me farëra të reja të ushqyeshme, nuk shohim të mbillen në to leguminoze ose tuberkula të përshtatshme për ushqimin e kafshëve. Ne arrijmë bilc deri atje që për 50 hektarë pyll të ri në Malin e Gjerë të Gjirokastrës, siç më kanë thënë, ndalojmë kullotjen e bagëtive në të tjerë sipërsfaqen tjetër të këtij mali.

Ushqimet për bagëtinë jo vetëm janë të pakta, por në përgatitjen e tyre ekziston prakticizmi i vjetër, domethënë injoranca e bujkut të vëtmuar të dikurshëm, që s'kishte as forcë, as mundësi t'i siguronte kafshiës ushqimet e nevojshme. Ne rrojmë në socializëm, prandaj ashtu sikurse luftojmë për të përmirësuar dhe zgjatur jetën tonë, ashtu duhet të interesohemi edhe për kafshët shtëpiake, pse këto u shërbejnë pikërisht njerëzve, pse forcat dhe prodhimet e tyre vihen te ne në shërbim të jefës së njerëzve.

Por kafsha ka nevojë për sasi të caktuara njësish ushqimore, për minerale, për azote, për elemente të tretshme, për vitamina etj., etj. të cilat ajo i merr në-përmjet ushqimeve që i japim, ndërsa njeriu të gjitha këto elemente të domosdoshme për jetën i merr të përgatitura nga prodhimet që na jep kjo «makinë» e gjallë. Edhe në këtë drejtim, duke përdorur figurën «makinë» ose «fabrikë» për lopën, për shembull, kjo duhet të kuptohet në *sens figuré*; lopët nuk duhen trajtuar njëlloj sikurse i trajtojnë shumë herë, ato nuk janë standard, pse secila ka individualitetin e saj, moshën, do sasinë e ushqimit të përshtatshëm, trajtim të posaçëm zooveteriner etj., etj.

Nga bisedat me punonjësit e bujqësisë kam pasur shumë herë përshtypjen sikur veterinaria, zooteknija dhe bujqësia kuption si të shkëputura. Agronomi, zootekniku dhe veterineri s'mund dhe nuk duhet të ndahen kurrë nga njëri-tjetri, pse edhe po të kërkosh ndarje në mes tyre, në realitet nuk mund të gjesh vëçse disa ndarje shumë të holla. Zootekniku duhet të jetë njëkohësish edhe agronom. Edhe veterineri nga ana e tij duhet të jetë zooteknik dhe agronom. Të tria këto profesione kanë të bëjnë me fiziologjinë e kafshëve, me gjenetikën e tyre, me ushqimin e tyre, me rritjen, me teknologjinë dhe me sëmundjet e tyre.

Prandaj, shokë, përparrë kemi një problem serioz për ta zgjidhur si duhet, problemin e blegtorisë. Ky problem nuk duhet copëtar, nuk na lejohet që nga një anë të marrim masa për të përmirësuar blegtorinë në kooperativa, nga ana tjetër të lëmë pas dore bagëtitë

e oborreve që përbëjnë një sasi kolosale prodhuese dhe një kapital të madh gjenetik për përmirësimin e të cilave ne duhet të marrim masa.

Bagëtia e oborreve duhet ushqyer njëloj si ajo e kooperativave dhe të punojmë që edhe ajo të prodhojë me rendiment të lartë. Këto bagëti janë të kooperativistëve, ashtu sikurse janë edhe lopët e tjera pasuri e përbashkët. Vendimi i Partisë që kooperativisti ta ruajë dhe ta shifrytëzojë këtë oborr dhe kafshët që rrit në të, është i drejtë. Ky oborr është një nevojë për kooperativistët dhe një lehtësim për shtetin socialist. Gjithë toka dhe mjetet e punës janë kolektivizuar, fshatarësia jonë kooperativiste ecën në rrugën revolucionare. Në i kemi lënë sot çdo kooperativisti oborrin dhe kafshët personale jo që të bëhet matrapaz, bile në kushtet revolucionare të vendit tonë s'ka asnja rrezik që ai të bëhet i tillë, por se gjykojmë që akoma ka nevojë për to. Kështu kooperativisti me anën e tyre ndihmon në shtimin e prodhimit dhe për furnizimin e vet. Mirëpo nevoja e ekzistencës akoma të oborrit nuk kuptohet si duhet nga disa, bile ka edhe nga ata që japid urdhra të dënueshëm për therjen e bagëtive të oborreve. Duhen marrë masa ndaj njerëzve të tillë. T'i therësh bagëtitë, për arsyen se nuk bëhen përpjekje për t'i ushqyer, është krim: të vazhdojmë të therim me metodën e skartimit dhe jo me metodën e majmërisë, edhe kjo është shumë e dëmshme, se na lë pa bagëti dhe popullin pa mish.

Kur morëm masat e fundit për ngushtimin e oborreve, këto i shoqëruam me udhëzimin e qartë, sipas të cilët toka e fituar nga këto oborre të punohej në më-

nyrë të shoqërizuar dhe prodhimet t'u ndaheshin kooperativistëve. Këtu ishte çështja e shfrytëzimit më intensiv të këtyre tokave. Kjo direktivë nuk u kuptua drejt dhe çdo gjë hyri në planin e kooperativës. Siç dëgjojmë, nga ky fond toke kooperativistët në shumë raste s'po marrin gjë.

Për kafshët e oborreve janë dhënë, gjithashtu, orientime të drejta se si të organizohen bashkërisht, ndërsa shpenzimet e prodhimet të ndahen respektivisht në bazë të sasisë së krerëve që mbeten pronë personale e familjes kooperativiste. Edhe kjo formë e drejtë ka mbetur në mes të rrugës. Atëherë vihet pyetja: Ku do të kullosin këto bagëti të oborreve? Është e kuptueshme se kooperativistët duhet ose t'i therin, ose t'i shesin, ose t'i kullosin vjedhurazi në arat e kooperativës.

Ne hoqëmi shpërblimin me prodhimet në natyrë dhe i zëvendësuam me lekë. Kjo ishte një masë e drejtë, por kemi thënë me kusht që me ato lekë fshatari të gjejë prodhime për të blerë dhe sidomos nga ato që prodhon edhe vetë kooperativa. Psikologjia e fshatarit dhe e cilitdo kërkon që prodhimet bujqësore të shpërndahen në përpjesëtime më të drejta midis qytetarëve dhe fshatarëve. Prandaj unë ritheksoj edhe një herë se problemi i furnizimit të kooperativistëve me artikujt bujqësorë që ai i prodhon vetë duhet të shikohet më seriozisht, të kuptohet dhe të merret më seriozisht në dorë nga kooperativat dhe nga organet shtetërore.

Në bazë të gjithë këtij problemi të madh është nxitja e prodhimit në të gjitha degët e bujqësisë, por pëngritjen e prodhimit nuk lejohet të përdoren disa forma

dhe të harrohen të tjerat, sikurse janë furnizimi në rregull e në masën e duhur i fshatarëve që përbëjnë shumicën e popullsisë së vendit tonë.

Ndërmarrjet bujqësore dhe kooperativat bujqësore të tipit të lartë, që ne kemi filluar të krijojmë, duhet absolutisht të prodhojnë me rendimente shumë të larët dhe me kosto të lirë. Këto tani përmbledhin një fond tokash të konsiderueshme, nga të cilat duhet t'i sigurojnë shtetit një pjesë të madhe të prodhimeve bazë kryesore përfurnizimin e qyteteve të mëdha dhe të qendrave të punës. Kjo do ta lehtësojë fshatin jo që të mos prodhojë, përkundrazi të prodhojë më shunië, se një gjë e tillë do të lehtësojë furnizimin e tij me prodhime bujqësore, do t'i furnizojë edhe teprica reale e të mëdha shtetit.

Nuk lejohen më dotacione ose planifikim me humbje në ndërmarrjet bujqësore e në kooperativat bujqësore të tipit të lartë dhe as që duhet që në këto të fundit të fillojnë punën, duke përcaktuar rrogat dhe pagat, duke prerë pemët frutore ose duke prishur shtëpitë ekzistuese përfundit të ndërtuar shtëpi të reja, por duhet filluar më parë nga organizimi, nga puna në prodhim dhe nxitja e saj. Të ardhurat, rezultatet, do të përcaktojnë nivelin e jetesës së anëtarëve, rrogat etj.

Këto kisha përfundit të thënë, shokë. Tani na mbetet të punojmë më mirë, t'i vëmë më mirë në jetë vendimet e Plenunit të Komitetit Qendror dhe direktivat e Kongresit. Këtë e kemi përdetyrë të dorës së parë dhe përfundit tonë do të jetë nderi më i madh përpara popullit, përfundit të realizuar ato me sukses. Unë, ashtu

sikurse edhe ju, kam bindjen e plotë se ne do t'i realizojmë detyrat e planit pesëvjeçar edhe në bujqësi.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha,
«Raporte e fjalime 1972-
-1973», f. 134*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Raporte e fjalime
1972-1973», f. 134*

FITORJA ËSHTË GJITHNJE ME POPUJT QE LUFTOJNE PER LIRI

Nga biseda me Norodom Sihanukun

23 qershor 1972

Në radhë të parë, zoti Kryetar i Shtetit dhe Kryetar i Frontit të Bashkuar Kombëtar të Kamboxhias, dëshiroj t'ju falënderoj për ardhjen në vendin tonë. Me këtë rast dua t'ju shpreh ndjenjat e singerta e gjëzimin që kemi sot midis nesh një delegacion nga Kamboxia, si dhe admirimin e madh që kemi për popullin heroik të Kamboxhias, për luftën heroike çlirimtarc, që ai bën kundër imperializmit amerikan dhe shërbëtorëve të tij me tradhtarin Lon Nol në krye.

Është e vërtetë se gjeografikisht popujt tanë janë larg nga njëri-tjetri, por, megjithatë, ata i afiron e kaluara e tyre pothuaj e njëllojtë. Të dy popujt tanë kanë vuajtur gjithmonë nga armiqjtë e jashtëm, të cilët kanë pasur si qëllim t'i pushtonin, t'i shtypnin, t'i skllavëronin e t'i mashtronin. Por ata nuk janë dorëzuar, ata kanë luftuar gjithnjë heroikisht kundër armiqve.

Ne kemi respekt të veçantë për popullin tuaj, për kulturën e tij të lashtë dhe të gjerë. Më kujtohet se, kur isha student, 42 vjet më parë, në shtetin që kishte kolonizuar vendin tuaj, në Francë, populli i së cilës ka një kulturë tradicionale të gjerë, vizitova një eksposítë mbi Kamboxhian, hapur në atë kohë në Paris. Mbeta i habitur, sepse nga shumë objekte, kuptohej, midis të tjera sh, vitaliteti dhe niveli i lartë kulturor i popullit tuaj që në kohët nië të lashta.

Në qoftë se nuk gabohem ju vazhdoni t'i ruani e t'i zhvilloni traditat e lashta të pasura kulturore të popullit khmer. Natyrisht nga e kaluara ne duhet të ruajmë gjithçka të mirë, duke bërë përpjekje për ta përshtatur, që ajo t'i shërbejë sa më shumë së tashmes e cila, me gjithë vështirësitë që i dalin, është me perspektivë, e ndritur. Akoma më e mirë do të jetë e ardhmja e popujve, që luftojnë kundër shtypjes, kundër agresorëve të jashtëm apo reaksionarëve të brendshëm, të çfarëdolloji qo'shin këta. Sido që të bëhet, populli nuk mund të mposhtet, pa lëre që të zhduket. Këtë e vërleton edhe ekzistencia e popullit tonë.

Populli shqiptar ka vuajtur shumë gjatë shekujve. Në truallin e tij kanë shkelur romakët, që e plaçkitën dhe u përpoqën ta zhduknin. Por e kundërtat ngjau, qenë romakët ata që u zhdukën nga trualli ynë e jo shqiptarët, të cilët vazhdojnë të luftojnë, të punojnë e të jetojnë edhe sot në tokën e tyre amtare. Në Shqipëri erdhën njëri pas tjetrit barbarët e mesjetës, më vonë osmanllinjtë, që e mbajtën gati 500 vjet të pushtuar. Çfarë nuk bënë ata për ta zhdukur popullin shqiptar, por së fundi u shporrën nga toka jonë. Në kohët e më-

vonshme erdhën këtu serbët e grekët, austrohungarezët, francezët e italianët. Gjatë Luftës së Dytë Botërore ishin hordhitë e Musolinit dhe të Hitlerit që pushtuan Shqipërinë dhe u përpoqën ta zhduknin popullin shqiptar, por ua mbathën këmbëve për vete, kurse populli ynë ja ku është, ai jeton i lumtur dhe në vëllazëri e në miqësi me gjithë popujt e tjerë, duke përfshirë edhe popullin e Kamboxhias.

Eshtë shumë pozitive që sot populli kamboxhian lufton kundër pushtuesve amerikanë, për të ndërtuar një jetë më të mirë pas çlirimt. Unë e çmoj politikën realiste që ndiqni në këto momente të vështira lufte, që po kalon populli juaj, duke qëndruar së bashku e të lidhur ngushtë me të. Pikërisht në lidhjet me popullin qëndron forca jonë.

Edhe populli shqiptar ka njojur mbretër e princër që kanë qenë me të ose kundër tij. Në vendin tonë në shekullin e 15-të ka jetuar Gjergj Kastrioti, mbret i Shqipërisë, i cili nga brezi në brez mbahet mend, admirohet dhe respektohet nga të gjithë. Atë e respektojnë edhe sot të gjithë, komunistë dhe jokomunistë. Po pse respektuhet dhe kujtohet edhe sot Gjergj Kastrioti me një admirim kaq të madh? Sepse ai ishte një princ i lidhur ngushtë me popullin e vet, jetonte për popullin e me popullin. Kur ishte akoma i vogël, Gjergj Kastriotin e çuan skllav te sultani Murati, që ishte mjaf dinak. Meqenëse i ngjiste shumë në zgjuarsi dhe trimëri Aleksandrit të Madh (ky ka qenë me origjinë ilire nga nëna, trim dhe inteligjent), sultani e quajti Skënderbej Gjergj Kastriotin. Skënderbeu kishte dashuri të thellë për popullin e vet. Ditën kur u kthyte në

Krujë ai iu drejtua popullit me këto fjalë plot besim në të: «Lirinë nuk jua solla unë, atë e gjeta këtu, midis jush». Ai u lidh shumë ngushtë me masat e popullit shqiptar dhe e çlroi vendin nga sundimi otoman.

Gjatë një çerek shekulli Skënderbeu u bë jo vetëm mbrojtës i popullit dhe i atdheut të vet, por edhe i Evropës. Nën udhëheqjen e tij, Shqipëria u bë barrierë e pakapërcyeshme për ushtritë otomane që synonin të kalonin në Perëndim. Megjithëse lufta e tij u shërbeu shumë vendeve të Evropës, të gjithë krerët e këtyre vendeve, e në radhë të parë papa i Romës që e hiqte veten përkrahës të Skënderbeut, e tradhtuan. Atë e tradhtoi edhe nipi i tij. Vetëm populli nuk e tradhtoi, dhe ai jetoi i rrethuar nga dashuria e madhe e njerëzve të thjeshtë, duke luftuar për të 25 vjet me radhë derisa vdiq. Ja përsë nga një brez në tjetrin prijësi ynë, Gjergj Kastrioti, kujtohet me respekt të madh nga populli shqiptar dhe gjzon popullaritet të gjerë edhe jash-të kufijve të vendit tonë. Me këtë doja të thosha se bashkimi me popullin ia rrit forcën, e bën udhëheqësin të pamposhtur, ndërsa shkëputja nga populli është vdekjeprurëse për të.

Ne kemi pasur edhe një mbret tjetër, Ahmet Zogu, që u shit tek imperialistët dhe më së fundi edhe te diktatori fashist italian, Musolini. Kur Italia fashiste sulmoi Shqipërinë, Zogu ua mbathi këmbëve dhe e la popullin në mjerim, sepse s'kishte besim tek ai. E afërt dhe e dashur për popullin tonë u bë Partia Komuniste e Shqipërisë, sot Partia e Punës e Shqipërisë, që u themelua më 1941. Ajo e udhëhoqi popullin tonë me guxim

në Luftën heroike Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe e çoi në fitore.

Ne, komunistët, flasim gjithnjë hapur, themi gjithnjë të vërtetën, edhe po të jetë e hidhur. Por veç duhet pasur parasysh se ka dy lloj komunistësh. Ka nga ata me maska, që në fakt janë tradhtarë të komunizmit. Të tillë janë revisionistët modernë. Janë pastaj komunistët e vërtetë që udhëhiqen nga filozofia marksiste-leniniste. Duke i kushtuar kujdes përvetësimit të kësaj filozofie, ne, komunistët e vërtetë, përpiqemi të bëjmë sa më pak gabime dhe në rast se bëjmë, i njohim ato dhe i korrigojmë, kurse ata që e heqin veten komunistë nuk i korrigojnë kurrë gabimet që bëjnë. Gjersa nuk veprojnë sipas filozofisë sonë, gjersa shkelin parimet e saj, ata nuk mund të janë komunistë të vërtetë.

Sot, kur revolucioni ecën përpëra dhe popujt luftojnë për një jetë më të mirë, nuk mund të ndahet çështja e popullit nga përpjekjet dhe lufta e patriotëve dha e komunistëve, që janë në një krah me popullin. Bashkimi i tyre në një front luftë kundër armiqve është i domosdoshëm.

Eksperiencia jonë u tregon të gjithëve se nō kemi pasur dha kemi kurdoherë respekt të madh për ata që, edhe pse nuk kanë qenë dhe nuk janë komunistë, kanë luftuar dhe luftojnë për çështjen e popullit. Në vendin tonë ne jemi lidhur ngushtë me ata që s'janë komunistë, por që janë patriotë dhe e kanë dashur dha e duan popullin me gjithë shpirt, duke e treguar këtë dashuri me vepra, duke kryer me ndër detyrat ndaj popullit dhe atdheut. Prandaj në vendin tonë, komunistët e patriotët që nuk janë komunistë nuk janë ndarë asnjëherë

nga njëri-tjetri. Në Shqipëri ka pasur dhe ka shumë patriotë të tillë, që kanë luftuar dhe janë gati të vdesin njëlloj si komunistët nö lustë, për mbrojtjen e interesave të popullit. Me këtë dua të them se ata që luftojnë për çështjen e popullit me besnikëri, që bashkohen me të, mundohen për interesat e tij dhe ia kanë kushtuar jetën atij, qofshin komunistë ose jo, nuk mund të mos jenë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin.

Mbi historinë e popullit tuaj, unë kam lexuar libra ku kam parë se mjaft përparime ishin arritur në Kamboxhia, në industri, në kulturë e në arsimin kombëtar, gjer para grushtit të shtetit. Bile ka pasur nü vendin tuaj sektorë që kanë nisur nga hiçi dhe kanë arritur rezultate të mira. Këto rezultata nuk u kanë pëlqyer armiqve.

Natyrisht, thirrja juaj drejtuar popullit kamboxhian në vitin 1970 për t'u ngritur në këmbë kundër imperializmit amerikan, kundër tradhtarit Lon Nol dhe bandës së tij, është një akt me rëndësi për luftën e popullit tuaj. Gjersa ky popull është i vendosur dhe po lufton, imperialistët amerikanë nuk do të fitojnë nü Kamboxhia. Ne bëjmë gjithçka për të ndihmuar luftën e popullit kamboxhian me ato mundësi që kemi dhe të jeni të sigurt se te populli ynë i vogël ai do të vazhdojë të ketë një mik besnik që do të jetë gjithmonë me të në luftën për çlirimin e plotë të atdheut të vet dhe për ndërtimin e jetës së re në Kamboxhia.

Ju e dini vetë, ashtu siç e dimë edhe ne, se lufta që po bëjnë e duhet të bëjnë sot popujt kundër imperialistëve amerikanë dhe revizionistëve sovjetikë, është e domosdoshme. Ata që nuk e kuptojnë, ose bëjnë sikur nuk

e kuptojnë këtë nevojë, jo vetëm e kanë gabim, por herët ose vonë do të pësojnë pasojat e rënda të qëndrimit të tyre dritëshkurtër. Politika e imperialistëve amerikanë është një politikë agresive, barbare, ajo është, gjithashtu, një politikë dinake dhe mashtruese që u përshtatet koniunkturave, ajo është politika e ujqve që janë gati të të hedhin kthetrat për të të mbytur.

Ka politikanë në botë si Titoja e disa të tjera që e quajnë veten komunistë, e paraqesin veten si pjesëtarë të «botës së tretë», të shteteve «të paangazhuara» etj. Ata sot kërcejnë si akrobatë në tel, sa nga një krah në tjetrin, por herët a vonë, me siguri, si rezultat i qëndrimeve të tyre jo të vendosura dhe të paqarta, do ta pësojnë.

Ne e kuptojmë politikën e bashkekzistencës paqësore jo siç e predikojnë revizionistët sovjetikë me bandat që u shkojnë pas. Ne e dëshirojmë këtë bashkekzistencë vetëm me kusht që të respektohen e të garanthonen të drejtat e popujve. Ne e dëshirojmë bashkekzistencën paqësore po që se udhëheqësit e vendeve janë të bashkuar dhe luftojnë me të vërtetë për të mirën e popujve, ndryshe ajo është blof.

Ne kemi qenë dhe jemi të kujdeshshëm e vigjilentë ndaj kursit të revizionistëve modernë, sepse i kemi vuajtur pasojat e tij, e kemi provuar mirë dhe jemi «dje-gur» prej tij. Prandaj Partia jonë tanë, siç na mëson populli, «mat shtatë herë dhe pret një herë». Ajo ndjek një politikë të drejtë, të vendosur, e thotë kurdoherë pa druajtje pikëpamjen e saj, pa u merakosur aspak se çfarë do të thonë armiqtë, nëse u pëlqen atyre apo jo. Ne e dimë se ata janë kundër nesh, por kjo

aq na bën, mjaft që miqtë e singertë të jenë në anën tonë. Ka njerëz që thonë: «Sa të çnendur janë shqiptarët me këto qëndrime të tyre!». Por ne nuk jemi të tillë, ne jemi realistë dhe nga armiqtë nuk mund të presësh veçse shpifje të këqija, prandaj kemi marrë të gjitha masat për t'i dalë përpëra çdo të papriture, çdo komploti që mund të kurdiset nga ana e tyre. Në qoftëse ata nesër do të sulmojnë vendin tonë, jemi të bindur se do të fitojmë. Sigurisht do të kemi edhe humbje, në luftë kjo është e pashmangshme, por fitorja do të jetë jona.

Disa na bëjnë tani komplimente, megjithëse nuk u pëlqen qëndrimi ynë. Kur u çliruam pati shtete kapitaliste që nuk deshiën të na njihnin. Ne nuk i pranuam kushtet që na vunë për të na njojur atëherë edhe imperialistët amerikanë. Që nga ajo kohë ne u lamë lamtumirën dhe me ta as kemi pasur dhe as kemi marrëdhënien. Bile më mirë kemi jetuar pa ta. Edhe tani ata na bëjnë propozime, na afrohen, por harrojnë se për 28 vjet rresht janë sjellë keq me ne. Ne qëndrojmë kryelartë që s'kemi lidhje me ta dhe nuk frikësohemë prej tyre, sepse jemi të vendosur dhe të sigurt në rrugën tonë. Kështu do të ndodhë edhe në Kamboxhia, në Laos, në Vietnam e kudo gjetkë, ku armiqtë imperialistë synojnë të nënshtrojnë popujt ushtarakisht, politikisht dhe ekonomikisht.

Izraeli ka bërë agresion kundër vendeve arabe dhe gjëzohet që hëpërhë ka pushtuar disa pjesë të këtyre vendeve. Është e qartë se prapa tij fshihet dora e dy superfuqive, të cilat, duke qenë kundër lirisë së popujve arabë, po bëjnë gjithçka që është e mundur për të.

vendosur sundimin e tyre të plotë në Lindjen e Mesme. Por, siç tregojnë faktet, ato përpiken të krijojnë vatra zjarri, jo vetëm atje, por kudo në botë, prandaj politikisht janë diskredituar në sytë e popujve.

Ne jemi në miqësi me popujt e Vietnamit, të Laosit, të Kamboxhias, me klasën punëtore dhc me patriotët në të gjitha vendet e botës. Në këto kushte nuk mund të përtypet propaganda false që bëjnë armiqtë, sipas së cilës Shqipëria ndjek një politikë që e ka vënë në izolim. Nuk është aspak kështu. Ne nuk jemi të izoluar. E vërteta është se ne kemi miq kudo në botë, bilc të fuqishëm. Duke i bërë mirë llogaritë, del se jemi ne që kemi shumicën, forcën, sepse jemi ne, popujt që bëjmë fuqinë. Pra, të izoluar janë armiqtë tanë, të cilët velëm armët kanë. Por çfarë kanë arritur ata me armët e tyre në Kamboxia dhc në Vietnam? Ata kanë hedhur shumë bomba, kanë përdorur lloje të ndryshme armësh, por rezultati shihet, fitorja është gjithnjë me popujt e këtyre vendeve që luftojnë për liri, kudo në botë vëmi re se ka një zhvillim të madh të lëvizjeve nacionalçlirimtare.

Detyra jonë është t'i demaskojmë pa hezitim imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë. Duke vepruar kështu, do të shohim se herët ose vonë ata do të pësojnë disfatë, pasi revolucioni ecën përpara dhe bën që popujt të fitojnë. Është një fatkeqësi për ata njerëz që akoma nuk e kuptojnë këtë, përkundrazi janë të lumi-tur gjithë patriotët, militantët, njerëzit përparimtarë që e kuptojnë qartë perspektivën e zhvillimit botëror dhe bashkohen me luftën për çështjen e popullit, për çlirimin e njerëzimit nga imperialistët gjakatarë.

Ne, shqiptarët, mendojmë se lufta që bën populli juaj e rrit admirimin e njerëzve për të, sepse ai lufton edhe në kushte jo të favorshme nga pikëpamja e armatimit dhe e furnizimit. Për sa i përket «ndihmës» sovjetike, ju keni vetë eksperiencë në këtë drejtim. Por mund t'ju them se hruščovianët edhe ne na konsideron si miqtë e tyre të ngushtë, por kjo ishte hipokrizi nga ana e tyre. Koha provoi se ata janë armiq të betuar, se kanë kryer akte shumë të poshtra dhe të tmerrshme kundër nesh. Duhet mjaft kohë që të numërohen e të tregohen të gjitha ato, aq shumë janë.

Prandaj edhe ju mos mbani shpresat te ndihma materiale e revisionistëve sovjetikë, bile edhe po t'ju jepin, mendimi ynë çshtë të mos e pranoni, se ajo është helm. Ashtu si kanë vepruar kundër jush imperialistët amerikanë, ashtu veprojnë dhe revisionistët sovjetikë. Amerikanët ju sulmuant dhe sovjetikët jo vetëm nuk e ngritën zërin, por mbajnë akoma përfaqësinë e tyre diplomatike në Phnom-Pen. Ata takohen shpesh me njëri-tjetrin, e ndihmojnë dhë i kanë kriuar kushte kliks kukull të Lon Nolit. Kur Kamboxhia ecte në rrugën demokratike përparimitare, imperialistët amerikanë bënin gjithçka që ishte e mundur për ta ndarë e copëtuar atë, të shtinin në duart e tyre ekonominë kamboxhiane, duke dashur që Kamboxhia të ishte satelite e tyre. Por kur kjo nuk u doli, atëherë kurdisën grushtin e shtetit.

Revisionistët sovjetikë hiqen si miqtë tuaj të sin-qertë, por në fakt ata nuk janë miq të popullit kamboxhian. Po të ishin të tillë, përsë nuk e kanë tërhequr ambasadën e tyre nga Phnom-Peni? Prandaj mos u besoni atyre që punojnë t'i përgatitin varrin popullit tuaj,

që duan t'ju vrasin. Ata nuk bëjnë asnjë dallim nëse jeni princ apo komunist, mjafq që nuk bëni siç duan ata, prandaj ju luftojnë e do t'ju luftojnë. Vetëm në qoftë se ju do t'u nënshتروheni imperializmit amerikan dhe revizionizmit sovjetik, ata do të jenë me ju e do t'ju lënë të qetë, por të jeni të bindur, jo për një kohë të gjatë, por për aq kohë sa të forcojnë pozitat e tyre e pastaj do t'ju kurdisin ndonjë komplot tjetër dhe t'ju rrëzojnë. Ndërsa komunistët e vërtetë nuk bëjnë veprime të tillë, ata janë shumë të singertë dhe atë që kanë në zemër e thonë haptazi.

Populli juaj lufton me të gjitha forcat kundër imperialistëve amerikanë, prandaj populli ynë e priti me kë-naqësi ardhjen e delegacionit tuaj në Shqipëri. Populli ynë e konsideron popullin kamboxhian si vëlla, e njeh mirë luftën që bën ai. Veprimet e qeverisë suaj më 1970, siç janë thirrja për luftë dhe bashkimi i popullit, janë me rëndësi të veçantë. Bashkimi brenda vendit i të gjitha forcave patriotike, është rruga e vetme për të shkuar drejt çlirimtë të shpejtë të atdheut. Edhe në kuadrin e Indokinës, bashkimi luftarak i të trë popujve të gadishullit ka rëndësinë e vet. Kjo është shumë sinjifikative dhe përbën një disfatë të madhe politike për imperializmin amerikan, për qeverinë e Lon Nolit, dhe për të gjitha kukullat e Sajgonit. Lufta e madhe dhe sakrificat e shumta, që bën populli kamboxhian, janë njëkohësisht një ndihmë e madhe që ju u jepni vëlle-zërvë vietnamezë.

Vizitën tuaj e kemi pritur prej kohësh, prandaj jemi të gëzuar që më së fundi ndodheni midis nesh. Do të bëjmë gjithçka që, gjatë ditëve të qëndrimit në vendin

tonë, ju të merrni kontakt me popullin e të njiheni me realizimet e tij në punë. Me këtë rast i urojmë fitore të shpejtë dhe përfundimtare popullit vëlla heroik kamboxhian kundër imperializmit amerikan dhe tradhtarit Lon Nol e kompani!

Botohet për herë të parë sipas shënimave të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

POLITIKA JONE NISET NGA INTERESAT E LARTE TË POPULLIT

Nga biseda me një përsaqësues të PK të Kamboxhias

24 qershor 1972

Pasi u përshëndet me mikun e ardhur nga Kamboxhia, shoku Enver Hoxha zhvilloi me të një bisedë të sinqertë.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirëseerdhët në vendin tonë! Partia dhe populli ynë i janë mirënjojës popullit tuaj që ju dërgoi për një vizitë në Shqipëri. Ne jemi shumë të interesuar të dimë pér gjendjen e luftës në Kamboxhia.

Ne, gjithashiu, dëshirojmë t'ju vëmë në korent të zhvillimit të gjendjes në vendin tonë, nën udhëheqjen e Partisë së Punës. Ambasadori ynë na ka vënë në dijeni pér të gjitha kërkesat tuaja, prandaj ne jemi gati të vëmi në dispozicion nga shokët më të mirë të Partisë sonë, që janë specialistë pör ato probleme pér të cilat keni kerkuar t'ju flasin. Ata janë gati t'u përgjigjen pyetjeve që mund t'u bëni ju, me qëllim që ato që dëshironi të dini në kuadrin e eksperiencës së Partisë sonë, të jenë të qarta. Gjithashiu edhe ju, me vërejtjet tuaja do të na ndihmoni ne në punën tonë.

Ne mund t'ju themi që në fillim se eksperienca e

Partisë sonë nuk është shumë e madhe, pse jemi një vend dhe një parti e vogël, prandaj ne kemi nevojë të marrim dhe të përfitojmë nga eksperiencia e partive motra. Natyrisht, ngjarjet janë zhvilluar dhe zhvillohen ndryshe në Shqipëri e ndryshe te ju, por, duke u mbështetur në parimet e marksizëm-lenismit, ne mund të adaptojmë një vijë politike dhe ideologjike të drejtë, sipas kushteve e rrethanave të secilit vend.

Për shumë gjëra që kërkoni ju nga eksperiencia jonë, do t'ju flasin shokë, anëtarë të Komitetit Qendror të Partisë sonë, prandaj unë do t'ju them pak fjalë vetëm për Frontin tonë Nacionalçlirimtar. Në këtë organizatë ne pranuam gjithë ata patriotë që ishin kundër pushtuesit të huaj, bile në radhët e saj erdhën edhe pasues të mbretit Zog dhe përsaqësues të tij. Ne u bëmë thirrje të gjithëve të hidheshin në luftë bashkë me ne kundër pushtuesve fashistë. Në fillim ata hezituan, por ne u thamë, në qoftë se jeni me të vërtetë kundër Italisë fashiste, sikurse deklaroni, bashkohuni me ne për të luftuar kundër pushtuesve, ndërsa punën e mbretit, nëse do të ketë apo jo, e zgjidhim pas Çlirimit. Gjithashtu u thamë që edhe karakterin e shtetit të ardhshëm do ta përcaktojë vetë populli pas Çlirimit. Për të tërhequr njerëzit në luftë, në shtatmadhorinë e Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare futëm edhe shefin e mëvonshëm të «partisë» së zogistëve, Abaz Kupin. Ne e njihnim që ai ishte agjent i Zogut dhe i anglezëve, por e futëm në Front, në mënyrë që ata, të cilët kishin akoma simpati përmbrëtës, të shikonin që pasues e përsaqësues të tij bënin pjesë në gjirin e Frontit dhe të bashkoheshin me ne. Me kohë qëndrimet tradhtare të Abaz Kupit gjatë

luftës, ne i demaskuam. Eksperienca jonë tregon se mund të ketë edhe elementë ose grupe të tillë jashtë, po edhe brenda Frontit, që dëshirojnë, me flamurin e mbretërisë tradicionale, të mbajnë njëkohësisht edhe flamurin e luftës kundër pushtuesve të huaj. Por ne këtë e kemi mbajtur parasysh.

Mbreti Zog në Shqipëri ishte njeri shumë i urryer nga populli. Zogu ishte me plot kuplinin e fjalës një kriminel, jo vetëm kundër komunistëve, por edhe kundër fshatarëve, kundër gjithë popullit. Në kohën e tij në vendin tonë nuk kishte shkolla, as spitale, asgjë të mirë nuk kishte. Prandaj popullit i kishte ardhur zemërimi në majë të hundës. Megjithatë Partia jonë, që kishte për qëllim të udhëhiqte Lustën Nacionalçlirimtare, për të ruajtur unitetin në mbarë popullin tonë, i pranoi zogistët në Front, ndonëse kishte shumë njerëz në popull që thoshin «si të bashkohemi ne me zogistët për të luftuar?». Ne u përgjigjeshim këtyre vërejtjeve, se aleancë me njerëzit e Zogut nuk kemi bërë, por në Front pranojmë të gjithë njerëzit, pa dallim feje, krahine dhe ideje, të gjithë ata që janë për luftë kundër pushtuesve. Në këto kushte neve na vihej detyra t'i tërhoqnim në anën tonë, të rritnim forcën e Frontit Nacionalçlirimtar dhe, për të pasur suksese në këtë vijë, duhet të kishim durim të madh politik.

Komunistët janë njerëz të singertë dhe kur vendosin të ndjekin një politikë, këtë nuk e bëjnë si opor tunistë, po duke u nisur nga interesat e lartë, nga çështja e shenjtë e popullit.

Vrulli i luftës së popullit i nxjerr me siguri çdo ditë e më shumë në shesh intrigat e fuqive të mëdha

kapitaliste dhe imperialiste, revolucioni në ecje e sipër nxjerr në dritë kalbëzimin e madh kapitalisto-imperialist, prandaj njerëzit që kanë të zhvilluar në njëfarë shkalle dashurinë për atdheun e tyre, që kanë njëfarë nderi, qoftë edhe në frymë borgjeze dhe personale, nuk mund të mos revoltohen kundër fuqive imperialiste dhe do të reflektojnë për rrugën që duhet ndjekur. Por për ne mbreti Zog ishte element që nuk mund t'i besoje për asgjë. Ne, kur krijuam Frontin tonë Nacionalçlirimtar gjatë kohës së luftës, nuk kishim përcarje në radhët e tij. Në vendin tonë pati një reaksion kundërrevolucionar që hodhi parulla kundër nesh, kundër Frontit tonë. Ishte kryesisht organizata reaksionare e Ballit Kombëtar, që me fjalë thoshte se donte bashkimin e popullit në një front, por jo me Frontin Nacionalçlirimtar.

Në Shqipëri pesha e fesë nuk ka qenë shumë e madhe, por edhe aq sa ka qenë, Partia jonë nuk i preku sentimentet e njerëzve që besonin te feja, përkundrazi, ne u përpoqëm që t'i neutralizonim klerikët, me qëllim që të mos vepronin kundër komunistëve. Kjo bëri që shumë prej tyre të thonë që komunistët nuk janë të këqij, ata luftojnë pushtuesit dhe tradhtarët e vendit. Populli ynë nuk u ka besuar feve të ndryshme që kanë ekzistuar te ne. Në vendin tonë ka pasur myslimanë, ortodoksë e katolikë, udhëheqësit fetarë të të cilëve kanë qenë në përgjithësi të lidhur me pushtuesit e huaj. Mbeturinat e fesë, megjithatë janë akoma të forta edhe te ne. Edhe pse kemi luftuar e luftojmë vazhdimisht kundër saj, mbeturinat e fesë herë pas here shfaqen përsëri, ku më shumë e ku më pak, prandaj me njerëzit

ne bëjmë kujdes dhe zhvillojmö një punë të madhe edukative.

Të gjitha këto janë probleme që duhet t'i shqyrtojmë mirë e me kujdes të madh, t'i peshojmë si duhet dhe të gjejmë rrugëzgjidhen më të përshtatshme, pa braktisur parimet e marksizëm-leninizmit, përkundrazi t'i kemi kurdoherë parasysh këto dhe t'i zbatojmë në kushtet e vendit në situata të ndryshme, me qëllim që ato të mbeten të paprekura, pse armiku përpinqet të kapë gishtin, pastaj dorën dhe me radhë gjithë trupin.

Me armiqtë ne s'jemi pajtuar kurrë. Me udhëheqjen jugosllave, për shembull, jemi në kontradikta të papajtueshme ideologjike. Titoja është një tradhtar i marksizëm-leninizmit, po ai është dhëpër e vjetër, politikan shumë dinak. Qëllimet e tij janë shumë të errëta. Ai është me amerikanët, ndjek politikën e tyre dhe shpreson të arrijë të bëjë një politikë të madhe edhe me të tjerë. Një politikë të pabesë u përpoq të bënte ai dhe me ne, por nuk i doli me sukses.

Titoja ka deklaruar se është për bashkekzistencën paqësore, megjithatë ne nuk do ta ndalojmë kurrë polemikën ideologjike me të dhe me gjithë revisionistët e tjerë. Partia jonë e ka dënuar vijën e krerëve revolucionarë që u mblodhën në Moskë, ka dënuar e ka demaskuar njëkohësisht edhe Titon. Në një fjalim të mbajtur kohët e fundit ai pohoi me gojën e vet se Jugosllavia është kthyer në një skandal ndërkombëtar, se në partinë e tij bëjnë pjesë me shumicë elementë joproletarë dhe për këtë jugosllavët nuk kanë sy e faqe të dalin përparrë botës. Megjithatë Titoja nuk e dëshiron polemikën që zhvillojmö ne tanë në shkallë ndërkombëtare. Kur

ne botuan artikullin e fundit kundër revizionizmit modern, revisionistët jugosllavë nuk thanë asgjë kundër nesh dhe këtë e bëjnë se duan të mos krijojnë situata të vështira me ne, përpiken «të na bindin» ne dhe botën se ato janë histori të së kaluarës që nuk duhen përsëritur!

Partia jonë mendon se komunistët e vërtetë janë në gjendje të bëjnë çdo gjë. Ne kemi deklaruar se edhe malet do t'i transformojmë e t'i bëjmë pjellore si edhe fushat. Por neve na duhet të luftojmë me armiq të shumtë, deri edhe me mbeturinat e së kaluarës dhe kjo është një luftë e përditshme që duhet të bëjmë deri në fitoren tonë të plotë, në ndërtimin e komunizmit.

Ne ju falënderojmë shumë për gjithçka dhe gëzohemi që ju jeni të interesuar për të përsituar sadopak nga eksperienca jonë modeste. I falënderoni shumë shokët nga ana e Komitetit Qendror të Partisë sonë.

Duke marrë fjalën, përfaqësuesi i PK të Kambozhias, ndër të tjera tha:

Fjalët Tuaja, shoku Enver, udhëheqës i madh i popullit shqiptar, janë për ne një mbështetje e madhe inkurajuese në luftën që bëjmë për çlirimin e vendit. Ne ju shprehim respektin tonë të madh. Ne e konsiderojmë Partinë tuaj një parti të vërtetë marksiste-leniniste, shembull në luftën kundër revizionizmit modern...

SHOKU ENVER HOXHA: Faleminderit shumë. Mirupafshim!

Botohet për herë të parë me shkurtime sipas shënimave të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

SHQIPERIA NDJEK KURDOHERË NJË POLITIKË TË PAVARUR

Nga biseda me Norodom Sihanukun

27 qershor 1972

Kjo bisedë u zhvillua në darkën që shtroi Norodom Sihanuku për udhëheqësit e Partisë e të shtetit tonë me rastin e vizitës së tij në Shqipëri.

Pasi princi Sihanuk falënderoi për pritjen e ngrohtë që iu bë kudo ku shkoi në vendin tonë, e mori sfalën

SHOKU ENVER HOXHA: Ardhja e delegacionit, që kryesoni ju, e ka forcuar më tej miqësinë midis dy popujve tanë. Ne e vlerësojmë akoma më shumë vizitën tuaj në Shqipëri. edhe për faktin se ju keni ardhur në momente të vështira për popullin tuaj, i cili po zhvillon beteja të mëdha për çlirimin e vendit. Ky moment nuk mund të harrohet nga ana jonë.

Ne e ndiejmë se nuk kemi bërë sa duhet për luftën çlirimtare të popullit kamboxhian. Detyra jonë është të bëjmë më tepër, ta ndihmojmë atë akoma më shumë. Prandaj do të vëmë të gjitha forcat dhe mundësitetë që t'ju mbështetim më fuqimisht, si në planin ndërkomb-

bëtar, ashtu edhe për forcimin e lidhjeve midis dy vendeve tona, nëpërmjet një propagande më të madhe që mund të bëjmë për luftën e drejtë të popullit kamboxhian. Ne do të shkruajmë vazhdimisht artikuj në mbështetje të kësaj lufte të lavdishme, që po bën e do të bëjë gjer në fund populli juaj kundër imperialistëve amerikanë.

Është detyrë e të gjithë popujve që të ngrihen në luftë kundër këtyre armiqve vdekjeprurës për ta. Çështjen e luftës së popujve kundër armiqve të tyre, ne e konsiderojmë si çështjen tonë të përbashkët. Disa nuk e kuptojnë këtë ose nuk duan ta kuptojnë, megjithëse kjo është një nevojë jetike për të gjithë. Bashkimi i popujve në luftën kundër imperializmit është një fitore shumë e madhe për ta.

Populli ynë është i vogël, megjithatë ai e thotë hapur atë që mendon, prandaj ne, shqiptarët, kemi tërhequr vazhdimisht vëmendjen e opinionit ndërkombëtar me qëndrimet tona. Ka në botë nga ata që janë dakord me këto qëndrime, por ka edhe të tjerë që nuk janë dakord, megjithatë të gjithë na dëgjojnë me kujdes për ato që themi, sepse flasim hapur.

Propaganda amerikane dhe e shumë të tjerëve bërtet se shqiptarët janë satelitë të kinezëve. Këtij avazi armiqtë tanë i kanë rënë prej shumë kohësh, por tani nuk u beson më njeri. Sot të tjerë e dinë që Shqipëria nuk ka qenë dhe nuk është shtet satelit, por shtet që ndjek një politikë të pavavarur.

Të luftosh kundër imperializmit është një ndërmarrje politike e madhe. Ju nuk jeni marksist-leninist, por me qëndrimin tuaj të tanishëm ndaj imperializ-

mit, jeni radhitur në anën e njerëzve përparimtarë.

Imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë në shumë gjëra janë dakord me njëri-tjetrin, por midis tyre ekzistojnë edhe kontradikta të forta dhe këto pikërisht për sferat e influencës. Ata luftojnë kush e kush të fitojë më shumë pozita dhe me çdo kusht përpinqen të zaptojnë tregjet botërore. Por ne e dimë se kjo do të thotë që popujt e tjerë të jetojnë nën skllavërinë e tyre. Sot ka ardhur koha që popujt nuk durojnë më të jetojnë në skllavëri. Prandaj ata luftojnë me guxim në fushën e betejës për të fituar të drejtën të jetojnë si njerëz. Kush mund ta merrte me mend në të kaluarën që vende si Vietnam, Kamboxhia apo Shqipëria të përballonin me vendosmëri të rrallë, për vite të tëra me radhë, luftën kundër një armiku të madh, bile të fitonin kundër armiqsh të egër e gjakatarë?!

Rëndësi ka që këtë vendosmëri ta tregojnë të gjithë dhe për këtë duhet punuar. Ju do të shkoni nesër në Algjeri. Atje do të gjeni një popull trim, të zgjuar dhe me tradita lufstarake. Në kemi marrëdhönje të mira me popullin algjerian dhe me të gjithë popujt e tjerë arabë, të cilët janë popuj heroikë dhe kanë histori të lashtë. Ju e shikoni çfarë kurdisin sot të dyja superfuqitë, imperializmi amerikan dhe revizionizmi sovjetik, në kurriz të këtyre popujve. Ato përpinqen të vendosin dhe të forcojnë ndikimin e tyre në vendet arabe. Sovjetikët dhe imperialistët amerikanë janë të pabesë, ata u kanë grabitur vendeve arabe të gjitha të mirat. Mendjmë se, nga këto vende, Algjeria mban një qëndrim më të vendosur. Edhe Dë Goli e kuptoi se nuk mund të ecte më në rrugën e vjetër me algjerianët.

Unë mendoj se aktualisht, megjithëse avionët nuk i kanë më pak modernë se avionët amerikanë, egjiptianët nuk janë në gjendje të bëjnë një luftë rezultative në dobi të tyre, sepse avionët që kanë marrë, pilotohen nga sovjetikët.

NORODOM SIHANUK: Më kujtohen fjalët që ju më thatë kur u takuam për herë të parë bashkë¹. Ju thatë se shumë fise e hordhi barbare e kanë shkelur dhe plaçkitur Shqipërinë, por të gjithë ata, sado të fuqishëm që kanë qenë, janë zhdukur, sepse populli shqiptar guxoi të luftojë deri në fitore për mbrojtjen e atdheut. Kush nuk vendos të japë jetën për atdheun e shkelur nga i huaji, atij shpejt i vjen fundi, sepse mund të zhdukesh më lehtë kur nuk lufton. Kush nuk guxon të marrë armët, të luftojë, por shkon në sallat e bisedimeve me imperialistët amerikanë dhe sovjetikë, me mendimin se do të fitojë, ai ka mbaruar. Kjo do të ishte një punë e kotë.

SHOKU ENVER HOXHA: Imperialistët në bisedime nuk të jepin asgjë, prandaj ne kurrë nuk duhet të çarmatosemi, këtë na mëson eksperiencia shekulllore e popullit tonë dhe e popujve të tjerë.

Do t'ju tregoj një ngjarje nga të vitit 1912, atëherë kur ne sapo kishim fituar pavarësinë kombëtare. Kiske në atë kohë patriotë shqiptarë demokratë, që e donin me gjithë shpirt lumturinë e popullit dhe që mbështeteshin në popull, i cili atëherë nuk ishte i organizuar si duhej, ashtu siç është sot. Dy patriotë të shquar shqiptarë shkuan me një delegacion në Londër për t'u

1. Shih në këtë vëllim, f. 203.

takuar me lord Grein, për t'i shprehur protestën për padrejtësinë që po i bëhej vendit tonë në Konferencën e Ambasadorëve duke lënë jashtë kufijve të shtetit gjysmën e territorit të vet. Para se të hynin në zyrën e ministrit të Jashtëm britanik, oficeri që rrinte para hyrjes, kur pa shqiptarët, iu drejtua atij që ishte më shtatmadh dhe me kobure në brez: «Më duhet t'ju çarmatos, sepse si rregull nuk lejohet të hysh i armatosur». Shqiptari, për të qenë brenda rregullave e «dorëzoit» armën. Pas takimit ministri i tha atij që i morën armën, Isa Boletinit: «Më në fund, zoti Boletini, atë që s'e kanë bërë dot pashallarët turq, e bëmë ne, këtu në Londër». Isai ia kuptoi hilen dhe iu përgjigj: „Jo, besa, kurrë, as edhe në Londër», dhe i nxori pistoletën tjetër që e kishte fshehur në gji.

Zakonisht, në darka të tilla, kur flitet nga ne kundër revisionistëve sovjetikë, anëtarët e trupit diplomatik të vendeve revisioniste që janë të akredituar në Tiranë, ngrihen e ikin, por sonte shoh që nuk po largohen. Ata nuk skuqen, se janë në rrugën e tradhtisë. Ja, kohët e fundit, Podgorni shkoi fshehurazi në Vietnam. Dhe përse shkoi? Me siguri për t'u bërë presione e shantazhe shokëve vietnamezë, për t'u servirur atyre pikëpamjet e Niksonit, për të gjunjëzuar popujt e Vietnamit, të Laosit e të Kamboxhias. Për këtë nuk na ka folur asnjeli, por e marrim me mend, se kemi eksperiencë, e njohim mirë sytyrën e vërtetë të revisionistëve.

Imperialistët amerikanë ndodhen në situata të vësh-tira në Indokinë, prandaj bëjnë çështë e mundur për të ruajtur atje një bërthamë të tyre për të ardhmen. Fja-

limi që mbajtët ju sot¹ ishte i drejtë, prandaj ne jemi dakord me sa deklaruat. Populli kamboxhian duhet të bashkohet i téri dhe do të bashkohet me siguri me Frontin e Bashkuar që mbron interesat e tij kombëtarë.

NORODOM SIHANUK: Në miting unë thashë se anëtarët e Frontit të Bashkuar Kombëtar, të qeverisë sonë dhe forcat e armatosura, që janë brenda vendit, më kanë ngarkuar t'ju siguroj se ne nuk do të pranojmë kurrë asnje kompromis dhe zgjidhje politike nëpërmjet bisedimesh me armiqtë tanë. Zgjidhja e vetme e çështjes së pavarësisë sonë do të arrihet në fushën e betejës.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo është politika më e drejtë dhe më e vendosur që duhet të ndiqet.

NORODOM SIHANUK: Shembull i madh për këtë është Shqipëria që mbështetet në forcat e veta. Edhe ne kështu duhet të veprojmë për të siguruar çlirimini kombëtar dhe të mos futemi në bisedime.

Pasi princi Sihanuk foli për punën që bëhej në Kamboxhia për ruajtjen e vlerave muzikore popullore, për ruajtjen e trashëgimisë kulturore të popullit, sfalën e mori përsëri

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe ne në vendin tonë kemi mbledhur të gjitha vargjet dhe këngët popullore, kemi regjistruar muzikën e popullit, se janë shumë të bukura, kemi fotografuar, gjithashtu, kostumet e vjetra popullore. Kjo punë është bërë duke shkuar

1. Në mitingun e organizuar nga Këshilli i Përgjithshëm i Frontit Demokratik të Shqipërisë dhe këshilli i Frontit Demokratik të rrethit të Tiranës më 27 qershor 1972 në Tiranë.

deri në fshatrat më të largëla sepse e vlerësojmë që gjithë kjo trashëgimi përbën një thesar të madh popullor.

Para disa javësh ne bëmë edhe një konferencë për folklorin¹. Fluam me këtë rast edhe shqiptarë që jetojnë në trojet e veta në Jugosllavi. Ne kemi kufij të përbashkët me Jugosllavinë, mirëpo përtej kufijve tanë në Lindje e në Veri, ekziston një popullsi e madhe shqiptare, si rezultat i padrejtësive të Traktatit të Londrës. Me shqiptarët që jetojnë në Jugosllavi, kemi vajtje-ardhje. Ne i japim një ndihmë të madhe Universitetit shqiptar në Prishtinë, dërgojmë atje çdo vit profesorë të universitetit tonë për të dhënë leksione. Kjo ndihmon shumë në përmirësimin e marrëdhënieve tona me popujt e Jugosllavisë.

Ne kemi ndjekur gjithnjë një politikë të drejtë ndaj Jugosllavisë, kurse politika jugosllave ndaj Shqipërisë ka qenë shoviniste. Ideologjikisht ne nuk jemi dakord me klikën e Titos. Fakti që atje janë rreth 2 milionë shqiptarë, të cilët shtypen egërsisht, vërleton më së miri se udhëheqësit jugosllavë nuk janë në pozita të drejta. Por politika jonë ndaj tyre ka qenë kurdoherë korrekte. Pas Çlirimt ne kishim marrëdhënie të mira me Jugosllavinë, pastaj Titoja bëri atë që dihet botërisht kundër nesh. Pas Çlirimt unë shkova vetë në Beograd, u takova me Titon dhe në një rast, duke biseduar, ai më bëri pyetjen: «Çfarë mendon, ti, shoku Enver, për Ko-

1. Është sfala për Konferencën e Parë Kombëtare të Folkloristikës Shqiptare, që zhvilloi punimet e saj në Tiranë nga 26 deri 27 maj 1972.

sovën?». Unë iu përgjigja: «Meqenëse më kërkonin mendim, po ju themi se Kosova e vise të tjera ku banojnë shqiptarë, janë toka shqiptare dhe si të tilla i përkasin dhe duhet t'i kthehen Shqipërisë. Ekzistenca e tyre jashlë kusijve të atdheut përbën një padrejtësi të madhe, që i është bërë Shqipërisë nga fuqitë e mëdha e që duhet ndrequr. Ne jemi dy vende socialiste dhe kushtet që kjo çështje të zgjidhet drejt, tashmë ekzistojnë». «Jam dakord, edhe ne këtë dëshirojmë», tha Titoja, duke u munduar të argumentonte se ishte e vështirë që shqiptarët të bashkoheshin menjëherë me atdheun e tyre. «Vetëm gjersa të zgjidhet kjo çështje, — vazhdova unë, — kërkojmë që shqiptarët të trajtohen si gjithë popujt e tjerë të Jugosllavisë, të kenë njëlloj si ata shkolla ku të përdoret gjuha e tyre amtare dhe të gjegzojnë gjithë të drejtat e tjera». Në realitet ai nuk ishte dakord me mënyrën si e shtroja unë këtë problem. Ai donte që Shqipërinë ta bënte republikë të shtatë të Federatës Jugosllave.

Sidoqoftë, tani i kemi përmirësuar disi marrëdhëni me Jugosllavinë. Sot kemi me të marrëdhënie kulturnore e tregtare, ndërsa në fushën ideologjike nuk jemi dakord në asnje çështje.

Ne, pas pushtimit të Çekoslovakisë nga revizionistët sovjetikë, bëmë një deklaratë në të cilën shpallëm botërisht se, në rast se do të sulmohej Jugosllavia nga kushdo qoftë, do të jemi gati t'u shkojmë në ndihmë popujve të saj. Kjo nuk do të thotë se ne pajtohem me pikëpamjet ideologjike të Titos dhe të pasuesve të tij, nëasnje mënyrë.

Nesër ju do të largoheni, por ne do t'ju kujtojmë.

Vizitën që bëtë në vendin tonë ne e çmojmë, mbasi forcon unitetin midis popujve tanë, forcon edhe më shumë ndjenjat e tyre të miqësisë. Prandaj ju lutem i transmetoni popullit kamboxhian respektin dhe miqësinë tonë. Rrugë të mbarë e mirupafshim!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimere të mbajtura në këtë
takim, që gjenden në AQP*

SOCIALIZMI DO TË TRIUMFOJË, AI I HAP PERSPEKTIVA TE GJERA POPULLIT

*Nga biseda me një delegacion të bujqësisë
të RP të Kinës*

18 korrik 1972

*Pasi u përshëndet me anëtarët e delegacionit kinez,
fjalën e mori shoku Enver Hoxha:*

Ju falënderojni për ardhjen dhe për vizitën që po bëni në Shqipëri, ku ju morët kontakt me popullin dhe me Partinë tonë. Ardhja juaj në Shqipëri do të ndihmojë për forcimin e miqësisë midis dy popujve dhe vendeve tona.

Ju keni vizituar gjer tanë mjaft krahina të Shqipërisë dhe me siguri jeni lodhur. Shokët tanë janë përpjekur t'ju çojnë në gjithë vandin për t'ju treguar, po të ishte e mundur, çdo gjë dhe mendoj se nuk e kanë pasur keq, sepse kështu mund ta ndihmojmë më shumë shoqi-shoqin. Në veprimtarinë tonë ne kujdesemi të mësojmë edhe nga eksperienca e popullit kinez. Vizita e delegacionit tuaj në vandin tonë do të japë kontributin e vet edhe në zhvillimin e bujqësisë sonë. Bujqësia është baza e ekonomisë dhe ju, me ardhjen tuaj, keni sjellë këtu

eksperiencën e madhe që ka populli kinez në zhvillimin e bujqësisë së vet. Ndihma për njëri-tjetrin është kurdoherë e domosdoshme, kurse eksperienca e secilit është një nevojë jetike e përbashkët. Kur njihet populli, kur njihen përpjekjet dhe mundësilë e tij dhe ajo ç'ka arritur dhe mund të arrijë ai me përpjekjet e veta, duke studiuar e duke korrigjuar gabimet e të metat, forcata tonë të përbashkëta rriten e forcohen më tej.

Ne kemi përpara një rrugë të gjatë për të bërë. Sot tendenca e zhvillimit të shoqërisë është ecja e saj përpara nëpërmjet revolucionit, në sajë të luftës që po bëjnë popujt dhe partitë marksiste-leniniste, të cilat përpiqen të koordinojnë si duhet në rrugën marksiste-leniniste të gjitha forcata fizike e mendore, politike, ekonomike dhe ushtarake të popujve në luftën e pamëshirshme kundër imperializmit me atë amerikan në krye dhe kundër revizionizmit modern me revizionizmin sovjetik në krye, të cilët po pësojnë disfata në të gjitha fushat, në ato politike, ekonomike dhe ushtarake.

Ashtu siç po pëson humbje të mëdha imperializmi amerikan si rezultat i luftës që bëjnë popujt kundër tij, veçanërisht popujt e Indokinës, dhe që ka kontribuar fuqimisht në disfatën e tij politike dhe ushtarake, po kështu edhe revizionistët sovjetikë kanë pësuar një disfatë tjetër të rëndë politike kohët e fundit. Sapo morën vesh se presidenti egjiptian, Anvar el Sadat, ka folur për dëbimin e ushtarakëve sovjetikë nga vendi i tij. Si duket ekziston një konflikt i mprehtë midis Bashkimit Sovjetik dhe Egjiptit. Agjencitë e lajmeve flasin nga të katër anët se me vizitën e fundit të kryeministrit egjiptian në Moskë marrëdhëniet midis kötyre

dy vendeve janë futur në krizë. Azis Sidkiu u ka kërkuar armë sovjetikëve për forcimin e mbrojtjes së vendit të vet, po, si duket, ata nuk u janë përgjigjur pozitivisht egjiptianëve. Si pasojë, Sadati ka kërkuar largimin e ushtarakëve sovjetikë nga Egjipti.

Zhvillimi i ngjarjeve tregon se imperializmi dhe socialimperializmi janë armiqtë më të egër të popujve, për çlirimin e të cilëve nga vargonjtë e tyre rruga më e drejtë është ajo e revolucionit.

I vogël është populli shqiptar, por ai merr pjesë aktive në luftën që po zhvillohet për shkatërrimin e imperializmit amerikan dhe të revizionizmit sovjetik, për triumfin e revolucionit në të gjithë botën. Shqipërisë, me gjithëse e vogël, i duhet t'u qëndrojë e t'u bëjë ballë armiqve me çdo kusht dhe në çdo rrëthanë, politikisht dhe ideologjikisht dhe të mbajë kështu kurdoherë lart flamurin e marksizëm-leninizmit. Ajo është një shembull që tregon se i vetmi regjim që u përshtatet masave të popullit është socializmi, armik i betuar i kapitalizmit, i cili do të zhduket patjetër, ndërsa socializmi do të triumfojë, ai i hap perspektiva të gjera popullit, ai e sjell atë në fuqi dhe e përmirëson jetën e tij me ritme të shpejta në të gjitha drejtimet. Në këtë kompleks të luftës sonë, të gjitha fushat e jetës së shoqërisë në socializëm zhvillohen shpejt, sepse çdo gjëje i jepet rëndësia e duhur. Pra, edhe industrinë ta zhvillojmë më tej, por edhe bujqësinë ta çojmë akoma më përpara, ashtu si edhe fushat e tjera të jetës sonë, me qëllim që nivelin e jetës së masave sa të jetë e mundur ta ngremë.

Armiqtë bëjnë çmos ta likuidojnë Shqipërinë si

vend socialist, por këtij qëllimi ata nuk ia kanë arritur dhe nuk do t'ia arrijnë. Ata mund edhe ta sulmojnë vendin tonë, por aktualisht rrethanat nuk janë të favorshme për ta. Megjithatë Partia jonë mendon e ka marrë masat edhe për një eventualitet të tillë.

Gjatë vizitave që keni bërë, ju keni krijuar një ide pak a shumë të plotë mbi zhvillimin e bujqësisë së sonë, për të cilën ne nuk jemi pesimistë, por as optimistë pa vend, sa të themi se kemi arritur qiejt. Ne kemi parasysh se për të arritur deri në nivelin ku jemi sot, na është dashur të fillojmë nga një bujqësi shumë e prapambetur. Lufta që kemi bërë dhe vazhdojmë të bëjmë, siç e dini, është përqendruar për ta zhvilluar atë me ritme sa më të shpejta, sepse përpala Çlirimtari i ky sektor ishte lënë krejtësisht pas dore. Përveç kësaj, duhet të njohim se me përjashtim të Stalinit, pseudomiqtë sovjetikë jo vetëm nuk na ndihmuam, por në të kundërtën, ata më shumë na dëmtuan si në bujqësi ashtu edhe në drejtimet e tjera, veçse politikisht dhe ideologjikisht ata s'mundën të na dëmtonin.

Pseudomiqtë na dëmtuan rëndë ekonomikisht. Në kohën e Stalinit ndihma e Bashkimit Sovjetik, si në çdo sektor edhe në bujqësi, ka qenë e singertë, por duhet thënë se ajo ka qenë e paktë dhe kjo për arsyen se Bashkimi Sovjetik sapo kishte dalë nga Lufta e Dytë Botësore dhe vetë ishte shumë i dëmtuar, prandaj s'kishte mundësi për të na ndihmuar më tepër. Në rrethana të tillë, ne e filluam ndërtimin e socializmit në kushtë shumë të vështira; industri nuk kishim fare, po edhe ajo bujqësi që ekzistonte ishte shkatërruar jashtëzakonisht.

Megjithatë populli dhe Partia i vunë gjoksin punës dhe arritën mjaft suksese, sepse, si kudo, faktori vendimtar ka qenë dhe është ai i brendshmi. Po të mos kishim luftuar në kohën e Luftës Nacionallirimitare, siç bëmë, nën udhëheqjen e Partisë sonë, ne nuk do të ishim të lirë sot. Ushtria e Kuqe nuk hyri në Shqipëri që ta çlironte, siç hyri në Rumani, në Poloni, në Çekoslovaki, në Hungari, në Gjermani, në Bullgari e në Jugosllavi. Shqipëria u çlirua nga lufta e djemve dhe e vajzave të saj.

Rëndësi ka, gjithashtu, kurdoherë edhe faktori i jashtëm. E tillë ka qenë për vendin tonë lufta e Bashkimit Sovjetik. Edhe sot, gjatë ndërtimit të socializmit, faktori i jashtëm ka, gjithashtu, rëndësinë e vet. Ju e patë vetë bujqësinë tonë, po ne jemi të ndërgjegjshëm se kemi akoma shumë për të bërë në këtë fushë. E keqja është se tokë të punueshme kemi pak, kurse njerëz për t'u ushqyer në proporcion me tokën kemi më shumë. Jo vetëm kaq. Politika e Partisë sonë synon që popullsinë ta shtojmë akoma më shumë, se jemi vend i vogël. Kjo kontradiktë që ekziston midis tokës së paktë e popullsisë që po shtohet nga viti në vit më shumë se fondi i tokës së punueshme duhet zgjidhur sa më parë. Për këtë ne lustojmë dhe bëjmë përpjekje që në vendin tonë të marrim rendimente sa më të larta, ndryshe nuk mund ta ushqejmë mirë popullin. Po të kishim sipërfaqe të madhe toke mund t'i përballonim nevojat edhe me rendimente më të ulëta, por, siç e thashë, sipërfaqen e kemi shumë të kufizuar. Veç kësaj, bujqësia jonë varet shumë nga kushlet atmosferike, të cilat shpeshherë e dëmtojnë.

Në kushtet tona shtimi i mekanizimeve do të ishte një nga faktorët e rëndësishëm që do të na ndihmonte ta zgjidhnim këtë problem. Shkalla e mekanizimit që kemi është e mirë, por për të marrë rendimente përherë e më të mëdha, ne. duhet, gjithashtu, të mësojmë akoma më shumë, sepse bujqësia është një sektor i gjërë që kërkon njohuri të shumta e të gjithanshme. Në këtë drejtim na mbetet shumë për të bërë. Për këtë bëhen dhe do të bëhen përpjekje akoma më të mëdha që specialistët tanë të bujqësisë të mund të mësojnë më shumë dhe që bujqësia jonë të përparojë përherë e më shpejt. Duhet, dhe ne po punojnë në këtë drejtim, të krijohen kushte akoma më të përshtatshme që bujqësia jonë të japë rendimente më të larta, duke marrë masa të mëtejshme përritjen e sipërfaqeve të ujitalime, për kanalizime, për kullimin dhe zgjerimin e sipërfaqeve të tokave etj.

Pra, bujqësinë ne duhet ta shtyjmë më tej përpara që të ngremë medoemos nga vili në vit si nivelin e jetesës së popullit ashtu edhe të forcojmë potencialin e mbrojtjes së vendit. Në drejtim të vendit tonë, kundër regjimit tonë socialist, armiqëtë bëjnë presion të madh me propagandën e tyre, me anë të radios, të televizionit, me anë të mijeteve e rrugëve të tjera. Prandaj këtë situatë në të cilën ndodhemi, ne duhet ta kapërcejmë medoemos, sigurisht jo me fryshten e shenjtë, po duke punuar më shumë dhe më mirë në të gjitha drejtimet e, në radhë të parë, në drejtim të edukimit të njeriut tonë të ri. Natyrisht populli ynë ka luftuar dhe lufton vazhdimesht për t'i kapërcyer vështirësitë, ai është kurdoherë i mobilizuar me të gjitha forcat për

realizimin e detyrave. Për këtë Partia e edukon atë të japë maksimalen e mundshme në çdo drejtim.

Zhvillimi ekonomik i harmonishëm i vendit dikton detyra edhe në drejtime të tjera. Nuk mund të ecë përpëra në mënyrë të pavarur një vend socialist pa metallurgjinë e vet të zezë dhe për këtë jemi duke ndërtuar Kombinatin e Metalurgjisë në Elbasan. Por edhe me ndërtimin e kësaj vepre të rëndësishme ne do të jemi prapë deficit në zhvillimin industrial, sepse kemi qenë shumë të varfër dhe se vepra të tjera do të na nevojitet të ndërtojmë edhe në të ardhmen. Gjithë ky popull, sot prej 2 milionësh, që do të vijë koha të bëhet edhe 3 milionë e më tepër, do të ketë nevojë të vishet, të mbathet etj., prandaj ndërtime të reja do të na duhet të bëjmë. Për çdo vepër që ndërtojmë, ne mendohemi mirë, nuk nisemi nga dëshira, po nga mundësilitë dhe nga nevojat tona më të domosdoshme.

Nevojat tona nuk kufizohen vetëm në bujqësi, industri e ndërtim, ato shtrihen edhe në mbrojtjen e vendit, sepse këtë na e imponojnë rrëthanat. Jemi vend i vogël dhe për këtë arsyе ne në Shqipëri gjithë popullin e kemi ushtar, krahas ushtrisë që duhet dhe e mbajmë në çdo kohë në gatishmëri, sepse rreziku përvendin tonë është kurdoherë iminent.

Këto janë që të gjitha probleme të rëndësishme e të koklavitura, që na vihen përpëra dhe siç e patë edhe vetë gjatë vizitave që bëtë, bëjmë përpjekje të mëdha për t'i zgjidhur. Populli duhet stërvitur përmbrojtje, për të qenë i aftë të përballojë çdo rrezik në çdo kohë dhe ngado që t'i vijë. Edhe në këtë drejtim ne mendohemi të përsitojmë edhe nga eksperiencia e

lufta e popullit të Vietnamit dhe e popujve të tjerë. Ushtria dhe populli ynë edukohen që të dinë të lustojnë dhe të mbrohen në kushtet e një lufte moderne, për arsyen se në lustë vendimtare nuk janë armët, por njërejt dhe një sërë masash të tjera që u japid mundësi këtyre të jenë luftëtarë kurdoherë në sulm që, me goditjen e parë, t'i shkaktojnë humbje të rënda armikut, kurse përvete të pësojnë sa më pak. Këtë është e domosdoshme ta kemi parasysh veçanërisht ne që jemi një popull i vogël në numër, të cilin armiqëtë do të përpilen ta likuidojnë. Ju e dini dhe e patë edhe vetë çfarë masash të shumta kemi marrë dhe vazhdojmë të marrim ne në drejtim të mbrojtjes. Ne po bëjmë ç'është e mundur përvjetorisht që të realizuar detyrat tona në fushën e mbrojtjes përvjetorisht qëdo rrezik, pse e shikojmë çfarë po bën imperializmi amerikan në Vietnam. Po na u imponua lufta, populli ynë, në sajë të sakrificave që po bën, do të mbrohet me sukses dhe do të fitojë.

Një nga shkrimitarët tanë, Ismail Kadare, ka shkruar një roman me titull «Kështjella». Ai trajton aty ngjarje të luftës së popullit shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut, kur osmanët, nga të cilët në atë kohë trembej tërë bota, sulmuan Shqipërinë, e cila ishte e vëtmja që nuk iu trembo sulmeve të tyre, por i përballoi me sukses dhe i theu njërin pas tjetrit. Populli ynë luftoi atëherë nën udhëheqjen e Skënderbeut. «Kështjella», përvjetorisht që e sulmojnë, veprojnë vetëm jashtë saj, nuk mund të futen dot brenda. Të gjitha mijetet i përdorin armiqëtë, por kështjellën. Shqipërinë, nuk arrijnë ta mposhtin. Këtë Shqipëri ne po e bëjmë të

pamposhtur. Në rast agresioni, vendi ynë do të jetë kështjellë e paprekshme dhe për këtë do të vazhdojmë të punojmë pa u lodhur. Partia shpenzon energji kolesale materiale dhe njerëzore, që janë të domosdoshme dhe jetike për forcimin e mbrojtjes, sepse më parë se të të ndihmojë shoku, duhet të punosh, të mbrohesh dhe të luftosh vetë.

Gjithë qeveritë e Evropës quditën pse shteti shqiptar është kundër «sigurimit evropian» për të cilin po bëhet një propagandë e madhe, sidomos nga ana e klikeve revizioniste. «Pse nuk doni ju të siguroheni? Venëm këshfu nuk do të pësoni gjë», na thonë. Ne e dimë fare mirë se «sigurimi evropian» është blof, pse ai është në favor të interesave të imperializmit amerikan dhe të socialimperializmit sovjetik në Evropë, ai ka përgjëllim të vendosë një paqe false në këtë kontinent.

Bëhet propagandë e madhe për largimin e flotave amerikane dhe sovjetike nga Mesdheu, po edhe kjo është një blof. Ne jemi të vendosur që, po të na sulmojnë, të luftojmë. Megjithëse qëndrimi i Shqipërisë në këto çështje nuk është vendimtar, fjala e saj sot dëgjohet me vëmendje, prandaj disa nga shtetet evropiane na bëjnë thirrje të marrim pjesë edhe ne në konferencën e «sigurimit evropian» për të thënë fjalën tonë atje, po ne u jemi përgjigjur kurdoherë negativisht.

Për sa u pörket ngjarjeve që po zhvillohen në Lindjen e Mesme, amerikanët dhe sovjetikët përpilen t'i shfrytëzojnë për forcimin e pozitave të tyre. Pastriimi i kësaj zone të rëndësishme nga këto dy fuqi imperialiste është një çështje që u pörket popujve arabë.

Në kuadrin e ngjarjeve botërore, ne punojmë për

forcimin e pozitave tona politike, ekonomike, ideologjike dhe shoqërore. Në propagandën e tyre imperialistët dhe revizionistët flasin kundër nesh, por gjithë ato që ata thonë, janë profka. Ata shpisin në mënyrën më të paturpshme, por neve nuk na bëhet vonë, tymi të na ecë drejt.

Pasi kryetari i delegacionit kinez falënderoi për bisedën e ngrohtë që u zhvillua në takim, si dhe për pritjen që u ishte bërë gjatë vizitave në Shqipëri, shoku Enver Hoxha falënderoi për fjalët në adresë të Partisë e vendit tonë dhe ugriti një dolli për miqësinë midis popullit shqiptar dhe atij kinez, si dhe për shëndetin e anëtarëve të delegacionit.

Etohet për herë të parë sipas shënimere të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

NE JEMI ABSOLUTISHT KUNDËR ORTAKLLËKUT ME ARMIQTË E POPUJVE

Nga biseda me Norodom Sihanukun

24 korrik 1972

Pas përshëndetjeve të rastit me mysafirin, fjalën e mori shoku Enver Hoxha:

Jemi të gjëzuar që, pas vizitës suaj të fundit në disa shtete të Evropës dhe të Afrikës, ju presim përsëri në Shqipëri.

Ju luftoni për çlirimin dhe pavarësinë e vendit tuaj, por edhe ne luftojmë, luftojmë pér ndërtimin e jetës së re dhe pér ruajtjen e fitoreve që kemi arritur në luftën me armiqtë imperialistë dhe revizionistë.

Ne mendojmë se ju vetë mund ta çmoni më mirë se kushdo vlerën e ndihmës dhe të miqësisë së çdo vendi që vizituat. Kjo ka shumë rëndësi. Miqësinë që lidh dy vendet tonë, miqësi e cila ka një kuptim të madh politik, të gjithë e shikojnë.

Kur ne bëmë së bashku takimin e parë, nuk domin të shtriheshim në të gjitha problemet. Edhe tani, që ju jeni kthyer nga Jugosllavia, ne nuk duam të ndërhyjmë në miqësinë që keni ju me Titon. Ne nuk dimë

deri në ç'pikë shkon kjo miqësi, sepse kjo është çështje që ju takon vetëm juve. Sidoqoftë ishim të sigurt se Titoja me anën e njerëzve të vët do t'ju bënte presion që ju të ndiqnit një politikë gjoja të pavarur. Ne nuk dyshonim usnjë fije për këtë. Ne e dinim se ai nuk do t'ju sulmonte vetë drejtpërsëdrejtë, por do të përdorte të tjerët për ta bërë këtë punë. Titoja është një dhëlpër e vjetër, mjeshtër në intrigë. Atë ne e njohim më mirë se kushdo. Për ne, marksistë-leninistët, ai është një renegat i komunizmit. Ai nuk është marksist-leninist, por një nga elementët më të rrezikshëm antisocialistë, veprimitaria e të cilët shpie ujë në mullirin e imperializmit amerikan dhe të Lon Nolit. Pikëpamja e atyre, me të cilët ju biseduat atje për zgjidhjen e disa problemeve, në mënyrë të veçantë për atë të problemit të Vietnamit, të Kamboxhias dhe të Laosit, nuk është për të mirën e popujve të këtyre tri vendeve. Interesin e vet ata e maskojnë me parullën e së ashtuquajturës demokraci, socializëm e internacionalizëm.

Gjatë Luftës sonë Nacionalçlirimtare dhe menjëherë pas Çlirimit të vendit, ne kishim shumë miqësi me popujt e Jugosllavisë. Por, prapa shpinës, çfarë nuk bëri Titoja. personalisht, çfarë nuk bënë Rankoviçi dhe të gjithë njerëzit që ai ka sot rrëth tij, për të gjunjëzuar popullin shqiptar. Titoja u përpooq ta bënte Shqipërinë republikë të shtatë të Jugosllavisë. Për këtë udhëheqësit jugosllavë kanë komplotuar kundër vendit tonë, duke u lidhur fshehtas me disa tradhtarë shqiptarë dhe duke bërë plane për ta pushtuar Shqipërinë me divizione jugosllave. Ata kurdisën për këtë qëllim intrigë se ne gjoja do të sulmoheshim nga Greqia, se

sulmi ishte i afërt e përbënte rrezik për vendin tonë, dhe për këtë përsitonin nga fakti se monarko-fashistët grekë atëherë na bënин provokacione të shumta në kufi.

Jugosllavët mund të thonë tanë shumë gjëra. Për shembull, akuzat e tyre se Stalini donte të sulmonte Jugosllavinë janë që në thelb false. Unë kam biseduar vëtë me Stalinin dhe nuk kam dëgjuar kurrë që ai të thoshte se Jugoslavia do të sulmohej nga ana e sovjetikëve. Ai na këshillonte që edhe ne shqiptarët të kishim kujdes, të mos u besonim shpifjeve që bënte kundër Bashkimit Sovjetik Titoja, që kishtë tradhtuar. Faktet janë të qarta dhe dihet përse e kritikoi Stalini Titon. Kritika e Stalinit ishte shumë shoqërore.

Ne mund t'ju themi se udhëheqësit jugosllavë mbrojnë interesat e kolonializmit. Të gjitha parullat e tyre janë të maskuara bukur.

Po përse gjykojmë ne kështu? Sepse faktet janë kokëforta. Në praktikë ne shikojmë çdo ditë të kundërtën e asaj që deklarojnë titistët me fjalë. Faktet na tregojnë të vërtetën dhe na sqarojnë arsyet që i shtyjnë ata të veprojnë kështu. Ne jemi plotësisht dakord me atë që thoni ju, se vendi i qëndrimit tuaj është sa më pranë popullit, atje ku rron e lufton populli dhe jo larg tij. Të jetosh larg popullit tënd do të thotë të lësh çështjen e tij në duart e të tjera, në duart e atyre që vënë në plan të parë interesat e vet.

Të njëjtën gjë do të vëmë re po të ndjekim edhe propagandën që bëjnë revisionistët e Moskës. Këta janë tradhtarë të popullit sovjetik e të të gjithë popujve të botës dhe përpigen të duken sikur janë në mbrojtje të luftërave çlirimtare. Por kjo është një gënjeshtë. Revi-

zionistët sovjetikë janë futur në Lindjen e Mesme. Po çfarë bëjnë atje? Mos vallë kanë shkuar për të ndihmuar Egjiplin të rimarrë tokat që Izraeli i ka pushtuar me ndihmën e imperializmit amerikan i cili synon të nënshتروجë arabët dhe popujt e Afrikës? Revisionistët sovjetikë deklarojnë se gjoja janë me Egjiptin dhe se luftojnë për t'i shpëtuar popujt arabë, por në fakt bëjnë të kundërtën.

Partia jonë prej kohësh e ka shprehur hapur pikëpamjen e saj lidhur me qëllimet e socialimperializmit sovjetik dhe të imperializmit amerikan në Lindjen e Mesme. Ajo ka shprehur pikëpamjen se arabët, për të risituar tokat e humbura, duhet të përqendrojnë forcat, të bashkohen, të luftojnë vetë deri në fund dhe të mos «ia varin mëlcitë ujkut në qafë». Ne kemi deklaruar vazhdimisht: Në qoftë se popujt arabë dhe egjiptianët duan të ruajnë pavarësinë, është e domosdoshme të luftojnë vetë, pa lejuar ndërhyrjen e revisionistëve sovjetikë. Vetëm me luftën e tyre këta popuj do të arrijnë t'i përzënë armiqjtë nga tokat e veta. Ata nuk duhet t'u japid revisionistëve të Moskësasnë bazë detare në Detin Mesdhe. Kjo nuk ka qëllim vetëm të shpëtojë pavarësinë e Egjiptit dhe të vendeve të tjera të Lindjes së Mesme, por të lehtësojë edhe luftën që bëjnë popujt e tjerë kundër sundimit kolonialist në Afrikë.

Kohët e fundit mësuam për fjalimet e mbajtura nga Sadati. Imperialistët sovjetikë, që e hiqnin veten si miq të Egjiptit, nuk e pritnë këtë qëndrim të Sadatit, por bomba plasi, mosmarrëveshjet midis tyre, më së fundi, dolën sheshit. Qëndrimin e Egjiptit ne e quajmë të drejtë, sepse kemi qenë kurdoherë të mendimit që

në qoftë se egjiptianët dëshirojnë të rifitojnë tokat e humbura, ata duhet të luftojnë vetë. Të presësh nga Bashkimi Sovjetik revizionist ose nga imperializmi amerikan të të çlirojë tokat e humbura jo vetëm që nuk do t'i fitosh kurrë ato, por do të humbasësh me siguri edhe të tjera.

Në shikimin e problemeve duhet qartësi, duhen kuptuar intrigat që luhen nga fuqitë e mëdha imperialiste kundër popujve. Ç'nuک kanë thënë armiqjtë tanë për Shqipërinë! Asgjë nuk kanë lënë pa thënë, por të gjitha shpifjet t'i mbajnë për vete, sepse asnjë të keqe nuk i bëjnë dot Shqipërisë. Populli ynë thotë një fjalë të urtë: «Tymi të shkojë drejt», e cila është njëloj si proverbi, që thatë ju, «Qentë le të lehin, karvani të shkojë përpara». Ne e dimë se me shpifjet kundër nesh armiqjtë duan të realizojnë synimet e tyre të ulëta, të këqija ndaj vendit tonë.

Këtë duan të bëjnë ata dhe sot jo vetëm ndaj vendit tuaj, por edhe ndaj popujve e vendeve të tjera që luftojnë, veçanërisht ndaj Vietnamit dhe Laosit. Armiqjtë përpilen që Vietnamin ta futin në një kompromis të tillë që ai të humbasë gjithçka, të humbasë pavarësinë e vet, të shkelë mbi gjakun dhe heroizmin e luftëtarëve trima që kanë dhënë e japid jetën në fushat e betejës, si dhe mbi gjakun e viktimave të luftës. Këtë duan ata të bëni edhe ju, të ndani pushtetin me tradhtarin Lon Nol, i cili ka bërë krime të përbindshme kundër popullit kamboxhian. Tani këta «politikanë të mëdhënëj» kanë hyrë në lojë për t'ju bindur ju dhe botën se duke i bërë një koncesion të vogël imperializmit amerikan, gjithçka do të rregullohet «miqësisht» etj. Por

politika e Niksonit nuk do të ketë sukses, në qoftë se mbështetesh në popull.

Edhe për sa i përket problemit korean ne e kemi bërë të njohur qëndrimin tonë. Ose duhet të luftosh kundër imperializmit amerikan dhe kundër tradhtarëve deri në fitore, ose të pranosh kapitullimin në kurriz të popullit, duke u futur në të ashtuquajturën «zgjidhje paqësore e çështjes koreane». Tjetër rrugë nuk ka. Të mendosh se amerikanët janë kaq të mirë sa të tërhiqen vetë nga Koreja, sepse kështu paskan deklaruar ata, të mendosh se Pak Çen Hia, me deklaratat e tij, në drejtim të Koresë së Veriut, do të heqë dorë nga rruga e tradhtisë ndaj popullit korean, kjo nuk është e lejueshme. Natyrisht, kjo është çështje e tyre, por ne jemi kundër qëndrimeve të tilla. Ne shqiptarët jemi marksistë-leninistë, nuk ndjekim një politikë ekstravagante, prandaj jemi në favor të luftës së drejtë të popullit vietnamez dhe të popullit kambozhian që mbrojnë trojet e tyre. Popujt janë më të fortë nga armiqjtë.

Amerikanët do të përpilen t'i pajtojnë në fillim koreanët me kukulla të tilla si Pak Çen Hi, të cilin, dihet se e kanë vënë prej kohësh në thes, kurse tanë duan të mbërthejnë edhe Korenë e Veriut. Prandaj rëndësi ka që në çdo moment të jesh me shumë vendosmëri me popullin tënd, me popullin e Kambozhias, me popullin e Koresë, ndryshtë do të jesh kundër tyre dhe do të bashkohesh me imperializmin. Nuk kemi të drejtë të mendojmë kështu? Ne dëshirojmë dhe urojmë të realizohet bashkimi i Koresë së Veriut me atë të Jugut, të realizohet bashkimi i Vietnamit të Veriut me

Vietnamin e Jugut, por këta objektiva të mos arrihen në interes të imperializmit. Ne jemi absolutisht kundër ortakllékut me armiqjtë e popujve. Bashkimi duhet të bëhet në unitet vetëm me forcat e shëndosha të të gjithë kombit dhe në interesin e madh të masave, për fitoren e lirisë dhe të pavarësisë së tyre. Të ndash pushtetin me tradhtarët e Koresë, me Kao Kinë e Vietnamit ose me Lon Nolin e Kamboxhias, të puthesh me ata që kanë gjakosur dhe vrarë popullin, kjo nuk është politikë e drejtë dhe si e tillë nuk është as e pranueshme.

Pasi princi Sihanuk foli përvizitat e tij në Rumania, Jugosllavi, Algjeri dhe Mauritani, e mori fjalën përsëri shoku Enver Hoxha:

Ashtu siç bëjnë amerikanët, edhe revisionistët sovjetikë kurdisin komplotë kudo e luajnë një rol skandaloz në botë, në mënyrë të veçantë në Kamboxhia. Ata nuk ju njojin ju, por Lon Nolin, që është njeriu i amerikanëve. Kuptohet përsë e bëjnë këtë ata. Mirëpo këtu është çështja e Kamboxhias, e së ardhmes së saj dhe e të gjithë Indokinës. Sovjetikët duan të forcojnë pozitat e tyre në Kamboxhia. Për këtë qëllim ata akoma kanë shpresë te Lon Noli dhe klika e tij, dhe vazhdojnë të mos ju njojin ju. Ata do t'ju afrohen e do t'ju njojin vetëm në momentet afér fitores suaj. Të shikoni atëherë se si do t'ju afrohen me zell prej «komunisti». Kini parasysh se sovjetikët do të mundohen të rekrutojnë edhe ndonjë element nga radhi të tuaja dhe t'ju paraqitin nën etiketën e komunistit, por dijeni se elementë të tillë nuk janë komunistë të vërtetë, por revisionistë si ata vetë. Revisionistët sovjetikë do të përpipi-

qen ta bëjnë edhe këtë, në qoftë se nuk e kanë bërë deri tanë.

Eksperiencia jonë si dhe ajo e partive komuniste që kanë qenë në pushtet në vendet e tjera, vërteton se revizionistët sovjetikë kanë bërë përpjekje pér të na sabotuar ne dhe këto parti, duke rekrutuar nü shërbim të tyre, në rrugën më të ulët dhe armiqësore e me thurje legjendash, elementë, tradhtarë të marksizëm-lenismit, bile duke u përpjekur të krijojnë edhe parti të tjera «komuniste». Përse e kanë bërë dhe e bëjnë këtë revizionistët sovjetikë? Pér të përgatitur në ato vende qilimin dhe kolltukun pér vete, pér t'i pasur si mbështetje ideologjike në syltë e popujve.

Ne luftojmë me ashpërsi kundër këtyre elementeve, sepse ata janë nga armiqëtë më të rrezikshëm të të gjithë popujve, janë armiqë e lirisë dhe të pavarësisë së tyre. Të tillë janë revizionistët dhe klikat që i përkrahin, të cilat i përgatitin vetes dhe vendit kolonializmin. Populli nuk i ngatërron kurrë këta njerëz të maskuar, këta armiq të këqij, me miqtë e vërtetë, me miqtë e singertë. Populli kamboxhian e shikon dhe di të dallojë kush është me të, kush është në mbrojtje të tij dhe kush jo.

Ne shqiptarët bëjmë një luftë të hapët kundër revizionistëve modernë, sepse ata janë kundër popujve. Ata na akuzojnë se në vendin tonë nuk paska demokraci, por diktaturë. Te ne ekziston diktatura e proletariatit, një diktaturë e atillë ku populli vetë gjykon, vetë vendos. Ai është i lirë të kritikojë çdo gjë kur sheh se nuk është në interesin e tij dhe përpinqet që gjithçka

të jetë e mirë, me qëllim që t'u sjellë lumburi të gjithë njerëzve. Pra, te ne ekziston demokracia sociale. Ne kemi besim se kështu si në vendin tonë do të ndodhë edhe në vendet e tjera dhe në këtë rrugë të drejtë do të bashkohet i gjithë populli.

Imperializmi amerikan dhe revizionizmi sovjetik sot janë dy fuqitë më të mëdha imperialiste agresive, që përpilen të sunojnë botën, ta ndajnë atë qoftë në-përmjet luftës, siç bëjnë te ju, qoftë nëpërmjet manovrave të shumta politike që bëjnë për të ngatërruar e mashtruar popujt.

Sot, në disa qarqe politike ekziston një mani për të bërë propozime për konferenca e mbledhje të ndryshme, «të shumanshme» ose «të dyanshme», që, sipas tyre, do të shërbejnë «për të shkëmbyer pikëpamjet», «për të lidhur traktate», nëpërmjet bisedimesh të astutuquajtura frytdhënëse etj., etj. Këto propozime herë pas here bëhen me një «stil të ri». Tani po flitet me bujë për «sigurimin evropian», po kështu edhe përdëbimin e flotave amerikane dhe sovjetike nga Mesdheu» etj., por askush nuk thotë se si do të realizohet kjo. Sovjetikët dhe ca më tepër amerikanët kanë shumë baza në Mesdhc. Po përse disa propozojnë të shikohet çështja e këtyre flotave, përse kërkojnë të bisedohet? A janë të gjithë kundër pranisë së këtyre flotave në Mesdhe? Mos vallë disa janë kundër pranisë së njërsës dhe disa kundër pranisë së tjetrës? Atëherë kush do t'i heqë? Kuptohet se në këto mbledhje do të zhvillohen vetëm diskutime pa mbarim, kurse flotat agresive, amerikane e sovjetike, do të mbeten në vend. Kjo është,

siç thotë populli, «të rrahësh ujë në havan». Pra, asgjë nuk do të dalë nga të tilla mbledhje, prandaj ne jemi kundër tyre.

Po «sigurimi evropian» ç'është vallë, përse duhet ai? «Për të siguruar të gjithë popujt e Evropës», na thonë. Por popujt duan pavarësi, nuk duan që të tjerët t'u pushtojnë vendet e tyre, t'u shkaktojnë fatkeqësi. Dhe cilët janë atë që veprojnë kështu? Imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë, si dikur Gjermania e Kajzerit ose ajo hitleriane. «Të mblidhemi», thonë, por, gjersa synimet e fuqive agresive janë të ndryshme nga ato të vendeve paqedashëse, ç'gjë e mirë mund të dalë nga këto mbledhje? «Të mblidhemi që të nënshkruhet një pakt «sigurimi», që Gjermania Federale me një të goditur të fshijë duart nga pretendimet, pra, të mblidhemi të diskutojmë», thonë. Por ne jo një herë, por çdo ditë kemi folur dhe shprehemi në mënyrë shumë të qartë për këto probleme të mëdha që preokupojnë botën. Opinion publik ndërkombëtar e di pikëpamjen tonë, dhe e kuption përse nuk jemi ne për të tilla mbledhje e konferenca. Ne jemi të mendimit se në to epërsinë nuk do ta kemi ne, popujt e vegjël, por do ta kenë fuqitë e mëdha, sepse do të jenë ato që do të veprojnë me makinacione dhe do të diktojnë vendimet siç e duan interesat e tyre dhe më pas do të kërkojnë të zbatohen duke u kapur pas faktit që edhe ne të tjerët kemi qenë në këto mbledhje e konferenca, prandaj duhet të bëjmë ashtu siç është vendosur atje.

Ne i njohim mirë se cilët janë imperialistët amerikanë dhe revisionistët sovjetikë, prandaj nuk mund të marrim pjesë në manovrat dhe kurthet që organizojnë

ata. Po të bënim një gjë të tillë, kjo do të ishte e dëmshme për ne. Ky qëndrim që mbajmë nuk na izolon aspak nga bota.

Përse ndodh që kur princi Sihanuk, si udhëheqës i popullit kamboxhian, shkon në ndonjë vend mik për t'i folur popullit të këtij vendi për heroizmat e luftëtarëve kamboxhianë, pengohet. Lihet në hije? Ky është një qëndrim i padrejtë.

Ka qeveri që marrin iniciativa me njëfarë vlere politike. Ne gjykojmë nëse kjo apo ajo iniciativë, qoftë kjo e një fuqie të madhe ose të vogël, sjell me të vërtetë gjë të mirë për popujt në luftën e tyre kundër imperializmit. Nëse po, e përkrahim dhe bëjmë gjithçka të mundshme që popujt dhe elementët përparimtarë të shikojnë të vërtetën dhe të lustojnë me sa mundin për ta realizuar në jetë këtë të vërtetë; nëse shohim që ajo iniciativë nuk është në favor të popujve, nuk e mbështetim, përkundrazi e dënojmë. Këtë rrugë ndjekim ne, dhe pavarësisht se jemi një popull i vogël, përpinqemi t'i sqarojmë gjerësisht ata që na shikojnë, që na dëgjojnë e përpinqen të na kuptojnë. Aq më keq për ata që s'duan të na kuptojnë. Ky nuk është një qëllim egoist yni. Ne nuk lustojmë vetëm për interesin e Shqipërisë. Ne nuk mund të jetojmë kurrë të izoluar. Prandaj me politikën dhe qëndrimin tonë, dëshirojmë të bindim ata që mund të binden për drejtësinë e çështjes sonë. Ne orientohemi gjithnjë nga një strategji e drejtë, por nuk pretendojmë se gjithçka që themi dhe bëjmë është e përsosur. Prandaj nga miqtë tanë presim edhe mendimet e tyre dhe këtë e shohim si gjënë më të mirë që mund të ndodhë në mes miqsh. Në qoftë se nuk i vëmë në

dukje anët e mira dhe anët e dobëta njëri-tjetrit, atëherë punët nuk do të na shkojnë mirë.

Ju thatë se në shtetet që vizituat ju bënë pyetjen përse nuk ju njeh Bashkimi Sovjetik si kryetar i ligjshëm i shtetit të Kamboxhias. Dhe ju iu përgjigjët atyre se sovjetikët nuk duan që në Kamboxia të ketë një front unik, por një qeveri të përbërë nga përfaqësuesit e tri grupeve të kundërtë. Qëllimi i tyre është të përsitojnë nga kjo situatë për të térhequr ndonjërin në anën e tyre dhe të mundin pastaj t'i eliminojnë të tjerët.

Kur populli kamboxhian të çlirorë Pnom-Penin e krejt vendin e tij, sovjetikët, siç e thashë edhe më parë, do të hiqen si miqtë tuaj më të dashur. Kur ju ta keni në dorë qeverisjen e vendit të çliruar, mbajeni mend se sovjetikët do të vijnë patjetër t'ju bëjnë lajka, do t'ju buzëgeshin e do t'ju thonë: „Ju lumtë dhe zoti ju ndihmostë!“ etj. dhe për këtë përgatitin plane që, kur të vijë koha, të afrohen sa më shpejt me ju. Ne themi se nuk u duhet besuar atyre që thotë Titoja, që ju të afroheni me sovjetikët. Të keni besim se sovjetikët do të bëjnë gjithçka në këtë drejtim. Qëndrimi i jugosllavëve nuk ka gjetur plotësisht mbështetje te ju. Ata nuk mund t'ju jepnin juve të drejtë dhe t'ju thoshin se cili është Brezhnjevi, por ju thanë se do të rregullohet puna. Me këtë manovër Titoja përpinqet ta heqë veten si politikan i madh, kurse Çaushesku si ndërmjetës që mban marrëdhënie me politikanë të sferave të larta, si me Niksonin e Brezhnjevin. Unë mendoj se ka disa arsyë që sovjetikët të bëjnë orvatje për t'ju njobur. Kjo mund të ndodhë sepse ata shohin në horizont fitoren

e popullit tuaj, por edhe për presion mund ta bëjnë këtë hap.

Nga eksperiencia që kemi fituar, ne mund t'ju themi: Mos u besoni buzëqeshjeve të tyre. Revisionistët e Moskës janë armiq të betuar të popujve, ata luftojnë kundër së vërtetës, kundër mësimave të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Bashkimi Sovjetik do të orvatajë të gjëjë mbështetje te komunistët fals, tek ata që nuk janë komunistë të vërtetë. Ne kemi besim se këta do të jenë të paktë në Kamboxhia dhe se populli kamboxhian do të luftojë deri në arritjen e fitores së tij përfundimtare. Të njëjtën gjë kemi provuar edhe ne gjatë Luftës Nacionallirimitare. Populli ynë u bashkua me Frontin Nacionallirimtar, luftoi dhe fitoi, sepse Partia jonë ka qenë e sinqertë dhe e hapët me masat, e lidhur ngushtë me to. Ajo i ka respektuar dhe i ka nderuar të gjithë ata patriotë që kanë marrë pjesë gjë në fund në luftë. Prandaj jemi të bindur që edhe te ju e njëjta gjë do të ndodhë. Por, natyrisht, kjo varet shumë nga ju. Ne shikojmë që populli juaj lufton për çlirimin e vendit të tij. Në këtë luftë ai ka pranë miqtë e tij, ka mbështetjen e sinqertë të popullit shqiptar dhe të popujve të tjerë.

Ne u kemi thënë shokëve vietnamezë, miqësisht, të mos mbështeten tek armët dhe te miqësia sovjetike, sepse kjo është false. Natyrisht, kjo është puna e tyre, ne nuk kemi arsyë të ndërhyjmë në punët e miqve dhe kemi deklaruar kurdoherë se do të jemi gjithmonë me popullin vietnamez, do të bëjmë gjithçka për forcimin e miqësisë midis popullit vietnamez dhe popullit shqiptar, por, si miq që i kemi vietnamezët dhe duke i njo-

hur se ç'janë sovjetikët, duam t'u bëjmë të qartë atyre se këta nuk janë të singertë, prandaj jemi të sigurt se do t'u bëjnë presione skandaloze vietnamezëve. Gjersa sovjetikët hiqen si miq të popullit vietnamez, pse nuk ndihmojnë të hiqet bllokada e amerikanëve, ose pse nuk e ndihmojnë Vietnamin duke e thyer këtë bllokadë?

Imperialistët francezë ju njohin ju më mirë se kushdo tjetër. Tani borgjezia imperialiste franceze nuk është aq e fortë si dikur, megjithatë ajo mban të njëtin qëndrim që ka pasur më parë ndaj jush dhe vendit tuaj. Me anën e intrigave, imperialistët francezë përpinqen të rishojnë ndikimin që kanë humbur në gadishullin e Indokinës dhe ca më tepër te ju, në Kamboxhia. Këtu nuk e kam fjalën aspak për popullin e proletariatin francez dhe frymën e tij revolucionare, por për imperializmin francez, i cili ka tani kontradikta të mëdha me sovjetikët, me amerikanët, me gjermano-perëndimorët, me anglezët. Dë Goli nuk iu nënshtrua atyre, ndërsa për Pompidunë nuk mund të themi se është aq i prerë sa paraardhësi i tij. Sidoqoftë imperializmi francez nuk dëshiron që Kamboxhia të jetë një shtet i lirë dhe i pavarur.

Disa nga udhëheqësit e shteteve që sapo keni vizituar janë treguar me ju hileqarë. Ç'mund të themi për Çausheskun, i cili, megjithëse e heq veten kundër Bashkimit Sovjetik, ju ka propozuar t'u drejtoheni për të tretën herë udhëheqësve sovjetikë me kërkesë që të pranojnë t'ju njohin?

Krejt ndryshe janë marrëdhëniet midis nesh. Kjo na ndihmon shumë të kuptojmë situatën e përgjith-

shme, të kuptojmë mirë idetë që hidhen nga të tjerët për ne, si dhe planet që kurdisen kundër luftës heroike të popullit kamboxhian. Natyrisht, ka akoma shumë vëshiirësi në rrugën tonë, por duke ndjekur vijën e drejtë nuk ka pse të kemi frikë nga vështirësitë. Fitorja jonë është e sigurt.

Ju patët rastin të vizitonit Jugosllavinë. Shumë fjalë mund të thotë Titoja për gjendjen në vendin e vet, por atje është krijuar një situatë konfuze. Atje popujt nuk janë të bashkuar. Situata ekonomike në Jugosllavi është keqësuar dhe keqësohen vazhdimi. Titoja dhe bashkëpunëtorët e tij mundohen ta paraqesin gjendjen e vendit të tyre jo siç është në realitet, përpiken të tregojnë sikur popujt e Jugosllavisë janë të bashkuar, por e vërteta është ndryshe. Udhëheqësit e këtij vendi përpiken t'u tregojnë të tjerëve jashtë se vendi i tyre është i paangazhuar. Si mund të jetë i tillë, kur atje kanë ngulur kthetrat imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik? Për çfarë mos-angazhimi flasin jugosllavët?

Mundet që në magazinat dhe në dyqanet e Jugosllavisë të ketë shumë mallra, por këta artikuj atje janë prodhuar ose importuar me borxhe dhe një ditë kapitalistët, imperialistët dhe socialimperialistët që ua jepin, do t'i kërkojnë popullit t'i paguajë. Dhe populli do t'i paguajë shtrenjtë me lirinë e pavarësinë e vet. Kurse në vendin tonë çdo gjë që ndërtohet e prodhohet, të gjitha janë për popullin, i takojnë atij dhe jo të huajve. Sipas të dhiave që jepin vetë organet zyrtare jugosllave, sot 50 për qind e prodhimit të ndërnarrjeve jugosllave shkon në favor të kapitalistëve të huaj, se-

pse investimet e tyre aq janë, 50 a 51 për qind. Udhë-heqësit jugosllavë flasin për pavarësi, për sovranitet, por si është e mundur të jetë reale një gjë e tillë, kur imperializmi ka lëshuar rrënjos brenda këtij vendi dhe sundon e drejton ekonominë e tij? Me fjalë jugosllavët mund ta quajnë veten të lirë, por në fakt nuk janë dhe nuk mund të janë të tillë. Jugosllavia nuk merr vetëm kredi dhe huara nga jashtë, por edhe ndërmarrjet që nuk janë në gjendje t'u paguajnë punëtorëve rrogat, dhe këtë e thonë vetë jugosllavët, detyrohen t'i shiten kapitalit të huaj, që ka bërë investime për ngritjen e tyre, ndryshe falimentojnë plotësisht. Situata që po zhvillohet në Jugosllavi tregon sejeta e popullit atje nuk është e sigurt, ai është varfëruar së tepërtimi, ekonomia qëndron në vend, kudo ka mungesa të mëdha, sidomos papunësi, prandaj, veç të tjerave, ka edhe emigracion. Po përsë largohen punëtorët me dhjetëra mijë nga Jugosllavia për në vendet e Perëndimit? Sepse atje, siç thashë, nuk ka punë dhe, siç vëni re, ka çdo ditë ngritje çmimesh, qoftë të mallrave ushqimore, qoftë të artikujve industrialë. Në qoftë se në një vend nuk ka situatë të qëndrueshme ekonomike, a mund të mendohet që atje të ketë unitet politik?

Faktet tregojnë se situata në Jugosllavi është konfuze. Këtu nuk është puna e disa kontrabandistëve, gjë që qeveria jugosllave e trumbeton me të madhe. Po përsë ekziston atje një situatë e tillë? Sepse Titoja nuk ndjek një politikë të drejtë. Ai mund të ketë namin si një «politikan i madh ndërkombëtar», por kur nuk rregulloi dot punët në vendin e vet, në shtëpinë e tij, ç'i duhet të luajë rolin e «ekspertit» ndërkombëtar? Ne e

dimë se këtë nam ia japin atij armiqtlë tanë. Titoja është shumë i vlefshëm për imperializmin amerikan i cili me gjithëse nuk e beson shumë, i intereson akoma ta ketë në anën e vet për t'i bërë ato punë që i shërbejnë forcimit të pozitave të tij imperialiste.

Krejt ndryshe është gjendja në vendin tonë. Në mund të mos kemi akoma një numër aq të madh fabrikash e uzinash sa do të dëshironim, por te ne të gjithë punonjësve u është sigruar punë, secili e merr rrugën rregullisht në fund të çdo 15-ditëshi. Në vendin tonë as për mallrat industriale, as për ato ushqimore, në asnjë rast nuk ka pasur ngritje çmimesh. Përkundrazi herë pas here ka pasur ulje të tyre.

Në vendin tonë, populli është i bashkuar për një çështje të drejtë e për një qëllim të lartë, prandaj ka suksese dhe ecën përpara. Ai do të jetë gjithmonë me luftën që po bëjnë popujt heroikë të Kamboxhias e të Indokinës kundër imperializmit amerikan e lakenjve të tij të brendshëm. Duke u bërë interpret i ndjenjave të singerta të popullit shqiptar, shpreh dëshirën dhe urimin që t'i shohim këta popuj të çliruar, të ndërtojnë një ekonomi moderne në kushtet e lirisë dhe të pavarësisë kombëtare!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtij takim, që gjenden në AQP

BUROKRATIZMI — ARMIIK I DEMOKRACISE SOCIALISTE

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit
të Kuvendit Popullor të RPSH¹*

7 shtator 1972

Shokët që diskutuan e trajtuan shumë mirë dhe hollësishët nevojën e gjallërimit të punës së organeve të pushtetit në rrëthin e Kukësit. Megjithëse këto probleme nuk trajtohen për herë të parë, përsëri na dalin disa gështje që duhet të kihen parasysh nga ana e shokëve drejtues të organeve dhe të administratës shtetërore në qendër dhe në bazë.

Ndihmën që duhet t'u japid organet qendrore organeve të bazës e konkretizuan shoku Adil Çarçani² edhe shoqja Vito Kapo³. Ata përmendën mjaft gjëra që kanë të bëjnë me ndihmën e dhënë nga organet qendrore të

1. Në këtë mbledhje u diskutua «Mbi punën e organeve të pushtetit në rrëthin e Kukësit».

2. Në atë kohë zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave të RPSH.

3. Në atë kohë anëtarë e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH.

pushtetit dhe të administratës organeve dhe administratës shtetërore në bazë. Nga dikasteret ndihma për bazën nuk ka munguar. Këtë, veç të tjerrave, e vërteton edhe vajtja shumë herë dhe në mënyrë të vazhdueshme e udhëheqësve të Partisë e të shtetit në rrethe të ndryshme. Shqipëria është i vetmi vend ku udhëheqësit shkojnë shpesh në rrethe e në bazë dhe ulen për të diskutuar shtruar me popullin. Ndihma nga qendra, ashtu si të tjerëve, nuk i ka munguar as rrëthit të Kukësit.

Problemet që trajtohen në raportin e paraqitur nuk janë të panjohura as për ne shokët e Presidiumit të Kuvendit Popullor, por as edhe për shokët që punojnë e drejtojnë në rrethin e Kukësit. Unë jam plotësisht dakord me mendimin e shoqes Vito që tha se shokët në bazë dinë t'i numërojnë një për një çështjet për të cilat vendos Partia, por problem është zërthimi në praktikë i parimeve dhe i direktivave, si dhe zbatimi i përpiktë i tyre. Pikërisht këtu ndihen më tepër të metat dhe dobësitetë e punës.

Problemet që diskutuam kanë të bëjnë me metodën dhe stilin në punë. Vazhdimisht po diskutohet për të zhdukur dobësitë e metodës dhe të stilit në punë të organeve lokale të pushtetit dhe të administratës shtetërore, por, për t'ia arritur këtij qëllimi, duhet të kapemi pas atyre elementeve të domosdoshme që përbëjnë metodën dhe stilin revolucionar në punë. Për të ndërtuar një metodë dhe stil të tillë, mendoj se kuadrot nuk duhet t'i preokupojë vetëm çështja për të qenë në marrëdhënie të mira me organet eprore të Partisë dhe të shtetit, por të shqetësohen, gjithashtu, për të krijuar raporte të drejta midis tyre dhe masave, për arsyen se

udhëheqja e Partisë dhe e shtetit tonë s'ka dhe s'mund të ketë asnjë qüllim tjetër dhe asnjë interes në kundërshtim me atë të punonjësve. Është e palejueshme të mendosh se mund ta kesh mirë me udhëheqjen, kur tregohesh fodull në marrëdhëniet me popullin. Kuadrot duhet t'i tregojnë popullit vijën e Partisë, ta bindin atë për drejtësinë e saj dhe për nevojën që kjo vijë të zbatohet nga të gjithë. Ata për këtë i kanë vënë populli dhe Partia, prandaj e kanë detyrë të shkojnë në popull, të nijihen me hallet e tij dhe të përpiqen bashkërisht përzgjidhjen e tyre. Për një çështje që masat nuk e kanë të qartë, duhet t'uash përpjekjet janë të pamjaftueshme, për arsyen që na shihen edhe në rrethin e Kukësit, por sa është bërë nuk mjafton. Veçanërisht për këtë rreth do të thosha se përpjekjet janë të pamjaftueshme, për arsyen se nuk bëhet sa duhet përzbërthimin e direktivave të Partisë dhe përzbatimin e drejtë të tyre. Në këtë drejtim vërehet një formalizëm i theksuar dhe një qëndrim dogmatik që duhen luftuar.

Parimet marksiste-leniniste dhe udhëzimet e Partisë sonë nuk janë dogmatike, përkundrazi, ato na shërbijnë dhe na udhëheqin për veprim. Prandaj ato, së

pari, duhet të kuptohen drejt, pastaj të zbërthehen mirë e të thellohen më tej nga shokët që punojnë në rrethet e në bazë. Parimet dhe direktivat e Partisë është e pamundur të shtrihen gjer në hollësitë më të vogla, për të parashikuar gjithçka dhe për të dhënë mënyrën e gatshme të zgjidhjes së problemit edhe për gjëra fare të thjeshta, si, bie fjala, për të parashikuar se si duhet ta shfrytëzojë kohën e punës një mami në fshat, që pret rreth 50 lindje në vit. Kjo çështje nuk është e mundur të zgjidhet nga lart. Parimi, si teza themelore e një doktrine, nuk mund dhe nuk duhet të parashikojë çdo gjë. Për zbatimin e tij në problemet e larmishme e të shumianshme që nxjerr jeta, kërkohet një interpretim i drejtë, duke arsyetuar në mënyrë dialektike materialiste. Kështu duhet të veprojnë vetë organet e pushtetit në rreth e në bazë, të cilat, kur është rasti, mund të kërkojnë edhe ndihmën e organeve qendrore dhe të dikastereve.

Një ekip prej 20 vetash u dërgua në rrethin e Kukësit nga Kryesia e Bashkimit të Grave dhe të metat që konstatoi ai në punë, që nga a-ja e deri te z-ja, ua ka vënë në dukje shokëve të rrethit. Le ta marrim shtruar këtë problem. Ishte nevoja të vente një ekip prej kaq shumë njerëzish, kur në rrethin e Kukësit ka përgjegjëse të gruas, instruktore, aktivistë, kryetar e nënkyetar komiteti, shefa seksionesh, inspektorë etj., etj.? Përse duhej të dërgohej ky ekip kaq i madh nga qendra në rreth? Apo që të mësonin, për shembull, shefin e seksionit të shëndetësisë, nënkyetarin e komitetit ekzekutiv, që ka në varësi këtë seksion etj., se si t'u shërbeshet më mirë grave para, gjatë dhe pas lindjes? Përse të dërgoheshin kur tani në rreth ka gjithë ato mami, që kanë mbaruar

shkollën e mesme pikërisht për këtë qëllim, kur atje ka mjekë, ndihmësmjekë dhe infirmierë, kur, si në çdo rreth tjetër edhe në atë të Kukësit njihen udhëzimet e Partisë për ruajtjen e shëndetit të popullit?

Unë nuk mendoj që këtej e tutje të mos venë më ekipe nga qendra në bazë. Të kuptohemi drejt, le të dërgohen përsëri për të ndihmuar sa herë të jetë nevoja, por e kam fjalën të mos shkojnë «për të ndihmuar» lidhur me ato probleme që kuadrot në rreth janë vetë në gjendje t'i kuqojnë, t'i zbërthejnë dhe t'i zbatojnë mirë. Mendoj se qendrën duhet ta preokupojnë më shumë gjërat kryesore dhe jo të voglat, për të cilat kuadrot në bazë janë në gjendje t'i zgjidhin dhe nuk ndiejnë asnjë nevojë për ndihmën e qendrës.

Kur shkojnë nga qendra në bazë për ndihmë, të qëndrojnë në ato probleme për të cilat baza duhet dhe kërkon të ndihmohet. Në qoftë se dikush shkon nga qendra në rreth dhe flet për gjëra të përgjithshme apo për çështje që njerëzit atje i njojin, shokët e rrethit kanë të drejtë t'i ndërhyjnë dhe t'i thonë: këto gjëra nuk na interesojnë, se i dimë, neve na intereson kjo apo ajo për të cilën kemi nevojë të na ndihmoni. Atëherë i deleguari i qendrës, cilido që të jetë, duhet të tërhoqet, të reflektojë më mirë dhe të flasë për ato që kërkojnë shokët e rrethit dhe të bazës. Kështu, pra, kur ndonjë kuadër apo udhëheqës vete në bazë, më parë të përgatitet mirë, të njihet me problemet kryesore që preokupojnë rrethin. Për shembull, në qoftë se rrethit të Kukësit duhej t'i shkonin 20 traktorë, kurse në fakt i kanë shkuar vetëm 2, atëherë, para se të niset për në këtë rreth, udhëheqësi t'i kërkojë ministrit përkatës shpjegime se për ç'arsye

këtij rrëthi nuk i kanë vajtur të 20 traktorët e parashikuar. Ministri mund ta bindë ose jo atë me sqarime përkëtë çështje dhe kështu, para se të shkojë në bazë, udhëheqësi do të jetë në gjendje të dijë gjërat kryesore.

Ne kujtojmë se disa situata, lidhur me punën e drejtimit, i kemi kapërcyer, por në fakt nuk është kështu. Krahas sukseseve të mëdha në zbatimin e ligjshmërisë socialiste, në praktikë disa herë ndeshemi ne arbitraritetë dhe me shkelje të ligjit. Këtë të keqe është e domosdoshme ta kuptojmë në esencë. Pushteti ynë popullor është i fortë. Po ku qëndron forca e tij, forca e Partisë dhe e njerëzve që drejtojnë? Ajo qëndron të lidhjet me masat, të vendosja e një raporti të drejtë në marrëdhëni midis kuadrove dhe masave, të forcimi i besimit reciprok dhe bashkëpunimi i ngushtë midis tyre.

Duhet ta kuptojmë se nuk mund të komandohet dhe të drejtohet si në regjimet e kaluara, por në bazë të parimeve të Partisë, ashtu siç veprohet në të vërtetë te ne. Rastet e veçanta të arbitrariteteve dhe shkeljeve të ligjshmërisë socialiste tregojnë se disa njerëz nuk i kuptojnë drejt natyrën, qëllimet dhe detyrat e pushtetit tonë popullor. Ata veprojnë, sigurisht, jo me ndërgjegje, siç vepronin dikur nëpunësit e regjimeve të vjetra, fjala vjen, prefekti e nënprefekti, të cilët kishin një kryeplak në çdo fshat, që e urdhëronin sipas interesave të regjimit në fuqi dhe ky bashkë me xhandarin zbatonin verbërisht urdhrat që i venin nga prefektura ose nënprefektura. Unë në asnje mënyrë nuk mund të them se këta pak njerëz në rendin tonë, që padashur shkelin ndonjëherë ligjet e pushtetit popullor, janë njëlloj si i sh-prefekti e nënprefekti, por disa veprime arbitrale që

kryejnë ata, siç janë, për shembull, gjobitja pa të drejtë e fshatarëve etj., atyre u ngjasin. E keqja është se këto veprime i kryen njeriu ynë, siç ka ndodhur me një kryetar kooperative bujqësore. Në rendin tonë socialist këto shfaqje negative janë absolutisht të palejueshme, prandaj të luftohet që të zbatohen me përpikëri dhe drejt ligjet, dekretet, vendimet, urdhëresat dhe udhëzimet që janë të kuptueshme, të zbatueshme dhe japin zgjidhje të sakta e të drejta për të gjitha problemet.

Ta kemi të qartë, shokë, se rendi ynë socialist ka marrë përsipër përgjegjësi të mëdha, se është rend popullor dhe, si i tillë, ka një metodë drejtimi dhe organizimi krejt ndryshe nga ai kapitalist. Ai ka marrë përsipër revolucionarizimin e tërë jetës së vendit dhe edukimin politik të njerëzve në një drejtim të ri, siç janë mësimet për brumosjen e masave me ndjenjën e lartë të punës dhe të pronës socialiste, për vënien e interesit të përgjithshëm mbi atë vetjak etj., etj.

Siç e dimë pushteti ynë popullor është një formë qeverisjeje thellësisht demokratike, që lufton për interesat e lartë të popullit; ai nuk është një sistem shtetëror formalisht demokratik. Shokët që janë ngarkuar me detyra drejtuese në qendër, në rrëth ose në bazë, duhet ta shikojnë mirë e me përgjegjësi plotësimin e detyrave të ngarkuara dhe të punojnë pa u lodhur për ta çuar kurdoherë punën përpara.

Për revolucionarizimin e aparatit shtetëror duhet çrrënjosur burokratizmi që është armik i demokracisë socialiste dhe shkëput pushtetin nga populli. Ne, për hir të interesave të popullit, nuk qëndrojmë indiferentë, por me takt dhe në rrugë parimore ndërhyjnë deri edhe

në jetën familjare të njerëzve, me qëllim që jetë kudo tek ne të zbulurohet, që marrëdhëniet midis pjesëtarëve të familjes të jenë sa më të drejta e demokratike dhe gjendja ekonomike e tyre sa më e mirë, që kalamajtë të vishen, të ushqehen dhe të edukohen sa më mirë. Në regjimet e kaluara nuk çante kokën kush, kur njerëzit vdisnin nga uria dhe sëmundjet. Qeveritarët e regjimeve antipopulllore nuk bëhen merak nëse bëhej apo nuk bëhej gruri ose misri, nëse njerëzit i përlanin sëmundjet etj. E si mund ta çante kokën për popullin Mustafa Merliku, që ishte shitur kokë e këmbë te fashistët italianë, kur blinte nga jashtë misër për t'ua shitur pastaj dyfish masave të uritura?

Shkelje të normave të Partisë dhe të ligjeve të shtetit nuk ka vetëm në rrethin e Dibrës, por edhe në Kukës. Ne kemi rrethe ku shfaqje të natyrës që përmenda nuk janë problemi, sepse atje udhëheqja e Partisë dhe e pushtetit ka punuar më mirë politikisht dhe ideologjikisht, nuk ka lejuar të bëhen shkelje të ligjshmërisë sonë revolucionare. Në to janë bërë më shumë përpjekje për të kuptuar drejt vijën e Partisë. Edhe kur nuk e kanë realizuar planin, shokët përgjegjës nuk kanë kryer arbitraritetë ndaj popullit, nuk kanë falsifikuar shifrat e realizimit të planit dhe kanë raportuar të vërtetën në organet qendrore. Udhëheqjes i intereson gjendja e vërtetë; ajo kërkon të njohë kurdoherë realitetin e jetës ashtu siç është, nuk ka nevojë t'i paraqiten gjërat të lustruara. Ata që përmenden në raportin e aparatit të Presidiumit dhe kanë lejuar shkelje dhe arbitraritetë, nuk janë të ndërgjegjshëm për vijën politike të Partisë. Këtë duhet ta kenë të qartë shokët e rrethit të Kukësit.

Ta kuptojmë mirë që shteti ynë po zhvillohet në mënyrë progresive, popullata në Shqipëri shtohet vazhdimisht, punët e pushtetit sa vijnë e zgjerohen. Gjithë ky zhvillim e përparim kërkon përpjekje shumë më të mëdha se gjer tani, prandaj rutina e vjetër që ekziston akoma në metodën e në stilin e punës të organeve të pushtetit, oshtë e domosdoshme të kapërcehet. Këshillat popullorë dhe komitetet e tyre ekzekutive në rrethe e në bazë, duhet të vetëveprojnë më me iniciativë në bazë të kompetencave që u janë dhënë. Për këtë problem ne kemi folur këtu, në Presidium; për të oshtë diskutuar në bazë dhe tashmi janë aprovuar e po zbatohen kompetencat e instancave të ndryshme të pushtetit dhe ka përparime në këtë drejtim. Megjithatë, siç del, ka edhe raste formalizmi dhe shfaqje të burokratizmit në dhënen dhe në ushtrimin e kompetencave të plota. Duke e parë më mirë këtë çështje në praktikë konstatohet se kompetencat nuk jepen në çdo rast si duhet; ato mbahen nga organet më të larta dhe këtu duket qartë se e vjetra e frenon të renë me arsyetimin formal se organeve më të ulëta «u mungon astësia», se ato «bëjnë gabime», mbasi «nuk i dinë gjërat» etj. Këto janë mendime të papjekura, të vjetra, konservatore dhe prapanike, prandaj të luftojmë që kompetencat e dhëna të vihen kudo në jetë, pa vonesë dhe të zbatohen mirë.

Në lidhje me ushtrimin e kompetencave del nevoja të kemi parasysh edhe zgjedhjen e njerëzve të aftë përkuptimin dhe zbatimin e plotë të tyre. Në qoftë se në një qendër pune, për shembull, kemi caktuar si drejtues një njeri me moshë të shkuar që ka luftuar, oshtë trenguar besnik i Partisë dhe i popullit, oshtë dekoruar

për meritat e tij etj., por nuk i njeh aparaturat teknike të qendrës së punës, që drejton, që nuk merr vesh, pra, nga zanati, atëherë çfarë tjetër, përvç frazave të përgjithshme, që s'kanë lidhje me teknikën, inund të presin prej tij inxhiniceri, tekniku etj., që kanë bërë shkollë dhë janë marrë për shumë vjet me radhë me këto aparatura? Njerëzit që zotërojnë teknikën, që njojin dhe përdorin aparaturat, që janë të mirë politikisht etj., përsë të mos vihen në krye të këtyre punëve? Pra, megjithëse janë çuar edhe specialistë të mirë, në ndonjë qendër punc atyre nuk u jepen kurdoherë detyrat dhe kompetencat që u takojnë!

Të mos pritet, siç veprohet deri tani, që të gjithë urdhrat të vijnë nga ministritë. Kur shtrohen këto probleme në bazë, dëgjon shpeshherë të thuhet: këtë çështje e ka në kompetencë ministria, atë e ka ministria etj. Ministria do ta bëjë sigurisht punën e vet, por për shumë gjëra duhet të japë mendim edhe rrathi. Prandaj mendoj t'u jepen akoma kompetencat e tjera që u përkasin organeve të bazës, bile, t'u jepen të plota. Po të veprohet kështu, atëherë ministria do t'u ketë mundësi të merret me ato probleme të rëndësishme që me të vërtetë i takojnë asaj t'i zgjidhë. Përse u dashka të merret Ministria e Ndërtimit deri me shpërndarjen e çimentos në Sarandë?! Nuk mendohet se po të preokupohet ajo edhe për gjëra të tillë që mund t'i zgjidhë vetë rrathi me iniciativë dhe me kompetencë të plotë, do të mbeten pa kryer detyrat e tjera më të rëndësishme që i janë ngarkuar?

Me çfarë probleme të rëndësishme mund të merret ministria? Ja, po ju jap një shembull: Ne po shkojmë

gjithmonë e më shumë drejt mekanizimit të proceseve të punës. Të gjitha punishtet e vogla që kemi sot, të cilat bëjnë, ta zëmë, vetëm 5 detale në ditë, në të ardhmen duke i mekanizuar, ato do të jenë në gjendje të prodhojnë jo 5, po 500 në ditë. Mekanizimi i proceseve të punës do të lirojë kështu mjaft krahë pune. Ku do të shkojnë tërë këta krahë që do të lirohen? Nuk është, pra, ky një problem, për të cilin duhet të mendojë me kohë ministria? Njerëzit që do të lirohen nga puna që kryenin më parë, natyrisht, duhet t'i çojmë atje ku atdheu ka më shumë nevojë për krahë pune, pra, në fshat. Mirëpo kjo çështje nuk mund të zgjidhet lehtë, pse duhet nienduar gjithçka me kohë: Ku do të flenë këta njerëz, ku do të ushqehen, si do të jetojnë etj., etj. A nuk është ky një problem i madh për të cilin duhet të mendojë dikasteri? Sigurisht që po.

Po jap edhe një shembull tjetër: Ne, me qëllim që t'i jepet një hov i madh rritjes së prodhimit bujqësor, kemi krijuar kooperativat bujqësore të tipit të lartë. Po është bërë vallë ndonjë studim i thellë e serioz për perspektivën e këtyre kooperativave bujqësore, në të cilat përfshihen zona fushore, malore dhe kodrinore? Ne do të mekanizojmë në maksimum proceset e punës edhe në bujqësi, duke u përqendruar në tepër në zonat fushore. Duke mekanizuar punimet në zonat e fushës, atje sigurisht do të na lironen një pjesë krahësh pune, që nuk mund t'i lëmë të rrinë kot, në një kohë kur zonat malore dhe kodrinore kanë nevoja të mëdha të zhvillohen për të dalë sa më parë nga prapambetja. Ne kemi shumë fronte për forcat e lira të punës, disa prej tyre do t'i çojmë nëpër uzina e fabrika të tillë gjigante, siç do të jetë

metalurgjia e Elbasanit etj., që do të kenë shumë nevojë për krahë pune. Përveç forcave të lira që do të sistemo-hen në uzina e fabrika, një pjesë prej tyre, siç thashë, do t'i çojmë në malësi.

A nuk janë këto disa probleme, me të cilat duhet të merret ministria përkatëse? Duke mekanizuar proceset e punës në bujqësi, për një kohë shumë të shkurtër, do të na krijohen forca të lira pune. Forcat e punës që u liruan gjatë 5 vjetëve të fundit nëpërmjet mekanizmit, pa këtë mekanizim, do të na liroheshin, ndoshta pas 15 vjetësh. Prandaj Ministria e Bujqësisë duhet t'i marrë në studim këto probleme kaq të rëndësishme. Mirëpo, në qoftë se ajo do të merret, fjala vjen, edhe me shpërndarjen e grurit në një rrëth, në atë shkallë sa të caktojë që kaq kuintalë të çohen këtu dhe aq atje, sigurisht s'ka se si t'i mbetet kohë për t'u marrë me të tilla probleme të rëndësishme.

Në këtë drejtim edhe rrëthet duhet të kenë më shumë kujdes. Pse të lihen pa u përdorur gatrat në rrëthin e Kukësit? Mos vallë për to duhet të merren organet qendrore? Për këtë mungesë përgjegjësi mban komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të këtij rrëthi. Kështu është e vërteta, shoku Kudusi¹, prandaj të bëni shumë kujdes, që të mos lihen në asnje rast pas dore dhe ca më shumë të bëhen të papërdorshme mjetet e punës që ju dërgohen nga qendra për bujqësinë. Unë të njoh, ti je një shok shumë i mirë dhe kemi besim se do t'i kryesh mirë de-

1. Kudusi Shehu — në atë kohë kryetar i Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit të Kukësit.

tyrat, por për të metat që konstatohen në rreth, përgjegjësi ke edhe ti, kanë edhe shokët e tjerë.

Për të metat në punë të kësaj natyre duhet të vihen, gjithashtu, përpara përgjegjësisë edhe kuadrot e specialistët e bujqësisë të rrethit tuaj. Pse të lihen për shembull, te ju pa u vjelë patatet? Po të pyetet agronomi përkëtë çështje, mund të thotë: «Patatet nuk i shkulim dot». Sikur t'i bësh pyetjen: «Po të përdorësh plugun, shkulen vallë?», ai do të përgjigjet: «Shkulen, po me 10 për qind humbje». Por duhet menduar, shokë, se po të mos i marrim me kohë patatet, kur të vijnë ngricat, do të rezikojmë të humbasim më shumë se 10 për qind të tyre. Atëherë përsë presim më gjatë? Kështu nuk do t'i plotësojmë detyrat asnjëherë. Mos vallë për këto çështje duhet t'i udhëzojë Ministria e Bujqësisë shokët e këtij rrethi?

Në Dibër dhe në rrethet fqinje me Kukësin, nga së dimë, është bërë një punë shumë e mirë për frutikulturën. Keni vajtur, ju shokë të rrethit të Kukësit, për të parë si veprojnë atje? Nuk keni vajtur. Po ç'pritni, përsë nuk shkon, qoftë në Dibër, qoftë në rrelle të tjera që të mësoni kokulur si kanë vepruar atje për frutikulturën, për mbjelljen e shkuljen e patates dhe për probleme të tjera që e shqetësojnë rrethin tuaj?

Kur dëgjon për dobësi të tilla, si të rrethit të Kukësit, njeriu nuk mund të jetë i qetë, me të drejtë zien përbrenda. Unë nuk them se shokët e këtij rrethi nuk i shqetëson kjo gjendje, përkundrazi ata brengosen përkëto probleme, pse nuk mund të mohohet që jehona e këtyre dobësive të ne, këtu në qendër, ushton më me pak forcë se te ju, sepse atje përplasen dhe vihen në

dukje më përpara këto çështje. Ne i kuptojmë edhe vështirësitë e punës suaj dhe kemi respekt të madh për sa bëjnë atje organet e pushtetit dhe të Partisë, por është fakt, gjithashtu, se Partia dhe pushteti në qendër ju ndihmojnë, prandaj përfiton më shumë nga ndihma e tyre, edhe iniciativë duhet të keni më shumë në punë. Të gjitha zotimet që merrni, i zbatoni më me kurajë dhe me më shumë energji.

Partia dhe Qeveria i kuptojnë vështirësitë tuaja, por dhe ju duhet t'i kuptoni vështirësitë që u lindin atyre gjatë punës së përditshme; shumë prej tyre janë probleme të marrëdhënieve tregtare të vendit tonë me botën e jashtme.

Por, pengesa e mosrealizime ka edhe në tregun e brendshëm. Në rrethe nuk punohet kurdoherë si duhet për të evaduar mallrat që ndonjëherë kanë mbetur stoque, nuk bëhen përpjekje të gjithanshme pér të mos u ulur qarkullimi i parasë nën pretekstin se «nuk kemi mallra» ose «po të kemi mallra me cilësi të lartë, xhiroja bëhet më e madhe dhe gustot e popullit plotësohen më shumë» etj., etj.

Shikoni, pra, sa probleme ekzistojnë, që pér t'i zgjidhur mirë, kërkohet një punë e madhe nga ana jo-në. Të mos harrojmë, shokë, se as ne, as të tjerët, nuk i zhdukin dot kaq lehtë këto vështirësi që dalin nga puna e përditshme. Megjithëkëtë rrugëzgjidhje ka, por duhet menduar që ato të gjenden.

Unë mendoj se punonjësve të tregtisë u del detyrë që ta bëjnë më mirë dhe më gjerë propagandën pér tregtimin e mallrave që kanë në shitje. Kur një klient vete në dyqan dhe pyet shitësin nëse e ka një lloj plaçke që i

duhet, ka raste që ky i përgjigjet ftohtë: «Jo, nuk e kam». Kur një klient tjetër shprehet se i dëshiron këpucët në këtë ose atë numër apo model, ka shitës që ia presin shkurt: «Vetëm nga këto kam, po deshe merri, po deshe lëri». Kështu nuk është mirë të veprohet. Kur klienti kërkon një mall që atë ditë dyqani nuk e ka, punonjësi i tregtisë, duke njojur normat e kulturës tregtare, të përpinqet t'i ofrojë një mall tjetër të ngjashëm me atë që kërkon klienti, të cilit t'i shpjegojë se ky është gati njëlloj i mirë si ai që dëshiron, i bukur, i fortë etj., etj. Pra, çdo shitës duhet të sillet me kulturë dhe të mundohet të bëjë propagandë për shitjen e mallit që ka në dyqan.

Edhe për çmimet e mallrave që shiten duhet të interesohet punonjësi i tregtisë. Kur vjen klienti në dyqan dhe merr dijeni për çmimin e një malli që i nevojitet, por nuk e blen, duke u shprehur se i duket i shtrenjtë, atëherë shitësi e ka për detyrë ta pyesë: «Po ju, shok, sa do ta blinit atë?». Në qoftë se blerësi përgjigjet se mund ta blinte dy ose pesë lekë më pak, atëherë punonjësi i tregtisë të mbajë shënim dhe këtë të dhënë t'ua raportojë eprorëve që ta studiojnë si një kërkuesë të klienteve, pastaj të studiohet nëse mund të ulet apo jo çimi i këtij malli.

Për disa mallra që nuk gjenden me bollëk në treg, shitësi duhet t'u sqarojë blerësve arsyet e mungesave dhe jo t'i përcjellë, duke u thënë: «S'ka».

Këto probleme mund të zgjidhen nga baza, por disa prej tyre duhet të zgjidhen nga dikasteret.

Siq thashë në fillim, problemet që ngrihen nuk janë të reja. Shokët folën konkretisht dhe në mënyrë bin-

dëse dhe del se me të vërtetë ju keni punuar, por akoma ka edhe mjaft të meta, prandaj tok me Partinë dhe me masat e popullit, të korrigjohen këto të meta vazhdimisht, në mënyrë të organizuar dhe sistematike.

*Botuar për herë të parë me
disa shkurtime në librin:
Enver Hoxha, „Për pushtetin
popullor (Përmbledhje
reprash) 1942-1982“, f. 507*

*Botohet i plotë sipas tekstit të
nxjerrë nga procesverbali i
mbledhjes së Presidiumit të
Kurendit Popullor të RPSSH,
që gjendet në AQP*

KORÇEN E KAM DASHUR DHE E DUA, PSE KËTU KAM KALUAR NJË PJESE TE RINISE SIME

Nga bisedat gjatë vizitave në rrëthin e Korçës¹

30 gusht 1972

Në ditët që shoku Enver Hoxha ishte me pushime në Pogradec, e gjente kohën të bënte vizita edhe në rrëthin e Korçës. Këtë herë Ai i filloi vizitat nga ekspozita e prodhimeve industriale. Duke e vizituar këtë eksposítë, shprehte edhe përshtypjet e Tij dhe jepte këshilla e porosi.

Shumë të bukura janë këto prodhime të qelqit. Keni bërë përparime. Këto ua kalojnë edhe atyre të importit. Është mirë që prodhime të tilla të hidhen në treg.

Edhe për prodhime të vogla nga mbeturinat siç janë kuletat për gra, këpucët etj., ka nevoja sot dhe nuk pret puna për vitin që vjen. Kjo mund të arrihet, se ka dhe katër muaj që të mbylljet viti 1972. Të luftojmë burokratizmin që na pengon në këtë drejtim për të plotësuar nevojat e popullit.

1. Shënimë të mbajtura nga shoku Vangjel Çërrava, në atë kohë kryetar i Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit të Korçës, që shoqëronte shokun Enver Hoxha.

Këtu, në pavionin e këpucëve, paska këpucë me ngjyra të ndryshme, mirëpo në treg këto nuk i gjen. Edhe unë kërkova një palë këpucë dhe më dërguan vetëm tri ngjyra lëkurësh. Të mos i kemi prodhimet vetëm për në ekspositë, shokë.

Edhe këto prodhime ushqimore, sidomos për fëmi-jët, kanë rëndësi të madhe, por lidhur me këtë duhet të ecim më shpejt. Nuk duhen bërë gjithnjë prova pas provash dhe në treg të mos gjenden këto që shohim e që na thoni ju. Ka dy vjet që është mbledhur Plenumi i Komitetit Qendror dhe akoma s'po realizohen si duhet disa nga detyrat që u caktuan. Kalamajtë kërkojnë ushqime të mira, me kalori, që të rriten ashtu, si dëshiron Partia.

Zdrukthëtaria ka prodhime të bukura, por këto duhen zgjeruar akoma më shumë. Populli ka nevoja përmobilie. Me lëndë druri çdo gjë nuk përballohet dot, pse ajo na duhet përlotë, të cilën vazhdojmë ta sjellim nga jashtë. Duhet përdorur më shumë plastika, sintetika. Këto prodhime i keni të mira, por në treg, gjithashtu, nuk gjen.

Ja dhe prodhimet artistike sa të bukura janë! Këto i kërkon shumë eksporti, prandaj duhet të zgjerohet më shumë gama e prodhimeve artistike.

Veçanërisht prodhimet e trikotazhit e të qilimave janë të bukura. Sa do të shiten çorapet e holla të grave që kërkohen aq shumë? Këto duhet të jenë pak më lirë se ato që vijnë nga jashtë.

Para se të largohej nga eksposita, shoku Enver Hoxha bëri këtë shënim në librin e përshtypjeve:

Më bënë shumë përshtypje prodhimet që keni kë-

tu, që janë kaq të mira. Ju keni prodhime që ua kalojnë atyre të importit, sidomos prodhimet e qelqit. Korçarët janë njerëz me kulturë, u pjell mendja dhe u zë dora.

Pasi u largua nga eksposita industriale, shoku Enver Hoxha bëri një vizitë në ndërmarrjen e rrabave të gatshme. Këtu, ndër të tjera Ai tha:

Më kishin thënë fjalë të mira për ju, ndaj erdha t'ju vizitoj se ne duhet të bëjmë shumë gjëra për popullin. Gustot e njerëzve janë të ndryshme dhe këtë detyrë të rëndësishme Partia jua ka caktuar juve, grave të drejttoni. Dua të di, ku qepni, ku bëni prova? (Eshtë fjalë për prodhimet gjysmë të gatshme.) Si i keni kategoritë e punëtorëve? Po kurset e kualifikimit?

Pasi mori përgjigje, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Kurset e kualifikimit duhen organizuar mirë. Në fillim punëtoret e reja që mësojnë, të marrin njohuri të përgjithshme, të sistemuara. Në proceset e punës me kategori të lartë të kemi ata punëtorë që dinë më shumë procese pune dhic jo vetëm një. Punëtorët që sapo hyjnë në punë, të paguhen me një rrogë më të ulët. Kategoritë të mos jepen shpejt, por kur punëtorët të kenë ecur në profesion. Në të ardhmen do të prodhojmë më shumë mallra në vend, gjë që do të plotësojë më mirë kërkuesat e popullit, por detyra jonë është të rritim prodhimet edhe për eksport.

Çështje me rëndësi për popullin është rrjeti i tregtisë, dyqanet. Atje shprehen më mirë dëshirat dhe kërkuesat e popullit, të cilat vijnë te ju si porosi për prodhim. Si i keni kontaktet me shitësit e dyqaneve të tregtisë?

Po organizatën e Partisë a c keni të fortë? Sa komunistë ka? Çfarë niveli arsimor kanë? Si e keni organi-

zuar punën për edukimin e komunistëve? Veç programit që keni për edukimin, të punohen herë pas here edhe artikuj, të bëhen komente nga gazetat. Këtë punë ta bëjë sekretarja e organizatës-bazë të Partisë, drejtoresha e punonjës të tjerë të përgatitur. Sekretarja e organizatës duhet të jetë gjithnjë e përgatitur, të jetë në gjendje t'u përgjigjet pyetjeve që mund t'i bëhen nga të tjerët.

Problemet e edukimit të lidhen me problemet dhe me detyrat e fabrikës. Veç këtyre të gjallërohetjeta e organizatave-bazë të Partisë. Po të jetë organizata-bazë e gjallë, revolucionare, ajo është shkollë për të gjithë. Detyrat që keni, t'i plotësoni me dituri. A mësojnë punëtorët e reja? A janë të kënaqura me normat teknike, ç'të mira kanë këto lloj normash? Si janë me shëndet punëtorët, a ka shumë nga ata me raporte dhe çfarë pune bëjnë më shumë ata që sëmuren?

Për të gjitha këto pyetje, që tregojnë kujdesin e udhëheqësit të Partisë, shoku Enver Hoxha mori përgjigje dhe u largua i përcjellë me dashuri e gëzim.

Pastaj shoku Enver Hoxha bëri një vizitë në ekspozitën e arteve figurative. Duke folur për Korçën, ndërtë tjetra Ai tha:

Pak vjet kam qenë në Korçë, por qytetin tuaj e kam dashur dhe e dua, pse këtu kam kaluar një pjesë të rinisë. Vangjush Mion, që ka bërë gjithë këto piktura, e kam pasur mësues, pastaj u bëmë edhe kolegë. Unë ruaj respekt për të, se ishte njeri shumë i mirë, patriot, i kuptueshëm dhe i sjellshëm me nxënësit, njeri i dashur dhe artin e kishte pasion. Një herë i kërkova të më dhuronë një pikturë. Më tha: «Do të ta jap, por në këtë pik-

turë do të jesh ti». Pastaj shkova disa herë dhe më pozoi, e bëri pikturën, të cilën e pashë edhe të mbaruar, por nuk ma dha, sepse më thoshte: «Do të gjej rastin të ta dhuroj, do të ta jap kur të martohesh!». Pas Çlirimt e kërkova pikturën, por s'më ra në dorë.

Në shtëpi kam tri-katër tablo të këtij piktori të talentuar. Janë të bucura, me ngjyra të gjalla. Rrugët karakteristike të Korçës i ka bërë shumë bukur. Edhe unë i dua këto rrugë. Ndaj ato t'i ruani me kujdes dhe t'i restauroni si në Gjirokastër. Për mbrojtjen e tyre të bëheni mbështetësit më të mëdhenj ju, piktorët dhe skulptorët. Ne s'jemi kundër modernes, por jemi për atë moderne që lidhet ngushtë me ambientet socialiste. Ne jemi për gjëra të reja e të bucura, por edhe për ruajtjen e atyre objekteve të së kaluarës që kanë vlerë.

Korçarët janë njerëz të kulturuar. Këto objekte që paraqiten në këtë ekspozitë janë thesare, prandaj t'i ruani me kujdes; në këtë drejtim do të keni edhe ndihmën e Partisë. Duhet t'ju krijojmë mundësi juve, piktorëve, që të eksposoni njerëzit e shquar, të vendosni në vende të ndryshme të Korçës bustet e tyre.

Dua t'ju pyes: Ku fillon historia e Korçës? Ku ka filluar lëvizja komuniste në Korçë? Pikërisht te pazari i Korçës, që është një vend me rëndësi të madhe, pse ka qenë qendra e asaj klase punëtore të paktë, e zanatçinjve dhe e çirakëve, të cilët u bënë punëtorët e ardhshëm dhe qëndruan në ballë të përpjekjeve për themelimin e Partisë. Prandaj pazari të restaurohet, po pa i bërë ndryshime, të kihen parasysh shtëpitë e tjera korçare, të lyhen me gusto.

Keni bërë mirë që keni hapur ekspozitën. Ju lumtë!

Kjo ka rëndësi për të gjithë. E ardhmja do të jetë më e ndritur për Korçën. Ja, ky është portreti i Riza Kodhe-lit. Rizai ka qenë burrë i mirë, ai u lidh ngushtë me Partinë, është njeri i popullit.

Ju piktorët e skulptorët duhet të njiheni edhe me veprat e autorëve të mëdhenj, t'i studioni ato dhe të përfitonit prej tyre.

Unë do t'ju bëja një propozim: do të isha i mendimit që para hotelit të ri të ngrihet një monument përluftë. Demonstrata e bukës përbën një episod lufte. Ajo mund të jetë në relief, por kryesorja të jetë Lufta Nacionalçirimitare, kjo të jetë në sintezë. Mund të krijohet një grup skulpturor me tri-katër basorelieve. Edhe te lëndina e lotëve duhet diçka, duhet menduar të përgatitet ndonjë vepër që të pasqyrojë bashkë me realitetin e hidhur të asaj kohe edhe të ardhmen me optimizëm.

Veprat e artit nga Lufta Nacionalçirimitare duhet të shtohen. Për këtë të studiohen me kujdes veprat dhe dokumentet e Partisë, të vizitohen vendet ku janë zhvilluar ngjarjet që të mund të reflektohet në art në mënyrë të përgjithësuar Lufta Nacionalçirimitare dhe të mos mbetet kjo vetëm në libra, pse veprat e artit ngjallin ndjenja të mëdha.

Ju përgëzoj për sa keni bërë, pse nga duart tuaja keni nxjerrë gjëra të bukura. Duken qartë përpjekjet që keni bërë dhe këto janë fillimi. Çështja është që në veprat e artit mendimet të na shfaqen jo vetëm nëpërmjet figurave, po t'i mësojmë njerëzit e sidomos të rinjtë përtat dashuruar artin. T'i mësojmë njerëzit tanë të mos e konsiderojnë artin sa për të kaluar kohën e lirë, por si një ushqim të domosdoshëm për jetën e njeriut. Dhe

veprat tuaja duhet ta nxitin këtë qëllim te njerëzit tanë të socializmit. Në veprat tuaja, në personazhet tuaja populli të shohë të pasqyruar ndjenjat,ëndrrat dhe luftën e tij.

Më kanë pëlqyer gjithnjë oborret e Korçës, të rrethuara me kangjella, por s'më vjen mirë që disa prej tyre janë zëvendësuar me mure. Kjo nuk duhet lejuar, përkundrazi të ruhen traditat e bukura dhe, në këtë rast, të mirëmbahen e të shtohen oborret me lule, me kangjella, pse këto shërbejnë për çlodhjen e njerëzve¹.

Kur njeriu të shikojë këto peizazhe të bukura të Korçës, kur të dëgjojë muzikën korçare, do t'i duket sikur jeton me tërë atdheun. Këtë ju duhet ta kuptoni. Veprat tuaja do të jenë të mira, kur të shprehë realitetin, dëshirat dhe qëllimet e popullit. Në këtë drejtim mos u tërhiqni nga vështirësitet.

Detyra e Partisë është që ju, artistët e shkrimitarët, t'ju edukojë politikisht dhe ideologjikisht drejt. Një edukatë më e gjerë politike dhe ideologjike do t'ju bëjë t'i kuptoni drejt problemet e artit. Vlerësimi i veprave tuaja duhet të preokupojë më shumë Partinë, Qeverinë. Çështja nuk qëndron vetëm te stimujt materialë. Ajo që ka më shumë rëndësi te ne është stimuli moral. Ne kemi vende pritjeje, shtëpi-muze, ku nuk ka asnjë pikturë nga tuajat. Në këtë drejtim kemi shumë për të bërë, po veç edhe ju të jeni më ekzigjentë në kërkesat ndaj vetes, pse kjo na vë të gjithë në lëvizje.

1. Sipas kësaj porosie të shokut Enver Hoxha, u punua me aksion dhe u bë me kangjella rruga e bukur nga kinema „Morava“ deri te stadiumi „Skënderbeu“.

Ju uroj shëndet dhe krijimtari të mbarë në shërbim të Partisë dhe të popullit!

Në vazhdim, shoku Enver Hoxha bëri një vizitë në kooperativën e Plasës, ku zhvilloi një bisedë të ngrohtë me kooperativistët.

Duke biseduar me kooperativistë, Ai i pyeste si quhen, si janë me shëndet, po me punë, ndërsa me një kooperativiste zhvilloi këtë dialog:

SHOKU ENVER HOXHA: Si të quajnë ty?

NJË VAJZË: Bukurie.

SHOKU ENVER HOXHA: O sa emër i bukur! Me siguri këtë emër ta kanë vënë prindërit, pse fëmija për prindërit është aq i dashur, prandaj prindi e do ta ketë fëmijën të bukur deri tek emri.

Sa e keni rendimentin e duhanit? Me sa shikoj unë, sikur nuk e dini. Mirëpo gjendjen nuk duhet ta dijë vetëm brigadieri që ju drejton, por të gjithë, pse për mbarëvajtjen e kooperativës duhet të interesohen të gjithë anëtarët e saj. Gjendjen dhe detyrat në kooperativë t'i dini njëlloj si kryetarja e familjes, që si një nikoqire e mirë e njoh si duhet gjendjen e shtëpisë. Duhanin ju e prodhoni me punën tuaj, prandaj edhe llogaritë t'i bëni mirë se sa rendiment do të merrni.

Kur themi që detyrat e kooperativës t'i njihni mirë, kam parasysh, se me këto rroni ju, por me këto rron gjithë Shqipëria, pra, me punën e përbashkët. Në sajë të kësaj punc nga viti në vit ne po përmirësojmë jetën tonë, e bëjmi këtë gjithnjë e më të bukur. Tani ju jetoni më mirë se përpara dhc në të ardhmen do të jetoni akoma më mirë se tani. Gratë e Zëmbjakut dikur

vuanin shumië, se atje ka pasur shumë agallarë, të cilët synonin të shtypnin popullin tonë.

Jeta në fshat vazhdimisht po përmirësohet. Ju tani keni radio, më pas do të keni edhe televizorë, do të merrni më shumë arsim etj. Ky përmirësim do të jetë aq më i shpejtë, sa më e shpejtë të jetë rritja e prodhimeve tona.

Duhet të kuptohet mirë nga të gjithë se çështja e bujqësisë është shumë e rëndësishme. Sot, të detyruar nga mosrealizimi i planeve në bujqësi, po importojmë shumë produkte bujqësore e blegtorale nga jashtë, kur ne i kemi të gjitha mundësitë që me punën tonë të kemi më shumë prodhime, të rritim mirëqenien.

Ju këshilloj që të mos thoni asnjëherë që këto punë i dinë Enveri, komiteti i Partisë apo brigadieri, këto punë duhet t'i dini të gjithë, t'i dini ju që prodhoni, në radhë të parë. Prandaj të interesoheni më shumë për punët e kooperativës dhe kur shikoni se brigadieri jep urdhra të jashtëligjshëm, siç është urdhri i dhënë për prerjen e duhanit pa përfunduar vjetra, të ngriheni dhe të mos e lejoni zbatimin e tij. Ju i dini më mirë se kushdo gjërat, pse ju e prodhoni vetë duhanin.

Pastaj shoku Enver i pyeti kooperativistët përsë nuk u realizua plani i grurit, çfarë lloj farërash mbjell kooperativa dhe, pasi mori përgjigjen, porositi:

Të bëni çmos që deficitet t'i plotësoni me misër!

Më pas shoku Enver pyeti: «Si ju përgjigjet tregtia me furnizim, me veshmbathje?» dhe, si mori përgjigjen se ka kërkesa për të pasur më shumë vaj, djathë etj., Ai theksoi:

Që të kemi më shumë nga ato që dëshirojmë, është

e domosdoshme të prodhojmë më tepër dhe prodhimet bujqësore varen drejtpërdrejt nga ju. Pra, prodhoni më shumë, që edhe në dyqane të keni mallra më shumë. Ju në fshat keni mundësi të prodhoni më shumë bulmet, nuk jeni si punëtorët e qytetit, ju keni edhe oborrin koooperativist. Qyteti, siç e thatë vetë, ju ka furnizuar rregullisht, po ju, nga ana juaj, si e keni furnizuar qytetin? Nga sa dimë me boshillëqe.

Pasi pyeti për rendimentet që janë marrë, shoku Enver Hoxha tha:

Nga toka ka mundësi të marrim shumë, po duhet të punojmë më mirë. Kur të marrim më shumë prodhimë, si për shenbull 30-35 kuintalë për hektar grurë, edhe të ardhurat do të janë më të mëdha. Kjo do të arrihet, në radhë të parë, me punën tuaj. Prandaj është në interesin tuaj dhe në interes të atdheut të punoni më mirë për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale.

Detyra të mëdha kemi në fshat për realizimin e planeve në bujqësi e blegtori, por kemi detyra edhe në qytet, veçanërisht atje ku ndërtojmë vepra të reja, ku ka nevoja të mëdha për fuqi punëtore. Edhe rrethi i Korçës ka detyra nü këtë drejtim, pra, të punohet që njerëzit të venë atje ku i kërkon Partia, në miniera, në hekurudhë e kudo.

Përse e ndërtojmë hekurudhën Elbasan-Përrenjas? Që të transportojmë hekurin. Përse e ndërtojmë metalurgjinë? Se na duhet çelik. Ne, pra, do të ndërtojmë çdo gjë që na duhet, që të jemi të pavarur, kështu do të jemi akoma më të fortë se tani.

Përparimet që kemi bërë janë shumë të mëdha dhe këto janë arritur në sajë të punës së popullit, të punës

suaj. Ju punoni këtu, në fshat. Juve as që ju shkon mendja se me punën që bëni keni kontribuar edhe në ndërtimin e Hidrocentralit të Vaut të Dejës dhe vazhdoni të kontribuoni në ndërtimin e tërë veprave të tjera të pësëvjeçarit që po ndërtohen në vendin tonë. Pra, kur punoni në arë, duhet të mos mendoni vetëm për përmirësinin e jetesës në familjet tuaja, për përparimin e koooperativës suaj bujqësore, po të mendoni edhe për tërë Shqipërinë.

Unë fola më shumë se ju, ndërsa nga ana juaj pak pyetje m'u bënë. Kjo nuk duhet të ndodhë kështu. Për një rast edhe mund të lejohet, se unë nuk para kam mundësi t'ju takoj dendur, por kini parasysh që kur ju vijnë shokët e rrëthit, u bëni sa më shumë pyetje, se këta duhet t'ju përgjigjen, në mënyrë që t'i keni të qarta të gjitha problemet që kemi përpara për të zgjidhur.

Ju uroj shëndet të plotë dhe suksese në punë! U jepni të fala nga unë gjithë pjesëtarëve të familjeve në shtëpitë tuaja!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këto
vizita, që ndodhen në AQP*

LIRINE E FITUAR ME AQ SAKRIFICA DO TA MBROJME NË ÇDO KOHË DHE ME ÇDO ÇMIM

*Nga biseda me kryetarin e Shoqatës së Miqësisë
Francë-Shqipëri, profesor Pol Miliez*

11 shtator 1972

Mirë se erdhët i nderuar mik! Kisha dëshirë të njihesha personalisht me ju, si mik i Shqipërisë që jeni dhe si një personalitet i shquar i popullit francez, jo vetëm në fushën e mjekësisë, por edhe si pjesëmarrës në rezistencën antifashiste kundër pushtuesve nazistë të Francës. Prandaj, në emër të popullit shqiptar, të Qeverisë dhe të Partisë sonë, ju përshëndes dhe dëshiroj t'ju falënderoj edhe për mirësinë që keni pasur të merrni mbi vete përgjegjësinë si kryetar i Shoqatës së Miqësisë Francë-Shqipëri. Është një nder për ne që në krye të kësaj shoqate jeni zgjedhur ju që së bashku me shokun Myri, jeni dy personalitete të njoitura që po i jepni një impuls të ri miqësisë që ekziston midis popullit tonë dhe atij francez. Ne dëshirojmë që kjo miqësi të forcohet gjithnjë e më shumë dhe jam i sigurt se Shoqata e Miqësisë Francë-Shqipëri, që ju kryeson, do të ndihmojë shumë në këtë vepër të madhe kulturore dhe

miqësore që keni ndërmarrë. Edhe ne, nga ana jonë, do të bëjmë akoma më shumë për forcimin e kësaj miqësie, do t'ju ndihmojmë me materialet tona kulturore, shkencore, folklorike, në mënyrë që t'i bëjmë sa më të njohura nü masat e popullit francez jetën dhe përpjekjet e popullit shqiptar, aspiratat dhe luftën e tij për një jetë akoma më të mirë.

Në vendin tonë organizojmë konferanca të ndryshme, për to përgatitim edhe gjithfarë materialesh studimore, të cilat mund dhe duhet t'u bëhen të njohura edhe opinionit francez e të vendeve të tjera. E kam fjalën për ato drejtime që ju interesojnë drejtpërdrejt. Për shembull, së shpejti do të bëhet në Tiranë Kuvendi i Parë i Studimeve Ilire, materialet e të cilit mund t'u interesojnë një numri studiuesish jashtë Shqipërisë. Meqenëse në këtë fushë ka një numër çështjesh, që nuk janë svaruar akoma për arsyet e një numri studiuesve të huaj që interesohen për to, bille të përkthyera në gjuhët që do të dëshirojnë. Nga ana tjetër, është e nevojshme që edhe në Shqipëri të bëhen akoma më të njohur vendi juaj dhe kultura e tij, t'u mësohet të rinjve e të reja ve tona gjuha frëngje, me anën e së cilës ata do të mund të përfitojnë sa të jetë e mundur më shumë nga thesari i madh që ka krijuar populli francez në shekuj.

Sic shihet, pra, krahas interesave të përbashkët, ne kemi edhe detyra të përbashkëta, të cilat jemi të sigurt se do t'i përmbushim reciprokisht. Gjatë përpjekjeve në këtë drejtim, jashtë vullnetit tonë, do të ketë ndoshta

edhe pengesa e ngadalësime, por në fund të fundit jemi të sigurt se me vullnetin e të dyja palëve ne do t'ia arrijmë realizimit të të gjitha detyrave, që i kemi vënë vetes për forcimin e miqësisë dhe të marrëdhënieve midis dy popujve tanë, për të mirën e përbashkët.

Duke marrë fjalën, profesor Pol Miliezi foli për forcimin e miqësisë midis popullit francez dhe popullit shqiptar. Midis të tjerare, ai theksoi:

Populli francez e di që populli shqiptar është i vetmi popull në Evropë, që u çlirua vetë... Më lejoni të shpreh me këtë rast dashurinë për popullin shqiptar dhe për Ju që udhëhiqni këtë popull. Personalisht, unë do të bëj gjithçka që është e mundur për të përmirësuar punën për njohjen reciproke të dy popujve tanë. Midis nesh ka mundësi të mëdha që në shumë fusha ta zhvillojmë miqësinë dhe ta çojmë gjithmonë e më përpara punën e Shoqatës së Miqësisë Francë-Shqipëri.

Fjalën e mori përsëri shoku Enver Hoxha:

Në këtë drejtim ndihmon edhe tradita e mirë në marrëdhëniet tona, për arsyen se populli francez nuk ka pasur as fërkime, as konflikte me popullin tonë, të dyja palët kemi konsiderata për njëri-tjetrin. Në të kaluarën, jo se populli juaj i ka bërë keq drejt përdrejt popullit shqiptar, por qeveritë franceze kanë ndjekur një politikë që nuk përputhej me atë të vendit tonë, duke mbështetur sqinjët tanë. Do të dëshironim që ky qëndrim t'i takonte vetëm së shkuarës.

Në të kaluarën, në një kohë kur arsimi në vendin tonë ishte shumë prapa, në Shqipëri u hapën dy lice franceze, një në Gjirokastër dhe tjetri në Korçë. Programi i

këtyre liceve ishte atëherë nga më të plotët dhe gjëzonte respektin e njerëzve tanë. Një gjeneratë e tërë mori kulturë në këto dy shkolla, të cilat kishin një aft gjëra pozitive. Profesorët francezë që punonin në këto dy shkolla ushqenin respekt për popullin tonë. Disa prej tyre, megjithëse kishin opinione politike të ndryshme, ishin shumë korrektë në marrëdhëniet me popullin dhe me rininë tonë, prandaj ne ruajmë edhe sot respekt për ta. Kishte atëherë midis tyre elementë të rrymave të ndryshme nga pikëpamja politike: socialistë, radikal-socialistë, ruajalistë etj., por, kur qëllonte të bisedoje me ta, qoftë unë, si kolegu i tyre, qoftë të tjera, megjithëse pikëpamjet mund të ishin të ndryshme, ata ishin të gatshëm të jepnin shpjegimet e duhura për kulturën demokratike franceze dhe bënин që ta doje atë. Ata në atë kohë ndihmuin për arsimimin e rinisë sonë, për t'i përgatitur të rinxjtë tanë si specialistë të shkencave ekzakte dhe të shkencave të tjera sipas programit arsimor francez.

Kur u sulmua Shqipëria nga Italia fashiste në prill të 1939-s, drejtori i Liceut të Korçës, Ksavie dë Kurvil, që ishte ruajalist, erdhi e më takoi në sallën e profesorëve dhe faqe të gjithëve u shpreh me përbuzje për push-tuesit: «Poshtë fashizmi! — tha ai. — Unë jam me ju deri në fund, jam me Shqipërinë, nuk e aprovoj pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste».

Me këto dua të them se në regjimin e Zogut, kur ishin ngritur dhe funksiononin licetë franceze në Shqipëri, njerëzit tanë fituan shumë njohuri. Njohja me Revolucionin Demokratiko-Borgjez të Francës të vitit 1789, i ndihmoi shumë për formimin e tyre në atë kohë,

kur në Shqipëri sundonte një regjim terrori. Midis tyre qarkullonte jo letërsi reaksionare, por letërsi përparimtare e shkrimtarëve modernë dhe seriozë francezë. Pedagogët dhe udhëheqja e këtyre dy liceve ndihmuan në këtë punë, e cila ishte veprimitari e ndërgjegjshme nga ana e tyre, prandaj ka lënë përshtypje të mira te nxënësit dhe te populli shqiptar.

Aktualisht në shkollat tona gjuha frëngje mësohet nga një numër i madh nxënësish e studentësh. Ajo fillon të jepet si lëndë që në klasën e pestë të disa shkollave tetëvjeçare. Në Tiranë kemi një shkollë të mesme të posaçme të gjuhëve të huaja, ku mësohet, veç gjuhëve të tjera, edhe frëngjishtja. Gjithashtu në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, ka një degë të veçantë ku mësohet edhe gjuha frëngje. Por shumë të tjerë e mësojnë këtë gjuhë duke ndjekur kurset e shumta që janë hapur kudo. Këtë e bëjmë sepse populli, sidomos rinia jonë, janë të etur për dituri. Ashtu si gjuhët e popujve të tjerë, edhe gjuhën e popullit tuaj ne kemi interes ta mësojmë sepse nëpërmjet saj njihem me eksperiencën e madhe të popullit francez, me rezultatet e arritura nga ai në shkencë, në filozofi dhe në të gjitha fushat e tjera të diturisë. Pikërisht për këtë qëllim të rinjtë e të rejat tona mësojnë çdo ditë e më shumë gjuhët e huaja.

Unë vetë lexoj frëngjisht dhe ka raste kur edhe shkruaj në këtë gjuhë. Gjuha frëngje është një gjuhë e bukur, me një saktësi të madhe në shprehjen e njoherive të thella të përpunuara gjatë shekujve nga populli francez.

Populli francez ka një kulturë të lashtë dhe të gje-

rë, të pasur me pikëpamje e me ide demokratike dhe pikërisht kjo kulturë na intereson shumë edhe neve. Në Francë kemi dërguar studentë dhe teknikë shqiptarë për të vazhduar shkollat ose për t'u specializuar në fusha të ndryshme të shkencës.

Kuadrot që kemi dërguar në Francë për t'u specializuar në mjekësi, kanë pasur ndihmën tuaj personale, nga e cila të tërë janë të kënaqur. Ju vetë keni punuar për ta ndihmuar Shqipërinë në përgatitjen e kuadrove të saj. Ne i kemi parë kur janë kthyer në atdhe, që ata kanë qenë të pajisur me dije e kulturë më të lartë. Për këtë arsy ne dëshirojmë t'ju falënderojmë nga zemra, zoti Miliez.

Ne dëshirojmë që kuadrot tanë në Francë të mësojnë në të tilla drejtime si në mjekësi, në matematikë të lartë, elektronikë, agronomi, për arsy se vendi juaj ka ecur përpara në këto fusha. Për shembull, për sa u përket hibrideve ose patates, Franca është shumë përpara, ka një nivel të lartë, prandaj ne dërgojmë kuadro të bujqësisë të specializohen në vendin tuaj. Po kështu bëjmë ne edhe për përkthyes të gjuhës frëngje.

Megjithëse në politikë e në ideologji nuk jemi dakord me qeverinë franceze, disa qëndrime të saj ndaj imperialistëve amerikanë i kemi gjykuar të drejta. Kështu i konsiderojmë, për shembull, disa qëndrime të prera të Dë Golut ndaj imperialistëve amerikanë, të cilët ai i njihte mirë. Me ta ai kishte për të rregulluar shumë hesape të lindura që nga kohët e vështira të Luftës së Dytë Botërore.

Edhe ne, po të mos u kishim rezistuar anglo-amerikanëve, do ta kishim pësuar siç e pësuan grekët. Partia

jonë ua bëri të qartë atyre se ne nuk mund të bënim atë që dëshironin ata, se për popullin tonë kishte mbaruar një herë e përgjithmonë ajo kohë kur të tjerët e merrnin nëpër këmbë. Ne, shqiptarët, jemi vërtet një popull i vogël, por ama një pretendim të madh e kemi: Ne dëshirojmë të kemi vendin tonë nën diell, të gjëzojmë lirinë për të cilën kemi luftuar në shekuj dhe që e kemi fituar me shumë sakrifica. Tani që këtë e kemi fituar, jemi gati ta mbrojmë në çdo kohë dhe me çdo çmim.

Ka njerëz që çuditën me këtë qëndrim tonin dhe thonë: «E ç'është ky vend i vogël përpara gjithë kësaj bote të madhe? Një pikë ujë në oqean!». Megjithëse jemi popull i vogël dhe nuk e kemi zakon të bërtasim shumë, ne shqiptarët ato që mendojmë, i themi hapur. Ne kurrë nuk kemi dashur dhe nuk duam t'i bëjmë keq njeriu, por nuk lejojmë as të tjerët të na bëjnë keq. Ca më tepër nuk lejojmë të bëhemë satelitë të të tjerëve. Disa mendojnë se po të jesh i vogël, për të jetuar, duhet të jesh medoemos nën kujdestarinë dhe vartësinë e më të mëdhenjve, përndryshe ke mbaruar. Por ne, shqiptarët, nuk dëshirojmë të rrojmë nën «kujdestarinë» e të tjerëve, të varur prej tyre. Marrëdhënie të mira ne duam të kemi me të gjithë popujt, por mbi baza barazie, pa ndërhyrë në punët e brendshme të njëri-tjetrit. Veç, në qoftë se dikush orvatet të na prekë, qoftë fuqi e madhe apo e vogël, ta dijë mirë se ne do të hidhemi në luftë kundër tij.

Ju mund të thoni: «Po çfarë mund të bëni kundër imperialistëve amerikanë?». Ne themi se do të mbrohemë. A është e mundur që një vend kaq i vogël të mbrohet nga sulmi i një fuqie të madhe që disponon armë

nga më modernet? Po, mendojmë ne, mund të mbrohet, kur ai është i përgatitur e përgatitet vazhdimisht për këtë dhe nuk ia lejon vetes që armiqtë ta gjejnë në befasi. Ne me punën, djersën dhe gjakun tonë jemi në gjendje të përballojmë çdo situatë. Prandaj jemi të bindur se çdo fuqi e madhe, megjithëse ka armë nga më modernet, nuk kalon dot, nuk mund të na mposhtë. Edhe lufta heroike që po bün populli vietnamez është një shembull që e tregon shumë qartë një gjë të tillë.

Revisionistët sovjetikë, kur ishte Hrushovi në fuqi, për të na frikësuar na thoshin se Bashkimi Sovjetik është fuqi e madhe, se ju shqiptarët jeni një popull i vogël dhe nuk jeni në gjendje të mbroheni. Por ne nuk u frikësuam nga shantazhet e tyre dhe këtë e ka treguar mirë lufta e rreptë parimore që u kemi bërë. Kjo i shtyu ata të llogaritnin se në Shqipëri nuk do ta kishin të lehtë si në Çekosllovaki. Ne nuk jemi si revisionistët çekë. Dhe kush bën llogari, nuk është vështirë ta kuptojë qëndrimin tonë të vendosur.

Ne kemi pasur marrëdhënie korrekte me sovjetikët gjatë kohës kur jetonte Stalini, i cili ishte një udhëheqës inteligjent, i sjellshëm dhe shumë i drejtë. Këtë nuk jua them për t'ju bërë propagandë për të, as për t'ju bindur që të përqafoni idetë e tij, por dëshiroj t'ju vë në dukje ato që kam parë thjesht me sytë e mi, qëndrimet shumë korrekte të Stalinit. Ndërsa propaganda e ndyrë e Hrushovit dhe e Titos është përpjekur të hedhë kaq shumë baltë ndaj këtij personaliteti të madh.

Titoja ka deklaruar shpesh sikur Stalini mendonte që Bashkimi Sovjetik do ta sulmonte Jugosllavinë, ndërsa vetë Stalini na ka thënë se u përket popujve të Ju-

gosllavisë ta zgjidhin vetë çështjen e regjimit në vendin e tyre. Hrushovianët punonin për të keqen e Shqipërisë, të cilën donin ta bënin koloni të tyre. Ata kërkonin të kishin të tyren bazën tonë detare të Vlorës, ta drejtonin ata ekonominë e vendit tonë etj. Por asgjë nuk u shkoi te ne, prandaj u tërbuan e u përpoqën me çdo mjet të na frikësonin, duke lëshuar edhe sllotën e tyre në gjirin e Vlorës. Ne iu përgjigjëm zjarr pér zjarr dhe, kur u drejtuan topat, atëherë u detyruan të largoheshin nga vendi ynë si hajdutë.

Me të gjitha këto dëshiroj t'ju them se, megjithëse jemi vërtet një popull i vogël, ne kemi opinionin tonë pér çdo çështje dhe, atë që kemi në mendje, nuk: druhemi aspak ta themi hapur. Shumë e kuptojnë dhe e përkrahin qëndrimin tonë, bile edhe nga ata që politikisht nuk mendojnë njëlljo si ne.

Ne e kuptojmë qëndrimin e qeverisë franceze e të Dë Golit lidhur me Tregun e Përbashkët Evropian, gjithashtu jemi në dijeni të kontradiktave të Dë Golit dhe pas tij të presidentit Pompidu me gjermanoperëndimorët. Edhe qeveritarët francezë i njojin qëndrimet tona. Në vendin tuaj dhe në vendet e tjera ka njerëz që e shohin me objektivitet realitetin shqiptar. Ka të tjerë që mundohen të bëjnë me ne politikën e shtetit të fortë, por një politike të tillë ne nuk i nënshtrohem.

Ne shqiptarët nuk para u besojmë hapave që ndërmarrin disa. Pse nuk u besojmë? Sepse si imperialistët, edhe klikat revizioniste të vendeve të Evropës Lindore na kanë bërë shumë dëme. Kjo na ka mësuar të jemi shumë të matur në çdo hap që hedhim. Ne nuk bëjmë lëvdata kur shikojmë që në botë imperialistët e revizio-

nistët ndërmarrin shumë aktivitete, përgatiten e organizohen mbledhje e konferenca ku thuhen plot pallavra dhe në fund të fundit, asnjë rezultat konkret nuk duket nga të tilla përqapje, çdo gjë bëhet nga ata vetëm për bujë.

Ka shumë njerëz që na pyesin: «Nuk jeni ju shqiptarët për sigurimin evropian?». Po ta marrësh hollë-hollë, në qoftë se mund të ketë shtet në kontinent që i intereson sigurimi i vërtetë evropian, ky duhet të jetë Shqipëria e vogël, por ne nuk ushqejmë iluzione rreth atyre që thuhen lidhur me këtë çështje, nuk i zëmë besë as Bashkimit Sovjetik, as Shteteve të Bashkuara të Amerikës, as atyre që u mbajnë ison. Po ç'kérkojmë ne? Ne duam vetëm të na lënë të qetë në punën tonë, kérkojmë të largohen sa më parë trupat e huaja nga vendet e Evropës. Por ata që kanë trupa në vendet e tjera nuk duan të ikin prej tyre. Atëherë përsë të vesh në një konferencë, në një kor të organizuar, që shërben vetëm për t'u hedhur hi syve popujve? Ne asnjeri nuk na ka lidhur dot dorën, sytë dhe gojën, asnjeri nuk mund të na ndalojë të flasim lirisht dhe të themi mendimet për konferencën e sigurimit evropian, për të cilën po flitet kaq shumë. Atyre që na stojnë, u themi: Ju mund të shkonit atje, kurse ne jo, ne nuk marrim pjesë në asnje aktivitet të tillë derisa dëgjojmë vetëm fjalë dhe nuk shikojmë asgjë me të vërtetë të dobishme, serioze dhe konkrete për popujt.

Gjithçka që bëjmë, ne e matim mirë, sepse mendojmë shumë për lirinë dhe pavarësinë e atdheut që, si për të gjithë popujt, ashtu edhe për popullin shqiptar, qëndron mbi çdo gjë. Pikërisht kjo na e ka rritur ndjenjën e përgjegjësisë. Ne punojmë që në vendin tonë gjithçka

të bëhet për të mirën e popullit. Demokracia jonë nuk është e njëllojtë me demokracinë borgjeze, që neve nuk na pëlqen, ashtu sikurse nuk na pëlqen as demokracia revizioniste. Merita për zbulimin e kësaj rruge nuk është jona, sepse, atë që tashmë është braktisur e është shkelur me të dyja këmbët në Bashkimin Sovjetik dhe në vende të tjera nga ana e revizionistëve, e kemi gjetur te Lenini dhe te Stalini. Mbi bazën e mësimeve të tyre, ne përpinqemi vazhdimisht që demokracia jonë të bëhet sa më vepruese, jo vetëm në luftën kundër armikut të klassës, të jashtëm e të brendshëm, por edhe kundër të gjithë atyre që veprojnë në kundërshtim me ligjet e popullit.

Ligjet tona, para se të aprovojen në Kuvendin Popullor, diskutohen nga masat e popullit. Kurjeta nxjerr gjëra të reja, përsëri populli jep mendime e bën sugjerime, mbi bazën e të cilave Kuvendi Popullor i ndryshon dispozitat që janë vjetruar dhe frenojnë zhvillimin. Sepse ndodh ashtu siç ka thënë Lavuazie që në botë gjithçka ndryshon. Prandaj, kur shikojmë që një lig frenon zhvillimin tonë përpara, është populli ai që shpreh mendimin dhe kërkon të ndryshohet.

Udhëheqja e shtetit te ne mban kurdoherë lidhje të ngushta me popullin, sepse zbatimi i ligjeve bëhet nga populli dhe nga udhëheqësit bashkërisht. Prandaj në vendin tonë fërkimet që mund të ndodhin midis kërkesave të ligjeve dhe kërkesave të popullit, diktohen sa më shpejt dhe merret në këtë rast mendimi i punonjësve mbi ndryshimet që duhen bërë. Përveç kjo e dallon demokracinë tonë, e bën të jetë vepruese dhe konsekutive. Ne punojmë vazhdimisht për ta bërë de-

mokracinë tonë të përsosur, por dimë, gjithashtu, se do të na duhet kohë që të arrihet në një demokraci të tillë proletare. E vjetra ia lë vazhdimisht vendin së resë. Kështu ndodh edhe me format e rendeve shoqërore, me shoqërinë njerëzore. Edhe në punët e shtetit te ne krijojen herë pas here disa kontradikta që zgjidhen e duhet të zgjidhen me rrugë demokratike, me pjesëmarrjen e masave të gjera të popullit. Megjithatë, nuk i detyrojmë të tjerët të veprojnë si ne, por në këtë rrugë kemi zgjedhur, rrugë që na duket më e mira.

Sot në vendin tonë bëjmë gjithçka që të rinjtë tanë të fitojnë tipare të reja dhe të braktisin shprehi e zakone të vjetra të trashëguara nga e kaluara e që janë të dëmshme dhe frenojnë ecjen tonë përpara. Ne bëjmë kujdes që njerëzit të cilët punojnë në zyra, të mos bëhen burokratë, të mos komandojnë, përkundrazi të jenë të ndërgjegjshëm, shërbëtorë të devotshëm të popullit. Kur i dërgojmë kuadrot të bëjnë punë në prodhim, kemi për qëllim që kjo kategori njerëzish ta kuptojë ç'do të thotë të punosh në prodhim si punëtori dhe fshatari, ndryshe edhe të ne, me siguri, do të ndodhë si në Bashkimin Sovjetik.

Gjatë lustës për ndërtimin e socializmit në vendin tonë kemi arritur suksese, por ne nuk pretendojmë se kemi arritur gjithçka që dëshirojmë, sepse e dimë që kemi akoma shumë e shumë për të bërë.

Duke folur për vizitat e tij në Shqipëri, profesor Pol Miliezi ndër të tjera tha:

Veç Tiranës, kam vizituar disa qytete, si Durrësin,

Krujën, Korçën dhe Pogradecin, ku gjithçka që kam parë, më ka bërë përshtypje të madhe. Unë kam pasur rastin të vizitoj shumë vende të botës, por asnjë vend nuk më ka bërë atë përshtypje të madhe si Shqipëria.

Pastaj, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Në përpjekjet për ndërtimin e socializmit ne i kemi vënë vetes detyrën që gjithmonë të mbështetemi, në radhë të parë, në forcën dhe në kurajën e popullit tonë, të ecim gjithmonë me këmbët tona. Të tjerët na kritikojnë, duke na bërë pyetjen: «Pse jeni kaq të mbyllur?». Mirëpo nuk është aspak kështu si na cilësojnë, përkundrazi, vendi ynë është i hapur, por vetëm për miqtë, për njerëzit e ndershëm. Të mbyllur jemi vetëm për ata që i duan të keqen Shqipërisë. Prandaj edhe me turistët jemi të matur, nuk lejojmë çdo njeri të hyjë në Shqipëri, sidomos ata që punojnë të helmojnë jetën e pastër e të ndershme të popullit tonë.

Kurse Titoja mburret shumë me dollarët që fiton Jugosllavia nga turizmi dhe nga industria që ka ngritur me kreditë e marra nga imperializmi. Ne i shikojmë fabrikat, uzinat, hotelet etj. që ka ndërtuar Jugosllavia gjatë regjimit të Titos. Në fakt ato nuk janë të popullit, sepse, ashtu si dhe më përpara, u përkasin kapitalistëve. Vetëm rrëth 50 për qind e fondeve të investuara janë jugosllave, kurse pjesa tjetër i takon kapitalit të huaj. Krejt ndryshe është te ne. Çdo vepër e ndërtuar në Shqipëri është sryt i djersës dhe pasuri e përbashkët e popullit.

Ne jemi të çiltër dhe përpigemi të jemi sa më korrekta me të gjithë e të kemi sa më shumë miq në botë.

Prandaj më lejoni të ngrë një dolli për shëndetin tuaj
dhe për forcimin e miqësisë midis popullit shqiptar dhe
popullit francez!

*Etohet për herë të parë sipas
shënimere të mbajtura në këtë
takim, që është gjenden në AQP*

T'I MESOJMË ZGJEDHESIT SE PËR ÇFARË T'U DREJTOHEN PËRFAQËSUESVE TË TYRE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

18 shtator 1972

Mendoj se problemin e kemi të törë të qartë, sepse si për çdo çështje edhe për këtë që po shqyrtojmë sot, ne ecim në rrugën e drejtë të Partisë. Në punën për informimin e masave nga ana e organeve të zgjedhura të të gjitha niveleve kemi përmirësimë, gjatë saj bëhet kërkesë llogarie, bëhet kritikë dhe autokritikë nga masat. Megjithatë, në këtë fushë ekzistojnë akoma të meta, bile disa herë serioze, në drejtimin që disa të zgjedhur në organet e pushtetit, siç e kemi konstatuar, shkelin parimet. Duke marrë parasysh këtë gjë, që përbën një rrezikshmëri dhe ndihmon zgjerimin e shfaqjeve të dëmshme, Partia është përpjekur që këto të meta t'i vërë në vend, në rrugën që parimet të mos shkelen.

1. Në këtë mbledhje të Byrosë Politike të KQ të PPSH u diskutua raporti -Si të organizojmë më mirë informimin e masave të popullit mbi veprimtarinë dhe vendimet e organeve të zgjedhura nga qendra në bazë».

Mjaft shokë dhe kuadro tē pushtetit, anëtarë tē këshillave popullore etj., parimet i kuptojnë drejt dhe janë plotësisht dakord me to, por nō praktikë ka raste që nuk i zbatojnë. Përveç këtu e kanë burimin tē metat serioze që vërtetohen. Këta njerëz nuk i zbatojnë parimet jo se nuk duan, por se shpesh hasin nō vështirësi, tē cilat rrjedhin nga shkaqe objektive, por edhe nga shkaqe subjektive. Megjithatë mendoj se vijnë më tepër nga arsyé subjektive, tē cilat pengojnë që masat tē vihen nō korent, sepse këto, nga ana e tyre, do t'u kërkojnë llogari.

Disa herë shokët e pushtetit japid llogari konkretisht, por ka edhe raste që nuk japid. Kjo ndodh për disa arsyé që përbëjnë një kompleks tē tërë, tē cilat nuk i lejojnë t'u venë punëve deri nō fund.

Po sëas pak më konkretisht. Kur gabimi qëndron, ta zëmë, nō dikaster, përgjegjësi i pushtetit mund dhe duhet t'u thotë masave që fajin e ka ministria dhe jo rrëthi, mirëpo kësaj ai nuk i shkon deri nō fund për shumë arsyé: Përgjegjësi i pushtetit nō rrëth, si njeri politik nō çdo rast mendon pür mbrojtjen e pushtetit populor, pra, edhe për ruajtjen e autoritetit tē organeve më tē larta, prandaj, pranon më mirë «t'i heqin veshin» atij vetë, personalisht, sesa tē kritikohen Komiteti Qendror i Partisë, Qeveria ose qostë edhe një ministri e vetme. Kështu, kur është rasti që ndonjë mall i planifikuar mungon nō treg, për arsyé se nuk ka ardhur akoma nga importi etj., masa nō këtë rast vë pyetjen: «Po ç'bën tregtia, pse vepron me kaq ngathësi, pse s'ka marrë masa me kohë?» etj., kërkon me një

fjalë sqarime. Duke marrë parasysh këtë, përsaqësuesi i pushtetit në bazë shpesh vërtitet dhe fajin e mesvetë përsipër.

Në punët e shumta që kryhen, ka sigurisht edhe të meta e mungesa, për të cilat nuk vihen dot në dijeni të tëra masat, për disa çështje ato nuk arrihet të informohen, disa herë edhe për arsyen se kanë karakter politik. Të meta në punën e organeve tona ndodhin e do të ndodhin, por ama, ata që i lejojnë duhet të përgjigjen për to e t'i kritikojmë. Megjithatë, siç thashë, ka çështje që nuk varen prej tyre. Ka, sfala vjen, nga ato për të cilat nuk ka çfarë të bëjë tregtia. Mirépo ajo, për të mos u futur në detaje, ka tendencë t'i rrumbullakosë çështjet, duke u justifikuar para masës se s'ka, për shembull, vaporë. «Si është e mundur që s'ka vaporë?» — thonë njerëzit. «Ata shteti i paguan, prandaj pse nuk vijnë në kohë mallrat?». Kjo do të thotë se në tregti s'ka organizim, s'ka drejtim të mirë e plot gjëra të tillë të tjera. Në fakt, ka punonjës të tregtisë që kanë vërtet faje për pakujdesi, për mungesë organizimi etj., por ka edhe arsyen që s'varen prej tyre, gjë që shokët përgjegjës ose forumet i detyron të mos e vënë masën plotësisht si duhet në koren.

Ka pastaj një tjetër kategori punonjësish, këta janë nga ata që përpinqen t'i fshehin gabimet që bëjnë, që mundohen të mbulojnë dembellëkun, injorancën, akraballëqet që bëjnë dhe një sërë dobësish të kësaj natyre, të cilat janë shumë preokupuese, se pasojat e tyre prekin vijën e Partisë. Këta elementë janë më të irrezikshmit, prandaj duhet t'i vëmë përpëra përgjegjësish, t'i shkundim fort, kundër tyre të ngremë masat e popullit.

Ilit dhe t'i bëjmë këto të ndërgjegjshme që t'u kërkojnë llogari me rreptësi gjer në një.

Mua më duket që mirë e kemi shtruar çështjen e kompetencave të këshilltarëve, të komiteteve ekzekutive, të marrëdhënieve në mes tyre etj. Por të bëhet kujdes në kuptimin që ata që zgjidhen në organet e pushtetit të jenë njerëz politikë, njerëz që luftojnë me të gjitha energjitet për zbatimin e plotë e në kohë të vendimeve dhe për zgjidhjen e problemeve, të aftë për të kontrolluar, njerëz krijues. Gjatë veprimitarisë që zhvillojnë duhet punuar edhe për edukimin e tyre. Por në këtë drejtim kam përshtypjen sikur kërkohet që këta t'i njojin ligjet një për një e fill e për pe. Kjo përshtypje del edhe kur lexon raportin që na është paraqitur. Kështu, kur ndonjëri nuk i njeh të tëra ligjet, e ironizojnë e thonë: «E po si nuk i di, ç'është kështu?». Në realitet, një gjë e tillë nuk është e mundur të realizohet. Njohja nga gjithë këta dhjetëra mijë këshilltarë të zgjedhur e të tëra ligjeve, urdhëresave e udhëzimeve të shumta që dalin nga Kuvendi Popullor, Presidiumi i tij dhe Qeveria, do të ishte një gjë ideale, por kjo në praktikë nuk është e mundur. Rëndësi në këtë çështje ka esenca, kuptimi i anës morale dhe politike i ligjeve e i udhëzimeve të ndryshme nga ana e të gjithëve. Në një mënyrë ose në një tjetër, të tërë duhet ta kuptojnë këtë. Por ato ligje e urdhëresa që u interesojnë drejtpërdrejt kategorive të veçanta të punonjësve dhe që duhet t'i zbatojnë ata vetë dhe në sektorët ku punojnë, këto po, lypset të njihen dhe bille mirë nga ana e tyre. Prandaj, kjo kategori e veçantë njerëzish nuk duhet lënë të njihet me këto ligje në

mënyrë spontane, por mësimi i tyre të bëhet në mënyrë të organizuar.

Ministria e Punëve të Brendshme, sjala vjen, nuk mund të mos përpinqet vazhdimisht që deri policëve që dërgohen në vendshërbimin më të largët t'ua bëjë të njohura ligjet e veçanta dhe t'i aftësojë për t'i interpretuar drejt ato, zbatimin e të cilave ua kërkon. Në qoftë se ata, këto ligje dhe urdhëresat që nxjerr vetë ministria, nuk do t'i dinë, nuk ka si të bëjnë zbërtimin e mëtejshëm të tyre, dhe atëherë ata nuk do të jenë në gjendje as t'i zbatojnë.

Ose, të marrim çështjet financiare që kanë të bëjnë me administrimin e mirë të lekut, i cili futet në të gjitha qoshet e jetës sonë. S'ka ndërmarrje apo institucion që të mos ketë të bëjë me fonde monetare, prandaj, ligjet dhe urdhëresat financiare duhet t'i njohin, në radhë të parë, drejtuesit e tyre. Ato duhet t'i dinë gjithashtu, bile akoma më mirë, financierët e normistët; disa prej tyre, për ato që u interesojnë, është e domosdoshme t'i njohin edhe punëtorët. Çfarë çështjesh financiare mund t'i interesojnë, për shembull, një punëtor? Atij mund t'i interesojë të dijë, sjala vjen, ligjin mbi pagat personale, mbi pensionet, mbi përqindjet e pagesës, në rast sëmundjeje e invaliditeti etj. pse po t'i dijë, do t'i thotë vetë llogaritarit kur zbulon se nuk është paguar në rregull, sipas këtyre ligjeve. Pra, kur është rasti ne duhet t'ia mësojmë këto gjëra masës që ka të bëjë me to. Punonjësit të bëhen të ndërgjegjshëm dhe t'i mbrojnë me vendosmëri ato që u takojnë me ligj. Por, të pretendojmë që t'u bëjmë të njohur masave, pa asnjë kufizim, çdo ligj e urdhëresë që del, kjo është

e paniundur. Me esencën e tyre, me politikën e ligjeve, siç e thashë edhe më parë, po, ne duhet t'i edukojmë gjithë punonjësit.

Lidhur me funksionimin e këshillave popullorë, të komiteteve të tyre ekzekutive e të Kuvendit Popullor mendoj se duhet të bëjmë më shumë për gjallërimin e tyre të mëtejshëm. Këto që bëhen tani nuk janë gjëra të reja, parimet që lidhen me veprimtarinë e këshillave, me kompetencat e tyre etj., etj. Partia jonë i ka shtruar me kohë, por ato duhen zbatuar kudo dhe kurdoherë si duhet. Të mos harrojmë se mbledhjen e këshillit popullor e drejton kryesia e këshillit, por nga ana tjetër, duhet të kuptojmë mirë se nuk mund të bëhet mbledhja e këshillit popullor të rrethit pa bashkëpunim të tij me komitetin ekzekutiv. Mbledhjet i thërret kryesia e këshillit popullor me iniciativën e vet, me kërkesën e komitetit ekzekutiv të tij, ose me kërkesën e 1/3 së anëtarëve, por, duke u këshilluar më parë me komitetin ekzekutiv se çfarë problemesh do të shtrohen. Kjo është e nevojshme të bëhet, pse këshilli i kryen detyrat edhe me anën e komitetit ekzekutiv dhe të komisioneve të tij.

Pse ta paraqitim çështjen sikur komiteti ekzekutiv s'ka asnjë funksion, por vetëm duhet të thirret për të dhënë llogari? Ne nuk e vëmë komitetin ekzekutiv mbi këshillin popullor, sepse është këshilli ai që ushton të gjitha funksionet e pushtetit shtetëror. Por, para se të bëhet mbledhja e këshillit, kryesia e tij me domosdo duhet të bashkëpunojë me komitetin ekzekutiv. Rëndesi ka të kuptojmë esencën e problemit. Çështja nuk qëndron në atë që kryetari i këshillit popullor të rrethit

të jetë apo të mos jetë sekretar i komitetit të Partisë. Në duhet të bëjmë të qartë se direktiva e Partisë është që të kuptohen mirë kompetencat e këshillave popullorë, rëndësia e tyre si organe të diktaturës së proletariatit dhe fakti që këshillat popullorë janë baza politike e Republikës Popullore të Shqipërisë. Edhe unë mendoj se është më mirë që sekretari i komitetit të Partisë të mos jetë kryetar i këshillit popullor të rrëthit, po në vend të tij të zgjidhet një njeri tjetër i gjallë, i zoti, kërkues dhe me horizont, që mund të jetë ose jo anëtar partie.

Prandaj të përpinqemi që këto punë t'i përmirësojmë vazhdimisht e në mënyrë sistematike dhe jo me fushata. Për këtë të punojmë pandërprerë dhe të mos tërhiqemi nga pengesat e vështirësitë që mund të gjejmë përpara, as të dalim me konkluzionin që të ngushtojmë numrin e këshilltarëve, për arsyen se paska edhe nga ata që nuk flasin nëpër mbledhje etj.. etj. Natyrisht, edhe nëpër mbledhje nuk mund të flasin të tërë, bile jam i mendimit se nuk është e domosdoshme të flasin në çdo rast. Ata mund të flasin kur duhet, t'i thonë pesë fjalë të urta popullit. Nuk duhen preferuar shumë ata që grijnë «pa bereqet», siç mendon ndonjëri. Ka nga këta edhe një numër të vogël shokësh, që u vjen zor të flasin nëpër mbledhje, por këta janë njerëz të popullit, me mendime të pjekura. Te këta njerëz të thjeshtë, krijohet dhe vepron një kompleks emocionalë, kur sidomos flasin përpara një njeriu që diskuton me oratori. «Si do të tingëllojë diskutimi ynë në mbledhje?.. mendojnë ata dhe tërhiqen. Por, ato pesë fjalë që dëgjojnë në mbledhje ata «i marrin dhe i futin në

xhep.. Puna është që në mbledhjet ku marrin pjesë të krijohet një atmosferë e ngrohtë e atillë, ku secilit t'i kërkohet mendimi ashtu si e ka. Pra, ne nuk mund të pretendojmë që të bëhen të gjithë menjëherë eflatunë, por, anëtarët e këshillit, nuk janë vetëm për berihaj, siç u tha këtu nga një shok, se janë përsaqësues të popullit, të zgjedhur në bazë të Kushtetutës për një qëllim të lartë. Prandaj, ata kanë të drejtë të bëjnë vërejtje e sugjerime, të mbajnë kontakt me udhëheqjen dhe t'i imponojnë asaj zbatimin e vijës së drejtë të Partisë. Po të eliminoheshin shumë këshilltarë dhe të reduktohej numri i tyre, atëherë do të humbiste tërë kuptimi i demokracisë së masave. Natyrisht, as me këto që janë bërë deri sot të mos kënaqemi. Kryesorja është që këshilltarët dhe deputetët të interesohen më shumë për këto probleme, sepse interesim nga ana e tyre ka, por ky nuk është në nivelin që dëshirojmë.

Me këtë rast desha të theksoja edhe një çështje tjeter, që duhet ta kuptojmë mirë ne, por ka rëndësi ta kuptojnë vetë masat e popullit. T'i mësojmë zgjedhësit që deputetit të Kuvendit Popullor t'i kërkojnë të interesohet jo për zgjidhjen e çdo gjëje, siç ndodh shpesh herë, por të disa problemeve të caktuara, nga ato më të rëndësishmet, kurse këshilltarëve të rretheve, lagjeve ose fshatrave ata mund t'u drejtohen për probleme më të thjeshta. Një deputeti të Kuvendit Popullor, një zgjedhës nuk mund t'i drejtohet për çdo ankesë, fjala vjen, për strehim, për punë personale, për ndonjë ankesë që mund të ketë për gjyqtarët popullorë etj. Deputeti i Kuvendit Popullor do të merret me të tilla çështje, që fare mirë mund t'u paraqiten këshilltarëve popullorë

në rrëth? Mendoj se atij nuk mund t'i shtrohen ankesa të kësaj natyre, por probleme të një karakteri më të përgjithshëm e më të nprehtë.

Kur në një rrëth, ta zëmë si Durrësi, shihet se ndonjë kuadër bën padrejtësi kur ka probleme strehimi etj., këto mund të ngrihen atje në rrëth, si probleme me rëndësi. Në këtë rast aktivistë shoqërorë, populli, përparrë se të thérresin deputetin në takim në zonën përkatëse elektorale, mund të organizojnë vetë një konsultë, nga e cila, në bazë të gjendjes, të nxjerrin nëse ka shkelje të ligjeve në fuqi; nëse bëhen hatëre e ndërhyrje në ndarjen e shtëpive etj. dhe të arrijnë në disa konkluzione, të cilat mund t'ia parashtronë edhe deputetit.

Po ashtu, në qoftë se në një zonë elektorale ka probleme të furnizimit me ujë të pijshëm, sidomos gjatë verës, edhe ky problem me karakter të përgjithshëm mund t'i ngrihet deputetit. Gjatë takimit, këtë gjendje ata ia parashtronë dhe i kërkojnë atij ndihmë nëse mund të zgjidhet sa më parë ky ose ai problem e si mund të zgjidhet, q'perspektiva ka, për sa vjet etj. Pra të tilla probleme mund t'i ngrihen përfaqësuesit të popullit në Kuvend dhe jo të lejohen njëri dhe tjetri t'i ankohen për gjëra të thjeshta, fjala vjen për një dhomë, për një kuzhinë, që natyrisht edhe këto kanë rëndësinë e tyre, por s'janë për deputetin.

Njerëzit duhet të mësohen që për çështjet personale t'u drejtohen atyre që janë vazhdimishit dhe drejt-përdrejt në luftë me të tilla fenomene dhe në kontakt të përditshëm me popullin, këshilltarit të lagjes, të fshatit etj., se këta njojin konkretisht njerëzit dhe pa

humbur shumë kohë janë në gjendje të vlerësojnë kujt i është bërë ose nuk i është bërë padrejtësi. Këshilltari që jeton me masat e pranë tyre është në gjendje t'i përgjigjet me kompetencë cilido që bën ndonjë kërkesë ose ankesë. Nuk duhet të harrojmë edhe faktin që ka edhe njeröz, të cilët tërhiqen nga ndjenja e interesit personal dhe i drejtohen jo vetëm deputetit, po deri edhe mua, duke u ankuar se i është bërë «padrejtësi», por në fakt, pasi verifikohet çështja, del se nuk ka padrejtësi. Më mirë se kushdo këto gjëra i dinë shokët e bazës, prandaj duhet bërë një diferencim në zgjidhjen e problemeve që dalin sipas rëndësisë dhe nivelit.

E kam fjalën që Partia dhe organet e pushtetit duhet të punojnë që kjo praktikë t'u bëhet edukatë njerëzve tanë, se fundja nuk mund të detyrohet tjetri të mos ngrejë këtë apo atë çështje. Puna bindëse e sqa-ruese e Partisë dhe e levave të saj do të ndihmojë që demokracinë dhe demokratizimin e jetës së vendit disa të mos e vulgarizojnë, sepse kështu kjo punë kthehet në dëm të demokracisë sonë të vërtetë. Kuptimi i drejtë i demokracisë, zgjerimi i saj arrihen kur punohet drejt për edukimin e masave, duke aktivizuar për këtë qëllim njerëzit më me autoritet që njihën nga populli, që i shërbijnë me devocion atij dhe ndaj të cilëve askush nuk mund të thotë se këta po na shkelin demokracinë. Këta aktivistë dhe të zgjedhur duhet t'i trajognë jo vetëm individit që është drejtuar me një kërkesë pa vend, se nuk e ka drejt, por me këtë rast të sqa-rohen edhe të tjerët që kanë të njëjtën ankesë. T'i bëjmë që të gjykojnë vetë se ky person me të vërtetë nuk e ka drejt për atë që ngre, ose se ky apo ai pro-

blem nuk duhet t'i ngrihet, për shembull, deputetit, por këtij ose atij forumi të bazës etj. Kështu t'i mësojmë ne njerëzit tanë, se ka nga ata që, nën maskën e demokracisë, duke u nisur nga interesat e ngushtë personalë, nuk e kanë për gjë të diskreditohet demokracia jonë populllore. Ata, nën maskën e parimit të drejtë, që secili çdo gjë mund të thotë dhe të kërkojë, drejtohen edhe për gjëra fare të thjeshta në instancat më të larta.

Këto ndodhin edhe nga fakti se nuk bëhet një punë e mjaftueshme edukative, sqaruesc dhe bindëse me masat punonjëse. Informim me karakter të përgjithshëm bëhet me masat. Por mendoj se nuk është kjo e tëra, pse masat, edhe pse për një numër problemesh nga më kryesoret, fjala vjen, për planin pesëvjeçar dhe planet vjetore për objektet kryesore që parashikojnë këto plane etj., janë informuar, Partisë i bie detyrë që këtë plan ta mbështetë politikisht dhe ideologjikisht, të sqarojë njerëzit që të mos bëhen kërkesa jashtë tij, në cilindro sektor qoftë, që askush të mos kërkojë mbi shifrat e vendosura. Mund të ketë nevojë, ta zëmë, një rrëth për ujësjellës, një tjetër për më shumë ndërtesa banimi, por këto janë parë mirë dhe gjersa në plan një objekt i tillë nuk është parashikuar ngaqë tani për tani mundësitetë kaq janë, si mund të ngulet këmbë dhe të ngrihet kjo kërkesë? Kur u hartua plani janë parë mundësitetë reale që kemi. Mund të duhen kudo fonde, gjithashtu edhe për objekte të ndryshme, edhe për ndërtesa banimi, po këto fonde janë caktuar. Me punë vullnetare do të ngrihen edhe ca më tepër banesa nga parashikimet, duke u mobilizuar të gjithë, po më tepër nuk është e mundur të ndërtohen. Kështu kërkesat për banesa

do t'i zgjidhim sipas kushteve. Por, rëndësi ka që shtëpitë, të cilat i ndërtojmë, të ndahen me drejtësinë më të madhe dhe pikërisht këtë problem ia kemi lënë ta zgjidhë masës së popullit në lagje apo në ndërmarrje. Kur ndahen apartamentet, venë njerëz të ankohen në komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të lagjes ose të rrëthit, duke thënë se bëhen padrejtësi etj. Këto ankesa nuk mund të futen të tëra në një thes. Ato duhet të shqyrtohen, ndonjë veprim jo i rregullt në bazë edhe mund të korrigohet, por disa njerëz të pandërgjegjshëm, ose ata që e shikojnë këtë çështje në prizmin e interesit të tyre vetjak, nuk mund të lejohen që ta ngrenë shtrembër problemin, sikur te ne po bëhen kudo padrejtësi të mëdha, s'po veprohet mirë etj., etj. Ky do të ishte një abuzim në demokracinë tonë dhe orvatje për diskreditimin e pushtetit tonë popullor. Prandaj të tilla orvatje t'i luftojmë; çështjet t'i analizojmë drejt dhe njerëzit t'i edukojmë vazhdimisht në vijën e Partisë, mbi bazën e parimeve të demokracisë sonë popullore.

Deputetët marrin kontakt me masat e zgjedhësve, sepse ata janë njerëz që i kuptojnë drejt politikisht problemet, që zbatojnë vijën e masave. Rëndësi të madhe ka që deputeti të marrë rregullisht kontakt me masat, të dëgjojë kritikat, vërejtjet e sugjerimet e zgjedhësve për çështje konkrete të interesit të përgjithshëm. Mirëpo shpesh në takimet me zgjedhësit osc flitet për probleme shumë të përgjithshme ose disa përpiken t'i futin diskutimet në cikërrima. Prandaj të punojmë më shumë në këtë drejtim që ta edukojmë drejt popullin, që ai të bëjë vetë diferencimin e problemieve, të dijë

çfarë i duhet ngritur deputetit dhe përse t'i drejtohet këshilltarit që e ka afër çdo ditë.

Kur bëhen padrejtësi, atje ku konstatohet burokratizëm, ku shkelen ligjet, ku nuk punohet mirë për të realizuar ato që janë parashikuar për fajin e administritimit të keq, për faj të njerëzve të pandërgjegjshëm, të mos lejojmë kërkënd që tu mbyllë gojën masave, ca më tepër anëtarëve të këshillave popullorë, për të kritikuar dhe për të rregulluar gjendjen. Askush nuk mund të thotë përse komiteti ekzekutiv nuk u jep mundësi anëtarëve të këshillit popullor të aktivizohen. Çështja nuk mund të shtrohet kështu. Komiteti ekzekutiv e ka për detyrë t'i raportojë këshillit popullor për veprimtarinë e tij dhe ky t'i kërkojë llogari komitetit ekzekutiv. Por ka gjëra që këtë e pengojnë të japë rregullisht llogari përpara këshillit, për arsy se vetë këshilltarët e rrethit i sjellin shpeshherë për shqyrtim shumë vogëlsira, të cilat ata vetë me autoritetin e tyre dhe me ndihmën e këshillit popullor të fshatit apo të lagjes, mund dhe duhet t'i zgjidhin me drejtësi, se atje kanë ndihmën e organizatave-bazë të Partisë, të byrove të tyre etj. Por, meqenëse vetë nuk bëjnë sa duhet përpjekje t'i zgjidhin në bazë, e kanë më lehtë të venë të shkarkohen në komitetin ekzekutiv, ku, natyrisht, nuk ka si u zgjidhen të tëra sa ngrenë. Mirëpo moszgjidhja e tyre i largon nga masat që u janë drejtuar, i stoh ata kështu nga funksioni i tyre i vërtetë.

Duhet kuptuar drejt dhe çështja se deputeti me funksionet e tij nuk mund të anulojë funksionet dhe kompetencat e komitetit ekzekutiv, i cili nuk mund të veprojë për zgjidhjen e kësaj ose asaj çështje-

je, ashtu siç mund të dëshirojë deputeti. Në qoftë se ankesa është e drejtë, komiteti ekzekutiv duhet ta zgjidhë atë deri në fund, por në qoftë se nuk është e drejtë, ankucesit do t'i përgjigjet negativisht, pavarësisht se ai që e ka sjellë aty problemin është deputet, pse edhe komiteti ka përpara ligje, ka buxhet, ka plan, vepron në bazë të tyre, të udhëzimeve të Qeverisë dhe vijës së Partisë. Prandaj, kur deputeti drejtohet në komitetin ekzekutiv, me iniciativën dhe dëshirën e vet ose me dëshirën e një opinioni të ngushtë në fshat, me synimin që rrethi t'i realizojë një kërkesë të parakohshme, ky nuk ka për t'ia realizuar, se mund të ketë përpara detyra të tjera për të kryer ose mund të mos ketë mundësi materiale etj., dhe këto deputeti duhet t'i kuptojnë. Në raste të tillë deputeti, më duket mua, duhet të jetë shumë i gjykueshëm dhe të veprojë drejt. Që të ecë kështu, më parë se të drejtohet në komitetin ekzekutiv, ai duhet vëtë të reflektojë thellë, duke u mbështetur në vendimet e ligjet bazë, të studiojë gjenjen dhe mundësitë ekzistuese dhe, në këtë frymë, të edukojë edhe masat, me të cilat e ka për detyrë të këshillohet, pastaj të shkojë në komitetin ekzekutiv. Kjo nuk do të thotë që, pa arritur në përfundim të një studimi të mos vejë atje për konsultime, për informim etj. Çështja është që të jetë sa më i arsyeshëm dhe të mos zgjedhë dy ekstremet e të bëhet fjala e tij ose të mos interesohet fare. Jo, ashtu siç mund të diskutohet me popullin, njerëzit e zgjedhur mund të diskutojnë edhe me organet ekzekutive të pushtetit, që veprojnë në bazë të ligjeve. Në qoftë se ai sheh që mundësitë ekzistojnë, por i vihen pengesa të pajustifikuara,

atëherë deputeti t'i drejtohet këshillit popullor në mbledhjen më të parë dhe të kërkojë aty që t'i jepet rrugë problemit. Në këtë drejtim mund të shqyrtohen një sërë çështjesh, po nuk bëhet kurdoherë kështu. Prandaj t'i kuuptojmë arsyet përse nuk aktivizohen sa duhet deputetët.

Të kemi, gjithashtu, të qartë edhe çështjen tjetër se deputeti nuk është funksionar, ai punën me masat e bën në kohën e tij të lirë, ndaj nuk mund t'i kërkojmë që gjatë kësaj kohe të punojë ashtu siç i kërkohet funksionarit gjatë kohës së punës. Deputeti do ta kryejë detyrën e tij në mënyrën më të përshtatshme për të, duke marrë kontakt në kohën e vet të lirë, kur është në shtëpi, kur vete në klub, në arë etj., etj. Gjatë këtyre kontakteve ai do të mund të nxjerrë një numër konkluzionesh për disa probleme, qoftë për komitetin ekzekutiv të këshillit popullor, qoftë për vetë ata që e kanë zgjedhur. Kjo është detyra e deputetit, prandaj të mos mendojmë të kërkojmë nga ai atë që i kërkojmë një nëpunësi shteti ose partie. Këtë ta kemi mirë të qartë.

Për gjallërimin e mëtejshëm të Kuvendit Popullor mund të vazhdojmë si kemi filluar, po të kemi parasysh që deputetët të mos vijnë në sesionet e Kuvendit me nga një diskutim standard, por me diskutime konstruktive, jo vetëm kritik, por të japin aty edhe eksperiencën e mirë.

Po çfarë mund të kritikojë deputeti? Kjo duhet parë, sepse Kuvendi nuk ka natyrën e një plenumi partie, ku mund të qëndrohet edhe gjatë për të zbërthyer një problem të rëndësishëm, kurse në organin më të lartë shtetëror të demokracisë sonë popullore nuk mund

të qëndrohet duke diskutuar për cikërrima. Kur një deputet ngrë një problem jashtë caqeve, jashtë planeve dhe vendimeve që janë marrë, si dhe mundësive që ka shtcti ynë në kohën që mblidhet Kuvendi nuk mund të rrimë të diskutojmë dhe të kritikojmë një ministri ose Qeverinë. Deputeti pra, nuk mund të vijë në mbledhje të kërkojë pse s'është bërë kjo, ose pse s'është bërë ajo, kur këto çështje nuk figurojnë fare në plan. Në qoftë se ai do të kërkojë të vihet një çështje në plan, kur plani është vendosur e mundësitetë janë diskutuar nga Kuvendi, kjo do të thotë që Kuvendi të rrijë ta diskutojë edhe një herë planin që është vendosur prej tij. Në këtë rast mund të dalin një mori e madhe çështjesh, pse dëshirat dhe kërkesat janë kolasale, ndërsa mundësitetë kanë një kufi. Kjo s'mund të bëhet.

Por në qoftë se deputeti parashtron në Kuvend një tablo realiste të gjendjes në rrithin e vet, ai mund të bëjë me këtë rast edhe kritika objektive të drejta për disa probleme, natyrisht, në nivelin e Kuvendit apo në shkallë qeveritare, jo në shkallën e këshillit popullor të fshatit ose të lagjes. Një diskutim i tillë do të ishte me vend. Në qoftë se ia arrijmë kësaj, atëherë Kuvendi Popullor do të gjallërohet me të vërtetë dhe ministritë e Qeveria do të vihen përpara përgjegjësive për ata objektiva që janë vendosur dhe nuk janë realizuar. Deputeti mund të kërkojë, fjala vjen, nga ministri i Tregtisë apo ai i Industrisë në Kuvend përsë nuk është realizuar një objektiv i planifikuar. Ministri për këtë duhet t'i përgjigjet atij konkretisht dhe t'i thotë që këtë çështje nuk e kemi zgjidhur për këto arsyе objektive,

këtë tjetrën për mungesat tona të organizimit apo për thyerje discipline etj. Dhe do t'u premtojë deputetëve se në Kuvendin Popullor, si ministër, nuk do të vijë më për këto çështje, nuk do ta kritikojnë edhe një herë, se do të marrë masa rrënjosore që çdo gjë të vihet në rrugë. Do të ishte shumë pozitive në qoftë se ne do t'ia arrijmë kësaj. Por kështu si veprohet tani që ndonjë deputet vjen në Kuvend pa reflektuar më parë, nuk është aspak mirë. Tani është fakt që deputetët punojnë diçka më mirë, por kjo nuk është akoma në atë nivel që dëshirojmë të arrijmë.

*Botuar për herë të parë me
ndonjë shkurtim në librën:
Enver Hoxha, «Për pushtetin
popullor (Përmbledhje
reprash) 1942-1982», f. 515*

*Botohet i plotë sipas tekstit të
nxjerrë nga procesverbali i
mbledhjes së Byrosë Politike
të KQ të PPSH, që gjendet
në AQP*

QARKULLIMI I MONEDHËS VARET EDHE NGA PRODHIMI I MALLRAVE TË KONSUMIT TË GJERË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

18 shtator 1972

Nga sa na folën shokët ministra, më duket se na u dha një pasqyrë e qartë për problemin e qarkullimit monetar.

Unë kam përshtypjen se Ministria e Financave (për këtë kam bërë një vërejtje edhe herë tjetër) nuk na i paraqit mirë çështjet kur marrim në shqyrtim të tilla probleme. Siç duket, atje nuk ka një stil e metodë pune aq të qartë dhe të përpiktë, siç është vetë ana financiare e problemeve. Në raportin që na bëri me gojë, shoku ministër u fut në detaje aq të mëdha, saqë kam frikë se ky problem po koklavitet, kurse çështja e qarkullimit monetar duhet të jetë ekzakte, prandaj kërkohet të jenë të sakta edhe konkluzionet që duhen nxjerrë për të.

Nuk ka asnjë dyshim se për këtë çështje kanë për-

1. Në këtë mbledhje u diskutua për problemin e qarkullimit monetar.

gjegjësi edhe dikasteret e tjera, por puna është që Ministria e Financave në gjithë veprimitarинë e vet duhet të jetë më precize, të punojë më me përgjegjësi për kryerjen e funksioneve që i janë ngarkuar. Prandaj, herë tjetër, konklusionet që nxjerr, të përpinqet që të jenë më të qarta; ajo vetë të jetë më e vendosur për zbatimin e ligjeve financiare në fuqi. Ministria e Financave, mendoj unë, duhet të jetë shumë e rreptë në kontrollin e lekut në të gjitha ato kanale ku mund të kalojnë fonde të paparashikuara ose të tepërtë. Një rol me përgjegjësi të madhe në këtë drejtim luan kjo ministri së bashku me organizmat e saj.

Gjendja ekzistuese tregon se nga ana e kësaj ministrie duhet të ketë lëshime, prandaj bëhen shkelje financiare nga entet, dikasteret dhe ndërmarrjet e ndryshme. Në qoftë se Ministria e Financave do të ishte kurdoherë rigorozë, nuk kishte pse të lëshonte fonde atje ku nuk duhet lëshuar dhe atëherë shkeljet nuk do të ishin vërtetuar në shumicën më të madhe të rasteve.

Në rrëthanat e tanishme ne mund të pranojmë një shtim të monedhës në qarkullim, veç duhen bërrë përpjekje që ky të jetë mundësish sa më i vogël. Ky shtim, më duket mua, është i shpjegueshëm dhe kjo u sqarua këtu. Shpejtësia e qarkullimit monetar është shumë e vogël, prandaj një gjë e tillë duhet ta preokupojë seriozisht Ministrinë e Financave. Për këtë qëllim është e domosdoshme që ajo të dalë me një studim më konkret për këtë problem e t'i vërë detyrë, nü radhë të parë, vetes, pastaj gjithë të tjerëve, dhe pastaj Byroja Politike e Qeveria të marrin masa të pranueshme që do të ndihmojnë në shpejtimin e

qarkullimit monetar. Mirëpo që të arrihet ky objektiv duhen përpunuar me kujdes masat që nevojiten të merren, natyrisht jo në hollësira të vogla për nc (për hollësirat le të mendojnë ata që merren drejtpördrejt me këto probleme). Ne duam të vëmë në zbatim disa caqe të mundshme dhe të detyrueshme për ekonominë dhe për ekonomistët tanë.

Mua më duket se qarkullimi i monedhës sonë i nënshtronhet njëfarë spontaneiteti; atë ne nuk e kemi fort të disiplinuar. Unë nuk kam mendimin që, duke caktuar disa masa, nuk do të ketë nië ndonjëfarë luhatjeje në qarkullim, por jo edhe të kemi të bëjmë me një luhatje të madhe.

Do të thosha edhe këtë që, çështja e qarkullimit monetar, vlera e monedhës, varet nga të gjitha hallkat që kanë lidhje drejtpördrejt me realizimin e planit, pra nga prodhimi. Në qoftë se ne nuk do të bëjmë përpjekje që të prodhojmë sipas planit, atëherë do të na lindin vështirësi të shumta edhe në çështjen e qarkullimit. Nuk është se ne nuk prodhojmë, bile kemi përparime në këtë drejtim, por këto përparime mendoj se duhet të jenë akoma më të mëdha dhe të mos bëhen në fryshtë artizanale. Veç kësaj, entuziazmi që lind gjatë punës për realizimin e këtyre përparimeve të jetë në masën e këtij niveli që është arritur dhe, kur është rasli, të mos krijohet përshtypja joreale, sikur diç po bëhet më tepër nga sa është arritur në fakt. E them këtë, sepse kur ngrihen linja e reparte të reja, të cilat më duket se kanë karakter artizanal ose diçka më lart se kaq, entuziazmi që krijohet, lë të kuptohet

sikur ajo, që kemi ndërtuar dhe vënë në shfrytëzim, është diçka që e tejkalon realitetin.

Po ju sjell një shembull: Në televizor pashë të flitej një ditë për një punishte të re të ndërtuar në Skrapar për prodhimin e marmelatës. Mirëpo termat që shoqëronin paraqitjen e kësaj linje ishin të tillë që, duke i krahasuar me atë që shihej në televizor, njeriu menjëherë s'kishte si të mos mendonte se nuk ishte ashtu si thoshte spikeri. Pa ekzagjerim në këtë rast spikeri foli kështu: «Kjo është një fabrikë moderne, çdo proces këtu është i mekanizuar» dhe menjëherë dolën në ekran një govatë si ajo ku përgatitet çimentoja dhe një vajzë që trazonte lëndën e parë, pas daljes të së cilës u paraqit edhe marmelata që derdhej në govatë, siç derdhet llaçi. Mirëpo kur konsumatori e sheh këtë proces prodhimi të marmelatës, do të thotë: «Mos e ngrënçim një të tillë marmelatë», për arsy se nuk prodhohet në kushtet e kërkua nga ana higjeno-sanitare dhe e kulturës industriale moderne.

E kam fjalën që për një sërë mallrash të konsumit të gjerë, për të cilat kemi shumë nevojë, megjithëse unë nuk jam për t'i përqendruar të tëra, disa prej reparteve dhe linjave të këtij lloji, në gjendjen artizanale që janë, është e domosdoshme të përqendrohen, natyrisht jo në një vend, por mbasë në dy ose tri vende, në mënyrë që prodhimet ushqimore të kësaj natyre, siç është edhe marmelata që përmenda, t'i nxjerrim të paktën në seri, t'i specializojmë. Tani ne kemi arritur në një gradë që mundet dhe duhet ta bëjmë këtë përqendrim.

Të tilla probleme ne duhet t'ua lëmë në kompe-

tencë vetë ndërmarrjeve që t'i zgjidhin. Jo vetëm kaq, po duhet menduar që me mbeturinat, edhe kur këto janë pjesë shumë të vogla, të përgatitim artikuj shumë të nevojshëm për popullin, duke menduar secila kryesisht për nevojat e rrethit të vet dhe pastaj, kur ka mundësi, edhe për rrethet e tjera. E kam fjalën që artikuj të kësaj kategorie të mos mendohet të prodhohen nën patronazhin e ministrisë, por nën patronazhin e vetë ndërmarrjeve në rrëthe. Ndonjëra nga ndërmarrjet mund të bëjë, fjala vjen, me mbeturina 1 000 ose 2 000 copë kuti për ambalazhim karamëlesh, pa körkuar fare as lëndë të parë, as hiçgjë tjetër, jo nga ministria, po as nga rrëthi. Këta artikuj mund të shiten brenda rrethit, por mund të shiten edhe në rrëthin më të afërt. Prandaj, kur ka prodhim mbi nevojat e rrethit, një përfaqësues i ndërmarrjes ngarkohet të shkojë për këtë qëllimi në rrëthin tjetër, ku të bisedojë me përgjegjësit e tregtisë dhe të kontraktojë për t'i shitur këta artikuj për të cilët njerëzit kanë nevojë. Mirëpo vjen pastaj çështja e çmimeve, e planit të shpërndarjes dhe e transportit, për zgjidhjen e shpejtë të të cilave dalin një mijë e ca gjëra, që pengojnë në këtë drejtim. Çështjen e kam që populli ka nevojë për mallra të konsumit të gjerë, mirëpo, kur vjen puna për prodhimin e tyre, mendojmë vetëm për globalin, për shumën e madhe.

Në raportin që i paraqitet Sekretariatit të Komitetit Qendror për punën ideopolitike që bën organizata e Partisë me punëtorët e ndërtimit të Hidrocentralit të Fierzës, lexova se atje janë shpërndarë 260 radio dhe ka vetëm 4 qendra zëri. Po përsë janë shpërndarë

kaq shumë radio? Këto, siç e dimë, kanë ardhur të tëra nga jashitë ose janë prodhuar me materiale të blera jashtë. Mendimi im është se në vend të 260 radiove dhe 4 qendrave zëri, atje të kishte më mirë 10 qendra zëri dhe vetëm 2 radio. Kështu si është vepruar, të gjitha mjetet financiare të caktuara për propagandën janë përdorur, siç duket, për të blerë radio. Po pse veprohet kështu, gjersa për radiot populli ka nevojë? Po masat punonjëse kanë nevojë për shumë gjëra, që janë një mori e madhe, të imëta dhe shumë të imëta, për prodhimin në vend të të cilave shumë herë është folur e megjithatë mungojnë në treg. Do t'i prodhojmë ne köta artikuj të imët e shumë të imët, për të cilët po flasim vazhdimeshit? Ne kemi mundësi që me disa investime të vogla të prodhojmë një mori artikujsh të imët e shumë të imët dhe të tërheqim nëpërmjet tyre mjaft të holla. Prandaj të marrim masa që këta t'i prodhojmë në sasi gjithnjë e më të madhe, pse populli ka shumë nevojë për ta.

Në këto drejtime nuk duhet të kënaqemi duke sjellë ndonjë fabrikë për të prodhuar, fjala vjen, nise-shtë ose ndonjë artikull tjetër, por, brenda mundësive, të marrim edhe masa të tjera që të shtojmë në një shkallë më të madhe prodhimin e artikujve të vegjël shumë të nevojshëm për popullin, në sasi të mjaftueshme, me cilësi të mirë dhe në asortimente të gjith-farëllojshme.

Për mobiljet unë doja të thosha që të mos vëmë qerren përpara buajve, problemi i tyre nuk mund të zgjidhet duke e prodhuar çdo artikull mobilierie, për të cilët ka nevojë populli, vetëm me lëndë druri. Gjersa

këta artikuj i kemi deficitarë, na vihet detyrë të mendojmë me çfarë lëndësh të tjera mund t'i prodhojmë që ta shtojmë sasinë e tyre, të prodhojmë edhe me lëndë plastike dhe t'i zgjerojmë kështu repartet e zdrukthëtarive për këtë qëllim, ndryshe, në kushtet e tanishme, nuk mund të sigurohen nevojat për mobiljet.

Çështja e cilësisë, më duket mua, nuk po kuptohet drejt. E kam fjalën lidhur me stoqet. Cilësia e çdo artikulli që prodhojmë është e caktuar, prandaj gjithçka duhet të prodhohet sipas parashikimeve, se po nuk doli me cilësi të mirë, do të përfundojë patjetër në stok. Në këtë drejtim ne duhet të jemi shumë të shtrënguar, të mos lejojmë shkelje. Por në situatën që jemi aktualisht, në rast se mendojmë të plotësojmë deri dëshirat dhe gustot e individëve të veçantë, do të futeshim në qorrssokak. Prandaj të mos pretendojmë tej mundësive tona.

Nuk mund të mos na bjerë në sy veshja e disa grave dhe e vajzave tona punëtore e fshatare, të cilat edhe në punë na vishen me rroba me cilësi të lartë. Kjo duhet të na bëjë të mendojmë se, kështu, si veprohet, nuk po i edukojmë drejt njerëzit tanë.

Kam dëgjuar nga disa shokë të trektisë të thonë që kombinati i tekstileve «Stalin» duhet të ndryshojë ngjyrat e dizenjot e tekstileve, që köto i kemi kërkuar të na i prodhojnë në këtë osc në atë mënyrë etj., etj. Po përsë ekzistojnë gjithë köto pretendime? Sa dizenjo janë përgatitur gjer tani për tekstilet që prodhon kombinati «Stalin»? Me mijëra! Megjithatë ekziston prirja të bëhen të tjera. Po pse, guston e çdo njeriu do të kënaqim ne, guston e çdo gruaje apo të çdo burri që

basmën njëri e do me vija, tjetri e do me lule etj., etj.? Jo, shokë, ne e kemi për detyrë të mos nxjerrim prodhime uniforme, të ketë patjetër sa më tepër llojshmëri në prodhimet tona, por jo të nxjerrim çdo vit artikuj të ndryshëm, se kështu dashkan disa. Sa mundësi të kemi, do të bëjmë, po rëndësi ka që ato që prodhojmë, t'i nxjerrim me cilësi të mirë, sipas parashikimeve, me bojëra që mbajnë, pse qëllon nganjëherë që kombinati i tekstileve «Stalin» basmat nuk i nxjerr në atë cilësi që i është caktuar. Po përse ndodh kjo? Ne duhet të kemi parasysh medoemos edhe cilësinë e pambukut që prodhojmë në vend, të ndjekim u bë apo jo pambuku i asaj cilësie që kërkon industria tekstile. Që të mos ketë paqartësi, është e domosdoshme t'u shpjegohen këto vështirësi blerësve. Mirëpo një propagandë të tillë nuk shikojmë të bëhet, që konsumatorët të dinë si është puna dhe të mos vazhdojnë të thonë që prodhimet nuk janë të mira, po të jenë në korent për arsyet përse nuk janë të mira dhe këto duhet t'ia shpjegojmë politikisht popullit, në situatat konkrete që rrojmö. Në këto drejtime ne duhet të bëjmë hapa më përpara dhe kemi mundësi t'i bëjmë këta hapa. Unë nuk them se nuk është bërë gjë në këtë drejtim dhe jam dakord me të gjitha masat që janë marrë, po ka mundësi të bëjmë më shumë, sidomos në bujqësi.

Bujqësia është një nga sektorët që prodhon artikuj të domosdoshëm, me të cilët furnizohet populli dhe që shërbejnë për të thithur edhe monedhën. Por duhen bërë përpjekje për të térhequr edhe paratë që fiton fshatarësia, pse pavarësisht sa është prodhimi bujqësor, ajo disponon para, për arsyec se tepricat ia blejmë,

bile edhe ato të oborrit kooperativist. Shteti ka interes të madh t'i marrë tepricat fshatarit, njëkohësisht e ka detyrë t'i çojë atij mallra industriale, për të cilat ka nevojë dhe është në gjendje t'i blejë me paratë që ka në xhep. Në këtë drejtim kemi shumë për të bërë dhe jemi dakord që edhe kokëçarje ka, njerëzit tanë në të tërë sektorët punojnë, megjithatë kërkohen akoma më shumë përpjekje nga ana e tyre pse deficitet janë të mëdha.

Si përfundim, mendoj të pranojmë si orientim që të ketë një rritje të monedhës në qarkullim, por kjo të jetë shumë e vogël, pse sa më e vogël të jetë shtesa, aq më mirë do të jetë. Çështja është të vëmë detyra që të realizohet plani, të shtojmë kudo edhe kursimet, bile të bëjmë sa më shumë kursime, duke u përpjekur të frenojmë dietat, lëvizjet pa nevojë, drekat e darkat, shpenzimet inproduktive etj. Sa më tepër t'i shkurtojmë këto, aq më mirë do të jetë për qarkullimin monetar.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

QE TË MOS KRIJOHEN STOQE, T'I PRODHOJMË MALLRAT SIPAS GUSTOS SË NJEREZVE

*Nga biseda me sekretarë të KQ të PPSH
dhe me dy ministra¹*

19 shtator 1972

Në vazhdim të diskutimit që bëmë dje në mbledhjen e Byrosë Politike për monedhën në qarkullim, dëshiroj të di disa çështje për t'i pasur sa më të qarta, por pa u ngatërruar me vogëlsira të panevojshme. Po të na duhen hollësira, më vonë, mund t'i shikojmë sipas rastit.

Unë dua të di sa para nga shuma e të hollave që hedhim në qarkullim gjatë vitit do të ndodhen në xhepat e qytetarëve dhe sa në arkat e ndërmarrjeve shtetërore që blejnë mallra të konsumit të gjerë me lekë në dorë. Këtu, natyrisht, hyjnë edhe një sërë mjetesh, si fondi i pagave e të tjera që nuk na interesojnë në

1. Në këtë bisedë që u zhvillua në selinë e Komitetit Qendror të PPSH merrnin pjesë shokët Haki Toska e Xhafer Spahiu, në atë kohë sekretarë të Komitetit Qendror të PPSH si dhe ish-ministri i Tregtisë Kiço Ngjela dhe ai i Financave Aleks Verli.

rastin konkret. Që të kuptohemi mirë, sqaroj se unë dua të marr vesh jo shumën e të hollave si tremujor, por atë që, sipas planit, do të jetë në fund të vitit 1972; në dorën e qytetarëve ose të ndërmarrjeve.

Këtë shumë ne duhet ta thithim, se ky është proces në dinamikë, por këtu del çështja e shpejtësisë së qarkullimit. Sigurisht, parashikimi ynë mund të mos jetë përfundimtar, se shpenzimi i të hollave nga qytetarët nuk bëhet pikërisht siç mendojmë ne, por çështja është që të bëjmë të hidhen në qarkullim sa më shumë e sa më shpejt të hollat që ruhen. Pra, e përsëris, unë dua të di: sa para janë hedhur në qarkullim për vitin 1972, sa prej tyre i kthchen përsëri shtetit nëpërmjet shitjes së sendeve të konsumit të gjerë dhe sa mbeten në xhepat e qytetarëve ose në arkat e ndërmarrjeve?

Gjithashtu dua të mësoj sa është sasia e mallit tonë industrial që destinohet për treg? Nuk kërkoj prodhimin e industrisë si total, po vetëm atë për treg, që të shohim, pastaj, raportin midis mallrave dhe të hollave.

Pyetjet janë të qarta¹. Unë e kam fjalën sa e kemi ne emisionin për vitin 1972, sa të holla do të tërheqë shteti nëpërmjet shitjes së mallrave etj. dhe sa do t'i mbeten popullatës. Ashtu sikundër themi zakonisht përparatë, që një pjesë do të harxhohen dhe një pjesë do të taprojnë, mund të shprehemi me analogji edhe për mallrat. Unë pyes sa mallra janë shitura nga ato që hedh në treg industria jonë, duke përjashtuar prodhimet

1. Shoku Enver Hoxha e theksoi këtë, pasi ish-ministri i Tregtisë, Kiço Ngjela, ndërhyn duke thënë: «Nuk i kam shumë të qarta pyetjet!».

bujqësore e blegtoreale, se ato, sado të hidhen në treg, të tëra shiten. Mallrat e importit nuk më interesojnë shumë, sepse ato në përgjithësi shiten sa të hidhen në treg, vetëm ndonjë gjë e vogël mund të mbetet. Si përfundim, të nxjerrim sa janë mallrat e industrisë sonë të shprehura në para, sa prej tyre hidhen në treg, sa shiten dhe sa mbeten stoqe. Sepse del që shumë para i mbajnë qytetarët dhe nuk i depozitojnë në arkat e kursimit. A kontrollohet kjo sasi parash që mbahet nga qytetarët?

Për të shpejtuar qarkullimin e monedhës, a nuk mundet tregtia të ndikojë të rishikohet struktura e prodhimit?

Ne kemi një industri që mendoj se nuk duhet të punojë pa objektiva të qartë; ajo duhet të synojë në dy drejtime: të plotësojë nevojat e popullit tonë dhe të shesë tepricat në tregun e jashtëm, në mënyrë që eksporti t'i shërbejë zhvillimit të mëtejshëm të ekonomisë. Ne duhet ta shikojmë me shkakhtësi këtë zhvillim se mund të na ndodhë ndonjë moment që të na zihen këmbët, siç u janë zënë më shumë akoma të tjerëve. Nuk është aq e lehtë të vendoset një teknologji e re, kur në të njëjtën kohë vazhdohet të prodhohet. Ne edhe kur në një moment të caktuar kemi vendosur të prodhohet një mall që na duhet, me shumë vështirësi kemi bërë ndonjë ndryshim në assortiment.

Unë nuk jam për atë që të kënaqim guston e secilit, se kjo gjë është mjaft e vështirë, por për ndonjë assortiment diçka mund të bënim. Për shembull, assortimentet e enëve të emaluara, që kanë mbushur tregun, duhet t'i ndryshojmë, me qëllim që të kënaqim kërkesat e konsumatorëve e të mos na mbeten të vdekura nëpër maga-

zina. Mua më duket se këtë fenomen duhet ta studiojmë në mënyrë krijuese dhe në harmoni me investimet financiare, me tregtinë e industrinë dhe me kërkesat e konsumatorëve. Këtu mendoj se është një ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në gjendjen e mallrave në treg.

Ministria e Tregtisë pas bilanceve vjetore, në një ose në dy vjet një herë duhet t'i dalë me propozime Qeverisë që të ndërrohet orientimi për prodhimin e këtij ose atij lloji malli që nuk shkon në treg, kurse për mallrat e tjera, për të cilat populli ka nevojë, të vazhdojë prodhimin.

A veprohet kështu në praktikë? Nuk mohoj se në këtë drejtim ne kemi iniciativa të mira, por, duke marrë parasysh nevojat që kemi, ato nuk janë të mjaftueshme. Tregtia duhet t'i shohë me kujdes mallrat e pashitura në treg, të mendojë e të punojë, që ato të shiten. Kam mendimin që Ministria e Tregtisë duhet të eaktojë njëfarë afati se sa duhet të rrijë një mall në dyqan. Çështja është që të qarkullojë paraja, sepse qarkullimi çon përpara realizimin e planit. Çfarë del nga qarkullimi, shiten mallrat apo jo? Por dhe industria ka detyrat e saj në këtë drejtim. Ajo duhet të prodrojë ato mallra për të cilat ka kërkesa nga populli, si batanije leshi, prodhime qelqi, plastmasi etj.

Ashtu siç flasim për plotësimin e nevojave të popullit me tekstile dhe për eksportimin e tyre, duhet të kemi parasysh e të veprojmë edhe për plotësimin e nevojave të brendshme për prodhimet e plastmasit dhe për eksportimin e tyre. Në qoftë se në një moment, ta zëmë, legenët e ngopin tregun, atëherë duhet të mos

vazhdojmë t'i prodhojmë më, por në vend të tyre të bëjmë diçka tjetër. Veçse duhet parë nëse mund ta bëjmë menjëherë ndryshimin e prodhimit të plastmasit, se për tekstilet nuk mund të bëjmë ndryshime të menjëherëshme.

E kam çështjen që të marrim masa me qëllim që të mos vijë një kohë e të saturohemi dhe megjithatë të vazhdojmë prodhimin, kur jemi të sigurt se malli ynë është shumë prapa kërkesave të eksportit. Në qoftë se vazhdohet të prodhohet një stof që nuk e merr populli ynë, atëherë kush tjetër do ta marrë? Prandaj për shumë gjëra, para se të veprohet, të mendohet drejt që në fillim. Ne më vonë do të eksportojmë më shumë, se hapen tregje, por të mos prodhojmë pa i bërë llogaritë mirë dhe të kërkojmë pastaj nga të tjerët që të marrin mallrat tonë, sepse ata mund t'i marrin, por mund edhe të mos i pranojnë, kur nuk u përgjigjen standardeve botërore. Pra, dy rrugë janë për evadimin e mallrave: ose t'i marrë populli, ose t'i eksportojmë. Që të plotësohet kjo detyrë e të mos kemi stoqë, industria duhet të jetë e perfekcionuar. Të kemi kujdes që kur ngremë një linjë të re, që është e vogël, kjo të mos na pengojë zhvillimin dhe ngritjen e linjave të tjera më të mëdha. Lidhur me tregtinë, zgjerimi i rrjetit në fshat është një gjë shumë e mirë, se fshatarit i vete malli afër, por kjo punë do kujdes, sepse ka mundësi që malli i dërguar në zonat e thella të qëndrojë shumë në dyqanin e fshatit dhe atje të vjetrohet, t'i dalë boja, të laget e të dëmtohet dhe kështu pa pritur e pa kujtuar të na krijohen stoqë në një kohë që industria vazhdon fabrikimin e po atyre asortimenteve. Prandaj duhet

kujdes që në rrjet të hidhen mallrat që shkojnë dhe ato që i jepen tregut të mirëmbahen!

Këtu ka vend për t'u rishikuar edhe organizimi i punës së tregtisë. A është e udhës që Ministria e Tregtisë të merret edhe me gjërat më të vogla si, për shembull, vete apo jo malli në dyqanin e Lukovës? Derisa janë ndërmarrjet tregtare dhe komitetet ekzekutive të rretheve që interesohen për këto punë, atëherë përsë të kërkojë ministria domate e të mos kujdeset për këto vetë rrethi? Puna është që ju të ministrisë i të mos hyni në ato gjëra që duhet t'i bëjnë të tjerët, rrethet. Për shembull, rrethi, që ka detyrime kontraktuale përfurnizimin, ta zëmë, me patate, të një rrethi tjetër, duhet të shlyejë me përpikëri detyrimin, pa qenë nevoja të ndërhyjë ministria. Në qoftë se për shkaqe të ndryshme prodhimi bujqësor nuk realizohet në një rreth, a duhet të ndërhyjë ministria përfundim, fjalë bie, të 100 kuintalë patateve të prodhuara në një rreth tjetër, kur ato janë të destinuara në një drejtim të caktuar? A, kur është fjalë për rezervat e shtetit dhe jo vetëm për sendet ushqimore, por edhe ato industriale, po, këto duhet t'i manovrojë ministria.

Për transferimin e një sasie të misrit nga një rreth në tjetrin, ministria i jep urdhër ndërmarrjes së grumbullimit dhe kaq. Po pse atëherë bëhen shumë ankesa përfundim, e ministrisë, si përfshembull, përmodelet e mallrave që prodhohen, përfondet etj. Në Korçë, përfshembull, na qaheshin përmodelet dhe përfshumë gjëra të tjera. Fabrika e Trikotazhit të Korçës, përfshembull, e prodhon mallin sipas dëshirës së popullit dhe në bazë të detyrës së planit kontraktor me ndërmarrjet e tjera.

marrjet e Fierit, të Kolonjës dhe të rretheve të tjera. Në qoftë se, për shkaqe të arsyeshme, Fabrika e Trikotazhit nuk prodhon dot mallin sipas kushteve të kontratës, ai duhet t'i propozojë palës tjetër një mall të përafërt, por unë kam dëgjuar që ministritë ndërhyjnë në modelet. Në Korçë, gjithashtu, ankoreshin se megjithëqë prodhimet e tyre pëlqehen nga gratë e këtij qyteti ose të Shkodrës, shokët e ministrisë i urdhërojnë për modele të tjera. Çështja është se ka probleme të tjera shumë më të mëdha, me të cilat duhet të merreni ju si ministri, prandaj mos u futni edhe në gjëra të vogla, që ju pengojnë për të ndjekur të mëdhatë¹. Po u kapët pas rasteve, këto të mbërthejnë, të ngatérrojnë dhe të heqin vëmendjen nga problemet kryesore. Për të të futur në ingranazhe, tjetri të nxjerr sa të duash justifikime, prandaj është më mirë, mendoj unë, që diskutimet të jenë të prera për këto gjëra. Tash nuk jemi në atë fazë kur njerëzit nuk ishin të aftë, kur nuk i kuptionin mirë gjërat dhe për këto arsyen nuk mund të mbanin përgjegjësi.

Si konkluzion, unë them se mallrat industriale që i prodhojmë ne dhe që i kemi në rrjet duhet t'i kontrollojmë periodikisht, me qëllim që të mos na shumohen dhe të na mbeten stoqe. Për të mos u krijuar stoqe le t'i prodhojmë mallrat sipas gustos së njerëzve. Ne jemi shumë të ngadalshëm në ndryshimet që u duhen bërë modeleve etj. Nuk them të bëjmë ndryshimet në strukturën

1. Për tu justifikuar, ish-ministri i Tregtisë, K. Ngjela, në ndërhyrjen e tij, tha: «Ne na tërheqin gjërat e vogla, se jemi mësuar me metodën e vjetër të punës. Në mjaft raste në rrethe lindin mosmarrëveshje, prandaj ndërhyn ministria».

e fabrikave, se këto nuk i bëjnë as të tjerët, por e kam fjalën për ndryshimet e strukturës dhe të formave të prodhimit. Të mos qëndrojmë të ngathët në kënaqjen e gustos së njerëzve dhe të synojmë që të krijojmë mundësi për eksport. Për një kontroll më të rreptë në këtë drejtim, më duket mua, kërkohet bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Industrisë, të Tregtisë dhe të Financave.

Për sa i përket uljes së çmimeve, mendoj se duhet të ketë një kriter jo vetëm në sasi, por edhe në kohë. Për disa prodhime të kombinatit të tekstileve «Stalin» edhe pse nuk ka nevojë tregu, ka dy a tre vjet që vazhdojnë të prodhohen, megjithëse për to shtrohet problemi i uljes së çmimeve. Çmimet e këtyre mallrave, që janë prodhuar dhe nuk po shiten, mund t'i ulim deri në atë masë sa të mos ketë humbje, por në të njëjtën kohë, të mos ketë ngaftësi në prodhimin e assortimenteve të reja që kërkojnë konsumatorët. Të shesim më shpejt, duke ulur çmimet. Mbajtja e mallrave krijon kënaqësinë false se gjoja kemi gjendje. Është më mirë të mos ketë një gjendje të tillë, kjo do të na nxitë për të prodhuar artikuj të rinj. Kjo „gjendje“ na sjell veçse dëme. Kush i blen me çmimin e caktuar këpucët që sjanë bërë të mira? T'i prodrojmë si duhet edhe këpucët e ushtarëve që kryejnë shërbimin e detyrueshëm ushtarak ose stërvitjen mësimore.

Kur kërkohen batanije leshi duhet të prodhohen ato, pse kështu edhe populli kënaqet edhe prodhimi nuk mbetet grumbull në depot dhe dyqanet e tregtisë.

Lidhur me atë që the ti, Kiço, se ju merreni me gjëra të vogla, dua t'ju përmend diçka që më thoshte një

ditë shoku Rita [Marko]. Në ndërmarrjen pyjore të Tiranës që varet nga Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Rrethit të Tiranës, lindi një problem që kërkonte zgjidhje. Për këtë problemi ishte në dijeni Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Rrethit. Por, në vend që të vepronin vetë, shokët e rrethit thanë: le ta zgjidhë ministria. Po pse të përzihet ministria në këtë çështje kur e ka për detyrë ta zgjidhë komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit? Ministria u paskësh dhënë përgjigje shokëve të rrethit, po pse duhet t'u thotë ajo për një gjë që është detyrë, që duhet ta bëjë vetë komiteti ekzekutiv? Drejtori i ndërmarrjes mund ta ketë shkelur ligjin për të gjitha sa kishin ndodhur, por ama për problemin nuk ishte interesuar komiteti ekzekutiv i rrethit.

Secili të bëjë mirë punën e vet, ndryshe s'mund të dalë as përgjegjësia e secilit në punë e sipër.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim. që gjenden në AQP*

JO TEORIZIME, POR MASA KONKRETE PËR VENDOSJEN E NORMAVE TEKNIKE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

21 shtator 1972

Gjatë ndërhyrjeve që bëra, kur diskutonin shokët, dhashë disa mendime dhe, meqenëse shokët ngritën mjaft çështje serioze dhe preokupante, me të cilat edhe unë jam dakord, nuk kam shumë gjëra për të thënë si konkluzion të këtij problemi të rëndësishëm. Vetëm dëshiroj të theksoj se, si kudo, edhe në drejtim të normimit teknik të punës, ne kemi bërë përparime. Por, në rast se punën për këtë problem do ta organizojmë më mirë në të gjitha hallkat, në rast se do ta forcojmë këtë sektor me kuadro më të aftë, të cilët duhet t'i stërvitim vazhdlimisht e në mënyrë serioze për këtë çështje kaq të rëndësishme të ekonomisë sonë, përparimet do të jenë edhe më të mëdha.

1. Në këtë mbledhje u diskutua rrëth zbatimit të konkluzioneve të Byrosë Politike të KQ të PPSH, të dhjetorit 1971, për normimin teknik të punës.

Mendoj se kolektivat punonjës, rrethet dhe ministritë duhet t'i rishikojnë disa forma organizimi që kemi në fuqi për normimin e punës, pse kam përshtypjen (natyrisht jo një përshtypje radikale), sikur ka një afirmim si shumë qetësues për mundësitet e punës në këtë sektor, ndërsa, lidhur me zgjidhjen drejt të këtij problemi kapital ekonomik, mua më duket se akoma nuk ka vend për qetësi.

Termat që dëgjohen se: «Do të shikohet për të kaluar nga këto norma që kemi, në norma më të avancuar», mendoj të përcaktohen më mirë. Nuk është me vend të vazhdojmë të themi: «Do të shikohen», po të kalohet konkretisht në përsosjen e mëtejshme të normimit të punës. Që të arrihet ky rezultat, siç u theksua edhe këtu nga shokët diskutues, studimet nuk i duhen lënë spontaneitetit, por të përfundohen brenda kohës që vendoset. Caktimi i afateve të studimit, sipas mëndimit tim, lyp një formë organizimi që duhet ta përsosim gjithnjë më mirë, si për ato studime që bëhen në mënyrë të pérhershme, ashtu edhe për diçka që mendohet të zbatohet brenda një kohe të caktuar. Në qoftë se nuk e organizojmë në këtë mënyrë punën për zgjidhjen e këtij problemi të vështirë me rëndësi kaq të imadhe ekonomike, politike dhe ideologjike, sikurse është ai i normimit teknik të punës, ku marrin pjesë organizatat e Partisë, teknikët, organet ekonomike, shtetërore, organizatat e bashkimeve profesionale, të bashkimit të rinisë etj., me një fjalë, gjithë punonjësit, jo vetëm nuk do të kemi përmirësime, po do të humbasim në një front pune shumë të gjerë, pa përgjegjësi dhe pa kritere të

drejta e të caktuara, mungesa e të cilave do të na pëngojë në kontrollin e vendimeve mbi këto probleme.

A është menduar ndonjëherë nëse sistemi i normave që kemi vendosur dhe mbi të cilin po ecim, është i mirë? Fjala vjen, disa makina kanë një normë të caktuar; ka t'u tjera që kanë një normë tjetër dhe në këtë mënyrë, na bëhet një mori e madhe normash që duhen studiuar. Mirëpo studimi thuhet se do të bëhet vitin tjetër. Veç kështu si po ecet as për tre vjet dhe as për pesë vjet, bile, nuk do t'i kemi këto norma që themi të vendosen. Këtë problem ne nuk e shtrojmë sot, kemi kohë që flasim për të, por s'po bëhet gjë. Në qoftë se normat i vëmë për t'u bërë qejsin vetëm punëtorëve, atëherë nuk do të kemi gjë në vijë. Punëtorëve do t'ua bëjmë qejsin në qoftë se do të arrijmë disa caqe në zhvillimin e ekonomisë, në rritjen e rendimentit, në fitimin e kohës etj. Vetëm kështu mund të mendohet se shikohet interes i punëtorëve, ndryshe themi vetüm fjalë. Mua më duket se për problemin e normimit të punës jemi futur në një labirinth nga i cili s'po dalim. Po konstatoj se kemi një diferencim shumë të madh në normime; shpesh e kërkojmë qimen edhe në vezë.

Mendoj se duhet të vëmë një normë mesatare dhe jo në mënyrë kaq të hollësishme, ndryshe nuk mund t'i dilet kësaj pune.

Një nga çështjet kyç që kanë lidhje me problemin që po diskutojmë është edhe studimi që po bëhet për pagat dhe kategorizimet, problem ky me rëndësi të madhe ekonomike. Në qoftë se këtë nuk e zgjidhim drejt, në bazë të një studimi të gjithanshëm dhe jo të shpejtuar -furtunë-, mund të vendosim gabim, duke dalë me ve-

ndime të përgjithshme e të rrumbullakosura në përcaktimin e pagave dhe të të ardhurave të punonjësve, gjë që ka të bëjë drejtpërsëdrejti me nivelin e jetesës së tyre. Ky nivel, natyrisht, duhet të studiohet në situatë aktuale të ndërtimit tonë socialist dhe të bazohet në mundësitë ekonomike që kemi dhe jo sipas dëshirës.

Lypset ta kuptojnë të gjithë që shteti ynë i diktaturës së proletariatit lufton përmbrojtjen e interesave të klasës punëtore dhe të të gjithë punonjësve. Ai përcakton, sa të jetë e mundur drejt, parimisht dhe konkretisht, norma të atilla reale në punë, jo për t'u bërë qejfin punonjësve të një ndërmarrjeje të veçantë, por duke pasur parasysh interesat e përgjithshëm të ndërtimit të socializmit në vendin tonë, me të cilët kuptojmë edhe përputhjen e interesit vetjak të çdo punonjësi. Këtë orientim politik ne duhet ta kemi kurdoherë parasysh në të gjitha çështjet, ndryshtë do të veprojmë në mënyrë sentimentale në shumë drejtime.

Për zgjidhjen e problemit të normimit teknik dhe të pagave të punës, duhet mbështetur në mundësitë reale të nivelit të ekonomisë sonë dhe të mos veprohet në mënyrë sentimentale, për t'i bërë qejfin njërit apo tjetrit: Një prirjeje të tillë i duhet vënë fre, pse po të veprohet sipas kësaj mund të ocet disi, për një kohë të shkurtër, por më vonë do të na dilnin vështirësi politike dhe ekonomike të vështira për t'u kapërcyer. Prandaj, në studiun e normave dhe të pagave, sikurse e thashë, të nisemi kurdoherë nga kushtet konkrete të zhvillimit të ekonomisë sonë socialistë. Problemi të mos shikohet në mënyrë të njëanshme apo të ekzagjerohet, duke ngritur çështjen se me këtë apo atë sistem

norme ose page do të na preken, bie fjala, pesëdhjetë mijë apo njëqind mijë punonjës.

Nuk është reale as pikëpamja e shokut sekretar të komitetit të Partisë të Kombinatit Metalurgjik të Elbasanit, sipas të cilët, punëtorët e rinj, që vijnë nga fshati, qenkan të pakënaqur, pse marrin një pagë të ulët. Edhe një i ri në kooperativë, sot për sot nuk mund të marrë më tepër se në metalurgji ose në çdo ndërmarrje tjetër shtetërore. Atëherë, si mund të dilet me konkluzione të tilla të hedhura pa përgjegjësi?! Në qoftë se çështjet i studiojmë mbi baza joreale, si rasti që përmenda, atëherë gjithë propaganda e Partisë, si dhe caqet që do të vendosim për t'i arritur ato, nuk do të gjejnë zbatim. Si mund të thuhet se është i pakënaqur një i ri që vjen nga fshati dhe punon në një ndërmarrje, kur babai, nëna, motra e të tjerë që ka atje punojnë në kooperativë dhe, me punën që bëjnë, kanë të hanë, të pinë e të vi-shen?! Përse të mos jetë ai i kënaqur në metalurgji, gjersa merr më shumë sesa merrte në kooperativë, ushqehet, fle dhe plotëson të gjitha nevojat kundrejt një shume minimale që paguan në ditë? Jo vetëm kaq, po ambienti ku punon në këtë ndërmarrje është më i përparuar se ai i fshatit, pse aty ka kinema, radio, kinoklube etj., etj. objekte që akoma nuk janë në këtë masë dhe nivel në fshat. Këto vërejtje nuk i kam vetëm për shokun sekretar të komitetit të Partisë të Kombinatit Metalurgjik, po edhe për ndonjë tjetër që mund të gjykojë në të njëjtën mënyrë si ai.

Duke arsyetuar drejt dhe realisht, është e qartë se konkluzione të tillë, si ky që na u paraqit, s'janë të vërteta; ato janë të nisura më shumë nga baza senti-

mentale. Arritja në përfundim e subjektive do të na dëmtojë patjetër rëndë jo vetëm ekonomikisht, po edhe ideologjikisht e politikisht. Në rast se për dhjetëra vjet me radhë, ne krijojmë një situatë të atillë, fjala vjen, që një i ri që sapo fillon punën, merr menjëherë një shumë të mirë të hollash në muaj, atëherë të mos çuditemi aspak kur të na thotë, bile me përbuzje: «Unë s'bëhem murator» etj., etj. Nga gjëra të tilla do të na lindin patjetër shumë vështirësi. Prandaj, çdo masë që marrim, ta peshojmë mirë, pra edhe normat t'i llogaritim dhe t'i përcaktojmë drejt. Në vija të përgjithshme, llojet e normave, si për shembull, normat statistikore, teknike etj. janë përcaktuar por, në këtë drejtim, na bie detyrë të punojmë akoma dhe më seriozisht.

Kur isha në Korçë, në Fabrikën e Konfeksioneve, pyeta se si paraqiteshin me këto çështje. Atje i kanë specifikuar shumë proceset e punës, saqë njëra punëtorë bën jakat, tjetra mëngët, një e tretë qep vetëm pullat etj. Unë vajta pikërisht tek ajo që qepte pullat dhe vrimat i bënte thilë. Punëtorja qe vendosur pranë makinës dhe qepte pullën, pastaj bënte thilenë dhe, menjëherë, pa vonesë, vinte tjetrën, se çdo operacion e bënte makina. «Sa kohë ke këtu ti, moj vajzë, dhesa merr?», e pyeta unë. «Kam një vit, dhe marr 530 lekë në muaj» — m'u përgjigj ajo. Kryeinxhinieri, që më foli për këtë çështje, më tha se tani po i specializonin më tej punëtorët e ndërmarrjes. Kur i kërkova shpjegime të mëtejshme, se si do t'i specializonin, kryeinxhinieri më tha se vajzat punëtore i mësojnë shpejt proceset e punës; brenda një, dy ose e shumta tri ditëve, secila, është në gjendje të specializohet për jakën. Sa para-

do të marrë, e pyeta unë, me një ditë specializim? Ai. pa të keq, më tha: «450 lekë».

Shikoni, pra, si është gjendja! Prandaj duhet të ecim më me kujdes në këtë drejtim, se pastaj del vetveti çështja që, një tekniku të kualifikuar, kur i vihen norma teknike me caqe të shtrënguara dhe i kërkoitet që planin ta tejkalojë 2 për qind të normës që i është caktuar, po të shikojë që një punëtor tjetër, i pakualifikuar, e tejkalon atë 20 për qind, me të drejtë do ta kundërshtojë këtë gjendje, nuk do ta gjejë të drejtë normën që i kanë caktuar. Kjo, mendoj unë, nuk mund të jetë në leverdinë e ekonomisë sonë. Këto punë duhen bërë në bazë të një kriteri, bile të një kriteri të shtrënguar. Kështu, për t'i realizuar normat, duhet t'u japim mundësinë punëtorëve, të cilët punojnë me to, që të kualifikohen për një kohë. Për këtë qëllim ata duhet të bëjnë përpjekje të mëdha që normat teknike t'i realizojnë dhe në qoftë se duhet të bëjmë ndonjë shtesë, ta bëjmë. Të krijohen mundësi të atilla që punëtori të vijë medoemos vetë e të kërkojë që të vihet normë teknike apo një normë tjetër në procesin ku punon, po jo të punojë pa normë. Atëherë do të shohim se tërë njerëzit do të vihen në lëvizje, pse, kur të vësh normat teknike në zbatim, tjetri duhet të kalojë herë pas here në një radhë kursesh kualifikimi, kurse me gjendjen ekzistuese nuk ka shumë kokëçarje nga ana e punëtorëve. Edhe për realizimin e normës progresive, po t'i vendosësh kudo, punëtori duhet medoemos të ketë një kualifikim, kurse kur punon pa normë, e merr fare lehtë pagën, prandaj nuk interesohet për kualifikim. Ndaj këto çështje duhet t'i shikojmë më mirë e në tërsësi.

Pra, më e rrezikshme është gjendja atje ku vazhdohet të punohet akoma pa norma. Siç e thashë edhe gjatë ndërhyrjeve që bëra, sa të jetë e mundur të kalohet seriozisht në punën me norma. Mund të mos e kem drejt, po personalisht mendoj të rishikohet parimi që na ka udhëhequr dhe vazhdon të na udhëheqë edhe sot, sipas të cilit, në disa procese pune, nuk mund të vendosim norma. Flitet, për shembull, se avulli s'ka si matet, por unë mendoj se mund të gjenden mënyrat që edhe avulli të matet. TEC-i i Korçës, fjala vjen, ku punojnë një numër punonjësish, jep një sasi avulli me harxhimin e një mase të njohur lëndë djegëse, e cila prodhohet, gjithashtu, me norma. Prandaj, ata që punojnë atje, mbi këto baza mund të inkadrohen plotësisht në normat teknike. Është e domosdoshme që problemi ta shtrojmë kudo kështu dhe të mos bëhet asnje lëshim. Si me TEC-et mund të ketë dhe shumë qendra të tjera pune ku duhet parë ky problemi. Prandaj, ka vend që, jo vetëm këto, po edhe dy kategoritë e mëparshme të normave ne duhet t'i rishikojmë në hollësi. Them që të rishikohen normat, se mund të kemi anuar më shumë nga ana teorike e problemit, që, për të vendosur diku norma teknike, duhen këto e ato kushte etj., etj. Gjersa dëshirojmë dhe gjykojmë se duhet të vendosim kudo norma teknike, është e domosdoshme të bëjmë kujdes dhe të marrim masa konkrete në këtë drejtim; të mos teorizojmë më shumë nga sa duhet, duke arsyetuar se, në situatën aktuale tonën, ne nuk i kemi akoma të tëra kushtet që kërkohen për vendosjen e normave teknike.

Në gjithë ata punëtorë të një ndërmarrjeje, a nuk

ka disa prej tyre që të jenë me të vërtetë të ndërgjegjshëm dhe komunistë dhe jo nga ata që të tundin zinxhirin. që, kur tu bëhet fotografimi i kohës së punës, rezultatet të jenë me të vërtetë të sakta?! Ata duhet të kuptojnë esencën, qëllimin e madh të kësaj çështjeje dhe jo të shohin vetëm xhepin e tyre, i cili nuk ka si të mbushet, në rast se punëtori, në mos nuk i tejkalon, as nuk i realizon normat, domethënë nuk shfrytëzon kohën gjatë 8-orëshit etj. ose nuk lufton të kualifikohet. Nuk kemi ne, pra, punëtorë të tillë? E kam çështjen këtu që, do të lejojmë ne, do të lejojë Partia, që presioni i disa të prapambeturve të na frenojë, apo do të bëjmë që vendimin e drejtë tua imponojmë edhe këtyre për ta zbatuar, duke ua shpjeguar politikisht dhe ekonomikisht këtë masë, duke ua argumentuar me prova, nga ana e interesit personal dhe e interesit të përgjithshëm?!

Në rast se disa, që shohin vetëm interesin e tyre të ngushtë personal, e kuptojnë shtrembër demokracinë e klasës punëtore dhe, pasi ne ta kemi bërë këtë studim me një numër punëtorësh të ndërgjegjshëm, u bëjnë këtyre presion, duke u thënë: «Ç'na bëtë, na morët më qafë» etj. dhe punëtorët e përparuar thyhen, kjo do të thotë që nuk e kemi situatën në dorë.

Partia ka vepruar kurdoherë drejt. Eksperienca e masave ka ndihmuar të nxirren konkluzione dhe të përcaktohet vija për një, dy apo më shumë probleme. Këtë vijë, e cila nuk mund të lejohet që të shtrembërohet, ajo duhet të punojë në mënyrë të tillë që ta përqafojnë të gjithë dhe të ecin në bazë të saj. Ka edhe elementë që përpinqen ta shtrembërojnë atë, megjithatë duhet kër-

kuar me këmbëngulje që të ecet brenda vijës. Kështu mund të ndodhë edhe për normat, të cilat duhet të caktohen me rreptësi dhe zbatimi i tyre të vihet detyrë për të gjithë, dashka apo s'dashka njëri apo tjetri. Pastaj, po të ketë argumente, le të vijnë të thonë se ne do t'uа vërtetojmë politikisht dhe teknikisht drejtësinë e normës së caktuar. Atëherë, ky që bën reklamimin duhet ta pranojë. Prandaj të mos shkojmë me dëshirën e njërit apo të tjetrit. Po të ecim kështu, nuk mund të ketë vijë dhe orientim të drejtë të Partisë; vija atëherë do të ketë zigzage. Një normë që vihet është në interes të klasës, në interes të socializmit. Ne nuk themi që kurrkush të mos e kundërshtojë atë, të mos diskutojë, sepse këto në fakt ne do t'i shtrojmë në bazë, pastaj do të caktojmë përfundimisht atë që është për zbatim. Por, ama, nuk i hedhim ato që të mbeten të varura, po që të vihen në jetë, se jemi të bindur për drejtësinë e tyre dhe bindjen për këtë na e kanë krijuar punëtorët e pararojës. Në rast se, në bazë të provave me një grup punëtorësh e specialistësh, vërtetohet se kjo ose ajo normë mund të arrihet, atëherë le t'i kundërshtojë ndonjëri. Këtij ne duhet t'i përgjigjemi me argumente, me punë politike bindëse dhe teknike. Në qoftë se nuk është i bindur sot ndonjëri, ai do të bindet nesër, ndryshe, po nuk vepruam kështu, do të ketë luhatje të mëdha në këto çështje.

Po a mundet Sekretariati i Komiletit Qendror të japë një mendim të saktë, në qoftë se nga ana shtetërore, nga ana e ministrisë, e rretheve dhe e ndërmarrjeve nuk na jepet një eksperiencë konkrete dhe e argumentuar teknikisht?

Konkretisht, kush e ndjek çështjen e normimit të punës në komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit? Këtu u tha se e ndjekin seksionet përkatëse, sipas degëve të prodhimit. Kështu është në përgjithësi, po a ka ndonjë organ të veçantë që merret me këtë punë? Kush i studion të gjitha vërejtjet, sugjerimet e konkretizimet e normistëve të ndërmarrjeve? Në ndërmarrje ka normistë, po kush i drejton dhe i koordinon punët e tyre? Pastaj, kush ia paraqet rezultatet e punës së tyre komitetit ekzekutiv?

Me këto pyctje që po bëj dëshiroj të ndriçoj sa më mirë problemin, se ne e dimë si ndiqen këto çështje. Në fakt ato nuk ndiqen në mënyrë sistematike që të nxirren konkluzione. Fakti është se në këtë drejtim ka vështirësi, por bëhen edhe lëshime. Prandaj, frazat e përgjithshme «i ndjek komiteti ekzekutiv», «i ndjek çdo seksion» nuk na thonë gjë, por të përpinqemi një çikë e të themi se si duhet të bëhet në realitet sa më e rregullt kjo punë, të reflektohet si duhet t'i zgjidhim më tej e më mirë këto probleme.

Ne mund të shikojmë, për shembull, edhe masat për sigurimin e materialeve e të lëndëve të para në punë, që janë një kusht i domosdoshëm në zinxhirin e kërkesave për zbatimin e normave teknike. Në rast se këto mungojnë, nuk mund të flitet për vendosjen e të tillë normave. Prandaj, në çdo ndërmarrje e repart ku punohet me norma teknike, të luftojmë me kohë që të sigurohet medoemos lënda e parë, si ato që gjenden në vend, edhe ato që duhet të vijnë nga jashtë dhe të mos punohet pa rezerva. Në këtë drejtim lypset vendosur një disiplinë e hekurt, ndaj së cilës ne shpesh jemi shu-

më dorëlëshuar. Lëshimet që lejojmë bëhen shkak për thyerjen e disiplinës dhe për luhatjet e mëdha që vihen re në pagat, normat dhe gjer në kënaqjen e disave me realizimin e planit vetëm si global, prirje që na futin në qorrkokak dhe, për pasojë, na pengojnë të realizojmë vendimet që kemi marrë.

Në kushitet ekzistuese unë mendoj se ne mund të shkojmë edhe në dy kategori, meqenëse me dy kategori u fillua edhe me normat progresive. Prandaj të studiohet nëse mund të bëjmë, gjithashtu, një shkallëzim edhe në këto norma. Disa të dhëna që na pengojnë në punën për realizimin e normave, ne nuk mund t'i hedhim poshtë *a priori*, po t'i themi punëtorit që ty, shoku punëtor, duke realizuar këto norma, të bie të marrësh kaq shpërblim, i cili është në interesin tënd, po edhe në interesin e republikës, sepse, duke luftuar për të tejkaluar rendimentin e gjertanishëm, kjo do të sjellë si pasojë një pakësim të nevojave përfundore etj., etj. gjë që do t'i japë mundësi shtetit të investojë mjete të tjera plotësuese përfundore e mëtejshëm të ekonomisë.

Një rëndësi të dorës së parë marrin në këtë drejtim edhe përpjekjet që duhen bërë përfundimtarëve të punës së punonjësve. Këto çështje duhet t'i shikojmë me shumë kujdes, duke respektuar me rreptësi kriteret e caktuara në ligjin «mbi sigurimet shoqërore-shtetërore».

Vihet pyetja: atyre që janë të sëmurë, do t'u gjejë më punë? Sigurisht që do t'u gjejmë, pse kjo është në interesin e shoqërisë dhe të atyre vetë. Por, sistemimi i invalidëve në punë, sikurse e tha dikush këtu, duhet të bëhet me kujdes e në mënyrë të organizuar nga

zyra të veçanta pranë komiteteve ekzekutive të këshilla-ve popullorë të rrtheve.

Në këto drejtime duhet të shikojmë çfarë mund të bëjmë. Kjo kërkon një studim me iniciativë dhe në mënyrë të organizuar. Këto probleme t'i marrim në dorë, t'i shqyrtojmë me vëmendje të madhe dhe t'i ndjekim realisht në zhvillimin e tyre, pa pretenduar t'u japim zgjidhje të përhershme, në formë të prerë e të pandryshueshme siç vihet re që mendohet disa herë. Në qoftë se kjo çështje më përpara shikohej me të meta, arsyja ishte se atëherë nuk kishim njerëz të mësuar, nuk kishim aq kuadro, sa kemi sot. Tani realiteti është ndryshe. Ne kemi e do të kemi gjithnjë e më shumë njerëz që mendojnë dhe veprojnë me kompetencë. Normistë, për shembull, sot kemi kudo. Ata mund të mos i kemi akoma të tërë të përgatitur si duhet (dhe kemi bërë gabim që nuk e kemi përgatitur mirë me kohë këtë kategori punonjësish) po ama nuk mund të themi që midis tyre s'kemi normistë të mirë, për të krijuar me ta një bërthamë njerëzish të aftë, për të mësuar, këshi-lluar, edukuar e drejtuar gjithë të tjerët që do të na duhen e nevojiten në të ardhmen.

Siç e thashë edhe më përpara, studimet që do të bëjmë dhe projektvendimet që do të na paraqiten të shqyrtojmë, kërkohet të jenë me baza. Për këtë arsy, është mirë që ato t'i çojmë më parë për diskutim në masat, të marrim aprovin e tyre dhe t'i edukojmë ato që t'i zbatojmë në mënyrë të ndërgjegjshme.

Mendoj që në çështjen e normimit teknik të jemi të rreptë. E them këtë se shumë herë tërhiqemi nga pikëpamjet individuale të disa njerëzve që dalin me fla-

murin e «demokracisë» për t'u imponuar të tjerëve mendimet e tyre personale. Mirëpo kësaj nuk mund t'i themi demokraci. Demokraci do të thotë zbatim i vullnetit të shumicës. Prandaj, në qoftë se shumica e punëtorëve është dakord me vendosjen e normave teknike, ato duhet të vendosen medoemos, pavarësisht se mund të mos jenë dakord një, tre, pesë, shtatë apo dhjetë punëtorë të prapanibetur që i kundërshtojnë. Në qoftë se gjatë studimeve që bëjmë, merremi me diskutimin e mendimeve apo me presionet që bëjnë disa persona të pandërgjegjshëm, që përpiken të turbullojnë ujërat e kulluara të Partisë, atëherë vaj halli çfarë do të ndodhë me studimet dhe me vënien në jetë të normave të drejta që caktohen mbi baza shkencore.

Sikurse është thënë në raport, dhe shokët na e shpjeguan edhe këtu sot këtë çështje, nga disa drejtues dhe teknikë ndërmarrjesh ka rezistencë për vendosjen e normave teknike. Partia këta njerëz duhet t'i sqarojë politikisht, pse është e domosdoshme të jenë ata që ta kuptojnë më mirë nga të gjithë këtë problem të rëndësishëm.

Në e kuptojmë dhe e kemi të qartë që në bazë ka vështirësi, të cilave duhet t'u dalim përpara me kohë dhe me një punë më të organizuar. Mundet që për këtë të pengojnë disa caqe, të cilat merren në forma shumë dogmatike. Këtu e kam çështjen në lidhje me studimin e disa problemeve kyç, siç është edhe ky i normave. Ky problem ka të bëjë me të gjitha problemet e tjera që dimë dhe s'sështë nevoja t'i përsëritim, zgjidhja e drejtë e të cilave do t'i sillte përfitime të mëdha gjithë ekonomisë sonë. Për studimin e normave ne kemi cak-

tuar disa persona në organikë që e ndjekin këtë problem dhe jemi përpjekur që këta të jenë sa më të kualifikuar. Natyrisht, ata duhet të kualifikohen edhe politikisht, sepse do të kenë të bëjnë me shumë koncepte që duhen kuptuar mirë dhe kanë lidhje me punëtorët, me kërkesat e nevojat e tyre etj., etj. Mirëpo një përgjithësim i këtyre normave në bazë rrathi, në bazë të orientimeve të dhëna, nuk është bërë ose është bërë shumë i zbehtë. Dihet vetëm që e mori në shqyrtim komiteti ekzekutiv ose komiteti i Partisë dhe asgjë më tepër. Ne jemi brenda këtyre problemeve, prandaj, në qoftë se komiteti i Partisë ose komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit nuk ka një grup punonjësish që ta ndjekë këtë çështje, qoftë edhe përkohësisht deri sa ta vëmë në rrugë, do të jetë e zorshme për të që të arrijë në stabilizimin e normave në rreth. Një pengesë për këtë është burokratizmi që do të nxjerrë përpara argumentin: «Nuk kemi kuadro për këtë problem», në një kohë që direktiva e Komitetit Qendror është të mos fryhen organikat. Kjo jo vetëm që është kuptuar, dhe natyrisht është kuptuar drejt, por çështja është që nuk bëhen as llogari sa humbje ekonomike kemi nga mosvendosja e normave teknike; sa humbje të mëdha ka ekonomia jonë popullore në qoftë se nuk stabilizojnë orientimet mbi normat e të tjera probleme si këto.

Sa mund t'i kushtojë shtetit një grup prej 5 ose 6 specialistësh, që tani nuk na mungojnë në rreth, të cilët për një kohë, qoftë edhe një vit ose një vit e gjysmë, mund t'i futen kësaj pune dhe, në bashkëpunim me të gjithë ata që janë në organikë dhe që marrin vesh nga

kjo punë, t'i dalin matanë kësaj çështjeje?! Llogaria do të na dalë se mbajtja e këtij grupei është me fitim. As që mund të llogaritet humbja përpara fitimeve të mëdha që do të ketë shitet nga kjo punë, e cila mund të kryhet me kuadro të rinj, megjithëse kemi edhe plot kuadro e specialistë të tjera. Vetëm se hezitohet të bëhet në rreth një gjë e tillë. Ky grup mund të krijohet edhe duke hequr në disa ndërmarrje nga një prej këtyre kuadrove dhe do të shohim se nga kjo masë nuk do të humbasim gjë, përkundrazi do të fitojmë.

Përse duhet të lajmërojë Ministria e Tregtisë, Komisioni i Planit të Shtetit ose ndonjë dikaster tjeter qendror që të krijohet në rreth një shtab për zgjidhjen e një problemi si ky në një kohë kur pranë seksionit të industrisë, të tregtisë, të financës etj. krijohen shtabe, të cilat mundet që marrin edhe kompetencat që nuk u takojnë?! Tani kjo çështje paraqitet si një koordinim dhe lehtësimi pune, por, vetë me iniciativë nuk organizohen gjëra të tillë. Për këtë ndoshta pengon edhe mungesa e sigurisë se mos nuk bëhen mirë, po koka nuk do t'i pritet njeriu për gjëra të tillë, sikur edhe ndonjë gabim i vogël të bëhet. Përkundrazi, shokët do të lavdërohen në qoftë se do të bëhen të tillë studime, duke marrë parasysh se ato që do të nxjerrin këta njerëz, të mbështetur edhe në mendimet e punëtorëve të përparuar, do të na ndihmojnë si orientim i drejtë dhe stabilizues.

Ka dy vjet që po ngremë çështjen e krahut të punës. Ky është një problem me rëndësi të madhe për të gjitha rrethet, prandaj, kemi dhënë orientime si dhe qysh duhet të veprohet. Desha të di nëse mbahen sta-

tistika në rrëth se sa njerëz kërkojnë punë? Ky është një problem demografik me shumë rëndësi.

Në këto evidenca që duhen mbajtur, duhet të pasqyrohet qartë, se çfarë njeriu është ai që kërkon punë; i ç'seksi është, i ç'moshe, pra, i ri apo i vjetër, ana shëndetësore e kushtet për punë, i predispozuar për të punuar në ndërmarrje e kooperativa bujqësore apo vetëm në qytet dhe përse; i gatshëm të vejë të punojë jashtë rrëthit, si në Hidrocentralin e Fierzës dhe Metalurgjikun e Elbasanit apo déshiron të vijë rrrotull në rrugët e qytetit? Kjo duhet të jetë një evidencë shkencore, pa të cilën nuk mund të ecet, nuk mund të bëhet një studim me baza. Kur një njeri kërkon punë, duhet të dihet, gjithashtu, edhe çfarë arsimi e kualifikimi ka, çfarë pune do, pse, në qoftë se déshiron të hyjë në çerdhe dhe nuk di fare nga mirërritja e fëmijëve, atëherë t'i thuhet menjëherë që shteti ka hapur kurse e shkolla për këto punë, prandaj, më parë të shkojë të mësojë e pastaj të vijë të pyesë për punë të kësaj natyre. Kjo është rruga e socializmit. Prandaj, kur tjetri të vejë të kërkojë punë, me atestimin që do të paraqitet, t'i thuhet, sa do të marrë në bazë të normave në fuqi dhe të punës që do të bëjë; se, për sa kohë që do të jetë akoma i pakualifikuar, mund të marrë në fillim kaq lekë në muaj; më vonë, kur të kualifikohet, mund të marrë më shumë. Këto janë detyrat e zyrave të punës. Në i kemi ngritur edhe më parë këto gjëra. Disa shifra na jepen, po mua më duket se punën e tyre duhet ta përsosim akoma më mirë se gjer tani, shokë, se nuk ua dalim mbanë kështu. Duhet të kihet parasysh që të mos kërkohen vazhdëmisht nga ministria udhëzime për

këto gjëra, po të veprohet edhe vetë, me iniciativë.

Unë nuk e di sesi janë përcaktuar me ministritë këto çështje dhe jam dakord që përgjithësimet, ato, në bazë të konkluzioneve që u vijnë nga rrethet, t'i bëjnë. Në qoftë se në rreth nuk do të bëhen konkluzione të drejta, as ministria nuk mund të përcaktojë mirë çfarë duhet bërë për unifikimin e normave në shkallë republike, në një sektor të tërë, për shembull në industri-në mekanike. Le të thotë një punëtor në Vlorë, fjala vjen, se «s'më del rroga» etj. Po të dojë të ardhura më shumë, të punojë të realizojë e të tejkalojë normën, e cila është e përcaktuar, për arsyen se rrethet i kanë diskutuar ato në mënyrë shkencore dhe e kanë aprovuar në atë nivel, prandaj edhe në Vlorë ajo duhet të zbatohet. Në qoftë se ndonjë punëtori që merr më pak të ardhura në muaj se një tjetër, nuk i del dhe dëshiron të largohet nga ai vend, është tjetri që i ka aftësitë dhe e zëvendëson, megjithëse edhe atë që do të largohet nga ky vend ne nuk do ta lëmë pa punë, as nuk do t'i mbyllim perspektivën. Atë mund ta dërgojmë në shkollë apo në kurs që ta kualifikojmë më parë, ta bëjmë më të aftë, e pastaj t'i gjejmë dhe punën që i përshtatet.

Çështja e bashkëpunimit të komiteteve ekzekutive me ministritë, më duket mua, dhe e ministrive me shokët e rretheve, duhet të përcaktohet ca më konkretisht. As ministria të mos marrë përsipër të gjitha përgjegjësitë, fajt dhë gabimet vetë, por ato që me të vërtetë i takojnë. Mirëpo shpesh nuk shikohet si duhet se deri ku qëndron përgjegjësia e secilit; si e kemi organizuar në rreth punën dhe si e ka organizuar ministria, pra të kihen të qarta detyrat dhe përgjegjësitë dhe, në rast se

del që baza s'ka vepruar drejt, t'i themi ministrisë që të tjerët nuk e kanë kryer detyrën, kurse ju e keni kryer. Këto gjëra, më duket mua, janë mjaft të rëndësishme dhe delikate, shumë të përhapura, po edhe shumë të vështira. Vetëm një organizim i shëndoshë dhe një punë politike dhe teknike e përgatitur si duhet, do të na japë mundësinë ta stabilizojmë mirë këtë çështje. Natyrisht, nuk pretendojmë se do të arrijmë në përsosmëri, pse si çdo çështje edhe kjo është në zhvillim. Puna është që luhatjet të jenë kurdoherë sa më të vogla, jo kaq të mëdha si tanë.

Me këtë rast, doja të prekja pak edhe çështjen e rishikimit të kompetencave dhe të përgjegjësive të ins-tancave të ndryshme, lidhur me problemin që po shqyrtojmë. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit të Planit të Shtetit, të ministrive dhe të komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rrtheve unë mendoj të përcaktohen në një fryshtë më të drejtë, në mënyrë që gjithsecili të përgjigjet për detyrën që i ngarkohet. Prandaj, për një pengesë që ndeshet apo për një detyrë që nuk kryhet, të mos flitet kuturu, duke ia hedhur fajin atij që s'i përket. Më kanë thënë se në një ndërmarrje të Tiranës kishin mbetur pa paguar për disa ditë me radhë rrëth 120 punëtorë që pritnin dru. Ankesa kishte vajtur në organizatën e bashkimeve profesionale të ndërmarrjes, po asgjë s'u bë. Çështja u zgjidh vetëm pasi dha urdhër ministria përkatëse. Ju lutem, shokë, përse duhej të ndërhynte në këtë rast ministria? Përse të mos e zgjidhët këtë çështje vetë Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Rrethit të Tiranës që e ka në kompetencë dhe në vartësi këtë ndërmarrje? Drejtori i ndër-

marrjes dhe pastaj komiteti ekzekutiv, para se t'i marrë punëtorët në punë, duhet të shikojë me kujdes për sa njerëz ka nevojë për punë dhe të bëjë llogari që punëtorëve t'u sigurojë pagesën për punën që parashikohet të bëjnë, se kjo është një e drejtë që u takon. Në qoftë se vjen koha që ndërmarrja s'ka më nevojë për ta, atëherë t'i dërgojë të punojnë në kooperativat bujqësore nga kanë ardhur.

Po përsë ndodhin të tilla anomali në punë? Këtu nuk kemi të bëjmë me një neglizhencë në kryerjen me kompetencë të detyrave që u janë ngarkuar disa drejtuesve, por më shumë me prirjen e dëmshme të disa njerëzve që u është bërë zakon të drejtohen për çdo gjë lart, në ministri, dhe vetëm në ministri dhe harrojnë se kjo ka shumë probleme të mëdha për të zgjidhur, siç është edhe ky që po diskutojmë sot, normimi i punës. Por, as nga vetë ministria nuk mund të zgjidhet ky problem, veçse, në disa drejtime, ajo mund të merret me këtë çështje, mbasi do të ketë anë të tjera të problemit, me të cilat mund të merret organizata e bashkimeve profesionale etj.

Siq kam biseduar me shokun Rita, organizata e bashkimeve profesionale duhet të ndërhyjë politikisht në këto probleme me njëfarë organizimi më të përshtatshëm, duke koncentruar interesin politik edhe ideologjik të tyre. Unë nuk them që disa nga këto probleme t'i rimarrin përsëri bashkimet profesionale, po e kam çështjen që kjo organizatë të mos kufizohet vetëm në një propagandë të përgjithshme: ajo të caktojë disa objektiva konkretë për propagandën që duhet të bëjë. Për shembull, në ndërmarrjen që përmes-

nda, bashkimet profesionale duhet ta njihnin gjendjen dhe, po të konstatonin, fjala vjen, se problemi i normimit teknik apo i disiplinës në punë etj. nuk zbato-heshin në rregull, të ngrinin zërin dhe të ndërhyrni politikisht në organizatën e Partisë, në dikaster e kudo që duhej, për tu kuptuar drejt këto probleme dhe të merreshin masa me kohë përzgjidhjen e tyre.

Si përsfundim, dëshiroj të them mendimin se, për zbatimin e konkluzioneve të Byrosë Politike lidhur me normimin teknik të punës, üshtë punuar, por duhet të punojmë akoma më mirë, sidomos tani që jemi përpara studimit që thamë, duke u përpjekur të arrijmë në disa konkluzione më pak të luhatshme se gjer tani.

*Botohet pür herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSII,
që gjendet në AQP*

RININE E KEMI TË PASTER, POR PËR EDUKIMIN E SAJ DUHET PUNUAR VAZHDIMISHT

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

21 shtator 1972

Ne, shokë, morëm nga një informacion të veçantë pör punon e secilës organizatë partie në këto dy vepra, ndërtimin e të cilave ne e kemi ndjekur vazhdimisht edhe nga ana shtetërore. Në përgjithësi, mund të them se Partia atje bën përpjekje, lufton dhe punon pér realizimin e detyrave, por has edhe në vështirësi. Këto janë të natyrshme dhe Partia, komunistët dhe punëtorët tanë patriotë, këtë e kuptojnë. Si kudo, ca më tepër nö këto dy vepra të mëdha, vështirësitet ekzistonë dhe do të ekzistojnë gjersa të përfundojnë, prandaj Partia të luftojë që ato të kapërcehen, sigurisht jo me lehtësi, se do të jetë e zorshme, por me vendosmëri e përpjekje të pareshtura.

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth punës së komiteteve të Partisë të Hidrocentralit të Fierzës dhe të Komblnatit Metalurgjik në Elbasan, pér edukimin ideologjik e tekniko-profesional të punonjësve të rinj dhe atyre që vijnë nga fshati.

Për ndërtimin e hidrocentralit të ri dhe të Kombinatit Metalurgjik kemi caktuar grafikë, kemi vënë edhe detyra që duhet të plotësoheshin. Por, gjatë luftës për realizimin e detyrave, krahas sukseseve, mund të ketë dhe ka, pa diskutim, neglizhenca e moszbatim të tyre, nga pakujdesia e shumë dikastereve, ndërmarrjeve apo komiteteve ekzekutive, të cilat nuk janë diçka e veçantë për këto dy vepra. Të tilla ekzistojnë kudo në ndërtimet e vendit tonë, ku janë duke u ngritur frontalisht shumë vepra. Ndërtimi i tyre kërkon kuadro të shumtë, mjete, fonde, ushqime, punëtorë dhe specialistë. Pa shfajësuar ata që nuk bëjnë sa duhet përpjekje të mjaftueshme, brenda mundësive e gjer në njëfarë shkallë merren masa që të plotësohen kërkesat në këto drejtime.

Sic më kanë informuar, unë nuk mund të shfajësoj as drejtuesit e Ministrisë së Ndërtimit e të Komisionit të Planit të Shtetit, as drejtuesit e Hidrocentralit të Vaut të Dejës, të cilët u morën me shpërndarjen e kuadrove teknikë që punuan në kantieret e ndërtimit të kësaj vepre dhe nuk parashikuan të imbanin disa prej tyre për të vazhduar punën në montimin e turbinave të pavadura. Atëherë vihet pyetja: «Përse u dërguan në Fierzë të gjilhë këta kuadro?». Shumë nga këta duhet të ishin larguar nga Hidrocentrali i Vaut të Dejës në mënyrë ritmike, në atë numër sa ishte nevoja dhe jo përnjëherësh, sikurse u veprua, saqë disave iu desh të qëndronin për një kohë pa punë atje ku vajtën. Mua më thanë se në fillim një numër i madh specialistësh nga këta po e hanin rrugën kot në Fierzë, pse ishin sistemuar në punë sa për të thënë dhe jo në profilet përkak-

tëse. Kjo tregon pakujdesi dhe mungesë thellimi e organizimi në punë. Prandaj i thirra dhe i kritikova drejtuesit e Ministrisë së Ndërtimit e të Komisionit të Planit të Shtetit, që këta kuadro, që tanë besoj se e kanë gjetur vendin e përshtatshëm, i morën dhe i shpërndanë kokrra-kokrra. Se çfarë specialistësh ishin këta, të çfarë kategorie e çfarë detyrash mund të përballonin, këto hollësira unë nuk i di, por, këtë fakt jo të hijshëm pakujdesie e mësova nga shoku Rita [Marko] që erdhi ditët e fundit dhe më tha se në Hidrocentralin e Vaut të Dejës paska mungesë specialistësh, prandaj edhe puna përmontimin e turbinave ecën ngadalë. Atje nuk po punohet, të paktën as me dy turne, megjithëse mundësitet janë që të punohet, bille, edhe me tri turne.

Atëherë, si janë bërë këto llogari kështu, more shokë? Përse u hoqën andej gjithë specialistët, gjersa një pjesë prej tyre nevojiteshin? Me këtë, edhe një herë, dua të vë në dukje që në këto veprime ka mungesë organizimi, gjë që u zë këmbët njerëzve, sa s'di ku t'i çosh të punojnë dhe kështu forca e energji disponibël përm një kohë shkojnë kot. Këto veprime janë të palejueshme dhe shumë të dëmishme përm ekonominë. Nga drejtuesit e qendrës, si dhe nga hallkat e tjera përkatëse, kërkohet llogari përm këto veprime, pa farë përgjegjësic, apo nuk kërkohet?

Nuk do të ishte më drejt kështu, more shokë të Ministrisë së Ndërtimit? Ju duhet t'i keni parasysh këto çështje! Njerëzit të shkojnë atje ku nevojiten në periudhën më të përshtatshme dhe jo të bëhen lëvizje pa vend, se gjëra të tilla na kushtojnë shumë. Ju thoni se disa teknikë e specialistë i dërguat në Hidrocentralin e

Smokthinës e gjetkë, po për këto kishit pasur në plan të përgatitnit kuadro të tjerë, gjë që do të thotë se as këtë detyrë s'e keni realizuar. Ka mjaft nga këto gjëra, që u përmendën edhe sot këtu, që s'duhet të përsëriten më në të ardhmen.

Unë dëshiroj që ju shokë të Kombinatit Metalurgjik të Elbasanit dhe të Hidrocentralit të Fierzës, të jeni më revolucionarë, t'u qëndroni më fort vështirësive dhe të luftoni më mirë për t'i kapërcyer. Të gjithë e dimë, që, kur fillohet një vepër e madhe, si ajo ku punoni tani ju, duhet të bëhen më përpara disa ndërtime, siç janë rrugët, objektet social-kulturore etj. Dëshira dhe e drejta është që të veprohet kështu, po mundësitet a janë vallë? Edhe hapja e rrugës së Komanit, për të cilën u fol sot, është studiuar me kohë, por doli që ishte shumë e kushtueshme, prandaj u mendua që situata të kapërcehej me një riparim të rrugës ekzistuese. Mirëpo masat e shpejtuara që u morën për ta përfunduar këtë rrugë, me një aksion të shpejtë me goditje të përqendruar, ishin shumë të çala. Vërtet atje punuan me dhjetëra mijë veta, por, siç më thonë shokët, që nga ajo kohë, në këtë rrugë, nuk është bërë asnjë riparim, nuk është ndërtuar asnjë vepër arti, nuk është kryer asnjë sistemi i skarpateve dhe i ndërtimeve të tjera që i dinë më mirë se kushdo punonjësit e ndërmarrjes së rruga-urave. Këto duhen mbajtur mirë parasysh, sepse ajo rrugë ka një rëndësi shumë të madhe. Nëpërmjet saj, kur të vijë koha, do të transportohen të gjitha materialët dhe makineritë e rënda, prandaj mos të tororisemi me llazë. U vendos vërtet të mos ndërtohej rruga e Komani, por ama kjo që është të rregullohet medoemos.

Për këtë të merren masa me kohë, të gjenden punëtorët e specialistët, të harmonizohet çdo gjë me grafikë, se duhet të jetë e qartë që, pa e rregulluar këtë rrugë, është e pamundur të kalojnë mjetet e rënda që do të vendosen në këtë hidrocentral të madh.

Pse e theksoj, shokë, që të jeni pak më revolucionarë? Sepse veç asaj që thashë për shokët e Hidrocentralit të Fierzës, sidomos shokët e komitetit të Partisë të Kombinatit Metalurgjik, më duket që nuk kanë pikëpamje të drejta, veçanërisht për rininë e fshatit. Në raport, ju shokët e Elbasanit, na keni raportuar keq, duke dalë me disa konkluzione jo të drejta, të cilat i keni pleksur me disa vështirësi të vogla. Kështu, raportimi që na bëni, nuk është i saktë. Sipas pohimeve tuaja, të rinjtë që vijnë nga fshati paskan në ndërgjegje të tyre të gjitha niseturinat që mund të ekzistojnë! Unë personalisht nuk jam i bindur për këtë afirmim nga ana juaj, pse po të ishte kështu, do të duhej të dilnim me disa konkluzione të pasakta, sikur puna e Partisë dhe e rinisë në fshatin tonë është përtokë! Ju harroni se kushtet që gjen rinia fshatare në kantieret tona, siç është ai i metalurgjisë, janë shumë më të mira nga ato që ka në kooperativë. Për këtë jam plotësish i bindur. Trajtimi material, rroga që marrin të rinjtë dhe kushtet e tjera materialoshoqërorë që kanë gjetur në Kombinatin Metalurgjik ose në Fierzë, nuk i kanë as në fshatrat e Elbasanit, ca më tepër pastaj në Lekbibaj, në Nikaj, bile ndoshta nuk i kanë as brenda në Tropojë.

Nuk mjafton të thuhet vetëm që «Kombinati Metalurgjik është një vepër me rëndësi». Punëtorit duhet t'i flitet për nderin që ka të punojë në këtë vepër, por

edhe për detyrat e miëdha. Ai vjen për të punuar dhe, për këtë, shteti i proletariatit e paguan, bile, pagesa atje s'ka diskutim që është më e mirë se në kooperativë. Kështu ta bëni propagandën ju, se kjo nuk bëhet vetëm duke folur gjithnjë për rëndësinë apo për madhështinë e veprës. Po të flitet gjithnjë në këtë formë, atëherë punëtori thotë: «Meqenëse puna qenka kështu, atëherë na paguaj». Çfarë t'i paguhet më? Përkundrazi t'i thuhet që paguhet, bile, shumë, se ai sapo «ka dalë nga vezë» në kooperativë. Një murator i vjetër, të cilin koooperativa e quan më të favorizuarin dhe që bën mbasse edhe 400 ditë-punë, nuk merr më shumë lekë në vit, se një punëtor i kombinatit tuaj, kurse një djalë i ri, që na vjen nga fshati, zanatin e muratorit e quan si një gjë pa asnjë vlerë.

Të them të drejtën, shokë, unë nuk mund të besoj plotësisht se kështu ndodh në realitet, sepse ai që vjen nga fshati e ka parë që atje punëtorët janë më të favorizuarit, prandaj kjo duhet ta nxitë atë që të bëhet murator. Mirëpo, si mund ta nxitë një gjë e tillë kur sapo vjen në ndërmarrje, ai merr menjëherë më shumë të ardhura?

Në Fierzë, siç shohim në raport, përvèç mensave, dyqaneve, fjetoreve, dusheve, klubeve, shesheve për loda e radiove ka edhe 2 qendra zëri, të cilat mund t'i shtoni. Atje më duket se keni 6 kinema dhe 2 kinoklube etj. Të gjitha këto mundësi i dispononi në një kohë kur në disa nga qytetet e vendit tonë, me popullsi 3-4 herë më të madhe se Fierza kemi akoma vetëm nga një kinema me kapacitet për 250-300 veta. Me këtë dua të them që nevoja të tilla në veprat e reja, megjithëse duhen

plotësuar proporcionalisht me numrin e popullsisë dhe me mundësitë tona konkrete, janë plotësuar një çikë me bollëk. Dhe, në këto kushte pak a shumë të mira, të thuash se të rinxjtë e ardhur nga fshati në këto vepra, nuk janë të kënaqur, nuk është e drejtë.

Pastaj, nuk është e drejtë, gjithashiu, më duket mua, as t'i atribuosh rinisë ato të këqija që nuk i ka, të përgjithësohen pa vend disa shfaqje negative. Disa mosmarrëveshje ose grindje midis të rinxve, në kolektiva të mëdha edhe mund të ngjasin. Prandaj, në ndonjë rast, ka shfaqje negative, si prishja e hatërit të ndonjërit me shokun, disa të rinx pretendojnë më shumë pagë, bile, ndonjëri, qëllon të manifestojë prirje në kundërshtim me moralin tonë proletar etj. Por, në qoftë se këta të rinx, që kanë në përgjithësi një edukatë të mirë politike dhe një ide të qartë për ndërtimin e socializmit në vendin tonë, që ushqejnë një dashuri të pakufishme për Partinë, ju i ngrini në majë të gjilpërës dhe bëni përt ta një pasqyrë të errët, më duket se nuk veproni drejt. Që ka shfaqje negative të disa elementë të veçuar dhe vështirësi në punën për edukimin e tyre, kjo është e vërtetë. Por këto nuk duhen zmadhuar, nuk duhen përgjithësuar e hedhur në platforma politike, në mbeturina të theksuara mikroborgjeze, se pastaj vaj halli çfarë do të thuhej për elementë më të infektuar me të tilla mbeturina.

Ne duam ta kemi rininë gjithnjë sa më të pastër, prandaj puna propagandistike e Partisë për këtë qëllim të jetë kurdoherë e balancuar. Në qoftë se ka disa të rinx që, kur vijnë në ndërmarrjet shtetërore, përcmojnë këtë ose atë zanat ose nuk kënaqen me rrrogën që marrin,

megjithëse kjo është më e madhe në krahasim me atë që merrnin ose mund të merrnin në fshat, nuk do të ishte e drejtë të cilësoheshin të tërë si të pakënaqur e të padisiplinuar. Partia të punojë që t'i sqarojë e t'i bindë edhe këta të rinj. Prandaj, t'u këshillohet që të mësojnë zanate, pse jetën e kanë përpara dhe perspektivat për të ecur në kategorizim, në pagë etj. i kanë të hapura.

Prandaj, para se të akuzoni të rinjtë, shokë, shikoni më mirë punën tuaj. Në çfarë drejtimi ta shikoni këtë punë? Të mos ju vijë rëndë, por unë mendoj se çështjet ekonomike që ngrini, trajtimin e të rinjve e të tjera, më duket se shpeshherë i keni nxitur vetë me një propagandë të disbalancuar e disi të fryrë. E kush nuk e di që Kombinati Metalurgjik është një nga veprat kryesore të pesëvjeçarit? Mos vallë u duhet fshehur kjo atyre që vijnë atje të punojnë? Jo, aspak nuk u duhet fshehur! Por, nga ana juaj, mendoj se nuk duhet kufizuar vetëm në propagandimin e rëndësisë që ka kombinati për ekonominë tonë, siç e thashë edhe pak më parë. Propaganda të përqendrohet në anën më kryesore që duhet të kemi parasysh, që kjo vepër, për t'u ngritur, kërkon disiplinë, kërkon vendosmëri për kapërcimin e vështirësive, djersë e punë të palodhur nga të gjithë etj., me qëllim që punëtori që vjen këtu, i ri ose i vjetër, të kuptojë se vjen për të punuar e jo për të dësryer. Me punën e tij ai do të rregullojë aty edhe jetën, po jo të pretendojë atë që nuk i takon, që të sjellë nga fshati nënën e babanë, kur ata janë në gjendje të punojnë vetë në kooperativë. Kështu jo. Në qoftë se propagandën ju e shtronni në platforma jo të drejta e të njëan-

shme, atëherë disa të rinj jo shumë të pjekur, mund të arrijnë në konkluzione të gabuara.

Unë nuk them të mos shikohet pretendimi i specia-listëve që kërkojnë t'u shtohet rroga «për vështirësi pune», por le ta marrim një çikë më shtruar këtë çështje, në parim dhe me llogari. Tjetri dërgohet nga Korça për të punuar, ta zëmë, në Elbasan. Në Korçë, ai ka fëmijët dhe gruan që punon, fjala vjen, në fabrikën e qilimave, pa bërë fjalë për ndonjë pjesëtar tjetër që mund të ketë familja e tij në punë. Shteti për punonjësin, siç e dimë, ka krijuar kudo kushte shumë favorizuese. Secili, në apartamentin ku banon, paguan në muaj një qira të vogël; pagesa për dritë dhe sidomos për ujë është akoma më minimale; ndihma mjekësore falas për të gjithë.

Veç kësaj, ka kohë që asnjeri te ne nuk paguan asnjë lloj takse. Atëherë, ky punonjës, për shembull, tornitor, që vjen nga Korça në metalurgji, ku gjëzon tërë këto të drejta, duhet ta kuptojë se e ka për detyrë patriotike që të punojë në shërbim të atdheut aty ku është dërguar dhe kudo gjatkë që të jetë nevoja. Në qoftë se nuk shkon për të punuar aty ku e thërret interes i popullit, kush tjetër do të vejë ta lulëzojë këtë Shqipëri, për të ndërtuar kombinatet, hidrocentralet, hekurudhat, tarracat, kanalet etj., etj? Në qoftë se njeriu ynë nuk e kupton drejt këtë, a do të mundë dot vailë shteti i diktaturës të mbajë çmimet aktuale të artikujve të konsumit të përditshëm, të veshjes, të ushqimit e të nevojave të tjera? Ne mund të kemi akoma edhe mungesa në këto drejtime, por, ama, asnjëherë nuk janë ngritur çmimet e mallrave në vendin tonë, si

në vendet kapitaliste e revizioniste. Për kundrazi, të ne ka pasur shumië ulje dhe tani bëhen përpjekje që këto të jenë të qëndrueshme, me qëllim që çdo vit e më shumë të përmirësohet niveli i jetesës së punonjësve tanë. Tornitori që vjen në Elbasan përfunduar në ndërtimin e një vepre të madhe, duke marrë të njëjtën rrogë që kishte në Korçë, në mensën e metalurgjisë do të paguajë përfundimin më pak nga ç'do të prishtë në shtëpi, kurse shumicën e të hollave që i tepron, është në gjendje fare mirë t'ia dërgojë familjes. Mund të themi që kjo llogari është në disfavor të tornitorit dhe të punonjësve të tjerë të ndërtimit të kësaj vepre? Jo, nuk është. Edhe sikur të pranojmë që pranë familjes punëtori do të prishtë aq ose diçka më pak, atje nuk do të hante kurrë atë ushqim që jepet në mensat e veprave që ndërtohen.

Ka rëndësi të madhe që këto çështje t'u sqarohen mirë njerëzve. Prandaj, propaganda e Partisë t'i trajtojë si duhet dhe, pa u hutuar nga vështirësitë, të mos bjerë nga pozitat e njërit apo të tjetrit që pa të drejtë mund të bëhen të pakënaqur.

Sipas raportit tuaj ne nuk mund të dalim as me konkluzionin që komunistët kanë kualifikim të dobët. Për kundrazi, kualifikimin në ndërmarrjet ata e kanë 3,7, në një kohë që punëtorët e kanë mesatarisht 2,6. Me një raport të tillë kualifikimi, komunistët mund të vihen fare mirë në pararojë, vetëm se kjo varet nga mënyra se si e organizon punën organizata-bazë e Partisë; sa i ngarkon ajo me përgjegjësi shokët komunistë; si bëhet nga ana e tyre puna me masat, me rininë, me gratë etj.; si shfrytëzohen mjetet që kemi në dispozicion etj., etj.

Pa mohuar në asnje mënyrë punën tuaj lidhur me përpjekjet që bëni për zbatimin e vijës së drejtë të Partisë; pa mohuar aspak qederet e shumta që keni në punët e përditshme, unë ju këshilloj, shokë, të përpique ni që punëve të Partisë, sipas situatës, t'u bëni herë pas here një analizë të drejtë, të mbështeteni fuqimisht te masat, sidomos tek të rinxjtë e të rejat.

Ti, shoku Fuat¹, je vetë i ri; ke dalë sigurisht nga rinia, në radhët e së cilës je përgatitur si kuadër partie, prandaj, shumë mirë kanë bërë shokët që të kanë zgjedhur në krye të punës së Partisë të kombinatit. Është një detyrë me përgjegjësi me të vërtetë të madhe ajo që të është ngarkuar, por jam i bindur se ti i ke aftësitë për ta kryer atë. Me eksperiencën që ke dhe që akoma do të fitosh dita-ditës në këtë punë, do t'i shtosh edhe më tepër cilësitë si kuadër partie, gjë që do të të ndihmojë t'i shikosh në një prizëm më të drejtë problemet. Përpiku të përsfitosh sa më shumë nga eksperiencia e shokëve të vjetër të Ministrisë së Ndërlimit e të ministreve të tjera. Po të drejtohem më shumë ty, shoku Fuat, se shoku Nimet Cani² është pak më i moshuar, prandaj ka edhe një eksperiencë më të gjerë në punët e Partisë. Është e kuptueshme që në Hidrocentralin e Fierzës vështirësitë janë më të mëdha se në metalurgji. Pikërisht, për këtë arsyë e dërguam atje shokun Nimet. Sidoqoftë, me shokë si ju, jemi të bindur që puna

1. Fuat Koçlari, në atë kohë sekretar i komitetit të Partisë të Kombinatit Metalurgjik Elbasan.

2. Në atë kohë sekretar i komitetit të Partisë të Hidrocentralit të Fierzës.

e Partisë nü köto dy vepra do të shkojë më mirë në të ardhmen.

Ne, me gjithëse përpinqemi të futemi në thellësi të problemieve, prapë nuk i njohim ato nü hollësi si ju që ndesheni përditë me vështirësi nga më të ndryshmet. Megjithatë, ju e kuptioni se ne e çmojmë punën tuaj, prandaj preokupohemi kaq shumë për të, se është puna e Partisë.

Kolektivi i Ministrisë së Ndërtimit është mjaft optimist për kryerjen e detyrave të ngarkuara në ndërtimin e këtyre dy veprave. Shoku Rahman Hanku¹, që foli kötu përpara Sekretariatit, tha se me përpjekje punët atje do të kryhen në kohën e duhur. Natyrisht, ndërtimi i tyre do të hasë patjetër në shumë vështirësi, se edhe kinezët po na e shtyjnë furnizimin me makineri e pajisje për këto vepra.

Unë mendoj t'i japim fund kësaj çështjeje. Kërkuesat e shokëve që na kanë përgatitur köto materiale, t'i kemi parasysh. Shoku Haki [Toska] t'u kërkojë llogari Ministrisë së Ndërtimit dhe ndërmarrjeve të tjera që të plotësojnë në kohë detyrimet ndaj këtyre kolektivave. Edhe Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës t'i kërkohet llogari për ato që i takojnë të bëjë. Me sa po shohim, për sa i përket përgatitjes së kuadrit për këto dy vepra, shokët e Partisë po punojnë mirë. Atje, me përpjekje, janë ngritur kurse e teknikume të mesme, prandaj nuk më duket i drejtë qëndrimi i Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës që nuk ju dërgon juve një ose dy pedagogë që ju duhen, sidomos atje larg, në Fierzë.

1. Në atë kohë zëvendësministër i Ndërtimit.

Përse të mos venë në Fierzë pedagogët për të mësuar dhe për të edukuar punëtorët e këtij kantieri të madh? Kjo nungesë gatishmëric, më duket mua, vjen më shumë se nuk punohet siç duhet politikisht me njerëzit, prandaj edhe atyre nuk u pëlqen të shkojnë; ndryshe, jo 2, por 42 veta janë gati dhe mund të venë me një thirrje. Këtë nuk e them kot, pse e kam të bazuar. Si të gjithë, edhe mësuesit tanë patriotë gjithnjë kanë dhënë prova gatishmërie, sa herë që e kanë kërkuar interesat e atdheut dhe të ndërlimit të socializmit.

Ju urojmë suksese! Ne do t'ju ndjekim nga afér edhe paskëtaj në punën tuaj dhe kemi besim tek organizatat e Partisë, te ju që i udhëhiqni ato dhe tek të gjithë punonjësit, se vështirësitet me të cilat jeni ndeshur, do të kapërcehen. Ju jeni një forcë e gjallë e klasës punëtore dhe e rinisë sonë!

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH,
që gjendet në AQF*

LUFTËN KUNDËR IMPERIALIZMIT DHE REVIZIONIZMIT NË ASNJË RAST NUK DUHET TA NËNVLEFTËSOJMË E TA ZBUTIM

*Nga biseda me një shok të Partisë Komuniste
të Italisë (m-l)*

25 shtator 1972

Jemi shumë të gjuar për ardhjen tuaj në Shqipëri. Shokët Hysni Kapo dhe Ramiz Alia, që janë takuar me ju, më kanë vënë në dijeni për bisedimet që keni bërë bashkërisht. Bisadimet midis partive marksiste-leniniste janë një nevojë e domosdoshme, sepse, për të arritur në mendime unike për zgjidhjen e problemeve që na preokupojnë, lypset të bëhen konsultime, diskutime të përbashkëta dhe këto realizohen kur mbahen vazhdimisht kontakte me njëri-tjetrin.

Sikundör e dini, shteti ynë dhë Partia që udhëheq gjithë jetën e vendit te ne, ndjekin me shumë interes zhvillimin e ngjarjeve të ndryshme, veçanërisht në Itali, që është sqinja jonë e afërt, ndaj së cilës, ashtu si ndaj gjithë vendeve të tjera, ne nuk ndjekim një politikë pasive, por një politikë aktive e të përpunuar mirë.

Politika e jashtme, që ndjek Republika Popullore e

Shqipërisë, nuk është e nuk mund të jetë veçse një politikë marksiste-leniniste në interes të popujve dhe të socializmit dhe, si e tillë, ajo nuk lejon as më të voglin kompromis me kapitalizmin dhe me revizionizmin modern, përkundrazi, kërkon të qëndrojmö kurdoherë vigjilentë ndaj orvatjeve që mund të bëjnë ata kundër popujve. Pra, duke mbajtur kurdoherë lart vigjilencën dhe duke e forcuar atë vazhdimit, duhet të përfitohet dhe të shfrytëzohet në interes të çështjes sonë të përbashkët çdo situatë, që mund të paraqitet në vendin tuaj, por pa vepruar në asnje rast në kundërshtim me interesat e popullit italian.

Politika e Partisë dhe e shtetit tonë socialist nuk mund të gjejë mbështetje në masat punonjëse të vendit tuaj, në qoftë se nuk do të ketë më parë përkrahjen e forcave të shëndosha revolucionare e të marksistë-leninistëve të vërtetë italianë. Nga kjo përkrahje edhe ne përfitojmë. Natyrisht, edhe koniunkturat duhet t'i shfrytëzojmë në interes të revolucionit e të socializmit, por pavarësisht nga ato, shteti ynë ndjek një politikë të tij të përcaktuar ndaj vendeve kapitaliste, duke u udhëhequr nga parimet e fqinjësisë së mirë e të miqësisë me popujt. Kështu, qoftë edhe përkohësisht, krijojen kushte disi të favorshme që Shqipëria të njihet në masat e popullit italian, i cili e do popullin shqiptar, do që Shqipëria të jetë e pavarur dhe socialeste.

Dihet se sot, përveç socialdemokracisë klasike, kundër komunizmit ka dalë në skenë edhe revizionizmi modern, i cili ka grumbulluar një eksperiencë të madhe në luftën kundër marksizëm-leninizmit. Përpjekjet e revisionistëve synojnë të mashtrojnë masat, të tërheqin

në anën e tyre sa më shumë punëtorë, fshatarë inaktivë, intelektualë etj. Për këtë ata përdorin propagandën e tyre, metoda dhe taktika të reja e të vjetra, të cilat duhen njojur nga marksistë-leninistët. Në këto drejtime revizionizmi inkurajohet edhe nga borgjezia. Duke mos qenë në gjendje t'u rezistojnë luftës, kërkesave, hovit dhe rezistencës së masave, borgjezia dhe revisionistët përhapin gjithfarë teorish të vjetra e të reja për të mbajtur në suqi organizimin e vjetër, të konsakruar. Nga ana tjetër, ata përpiken të krijojnë grupime me tendenca «të majta», gjoja revolucionare. Përse e bëjnë këtë? Sigurisht për të shkatërruar çdo përpjekje të masave për organizim, për të mos lejuar në asnjë mënyrë unitetin revolucionar të tyre, të klasës punëtore, në radhë të parë, por edhe të fshatarësisë e të inteligjencies me të, t'u jepin atyre të kuqtojnë dhe t'i bindin se gjoja nuk është e nevojshme të bushkohen me komunistët, sepse mund të luftojnë e të fitojnë edhe duke qenë të shkëputur prej tyre. Qëllimi i tyre kryesor është të shpartallojnë forcat revolucionare, t'i shkëputin masat prej komunistëve të vërtetë, në mënyrë që këtyre t'u bëhet më e vështirë lufta që zhvillojnë.

Akoma më e vështirë bëhet në këto kushte çështja e krijimit të një fronti të përbashkët në luftën kundër imperializmit botëror dhe kundër kapitalizmit të brendshëm në çdo vend kapitalist. Çështjen e frontit të përbashkët, për të cilin duhet të mendojmë të gjithë, Partia jonë e ka trajtuar që në Kongresin e saj të 5-të. Mirëpo ky front antiimperialist nuk krijohet vetë, atë duhet ta krijojmë ne, së bashku, të gjitha partitë marksiste-leniniste dhe për këtë duhet të punojmë, të luftojmë

pa u lodhur. Në një kohë kur armiqjtë tanë të klasës përpinqen t'i shpérndajnë forcat revolucionare, detyra jonë është t'i pörkrahim e t'i grumbullojmë ato. Për t'ia arritur këtij qëllimi, Partia jonë mendon se nuk mjaf-tojnë përpjekjet dhe iniciativa vetëm e një, dy ose qoftë edhe e tri partive marksiste-leniniste, por për këtë është e domosdoshme të punojnë të gjitha partitë, të cilat duhet të bëjnë një luftë konsekiente në bazë të marksizëm-leninizmit, në unitet marksist-leninist në shkallë kombëtare e ndërkombëtare.

Dihet se kushtet e luftës ndryshojnë nga vendi në vend. Kështu, për shembull, të tjera kushte ekzistojnë në Itali, të tjera ekzistojnë në Francë, krejt ndryshe janë ato në Argjentinë apo në vendet arabe. Këto ndryshime duhen pasur mirë parasysh nga ana e komunistëve, të cilët mendojnë e veprojnë edhe si internacionalistë, por edhe si luftëtarë revolucionarë të secilit vend veçanërisht. Por vallë a mjafton vetëm mbajtja parasysh e kushteve të ndryshme? Jo, për të pasur sukses në luftën që bëjnë, si për çdo problem, edhe për krijimin e frontit të përbashkët, ka një rëndësi të madhe që të rrahim bashkërisht mendimet. Në kuadrin e kësaj lufte mund të ketë edhe ndonjë çështje për të cilën të mos bihet dakord, të ketë mendime të kundërtta. Një gjë e tillë mund të ndodhë, sepse këtu nuk është fjala se do të diskutohet për një çështje në platformë të ngushtë, por në një plan më të gjerë, në baza parimore.

Krijimin e Shoqatës së Miqësisë Itali-Shqipëri, ne përpinqemi që të gjithë ta kuptojnë drejt. Këtu është çështja që në këtë shoqatë të bëjnë pjesë elementë nga

shtresa të gjera të popullit italian, elementë që mund të mos mendojnë njëlloj si ne, por që kanë admirim, respekt dhe dashuri për Shqipërinë dhe për popullin tonë. Aty mund të bëjnë pjesë mjekë, profesorë, filozofë, arkeologë, gjithë ata që ushqejnë simpati për Shqipërinë. Në Itali ka njerëz të ndershëm, që interesohen për bukuritë e Shqipërisë, ka të tjerë që kanë simpati pikërisht për politikën e vendosur që ndjek e zbaton Partia jonë kundër imperializmit dhe revizionizmit modern. Në fakt, shumë nga këta elementë mund të mos janë dhe nuk janë dakord me ideologjinë tonë, por ata janë kundër shtypjes që ushtrojnë imperialistët në vendë të ndryshme. Mund të ketë persona të tjerë të cilëve u pëlqen arkeologjia, disa të tjerë interesohen për gjuhën dhe letërsinë shqipe etj. Profesori italian [Cirilio] Maliani, për shembull, interesohet për bujqësinë. Ai ka qenë edhe herë tjetër në Shqipëri dhe tanë na ka shfaqur idenë që së bashku me specialistët tanë të eksperimentojë disa nga llojet e farërave për të cilat ka studiuar dhe punuar. Ne e njohim Malianin, ai ka mbajtur qëndrim të mirë ndaj vendit tonë dhe ka botuar artikuj realistë mbi përparimet te ne. Për njerëzit tanë që shkojnë për të përfituar e mësuar tek ai, i cili i sheh që punojnë me ndërgjegje, ai thotë fjalë të mira: «Nuk kam parë kurrë njerëz kaq të mirë» dhe i ndihmon ata konkretisht. Pse e bën Maliani këtë? Pikërisht për atë politikë të drejtë e të gjerë që ndjekim ne mc këta njerëz përparimtarë, të cilët Shqipërinë e duan në mënyrën e tyre. Ne mendojmë se një politikë e tillë ndaj atyre që kanë simpati për Shqipërinë, ndihmon në forcimin e miqësisë midis dy popujve tanë.

Kur ne u hodhëm në luftë për jetë a vdekje kundër pushtuesve fashistë, na duhej të krijonim medoemos Frontin Nacionalçlirimtar. Po tani a jemi ne në luftë me armiqllë tanë? Sigurisht që po. Partia jonë dhe të gjitha partitë e tjera të vërteta marksiste-leniniste janë në luftë të përditshme me armiqllë e klasës, të brendshëm e të jashtëm. Dhe kjo është një luftë akoma më dinamike e më e ndërlikuar sesa lufta me armë.

Lufta e armatosur që bëmë ne kundër pushtuesit ka qenë e vështirë, por edhe lufta aktuale e marksistë-le-ninistëve është një luftë tepër e vështirë. Gjithë atyre forcave, që janë rreshtuar dhe veprojnë dita-ditës kundër tyre, vetëm partitë marksiste-leniniste nuk mund t'u bëjnë ballë. Për këtë arsyе është e domosdoshme të krijohet fronti, të bashkohen në një organizatë të gjërë masash të gjithë ata që janë kundër armiqve të përba-shkët. Ne e dimë se vendimtare është, në radhë të parë, të kesh partinë të organizuar mirë dhe me një vijë të drejtë. Po të kesh partinë të fortë, duhet të mendosh pastaj edhe për organizatën e frontit. Me cilët do të shkojmë ne komunistët në luftën e ashpër kundër armiqve të proletariatit? Sigurisht me aletatët klasikë të klasës punëtore, të cilët është e domosdoshme t'i kemi kurdoherë parasysh dhe t'i trajtojmë drejt, ndryshe do t'i humbasim. Por radhët e tyre nuk janë homogjene: disa janë të qëndrueshëm, disa janë më pak të qëndrueshëm; ka të tjerë që janë akoma më pak të qëndrueshëm, prandaj partia ka për detyrë t'i njohë ata dhe të veprojë. Po si të veprojë? Ajo duhet të ketë të qartë çfarë interes i ka aktualisht ky osë ai grupim i borgjezisë së vogël që të bashkohet me proletariatin. Kur partia ta ketë të qartë si

në pasqyrë këtë, asaj i duhet të dijë se deri ku mund ta ndjekë ky apo ai grupim.

Ju e dini se çfarë janë tërë këto grupime, megjithatë, në momente të caktuara, duhen shfrytëzuar kundërshtimet e tyre me armiqtë e përbashkët. Një punë e tillë është e rëndë dhe e ndërlikuar. Megjithatë, duke pasur për bazë proletariatin dhe aleancën e tij me fshatarësinë, nuk duhen lënë mënjanë aleatët e tjerë të mundshëm.

Marksistë-leninistëve u duhet të punojnë më shumë për frontin e përbashkët të luftës kundër imperializmit dhe kapitalizmit botëror. Për këtë problem, si për çdo problem tjeter kapital, janë të interesuara të punojnë të gjitha partitë marksiste-leniniste me forma nga më të ndryshmet dhe sipas situatave. Në këtë drejtim neve na vihet detyrë të bëjmë përpjekje të përbashkëta për të diskutuar problemet. Kjo që po bëjmë tani është një pjesë e kötyre përpjekjeve, të cilat duhet t'i vazhdojmë, por të mendojmë për të diskutuar edhe probleme të tjera. Ju mund të vini të na propozoni, për shembull, se dëshironi të bisedojmë bashkërisht për situatën në Brazil, pasi mund të keni ndonjë mendim për të. Atëherë ne bisedojmë për këtë çështje, kjo nuk ka asgjë të keqe dhe, po të kemi mundësi, rezultatet e bisedimeve ua transmetojmë edhe të tjerëve.

Po kështu mund të veprohet edhe kur, gjatë bisedimeve tuaja me ndonjë përfaqësues të një partie marksiste-leniniste, ky shpreh pikëpamje ose qëndrim jo të njëjtë me tuajin ndaj ndonjë partie tjeter marksiste-leniniste. Në këtë rast diskutimi sëaron dhe sheshon pikëpamjet për të arritur këtë apo atë objektiv. Këtë

objektiva nuk arrihen vetëm me dëshirë, sepse, nga dëshira deri në realizimin e tyre, duhen bërë përpjekje dhe punë e madhe.

Me këto doja të thosha se sa të nevojshme e të domosdoshme janë takimet e diskutimet midis partive marksiste-leniniste. Këto takiime e diskutime duhet të kenë kurdoherë karakter shoqëror. Ne nuk kemi asnje pretendim të veçantë, po ashtu edhe partitë e tjera marksiste-leniniste. Pretendimi ynë i përbashkët është të mbrojmë marksizëm-leninizmin, të jemi kurdoherë marksistë-leninistë konsekuentë, militantë. Secili duhet ta thotë hapur pikëpamjen e parlisë së vet në këto takime, i mbetet apo nuk i mbetet qejfi njërit ose tjetrit. Në rast se dikush mendon se «një shok nuk ka të drejtë», atëherë duhet ta bindë që nuk ka të drejtë, kurse ky do të përpinqet ta bindë atë me argumente për drejtësinë e pikëpamjes së tij. Në qoftë se jemi komunistë të vërtetë, pasi i rrëshim mirë mendimet, nuk ka asnje arsyе përsë të mos biem dakord dhe t'i nënshtrohem logjikës së fortë marksiste-leniniste dhe interesit të përgjithshëm. Mund të qëllojë që për një problem të rikthehem për të diskutuar disa herë, sepse s'është e thënë të biem dakord menjëherë. Megjithatë dialektika marksiste-leniniste do ta vërtetojë medocmos një ditë drejtësinë e pikëpamjes së njërit apo të tjetrit dhe, nëse ndonjë nuk i nënshtronhet arsyes, drejtësisë dhe interesit të çështjes së përbashkët, atëherë vihem përpara një situate tjetër. Ai që vepron kështu, do të thotë se nuk dëshiron ta kuqtojë situatën, se nuk e pranon marksizëm-leninizmin. Është e ligjshme që për rezultatet e bisedimeve secili prej nesh të raportojë në partinë e vet dhe shokët le ta gjykojnë pastaj

drejtësinë ose jo të pikëpamjeve të hedhura në tavolinë.

Në këtë drejtim, mendoj unë, duhen edukuar partitë marksiste-leniniste veç e veç. Në këtë rrugë të drejtë të zhvillojmë edhe unitetin tonë frontal të përbashkët marksist-leninist në luftë kundër imperializmit dhe re-vizionizmit. Këtë luftë, në asnjë rast, nuk duhet ta nën-vlefësojmë dhe ta zbutim, as aktualisht, kur po thellohet konfuzioni politik e ideologjik dhe shumë njerëz kanë përshtypjen sikur në situatën e tanishme çdo gjë në botë po rregullohet nëpërmjet bisedimeve, por as në të ardhmen, deri në shpartallimin e plotë të armiqve të revolucionit e të socializmit. Ky konfuzion politik e ideologjik, ky iluzion për zgjidhjen e problemeve nëpërmjet bisedimeve pengojnë unitetin dhe organizimin tonë. Kësaj situate duhet t'i bëjmë ballë, por mua më duket se me mbledhje formale kjo nuk mund të bëhet. Gjithashtu nuk na lejohet të rrojmë me famën e së kaluarës dhe të mos i shikojnë problemet drejt në sy. Kjo nuk është në favor të revolucionit.

Si thoni ju, a duhet të punojmë kështu?

Duke iu përgjigjur pyetjes, mysafiri falënderoi shokun Enver Hoxha për kujdesin që i kushtoi kërkesës së tij për t'u takuar me të, si dhe për mendimet që ai shprehur në lidhje me problemet e ndryshme që u diskutuan në takim. Pastaj shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Ju faleminderit për fjalët e mira që thatë në adresë të Partisë sonë.

Megjithatë, ne dëshirojmë që eksperiencës së Partisë sonë të mos i jepet rëndësi më tepër nga sa i takon. Dëshiroj të theksoj, gjithashtu, se është e domosdoshme të mos harrohet se ku e kemi gjetur ne burimin e forcës

sonë, burimin e kësaj eksperience. Ky burim është i përbashkët për të gjithë ne, është te mësimet e pavdekshme të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Ne jemi përpjekur dhe përpinqemi të zbatojmë mësimet e klasikëve të marksizëm-leninizmit në kushtet e Shqipërisë dhe t'i zbatojmë drejt. Mund të them se vënien në jetë të këtyre mësimeve ne herë pas here e rishikojmë, natyrisht, me syrin marksist-leninist, sepse edhe mund të gabojmë. Por edhe sikur të supozojmë që nuk kemi gabime, duhet pasur parasysh që eksperiencia jonë mund të mos jetë plotësisht e zbatueshme për kushtet e Italisë, sepse këto mësimë të mëdha të marksizëm-leninizmit janë zbatuar sipas kushteve tona.

Të marrim çështjen e krijimit të Frontit Nacionallirimtar, kur filluan Lustën Nacionalçlirimtare. Në atë kohë, kushtet tona nuk ishin njëloj si ato që keni ju sot në Itali. Në Shqipëri nuk kishte parti të tjera politike ose 10 apo 15 grupe të quajtura marksiste-leniniste, si te ju. Prandaj për ne puna ishte më e lehtë. Kurse te ju, përkushtet në të cilat ndodheni sot, puna e partisë komuniste është shumë më e rëndë. Vërtet parimet leniniste janë po ato, si për ne, edhe për ju, por taktikat që duhen ndjekur nga partia juaj nuk mund të janë njëloj si ato që kemi përdorur ne gjatë luftës, përderisa situatat janë krejt të ndryshme. Ta marrësh në mënyrë dogmatike eksperiencën e të tjerëve, nuk është aspak e rekomandueshme.

Atëherë ç'gjë mund të jetë e rekomandueshme? Një punë e bërë bashkërisht në mënyrë të studiuar, duke biseduar e shkëmbyer përvojë. Për këtë qëllim, Partia juaj mund të parashtrojë si është situata në Itali dhe

çfarë problemesh dalin në këtë situatë, ndërsa ne do të përpinqemi t'u japim shokëve dhe vëllezërve italianë atë eksperiencë për të cilën kanë nevojë, atë që gjykojmë se mund t'u shërbejë. Pra, nuk u themi «merreni këtë dokument, lexojeni dhe veproni ashtu siç kemi vepruar ne». Neve mund të na pëlqejë dhe mund ta bëjmë lehtë përkthimin e Veprave të Partisë sonë dhe këto t'ua japim ashtu siç janë, por puna është të ndihmojmë pikërisht për atë që shokët tanë të partive marksiste-leniniste kanë nevojë.

Një çështje tjetër është puna që keni bërë ju duke shtypur e botuar vetë disa nga dokumentet e Partisë sonë. Një gjë e tillë bëhet edhe në Francë e gjekë. Qëllimi është që me propagandën tonë të lusfojmë efektivisht kundër revizionizmit modern dhe imperializmit, në çdo lloj forme që të jetë e mundur dhe kjo t'i shërbejë çështjes sonë të përbashkët.

Shumë parti motra propozojnë të bëhen mbledhje partish, bile në shkallë ndërkombëtare. Në kohën e tanishme bota është ngopur deri në grykë me mbledhje. Nga të katër anët bëhen mbledhje nga më të ndryshmet e të tëra këto vetëm për të maskuar diplomacinë e fshehtë të imperialistëve dhe të revizionistëve sovjetikë, sepse në fakt prej këtyre mbledhjeve nuk po rezulton asgjë konkrete për të mirën e njerëzimit. Nuk dua ië them se, në mbledhjet që mund të bëjmë ne marksistë-leninistët, nuk do të arrijmë në ndonjë rezultat. Çështja është që ato të përgatiten mirë, për të çuar përpara kauzën tonë dhe jo të dalim thjesht me njëfarë rezolute sa për bujë. Në duhet t'u tregojmë me fakte armiqve kapitalistë dhe

revisionistë se ato që vendosim dhe shpallim nuk janë sloganë, por programe për zbatim.

Për sa i përket mbledhjes së «sigurimit evropian», që propozohet me të madhe, ne refuzojmë të marrim pjesë në të. Pse e bëjmë këtë? Sepse ne shtrojmë pyetjet: Përse të ketë sigurim vetëm për Evropën dhe jo për të gjithë botën? Ndaj kujt do të jetë ky sigurim? Në të vërtetë ky është sigurim i zonave të influencës së imperialistëve amerikanë dhe të revisionistëve modernë sovjetikë në Evropë, që do të thotë nënshtrim politik e ekonomik i këtij kontinenti ndaj tyre. Ja pse ne as nuk marrim pjesë në një mbledhje të tillë, as jemi dakord që ajo të bëhet.

Partia Komuniste e Kinës na ka njoftuar se ka vendosur të mos ftojë asnjë delegacion në kongreset e saj dhe kërkon që edhe partitë e tjera të mos ftojnë delegacione të saj në kongreset e tyre. Partia jonë nuk mendon kështu. Ne nuk i konsiderojmë formale kongreset që bëjmë, sepse në to tregojmë vullnetin e Partisë dhe përcaktojmë vijën për një periudhë të ardhme. Në qoftë se nuk mblidhemi në të tilla ngjarje kaq të rëndësishme në jetën e partive, atëherë kur do të mblidhemi ne komunistët?

Ne e themi hapur se, për çështjet e përgjithshme të përbashkëta, të shprehin mendimet e tyre e të diskutojnë të gjitha partitë marksiste-leniniste, qofshin në pushtet osc jo. Vërtet ne jemi Parti në fuqi dhë kemi mundësi më shumë se partitë e tjera motra, por detyra jonë është që këto mundësi t'i vëmë në shërbim të komunistëve të të gjitha vendeve dhe të revolucionit. Si Parti në fuqi ne nuk kemi ndonjë avantazh dhe monopol të veç-

ntë ideologjik dhe politik, përkundrazi kemi për detyrë të llogaritim e të mbështetemi në mënyrë shoqërore tek të gjitha partitë e tjera marksiste-leniniste, ashtu siç janë, me sukseset dhc me të metat e tyre, sepse si të gjitha partitë motra, edhe ne kemi suksese, por kemi edhe të meta. Kështu mendojmë ne për këtë çështje.

Partitë e reja marksiste-leniniste kanë forca të dallin nga xhironi që ka stabilizuar borgjezia kapitaliste dhe revisioniste. Ato do të lustojnë dhe do të sulmojnë vazhdimisht duke shfrytëzuar situatat e krijuara. Në qoftë se në revolucionarizimin e vazhdueshëm të luftës suaj ju jeni origjinalë dhe dilni nga ky xhiron, nga rregullat e vendosura prej borgjezisë, ju do të keni patjetër përkrahje të hapët nga të gjithë elementët demokratë, të cilët do t'ju japid të drejtë. Ja, për shembull, politika e Partisë së Punës të Shqipërisë gëzon simpati në shumë qarqe të gjera në botë, sepse ajo është e hapët, parimore dhe e singertë. Ambasadorët e vendevë anëtare të OKB-së, përveç atyre të Britanisë së Madhe, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhc të ndonjë vendi tjetër, që u shkon pas verbërisht këtyre, megjithëse janë të gjithë përfaqësues të qeverive borgjeze, vlerësojnë lart faktin që ne flasim kurdoherë hapur, gjë që të tjerët nuk e bëjnë dot.

Ne ju falënderojmë që erdhët në Shqipëri. Nuk e di si mendoni, por të jeni të bindur se shokët tanë bënë ç'ishte e mundur për t'ju sqaruar mbi të gjitha ato çështje, për të cilat kishit nevojë. Sidoqoftë rrugët tonë janë të hapura kurdoherë për ju. Italia e Shqipëria janë shumë afër njëra-tjetrës, prandaj dëshirojmë që të vini më shpesh në vendin tonë.

U jepni shumë të fala nga ne shokëve dhe i sigroni përkrahjen tonë në çdo kohë dhe për çfarëdo problemi, me qëllim që të forcojmë gjithnjë e më shumë bashkëpunimin, ashtu siç duhet të jetë ky bashkëpunim midis marksistë-leninistëve të vërtetë. Ne ju urojmë suksese në luftën që po bëni. Shokët komunistë italianë nuk janë të rinj, nuk janë as pa eksperiençë, prandaj shpresojmë se asnjë situatë, sado e vështirë të jetë, nuk do t'i dëshpërojë dhe nuk do t'i thyejë. Situatat nuk janë të lehta, por komunistët, kur janë të vendosur dhe udhëhiqen nga marksizëmi-leninizmi, do të dinë t'i shfrytëzojnë ato në favor të çështjes sonë të përbashkët.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim, që gjenden në AQP*

PARTIA JONE PUNON QË ATDHEUN TA MBROJE JO VETËM USHTRIA, POR TËRE POPULLI USHTAR

Nga biseda me delegacionin e ushtrisë kineze

13 tetor 1972

Pasi u përshëndet me mysafirët dhe i pyeti nëse ishin lodhur nga vizitat nëpër vendin tonë, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Komunistët dhe ushtarakët kurrë nuk duhet të ndiejnë lodhje, ata bile edhe në situatat më të vështira duhet të jenë gjithnjë të freskët dhe luftarakë. Nga komunistët dhe ushtarakët, Partia dhe populli presin shumë si në kohë paqeje, ashtu edhe në kohë lufte. Prandaj është e domosdoshme të kaliten vazhdimi shëndetësor, të jenë të një brumi të atillë që të kuptojnë e të orientohen drejt në të gjitha situatat, të jenë të vendosur që, sado të ndërlidhura të jenë ato, t'i përballojnë me sukses dhe t'i kapërcejnë, duke u bërë shembull për masat e gjera të popullit.

Ardhja juaj në vendin tonë do të ndihmojë për të kalitur miqësinë në mes nesh. Kjo miqësi duhet të jetë

e tillë që t'i bëjë ballë çdo vështirësie që mund të dalë në rrugën revolucionare.

Edhe shtetet e tjera, si ato revizioniste dhe kapitaliste, praktikojnë midis tyre shkëmbime delegacionesh të qfarëdo lloji, duke përfshirë edhe delegacione ushtarake, por me këto shkëmbime ata kanë synime të këqija, shkatërruese. Veprimtaria e tyre fyrmezohet nga frika që kanë prej nesh, sepse çdo hap që hedhim ne përpara e që ka karakter konstruktiv për ne, shpie në shkatërrimin e tyre. Ndërsa shkëmbimet e delegacioneve tona nisen nga qëllime të larta për ndërtimin dhe për mbrojtjen e socializmit, për të mirën e dy popujve tanë dhe atyre të të gjithë botës. Këmbimi reciprok i eksperiencës është i rëndësishëm për të dyja palët, sepse nga takimet e përbashkëta me siguri del diçka pozitive për të përsituar nga njëri-tjetri, si në situatë aktuale, ashtu edhe në situatat e ardhshme për mbrojtje nga armiqjtë.

Duke u udhëhequr nga marksizëm-léninizmi ne ndërtojmë me të gjitha forcat të tashmen, por shikojmë edhe drejt së ardhmes. Partia jonë na mëson t'i shohim realisht situatat, të jemi kurdoherë vigjilentë, ta mbajmë barutin në çdo kohë thatë, me një fjalë, të jemi plotësisht të përgatitur dhe të stërvitur për zbatimin në nivelin e duhur të strategjisë dhe të taktilës revolucionare. Kjo na vë detyrën që, gjatë luftës për ndërtimin e socializmit, ta kalitim vazhdimisht ushtrinë tonë, duke pasur parasysh manovrat dhe synimet plot lakmi, kërcënimet e hapëta ose të fshehta të armiqve tanë, imperialistëve amerikanë, socialimperialistëve sovjetikë dhe të gjithë armiqve të tjerë. Për të arri-

tur këto qëllime të larta, natyrisht, ne duhet të kemi medoemos ushtri të kalitura, të armatosura dhe të edukuara më së miri. Në realizimin e këtij objektivi, këmbimi i eksperiencës reciproke ka rëndësinë e vet.

Partia jonë bën të gjitha përpjekjet që organizata e Partisë në ushtri të jetë në komandë, që në mendjen e kuadrove dhe të ushtarëve të rrënjoset në gjithë gjérësinë dhe thellësinë e vet mendimi marksist-leninist. Kjo do të thotë që kuadrot dhe ushtarët tanë të kenë në mendje dhe të jetojnë në radhë të parë me çështjet ideologjike dhe politike e jo vetëm me problemet strategjike, ushtarake dhe teknike, me çështjet e komandimit, të disiplinës, të miqësisë e të dashurisë për njërit-tjetrin etj. Me një fjalë, në të gjitha aspektet e jetës së ushtrisë sonë të sundojnë dhe të veprojnë idealet dhe ndjenjat e vërteta të kulluara marksiste-leniniste. Po të arrihet kjo, çdo gjë do të shkojë në mënyrë të përsosur, ndryshe krijohen rreziqe, si nga e djathta, ashtu edhe nga e majta, nga e majta ekstreme, siç janë irreziku i mendjemadhësisë, i komplotovec dhe i të gjitha të këqijave të tjera të kësaj natyre. Mund të ketë, fjalë vjen, njerëz të këqij që komplotojnë, por forca e ideve marksiste-leniniste të partisë, në mos sot, nesër, i shpartallon ata. Të këqija të kësaj natyre nuk mund dhe nuk duhet të zënë vend në radhët e një partie të vërtetë marksiste-leniniste.

Në këto drejtime lufton Partia jonë dhe suksese kemi. Por, natyrisht, kemi edhe vështirësi, nga të cilat nuk trembemi, sado të mëdha qofshin. Edhe ju jeni ndeshur vazhdimisht me armiq të mëdhenj e të rrezikshëm, keni kapërcyer vështirësi të mëdha, shpartalluat çan-

kaishistët dhe japonezët, intrigat e imperialistëve amerikanë dhe të të gjithë armiqve të tjera të brendshëm. Edhe populli ynë ka luftuar e ka fituar mbi arniqtë e shumtë që i kanë rënë në qafë dhe sot është i përgatitur e përgatitet çdo ditë e më shumë që t'i bëjë ballë cilidh armik. Prandaj nuk kemi frikë nga ata që duan të na luftojnë e të pengojnë ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

Partia jonë punon me kujdes për edukimin e mësave. Ajo bën ç'është e mundur t'i ndreqë njerëzit që gabojnë, qofshin këta të thjeshtë, qofshin me përgjegjësi. Duke mbajtur parasysh psikologjinë e njerëzve, qëllimet e mira dhe ato të mbrapshta të tyre, ajo mbështetet e i konsolidon të mirat, ndërsa të këqijat lufton t'i korrigjojë me masa bindëse, por kur sheh se ata që gabojnë nuk dëshirojnë të korrigjohen, atëherë merr fshesën e hekurt dhe të tillë elementë i spastron. Qëllimi është të mbrohen interesat e mëdhenj të socializmit, të pavarësisë dhe të lirisë së atdheut, sepse këto janë të shtrenjta për popullin. Historia shekullore e popujve tregon se në epoka të ndryshme popujt kanë derdhur vazhdimi shpesh gjak duke luftuar me mënyrat e tyre, me intensitetë të ndryshme dhe kanë pësuar disfata, por kanë korrur edhe fitore. Fitoret njerëzimi i ka arritur me sakrifika të panumërtë, prandaj nuk duhet të lejohet që të shkelë njeri mbi to.

Përse po i bëhet një luftë kaq e tmerrshme sot marksizëm-leninizmit? Pikërisht sepse ai u tregon njerëzve rrugën e drejtë për kryerjen dhe fitoren e revolucionit, për ndërtimin e socializmit e të komunizmit, për zgjidhjen e kontradiktave, i mëson ata se si të luftohen

me ashpërsi imperializmi dhe të gjithë ata që e mbësh-tetin, duke filluar nga revizionizmi, socialdemokracia e deri te një varg rrymash të tjera reaksionare dhe tregon rrugën si të fuqizohen të masat punonjëse ndjenja të qëndrueshme revolucionare. Në situatat e sotme të zhvi-limit kaq të ndërlikuar të njerëzimit, vetëm partitë marksiste-leniniste, që kanë parasysh rrugën e madhe që çon në ndërtimin e plotë të socializmit dhe të komunizmit, janë në gjendje të shikojnë mundësitë e ecjes përpara, duke shfrytëzuar edhe «rrugët e vogla», vepri-met taktike, sepse edhe këto kanë rëndësi mbasi të çojnë në rrugën e madhe.

Partia jonë punon intensivisht në këtë drejtim. Këtë ju e patë vetë, sepse patët rast të binit në kontakt, në radhë të parë, me masën e ushtrisë sonë, me masat e popullit dhe me organizatat e Partisë. Me këtë nuk dua të them sikur ne kemi arritur çdo gjë, sepse në punë e sipër ndiejmë dhe shikojmë që kemi edhe të meta, por edhe detyra të mëdha për të kryer. Partia dhe shteti ynë kanë parasysh mësimin e drejtë marksist, sipas të cilit, që të ndihmojë miku dhe aleati i ngushtë, më parë duhet të jesh vetë i fortë. Partia jonë ka theksuar e thekson se socializmi duhet të ndërtohet nga secili vend me forcat e veta. Vetëm në këtë mënyrë ai po forcohet e do të forcohet më tej dita-ditës në Shqipëri.

Të forcosh socializmin do të thotë, në radhë të parë, të përgatitësh si duhet njerëzit që e ndërtojnë dhe e mbrojnë atë. T'i edukosh ata të jenë të fortë e të patrembur, revolucionarë, besnikë ndaj atdheut, të kulturuar, ushtarë të mirë deri në vdekje për çështjen e madhe

të popullit. Dhe që të jenë kështu, duhet t'i edukojmë ata vazhdimisht, në radhë të parë, politikisht dhe ideologjikisht, por edhe teknikisht. Kjo do të thotë të punojmë për të ngritur më tej ndërgjegjen dhe aftësitë e njerëzve tanë, sepse vetëm kështu ata do të dinë të shfrytëzojnë plotësisht e në të mirën e interesit të përgjithshëm të gjitha mjetet, që u vihen në dispozicion.

Ne punojmë t'i çojmë përpara ekonominë tonë, industrinë, bujqësinë, kulturën, që të gjithë punonjësit, mbarë vendi, të udhëhequr nga Partia, të jenë në revolucion të vazhdueshëm. Ne ecim dhe do të vazhdojmë të ecim me këtë vrull të madh, të cilin kurrë nuk do ta ndalim. Në qoftë se do të shohim ngadalësim në rrugën tonë, kjo do të ishte shenja e parë që do të tregonte se Partia është duke u dobësuar. Atëherë nga të katër anët duhet të jepet alarmi. Kush do ta japë këtë alarm? Jo ata që kanë «ndryshk» në kokë, por komunistët dhe populli. Kush e kalb partinë? Atë nuk e kalbin populli dhe revolucionarët e vërtetë, por elementët, të cilëve u «krimbet» koka, prandaj mirë vepron Partia jonë që i mëson popullin dhe komunistët të shikojnë kurdoherë çdo gjë drejt e në sy, të flasin hapur, të kritikojnë pa druajtje të metat e cilitdo, të respektojnë njerëzit e mirë e të ndershëm, punëtorët, fshatarët e intelektualët modestë, që shkrijnë të tëra energjitet e tyre për të mirën e popullit dhe të kritikojnë, të pastrojnë me fshesë të hekurt ata që bëjnë këq, që i sjellin dëm revolucionit e socializmit. Vetëm në këtë rrugë revolucionare mund të ecin mirë punët. Sigurisht, në këtë drejtim ka edhe të meta, ka vështirësi, ka edhe njerëz që nuk mendojnë drejt. Të themi se s'ka të tillë njerëz, nuk do

të ishim realistë, do të thoshte që sytë nuk i mbajmë hapur, por as mund të themi që nuk kemi suksese, që rininë, gratë, masat e popullit nuk po i edukojmë në rrugën e revolucionit. Kështu do të bënim gabim, për arsyen se fitoret tona janë shumë të mëdha, janë kolosale në këtë drejtim dhe në çdo fushë. Ky është realiteti.

Në numrin e sotëm të gazetës «Zëri i popullit» kishte një artikull¹, ku shumë mirë trajtohej një temë ideologjike kundër pesimistëve, atyre që shikojnë «qimen në vezë». Është fjala për ata që merren me gjëra të vogla. Artikullshkruesi atyre u vë përballë realitetin e madh të vendit tonë. Gabime e të meta ka në jetën tonë të përditshme, shkruan ai, por pa shikoni çfarë është bërë në Shqipëri që pas Çlirimt, shikoni sa shumë shkolla janë ngritur, sa uzina, fabrika e hekurudha janë ndërtuar! Sot ka drita elektrike në të katër anët e vendit, bujqësia është duke kaluar në një stad të ri të përparuar etj., etj. Ku kemi qenë e ku jemi! Prandaj, a ka vend për të qenë pesimistë? Jo, nuk ka vend, përkundrazi ne duhet të jemi optimistë, vazhdon autori, por kjo nuk do të thotë aspak të mos shikojmë drejt në sy, në rrugë revolucionare, gabimet e të metat që kemi.

Kështu veprohet edhe në radhët e ushtrisë sonë. Megjithëse Partia i ka vënë rëndësi të veçantë ushtrisë që në fillim, që në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare dhe për hir të kujdesit e të udhëheqjes së saj ne kemi sot një ushtri moderne, të çeliktë, prapë edhe këtu ne kemi të meta e dobësi, kundër të cilave luftojmë çdo di-

1. Artikulli «Rreth psikologjisë së pesimistit».

të. Por karakteristika të jetës dhe të veprimitarisë së ushtrisë sonë janë anët e saj pozitive, të cilat nuk na e rritin aspak mendjen, nuk na dehin, nuk na bëjnë të mos i shohim të metat e dobësitë, përkundrazi, mbështetemi fort tek të parat për të likuiduar të dytë. Çështjet e pavarësisë, të lirisë së atdheut dhe të socializmit si për ne, ashtu edhe për çdo popull, janë të dorës së parë.

Shqipëria është një vend i vogël socialist, prandaj Partia e Punës e Shqipërisë punon që ta ketë atë plotësisht të përgatitur kundër gjithë armiqve revisionistë, kapitalistë dhe imperialistë, sepse NATO-ja dhe Traktati i Varshavës, pavarësisht se kanë kontradikta ndërmjet tyre kötu në Evropë, përpilen të bien në ujdi, të bashkohen kundër socializmit, pra, edhe kundër vendit tonë. Ne e dimë se kontradiktat që kanë midis tyre këto dy grupime imperialiste nuk i sjellin asnjë fitim vendit tonë, prandaj nuk na lejohet të flemë të qetë, të jemi, me një fjalë, pa merak, duke menduar se në këto kushte nuk na gjen gjë. Evropa e sotme është edhe e bashkuar, edhe e ndarë. Armiqtë imperialistë e revisionistë, në të dy rastet, edhe kur për shkak të disa interesave të përkohshëm janë të bashkuar, edhe kur për shkak të kontradiktave janë të ndarë, janë të rrezikshëm për Shqipërinë, prandaj ne nuk duhet të na zërë gjumi, duke menduar se gjersa NATO-ja e Traktati i Varshavës kanë kontradikta midis tyre, nuk është nevoja të armatosemi e të përgatitemi për mbrojtje. Kjo nuk do të na falej as nga populli ynë, as nga revolucionarët e të gjithë botës.

Dihet që NATO-ja është një organizatë ushtarake agresive, që përgatitet të vërsulet kundër popujve, ku-

ndër Republikës Popullore të Shqipërisë, në radhë të parë, por edhe kundër kokës së Traktatit të Varshavës, Bashkimit Sovjetik. Organizata ushtarake e Varshavës, ku sundon socialimperializmi sovjetik, është, nga ana e vet, gjithashtu, kundër popujve, kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, por edhe kundër NATO-s. Brenda radhëve të këtyre organizatave ka gjithashtu mos-marrëveshje.

Në Veri kemi Jugosllavinë e Titos, që formalisht nuk është as në Traktatin e Varshavës, as në NATO, kurse në realitet bën pjesë në të dyja. Aktualisht, me Jugosllavinë ne kemi marrëdhënie shtetërore normale. Por kush sundon atje? Sundojnë të atillë revisionistë që haptazi janë bërë kapitalistë. Që para Çlirimt, por edhe kur çliruam vendin, Titoja dhe klika e tij bënnë ndaj neshi dhe jo vetëm ndaj nesh, një mijë e një të këqija. Dihet, gjithashtu, se fuqitë imperialiste me marrëveshjet që kanë nënshkruar në të kaluarën, e kanë copëtuar Shqipërinë, duke i shkëputur asaj gjysmën, që sot ndodhet jashtë kufijve të saj të sotëm shtetërorë. Jugosllavia, në të cilën tradtia e grupit të Titos solli rivendosjen e kapitalizmit, është katandisur sot në një situatë të tillë sa mezi qëndron në këmbë.

Por çfarë po ngjet në fakt aktualisht në Jugosllavi? Atje, siç është e natyrshme në situata të tilla, ekziston një konflikt i madh për hegemoni midis klaneve të ndryshme, sidomos midis klanit serb nga një anë dhe atij kroato-slloven nga ana tjeter.

Liria, pavarësia dhe ndërtimi i socializmit në Shqipëri kërcënohen nga armiqjtë. Çështja lidhet jo vetëm, me fërkimet e dy të mëdhenjve, por edhe me kontra-

diktat e atyre që janë aleatë të imperializmit amerikan dhe të revizionizmit sovjetik. Në koniunkturat aktuale superfuqitë mund të mos i shpallin luftë njëra-tjetrës, por ato mund të nxitin aleatët e tyre për luftëra lokale, në të cilat të implikohen ato vende ku situata është e dobët ose edhe ndonjë vend tjetër i patolerueshëm për to. E tillë është Shqipëria socialiste, të cilën armiqtë e komunizmit do të donin ta kthenin në një plasdarmë. Për të sulmuar, ata nuk e kanë të vështirë të gjejnë pretekst, pasi janë mësuar të mos respektojnë asnje normë e të shkelin pa pikë turpi çdo marrëveshje ndërkombëtare.

Se si e filluan luftën fashistët italianë për pushtimin e Shqipërisë, këtë episod ju. sigurisht, e dini prandaj po ju sjell një shembull tjetër: me ç'pretekst e filloi luftën Italia fashiste kundër fqinjës sonë të Jugut, Greqisë? Me pretekstin absurd se një bari shqiptar qe vrarë në kufi nga kufitarët grekë. Kështu Italia fashiste që e kishte «në zemër» Shqipërinë, i dërgoi ultimatum Greqisë, duke i kërkuar arsyet e «vrasjes» së çobanit shqiptar brenda kufirit tonë dhe i shpalli luftë asaj. Ja, me një pretekst të tillë e sulmoi Italia fashiste Greqinë. Në të kaluarën fshatarët tanë imbanin një brez në mes dhe, kur ndonjë prepotent done të provokonte ndonjërin për ta vrarë, lëshonte brezin në mes, me qëllim që ai të vinte këmbët mbi të, ta shkelte dhe provokatori të gjente kështu pretekst për të justifikuar vrasjen. Edhe Italia fashiste kështu veaproj me Greqinë, i shpalli luftë asaj vetëm për vrasjen e një çobani shqiptar në kufi. Këtë e thashë për të vërtetuar atë që imperialistët, për të shpallur sidomos një

luftë të pjesshme, lokale, nuk e kanë të vështirë të gjejnë një arsyе të kotë.

Për këto arsyе ne punojmë dita-ditës që të kemi një Parti, popull e ushtri të fortë. Për këtë ne kemi ngri-tur të tërë popullin në këmbë, e kemi organizuar, e edukojmë politikisht e ideologjikisht dhe e stërvitim më së miri ushtarakisht. Ne nisemi nga parimi që në kohë rreziku tërë populli duhet të jetë në këmbë dhe të bëjë çdo gjë për luftën, për atdheun, të luftojë me zjarr në zemër dhe me mendje të kthjellët, të jetë i ndërgjegjshëm se në rast agresioni ne do të gjendemi të rrëthuar. Prandaj Partia po i edukon popullin dhe ushtrinë ta kenë të qartë e të jenë të ndërgjegjshëm se lufta nesër do të jetë e ashpër, në kushte rrëthimi të plotë nga armiqëtë dhe se mund të vazhdojë për një kohë të gjatë.

Partia jonë ka menduar për çdo rast, sado i vështirë të jetë, se ç'strategji dhe ç'taktikë të ndjekë. Ajo e edukon popullin dhe ushtrinë të mbrojnë pëllëmbë për pëllëmbë atdheun, shtetin tonë. T'u zënë armiqve çdo shteg, të mos i lënë të futen në tokën tonë, por edhe po të futen, t'i luftojnë pandërprerë e të mos i lënë të qetë për asnjë çast gjersa t'i likuidojnë forcat e tyre, qofshin edhe të mëdha në numër e në armatime. Prandaj të gjithë kuadrove tanë, që kanë dalë nga lufta ose që më vonë kanë mbaruar akademitë dhe kanë një eksperiençë shumë të madhe në çështjet ushtarake. Partia kurdoherë u përsërit porosinë që këtë eksperiencë që kanë fituar, qoftë gjatë Luftës Nacionallirimitare, qoftë në shkolla ose në punën e përditshme për edukimin e forcimin e ushtrisë, ta vënë në jetë në kushtet tona dhe

as ta nënvleftësojnë armikun, por as të mos tremben nga forca e tij e madhe, por me llogari dhe gjakstohtësi të peshojnë çdo gjë.

Kuadrot tanë, që kanë mësuar në shkolla, e dinë si zhvillohen betejat. Njohuritë që kanë marrë në auditore janë shumë të dobishme, prandaj Partia i këshilllon që ato t'i përdorin, por të mos mendojnë se në kohë lufte, fushat e betejës mund të jenë si ato që kanë mësuar në akademi. Për këtë ata duhet të kenë gjithmonë parasysh kushtet konkrete të Shqipërisë, sepse, në qoftë se nuk bëjmë këtë, atëherë armiku mund të na dëmtojë rëndë.

Sot ne po bëjmë kudo fortifikime. Po përse i bëjmë këto? Për t'u mbrojtur nga armiqtë dhe për t'iu kundërpërgjigjur atyre. Ju i patë fortifikimet që kemi ndërtuar ne. Ne po punojmë me të gjitha mundësitë që të mbyllim çdo shteg të vendit tonë nga mund të kalojnë armiqtë. Ne, gjithashlu, kujdesemi shumë që të ruajmë sa më mirë njerëzit tanë. Do të ketë situata të përkohshme kur armiqtë do të jenë superiorë, por në fund të fundit ne do të jemi superiorë mbi ta. «Në vrimë të gjilpërës» armiku nuk mund të kalojë dot armata të tëra.

Në bazë të këtyre që thashë dhe duke parë edhe eksperiencën e luftës në Vietnam, armiku mund ta fillojë sulmin, por nuk i jep dot fund luftës me një operacion. Prandaj kemi parasysh se në rast se ne sulmohemi, vendit tonë do t'i duhet të përballojë një luftë të gjatë. Edhe Vietnami po lufton prej shumë vjetësh me imperialistët amerikanë. Ne i admirojmë vietnamzët për luftën e tyre heroike. Nëse lufta atje akoma

nuk është fituar dhe po vazhdon me sakrifica të mëdha, kjo vjen se sovjetikët kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë dallaveret më të ulëta për ta dobësuar dhe, po të jetë e mundur, për ta shuar luftën heroike të popullit vietnamez.

Pra, në rast se armiqjtë do të na atakojnë, ne do të luftojnë gjer në fitoren e plotë, pavarësisht se lufta kundër tyre do të jetë e gjatë.

Qëllimi ynë është që, duke u përgatitur për të mbrojtur atdheun tonë nga kërcënimi i një lufte, të mbrojmi njëkohësisht çështjen e madhe të popujve. Në çfarëdo situate rezistenca që u bëhet imperialistëve, revisionistëve modernë sovjetikë dhe gjithë reaksionarëve të tjerë nga ana jonë, është një fitore e madhe për popujt dhe dobësim për kundërshtarët tanë. Duke i vënë në balancë të dyja palët, ne dhe armiqjtë tanë, peshorja rëndon nga ne, është në favorin tonë, prandaj fitorja do të jetë jona. Kështu e kuptojmë ne këtë çështje.

Vija e Partisë sonë është që të edukohen dhe të bëhen të aftë për mbrojtjen e atdheut të gjithë njerëzit që janë në gjendje të mbajnë armë. Këtë e kërkojnë kushtet e interesat e lartë të vendit tonë. Prandaj Partia jonë i kushton shumë kujdes përgatitjes ideologjike, politike dhc ushtarake të të gjitha masave të popullit.

Edhe një herë ju falënderoj nga zemra dhe ju siguroj se te Partia dhe tek ushtria jonë keni miq besnikë deri në fitoren e madhe përfundimtare të komunizmit.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim, që gjenden në AQP*

INDIVIDUALIZMI DHE INDIFERENTIZMI MBËSIHTETEN NË IDEOLOGJITË E KLASAVE SIHFRYTEZUESE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

28 tetor 1972

Në qoftë se problemet e individualizmit dhe të indiferentizmit, që paraqiten në këto dy raporte² i marrim të shkëputura ngajeta e gjallë, ka rrezik që, në vend të nxjerrjes së disa konkluzioneve me vlerë, të thuhen shumë fraza dhe të përsëriten mjast parime që Partia jonë i ka shtruar drejt. Partia lufton tani që t'i zbatojë në jetë këto parime, t'i zhvillojë e thellojë ato më tej dhe t'i korrigjojë, kur shikon se disa janë vjetruar dhe jeta nxjerr probleme të reja për të zgjidhur. Këto dy probleme, për arsyen studimi i shikojmë veçan nga njëri-tjetri, por nuk duhet harruar se, me gjithë veçoritë që kanë, ato janë të lidhura me të gjitha shprehitë pozitive ose

1. Në këtë mbledhje u diskutua treth punës që po bëhej përzbatimin e vendimeve të Kongresit të 6-të të PPSH lidhur me luftën kundër individualizmit e indiferentizmit.

2. Është fjalë për dy raportet e paraqitura nga Komiteti i Partisë i Tiranës dhe ai i Shkodrës.

negative të jetës së njerëzve tanë, të cilët, nën udhëheqjen e Partisë, gjatë procesit të ndërtimit të socializmit zhvillojnë një luftë të vazhdueshme për përsosjen e karakterit dhe revolucionarizimin e mendjes dhe të ndërgjegjes së tyre. Është fakt, se duke ndërtuar socializmin, njerëzit tanë formojnë shprehi e koncepte dhe shprehin dëshira të reja, të cilat nuk duhet t'i marrim kurrë të shkëputura nga zhvillimi i jetës, nga kuadri i punës që bëhet për edukimin e përgjithshëm të tyre dhe nga ndërtimi i socializmit.

Në studimet, artikujt ose leksionet teorike që përgatitum, problemet ideologjike nuk duhet t'i marrim të shkëputura nga praktika dhe t'i trajtojmë vetëm nga ana filozofike, siç po lexojmë në disa artikuj që boton shtypi ynë. Po të veprohet kështu, mund të mos jemi shumë realistë dhe përfundimet e arritura nuk do të bëjnë shumë efekt. Njerëzit, në punë dhe në jetë, nga qëndrimet që mbajnë dhe nga mendimet që shprehin, tregojnë çndjenja dhe dëshira kanë, në marrëdhëni e tyre të përditshme ata ballafaqohen dhe përpiqen me të mirat dhe me të këqijat. Në këtë proces ndeshjeje të mirat duhet të litojnë, kurse të këqijat të punohet që të pastrohen dhe gradualisht të zhduken.

Individualizmi dhe indiferentizmi janë të lidhur me disa të këqija të tjera, siç është prona private, tek e cila mbështeten të gjitha ideologjitet e klasave shfrytëzuese. Sado që aktualisht prona private nö përgjithësi është likuiduar në shtetin tonë socialist, indiferentizmi dhe individualizmi tek ajo e kanë origjinën. Të gjitha mbeturinat dhe ndikimet e ideologjive të huaja pleksen me psikologjinë e pronës private dhe me ndjenjën e

rendjes pas interesit të ngushtë vetjak që burojnë prej saj. Frika nga veprimet e guximshme revolucionare, që i nxitin dhe i edukojnë punonjësit për të vënë, në radhë të parë e mbi të gjitha, interesat e mëdhenj shoqërorë, i pengon disa njerëz që të kritikojnë anët negative të shokëve të tyre, i bën që të mos ngrenë zërin kundër mosrealizimeve, kundër shkeljeve të ligjshmërisë revolucionare etj. Ata tremben se, duke vepruar ndryshe, u cenohen kushtet që kanë siguruar, prandaj mendojnë kësisoj: mirë jemi, diçka të kënaqshme e kemi arritur, një apartament për të banuar e kemi marrë, atëherë pse të mos rrimë rehat? Dhe, duke gjykuar kështu si mikroborgjezë, mbyllin sytë ndaj shfaqjeve negative të jetës, nuk kritikojnë të metat në punë etj., etj.

Natyrisht, kur mendohet kështu dhe kur shikohet interes i ngushtë personal në një mënyrë të tillë sa ky t'u kundërvihet interesave të përgjithshëm, këta të fundit dëmtohen. Shfaqje të tillë sot mund të janë akoma të theksuara, ndërsa nesër, në sajë të luftës dhe të punës së Partisë, sigurisht do të shkojnë drejt pakësimit dhe zhdukjes së tyre. Megjithatë ekzistanca dhe shkalla e tyre duhen parë kurdoherë të lidhura me zhvillimin frontal të luftës klasore kundër të gjitha formave të ideologjisë së huaj. Po të kryhet puna e Partisë me të meta në sektorë të ndryshëm, siç thuhet në raportet dhe siç diskutuan shokët, ka momente që këto shfaqje bëhen më të mprehta.

Çështjet duhen shpënë njëherë e mirë deri në fund dhe t'i zgjidhim ato sa të jetë e mundur më parë. E kam fjalën sidomos për njerëzit që shktuajnë letra apo që ankohen për «padrejtësitë» që u qenkan bërë.

Ne do të përpinqemi me durim e gjakstohtësi t'i s'qarojmë, t'i bindim këta njerëz se çfarë u takon dhe çfarë nuk u takon. Nuk duhet të merremi më me ata individë që nuk duan të binden, që kanë bërë gjithë ato gabime e nuk i pranojnë. Kur tjetri s'është dakord as me organizatën-bazë e as me komitetin e Partisë bile, kur nuk është dakord as me ne, duhet të rrnimë me vite të tëra që ta bindim këtë njeri pse u përjashtua nga Partia, fjala vjen? Këtu nuk është çështja kur një individ i ka bërë të keqë një tjetri, por, kur nga verifikimi i çështjes, dalin po ato gjëra, po ato të meta dhe ai s'bindet, përkundrazi, vazhdon të trashë gabimet, mund t'i thuhet: «Në qoftë se nuk je i bindur, përpiku të bindesh, në qoftë se mbush kupën dhe kryen ndonjë krim, do ta çosh veten në gjyq dhe do të dënohesh». Demokracinë të mos është shpërdorojmë por, sigurisht, as të mos bëhen veprime arbitrale. Pra, siç thashë, problemit duhet t'i shkohet deri në fund dhe ta zgjidhim përfundimisht.

Kur shtrohet çështja në Parti, shokë, atëherë duhet të pranohet vendimi i Partisë. Para ca kohe mora një letër nga një shok prej Berati, që punon në organet e Punëve të Brendshme. Ai është 50 vjeç, por e kishte plotësuar moshën e pensionit të shërbimit. Që më parë i patën thënë të dilte në lirim. «Pse të dal, thoshte ai, kur jam në gjendje të punoj akoma?!». «Ke disa të meta», i përgjigjeshin shokët. «Mirë, këto i njoh dhe do t'i korrigjoj», ua kthente oficeri. Megjithatë ngulej këmbë që ai të shkarkohej nga detyra dhe të merrte pension për vjetërsi shërbimi, gjersa të mbushte moshën për pension pleqërie. Mbasi nuk binin dakord me të, e quan çështjen për diskutim në organizatën-bazë të Partisë,

ku 17 veta ishin dakord që ankuesi të mos dilte në lirim, kurse 5 ose 6 mendonin të dilte. Komiteti i Partisë, që shqyrtoi çështjen, vendosi në kundërshtim me organizatën-bazë: E nxori oficerin në lirim, duke mos e çarë kokën fare për vendimin e organizatës-bazë të Partisë. U shkelën kështu normat e Partisë.

Pastaj, për të „argumentuar“ veprimin, folën në organizatë me Veprat e shokut Enver, duke thënë se „shoku Enver ka thënë për këtë çështje kështu e ashtu.. Unë, siç e dini të gjithë, kam folur në parim që njerëzit, kur vijnë në moshën e caktuar, t'ua lënë vendin të rinjve etj., etj., por, thëniet e mia nuk duhen interpretuar keq, sipas dëshirës së njërit apo të tjegrit. Pasi i bënë presion organizatës-bazë, kjo u mblohdh për të dytën herë dhe u lëkund; vendosi me shumicë votash që ankuesi të dilte në lirim, duke e zëvendësuar oficerin me një shok tjetër të së njëjtës moshë, po 50 vjeç (!). Kjo ndodhi se një pjesë e komunistëve, joparimorë, u tërroqën. Ministria e Brendshme nuk e pranoi këtë veprim të padrejtë. Unë i njostova shokët e Beratit që nuk jam aspak dakord me vendimin e dytë, por me vendimin e parë të organizatës-bazë të Partisë. Gjersa çështja iu la asaj për gjykim duhej të veprohej ashtu, siç vendosi ajo dhe udhëheqja e rrethit të mos lozta dhe as të mos abuzonte me parimet e drejta të Partisë. Nuk u duhet bërë presion shokëve me vendimet e Partisë dhe me fjalët e mia që të ndërrojnë mendimet. Në qoftë se kishte të meta, atëherë këto duhej t'i viheshin në dukje organizatës, e cila, po të gjykonte me vend dhe të bindej, do të vendoste me siguri në favor të propozimit që iu paraqit. Por, gjersa ajo vendosi, duhej zbatuar vendimi i saj, pa

bërë presione e rishqyrtime për të vendosur konform vullnetit të disa shokëve.

Veprime të tilla nuk duhet të ndodhin. Kur vendos populli që një person, me gjithë të metat që ka, të qëndrojë përsëri kryetar i kooperativës ose i këshillit popullor etj. aparatet s'kanë të drejtë tu kundërvihen masave. Në përgjigje të ankesave që bëhen për shkeljen e këtyre parimeve, ndodh nganjëherë që aparatet na shkruajnë: «Megjithatë, ne të aparatit mendojmë që ankuesi të mos jetë më kryetar, për arsy se ka këto e ato të meta». Unë, disa herë, mbi shkresat e tyre kam shënuar që «ankuesi, me gjithë të metat që ka, të qëndrojë atje ku dëshiron populli, sepse ju, nuk ia keni vënë mirë në dukje dobësitë as vetë kuadrit, as popullit». Si mund të lejojmë ne që aparatet të vendosin në kundërshtim me vullnetin e masave? Me ç'të drejtë punonjësit e aparateve shkelin parimet e vendosura që për kuadrot dhe për punën e tyre, të pyetet Partia dhe populli? Me parimet nuk duhet të lozim, po t'i zbatojmë ato gjer në fund dhe me përpikërinë më të madhe. Kështu, shokë, nuk mund të eeet. Pra, sikurse tha shoku Hysni, një gjë që vendoset në popull, merr fund atje.

Shokët që punojnë në sektorin e letrave, jo çdo kërkësë duhet ta dërgojnë për verifikim në rrëth ose në bazë, sidomos kur e njëjta çështje është parë nga instancat kompetente. Nganjëherë dërgohen për verifikim në rrëthe disa ankesa për njerëz me të cilët Partia në bazë është marrë 3-4 herë. Kështu krijohet përshtypja sikur Komiteti Qendror, për këtë ankues që s'ka të drejtë, interesohet në mënyrë të veçantë. Shokët e rrëtheve, edhe kur u shkon ndonjë letër e tillë, mendojnë:

«Dale se kjo letër ka ardhur nga Komiteti Qendror, nga shoku Enver» etj. Të gjitha letrat, pavarësisht ku dhe cilit i drejtohet ankuesi, duhen shqyrtuar me vëmendje, duke gjykuar nga thelbi i ankimit, nga fakti nëse ka apo jo të drejtë ai që shkruan dhe nga rëndësia e problemit që ngrë.

Partia mëson që komitetet e Partisë të interesohen dhe t'i gjykojnë me kujdes hallet e popullit dhe ankesat që vijnë t'i gjykojë vetë populli atje ku këta njerëz, që ankohen, punojnë e jetojnë. Kjo nuk do të thotë që në emër të zbatimit të vijës së masave të kalohet në njëfarë demokracie të papranueshme, ndryshtë disa njerëz, të cilët s'kanë tjetër zanat veçse të shkruajnë letra për gjëra të kota, do të na linin pa punë.

Çështja e kapjes fort të njerëzve pas interesave të ngushtë vetjakë, që u kundërvihen interesave të përbashkët të shoqërisë, çështja e ndjenjës së pronës private, në kuptimin filozofik dhe në praktikën e jetës, nuk duhet nënvlerësuar. Diku në raport thuhet se vënia e interesit personal mbi atë të përgjithshmin «ngre aty-këtu krye». Unë mendoj se kjo prirje nuk është kaq e thjeshtë sa paraqitet, ajo nuk ngrë krye aty-këtu, por vihet re në shumë raste.

Të jemi realistë, shokë. Shumica e njerëzve edhe kur luftojnë për interesat e pronës së përbashkët, prapë-serapë, qoftë edhe në forma shumë-shumë të zbehta, përpiken më tepër nga sa duhet për interesin vetjak, por këtë prirje nuk e shfaqin haptas, dhe kjo është arsyaja që nuk bëhet problemi botëkuptimi i tyre mikroborgjez. Do të duhet një kohë shumë e gjatë prej dhjetëra e dhjetëra e ndoshta qindra vjetësh që Partia, me një luftë re-

volucionare të vazhdueshme, duke u udhëhequr nga doktrina jonë marksiste-leniniste, të arrijë edukiniin e plotë komunist të njeriut. Ky edukimi do të kalojë në-për një proces shkallë-shkallë, duke marrë parasysh veçoritë e njerëzve, prejardhjen, nivelin e ngritjes së tyre ideopolitike, kulturore etj. Puna edukative duhet të bëhet në mënyrë të diferencuar, sepse nuk janë njëlloj të gjithë njerëzit. Ka prej tyre që megjithëse c shikojnë shumë interesin e ngushtë vetjak, nuk dëshirojnë të shkelin interesin e përgjithshëm, interesin e Partisë ose t'i bëjnë dëm tjeterit, por ka të tjerë që për interesin vetjak shkelin edhe ligjet e shtetit, domethënë të shqërisë, edhe të drejtat c shtetasve.

Jam i një mendimi me shokët se të gjitha të këqijat në jetën dhë karakterin e njerëzve shifaqen mië shumë tek ata që kanë një zhvillim politik të pamjaftueshëm. Partia na ka mësuar që çështjen e ngritjes së nivelit politik të njerëzve ta kuuptojmë në të gjitha aspektet c jetës dhe jo vetëm në një aspekt të cunguar, në atë të gjendjes ndërkombëtare. Në çdo hap të jetës së Partisë dhe të popullit, në çdo problem, në çdo vepriptari që zhvillohet, hyn politika. Kuptimi i drejtë i anës politike të çështjes, në çdo kohë dhe në çdo sektor të jetës e të punës, është gjëja më me rëndësi për njerëzit, të cilët, pasi ta kenë bluar këtë anë në vijat e saj të përgjithshme, luslojnë që ta zbërthejnë dhc ta zbatojnë në jetë.

Duke e parë çështjen në këtë prizëni, duhet t'i vëmë vetes pyetjen: punojmë si duhet që jo vetëm komunisët, por të gjithë njerëzit tanë, jo vetëm Partia, por edhe organizatat e masave, organet e pushtetit, të ekonomi-

së etj., të interesohen për ta kuptuar mirë politikën e Partisë në gjithë këtë aktivitet të gjerë e të shumëllojshëm për ndërtimin e socializmit? Në veprimtarinë tonë për edukimin komunist të masave hasen shumë pengesa objektive, që sjanë të vogla, por më shumë hasen, sidomos, pengesa subjektive, për mënjanimin e të cilave duhet një luftë akoma më e madhe. Që të kuptohet politikisht ky realitet, Partia ka punuar dhe vazhdon të punojë me sukses për edukimin revolucionar të masave. Për këtë qëllim ajo ka gjetur e përpunuuar metodat, format dhe stilin e përshtatshëm. Megjithatë akoma nuk mund të thuhet që ne kurdoherë kemi ecur frontalisht e në thellësi në këtë drejtim.

Kur flasim për shfaqjet e individualizmit ose të indiferentizmit, ato, në radhë të parë, duhet t'i kuptojmë politikisht. Një njeri individualist ose indiferent nuk mund të jetë i pastör nga shfaqjet e tjera të ideologjisë së huaj. Në ndërgjegjen e tij ai duhet të ketë edhe frikën, që nuk është diçka pa të cilën njeriu nuk rron dot, sepse nëpërmjet edukimit ajo mund të lufiohet dhe të zhduket. Frika i ka rrënjet në paditurinë e njeriut për të kuptuar drejt fenomenet e natyrës dhe të shoqërisë, në ideologjinë fetare, në pasigurinë për të ardhmen etj. Te njerëzit me pikëpamje individualiste ose me qëndrim indiferent mund të ekzistojnë edhe ndjenja e rehatllökut, prirjet e burokrațizmit e shumë fenomene të tjera negative të jetës.

Të gjitha këto fenomene janë të lidhura e të ndërvarura me njëra-tjetrën dhe, ku më shumë e ku më pak, ndikojnë tek individët. Njerëzve me mbeturina të illa në ndërgjegje, sipas të metave që shfaqin në

punë e në jetë, një herë u vihet emri burokratë, herën tjetër konservatorë etj.. por burokrati është njëkohësisht edhe indiferent ndaj trajtimit revolucionar të problemeve, ai është edhe konservator, sepse kërkon të mbajë të pandryshuar gjendjen e vjetër, është kundër çdo gjëje të re që sjell mendimi revolucionar i masave etj. Pra, këto mbeturina borgjeze e mikroborgjeze janë një pjellë me shumë kokë, që, sipas rastit, vendit, kohës etj., shfaqen në një mënyrë ose në një tjetër, me një intensitet më të madh ose më të vogël. Në rrugën tonë, të ndriçuar nga ideologjia marksiste-leniniste dhe nga realiteti ynë socialist, këtyre mbeturinave mund dënu duhet t'u bëhet ballë.

Po si mund t'i zhdukim këto? Partia jonë këtë rrugë e ka filluar nëpërmjet një luste frontale. Ajo e di që luftha kundër ideologjisë së huaj është një proces edukimi i gjatë, i pandërprerë dhe jo i lehtë, i cili fillon që kur njeriu është kalama. Edukimi komunist, që synon zhvillimin e gjithanshëm të personalitetit të njeriut, bëhet në shumë forma: në shkollë, në familje, në punë e në jetë. Pra, procesi i edukimit komunist të njerëzve zhvillohet në mënyrë individuale dhe masive. Nëpërmjet studimit të filozofisë marksiste-leniniste, por njëkohësisht edhe nëpërmjet aksionit dhe luftës për realizimin në jetë të vijës së Partisë. Pa nënvlërësuar asnjëren formë edukimi, ne mund të themi se në tërë këtë proces, luftha e masave të gjera, të organizuara e të edukuara nga Partia për ndërtimin e socializmit, për zhdukjen e të metave, për çrrënjosjen e moralit fetar, për krijimin e marrëdhënieve të drejta në familje, në

shoqëri, në fabrikë, në zyra, në organizatat-bazë etj., ka dhënë rezultate të shkëlqyera. Pa luftën e organizuar nga Partia në mënyrë masive e revolucionare, vetëm nëpërmjet edukatës së thjeshtë shkollore ose familjare, së cilës i përbahen filozofët e borgjezisë, nuk mund të arrilleshin ato rezultate të mëdha që kemi në vendin tonë socialist. Edukimi shkollor dhe familjar sigurisht do të bën efekt, por ky do të ishte shumë i paktë, në krahasim me ndikimin e fuqishëm të edukimit masiv në punë, që i jep njeriut forcë, i zgjeron horizontin, i heq frikën, i shton besimin e madh te kolektivi dhe e bind se atje ku forcat mblidhen dhe godasin bashkërisht, realizohet një veprim që individualisht ose nga një grup i vogël do të ishte i pamundur të arrihej. Jeta jonë ka provuar në mënyrë të pakundërshtueshme se të gjitha çështjet e problemet më të koklavitura janë zgjidhur mirë dhe shpejt kur për këto kemi bërë të interesuar masën e Partisë dhe të popullit. Në këtë mënyrë janë edukuar njerëzit, janë shpëtuar të lëkundshmit dhe janë goditur të këqijtë.

Pra, në procesin e edukimit revolucionar të njerëzve, lufta masive kalit virtute të larta morale, zhduk pengesa që ndeshen në punë e sipër dhe, në një kohë shumi të shkurtër, fshin botëkuptimet filozofike të vjetra, të trashëguara e të bëra zakon nga e kaluara.

Neve na vihet detyra që, duke mos lënë pas dore asnjë nga format e luftës për ndërtimin e socializmit dhe për edukimin e njeriut të ri, në radhë të parë, të theksojmë edukimin filozofik marksist-leninist dhe aksionin revolucionar masiv. Kjo formë e edukimit nuk mund

të përjashtojë edukimin individual, që ka gjithashtu rëndësi, por edukimi masiv dhe i vazhdueshëm duhet praktikuar shumë gjerë.

Hipokrizia apo hileja nuk mund të qëndrojnë në këmbë përpara masave, kurse përpara individëve të vëçantë ose një grapi të vogël njerëzish ato mund të zënë rrënje të thella. Nuk ka mundësi që një njeri, tre apo dhjetë njerëz indiferentë në një ndërmarrje t'i kundërvihen një mase të madhe prej 300 ose 400 vëtash, që hidhet në sulm për të zbatuar detyrat e ngarkuara. Herrët ose vonë indiferenti do të kuptojë që interesit i tij i ngushtë, mbyllja në guaskën e një bote të vogël meskine bëhen pa kuptim para problemeve kaq të mëdha që ndërnerr kolektivi ku bën pjesë edhe vetë. Vrulli revolucionar i masave nuk ka si të mos e rrëmbejë indiferentin, i cili do të marrë guxim e do të hidhet në punë bashkë me shokët. Njeriu indiferent shikon që masat e gjera punonjëse, duke zbatuar vijën e Partisë, hidhen në luftë për një çështje të drojtë dhe arrijnë rezultate, prandaj, në qoftë se nuk është armik, në mos sot, nesër do ta kuptojë se qëndrimi i tij duarlidhur dhe mendimi: «Ç'më duhet mua, pse të futem në këtë valle?» etj., s'janë të drejtë dhe nuk përputhen aspak me normat e moralit komunist. Kështu indiferentizmi dhe hipokrizia në qëndrimet dhe sjelljet e njerëzve nuk do të jenë të përhershme, por do të shfaqen vëtëm në momente të caktuara.

Luftën frontale klasore kundër të gjitha formave të ideologjisë së huaj duhet ta vazhdojmë më me shkathësi, më të studiuar e më gjallërisht. Në këtë luftë, siç thashë, ç'është e vërteta kemi suksese, po kemi edhe

mjaft të meta e dobësi që nuk mund të lejohen. Rezultatet që janë arritur kundër prirjeve të individualizmit dhe të indiferentizmit të njerëzve, nuk duhet të krijojnë vetëkënaqësi. Në këtë drejtim është e domosdoshme të jemi më kërkues, sidomos ndaj komunistëve që tregohen individualistë ose indiferentë, qoftë edhe në një shkallë shumë të vogël. Organizata-bazë e Partisë t'i vërë gishtin kokës kur një ose disa shokë kanë shfaqje të tillë, sepse tregojnë që ata akoma nuk janë të pjekur për Partinë. Organizatës-bazë në këto raste i vihet për detyrë që këta komunistë t'i edukojë jo nëpermjet një punë të përgjithshme shkel e shko, por konkretisht, jo vetëm në mbledhjen e mbyllur të organizatës dhe në kurset e format e edukimit që organizohen, por sidomos në aksion, për t'i vënë këta njerëz në provën e jetës dhe për t'u bindur nëse kurset, diskutimet, kritikat, autokritikat dhe edukimi që bëhen, kanë apo s'kanë vlerë. Në rast se të metat dhe shfaqjet e huaja të komunistit nuk ndreqen, pse puna e organizatës së Partisë është e dobët, atëherë ajo ta përmirësojë atë më tej. Në të kundërtën, kur ndihma e saj s'ka munguar dhe ka qenë në nivelin e duhur, ndërsa komunisti vazhdon të mos e njohë fajin e tij dhe ruan shfaqje të huaja, në kundërshtim me vijën e Partisë, ai duhet të nxirret pa hezitim jashtë radhëve të saj. Për hir të zemërbutësisë së disa njerëzve ne nuk mund të komprometojmë Partinë. Nuk mund të sakrifikohet roli revolucionar dhe pararojë i Partisë për qëndrimet joparimore të disa njerëzve, qofshin këta edhe shokë me të kaluar të mirë, siç u përmend këtu, gjatë diskutimeve. Këta nuk duhet të hiqen zvarrë në një kohë kur Partia lufton

dhe nuk pajtohet me të metat në punë dhe punon vazhdimesht për të mbajtur të pastra radhët e saj.

Partia duhet ta kuptojë që ndërtimi i socializmit, formimi dhe zhvillimi i gjithanshëm komunist i njeriut të ri hasin në vështirësi të mëdha jo vetëm nga shfaqjet negative që përmendëm, por edhe nga disa mungesa me karakter ekonomik objektiv, prandaj problemet ajo duhet t'i shkojë realisht, siç janë dhe jo me syrin ëndërrues, sikur çdo gjë te ne shkon mirë. Jo, puna nuk do të shkojë si duhet, në qoftë se ne nuk punojmë mirë në shumë drejtime. Në qoftë se do të mbillej pambuku në tokat më të këqija, nuk do t'i hidhej pleh, nuk do të prashitej e nuk do t'i bëheshin shërbimet e tjera, siç u veprua vjet, këtë vit nuk do të kishim pambuk. Megjithëse ra shunië shi, shokët e rretheve sivjet janë më optimistë dhe plani affërsisht mund të realizohet. Kjo ndodh se të gjitha mendimet e gabuara që kishin ata për mbjelljen e pambukut, u luftuan me sukses. Parulla «bujqësia është fabrikë pa çati» nuk është mobilizuese. Të gjitha vështirësitë, që nuk i kapërcejmë dot, i mbulon ajo.

Vjet patëm deficit në pambuk. Atëherë si do të punojnë kombinatet tonë të tekstileve me këtë mungesë? Mendojnë shokët e Partisë e të pushtetit në rrethet ku mbillet pambuku se ku do t'i çojmë qindra e mijëra punëtorë të tekstileve, në rast se nuk do të kemi lëndë të parë? Mund t'u themi atyre të shkojnë në shtëpi se s'kemi punë? Jo, nuk mund dhe nuk do t'u themi kështu!

Unë pyes: bëhen apo nuk bëhen llogari për këto gjëra? Llogaria është e nevojshme për të pasur një ide të qartë për koston e prodhimit dhe për t'i dalë përpara

çdo të papriture. Çështjen e kam këtu: për çdo punë që bëjmë apo edhe për çdo aksion që ndërmarrim, qoftë ky që kryhet me punë vullnetare, me punë prodhuese, me aktivizimin e nxënësve të shkollave etj. duhet të mbajmë llogari për të parë sa na kushton ajo që përfitohet, ndryshe, shokë, mund të na krijohen situata shumë të vështira. Në qoftë se nuk bëhen llogari dhe mendohet se për këto gjëra mund të ecet dosido apo kuturu, atëherë do të kemi pasoja në fondin e pagave, në treg, në mallrat, në arkat e kursimit, do të kemi inflacion etj. Në vështrim të parë, duket sikur këto janë punë fare të lehta, mirëpo, më vonë, nuk del ashtu; çdo veprim që ndërmarrim ka më vonë pasoja.

E zura në gojë çështjen e pambukut për të treguar se shteti ka shpesh vështirësi objektive në lëmin ekonomik. Këto vështirësi të parët duhet t'i kuptojnë komunistët, të cilët duhet të mobilizohen më gjallërisht për kryerjen e detyrate. Në rast se ata nuk e kuptojnë nevojën e zbatimit të detyrate që vë Partia, do të thotë se nuk kuptojnë politikën e Partisë në fushën ekonomike, e cila kërkon rritjen e rendimenteve, vendosjen e normave të larta dhe të një disipline të rreptë në punë, shfrytëzimin e plotë të kohës normale të punës, prodhimë me cilësi të mirë dhe me çmime të lira etj. Nuk mund të bëhet fjalë për disiplinë proletare në punë dhe për plotësimin e nevojave të popullit, po qe se mendohet: «le të punojmë sa për të marrë rrogën». Ky gjykim i cekët është shumë i dëmshëm për ekonominë popullore. Kur në dyqanet tona nuk gjenden mallrat që nevojiten, domethënë kur kërkesa është më e madhe se oferta, edhe sikur shumë të drejtë, të ndershëm e rigo-

rozë të janë shokët e tregtisë (megjithëse nuk janë të tërë të tillë) në këto kushte populli prapë do të thotë: po bëhen hatëre. Këto mungesa bëhen shkak për pësh-përitjen me vend e pa vend, krijojnë situata të vështira nga ana ekonomike. Mungesa e disa mallrave në treg ndikon, gjithashtu, në prishjen e ndërgjegjes së njerezve.

Shokët e Partisë, në radhë të parë, duhet të janë korrektë, të qëndrojnë në pararojë dhe të bëjnë shumë kujdes për kuptimin dhe zbatimin e vijës së Partisë. Ata duhet të përpiken me zell për edukimin ideologjik të tyre dhe të masave, por masat, ama, t'i edukojmë me «këmbët mbi tokë», duke u mbështetur në realitetin tonë socialist. Me të vërtetë popullit mund t'i mungojë ndonjëherë diçka, por ai duhet ta dijë dhe sigurisht e di që në botën e jashtme, si rezultat i vështirësive shumë të mëdha ekonomike, janë ngritur dhe vazhdojnë të ngrihen çmimet në qiell. Për të kapërcyer përkohësisht disa vështirësi, vendet e tjera janë shitur tek imperializmi, kurse te ne liria dhe pavarësia e atdheut ruhen të paprekura, çdo ditë shtohen mallrat, çdo sektor ecën pa u ndalur përpara, gjithçka është në duart e popullit, nevojat e tij plotësohen çdo vit e më mirë, çmimet te ne nuk janë ngritur, përkundrazi kanë qëndruar në vend, bile nganjëherë edhe janë ulur.

Ne shikojmë gjithmonë përpara, pavarësisht se në rrugën e përparimit kemi vështirësi. Por, në qoftë se do ta sqarojmë si duhet popullin që sukseset e parashikuar do t'i arrijmë me kusht që vazhdimisht të mësojmë dhe të edukohemi që të punojmë mirë, të realizojmë prodhimin, të jemi të disiplinuar etj., me siguri populli

do të na kuptojë drejt dhe do të na ndjekë, siç na kanë ndjekur kurdoherë. Në këtë drejtim mund të themi se punohet dhe kjo shpjegohet veçanërisht me rezultatet e mira e shumë të mira që kemi arritur. Ne nuk duhet të biem kurrë në pesimizëm, duke u ndikuar nga disa të meta e vështirësi të përkohshme. Të meta, dobësi dhe shfaqje negative në punë e në jetë vërtetohen, sepse në vendin tonë ka akoma edhe njerëz të pandërgjegjshëm. Gabimet në punë nuk përjashtohen, ka, bile, shokë të mirë, që janë drejtues të Partisë dhe bëjnë gabime, por ata vazhdimisht kritikohen dhe ndreqen, sepse i kuptojnë të metat në punën e tyre.

Këto që thashë janë gjëra të njohura, por desha të theksoj se çështja është që të mobilizohemi për t'i zbatuar më mirë porositë që jep Partia. Konkluzionet që dalin nga mbledhja e Sekretariatit të Komitetit Qendror të na shërbejnë për të pasur rezultate akoma më të mira. Edukimin politiko-ideologjik të njerëzve kurdoherë ta kemi në qendër të vëmendjes, sepse ai zë vendin më të rëndësishëm në tërë sistemin e edukatës komuniste. Pa këtë edukim nuk mund të arrihen suksese në luftën që bën Partia kundër mbeturinave e ndikimeve të ideologjive të huaja. Në këtë frymë dhe rrugë që thamë të punojmë si gjer tanë edhe më mirë në të ardhmen.

*Botuar për herë të parë me
disa shkurtime në librin:
Enver Hoxha, «Për Partinë
(Përmbledhje veprash)»,
vëll. 3, f. 82*

*Botohet i plotë sipas tekstit të
nxjerrë nga procesverbali i
mbledhjes së Sekretariatit të
KQ të PPSH, që gjendet
në AQP*

T'I BËJMË SA MË MASIVE KULTUREN FIZIKE E SPORTEL DHE TË NGREME MË LART MJESHTËRINË SPORTIVE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

28 tetor 1972

Unë mendoj se njerëzit tanë kulturën fizike dhe sportet, në përgjithësi, nuk i konsiderojnë akoma në shkallën e duhur si çështje të rëndësishme që ndikojnë për zgjatjen e jetës, për rritjen dhe ruajtjen e aftësive fizike, për të luftuar sëmundjet, ngathësinë dhe «ndryshkun» që sjell kalimi i kohës në funksionimin e rregullt të organizmit të tyre. Fizkultura nënvleftësohet akoma te ne dhe duhet pranuar se jemi shumë larg kuptimit të drejtë që, pas ushqimit, ajo ka një rëndësi të jashtëzakonshme për jetën dhe shëndetin e njeriut. Të kuptuarit e rëndësisë së kulturës fizike nga masat nuk mund të arrihet thjesht me ca propagandë. Këtij

1. Në këtë mbledhje u diskutua rrëth raportit të Komitetit Shtetëror të Kulturës Fizike dhe të Sporteve, si dhe atij të Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit «Mbi zhvillimin masiv të kulturës fizike e të sporteve».

qëllimi ne nuk mund t'ia arrijmë as me urdhra të detyrueshëm për ushtrimin e saj. Po nuk vuri dorë Partia, tok me organizatat e masave, që t'u shpjegohet njerëzve dhe të binden ata për t'u marrë rregullisht me fizkulturë e sport, masivizimi në këtë fushë nuk do të arrihet si duhet.

Për përhapjen masive të fizkulturës dhe të sporteve duhet të rishikojmë edhe mënyrën e organizimit të tyre. Mua më duket se duhet, patjetër, një organizim më i mirë i punëve. Të japësh receta «të gatshme» të punës dhe të kujtosh se kështu i ke zgjidhur problemet, mund të gabosh. Në shtrimin e problemeve të përhapjes masive të kulturës fizike dhe të sporteve, veç të tjera, duhet të kemi kujdes këto dy anë:

E para, të bëjmë diferencime pür zhvillimin e fizkulturës dhe të sporteve në masat e gjera punonjëse, sepse jo të gjithë mund të ushtrojnë sportet osc të merren me të njëjtat ushtrime. Kjo do të ishte një absurditet, prandaj nuk mund të shtrohet një kërkesë e tillë, sepse nuk e lejojnë as kushtet, as moshat, as prirjet dhe as dëshirat. Për brezin e ri, ne duhet të zhvillojmë sa më shumë sportet, sidomos atletikën, gjimnastikën, notin, lojërat sportive, qitjen etj., kurse me moshat e rritura kultura fizike dhe sportet duhen zhvilluar ndryshe nga ajo që bëjnë të rinjtë, sepse dihet që edhe sportistët, kur venë 30 vjeç e lart, bien nga forma e tyre sportive dhe nuk i përballojnë dot më kërkesat e aktivitetit sportiv të moshës së re. Prandaj duhet që jo vetëm këta, por edhe 60-vjeçarët të merren me fizkulturë e sport në përshtatje me moshën dhe gjendjen e tyre fizike.

Zhvillimin masiv të kulturës fizike dhe të sporteve

të mos e kuptojmë, pra, në mënyrë dogmatike, as të mos pretendojmë me fjalë gjëra shumë të mëdha dhe në fakt të mos bëjmë asgjë, por të vrasim mendjen më tepër si t'i bëjmë ato sa më masive dhe si të ngremë më lart mjeshterinë sportive.

E dyta, masiviteti duhet të përbëjë bazën e shëndo-shë pör zhvillimin e degëve të ndryshme të sportit, pér edukimin e gjithanshëm fizik, pér përgatitjen e gjithanshme të njeriut tonë të ri, por krahas masivitetit të mos nënvlëftësojmë cilësinë sportive nü llojet kryesore të sporteve.

Kur orientojmë pör përhapjen masive të fizkulturës, duhet të kuptojmë një organizim të tillë që, prej saj, të lindin edhe sportistë të veçantë të kualifikuar. Te ne bëhet një vlerësim i njëanshëm në zhvillimin e sporteve, sidomos pör futbollin ose pör ndonjë tjeter lloj sporti. Kjo ndodh sepse pör to vërehet një interesim më i madh nga disa njerëz, të prirë vetëm pör përhapjen dhe zhvillimin e tyre, pa pyetur pör llojet e tjera të sportit. Çështja e zhvillimit jo të një, po të shumië llojeve të sportit, duhet të shikohet frontalisht, sipas kritereve të studiuara mirë dhe në bazë të një pune të organizuar me kujdes, derisa kjo të bëhet massive dhe të kemi me qindra e mijëra ekipe atletike, gjimnastike, noti, qitjeje sportive e ushtarake, të kemi me qindra e mijëra skuadra volejbolli, futbolli, basketbolli etj. Me të njëjtin ritëm të zhvillojmë edhe alpinizmin e shumë lloje të tjera sporti.

Ne nuk do të shkojmë aspak drejt zhvillimit të sportit profesionist, por atletikën, gjimnastikën, notin, qitjen, futbollin, volejbollin, basketbollin etj., duhet t'i

ngremë në një lartësi shumë më të madhe sesa sot, duke u nisur nga koncepti ynë për kalitjen e gjithanshme fizike të masave, sidomos të rinisë dhe jo nga pikëpamjet ideologjike borgjeze dhe revizioniste që fizkulturën dhe sportet i katandisin në marrëdhënie tregtare midis njerëzve. Fizkultura dhe sporti ynë kanë për qëllim edhe t'i tërheqin, t'i edukojnë dhe t'i argëtojnë masat, siç synojmë nëpërmjet kinemasë, teatrit etj., por me anë të tyre, në radhë të parë, duhet t'i kalitim njerëzit fizikisht. Të gjithë nuk mund të janë dashamirës vetëm për një lloj sporti, prandaj të mos pretendohet që të tërë të duan vetëm futbollin, volejbollin, notin, alpinizmin apo ndonjë sport tjeter. Kjo është arsyaja që kërkohet të zhvillohen shumë lloje sporti dhe njerëzit të merren me ato që u pëlqejnë më tepër.

Të gjithë duhet të jemi të interesuar për t'u marrë me fizkulturë dhe sport, por më të interesuarit nga të tërë duhet të janë të rintjtë dhe të rejet. Këtyre, që në moshën e vegjëlisë, t'u krijojmë kushtet, t'i mësojmë dhe t'i nxitim që të merren me fizkulturë, të duan sportin dhe të kaliten fizikisht. Për këtë qëllim duhet të bëjmë edhe ca sakrifica, të shpenzojmë disa fonde të domosdoshme. sepse është fjala për përgatitjen e njerëzve tanë të shëndoshë nga ana fizike dhe mendore, të aftë për ndërtimin e shoqërisë socialiste. Në rast se do të arrijmë, dhe duhet të listrojmë që fizkulturën dhe sportin t'i përhapim në masën e gjerë të rinisë, atëherë, dalngadalë, do të kalojmë në zhvillimin masiv të fizkulturës edhe për ato mosha. Të cilat, duke qenë të kalitura në rini, do ta mbajnë më të gjallë dhe më të freskët organizmin e të zgjatin jetën e tyre.

Rinia është e gatshme të merret me fizkulturë dhe me sport, siç ka qenë dhe është e gatshme të kryejë të gjitha detyrat që i vihen përpara. Ne nuk kemi asnje humbje nga të hollat që do të harxhojmë në këtë drejtim, bile më duket fare qesharake kur diskutohet për dhënien e disa materialeve e mjeteve sportive për të rinxjtë që merren me atletikë, gjimnastikë, qitje, futboll, volejboll etj. Po të mendojmë se me përhapjen më të gjerë të fizkulturës në fabrika, në kooperativa bujqësore e gjetkë do të kemi njerëz më të shkathët, më rezistentë, më të fortë dhe sa më pak të sëmurë, që do të punojnë me ritme më të larta dhe do të bëjnë marshime ushtara-ke, pa e ndier lodhjen, ç'kuptim ka kursimi i të hollave për blerjen e disa materialeve sportive, për ngritjen e disa fushave sportive apo palestrave dhe për sigurimin e mjeteve të tjera për sportin, shumica e të cilave bëhen me dru dhe hekur? Të matësh shtrënguar disa shpenzi- me të vogla, përpara përfitimeve shumë më të mëdha që sjellin ato, do të thotë t'i bësh llogaritë gabim.

Kur analizojmë humbjen e orëve të punës për ar-sye të paftësisë së përkohshme, që shkaktohet nga disa shqetësime të vogla, si dhembja e kokës, e dorës apo e një pjese tjetër të trupit dhe pas kësaj llogaritim dëmet që pëson prodhimi dhe ekonomia në tërësi, arritmë në përfundime shqetësuese. Nga se vijnë këto mungesa në punë? Sepse shumë nga njerëzit tanë nuk janë të përgatitur si duhet nga ana fizike, prandaj, krahas organizimit me mend të fizkulturës dhe sporteve, si dhe punës më të thelluar që duhet bërë për propagandimin e tyre, të mos jemi dorështrënguar në dhënien e disa mjeteve monetare të domosdoshme.

Rinia shkollore duhet të merret me kulturën fizike sipas një programi të studiuar në mënyrë serioze dhe, në krahasim me orët e tjera të mësimit, fizkultura të mos konsiderohet si «vrimia e fundit e kavallit». Në të gjitha shkollat e sistemit tonë arsimor, realizimi i programeve të edukimit fizik duhet të vlerësohet më drejt dhe kultura fizike e sportet të çmohen ashtu siç i ka përeaktuar Partia — faktorë të rëndësishëm të edukimit të gjithanshëm komunist të rinisë sonë shkollore. Përpara shkollës sonë sot nuk duhet shtruar problemi i futjes së ushtrimeve fizike dhe të sporteve, por pjesë-marrja sa më e gjerë dhe aktive e rinisë shkollore në fizkulturë e sport dhe rritja sa më e lartë e nivelit sportiv dhe e mjeshtërisë sportive. Ne, me fjalë, themi se po punojmë në këtë drejtim, por në të vërtetë më duket se nuk veprojmë si duhet. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës ta kuptojë mirë rëndësinë e madhe të fizkulturës për të tashmen dhe për të ardhmen e brezave të Shqipërisë, ajo duhet të marrë masa serioze për një kuptim më të shëndoshë të këtij problemi nga organet e saj, drejtoritë e shkollave dhe arsimtarët, për të shtuar ndihmën dhe për të plotësuar kërkesat e arsyeshme, si dhe për të vënë disiplinë të rreptë në këtë lëndë të rëndësishme mësimore. Për këtë qëllim duhen sigurisht edhe mësues. Ne tani kemi mësues të posaçëm fizkulture në të gjitha shkollat e mesme, si dhe në ato 8-vjeçare të qyteteve. Detyra jonë tani është t'i përgatitim e t'i kualifikojmë më mirë ata, kurse në shumë shkolla 8-vjeçare fshati nuk kemi akoma mësues të tillë dhe nuk mund t'i përgatitim ata menjëherë, pse «këmbët duhet t'i shtrijmë sa kemi jorganin». Prandaj

në këto shkolla, për mësuesit që caktohen të bëjnë edhe mësimin e edukimit fizik, duhet të organizohen kurse për përgatitjen e tyre tekniko-profesionale.

Për organizimin e punës të kemi kujdes që të përcaktojmë më mirë llojet e sportit që duhet të zhvillojmë me rrininë shkollore dhe me punëtorët e fshatarët jashtë shkollës. Në këtë drejtim duhet të kemi një orientim të qartë dhe vitin tjetër në programet e shkollave të kulturës fizike të parashikojmë përgatitjen e trajnerëve jo vetëm për futbollin, por edhe për llojet e tjera të sportit. Sipas mendimit tim, ai që do të përgatitet si trajner për ekipe të futbollit nuk mund të bëhet në të njëjtën kohë i tillë edhe për atletikën e lehtë ose për një grupim sportesh, të cilat mund të kenë një karakter pak a shumë të përafërt. Në qoftë se shkolla e fizkulturnës është akoma e ngushtë për të përgatitur specialisht që kërkojmë, le ta zgjerojmë akoma dhe të mos qëndrojmë vetëm në përgatitjen që bëhet sot në institutin e kulturës fizike «Vojo Kushi».

Kur u shqyrtua ky problem në Qeveri, ju, shokët që ju takon të merreni me këto çështje, duhet t'i kishit zbërthyer sa më shpejt orientimet që ju dhanë atje. Afër 300 studentë që mësojnë në institutin e kulturës fizike «Vojo Kushi» janë pak, mendoj unë, për të ndihmuar sa duhet zhvillimin e kulturës fizike dhe të sporteve në vendin tonë, prandaj me çdo kusht duhet të shtojmë numrin e tyre. Po të vazhdojnë ritmet e zhvillimit të sportit, kështu si deri tanë, do të thotë se nuk po e kuptojmë mirë rëndësinë e këtij problemi. Ne, si marksistë, kur na këshillon Partia, bindemi më shpejt për t'u marrë vetë me fizkulturë e sport, por në masat e

gjera të popullit kjo është më e vështirë të realizohet, me to duhet bërë më shumë punë derisa ato të krijojnë bindjen e plotë për nevojën e domosdoshme për t'u marrë me fizkulturë e sport, derisa kjo veprimitari t'u bëhet shprehi. Që t'ia arrijmë me sukses këtij qëllimi, lypset të përgatitim më shumë kuadro të aftë dhe të pasionuar për kulturën fizike e sportet.

Unë nuk mendoj se duke i dhënë një hov më të rradhë masivizimit të sporteve, të gjithë njerëzit do të bëhen sportistë të klasit të parë, por kam bindjen se nga radhët e shumta të njerëzve që do të merren me sport, do të dalë në dukje ajka e tyre. Çfarë fitimi do të kemi nga kjo ajkë? Dobinë ne nuk e llogaritim me të holla, siç bën kapitalisti, por llogaritim kalitjen fizike të popullit, rritjen e mëtejshme të aftësive fizike të tij, përfitim ky kolosal që nuk mund të çmohet me asnjë vlerë materiale apo monetare. Rreth sportistëve të përgatitur do të grumbullohen kështu shumë njerëz të tjerë që do të kenë dëshirë të merren me ushtrime fizike dhe do të krijojmë në ta pasionin për t'u marrë me fizkulturë e sport, si, bie fjala, me vrapimin 100 m., 400 m. etj., me ushtrimet në veglat gjimnastikore, me notin, qitjen apo lojërat sportive. Në këtë mënyrë sporti ynë do të bëhet më spektakular. Kështu do të arrijmë që në rrugët e Tiranës dhe gjetkë të mbolidhen me mijëra njerëz për të pritur djemtë e vajzat që konkurojnë në aktivitete të ndryshme sportive. Sot, kur bëhen garat e çiklizmit, te ne asnjëherë nuk kam vënë re që të grumbullohen anës së rrugëve e bulevardeve njerëz me shumicë për të parë, bile as afër vendit, ku tabela shënon «nisje» apo «mbërritje», nuk shikon më shumë se 50-100 veta dashamirë

të çiklizmit. Njerëzit tanë shkojnë më tepër për të parë ndeshjet e futbollit, pse ky lloj sporti është bërë populor dhe pëlqehet shumë te ne. Ka pastaj shumë njerëz që ndjekin me pasion një skuadër të caktuar dhe dëshirojnë që ajo të fitojë, që admirojnë këtë ose atë lojtar, i cili përdor bukur e me teknikë topin etj. Nuk përrash-tohen midis gjithë këtyre edhe disa tifozë të sëmurë, që duhen edukuar politikisht.

Ne duhet t'i zhvillojmë fizkulturën dhe sportet deri edhe në fushat e vogla e në këndet sportive të lagjeve, të fshatrave etj. Në këto fusha të vogla sportive, qoftë edhe në ato që ndodhen ndërmjet shtëpive, trajnerët tanë, njerëzit më të kualifikuar në llojet e ndryshme të sportit, duke ndjekur me kujdes deri ndeshjet e kalanëve e të rinjve të vegjël nëpër shkolla e lagje, do të zgjedhin midis tyre ata që kanë prirje për këtë ose për atë lloj sporti. Më të dalluarit ne mund t'i futim në shkolla të veçanta për t'i përgatitur si sportistë, trajnerë dhe propagandistë aktivë të sportit.

Edhe lojërat popullore si „kalaja dibrançe“ etj., kanë karakter sportiv, por në to, sipas mendimit tim, spikat më tepër qëllimi i argëtimit, i çlodhjes aktive të rinisë dhe i zhvillimit fizik të saj, prandaj edhe për organizimin e tyre duhet të ketë më tepër iniciativë që të mësohen dhe të përhapen në masat. Nëpërmjet këtyre lojërave mund të futen edhe disa ushtrime gjimnastikore që ndihmojnë për ruajtjen e shëndetit. Sidoqoftë, në radhë të parë, t'u jepet prioritet sporteve.

Gjimnastika e mëngjesit që pati filluar të bëhej në të gjitha qendrat e punës e të prodhimit, dalngadalë gati po harrohet. Kjo ka ndodhur nga sedra mikrobor-

gjeze e disa nëpunësve që u vjen «zor» të dalin 10 minuta para orarit zyrtar për të bërë gjimnastikë, se mos tallen me ta njerëzit që i shikojnë. Gjimnastikën e mëngjesit mund ta bëjnë të gjithë, pa përjashtuar as të moshuarit që i kanë kaluar të 60 vjetët, prandaj nuk duhej hcqur emisioni i gjimnastikës së mëngjesit nga radioja. Çfarë humbet njeriu që, porsa fillon gjimnastika e mëngjesit në radio, të ngrihet dhe të bëjë disa ushtrime? Sigurisht, asgjë nuk humbet, përkundrazi fiton, pse ajo të mban të freskët. Po ta ushtrosh fizkulturën, kjo gradualisht të bëhet një shprehi e zakonshme. Veç gjimnastikës së mëngjesit, njerëzit mbi 45 vjeç, në ditët e pushimit, mund të bëjnë ekskursione dhe marshime prej disa kilometrash, që të kaliten fizikisht dhe të përgatiten për stërvitjet ushtarake, të cilat, sipas ligjit, janë të detyruar t'i bëjnë edhe ushtarët, nënoficerët dhe oficerët në rezervë. Këto nuk do të bëhen me komandë, si marshimet ushtarake, por në formë shëtitjeje me lëvizje të lira pak a shumë të gjata, duke biseduar e kënduar në grupe.

Edhe për stërvitjet ushtarake fizkultura duhet të parashikohet në program si pjesë e tij me rëndësi. Më duket se kjo është futur në programin e edukimit ushtarak në shkolla. Nëndrejtori i shkollës, që është ushtarak dhe i ngarkuar me përgjegjësinë e edukimit ushtarak të nxënësve, duhet të ketë kujdes për këtë çështje, ndryshe ai nuk mund ta kryejë detyrën.

Ju, shokët e Komitetit të Kulturës Fizike dhe të Sporteve, keni bërë mirë që krijuat kolektivat fizkulturorë e komitetet e kulturës fizike në bazë. Këta organizma duhet të punojnë me nend në kokë, domethënë

njerëzit që zgjidhen në ta ta kuptojnë brenda realitetit tonë zhvillimin e kulturës fizike dhe të sporteve masive e jo «të fluturojnë» me llafe, ndërsa në fakt të mos bëjnë asgjë. Sa më mirë ta bëjmë këtë punë, aq më shumë dobi do të kemi. Për ata që janë të rinj dhe kanë mundësi të merren më shumë me fizkulturë e sport, të ngulin këmbë dhë të bëjnë diçka më të frytshme për t'i ndihmuar. Shoku Manush tha se në Tiranë, me krijimin e klubeve sportive «Dinamo», «Partizani» e «17 Nëntori» vëmendja është përqendruar vetëm në to, prandaj kujdesi i duhur për aktivitetet masive nuk ndihet. Në asnjë mënyrë nuk duhet hequr dorë nga aktivitetet masive, bile edhe brenda këtyre klubeve duhen aktivizuar sa më shumë elementë të rinj, sepse, siç dihet, nga masiviteti del cilësia sportive. Për shembull klubit «Dinamo» ka mbledhur një numër të kufizuar vajzash që luajnë basketboll ose volejboll. Po si ky klub, ashtu edhe të tjera, duhet të grumbullojnë rrëth vetes jo vetëm nga një skuadër, por disa skuadra. Në shkollat dhe në qendrat e punës të Tiranës ka disa qindra vajza të tjera që mund të aktivizoheshin në këtë lloj sporti, por, meqenëse s'është kujdesur njeri, ato nuk bëjnë gjë. Veç klubeve të njohura, skuadra të ndryshme sportive mund të krijojnë edhe shumë kolektiva fizkulturorë të uzinave e fabrikave, të shkollave, bile edhe të kooperativave bujqësore. Këto mund të krijohen jo vetëm në Tiranë e në rrethe të tjera të mëdha, por edhe në rrethe më të vogla.

Organizimin e fizkulturës dhe të sportit masiv të mos e lëmë vetëm në dorën e një komiteti, qoftë ky edhe me një, me dy ose me pesë instruktorë. Nuk mund të kërcohët që vetëm komitetet fizkulturore ta rregu-

Ilojnë gjendjen, prandaj të përdorim të gjitha format organizative, të gjithë organizmat dhe shoqatat që janë, si dhe të tjera që mund të krijojen nën drejtimin e këtij komiteti. Në qoftë se në çdo lagje të qytetit të Gjirokastrës ka, ta zëmë, nga tri skuadra futbolli të formuara prej të vegjilish që luajnë andej-këtej, le të krijojmë një këshill të këtyre skuadrave që të kujdeset për aktivizimin e rregullt të tyre, duke qenë në patronazh të klubit «Luftëtar». Pas kësaj punc të ngarkojmë atje, sipas nevojës, një, dy ose tre njerëz të përshtatshëm për të shikuar nevojat e këtyre skuadrave, sepse në tërë qytetin mund të jenë, sfala vjen, 60 skuadra futbolli sportistësh të vegjël që luajnë në të tëra lagjet dhe kanë disa nevoja të vogla që u duhen plotësuar. Kështu mendoj se do të krijojen mundësi për një organizim sa më të mirë për t'i bërë sa më masive fiskulturën dhe sportin.

Ju, shoku ministër i Arsimit dhe i Kulturës, për disa gjëra që keni vendosur na thatë «do t'i shikojmë», «do t'i studiojmë» etj., por, për çështjet që vendosët, studimin duhej ta kishit bërë më parë. Tani është koha që vendimi të zbatohet pa hezituar as për gjënë më të vogël, të vështrojmë dhe të ecim përpara pa zvarritje e ngurrime në këto çështje. Këtë vërejtje nuk e kam vetëm për ju, por edhe për shokët udhëheqës të dikastereve të tjera. Brenda kompetencave që keni ju dhe ministritë e tjera, vendosni dhe veproni. Vija e Partisë dhe interesit i popullit për sektorët që drejtoni, janë të qartë, prandaj për vendimet që merrni dhe për zbatimin e tyre jeni ju përgjegjës. Në qoftë se personat zyrtarë kompetentë janë të bindur për hapjen e dyqaneve të shitjes së materialeve sportive, atëherë kjo

gjë të vendoset dhe, pasi të parashikohen fondet në buxhetin e dikasterit përkatës, të hapen dyqanet dhe të shiten topa e të tjera sende të nevojshme sportive. Të pyesësh njërin apo tjetrin për çështje që duhet t'i bësh vetë, do të thotë që këto të mos kryhen, ose disa punë që mund të përfundojnë shpejt të zvarriten së tepërm. Sigurisht nuk do të bëhen shpenzime vend e pa vend që të dëmtojnë buxhetin e shtetit. Asnjë nuk të kritikon për masa e shpenzime të arsyeshme, përkundrazi cilido ka për të të thënë: Shumë mirë ke bërë për iniciativën e drejtë që ke marrë. Pra, derisa vendimi është marrë, brenda sferës së kompetencave që keni, përse të pyetni të tjerët për zbatimin e tij?

Si përfundim jam i mendimit që fizkultura dhe sporti në vendin tonë, me gjithë të metat që vërehen, kanë filluar të ecin përpara, prandaj nuk ka arsyë të jemi pesimistë për perspektivën e tyre. Për zbatimin e detyrave të kalitjes fizike masive të punëtorëve, të fshatarëve dhe të nëpunësve, përvèç sa përmenda, mendoj të kemi parasysh disa kriterë:

Së pari, përgatitja fizike me anë të gjimnastikës së përditshme të bëhet sa më e larmishme. Disa mund ta bëjnë atë individualisht duke dëgjuar programet e radios. Në shkolla, në ushtri, në zyra e në institucione të ndryshme ajo mund të bëhet fare mirë në mëngjes para fillimit të mësimeve, të stërvitjes apo të punës. Kështu mund të veprohet edhe në shumë qendra industriale e kooperativa bujqësore para se të fillojë turni përkatës. Në disa lloje punësh ajo mund të bëhet edhe gjatë orarit që të vlejë për çlodhje aktive, por nuk është me vend të detyrohen njerëzit që pas punës të bëjnë gjim-

nastikë detyrimisht të gjithë së bashku. Pas 8 orë pune 45-vjeçari nuk të vjen në gjimnastikë, se e ndien lodhjen më shumë nga 20-vjeçari, që është gati të vçjë e të luajë edhe 2 ose 3 orë. Së dyti, fizkultura të zhvillohet në përshtatje jo vetëm me moshën, por edhe me gjendjen shëndetësore të njerëzve dhe, së treti, të zhvillohet në përputhje me dëshirat dhe prirjet e njerëzve.

Ne kemi shumë dëshirë dhe shpresë që fizkulturën dhe sportin masiv t'i çojmë akoma më përparrë në gjerësi dhe cilësi. Vendimet dhe masat organizative që janë marrë duhet të ndihmojnë fort që zhvillimi masiv të kuptohet më mirë, pse kështu do të kemi akoma më shumë suksese. Sigurisht përnjëherësh nuk do ta arrij më masivitetin që kemi në program, por jemi të bindur se me kohë ky qëllim do të plotësohet në mënyrë të kënaqshme.

*Botuar për herë të parë me
ndonjë shkurtim në librin:
Enver Hoxha, "Raporte e
fjalime 1972-1973". f. 159*

*Botohet i plotë sipas tekstit
të nxjerrë nga procesverbali i
mbledhjes së Sekretariatit të
KQ të PPSH, që gjendet
në AQP*

AKSIDENTET SHMANGEN PO U ZBATUAN RREGULLORET

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

28 tetor 1972

Për të shmangur sa më shumë që të jetë e mundur aksidentet që u ndodhin punonjësve në punën e tyre prodhuese, mendoj të kemi parasysh dy çështje me rëndësi, që shkojnë paralelisht njëra me tjetrën: e para, punën edukative me punonjësit dhe e dyta, marrjen e masave parandaluese tekniko-organizative. Asnjëra nga këto dy anë të të njëjtë problem nuk ecën pa tjetrën. sepse mund të merren të gjitha masat tekniko-organizative që janë të nevojshme për të shmangur ose pakësuar aksidentet në punë, por, po të mos kuptohet domosdoshmëria e zbatimit të përpiktë të tyre, me një disiplinë të rreptë nga ana e punëtorëve, nga ana e Partisë, e bashkimeve profesionale dhe e administrative të ndërmarrjeve, këto masa nuk do të vihen si duhet në zbatim.

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për aksidentet në punë.

Ne, në të dy drejtimet e mësipërmë kemi akoma dobësi, prandaj ndodh që të na shkaktohen edhe aksidente, bile edhe të rënda. Kjo situatë është një sinjalizim shqetësues e serioz. Edhe sikur të mos flasim për vdekjet nga aksidentet në punë, në sektorët për të cilët janë dhënë shifrat në raport, po të shikojmë vetëm rastet e tjera që kanë sjellë dëmtimin e shëndetit, gjymin e njerëzve apo vuajtjet e tyre fizike, si dhe dëmet e mëdha që ka pësuar ekonomia popullore, del nevoja e forcimit të punës në drejtim të edukimit të punonjësve dhe e marrjes së masave tekniko-organizative.

U tha këtu se nga ana e Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave janë marrë mjaft masa për mënjanimin e aksidenteve në punë. Ashtu është, unë mendoj se nga ana e kësaj ministrie në këtë drejtim ka seriozitet, po prapëseprapë mbetet akoma shumë për t'u bërë, nga kjo dhe nga ministritë e tjera. Për plotësimin e kushteve të mira të punës janë caktuar edhe fondet përkatëse, por, po të jetë nevoja, mund të disponojmë edhe të tjera për sigurimin e jetës dhe të shëndetit të punëtorëve. Për këtë problem kaq të madh duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme dhe, atje ku vihet re se nuk përdoren fondet e caktuara, të mbahet qëndrim ndaj neglizhencave.

Unë jam dakord që Ministria e Industrisë dhe e Minierave, e Ndërtimit, e Komunikacioneve etj. kanë për detyrë të marrin masa tekniko-organizative kundër aksidenteve në prodhim, por, përvç organeve shtetërore, nuk mund të shkarkohen nga përgjegjësia as organizatat-bazë të Partisë dhe as ato të bashkimëve profesionale. Partia dhe bashkimet profesionale duhet të

lozin rolin që u përket në këtë drejtim. Kur udhëzimet e dhëna nuk u shpjegohen punëtorëve dhe kur nuk ushtrohet kontroll për zbatimin me rreptësi të tyre, mendoj se nuk duhet të ngarkohet me përgjegjësi vetëm Ministria e Industrisë dhe e Minierave ose ndonjë ministri tjetër. Në raste të tilla ne t'u kërkojmë llogari si këtyre dikastereve, ashtu dhe personave zyrtarë të ndërmarrjeve apo organizatave që nuk kryejnë si duhet detyrat që u takojnë. Këtu u tha, për shembull, se Ministria e Industrisë dhe e Minierave u ka siguruuar kaska të gjithë punëtorëve të pyjeve të Pukës, ndërsa ata nuk i vënë. Në rast se nga mosvënia e kaskës do të humbiste jetën ndonjëri prej tyre, këtu nuk do të ishte faji i ministrisë, por i organizatës-bazë të Partisë, i bashkimeve profesionale të ndërmarrjes dhe i vetë punëtorëve. Në qoftë se në Minierën e Kurbneshit, për shembull, minatorët nuk suten nën tokë me maskat që u janë dhënë, as këtu nuk mund t'i hidhet faji ministrisë, po atyre që thashë.

Në përcaktimin e shkaqeve të aksidenteve në punë të mos harrojmë fajin e vetë punëtorit të aksidentuar që, për pakujdesinë e rëndë nga ana e tij, shkelen udhëzimet e dhëna. Nuk është e drejtë që të ngarkohet me përgjegjësi në çdo rast vetëm ndërmarrja, inxhinieri apo tekniku. Të punohet që edhe punëtorët të jenë më të vëmendshëm për ruajtjen e jetës së tyre.

Disiplinën për shmangien e aksidenteve në punë duhet ta futim thellë në ndërgjegjen e punëtorëve, të cilëve t'u shpjegojmë konkretisht që pakujdesia më e vogël mund t'u rrezikojë jetën. Brigadieri të kontrollojë që të gjithë minatorët të suten me maska në galeri.

Vetë ai të hyjë i fundit dhe, kur të shikojë që ndonjëri nuk e ka me vete maskën, ta kthejë imbrapsht për ta marrë, pastaj të fillojë punën. Në këtë mënyrë t'i mësojmë njerëzit, që ta ruajnë jetën dhe shëndetin nga rreziqet që mund t'u ndodhin.

Unë jo rastësisht pyeta se çfarë masash edukative e propagandistike u morën kur ngjau aksidenti i fundit në Kurbnesh e konkretisht, jo në teori. Me fjalë të tjera, desha të di se ç'u bë për edukimin individual, duke shfrytëzuar fatkeqësinë që ndodhi në këtë minierë.

Jam dakord me gjithë ato analiza që u bënë atje. Por, po të isha unë, do të lajmëroja përnjëherë gjithë punëtorët e minierës që pas punës të mbahej disa minuta zi për shokun që u vra. Pastaj, do të shpjegoja pse u vra, duke analizuar shkaqet, mungesat e ndërmarrjes, pakujdesinë e treguar nga shoku i vrarë etj., etj. Do të theksoja se si shkaktohen aksidentet nëpër miniera, kur nuk respektohet disiplina e punës, kur nuk zbatohen rregulloret etj. Kjo nuk do të ishte vetëm një respekt për shokun e rënë, por edhe një mësim me vlerë të madhe për ruajtjen e jetës së njeriut. Pastaj, do të bëja ato punë që bënë ata, duke thirrur drejtorin, duke mbledhur organizatën-bazë, që të tërhiqej seriozisht vëmendja në tërë punëtorët për atë që ngjau. Kjo bën më shumë efekt sesa mënyrat e zakonshme burokratike që praktikohen, sa për të thënë se «bëmë këto osc ato punë, por s'ke ç'bën, kjo ngjau» etj., etj.

Jo vetëm kaq, por, është e nevojshme që minatorëve t'u thuhet se po t'i bjerë diçka në kokë njeriut, ai mund edhe të mos vdesë, por edhe mund të mbetet në vend, prandaj duhet të kenë kujdes në këtë osc në atë

drejtim. Për këtë edhe pyeta nëse u thuheshin këto minitorëve apo nuk u thuheshin. U shpjegohej çfarë rreziku do të ndodhte po të hapet koka? Me këtë rast atyre mund t'u sqarohej pak anatomia e kokës, natyrisht jo me hollësi, siç bëhet, fjalë vjen në Fakultetin e Mjekësisë, po në mënyrë të thjeshtë, që të kuptojnë mirë se, kur i zë shpella, u hapet kaska, preket truri dhe mund të vdesin, ose të paralizohen e të tjera gjëra të tilla. T'u thuhet se po të shtypen në gjoks, mund të ndodhin këto e ato pasoja të rrezikshme etj. Dua të them se punëtorëve të rinj, bashkë me zanatin, duhet t'u mësohen edhe rreziqet që mund të rrjedhin prej tij, po të mos zbatohen rregullat e mbrojtjes, prandaj të binden për nevojën eshmangies së këtyre rreziqeve. Pastaj, si të bëhen të gjitha këto, të shikoni ju se ai nuk do të futet më në galeri pa kaskë në kokë.

Po nuk u zbatuan rregulloret, do të ketë patjetër aksidente. Neve nuk na duhen «trimat» që, për mendje-lehtësinë e tyre, rrezikojnë veten, pa qenë aspak nevoja. Një qëndrim i tillë ndaj jetës dhe shëndetit s'është aspak trimëri, po marrëzi. Njeriu të jetë guximtar kur duhet dhe si duhet e jo të sakrifikohet kot, duke menduar: «Nuk më gjen gjë mua që kam punuar 20 vjet, pa i zbatuar rregullat e teknikës së sigurimit». Këta njerëz harrojnë që aksidenti vjen papritur, pikërisht kur nuk ke marrë masat për mënjanimin e tij dhe kur nuk ke vëmendjen e duhur për t'u ruajtur. Eksperiencia në punë duhet ta bëjë punëtorin më të kujdeshshëm për të marrë të gjitha masat e jo ta vëré në gjumë ndaj rreziqeve që i kanosen.

Bashkimet profesionale nuk kanë vetëm detyrën

që të ndihmojnë Partinë në punën propagandistike, por të vënë të gjitha forcat që kjo propagandë të kuptohet dhe të vihet në jetë, me një disiplinë të hekurt, nga të gjithë anëtarët e organizatës.

Të lusfohen ashpër prirjet liberale, të sentimentalistët mikroborgjez dhe të familjaritetit të sëmurë që u hapin shteg shkeljeve të rregullave për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të punëtorëve. Nuk është i drejtë qëndrimi i disa punëtorëve që, kur u dërgua në gjyq personi zyrtar për shkeljen e rregullave të mbrojtjes në punë, ata i dërguan letra gjyqit, sikur «fajtorët e aku-zuar s'paskan faj, qenkan njerëz të mirë» etj. Kjo mënyrë veprimi është e huaj për punëtorët tanë të edukuar nga Partia. Çështjen e fajësisë, të llojit dhe të masës së dënimit, duhet ta vendosë gjykata e zgjedhur nga populli, në bazë të ligjeve në fuqi. Gjyqi, kur s'janë rrëthanat e parashikuara në Kodin Penal, nuk mund të japë dënim me kusht sipas dëshirës së disa njerëzve. Gjyqtarëve nuk u lejohet të lëvizin herë nga e djathja e herë nga e majta dhe të dënojnë ndonjërin më lehtë nga ç'duhet, sepse kështu dashkan disa punëtorë të një ndërmarrjeje ose ta dënojnë më rëndë nga ç'duhet, sepse drejtuesit e punës, pa arsy, dashkan të jepet një goditje shembullore. Gjykatat duhet të vendosin vetëm sipas ligjit, sipas provave që kanë në dosje dhe sipas bindjes së formuar sa më objektivisht nga shqyrtimi i të gjitha rrëthanave të çështjes, në tërësinë e tyre. Që punëtorët ta kuptojnë mirë këtë gjë, duhet bërë me ta një punë e madhe edukative nga Partia dhe nga bashkimet profesionale, të cilat, bashkë me gjykatën, t'u shpjegojnë edhe këto çështje.

Partia dhe pushteti popullor kanë vënë detyra me shumë rëndësi për riaftësimin fizik dhe profesional të invalidëve që aksidentohen. Dikasteret e ndryshme kanë detyra të miëdha në këtë drejtim. Natyrisht, pasi shërohen, invalidët sistemohen në punë më të lehta që rezervohen për ta, në përshtatje me gjendjen shëndetësore. Por Partia dhe, në mënyrë të veçantë, bashkimet profesionale kanë për detyrë që i aksidentuarit të ngrihet moralisht, mbasi atij ngjarja i lë mbresa të vecanta. Pavarësisht se paga e re e punës, bashkë me pensionin e invaliditetit mund ta plotësojnë pagën e mëparshme të invalidit, ky duhet të nxitet për të mos qëndruar në vend, por brenda mundësive, të mësojë një mjeshtëri të përshtatshme që është në gjendje të ushtrøjë. Që të arrihet kjo, invalidi duhet shtyrë përpara; ai duhet të ngrihet politikisht dhe moralisht në një shkallë të tillë sa t'i thotë drejtorit të ndërmarrjes apo shefit të sektorit: «Dua të kualifikohem për të punuar më tepër, nuk më pëlqen të rri në punë pa telashe».

Bashkimet profesionale të ngrenë zërin dhe të ndërhyjnë në ndërmarrje, në komitetin ekzekutiv e në ministri, në rast se shohin që të aksidentuarit lihen pas dore, nuk sistemohen në punë sipas grupit të invaliditetit ose nuk u jepen mundësitë për të mësuar në kurse disa mjeshtëri të përshtatshme pér gjendjen e tyre.

Ju, shokë të Këshillit Qendror të Bashkimeve Profesionale, përmendni në raportin tuaj organizimin e Sigurimeve Shoqërore Shtetërore, por nuk thoni se çfarë detyrash mund t'u caktohen atyre pér mënjanimin e aksidenteve në punë. Sigurimet Shoqërore Shtetërore

nuk janë si zyra të bankës, që vetëm të caktojnë shumën e pensionit të punëtorit ose nëpunësit, në bazë të dokumenteve që paraqiten nga i interesuari ose nga qendra përkatëse e punës dhe nuk shtyhen më tej kësaj detyre. Ju nuk na thoni çfarë del nga eksperiencia e punës për sa i përket nevojës së aktivizimit të këtyre organeve, çfarë kompetencash të tjera mund t'u japim atyre, si për mbrojtjen në punë, për riaftësimin e të aksidentuarve etj. Ju mund t'i keni diskutuar këto çështje, por neve nuk po na i bëni të ditura mendimet tuaja që të jemi në gjendje të gjykojmë e t'u themi për çka mund të keni të drejtë e për çka jo. Në nuk jemi specialistë që të shprehemi me kompetencë për të gjitha problemet që dalin.

Në përgjithësi, punën me udhëzimet dhe me kontrollin e zbatimit të tyre e bëjmë dobët, prandaj na duhet të gjallërojmë mbikëqyrjen dhe inspektimin, për mbrojtjen në punë. Kur të jemi të rreptë ndaj shkeljeve të rregullave të sigurimit teknik, atëherë do të shikojmë që aksidentet në punë do të ulen. Me masat që do të merren në të ardhmen, kam bindjen e plotë se të metat dhe shkeljet që vërehen do t'i zhdukim dhe fatkeqësitet do të na pakësohen.

Me kaq i japim fund këtij problemi jashtëzakonisht të rëndësishëm që ka të bëjë me jetën dhe shëndetin e punonjësve tanë.

Etohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH, që gjendet në AQP

ZBATIMI I DREJTE I DIREKTIVAVE KËRKON EDHE ZBËRTUHMIN E KUPTIMIN TEORIK TË TYRE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

30 tetor 1972

Edhe unë si shokët jam dakord me përmbajtjen e raportit që na është paraqitur, ku pasqyrohet veprimtaria e zhvilluar nga Partia dhe nga masat për t'u thelluar në problemet që u ngritën në fjalimin e Matit. Këto probleme për Partinë, për pushtetin dhe për popullin janë të përhershme, prandaj, bashkë me masat e popullit, është e kuptueshme që Partia, në radhë të parë, duhet të vërë kujdesin më të madh që ato të trajtohen e të zgjidhen vazhdimit sa më drejt.

Është e domosdoshme të kuptohet se problemet e shtruara në këtë fjalim kanë të bëjnë me teorinë dhe me praktikën tonë revolucionare. Çështjet që u shtruau

1. Në këtë mbledhje u shqyrtua rapporti informativ i paraqitur nga aparati i Komitetit Qendror të Partisë "Mbi disa probleme që dalin nga punimi i fjalimit që shoku Enver Hoxha mbajti në Mat".

atje ishin rezultat i një analize të përhershme që ne u bëjmë gjendjes së Partisë, ngritjes së saj ideologjike dhe politike, problemeve ekonomike dhe atyre organizative, me sukseset dhe me të metat që ekzistojnë në këto drejtime. Në atë fjalim u bë përpjekja që të vihen në dukje disa nga këto aspekte, duke theksuar, për sa ishte e mundur, jo vetëm anën praktike të çështjes, por edhe atë të teorisë sonë revolucionare.

Në fjalim janë sjellë edhe disa nga tezat e Leninit dhe të Stalinit, që përbëjnë orientimin kryesor të Partisë sonë dhe i përshtateshin qëllimit të caktuar. Por me këto teza synohej edhe një qëllim tjeter: me problemet që u trajtuan në fjalim, me rrahjen e tyre nga Partia dhe nga organizatat e masave, të nxiteshin te komunistët dhe te punonjësit diskutime në planin politik dhe sidomos ideologjik. Mendova se ishte rasti që, duke zhvilluar debate, tezat e cituara nga Lenini dhe nga Stalini t'i shërbenin Partisë për t'u thelluar më shumë në anën teorike të problemeve dhe jo vetëm të provohej, por, sidomos, të nxitej Partia, e cila tashmë nuk është si në stadin e vet fillestar, që një problem që i del përpara për ta zgjidhur, të mos e trajtojë vetëm nga ana thjesht praktike, po ta zbërthejë mirë edhe nga ana teorike.

E bëri këtë Partia jonë? Në vija të përgjithshme, problemet e ngritura në këtë fjalim u diskutuan kudo në fryshtë partie. Në praktikë, në diskutimet e saj të zjarrta e të drejta, Partia u udhëhoq nga mësimet e marksizëm-leninizmit, të cilat, siç e dimë, nga dikush më shumë e dikush më pak, janë përvetësuar. Po qëllimi ishte që problemet e shtuara të trajtoheshin dhe

teorikisht, gjë që tani është e imundur të bëhet, pasi Partia ka sot jo vetëm një eksperiencë të madhe të situar nga praktika e saj revolucionare, por edhe nga ana teorike ka një nivel të kënaqshëm zhvillimi. Nga Shkolla e Partisë «V.I. Lenin», nga kurset e ndryshme që janë zhvilluar e po hapen kudo, si dhe nëpërmjet mësimeve individuale që merr vazhdimisht çdo komunist, sot kemi jo me mijëra, por me dhjetëra mijë shokë, të cilët mund t'i trajtonin edhe teorikisht problemet e ngritura në diskutimet e tyre.

Le të marrim një nga çështjet që trajtohet atje, atë të shkurtimit të aparateve. Disa e kuptuan këtë çështje, disa nuk e kuptuan etj., disa dikastere hezituan të bëjnë shkurtime, disa nuk hezituan etj., por e vërteta është se nuk pashë të ngrihej një shok që ta trajtonte teorikisht këtë problem, të argumentonte përsë duhen shkurtuar nga aparatet tona gjithë ata punonjës të panevojshëm që nuk prodhojnë të mira materiale, përsë ne duhet të kemi vazhdimisht në administratat tona sa më pak njerëz joprodhues, të shpjegonte se këta njerëz jo vetëm janë prodhuesit e burokracisë, të letrave, të gjithfarë pengesave etj., etj. që as kjo nuk është e nijastueshme, por edhe se mbajtja e tyre pa nevojë përbën një rrezikshmëri të madhe për të ardhmen e socializmit.

Ekzistanca e njerëzve të tepërt nëpër aparatet do të thotë përqendrim i një morie funksionarësh apo rrogëtarësh, të cilët futin në jetën e vendit tonë, në një mënyrë ose në një tjetër, ndjenjën e indiferentizmit, të pasivitetit, bëjnë të lindë burokracia, nxjerrin pengesa të panumërtë dhe krijojnë rreziqe të mëdha që mund të çojnë deri në transformimin e sistemit tonë

shoqëror. Po të futeshin thellë në problemet, anëtarët e Partisë sonë janë tanë në gjendje ta bëjnë këtë. Ata s'janë vetëm prakticienë, për arsyen se Partia çdo anëtar e mëson që të tilla çështjeve t'u vejë deri në fund. Prandaj, kur në një ndërmarrje, kooperativë apo institucion del se ka disa punonjës të tepërt në administratë, atëherë në atë organizatë-bazë mund dhe duhet të dalin një ose dy komunistë që ta ngrenë këtë si problem, duke shpjeguar njëkohësisht edhe teorikisht rrezikun e qenies së tyre në këto vende për shtetin tonë, për tanë dhe për të ardhmen dhe të propozojnë të merret vendim që këta nuk duhen në këto vende.

E mban mend shumë mirë komunisti apo punonjësi i paorganizuar në Parti kur t'i thuhet se do t'i shkatërrohet shteti i vet socialist, në qoftë se lejohet të mbushen aparatet me zyrtarë. Po nuk iu vu freri kësaj të keqjeje, imbaroi pushteti popullor, pse do të shtohen njerëz të panevojshëm që do të kthehen në parazitë, që do të thihin frytin e djersës së punonjësve. Prandaj, sa herë që të lindë nevoja e shkurtimit të organikave, të tërë do ta kenë të qartë problemin dhe, siç e thashë në fillim, do të kërkojnë ta shohin sa më shpejt, ta shqyrtojnë me kujdes dhe të marrin masa që në administrata të lënë aq njerëz sa duhen, për të drejtuar punët. Kjo është e domosdoshme të bëhet, pse problemet e shumta, që dalin, nuk mund të zgjidhen vetëm nga njerëzit e aparateve, po nga të gjithë. Drejtimi i punëve shtetërore nuk realizohet vetëm me organizmat që janë krijuar, po me törë popullin, me klasën punëtore dhe me kooperativistët, të cilët dita-ditës po i mësojmë, po i drejtojmë dhe përpinqemi t'i bëjmë të ndërgjegj-

shëm për kryerjen e detyrave. Mos vallë fati i jetesës së punonjësve të një rrëthi, shpresat e tyre varen nga nëpunësit që ka aparati i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të një rrëthi? Po masat mos duhet të rrinë duarlidhur? Jo, shokë, nuk mund të zgjidhet kurrë asnjë problem, në rast se punëtorët dhe kooperativistët e një rrëthi nuk «futen vetë në valle». Punonjësit e aparatave vetë s'mund të bëjnë dot asgjë pa masat, ata mund dhe duhet të punojnë, po detyrat do t'i realizojnë tok me masat. Prandaj, sa më të mirë t'i kemi njerëzit në aparatet dhe sa më pak të kemi prej tyre, aq më mirë e më shpejt do të zgjidhen problemet. Këtu nuk është vetëm çështja e fondit të madh të përgjithshëm monetar e material që do të harxhohej pa vend me mbajtjen e njerëzve të tepërt, por edhe e së ardhmes së socializmit. Shtimi pa kriter i njerëzve të aparatave do të ketë efektet e tij të dëmshme, në qoftë se lejohet një gjë c tillë, përkundrazi, do të ketë efektet e tij të shëndetshme, në rast se në praktikë mbajmë parasysh në mënyrë korrekte zhvillimin dhe zbatimin e teorisë sonë për të gjitha këto probleme.

Mua më duket se në këtë prizëm nuk është bërë sa duhet, jo vetëm në tërsi, por një gjë të tillë nuk e shoh as konkretisht. Shokët e Partisë, edhe kur janë të mësuar e kompetentë për këto probleme, deri në njëfarë shkalle hezitojnë të futen në brendinë dhe në thelbin teorik të një problemi praktik. Këtë nuk mund ta kërkojmë që të bëhet në mënyrë të përsosur në masë nga ata, por ama atyre që janë më të ngritur, që kanë mbaruar shkolla e kurse, nuk u lejohet që të mos

e bëjnë. Atyre nuk u lejohej as me këtë rast, të mos e bënин, nuk u lejohet të mos e bëjnë ca më shumë këtej e tutje, sa herë që Partia do të ngrëjë probleme të tjera që mund dhe do të nxjerrë koha. Kötë boshllék na vihet detyrë ta plotësojmë medoemos në të ardhmen.

Teorinë ne ua kemi mësuar dhe do të vazhdojmë t'ua mësojmë kurdoherë shokëve të Partisë, po kemi positor gjithnjë që ajo në asnjë rast t'ë mos u mësohet në mënyrë dogmatike dhe unë mendoj se nuk u është mësuar kështu. Megjithatë, kur në praktikë del një problem, anëtari i Partisë nuk është gjithnjë në gjendje të trajtojë si duhet anën teorike, gjë që ka rëndësi të madhe të bëhet, sepse lidhet me të gjitha ato që thashë.

Një gështje kryesore në fjalimin e Matit ishte ajo e normave të Partisë dhe e marrëdhënieve të saj me masat. Ne flasim vazhdimisht për unitetin e Partisë, rëndësinë jetike të të cilit, jo vetëm komunistët, po edhe njerëzit e paorganizuar në Parti e kanë të qartë. Mirëpo ka edhe anëtarë partie që unitetin e kuptojnë në mënyrë dogmatike, ka edhe ndonjë komunist apo punonjës të paorganizuar në Parti, që këtë unitet nuk e kupton si duhet në rrugën marksiste-leniniste. Ku konsiston ky unitet? Ai duhet zhvilluar e kalitur në praktikën tonë revolucionare. Ka unitet mendimi dhe unitet veprimi në Parti, themi ne. Kështu është. Në Partinë tonë ka unitet politik dhe ideologjik, nga i cili buron edhe uniteti i veprimit. Uniteti i veprimit shprehet në përpjekjet që bëjnë gjithë komunistët për zbatimin e vendimeve që merren. Për të marrë një vendim, sigurisht duhet të kesh një politikë për të zbatuar. Kjo ka të bëjë me unitetin e mendimit, po, që ta marrësh drejt një vendim po-

litik dhe ideologjik, është e domosdoshme të zbatosh më parë të gjitha normat e njohura të Partisë, duke filluar nga centralizmi demokratik, nga demokracia e brendshme e Partisë dhe politika e gjerë e masave. Në qoftë se njëra nga këto norma nuk mbahet parasysh, uniteti jo vetëm nuk mund të jetë i çeliktë, marksist-leninist, po ka rrezik të shtrembërohet. Pra, për një vendim që merrret brenda normave të Partisë, parimi i unitetit kërkon të bëhen përpjekje që ai të zbatohet dhe kjo është e drejtë, por, kur vendimi nuk merret në bazë të normave që thashë, ai nuk mund të jetë i drejtë, megjilhëse, po ta marrësh në mënyrë dogmatike, parimi i unitetit kërkon që vendimi të zbatohet. As kjo nuk do të ishte e drejtë.

Të marrim anën tjetër. Në bazë të të gjitha normave të pranuara merret një vendim i drejtë politik ose organizativ nga Partia. Përderisa ky është marrë në bazë të të tëra normave, atëherë duhet mobilizuar për ta zbatuar. Në këtë rast themi që kemi unitet veprimi dhe jemi dakord se duhet të ketë unitet veprimi. Po si duhet të realizohet ky unitet, në mënyrë të verbër? Të veprohej kështu, do të ishte dogmatike, jomarksiste-leniniste. Atëherë si, të realizohet në mënyrë liberale? As në këtë rrugë nuk do të ishte marksiste-leniniste, pse kjo do të thotë të likuidosh një vendim të drejtë të marrë në bazë të normave të Partisë. Çështja është të mbështetemi fort në demokracinë socialiste në veprim, në demokracinë e komunistëve dhe të masave të gjera të punonjësve. Vetëm kur marrim një vendim në bazë të të gjitha normave, kjo e bën atë të jetë i drejtë. Mirëpo pas kësaj duhen mobilizuar masat për ta zbatuar.

Ne kemi marrë një vendim për ngritjen e kooperativave të tipit të lartë, që në parim është i drejtë, pse këto kooperativa kanë shumë anë pozitive që tashmë të gjithë i dimë. Mirëpo, kur vjen puna për zbatimin e vendimit, gjatë organizimit dhe veprimtarisë së këtyre kooperativave, dalin plot pengesa. Atëherë, në qoftë se nuk praktikojmë demokracinë e brendshme të Partisë dhe demokracinë që Partia lufton të zbatohet në masat e popullit, mund të bëjmë gabime. Si në çdo çështje që pa demokraci nuk mund të ketë unitet zbatimi në kuptimin marksist-leninist, nuk mund të ketë unitet as në rastin e krijimit të këtyre kooperativave. Po të mbyllim sytë përpara veprimeve të gabuara që u vërtetuan gjatë krijimit të disa kooperativave të tipit të lartë, do të ushqenim pikëpamjen se çfarë duhen tashmë oborret kooperativiste ose pse lejohen akoma edhe në këto kooperativa bagëtitë personale etj. Në qoftë se do të merrnim masa ndaj atij që më shkroi mua letër para ca kohësh, në të cilën më thoshte: «Na shkurtuan oborret, duke na thënë se do të na furnizonte kooperativa, tani na merrni edhe bagëtitë» etj., ne do të zbatonim në mënyrë dogmatike një vendim të drejtë, që deformohej, dhe nuk do të lejonim që nga masat e popullit të shfaqeshin mendimet lirisht. Në këtë rast nuk mund të ketë një unitet të shëndoshë marksist-leninist.

Ka edhe komunistë që nuk e kuptojnë një gjë të tillë, ata flasin sa nga e majla, sa nga e djathta, me fjalë thonë se uniteti ynë duhet të jetë marksist-leninist, i çeliktë, por ata nuk përfillin faktin se ky unitet lyp absolutisht që të zbatohen me rreptësi normat leniniste që do ta bëjnë atë me të vërtetë të çeliktë.

Kur flasim për demokracinë e brendshme të Partisë, me këtë kuptojmë atë mundësi që lejon për të zhvilluar në Parti debate rreth problemeve që i shtohen asaj për të përcaktuar rrugët e zgjidhjes së tyre. Por zhvillimi në rrugë të drejtë e të natyrshme i këtyre debateve s'ka të bëjë në asnjë mënyrë me prirjet për krijimin e fraksioneve. Partia, gjatë zhvillimit të debateve, rrëh mendimet nga të gjitha anët, gjë që që është e domosdoshme të bëhet dhe përpunhet me normat e saj. Këto debate dhë rrahje mendimesh bëhen për të dalë në rrugën më të drejtë marksiste-leniniste për zgjidhjen e problemeve dhe nuk zhvillohen vetëm nga ana praktike, po, në radhë të parë, bëhen nga ana teorike, politike. Gjatë rrahjes së mendimeve nuk është e mundur që të jenë të gjithë të një mendjeje në organizatë, pse ky do të ishte një unitet dogmatik. Mendimet që shfaqen nga komunistë të ndryshëm për problemet që shtrohen në organizatën-bazë nuk është e thënë të jenë të tëra «zile». Prandaj ato duhet të hidhen, të diskutohen e të shoshiten, pastaj të sheshohen që të arrihet në unitet.

Është e natyrshme se do të ketë njerëz që nuk do të jenë dakord për një ose disa aspekte të një problemi që diskutohet, që do të kërkojnë që kjo ose ajo çështje të zgjidhet në një mënyrë, do të ketë të tjerë që do të shfaqin pikëpamje për ta zgjidhur në një rrugë tjetër, do të ketë edhe nga ata që mendojnë të zgjidhet përgjysmë e të tjera. Atëherë, të gjitha këto mendime rriven, bëhen debate rreth tyre. Një zhvillim i tillë i punimeve për zgjidhjen e një problemi nuk është një punë fraksioni, po një veprimtari normale

në rrugën e drejtë të Partisë. Si mund të mendohej ndryshe demokracia e brendshme e Partisë, po të mos lejohen komunistët të shprehin lirisht mendimet që kanë? Kjo duhet të kuptohet drejt. Ne nganjëherë themi përse shumë shokë partie nuk diskutojnë në organizatë. Sigurisht janë të ndryshme shkaqet për të cilat një numër komunistësh nuk diskutojnë në organizatë. Disa mundet që s'diskutojnë se nuk janë shumë të ngritur, disa të tjerë se nuk i janë futur dhe s'e njo hin problemi që shqyrtohet, por mund të ketë edhe nga ata që, megjithëse kanë mendime, druhen t'i thonë, kanë frikë të shprehen për arsyen se janë kundër pikëpamjeve që ka, ta zëmë, sekretari i organizatës-bazë ose i komitetit të Partisë, një shok me përgjegjësi e ca më tepër akoma kur, për një çështje, ka sugjerime nga Komiteti Qendror. Kur nga komunistë të ndryshëm ka mendime për një problem dhe këto mendime nuk rrihen në organizatën e Partisë, mund të duket sikur nga mbledhja dilet me një unitet mendimi, po në fakt nuk është kështu. Ekzistanca e këtyre mendimeve tregon se diskutimi nuk është bërë i plotë dhe nga të gjithë, tregon, pra, se demokracia në këtë organizatë është e çalë, prandaj edhe uniteti i mendimit atje do të jetë medoemos i çalë.

Ne duhet të bëjmë përpjekje që për këtë ose atë problem në organizatën e Partisë të arrijmë në një unitet mendimi. Partia këtë e ka thënë vazhdimisht, por kjo nuk përjashton në asnjë rast ekzistencën e mendimeve të kundërta, të cilat duhet të figurojnë në dokumentet e saj. Drejtësia e vendimit që është marrë me shumicë votash për problemin, në bazë të një diskus-

timi me të vërtetë marksist-leninist, do të ndiqet e të vërtetohet gjatë zbatimit të tij në praktikën revolucionare. Aty do të provohet nëse mendimi i shumicës së organizatës-bazë është apo nuk është i drejtë dhe atëherë dy, tre apo pesë shokët që u shfaqën kundër shumicës ose që kishin disa vërejtje për çështjen e diskutuar, do të vihen përpala realitetit. Në qoftë se ky realitet do të vërtetojë që vendimi i marrë nga shumica, pasi u morën të gjitha masat, dha rezultate gjatë zbatimit të tij, atëherë shokëve të organizatës-bazë që ishin kundër, duhet t'u thuhet se jeta, praktika, realiteti vërtetojnë se ai ishte i drejtë, ndërsa parashikimet e tyre nuk qenë të sakta, prandaj edhe qëndrimi që mbajtën nuk ishte i bazuar. Megjithatë, nuk do të thotë aspak se këta që s'qenë të një mendimi me shumicën, ishin kundër vijës së Partisë, gjersa pavarësisht se ishin kundër osë kishin rezerva, u mobilizuan njëlloj si të gjithë të tjerët për ta zbatuar vendimin që mori organizata me shumicë votash. Në të kundërtën, në qoftë se vërejtjet e pakicës vërtetohen në jetë si të drejta, pra, del që shumica e ka pasur gabim, kjo shumicë duhet të bëjë autokritikë dhe të merren menjëherë masa që vendimi i organizatës-bazë të rishikohet, të merret një vendim i ri, i pari, pra, të korrigohet.

Ka rëndësi të madhe që njerëzit të kuptojnë mirë jo vetëm në praktikën revolucionare, por dhe nga ana teorike, thellësinë e çdo çështjeje, komunistët të jenë të qartë për normat e Partisë, sepse ka raste që, nën maskën e unitetit, nën maskën e Partisë, demokracia në Parti të mos zbatohet drejt.

Përse sillen në fjalimin e Matit posaçërisht cita-

tet e Leninit dhe të Stalinit? Sepse nga shkelja e parimeve që përbahen në to, vijnë rreziqe të mëdha, siç tregon qartë eksperiencia e hidhur e Bashkimit Sovjetik, që e përmendini kurdoherë. Në Bashkimin Sovjetik u bënë shkelje të rënda të normave të Partisë, saqë u krijuat një situatë e tillë që nuk guxonte njeri të fliste as në Parti, pa le më në popull. Edhe te ne nga persona të veçantë janë bërë dhe bëhen herë pas here gabime, arbitraritete, goditje të jashtëligjshme, shkelje të normave e plot gjëra të tillë nën mantelin e Partisë, nën mantelin e autoritetit të saj, nën mantelin e disiplinës. Mirëpo këto ne nuk i kemi lejuar dhe nuk mund t'i lejojmë.

Frakzioni i tmerrshëm i hrushovianëve që u vërtetua në Bashkimin Sovjetik mos lindi vallë përnjëherësh? Jo, shokë, ai nuk lindi përnjëherësh, po ndoqi një proces. Nga sëmundjet e shkaktuara prej moskuprimit të drejtë të parimeve të marksizëm-leninizmit nga anëtarët e partisë dhe prej moszbatimit si duhet në rrugën revolucionare të këtyre parimeve, atje u krijuat një situatë e atillë që i gjithë ky proces regresiv hap pas hapi u kthyte mië së fundi nga sasia në cilësi. Me një fjalë, hrushovianët shfrytëzuan momentin e krijuar dhe morën fuqinë në dorë. Mirëpo këta njerëz nuk ishin vetëm, ata ishin në një mendje që u mbështetën nga një mori elementësh në të gjitha aparatet e partisë dhe në gjithë partinë. Të gjithë së bashku kishin punuar për të krijuar një indiferentizëm të madh edhe në masat e popullit. Atje ishin marrë vendime të drejta, po dhe të padrejta. Në Bashkimin Sovjetik në kohën e Stalinit ishin krijuar situata të atilla që armiku duhej goditur medocmos rëndë, blic ishte momenti

që disa njerëzve u duhej prerë edhe koka. Por në situatat kur normat e Partisë nuk kuptoheshin si duhej, as teorikisht, as në rrugën e praktikës revolucionare, të gjitha ato që thashë kishin bërë të lindnin e të zhvilllohen pasiviteti, frika, ndjenja e pronës private e shumë të këqija të tjera që nuk korrigohen, prandaj sollën pak nga pak degjenerimin e Partisë.

Nga fjalimi i Matit kishte rëndësi të posaçme që problemet e shtruara t'i kuptonin, në radhë të parë, komunistët, pastaj masat. Mirëpo jeta tregoi se pati edhe ndonjë komunist që këto probleme nuk i kuptoi si duhet dhe filloi të shfaqë shqetësimë: «Si mundet që mua, komunistin, të më gjykojë masa?», «Si të pyjet masa nëse ky ose ai duhet të futet apo s'duhet të futet në Parti?». Mos vallë është ndonjë sekret për mësën që Partia, pararoja e klasës punëtore, duhet të jetë e çeliktë, e fortë, e ndërgjegjshme, e ndershme? Jo, nuk është sekret. Ç'do të thotë kjo? Kjo do të thotë që elementi i ri që do të pranohet në Parti duhet të jetë i çeliktë, të jetë i ndershëm, të jetë i sakrificës, të ketë të gjitha cilësitë që kërkon Partia. Atëherë ç'irrezik ka po të pyjet masa nëse e meriton apo s'e meriton ky apo ai person që të bëhet komunist? Masa do të thotë e meriton, në rast se ia ka parë ato cilësi që kërkohen dhe nëse ushqen respekt për të. Ç'norma të Partisë shkellen, kur pyjet masa? Ne pikërisht për zbatimin e këtyre normave luftojmë dhe jo vetëm vetë nuk i shkelim, por as të tjerët nuk lejojmë t'i shkelin, se po ta bënim këtë, do të binim në liberalizëm, do të shkonim drejt likuidimit të Partisë, drejt likuidimit të normave të saj.

Demokracinë nuk duhet ta kuptojmë jashtë nor-

mave, sa të mbyllim sytë e të lejojmë që një dru i shtrembër të flasë e të veprojë në kundërshtim me interesat e popullit, siç ndodhi në ndonjë rast edhe gjatë diskutimit të fjalimit. Ishte e natyrshme se do të dilnin elementë që kujtuan se iu krijuan mundësitetë të punojnë për të nxitur njerëzit, sikur erdhi koha të bëjnë lirisht si të duan. Në qoftë se ne do t'i lejonim të tilla orvatje, kjo do t'i hapte rrugën likuidimit të Partisë, vijës së saj të drejtë, socializmit. Të tilla orvatje të shtrëmbra nuk i lejojmë, jo në sajë të dogmatizmit, por në sajë të zbatimit si duhet të normave të Partisë, të cilat vazhdimisht duhet t'i përtërijmë, t'i freskojmë në teorinë dhe në praktikën tonë revolucionare. Po të kuptojet mirë ky aspekt i problemit, atëherë fare mirë do të gjenden edhe format e rrugët konkrete për zbatimin e tyre në jetë.

Lidhur me propozimin se si të përsoset më tej puna për informimin e masave për vendimet e Partisë, mua më duket se rëndësi ka, në radhë të parë, të kuptuarit e esencës së problemit dhe jo marrja e përcaktimi i formave. Populli duhet të jetë në dijeni të problemeve të mëdha të Partisë, se me njerëzit, me masat, Partia do t'i zgjidhë ato, prandaj të punohet që këto t'i kuptojnë drejt dhe ne t'i ndihmojmë e t'i udhëzojmë që t'i kuptojnë drejt dhe së bashku të kontrollojmë zbatimin e vendimeve që merren.

Në qoftë se e kuptojmë mirë, nga ana praktike dhe teorike esencën e një vendimi që merr Partia, mendoj se gjenden fare lehtë format për t'ua bërë atë të njohur masave.

Jam dakord me mendimin se puna për kuptimin

dhe zbatimin e detyrave që dalin nga fjalimi i mbajtur në plenumin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Matit duhet të vazhdojë. Por dëshiroj të rekomandoj që shokët e Partisë dhe, sidomos, organet që merren me edukimin teorik marksist-leninist të komunistëve dhe të masave, si dhe organet e shtypit, në asnjë mënyrë të mos mendojnë se këto anë teorike të problemeve të mëdha, që preokupojnë ditë e natë Partinë dhe që janë të lidhura me këtë praktikë revolucionare, i kemi thënë e trajtuar një herë, u kemi bërë edhe skemat dhe me kaq mjafton, duke u nisur nga mendimi se çdo gjë e kemi në rregull. Mua më duket se gjatë praktikës revolucionare të Partisë duhet të rikujtohet vazhdimit ana teorike e problemeve. Këto organe kanë një detyrë të madhe për ta bërë këtë gjë. Kjo nuk mësohet në mënyrë dogmatike, por duhet lidhur ngushtë me aksionin.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

NË KOOPERATIVAT E TIPIT TË LARTE TË MARRIM RENDIMENTE TË LARTA

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

30 tetor 1972

Problemet e bujqësisë janë shumë të rëndësishme, po jo të lehta, prandaj, vetëm me një organizim të fortë mund t'i dilet mbanë zgjidhjes së tyre, që të mund të kemi rezultate më të mëdha se gjere tanë.

Në fillim dua të bëj një vërejtje të përgjithshme për ju, shokët e rretheve e të kooperativave, si dhe për shokët e Ministrisë së Bujqësisë. Këtu, në Byronë Politike, bëhen pyetje, ndërhyrje e diskutime, si për të sqaruar problemet, ashtu edhe për të dhënë mendime. Gjatë këtyre ndërhyrjeve ju thatë: „Po, ashtu është, e drejtë!“. Atëherë, këto mendime duhet të mos i marrë era, por të merren masa që të zbatohen. Këtu u ngritën mjaft çështje; u tha, për shembull, se duhet të bëhet niveli i tokave me ata skreperë të vegjël që kemi;

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rrëth eksperiencës së situar në organizimin e kooperativave bujqësore të tipit të lartë dhe detyrave që dilnin.

u ngrit problemi i pulave dhe i derrave; u ngrit çështja që ne nuk jemi të kënaqur duke marrë 37 kuintalë misër pér hektar etj. Këto duhet të mbahen mirë parasysh. Mund të mos arrijmë dot tek ajo që u tha këtu, pér të marrë, fjala vjen, 12 kuintalë mish pér hektar, por 8-8,5 kuintalë pér hektar duhet t'i marrim patjetër. Të gjitha këto që u thanë në Byronë Politike duhet, pra, të vihen në jetë, se janë program pune, prandaj i mbani shënim!

Për Ministrinë e Bujqësisë kam edhe vërejtjen që të mos ecë me kaq ngadalësi, si në drejtim të studimeve që ndërmerr, ashtu edhe në zbatimin e masave dhe në realizimin e detyrate. Në këto probleme, më duket mua, duhet të ecim më shpejt, siç u diskutua këtu me të drejtë. Në rast se shokët e Ministrisë së Bujqësisë ishin në dijeni pér këto probleme (dhe unë mendoj se duhet të ishin në dijeni); në rast, gjithashtu, se shokët e Partisë dhe të pushtetit në rrethe i ngrenë problemet jo sikur kërkojnë ndonjë lëmoshë, po hapur dhe me forcën e duhur, mua më duket se shumië prej problemeve, që janë brenda kompetencave të saj, Ministria duhet t'u kishte dhënë rrugë; kurse, pér të tjerat, të na paraqiste propozime pér të marrë vendimet përkatëse, siç është, fjala vjen, çështja pér stimulimin e orizit dhe të disa bimëve të tjera, çështje këto që kanë të bëjnë me financën dhe buxhetin.

Ose të marrim problemin e SMT-së së Sarandës, ku punët nuk kanë ecur mirë, prandaj janë vërtetuar edhe gabime. Mungesa e mjeteve mekanike dhe e kudrove, inxhinierë e mekanikë që duhet të merren me riparimin e tyre, atje duhet të ishte zgjidhur me ko-

hë nga ana e Ministrisë. Ne sot nuk vuajmë as për inxhinierë mekanikë e as për teknikë. Prandaj, përpara se të kritikoheshin ata të bazës, duhej të qenë marrë masa sa më shpejt qysh këtu për këto probleme.

Ose le të marrim një problem tjetër, gjithashtu të rëndësishëm, që është edhe ky në kompetencën e ministrisë, atë të diferencës relative në shpërndarjen e mekanizmave midis ndërmarrjeve bujqësore dhe kooperativave, bile edhe atyre të tipit të lartë. Ky është një problem që e kemi ngritur disa herë. Vazhdimesht kemi thënë se ndërmarrjet bujqësore janë shumë të favorizuara. Nganjëherë këtë e themi edhe tani, përsye se shpërndarja e mekanizmave dhe mjeteve të tjera nuk është e drejtë. Probleme të kësaj natyre duhet të ishin studiuar nga ministria dhe të ishin marrë masa nga ana e saj për zgjidhjen e tyre.

Në drejtimet që përmenda shikoj një javashllëk në marrjen e vendimeve nga ana e ministrisë. Në të ardhmen është e domosdoshme të veprohet më me shkathtësi në këto drejtime, se problemet kaq të mëdha e të koklavitura, siç janë këto të bujqësisë, nuk zgjidhen lehtë.

S'ka dyshim se çështjet e bujqësisë në vendin tonë kanë ecur përpara, prandaj s'ka vend të jemi pësimistë. Por, fakt është që në disa drejtime jemi akoma prapa, në krahasim me mundësitë e mëdha që kemi, sepse mungesat në fushën e organizimit janë të tillë që na frenojnë, na ngadalësojnë ritmin e përparimit dhe na krijojnë kokëçarje, të cilat do të shtohen, po të mos marrim me kohë masat e duhura.

Po për çfarë duhet t'i marrim këto masa?

Në qoftë se presim të bëjmë studime për të tëra kooperativat bujqësore të Shqipërisë, si ai që bëmë për kooperativën e Plasës, të cilit i hodha një sy të shpejtë edhe vetë, ku janë matur deri edhe minutat e çdo procesi pune të bujikut, edhe koha që i duhet të vejë nga një parcelë në tjetrën, mendoj se kësaj pune mund të mos ia dalim as për disa vjet. Po të vepronim kështu, jo vetëm që do të humbisnim kohën e vlefshme të kuadrove, por do të pengonim edhe ecjen e mëtejshme përpara të bujqësisë sonë. «Kjo është një punë e përsosur», mund të na thotë dikush. Ashtu është, e përsosur, por neve nuk na pret puna që të bëjmë një gjë të tillë, se do të na duhej shumë kohë.

Çështjen e specializimit të mëtejshëm të prodhimit duhet ta kryejmë më mirë nga sa e kemi kryer gjë më sot, por jo ta matim këtë gati me metro. Në këtë mënyrë nuk mund të ecim, prandaj të përcaktojmë në rrëth dhe në kooperativat e tipit të lartë përpjesëtime të drejta të bimëve në bazë të tokave, të klimës dhe të nevojave që ka shteti. Kjo është e domosdoshme të bëhet nga çdo rrëth, ndërsa Ministria e Bujqësisë të merret me drejtimin e përgjithshëm dhe të kontrollojë se si po zbatohet.

Për kooperativat e tipit të lartë, që të mos zgjatemi, orientimet i kemi të qarta. Çështja është që studime të bëjmë, po nga plani i pesëvjeçarit mendoj të mos lëvizim në asnjë mënyrë për sa u përket rendimenteve dhe prodhimit. Këta jo vetëm të mos i ulim, por, përkundrazi, kërkojmë e duhet të përpinqemi që të ngrihen akoma më shumë. Siç e kemi thënë, në kooperativat e tipit të lartë, specifikimi dhe orientimi

i bimëve të bëhet më mirë e në një masë më të shëndoshë se në kooperativat e tjera. Në qoftë se në ndërmarrjet bujqësore kemi arritur një specializim të bimëve, të përpinqemi ta arrijmë këtë sa më parë edhe në kooperativat e tipit të lartë. Prandaj, mua më duket që të mos diskutohet fare për rendimentet në kooperativat e tipit të lartë, sepse këto janë edhe më të përparuarat. Të bëhen të gjitha përpjekjet që këto rendimente atje të realizohen, kështu siç i kemi caktuar, se këto kooperativa kanë edhe tokat më të mira, ku janë arritur gjer tanë rendimente mjaft të larta. Me ndihmën që do t'u japë shteti atyre, me mekanizime dhe plehra, treguesit ekonomikë në to duhet të ngrihen në një nivel akoma më të lartë dhe në të ardhmen të arrijnë në një shkallë të barabartë me ndërmarrjet bujqësore. Prandaj, s'ka përsë të tororisemi në këto gjëra; ne për këtë qëllim i kemi ngritur dhe ato i kanë të gjitha mundësitë t'i realizojnë. Bile, unë mendoj që në disa bimë kooperativat e tipit të lartë mund t'i tejkalojnë edhe ndërmarrjet bujqësore. Kjo duhet të jetë e qartë.

Sivjet, që ishte viti i parë i krijimit të tyre, nuk u mbajtën detyrimet nga ana e shtetit. Kështu, nuk qëndron ajo që u tha këtu se: «U dhanë ato që ishin parashikuar për sivjet; ne nuk ua dhamë dot materialt, për arsyec se u gjetëm shtrënguar». Por, kjo që ndodhi të shërbejë për të qenë në rregull vitin e dytë. Vetëm të mos harrojmë se as vitin tjetër ne nuk do të notojmë në materiale, këtë ta kenë të gjithë parasysh. Mundet që në Komisionin e Planit këto t'i kenë përcaktuar në letër, por në të ardhmen ka rrezik të mos i

realizojnë detyrat, në rast se nuk do të marrim me kohë masat e nevojshme. Unë mendoj që në këto situata bujqësisë t'i japim mundësi për të ndërtuar disa objekte më përpara, duke i shtyrë për më vonë disa objekte të sektorëve të tjera. Bujqësisë t'i japim rëndësi të madhe, sidomos kooperativave të tipit të lartë që po ngremë, të cilave, për arsyet që dimë, u kemi dhënë një orientim të tillë, sipas të cilit këtë vit kërkojmë prej tyre rendimente të mëdha, mbasi për të importuar prodhime kryesore bujqësore e blegtoriale për nevojat e popullit, si drithë, vaj, oriz, sheqer, mish e të tjera, do të na duhen disa milionë lekë valutë.

Prandaj, duke marrë parasysh vështirësitë e shumta që kemi, Qeveria ta shikojë edhe një herë me vëmendje planin e ndërtimeve, duke përfshirë edhe objektet e industrisë, në lidhje me shtyrjen e ndërtimit të disave prej tyre dhe të sigurimit të materialeve që janë caktuar për to. Çështja është që me këtë masë të mundim të sigurojmë disa fonde e materiale për të ndërtuar sa më shpejt objektet më të ngutshme e më të domosdoshme, për të cilat të vëmë të gjitha forcat që të mbarohen sa më parë për të na dhënë prodhime e për të plotësuar nevojat e bujqësisë.

Çështja tjeter që dëshiroj të theksoj, qoftë për ndërmarrjet bujqësore, qoftë për kooperativat, ka të bëjë me disa ndërtime që më duken relativisht luksoze. Unë mendoj që të heqim dorë nga objekte tepër të kushtueshme. Ekziston mania të bëhen stalla të rënda, me harxhim materialesh të panevojshme, gjë që e kemi vënë re të tërë. Ne, investojmë shpeshherë pa vend në këtë drejtim, ngremë gati pallate për lopët. Ndërsa

lëmë pas dore dhe nuk kujdesemi sa duhet për ushqimin, pastrimin dhe shërbimin veterinar të tyre. Këtu nuk është vetëm çështja e fondeve monetare, por sidomos e materialeve, e rritjes së kostos të prodhimeve etj. Për të gjitha këto, më duket mua, ka ardhur koha të veprojmë me një sy më ekonom; çdo objekt ta përfundojmë sa më shpejt, të na kushtojë sa më pak e ta vëmë brenda një kohe sa më të shkurtër në shfrytëzim dhe të heqim dorë nga ndërtimet luksoze dhe të shtrenjta.

Në lidhje me vështirësitë që hasim për sigurimin e prodhimeve bujqësore, mendoj se Ministria e Bujqësisë duhet të ketë më mirë parasysh zbatimin me rreptësi të orientimeve që kemi dhënë, të cilat, me sa shikojmë, pak a shumë zbatohen. Megjithatë, këto orientime, sidomos për sa i përket përqindjes së bimëve dhe strukturës së tyre, duhen zbatuar në mënyrë më të studiuar.

Mbase gabohem, po kam përshtypjen që në çështjen e drithërave, që është me rëndësi aq të madhe përvardin, fakt është që sipërsaqet e planifikuara të tokave me grurë, sidomos sivjet, i tejkaluam. Por, rendimentin nuk e arritëm dot. Megjithatë, prodhimit total të paktën po i afrohem; diferenca që ka mbetur nuk është ndonjë gjë e madhe. E kam fjalën që në bimët kryesore, përqindjen që zënë ato, në shumiën e sipërsaqeve, ta shikojni, se mos na duhen akoma më tepër. Zhvillimi i lopës nuk duhet ta bëjë ndonjërin që të shkurtojë mbjelljen e drithit, duke shtuar tokat për foragjere, sepse kështu krijohet përshtypja sikur është lopa më me rëndësi sesa buka, pra cenohet orientimi.

Dakord, nuk them se nuk ka rëndësi lopa, por për zhvillimin e saj të vëmë në shfrytëzim sa më tepër lihadhe, të përpinqemi të ngremë rendimentet e foragjereve, që t'u japid sa më pak tokë, me qëllim që të mos cungojmë sipërsfaqen e prodhimit të drithërave. Prandaj, në qoftë se nuk do të përcaktojmë drejt, me rreptësi dhe në bazë të vendimeve që kemi marrë, përpjesëtimet e bimëve, nuk do të zbalojmë mirë as orientimin e Partisë për zgjidhjen e një problemi kaq të rëndësishëm, siç është sigurimi i drithërave.

Tani për sa u përket kooperativave të tipit të lartë që do të ngremë në të ardhmen, të ecim si kemi vendosur. Në t'ua destinojmë atyre ekonomive investimet në türësi, po t'i porositim që köto t'i përdorin në ato toka apo sektorë, ku leverdia është më e madhe përritjen e prodhimit e shtimin e të ardhurave. Përveç kësaj, kur ta mekanizojmë më shumë fushën, është e qartë që atje do të kemi ekonomizim në krahët e punës, të cilët mund t'i përdorim në zonat kodrinore e malore. Do të krijojmë kështu mundësi të mëdha që, me rritjen e prodhimit, kodrat dhe malësitë t'i ndihmojmë më shumë, duke rritur investimet në to. Vetëm të kemi kujdes që të mos shpërndahemi shumë, se mos nuk arrijnë dot qëllimin që kemi vënë përpara.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Byrosë

*Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

**KËNGA JONË PATRIOTIKE POPULLORE NË ÇDO
KOHË KA PASQYRUAR BOTËN REALE
SHQIPTARE**

Letër drejtuar grupit të këngëve karakteristike korçare

31 tetor 1972

Të dashur shokë,

Ju falënderoj nxehtësisht për ftesën që më bëtë me rastin e 50-vjetorit të krijimit të grupit tuaj, së cilës nuk iu përgjigja dot në kohë, mbasi isha i zënë në Kongresin e 6-të të BRPSH, ku, gjithashtu, isha ftuar. Me këtë rast dëshiroj të përgëzoj gjithë pjesëtarët e kolektivit tuaj aktiv për kontributin e çmueshëm që kanë dhënë dhe vazhdojnë të japid nëpërmjet këngës dhe muzikës popullore, në transmetimin e traditave patriotike dhe revolucionare të popullit tonë te brezat pasardhës.

Nëpërmjet këngës dhe muzikës së tij të bukur e plot frysëzim, në ditët e mira dho të vështira, populli ynë ka shprehur me shumë art ndjenjat e tij të pastra, dashurinë për atdheun e shtrenjtë, shpirtin e heroizmit dhe të sakrificës dhe urrejtjen për armiqjtë. Kënga jonë patriotike popullore në çdo kohë ka pasqyruar botën

reale shqiptare në rrëthana të caktuara historike dhe në zhvillimin e saj të pandërprerë, ajo i ka shërbyer kurdoherë edukimit revolucionar të njerëzve tanë. Ja arsyet për të cilat Partia konsideron si shumë të dobishme dhe fisnike ruajtjen, zhvillimin e mëtejshëm dhe përhapjen e traditave të mira të trashëgura nga e kaluara, duke përfshirë edhe këngët e muzikën popullore.

Ju uroj shëndet dhe suksese të reja në veprimtarinë tuaj të palodhur dhe shpreh bindjen se edhe paskëtaj puna juaj do t'u shërbejë argëtiimit dhe edukimit patriotik e revolucionar të masave, veçanërisht të rinisë sonë, që është aq shumë e etshme për të shijuar dhe për të çuar gjithnjë e më përpara artin tonë popullor.

Juaji

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
librin: Enver Hoxha, «Mbi
letërsinë dhë artin», f. 323*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Mbi letërsinë
dhë artin», f. 323*

STUDIMIN E GJEJ SHUMË TË THIELLUAR DIIE ME KONKLUZIONE TË DREJTA

Letër drejtuar shokut Miti Bozo

4 nëntor 1972

Shoku Miti Bozo,

E studiova me shumë kujdes raportin që na paraqite «Mbi disa probleme themelore organizativo-ekonomike të ekonomive bujqësore» dhe, me sa e kuptoj unë këtë problem kaq të rëndësishëm, studimin në fjalë e gjej shumë të thelluar dhe me konkluzione të drejta, të arsyetuara shkencërisht dhe në bazë të orientimeve të Komitetit Qendror.

Kur e zura kalimthi në gojë, në mbledhjen e fundit të Byrosë, studimin që po bëhej në kooperativën e Plasës, dija vetëm disa gjëra preliminare që më kishte thënë gojarisht shoku Haki [Toska]. Tash me studimin që i bëra relacionit tuaj, jam i qartë për punën e madhe e të frytshme që keni bërë ju dhe gjithë grupi që ndërmori këtë studim.

Unë jam i mendimit si dhe ju, që Ministria e Bujqësisë duhet ta ketë parasysh si rrugërrëfyes këtë stu-

dim dhe të fillojmë në gjerësi nga puna, në radhë të parë në NB, në kooperativat e tipit të lartë, por edhe në kooperativa të bashkuara.

Nuk mund të prononcohem me kompetencë për çështjen e qarkullimit dhe të renditjeve, por si për këto dhe për të tjerat, unë jam me konkluzionet e grupit të studimit.

Ju përshëndes për punën e mirë.

Enver

Estuuar për herë të parë në librin: *Enver Hoxha, «Për shkencën (Përmbledhje re-prash)», vëll. I, f. 495*

Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Për shkencën (Përmbledhje re-prash)», vëll. I, f. 495

**PARTIA E MËSON RININË TË VEPROJË
E ORGANIZUAR NË LUFTËN PËR NDERTIMIN
E SOCIALIZMIT**

Nga biseda me delegacionin e rinisë kineze

8 nëntor 1972

Pasi u përshëndet me miqtë dhe i pyeti për përshtypjet nga vizitat e bëra nëpër vendin tonë, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Besoj se për të vizituar Shqipërinë ju ndihmoi ca edhe koha, e cila po bën e ngrohtë në këto ditë nëntori. Është e vërtetë ajo që thatë ju për Partinë tonë, për ngrohtësinë e saj. Janë rrezet e 8 Nëntorit që ngrohin në vendin tonë, ato zhdukën retë, hapën qiellin dhe lejuan të dilte dielli për popullin shqiptar. Rrezet e dieillit të Partisë i shpërndanë retë dhe ndihmuam që ju ta shikoni vendin tonë të ngrohtë e të bukur.

Për të shprehur gjëzimin për vizitën tuaj ne, përfaqësuesit e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, këtë takim me përfaqësuesit e rinisë kineze, menduam ta bëjmë pikërisht sot, në ditën e shënuar të 8 Nëntorit, që është dita e themelimit të Partisë sonë.

Ne, shqiptarët, jemi të lidhur në miqësi vëllazërlore me popullin kinez.

Uniteti revolucionar midis marksistë-leninistëve ka rëndësi të jashtëzakonshme, se shërben si shembull për luftën e përbashkët të të gjithë popujve dhe të proletariatit botëror kundër armiqve imperialistë dhe revizionistë.

Një nga çështjet më të rëndësishme parimore për partitë marksiste-leniniste është qëndrimi ndaj rinisë, sepse rinia është pjesa më e madhe, më e gjallë, që ndikon shumë në jetën e një populli. Rinia është e ardhmja e popujve tanë, prandaj edukimi dhe kalitja e saj revolucionare kanë rëndësi jetike. Nga radhët e rinisë vijnë kuadrot e rinj që zëvendësojnë të moshuarit. Kush ka rininë me vete e ka të sigurt të sotmen dhe të ardhmen e ndritur të popullit. Kush e edukon rininë që të jetë e pastër me zemër dhe e guximshme në veprime, trime në luftë dhe e ditur për ndërtimin e socializmit, ai ka të siguruara të tashmen e të ardhmen e atdheut. Kush nuk e ka kuptuar këtë dhe nuk punon për edukimin revolucionar të rinisë, ai i bën varrin atdheut. Prandaj Partia e Punës e Shqipërisë e ka kuptuar drejt dhe e ka çmuar si duhet rolin e rinisë dhe punën që duhet bërë vazhdimisht për edukimin e saj.

Rinia trashëgon virtytet më të mira të brezave të mëparshëm dhe kur pajiset me edukatën marksiste-leniniste revolucionare, ajo është më e pastër në ndërgjegje dhe më e zhvilluar në mendime se paraardhësit e saj. Dhe është e natyrshme që të moshuarit edhe pse kanë bërë revolucionin, për shkak të rrugës së gjatë që kanë kaluar dhe të kohëve që kanë jetuar, të kenë për-

sëri disa mbeturina, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u zhdukur dhe që, po nuk u luftuan, transmetohen edhe te brezi i ri. Prandaj Partia jonë i vë rëndësi të madhe e të jashtëzakonshme kujdesit për rritjen dhe edukimin e shëndoshë të rinisë.

Qëllimi i partisë së vërtetë komuniste është që shoqëria të ecë përpara drejt ndërtimit të plotë të socializmit dhe të komunizmit. Por në socializëm dhe në komunizëm nuk mund të shkohet pa përpjekje e pa luftëra kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm. Të gjitha këto përpjekje do të kurorëzohen me sukses vetëm në përmjet njerëzve të kalitur në revolucion dhe të edukuar nga partia, sepse, siç na mëson marksizëm-leninizmi, njeriu ka rëndësi kolosale, ai është faktori vendimtar në revolucion. Prandaj kur i vihet kujdes dhe rëndësi e madhe edukimit të njerëzve me ideologjinë revolucionare dhe me moralin komunist, revolucioni dhe shoqëria ecin përpara, kurse «llumi» i mbetur në ndërgjegjen e njerëzve spastrohet. Për këtë arsyе ne bëjmë një punë të gjithanshme për edukimin e përgatitjen revolucionare të brezit tonë të ri.

Ndërsa në kapitalizëm, rend shoqëror që mbështetet në shtypjen dhe shfrytëzimin e njeriut, borgjezia dëshiron dhe përpigjet që rinia të degjenerojë moralisht, politikisht dhe ideologjikisht, sepse kështu mund ta skllavërojë dhe ta shtypë më lehtë. Pra, konsideratat dhe qëllimet tona për rininë, janë diametralisht të kundërtë me ato të borgjezisë. Konsideratat tona bazohen në marksizëm-leninizmin dhe kjo është një arsyë që na bën të themi se ne do të fitojmë mbi borgjezinë dhe bashkëpunëtorët e saj, revisionistët modernë. Deklaratat

tona nuk janë parulla të zbrazëta, por shprehin bindjen e thellë për të vërtetën, sepse nisen nga gjykimi se fitoret i sjellin njerëzit, me luftën dhe me idetë e tyre, që rrjedhin nga zhvillimi materialist i historisë. Mësimet që nxjerr nga marksizëm-leninizmi, Partia jonë i zbaton me vendosmëri. Prandaj rinia te ne merr pjesë gjallërisht në ndërtimin e jetës së re të vendit.

Të rejat e të rinxjtë shqiptarë, mbarë rinia e vendit tonë, përbëjnë një nga repartet më të lavdishme të Partisë dhe të popullit. Ajo kurrë nuk ia ka bërë fjalën dy Partisë. Çfarë ka thënë Partia, e ka kryer me nder rinia. Ishin të rinxjtë ata që, nën udhëheqjen e Partisë, u hodhën të parët në luftën për çlirim kombëtar e shoqëror dhe, nën shembullin e tyre, edhe burrat më të moshuar nuk mbetën prapa. Të rinxjtë ishin ata që bënë Luftën Nacionaçlirimtare. Atëherë ata ishin nga 15 deri në 20 e ca vjeç, ndërsa tani shumica e tyre janë bërë nga 45-50 e më shumë vjeç dhe vazhdojnë të marrin pjesë gjallërisht në ndërtimin e Shqipërisë së re. Nën shembullin e të rinxjve të kohës së luftës punon edhe brezi i sotëm i rinisë, që i ka dhënë e i jep gjak të ri Shqipërisë.

Sikundër e dini dhe e patë vetë këto ditë të qëndrimit në vendin tonë, brezi që bëri luftën, së bashku me të rinxjtë e sotëm, kanë ndërtuar shumë uzina, fabrika, hekurudha e hidrocentrale. Luftëtarët për çlirimin e atdheut, gjatë luftës për ndërtimin e socializmit mësuan në shkolla dhe u bënë mjekë, inxhinierë, agronomë, shkrimitarë, artistë, pedagogë etj., etj. Të rinxjve tanë të dikurshëm, të cilëve tani u janë zbardhur flokët, Partia u thotë: «Ju bëtë revolucionin, ndërtuat bazat e socializmit dhe për këto arsyen keni merita të mëdha, por keni akoma

detyra përpëra brezit të ri, rinisë së sotme, për t'i dhënë asaj përvojën dhe njohuritë tuaja; të keni besim të madh te rinia, përkrahjeni atë, ngarkojeni me detyra, se ajo do t'i kryejë ato me sukses, ashtu siç i kryet edhe ju detyrat tuaja». Kështu na mëson Partia për qëndrimet që duhet të mbajnë më të moshuarit ndaj të rinxve, me qëllim që «vala të zërë valën» dhe të përjetësohet socializmi, që idetë e revolucionit të futen në gjakun e rinasë dhe të konkretizohen në jetë për të mirën e popullit.

Marksi i mësonte punëtorët që të sulmonin kapitalistët dhe borgjezinë duke qëndruar me radhë të shtrënguara fort, në mënyrë të tillë sa këta të fundit të mos gjelin dot asnjë të çarë për të depërtuar në radhët e proletariatit. Edhe sot, që të luftohen si duhet armiqtë kapitalistë e revizionistë lypset një organizim i përsosur i klasës punëtore, e cila duhet të jetë në ballë të betejës, në aleancë të ngushtë me fshatarësinë, duke pasur rreth vetes intelijgencien dhe gjithë popullin, e veçanërisht rininë. Por, sipas mendimit të Partisë sonë, üshtë e domosdoshme që rinia të edukohet me një frysë revolucionare që të kuptojë teorikisht e praktikisht se lufta e saj kundër armiqve duhet të organizohet në frysë e klasës punëtore dhe nën udhëheqjen e saj. Kjo punë duhet bërë medoemos, sepse në organizatën e rinasë bëjnë pjesë edhe të reja dhe të rinj nga fshatarësia punonjëse dhe nga shëresat e ndryshme të popullsisë. Tërë kësaj mase të gjerë të rinxh e të rejash duhet t'i futim në gjak ndjenjën e bashkimit, të vëllazërimit dhe të organizimit të klasës punëtore sipas frysë së marksizëm-lenninizmit. Partia, pra, e mëson rininë të veprojë e organizuar politikisht dhe ideologjisht në luftën për ndërm

timin e socializmit, si në industri, në bujqësi e në çdo sektor tjeter, ashtu edhe në luftën kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm, të cilët, vetëm duke luftuar nën udhëheqjen e klasës punëtore, do t'i vërë përpara shpejt, energjikisht dhe nga të gjitha anët, gjer në shpartallimin e tyre të plotë.

Organizimi i rinisë në këtë fryshtë ka një rëndësi të madhe për partinë marksiste-leniniste. Në qoftë se nuk e bëjmë mirë këtë punë, mund të na ndodhë që i riu, kur të bëhet punëtor, të veprojë nën ndikimin e ideve anarkiste, t'i mungojë disiplina në punë, të tregohet oportunist ose sektar, shfaqje këto që nuk janë aspak të mira. Për këto arsyen organizatën e rinisë e drejton Partia. Po të shprehem në mënyrë figurative, mund të them se rinia për Partinë është si fara që hedhim në arë për të siguruar bukën, pa të cilën njeriu nuk rron dot. Fshatarësia jonë e rrit me kujdes të madh bimën e njomë që mbin në arën e mbjellë, e pastron nga barërat e këqija, e ujit, e prashit etj., në mënyrë që ajo të japë prodhime të mira. Me të njëjtin kujdes, bile ca më tepër, kujdeset Partia për rininë. Prandaj të rejat dhe të rinxhë e vendit tonë ecin në rrugën e Partisë, në rrugën marksiste-leniniste dhe janë të lidhur ngushtë me të. Edhe rinia e Kinës ka dhënë shembuj të patriotizmit dhc të ndihmës për popujt e tjerë. Kur asaj iu bë thirrje për t'i shkuar në ndihmë popullit korean kundër agresionit imperialist amerikan, ajo vullnetarisht u hodh në luftë dhe e ndihmoi popullin e Koresë të çlirohej nga imperialistët.

Gjatë luftës te ne ka pasur ndonjë element që ka mbajtur qëndrim kapitullues, siç është, për shembull,

rasti i disa tradhtarëve, që ishin anëtarë të Partisë, bile edhe anëtarë të Komitetit Qendror, që kapitulluan në mbledhjen e Mukjes. Duke vepruar në kundërshtim me vijën e Partisë, ata ranë në ujdi në kushte shumë poshtëruese me krerët e organizatës tradhtare të Ballit Kombëtar.

Ne ishim për atë që Balli të hiqte dorë nga lufta kundër Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe të hynte në luttë kundër pushtuesit etj., por delegacioni që dërguam ne u përkul para presionit të Ballit Kombëtar dhe, në vend që të mbronte vijën e Partisë Komuniste të Shqipërisë, pranoi një marrëveshje të tillë që binte në kundërshtim të hapët e të drejtpërdrejtë me qëllimet, detyrat dhe interesat e Luftës Nacionalçlirimtare dhe të popullit shqiptar. Delegacioni ynë, duke rënë kokë e këmbë në pozitat e Ballit, pa qenë i autorizuar, pranoi të krijohej një «Komitet për shpëtimin e Shqipërisë», që do të pajisej me atributet e një qeverie, ku të merrnin pjesë me numër të barabartë përfaqësues si nga Balli Kombëtar, që nuk kishte luftuar, përkundrazi kishte bashkëpunuar me armikun, ashtu edhe nga Fronti Nacionalçlirimtar! Kjo ishte një përpjekje për ta ndarë pushtetin e popullit me armiqtë e tij. Por Partia jonë e hodhi poshtë dhe e dënoi pa ngurrim këtë marrëveshje që përbënte një tradhti ndaj popullit dhe luftës së tij.

Populli luftoi edhe në Greqi, por disa udhëheqës të komunistëve grekë, në një vend të quajtur Varkizë, ranë në bisedime me reaksionarët e brendshëm e me anglezët. Duke vepruar kështu udhëheqja, komunistët grekë hodhën armët, prandaj në vendin e tyre fuqinë e mori

në dorë reaksiuni. Pas Luftës së Dytë Botërore, në Gregi vazhdoi përsëri lufta popullore, mirëpo taktika e komunistëve ishte prapë e gabuar, ata nuk organizuan një luftë të drejtë partizane. Pasi ndërhyjnë amerikanët në këtë vend, Titoja tradhtoi dhe partizanët grekë i përkrahu vetëm Shqipëria, e cila u tha «Ndal!» reaksionarëve grekë në kufirin shqiptaro-grek.

Duke gjykuar nga eksperiencia e nxjerrë prej shumë lëvizjeve dhe luftërave, Partia jonë është e bindur se vetëm lufta do ta çlirojë Vietnamin. Ndërsa bisedimet me imperializmin amerikan nuk do të jepin asgjë të dobishme dhe të pranueshme për popullin vietnamez.

Niksoni dje u zgjodh përsëri president i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në sfjalimin e tij të fundit ai i tha popullit amerikan: Voto për mua, se unë do të bëj një paqe të drejtë për Amerikën. Tani do të shikojmë çfarë do të ngjasë, por dëshirojmë që populli vietnamez të fitojë. Ne e duam shumë popullin vietnamez, se ka luftuar e lufton heroikisht, prandaj shumë e shumë herë, kur kemi pasur rast, u kemi thënë haptazi shokëve vietnamezë: «Mos u gënjeni nga revizionistët sovjetikë, që duan t'ju shesin tek imperialistët amerikanë. Forconi unitetin e radhëve tuaja, se atje qëndron fitorja». Ne dëshirojmë që ata të mos u bëjnë lëshime armiqve, kundër të cilëve kanë derdhur aq shumë gjak. Imperialistët amerikanë po pësojnë disfata të turpshme në Vietnam, por ata vetëm lufta do t'i detyrojë të largohen nga ky vend. Ne shpresojmë dhe kemi bindje se populli i Vietnamit do të luftojë deri në fund, ai nuk do t'u bëjë lëshime armiqve.

Ta ngremë këtë gotë për miqësinë tonë, për shëndetin e popujve tanë, për shëndetin tuaj, shoqë dhe shokë. Rrugë të mbarë dhe suksese në punë!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim, që gjenden në AQP*

JU KENI TË DREJTE TË JENI TË LUMTUR

*Letër drejtuar Bajame e Islam Sopit, punëtorë
në Fabrikën e Miellit*

Durrës

13 nëntor 1972

Të dashur Bajame e Islam,

Lindja e fëmijës suaj të 12-të më gjëzoi edhe mua. Ju keni të drejtë të jeni shumë të lumtur për këtë ngjarje jo vetëm si prindër të 12 fëmijëve, por edhe pse jeta e djalit tuaj të porsalindur¹ filloi në ato ditë të zjarra të Kongresit të 6-të të BRPSH, që u zhvillua në Durrës, në vendlindjen e tij.

Fëmijët janë gjëzimi ynë, pse na zbukurojnë shtëpitë e na lulëzojnë jetën. Ata janë edhe pasardhësit tanë që do ta ngrenë akoma më lart atdheun tonë socialist. Prandaj, bashkë me kënaqësinë e madhe që ndiejnë për

1. Prindërit i vunë atij emrin Gazmend. Në Kongresin e 9-të të BGSH, që zhvilloi punimet në qytetin e Durrësit nga data 1-3 qershor 1933, Gazmendi ishte midis pionierëve që përshëndetën kongresin dhe u takua me shokun Enver Hoxha.

fëmijët që lindin dhe rritin, prindërët kanë edhe detyrimet që ata të bëhen të denjë e të vlefshëm për familjen, shoqërinë dhe Shqipërinë tonë të dashur. Dhe kështu edukohen sot fëmijët e vendit tonë, zemra e vogël e të cilëve këndon për Partinë, që kujdeset aq shumë për ta bërë jetën e tyre gjithnjë më të bukur.

Në punën e madhe që zhvillohet te ne për mirërritjen dhe edukimin e drejtë të fëmijëve një rol të veçantë luan familja. Ajo është shkolla e parë e edukimit të fëmijëve dhe prindërët janë mësuesit dhe edukatorët e tyre. Kur të rritet fëmija e 12-të, ju, natyrisht, do t'i tregoni atij gjithçka që s'ka jetuar, që nga traditat e bukurë të lashta të popullit tonë, nga ngjarjet e Luftës Nacionallirimi të partizane, në radhët e të cilëve ka qenë edhe babai i tij, Islami, e deri në ditët tona. Unë jam i bindur se ju si prindër, do të përpigjeni t'i rritni fëmijët ashtu si dëshiron Partia, sot të zellshëm në mësime dhe nesër punëtorë të dalluar, siç jeni vetë, qytetarë besnikë të Republikës sonë Popullore.

Me këtë rast, i uroj fëmijës suaj të 12-të shëndet e jetë të gjatë dhe ju, prindërve si dhe völlezërve e motrave të tij gjëzim e lumturi familjare dhe suksese në punë e në mësime.

Juaji

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, "Letra të zgjedhura", vëll. 1, f. 266

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, "Letra të zgjedhura", vëll. 1, f. 266*

PROBLEMET E PUNËS E TË PAGAVE TË NA PREOKUPOJNË VAZHDIMISHT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

22 nëntor 1972

Sot në rendin e ditës kemi dy çështje të rëndësishme. Të dy këto probleme, pasi u studiuam, i mori në shqyrtim Qeveria dhe këtu na janë paraqitur mendimet përfundimtare për çka mendohet të bëhet në lidhje me to.

Unë mendoj se do të jetë mirë që, përvèç materialit që na kanë dërguar, shokët e Qeverisë të na japid shkurtimisht disa shpjegime për problemet kyç, për të cilat janë shprehur mendime dhe janë diskutuar propozime të ndryshme. Shokët mund të bëjnë edhe pyetje të veçanta për të sqaruar më mirë problemet kryesore. Shokët e Qeverisë i kanë parë problemet në tërë kompleksi-

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth studimeve për disa probleme të punës e të pagave dhe për disa çështje të organizimit të prodhimit nëpërmbjet përqendrimit, specializimit e kooperimit dhe për përmirësimin e mëtejshëm të strukturave të organeve të drejtimit.

tetin e tyre, duke marrë të gjitha të dhënët nga specia-listët e ndryshëm që kanë bërë këto studime. Në qoftë se ka shokë që duan të bëjnë ndonjë pyetje, le të pyesin, pastaj të jepen shpjegime.

Mendoj që, në bazë të këtyre studimeve, të na flitet më konkretisht cilat kanë qenë arsyet e anomalive që na janë krijuar në pagat dhe, për pasojë, na kanë detyruar t'i shikojnë dhe t'i korrigojnë këto? Kjo ishte pyetja e parë. Lidhur me këtë pyetje të na shpjegohet pak më mirë mekanizmi i përcaktimit të mesatares së pagave, bazuar në kategorinë më të ulët ose në pagën mesatare të realizuar; të jepen edhe arsyet pse prishet ekilibri në tabelën e pagave të vendosura dhe si duhet ta llogaritim këtë pagë që të mos lëvizë? Meqenëse ekziston zhvillimi i mekanizmit të disa proceseve ndërmjetëse, që ndikojnë posaçërisht në disa paga të mesme, që shkaktojnë këtë disniveli, me çfarë duhet të manovrojmë që këto disnivele të mos janë aq të mëdha si në shembujt që jepen për Përrrenjasin dhe Mborje-Drenovën?

Pyetjen e dytë e kam lidhur me propozimin që bëhet në dy variante për shtesën në fondin e pagave. A i janë paraqitur Qeverisë disa pasqyra të pagave orientuese për nivelin e jetesës, duke u bazuar në situatën aktuale, për të parë nëse këto shtesa janë të nevojshme për arsyen ekonomike, apo për arsyen që të ndreqen anomalitë? E kam fjalën se ç'duhet të bëjmë që të mos ketë lëkundje të mëdha midis kategorive të ndryshme.

Pasi iu dha përgjigje pyetjeve të bëra dhe pasi u diskutua për problemet në fjalë, shoku Enver Hoxha tha:

Problemet e punës dhe të pagave, që po marrim në

studim duhet të na preokupojnë vazhdiminë se janë të një rëndësie të dorës së parë, pasi kanë të bëjnë me organizimin e punës, me shpërblimin e saj dhe, pra, me marrëdhëniet socialiste të shpërndarjes që rrugullojnë nivelin e jetesës të punëtorëve dhe shtyjnë përpara zhvillimin e prodhimit. Ne nuk kemi bërë ndonjë gabim parimor në përcaktimin e këtyre çështjeve. Të meta ka pasur dhë këto kanë qenë të natyrshme, prandaj herë pas here, janë bërë korrigjime. Fakt është se edhe tash ne po korrigjojmë, sido që kriteret kanë qenë dhe mbenët të drejta.

Organizimi më i efektishëm i punës dhe i pagave është ai që ndërtohet në baza të drejta marksiste-leniniste, që ka si objektiv zhvillimin e vrullshëm dhe të harmonishëm të ekonomisë dhe të kulturës; që synon ngrijtjen e mirëqenies ekonomike dhe që e ndihmon këtë proces të ecë përpara. Duke u mbështetur në këto baza, ne duhet të orientohemi në atë që tu japim kurdoherë prioritet të ardhurave reale të popullsisë dhe rritjes së pagës reale të punonjësve, nëpërmjet uljes së çmimeve.

Unë mendoj se rritja e pagës nominale të punonjësve nuk duhet të përdoret, përvçse në disa raste ekstreme dhe të rralla. Ngritja e rendimentit, aftësimi në punë e të tjera çështje stimulohen me format e organizimit dhe të pagave që kemi vendosur osc me këtë riparim të pjesshëm që mund të bëjmë.

Në disa orientime që u dhashë shokëve, kur ishin duke punuar për këto probleme, vija theksin në idenë që, mundësisht, sistemit të pagave t'i bënim korrigjimet e nevojshme lidhur me organizimin e punës, duke u bazar jo vetëm në aktualitetin objektiv, por të kihet pa-

rasysh edhe perspektiva. Kështu që korrigjimet e herë-pashershme të mëvonshme, që mund të kërkonin situatat të bënimi, të ishin anësore, të pjesshme, pa lëvizur trungun parimor. Unë rekomandoja në ato orientime që, në përcaktimin definitiv të normave që rregullojnë këto marrëdhënie, duke u bazuar në gjendjen aktuale të niveli të jetesës të përsaqësuar nga disa paga-bazë, të shihnin nëse mund t'u bëjmë ndryshime këtyre pagave-bazë dhe pastaj të gjykonim proporcionet e këtyre ndryshimeve. Veçanërisht ishte e nevojshme të përfaqtohet niveli i një page, e cila, në kushtet e sotme të zhvillimit të shoqërisë, të përsaqësonte një nivel jetese të pranueshëm për punonjësit. Të bazuar në këtë, ne do të gjykonim më drejt aktualisht dhe në perspektivë. Do të shihnim, gjithashtu se a do të duhej të bënim ndryshime në klasifikimet dhe shkallëzimet aktuale dhe a kishte mundësi t'i bënim në një etapë të gjitha këto ndryshime. Në rast se jo, ne duhej të ndërtonim një organizim të tillë, siç thashë më lart, që të na i lejonte t'i bënim këto korrigjime në etapa të ndryshme. Unë mendoj se këto studime shokët i kanë bërë, pavarësisht se këtu në këtë studim nuk na jepen të dhëna.

Ne jemi udhëhequr dhe udhëhiqeini nga disa paramë e preokupacione me karakter shoqëror në përcaktimin e pagave. Duhet të kemi gjithashtu të qartë perspektivën se ku dhe si do të shkojmë me këto.

Paga kurdoherë është personale. Personi shpërblehet për aq sa i jep shoqërisë, brenda të gjitha normave dhe ligjeve që rregullojnë marrëdhëniet socialiste në vendin tonë.

Pagat e ulëta dhe pastaj ato të mesmet janë paga

masive, prandaj në to duhet të përqendrohet edhe preokupacioni ynë më i madh. Këto paga duhet të na orientojnë, pse pikërisht këto përfshijnë shumicën e punonjësve dhe te këta shfaqen më dukshëm vështirësitet e jetesës.

I riu ynë, për shembull, në përgjithësi hyn në jetë dhe fillon nga puna e nga paga, pra, shkëputet nga prindërit si barrë ekonomike, rrëth moshës 20 vjeç. Ai e fillon punën me pagën minimale dhe pastaj ngjitet. Niveli i tij i jetesës, pas martesës, ndryshon ngajeta e beqarit. Kur të rintjtë krijojnë familje, bëhen dy veta me pagë; pastaj fillojnë bëjnë fëmijë. Sikur për çdo familje të llogaritim mesatarisht 4 fëmijë, të dy prindërit duhet t'i ushqejnë ata të paktën për 20 vjet rresht. Pra, deri në moshën 45 vjeç prindërit kanë detyrime dhe afërsisht pas kësaj moshe fillojnë të lehtësohen. Gjatë gjithë kësaj kohe ata janë ngritur nga ana profesionalë, pra që në pagë. Pikërisht niveli i jetesës i kësaj kategorie të madhe punonjësish, në këtë periudhë kohe, duhet të na preokupojë më shumë në përcaktimin e koeficientit të pagave dhe në shkallëzimin e tyre, nga kategoria më e ulët, në kategorinë më të lartë.

Llogaritja e buxhetit familjar është e drejtë të bëhet dhe është vepruar gabim që nuk është bërë deri më sot. Unë e shtroj çështjen kështu: një njeri me pagën bazë më të ulët, po të kemi parasysh që kjo pagë është personale, me të ai do të ushqejë vetëm vetvete. Po punëtori mund të ketë fëmijë në ngarkim dhe me të nuk mund të plotësojë siç duhet të gjitha kërkesat. Shteti paguan sipas parimit socialist: shpërblim sipas punës. Çështja se si do ta administrojë secili buxhetin e tij famil-

jar është punë tjetër. Por në punë do të ketë edhe pjesëtarë të tjerë të familjes. Edhe qiratë e shtëpisë janë minimale etj., por këto duhen llogaritur në mënyrë që të dimë përsë duhet të ngremë rrogat e ulëta. Puna këtu nuk është për kaq apo aq veta, por për ta parë në parim çështjen e pagave të ulëta dhe mesatare që janë masive. Po të ishte puna për ta zgjidhur problemin e pagave të ulëta, duke dhënë 5 milionë lekë, këto i japim që sot, po çfarë përmirësimesh bëjmë me to?

Në qoftë se arsyetohet rritja e pagës minimale që të rregullohet raporti me minimalen e pensionit të pleqërisë, më duket se ky argumentim nuk është as i bazuar dhe as i drejtë. Aktualisht disa njerëz kanë një rrogë të ulët, por ne parashikojmë që, në një perspektivë jo shumë të largët, pasi të jetë rritur edhe më mirëqenia, të jetë shtuar prodhimi etj., të rritim pagën reale duke ngritur minimalen. Këto vështirësi pra, këshiu do të kapercehen e jo duke vepruar në mënyrë matematike.

Pse pensioni minimal duhet të jetë më i ulët nga paga minimale? Përkundrazi, unë mendoj se minimalja e pensionit mund të jetë më e madhe se minimalja e pagës. Jeta aktive e pensionistit, kur del në pension, vërtet pakësohet, por ai punoi për popullin dhe shtetin deri në moshën 55-60 vjeç. Në këtë kohë shteti atij i jep pensionin në bazë të pagës që merrte. Kurse i riu që hyn në punë, jetën e ka përpara, ai sa ka mbaruar shkollën prandaj ka kohë për të marrë rrogën maksimale. Atëherë për ç'arsye ai që fillon nga puna, duhet të marrë më shumë nga pensionisti që i kanë rënë flokët? Kjo më duket nuk është as njerëzore, as dhe e drojtë nga ana parimore.

Ne nuk jemi për të mos i shikuar këto paga, le t'i shikojmë, po të vështrojmë realitetin, anën financiare dhe ekonomike të vendit. Asnjjeri nuk është që të mos ngrihet niveli i jetesës, por duhet shikuar pak më thellë kjo çështje, për të mos krijuar probleme në ekonomi.

Po këto shtesa që përmenden, për punëtorët që punojnë në veprat e mëdha, si për vështirësi punc, ashtu dhe për vështirësi ekonomike, në ç'mënyrë arsyetohen? A janë studiuar mirë këto çështje? Unë nuk e di mirë, por në qoftë se do të jetë kështu si do të them, kujtoj se vështirësia ekonomike nuk ekziston: ushqimin punëtori e ha në mensë kundrejt një pagesë minimale, që i bie më lirë se ushqimi në shtëpi, qira banese ai nuk paguan, se banon në fjetoret që ndërton shteti posaçërisht etj. Vërtet se ai gruan dhe fëmijët nuk i ka pranë, por këtu nuk ka të bëjë më ana ekonomike, këtu hyn patriotizmi për t'i shërbyer atëheut atje ku ka nevojë. Për këtë çështë e nevojshme të intensifikohet shumë puna ideologjike, duke i shpjeguar punonjësit se nuk do të qëndrojë larg familjes për tërë jetën, po gjersa të ndërtohet metalurgjia ose objekti tjetër ku çështë dërguar. Pastaj, dora-dorës, kur të mbarohen punët, ata do të shkojnë pranë shtëpive të tyre. Në qoftë se pagesashësë bëhet vetëm përfaktin e jetesës larg familjes, dhe kjo gjë duket me vend, atëherë pse të paguhet shtesë vështirësic vetëm përfpunonjësit e Fierzës, apo Metalurgjikut, e jo edhe përgjithë të tjerët që punojnë larg familjeve? Si do të shkonte atëherë puna, po që se të tërë do të paguheshin kështu? Parimin nuk do ta ndërtojmë sipas dëshirës së njërit apo të tjegrit, po në bazë të disa arsyeve, si, bic sfala, arsyec ekonomike ose arsyec huma-

nitare, kur është rasti që punëtori largohet nga familja.

Kështu me të dy variantet që propozohen, nga të cilat Qeveria është për variantin e dytë, ne do të ndihmo-heshim për të zgjedhur variantin më të mirë, në rast se gjendja do të na ishte svaruar me disa të dhëna mbi jetesën e disa personave që marrin paga të kategorive të ulëta dhe mesatare, nga ato që janë më masive, për të krijuar kështu një ide për korrigimet që mund të bënim. Por, kjo do të ndihmonte edhe për perspektivën, se ka të bëjë me raportet midis pagës më të ulët me atë më të lartë, si tani ashtu edhe në të ardhmen. Të supozojmë se këto raporte aktualisht janë ndërtuar afërsisht drejt. Në të ardhmen mendoj se duhet të shkohet me synimin që këto raporte të vijnë duke u ngushtuar, në varësi me mundësinë e zvogëlimit të numrit të kategorizimeve, si konsekuençë e një kualifikimi më të madh e më masiv të punonjësve, duke u ruajtur natyrisht nga tendenca e egalitarizmit, pa hequr dorë nga stimuli i kualifikimit, i ngritjes së rendimentit, i vjetërsisë në punë (eksperiencës teoriko-praktiko-profesionale), i vësh-tirësisë etj.

Si rrjedhim, në qoftë se nuk gabohem, kategorizimet e vendeve të punës, pavarësisht se aktualisht mund të ketë propozime që të shlohen, mendoj se në të ardhmen do të zvogëlohen si numër dhe nuk do të zmadho-hen, për arsyet të ngritjes së nivelit arsimor e tekniko-profesional të punëtorëve, që nga data kur hyjnë për herë të parë në punë dhe gjatë procesit të ngritjes në kategori.

Pra, politika jonë në të ardhmen për arsyet që përmenda më lart, duhet të ecë me kujdes drejt ngushti-

mit të diferencave në pagë midis punëtorëve nga njëra anë dhe personelit inxhiniero-teknik dhe atij administrativ nga ana tjetër, duke bërë kujdes që të mos biem në egalitarizëm.

Vetë koha do të na mësojë për të bërë ndryshime të tjera të drejta. Por ne edhe raportet e pagave në mes personelit inxhiniero-teknik dhe atij administrativ duhet t'i sjellim në një nivel me një diferencë sa më të vogël ose anasjelltas, pse edhe personelin administrativ do ta ngremë sa më lart nga ana profesionale. Në të dy rastet, raportet e tyre me punëtorët (flas kurdoherë për çështjen e raporteve të pagave) duhet të korrigohen në favor të kategorive të ulëta dhe të mesme.

Në të ardhmen, tok me shtimin e të ardhurave kombëtare dhe të të ardhurave reale të popullsisë, duke i dhënë prioritet uljes së çmimeve, për rritjen reale të pagës së punonjësve, ne mund të manovrojmë me një politikë, e cila të ketë kurdoherë për synim rritjen e pagave nië të ulëta, por përsëri të jetë një politikë e balancuar, e ndërmjetme, që t'i përgjigjet fuqisë blerëse dhe të mos rrezikojë stabilitetin monetar.

Ne u shtymë të bënim këtë studim «Mbi problemet e punës dhe të pagave» për arsyen e tyre, për t'u gjetur prejardhjen dhe për t'i korrigjuar. Ky studim do të na lejonte, gjithashtu, të rishikonim në tërësi edhe sistemin e organizimit të punës dhe të pagave, nëse në të kishte vend për korrigjime e përmirësimet, në formë dhe në substancë, sido që në parim ato ishin ndërtuar drejt.

Ne konstatonim (dhe raporti që na paraqitet na i vërteton shqetësimet), se në zbatim në mjaft vende punc

nuk u është përbajtj parimeve të drejta të shpërbllimit: Degë të ndryshme të ekonomisë nuk ruajnë më kategorinë e caktuar në tabelat e pagave e disa anomali të tjera si këto. Nëse ne do t'i korrigojmë këto anomali (dhe këtë gjë duhet ta bëjmë), diçka dhe dikush duhet të preket, pse në fakt është krijuar një situatë, ku disa, në pagesa, marrin më shumë nga sa u takon, disa të tjerë më pak dlie një pjesë ecën normalisht. Këtu ka dy rrugë: ose të pranojmë statukuonë dhe, mbi këtë, të vazhdojmë të bëjmë korrigimet duke i sjellë të gjitha të tjerat në nivelin e anomalive, ose të zhdukim anomalitë dhe pastaj të shohim përmirësimin e pagave në gjithë sistemin. Është e natyrshme se rruga e parë duhet braktisur, kurse e dyta është më e drejta.

Por, edhe zhdukja e shkaqeve të anomalive lyp një periudhë kohe e cila duhet caktuar sa më e shkurtër, se përndryshe sa më e gjatë të lihet kjo periudhë, aq më shumë do të vështirësohet problemi, si nga ana ekonomike, ashtu edhe nga ajo politike, pse njerëzit ambientohen me një situatë jonormale dhë me zor shkëputen prej saj. Shtetit, gjithashtu, i duhet të bëjë sforco të mëdha për riparimin e situatave.

Natyrisht edhe për përmirësimin e pagave në gjithë sistemin duhet një periudhë kohe mjaft e gjatë, pse ky problem nuk është një operacion i thjeshtë matematik, por një nga problemet kyç më të vështira të ekonomisë socialiste, një problem i madh e kompleks, për të cilin po luftohet e do të luftohet çdo ditë e çdo pesëvjeçar drejt përmirësimit e zgjidhjes së tij.

Kur filluan këtë studim, unë kisha bindjen se jo vetëm do t'i zbulonim anomalitë (një pjesë të të cilave

i njihnim edhe më parë), por do të gjenim edhe mënyrat e metodat për t'i eliminuar ato.

Për sa i përket përmirësimit të pagave të punonjësve, në situatat aktuale, nuk shihja mundësi të mëdha. Një gjë e tillë do të ishte e zorshme të bëhej dhe konkluzionet e Qeverisë këtë gjë vërtetojnë. Por studimi, pavarësisht se nuk mund të merren masa të plota që imediate, na përcakton një rrugë që të punojmë me etapa në këtë drejtim.

Ngritja e nivelit të jetesës së popullit, siç e dimë dhe siç luftojmë çdo ditë, është e lidhur ngushtë me realizimin e planeve ekonomike. Ngritjen e nivelit të jetesës ne e përcaktojmë në planet e çdo viti e të çdo pesëvjeçari, si për punonjësit e qytetit, ashtu edhe për ata të fshatit.

Ka ngritje të nivelit të jetesës? Ka, si s'ka, çdo vit e çdo pesëvjeçar. Por, kjo rritje duhet të ecë me ritme më të shpejta.

Për nevojat e zhvillimit të ekonomisë investimet tonë të ndryshme shtohen. Gjithashtu shtohet edhe fondi i pagave e prodhimi, por jo në atë sasi e cilësi që ishin planifikuar. Për të ruajtur nivelin e jetesës detyrohemë t'i plotësojmë këto me importime. Fuqia blerëse e popullit relativisht nuk është e ulët. Këtë e tregojnë kërkuesat në treg për mallra të ndryshme, dhe depozitimet nga populli në arkat e kursimit.

Prandaj, në këto situata, para se të marrim masa të mëtejshme, qoftë edhe të pjesshme, për riparimin e pagave, duhen mbuluar këto me mallra konsumi nga më kryesoret, për të cilat ka nevojë populli. Këto mallra duhet t'i sigurojmë me realizimin e planeve tona. Edhe

rruga tjetër, ajo e importit, me klering ose me devizë qoftë, do të përcaktohet, gjithashtu, nga realizimi i planeve. Të ngremë pagat duke shtuar emisionin e monedhës, pa e mbuluar atë me mallra dhe, në një kohë, kur ne kemi shkuar duke i ulur çmimet dhe jo duke i ngri-
tur, është e rrezikshme. Kjo do të shkaktonte inflacionin dhe do të na krijonte perturbacione të rënda. Ne s'kemi pse shkojmë në një rrugë të tillë, që nuk është rruga jonë, aq më tepër kur situata jonë ekonomike nuk paraqitet shqetësuese.

Populli është i kënaqur me pagat që merr gjithsecili për punën që bën. Ai, me të ardhurat që fiton, me ekonomizimet që bën, kërkon të blejë mallra ushqimore, industriale, të ndërtimit etj. Ne duhet t'i përmirësohet këto nevoja dhe ta mësojmë atë që të organizojë sa më mirë punën, të prodhojë sa më shumë dhe, mbi këtë bazë, të përmirësohet edhe paga reale c' tij e të ngrihet niveli i jetesës.

Pra, zgjidhjen e kësaj çështjeje duhet ta shohim jo duke shtuar emisionin e monedhës. Ata qindra milionë që na duhen për të ndrequr anomalitë në paga ose për t'i përmirësuar ato t'i nxjerrim nga realizimi dhe tejkalimi i planeve; nga ndalimi i kërkeshës përfuqi punëtore të tepërt dhe nga lufta ndaj fryrjes së organikave; duke u treguar të matur në investime e ndërtime; duke lusfuar për uljen e normativave të lëndëve të para c' të materialev; duke bërë përpjekje më të mëdha përfshurtimin e importit dhe rritjen e eksportit e një sërë çësh-
tjesh të tjera. Këto, pra, duhet t'i realizojmë që të mund të ndërmarrim veprime në përmirësimin e pagave.

Në çdo studim të kësaj natyre, siç është ky i «or-

ganizimit të punës dhe të pagave» që po bëjmë, të mos e shkëputim kurrë problemin kooperativist nga ai i klasës punëtore dhe i punonjësve të administratës. Kur flasim për ngritjen e nivelit të jetesës së popullit, të organizimit të punës dhe të pagave, të kemi kurdoherë parasysh jo vetëm parimet, por edhe zbatimin e tyre në praktikë. Ne po luftojmë për ngritjen e vazhdueshme të mirëqenies, si në qytet edhe në fshat, si në fabrikë edhe në arë. Ne duhet të luftojmë që të ecim drejt ngushtimit të disnivelit ekonomiko-kulturor të fshatit me qytetin. Bujqësia është baza e ekonomisë sonë. Shumica e popullsisë te ne jeton në fshat, ku puna është më e rëndë nga ajo e shumë sektorëve të qytetit; po kështu edhejeta ekonomike e kooperativistëve nuk është në nivelin e punonjësve të qytetit. Kjo bën të lindë ajo tendencë që shohim, që fshatari kërkon të vijë në qytet. Ne e frenojmë dhe duhet ta frenojmë, por me dekrete kjo zor se mbahet për shumë kohë. Ç'do të bëhet në rast se nuk do të marrim masa të atilla që kooperativisti të rrijë me kënaqësi në fshat, duke ia lehtesar punën e rëndë me mjete të mekanizuara dhe duke u përpjekur që t'i përmirësohet atij niveli i jetesës?

Ç'do të ngjasë në rast se, duke shkuar nga mendimi se punonjësit e qytetit paguhen prej shtetit dhe janë më pak se fshatarësia, ndërmarrim veprime për përmirësimin e mëtejshëm të jetesës së tyre, pa marrë parasysh të tërë tablonë, pa i lidhur dhe harmonizuar të gjitha çështjet? Natyrisht, edhe në këtë rast, punët nuk do të na shkojnë mirë, pse do të ndreqim nga një anë, po do të prishim nga ana tjetër.

Ç'duhet të bëjmë, pra, në këto situata, për ta for-

cuar punën? Raporti i Qeverisë jep mjaft zgjidhje. Ne duhet të përcaktojmë një kriter bazë për pagesat, që, sipas mendimit tim, ky duhet të jetë vendi i punës. Këtu ka dy gjëra. Është tjetër çështje kur gjatë ditës punëtori ndryshon procesin e punës për nevojat e prodhimit dhe është diçka tjetër kur në vend që të punojë 8 orë, ai bën vetëm 6 ose 7 orë punë. Këto dy çështje të mos i ngatérrojmë, ndryshe do të harxhonim kohën kot. Nevoja që punëtori të ndryshojë punën për një ose dy ditë, do të lindë në prodhim, po ne duhet të caktojmë nëse ai do të paguhet me kategorinë e vendit të punës apo me atë personale? Punëtorit që nuk e ka kategorinë e vendit të punës për të cilin paguhet, mund t'i themi që tanise ai rri «kontrabandë» në këtë vend, prandaj ne t'i japim, ta zëmë, një vit asfat që të marrë kategorinë e vendit të punës. Në qoftë se nuk e merr, ne prapë mund ta mbajmë, po duhet ta paguajmë sipas kategorisë që ka, se një njeri mund të rrijë edhe 20 vjet në punë me të njëjtën rrogë, kur nuk bën përpjekje për tu kualifikuar. Këtu duhet të vëmë rregull, të pranojmë parimin e drejtë, që punëtori të paguhet sipas vendit të punës, kur të ketë aftësinë dhe kualifikimin që kërkohet. Në qoftë se e pranojmë këtë parim, atëherë njeriu i kategorisë së dytë që është shumë i zoti dhe punon me një punëtor të kategorisë së gjashtë, nxjerr prodhim të mirë etj., duhet të zbatojë orientimet e drejta të Partisë që të kapërcejë shkallët dhe, duke mësuar, të marrë kategori më të lartë.

Në qoftë se për nevoja pune, për shembull, punëtori i kategorisë së gjashtë katër muaj në vit, vendoset të punojë në një vend pune të kategorisë së pestë apo

të katërt, duhet të paguhet me kategorinë e gjashtë që i është caktuar. Po pati ndërmarrja punëtorë të tjerë, të kategorisë së tretë apo të dytë, le t'i dërgojë këta në këto procese me kategori më të ulët, kurse punëtorin e kategorisë së gjashtë të mos e lëvizë. Unë mendoj se nuk duhet të ndryshojmë mënyrat e pagesës sa herë që punëtori gjatë ditës kalon nga një proces pune në tjetrin. Përse duhet të hyjmë në kaq hollësira për pagat? Ne duhet t'i paguajmë punëtorët në bazë të punës kryesore, sepse për një ose dy ditë që punonjësi merret me një punë tjetër, do të jetë rast i veçantë.

Duke pranuar sistemin e kategorizimit të vendeve të punës, këto kategorizime duhet të bëhen shkencërisht dhe të azhurnohen në periudha të caktuara tok me zhvillimin e modernizimin e ekonomisë në përgjithësi dhe brenda degëve në veçanti. Krahas kësaj ne duhet të kemi edhe librat e kualifikimit të punëtorëve, të cilët duhet t'u korrespondojnë kategorizimeve të vendeve të punës. Me fjalë të tjera duhet të kërkohet kualifikimi i punëtorëve dhe i nëpunësve gjë që do të shërbejë për atestimin dhe kategorizimin në punë, i cili do të merret si bazë për pagën.

Mospërcaktimi drejt, rigoroz e shkencor i këtij kriteri bazë, i kategorizimeve dhe i librave të kualifikimit ose të kategorive që jepen në shkolla dhe mosndjekja pikë për pikë e zbatimit të tyre, do të sjellë perturbacione në përcaktimin e kritereve të pagave, në raportet midis tyre, në sasinë dhe në cilësinë e prodhimit etj. Mendimi im është se atestimi zyrtar kulturor e profesional duhet të jetë kriteri bazë për përcaktimin e kategorisë personale. Atestimet e marra shërbejnë për klasifikimin e

punonjësve në kategoritë e ndryshme të punëve në bazë të të cilave dhe shpërblehen, por njëkohësisht pajisen me një kulturë sa më të gjerë e të shumanshme, për të qenë me të vërtetë njerëz që ndërtojnë dhe drejojnë sistemin e ri socialist. Kultura është e domosdoshme për tërë punonjësit dhe shteti e jep këtë pa përjashtim me të gjitha format. Prandaj ajo që thuhet për variantin e dytë se me vendosjen e këtij sistemi ka mundësi që, «kualifikimi i punëtorëve të marrë më tepër karakter të përgjithshëm teoriko-shoqëror, duke u shkëputur nga nevojat konkrete të prodhimit etj.», më duket se nuk është e drejtë as teorikisht, as praktikisht.

Kërkesat e atestimeve do të bëhen në bazë të diturive që jepen dhe për të cilat kemi ndërtuar një sistem të tërë shkollash e kursesh. Këtë kulturë të shumanshme ne e japim jo vetëm për zhvillimin e ekonomisë socialiste, por edhe për të gjitha aktivitetet që lidhen me të. Nevojat konkrete të prodhimit nuk mund dhe nuk duhet të përjashtojnë punëtorët nga kultura teoriko-shoqërore, nga kultura që i mëson ata të organizojnë e të drejtojnë, pse atëherë largohemi nga parimi dhe na krijohet kështu një kastë burokratësh e teknokratësh. Që nga kurset më të ulëta e deri në të diplomuarit universitarë ka një gamë të madhe atestimesh kulturore, që specializojnë shkallë-shkallë njerëzit, edhe teorikisht, edhe praktikisht. Kombinimi i këtyre dy drejtimeve duhet të bëhet patjetër. Duke pranuar variantin e dytë, nuk zhdukim në asnjë mënyrë kërkesën për kualifikim, përkundrazi këtë e nxitim dhe e nxitim drejt. Të gjitha punët duan kualifikim të punëtorëve, pra edhe atestim të tyre.

Ne aktualisht, nuk ka pse të bëjmë ndonjë ndryshim

në tabelat e pagave. Bile, edhe ato kategori që propozon Qeveria a janë urgjente të bëhen që tash, apo t'i lëmë për më vonë?

Ne duhet të ristudiojmë edhe një herë shkencërisht kategorizimet e ndryshme të proceseve (të vendeve) të punës dhe për këtë të caktojmë një afat. (Edhe për pagat e punonjësve unë jam i mendimit të vendosen kategori, se sa duhet të jetë maksimalja e minimalja, të cilat deri tani nuk kanë qenë një rregullator aq stimulues). Të studiojmë, gjithashtu, edhe një herë shkencërisht librezat e kategorizimeve, të shkollave e të kurseve, me një fjalë të atestimeve kulturore-tekniko-profesionale që duhet t'u korrespondojnë kategorizimeve të proceseve të punës. Kur t'i kemi bërë këto, të caktojmë afate të studiuara për zbatimin e tyre. Këto afate duhet të shërbejnë përmarrjen e atestimit nga ata punonjës që nuk e kanë. Gjatë këtyre afateve të merren edhe masat për organizimin e shkollave e të kurseve, të cilat deri tani nuk i kemi të përgatitura siç duhet për këtë punë.

Më falni të bëj një parantezë, për një çështje që e kam shkruar në shënimet e mia. Nxënësi që mbaron shkollën teknike, pavarësisht se i japim kategori për një profesion, ka mësuar dhe është në gjendje të ushtrojë dy-tri zanate. Në librezat personale aktuale ne cilësojmë që ai të jetë, fjala vjen, hidraulik, kurse të tjerat nuk ia përmendim, megjithëse kemi nevojë që ky teknik të na shërbejë edhe si hidraulik, edhe si saldator, edhe si elektricist apo ndonjë profesion tjetër. Prandaj unë jam dakord me atë që u tha këtu që t'i rishikojmë librezat, të cilat të bëhen të atilla që të mos dëshmojnë vetëm përfaktin se punëtori ka mbaruar shkollën teknike, por

edhe se ka dhënë provim e është atestuar për një, dy ose tri zanate që zotëron. Kjo zgjidhje e problemit do të na shërbejë për shumë gjëra. Kur të marrim në shtëpi, për shembull, një hidraulik të kategorisë së katërt, ai do të kryejë vetëm shërbimet hidraulike, ndërsa shërbimet elektrike nuk do të jetë në gjendje t'i bëjë. Prandaj, pas hidraulikut duhet të thérresim edhe elektricistin. Në qoftë se një teknik njeh dy-tri zanate, për të cilat i është dhënë atestimi, atëherë ai mund të punojë edhe si hidraulik, edhe si elektricist, edhe si marangoz dhe të paguhet me kategorinë sipas atestimit. Kështu do të shumojmë diturinë e njerëzve dhe, në të ardhmen do të shkojmë drejt ngushëlimit të dallimeve në këto profesione.

Ne duhet të vendosim qysh tash nëse do të qëndrojmë në ato tarifa page që kemi vendosur dhe që janë të drejta. Anomalitë në sistemin ekzistues na shkaktohen nga mënyra e llogaritjes së pagës-bazë. Këtë duhet ta rregullojmë dhe kjo anomali të zhduket, pa ulur nxitjen në shtimin e rendimentit dhe pa harruar vështirësitë e mundësitet që ka shteti sot për sot për të mekanizuar të gjitha proceset e punës të të gjitha kategorive dhe të të gjitha degëve të prodhimit, të njëllojta ose të përaferta në tabelën e pagave. Në këto drejtime duhet manovruar me normat. Fakt është se normat i prishin proporcionet e tabelave të pagave, po këtu ka anomali.

Normal teknike duhet të janë baza orientuese dhe për këto duhet të kemi një tarifë pagese më të lartë nga të gjitha llojet e tjera të normave. Në bazë të kësaj norme të caktohet edhe kategorizimi i llojit të normave të tjera. Kjo gjë natyrisht duhet studiuar. Për normën teknike të mos caktohet as shpërblimi që është tanë, po

qe se këtë e konsiderojmë të madh. Në qoftë se çmojmë që shpërblimi i tanishëm është i arsyeshëm, atëherë le të pranojmë këtë si bazë. Në studimin e uljes së pagës, për normat e tjera, të kihet parasysh që të mos ulet niveli i jetesës. Punëtori do të detyrohet kështu të shfrytëzojë tetorëshin që të plotësojë të paktën këtë normë. Kufijtë midis llojeve të normave nuk mund të zhduken. Të mos na ngjasë ajo që normat të janë të përafërtë. Dërisa kemi normën eksperimentale për të ka orientime dhe kufij të caktuar, prandaj i dallojmë me emrat e vëçantë: normë teknike, normë progresive etj. Në qoftë se zhduket dallimi, ka rrezik që norma statistikore «të shitet» për normë teknike. Po të paguhet norma eksperimentale njëlloj si norma teknike, atëherë rezultati i punës së tyre duhet të jetë i barabartë dhe, për pasojë, kjo e fundit, s'është më normë teknike.

Pasi t'i kemi kategorizuar llojet e normave, brenda tyre, të përcaktojmë kufij, domethënë kategori pagash të ndryshme për tejkalime të ndryshme të normave. Tejkalimi të bëhet i shtrënguar, të mos kapërcehen dot në atë shkallë që bëhet sot. Një masë e tillë, mendoj se do të bëjë që punëtori të shfrytëzojë si duhet kohën e punës, të jetë më i disiplinuar e më i rregullt. Nxitja për të punuar do t'i shtohet; rendimenti do të jetë më i lartë e drejtësia në shpërndarjen më e mirë.

Në këto përllogaritje të kemi parasysh nivelin e jetesës së punonjësit. Pak ulje edhe mund të ketë, por jo nga paga-bazë. Kjo vjen se ajo që do t'i hiqet rrjedh nga diçka jonormale, që ka ekzistuar deri tani, si dhe nga përpjekjet e pamjaftueshme të vetë punëtorit. Në qoftë se këto përpjekje punëtori i bën me punë të shtrën-

guar e të disiplinuar duke arritur rendiment të lartë, atëherë e kompenson edhe atë që në ndonjë rast mund ta humbasë.

Për sa u përket propozimeve për sektorin kooperativist, jam dakord me propozimet e Qeverisë që të ruajmë shpërblimin sipas vendit të punës. Ashtu si mëson punëtori, të mësojë edhe kooperativisti, sepse edhe atje kemi hapur shkolla e do të hapim edhe të tjera, pavarësisht se ndryshon një çikë procesi i punës. Pjesërisht mund të shikohen edhe disa propozime që bëjnë shokët e aparatit të Komitetit Qendror. Në përgjithësi unë këto kisha për këtë çështje.

Pas kësaj u kalua në diskutimin e pikës së dytë të rendit të ditës. Lidhur me çështjet që u trajtuan shoku Enver Hoxha tha:

Industria ushqimore dhe ajo e lehtë kanë krijuar një sektor të gjerë punësh që do të zgjerohet vazhdimisht akoma më shumë në të ardhmen. Kjo industri do të plotësojë nevojat e konsumit të gjerë të popullit, për të cilat ne në disa prodhime jemi akoma relativisht prapa. Për të bërë një organizim të ri, të mos mbetemi vetëm te degët e vjetra, duke pasur frikë ta çojmë çështjen deri në fund. Në qoftë se mendojmë që krahas industrisë së lehtë të zhvillohet njëkohësisht edhe e rënda, unë mendoj se duhet të kemi dy ministri. Ministria e Industrisë dhe e Minierave ka shumë sektorë, si atë të kromit, të bakrit etj. pra, detyrat e saj shtohen. Mirëpo, me këtë zhvillim që marrin punët, secila nga këto degë të industrisë minerale aktualisht është si një «ministri» në miniaturë.

Në bujqësi gjithashtu kemi halle të mëdha, prandaj

kemi krijuar hozrashote në ndërmarrjet bujqësore. Megjithatë, mendoj që Ministria e Industrisë dhe e Minierave të ketë tërë industrinë, me përjashtim të asaj ushqimore dhe të veshmbathjes. Kësaj ministrie i mbeten sektorë të gjerë dhe të mëdhenj, që i diskutuan më parë, siç janë industria e ndërtimit të fabrikave, industria mekanike, metalurgjike dhe elektrike. Në situatën aktuale, kur po zhvillojmë industrinë e rëndë dhe kur rëndësi i kushtojni edhe industrisë së lehtë e ushqimore, duhet të forcojmë organizimin e drejtimin e tyre që t'u përgjigjet si detyrave të sotme ashtu dhe të perspektivës.

Po të vendosim që të krijojmë dy ministri, një për industrinë e lehtë dhe një për të rëndën, atëherë të diskutohet çështja se kush do t'i grumbullojë lëndët e para. Nuk mundet, për shembull, bukën ta bëjë e ta bluajë një organ, kurse lëndën e parë ta ketë dikush tjeter. Nuk më duket e drejtë, fjala vjen, që fabrikat e nishestesë t'i administrojë një organ dhe lëndën e parë një tjeter. Ose pambukun do ta ketë ai që do të bëjë jo vetëm zhveshjen e grumbullimin e tij, por edhe tekstilet e pambukta. Po kështu mund të thuhet edhe për mishin. Mishin të mos e shesim ashtu sikurse e shiste kasapi dikur. Tani, në qoftë se nuk gabohem, mishin e ndajmë në copa, e futim në qese celofan dhe pastaj e shesim. Kjo do të thotë industrializim.

Ne duhet të shkëputemi nga rutina e vjetër dhe të mendojmë se si duhet të veprojmë më mirë në kushtet e reja.

Mua më duket se, në përgjithësi, shqyrtimi që i ka bërë Qeveria kësaj çështjeje është i drejtë dhe mund ta pranojmë. (*Të gjithë u shfaqën dakord.*)

Në qoftë se e pranojmë ndarjen e Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave dhe krijimin e Ministrisë së Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore, atëherë Qeveria të marrë përsipër të bëjë këtë ndarje.

Jam dakord me propozimin e bërë për shkurtimin e organikave. Por ne duhet t'i rekomandojmë Qeverisë që ta mbajë gjithmonë parasysh këtë problem dhe herë pas here ta thellojë akoma më shumë. Vërejtjet e shokëve të aparatit të Komitetit Qendror për çeshtjet e kooperimit, të profilizimit etj., si edhe për shkurtimin e aparateve dhe të administratës, si gjer tani edhe në të ardhmen, duhen pasur parasysh.

Duhet parë, gjithashtu, se mos jemi treguar pak dorëleshuar në organikën e pushtetit në fshat, duke krijuar shumë nepunës. Është me vend që kryetarëve të këshillave popullorë të fshatrave t'u jezet shpërbllim mujor në të holla? Unë nuk e kam sjalën për kryetarët e këshillave popullorë të fshatrave të bashkuara, po për fshatrat e veçuara që janë shumë. Derisa ne kemi krijuar këshillin e bashkuar në kooperativë, ku kryetari është me autoritet etj., s'ka nevojë që në çdo fshat të ketë përsëri një kryetar këshilli me pagë. Kryetari i këshillit të fshatit nuk mund ta bëjë këtë detyrë duke zbatuar vijën e masave për disa probleme që duhet të zgjidhen në fshat? Edhe kryetari i këshillit të fshatit le ta kryejë detyrën vullnetarisht ashtu siç bën kryetari i Frontit, sekretari i organizatës së rinisë apo përgjegjësja e organizatës së gruas. Unë mendoj të shikohet me kujdes që të mos rritet numri i njerëzve me paga fiksë në fshatra. Nuk flas këtu për mësuesin, maminë, punonjësit e shërbimeve komunale ose të çerdheve, por për të tjerët. Na

raportojnë që në disa fshatra ka çerdhe me personel në numër më të madh se ai i fëmijëve. Natyrisht, kjo nuk ndodh kudo, megjithëkëtë nuk duhet të jemi dorëlëshuar. Ne rekomandojmë të bëhen këto gjëra, megjithatë Qeveria duhet ta ketë kurdoherë syrin në këtë drejtim jo vetëm për anën financiare, po edhe për të shmangur mundësinë e krijimit të një shtrese të privilegjuar dhe parazite njerëzish që veprojnë nën maskën e pushtetit.

Të kemi parasysh që të mos përsëritim praktikën e gabuar që kur bëhen organizimet, tregohemi dorëlëshuar, duke gjykuar se «meqë po e bëjmë dhe po marrim tërë ato masa, të shikojmë organikat». Kjo metodë pune s'është e drejtë dhe ja, me një rishikim që i bëri Qeveria kësaj çështjeje, u shkurtuan 1 200 veta. Kjo na bën të dalim me konkluzionin se këta 1 200 veta ne nuk i kemi parë mirë kur i shtuam.

Gjer tanë kemi bërë e po bëjmë shumë për kualifikimin e njerëzve që punojnë në administratë, prandaj këta duhet të mbajnë mbi shpatulla më shumë punë. Kur u futemi më mirë çështjeve, shikojmë që disa njerëz, megjithëse janë të kualifikuar, vijnë e raportojnë çdo muaj në qendër për probleme të përgjithshme, sepse venë fshat më fshat e rreth më rreth dhe në secilin vënë re po ato gjëra. Kjo ndodh pse 7 ose 8 instruktorë që janë caktuar në një organ qendror, kanë planin e tyre të punës, sipas të cilët çdo muaj shkojnë nga 15 ose 20 ditë nëpër rrethe për të parë kudo të njëjtat gjëra. Ja, sfala vjen, le të marrim instruktorët e Komitetit Qendror. Këta janë kuadro të pjekur; shumica kanë qenë sekretarë të parë partie, kryetarë komitetesh ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve dhe kanë punuar

shumë mirë, prandaj edhe janë sjellë në aparat. Duke pasur tërë këtë eksperiencë të madhe, ata duhet të mbajnë në supe më shumë detyra, të cilat duhet t'i kryejnë jo 7 po vetëm 3 prej tyre. Kur të jenë 3, ata mund të venë në çdo rrëth një herë në vit. Nuk ka nevojë të rrinë aq gjatë, në një rrëth, po mjaftojnë disa ditë dhe, duke u mbështetur në horizontin e tyre të gjerë, të sjeillin konkluzione të studiuara mirë. Këtë çështje të mos e harrojmë, shokë, po ta kemi kurdoherë parasysh.

Pra, me këto që thamë, mund t'i japim fund edhe kësaj pike.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

KRIJIMI I AKADEMISE SË SHKENCAVE — NGJARJE E SHËNUAR HISTORIKE

Nga biseda me drejtuesit e Akademisë së Shkencave¹

25 nëntor 1972

Mbetëm shumi të entuziazmuar nga niveli i zhvillimit të Kongresit të Drejtshkrimit që porsa u dha fund punimeve. Ky është rezultat i përpjekjeve që keni bërë të gjithë ju, kuadrot e shkencës shqiptare, për përpunimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës sonë në rrugën e pionierëve të mëdhenj të Rilindjes Kombëtare, prandaj ju përgëzoj nga zemra për suksesin e arritur.

Më pëlqeu sidomos referati i profesor Androkli Kos-tallarit, fryt i punës kolektive të të gjithë juve, të linguistëve të tjerë shqiptarë dhe të profesor Eqrem Çabejt, kuadër me kulturë të gjerë në fushën e gjuhësisë.

Më pëlqyen mjaft edhe referatet që mbajtën në kongres vëllezërit tanë të ardhur nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi, pjesëmarrja e të cilëve në këtë ngjarje të madhe historike të përbashkët është një fitore për ne. Disa prej tyre, në referatet që mbajtën, kishin vënë, me shumë vend, citate të marra nga shkrimet e doktor pro-

1. Kjo bisedë u bë në selinë e Komitetit Qendror të PPSH.

fesor Aleksandër Xhuvanit, si ai, për shembull, ku thuhet se «Njësia e gjuhës është njësia e kombit».

Por sot nuk ju kam thirrur vetëm për t'ju përgëzuar për këtë sukses të madh. Këto që ju thashë vlejnë si një hyrje për atë që do t'ju them, pse ma do zemra që, në emër të Komitetit Qendror të Partisë, t'ju shprehja juve urimet tona për suksesin e arritur me rastin e kësaj ngjarjeje të rëndësishme¹, urime, që, ju lutem, t'u transmetoni gjithë shokëve të tjerë të shkencës dhe të kulturës sonë kombëtare.

Qëllimi, për të cilin ju kam thirrur këtu, ka të bëjë me një çështje tjeter, po aq të rëndësishme, ka lidhje me një vendim tjeter historik të Byrosë Politike të Komilitit Qendror të Partisë, për të cilin jeni në dijeni: për krijimin e Akademisë së Shkencave. Kjo është një ngjarje tjeter e shënuar historike, që erdhi si rezultat i përpjekjeve të mëdha të të gjithë punonjësve tanë, që merren me zhvillimin e kulturës dhe të shkencave, me ngritjen e pareshtur të nivelit arsimor dhe kulturor të njerëzve tanë. Zhvillimi i fazës së tanishme të vendit tonë e kërkonte patjetër krijimin e këtij institucioni të rëndësishëm.

1. Në Ditarin Politik, më 20 nëntor 1972, shoku Enver Hoxha shkruan: «Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe është një ngjarje me rëndësi historike për njësimin e drejtshkrinit të gjuhës sonë letrare. Janë bërë përgjithësime shumë të rëndësishme, që do ta zbulurojnë dhe do ta qojnë më tej drejt përparimit gjuhën tonë. Këtë thesar të madh, të pashtershëm dhe gjithnjë në rritje e në zhvillim të popullit tonë... Profesori kosovar, Idriz Ajeti, luftëtar i shquar i mbrojtjes e i përhapjes dhe më në fund i vendosjes së gjuhës letrare shqipe edhe në Kosovë, foli shumë mirë. Kumtesa e tij ishte e dokumentuar».

Akademia do të përböhët, natyrisht, nga njerëzit më të mirë e më të përgatitur të shkencës shqiptare. Mirëpo, gjersa akoma nuk kemi një statut dhe rregulloren, që do të përcaktojnë, në mes të tjerash, normat e zgjedhjes së elementëve në organet e saj, duke përfshirë edhe organet drejtuese, Komitetit Qendror të Partisë i vihej detyrë që në fillim të procedonte, siç ka vepruar zakonisht, kur janë krijuar organet e pushitetit popullor dhe organizatat shoqërore. Ne kemi besim se njerëzit tanë të shkencës dhe të kulturës do ta aprovojnë zgjedhjen e drejtë, objektive të Komitetit Qendror të Partisë për drejtuesit kryesorë të akademisë, për kryesinë e saj. Për organet e tjera të akademisë, natyrisht, në të ardhmen do të përdorim metoda nga më demokratiket, por, duke mos pasur akoma statutin dhe rregulloren, që do të na udhëhiqnin për këtë qëllim, aktualisht, Komiteti Qendror mendon të shoshitë edhe një sërë kandidaturash, për të cilat përsëri do të kërkojë mendimin tuaj. Këto kandidatura, me qëllim që në Akademinë e Shkencave të vijnë ata që e meritojnë me türë kuptimin e fjalës këtë ndër, ne do t'i konsultojmë së bashku me njerëzit tanë të rretheve shkencore. Unë mendoj se mund të procedojmë kështu në kushtet fillestare dhe se kjo është rruga më e përshtatshme.

Dëshiroj tani t'ju komunikoj juve një vendim që ka marrë Byroja Politike ditët e fundit¹, për udhëheqjen kryesore të Akademisë së Shkencave, për caktimin e

1. Ky vendim u mor në mbledhjen e Byrosë Politike më 22 nëntor 1972.

kryesisë, pra të kryetarit, të dy nënkyetarëve dhe të sekretarit shkencor të saj. Përcaktimi i anëtarëve të akademisë, i asamblesë dhe i presidiumit të saj, siç ju thashë, do të mbeten për më vonë. Zgjedhja e personelit teknik, meqenëse ka rëndësi të dorës së dytë, mund të bëhet nga vetë kryesia e akademisë.

Konkretisht, Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë ka vendosur që shoku Aleks Buda të jetë kryetar i Akademisë së Shkencave, shokët Kolë Popa dhe Petrit Radovicka nënkyetarë dhe shoku Bedri Dedja sekretar shkencor. Byroja Politike, duke njohur mirë të gjitha cilësitë tuaja, në radhë të parë virthytet e larta njerëzore, patriotizmin dhe besnikërinë ndaj çështjes së madhe të popullit dhe të Partisë dhe pajisjen me dituri të gjera e kulturë të madhe, duke ju njohur si njerëz të shkencës të një niveli të lartë jo vetëm përvendin tonë, por që mund të krahasoheni edhe me shkençtarë të vendeve të tjera, e mori njëzëri këtë vendim. Këto jua them jo për t'ju bërë qejfin, por se janë të vërteta, reale. Ne, e bashkë me ne i gjithë populli ynë, krenohemi me ju dhe me një numër jo të vogël kuadrosh të tjerë si ju, që punoni me mish e me shpirt në fushën e shkencës dhe të kulturës, derdhni djersë dhe jeni gati të bëni çdo sakrificë për të mirën e popullit, për ndërtimin e socializmit në rrugën që na udhëheq Partia.

E marr me mend se, kur ju flas në sy për këto mercita, juve ju vjen shumë rëndë, se jeni njerëz të thjeshtë dhe nuk dëshironi që t'ju mburrin të tjerët. Po këto nuk janë mburrje, këto janë një realitet, që ju shpreh nga zemra në emër të Komitetit Qendror. Prandaj më

lejoni t'ju uroj që ta kryeni me ndër këtë detyrë të madhe, që ju ngarkon Komiteti Qendror dhe Partia për zhvillimin e mëtejshëm të shkencave dhe të progresit në vendin tonë. Ne jemi të bindur se ju do ta kryeni plotësisht këtë detyrë, pse e kuptioni ç'rëndësi të madhe ka themelimi dhe funksionimi i Akademisë së Shkencave, q'hov të madh do t'i japë ajo zhvillimit të mëtejshëm të shkencës, të ekonomisë dhe të kulturës sonë. Nga institulet që do të ketë akademia në vartësi, do të dalin një numër i madh drejtuesish, që do të marrin e do të trajtojnë, do të zhvillojnë e do të zbatojnë në jetë të gjitha ato detyra që do të vihen përpara për zhvillimin e ekonomisë, të arsimit dhe të kulturës në Shqipëri. Për zgjidhjen e këtij problemi me rëndësi ne jemi të bindur se kemi vepruar drejt, se, në radhë të parë, njerëzit i kemi zgjedhur me kriter, prandaj ju urojmë sukses për kryerjen me ndër të detyrave që ju ngarkohen.

SHOKU ALEKS BUDA: Ju na pritët, shoku Enver, në një moment shumë të gëzuar, që ka të bëjë me përfundimin me sukses të punimeve të Kongresit të Drejtshkrimit. Lajm shumë i gëzuar ishte për ne edhe vendimi për krijimin e Akademisë së Shkencave, por sot është mjaft emocionues për ne komunikimi i detyrës së lartë që po na ngarkoni. Dëshiroj të vë, me këtë rast, në dukje se edhe në këtë fushë po zbatohen njëri pas tjetrit vendimet e Komitetit Qendror të Partisë, duke filluar që nga vendimi për krijimin dhe pastaj me masat që janë duke u marrë për organizimin dhe fillimin e funksionimit të Akademisë së Shkencave, që ne askishim menduar t'ia arrnim dot gjatë brezit tonë. Por

ja, Partia këtë e bëri realitet. Ajo ka menduar, gjithashu, edhe për kuadrot që do ta drejtojnë atë. Por ne, krahas gjëzimit të madh për themelimin dhe organizimin e akademisë, jemi të preokupuar se detyra që na ngarkon Partia është me përgjegjësi.

Ashtu si çdo njeri tjetër, që do ta kishte të zorshme ta imerrte përsipër një detyrë kaq të lartë, edhe ne e kemi këtë druajtje. Veçanërisht unë e kam akoma më të zorshme marrjen e kësaj përgjegjësie, ca nga mosha e kaluar, ca nga mungesa e përvojës, duke marrë me mend se drejtimi i akademisë kërkon një dorë të fortë. Unë nuk tutem nga përgjegjësitë, shoku Enver, nga marrja përsipër e çfarëdo detyre që duhet kryer. Duke e parë çështjen nga kjo pikëpamje, nuk e ndiej veten të moshuar, as që mund të them se nuk dëshiroj të marr pjesë në një aksion kaq të madh e të rëndësishëm që po ndërmerr Partia, vetëm kam druajtje, sepse të jesh përgjegjësi kryesor i një institucioni të ri me kaq rëndësi, kërkohet një përvojë e madhe, gjë që mua më mungon. Më besoni, në këtë kuptim e shpreh druajtjen, pa në çdo rast jam gati ta marr përsipër kryerjen e saj, pse e di që do të kem kurdoherë përkrahjen e madhe të Partisë dhe Tuajën personalisht. Megjithatë, duke pasur përreth shokë të astë, si: Kolë Popën, Androklı Kostallarin, Stefanaq Pollon dhe shumë të tjera, duke pasur edhe ndihmën e Partisë dhe Tuajën, shoku Enver, kam besim se të gjithë së bashku do ta çojmë punën përpara. Ju, shoku Enver, na keni dhënë kurdoherë dorën, na keni nxjerrë në dritë në çdo situatë të vështirë, prandaj, ashtu si gjithë populli, edhe ne pu-

nonjësit e shkencës dhe të kulturës çdo gjë ia detyrojmë Partisë.

Kur e lavdërojnë një ushtar që ka kryer mirë detyrën, më ka bërë shumë përshtypje, sa herë kam dëgjuar përgjigjen: «I shërbej Republikës Popullore të Shqipërisë». Edhe ne si ushtarë të mirë, do të përpinqemi që në fushën e shkencave t'i shërbejmë sa të na jetë e mundur më mirë Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Partisë së Punës. Ju keni thënë vazhdimisht fjalë të mira për punën tonë, me të cilat na keni inkurajuar pa masë. Edhe me këtë rast fjalët Tuaja na frymëzojnë t'ia hyjmë punës me besim, prandaj do të përpinqemi të punojmë me të gjitha forcat për ta kryer si duhet detyrën që na besohet.

SHOKU ENVER HOXHA: E kemi plotësisht këtë bindje, pse kemi prova, prandaj kemi besim te ju.

SHOKU KOLE POPA: Detyra që na ngarkohet është e rëndë, shoku Enver. Porsa Ju na komunikuat vendimin e Komitetit Qendror për caktimin tonë në drejtimin e akademisë, ne u shqetësuam ca, por, sikurse e tha edhe shoku Aleks, edhe unë kam mendimin se me ndihmën e Partisë dhe Tuajën, ne do të ecim kurdoherë përpara në kryerjen me nder të detyrës që po na besoni.

SHOKU ENVER HOXHA: Me ndihmën e njëri-tjetrit çdo gjë do të ecë përpara me sukses.

SHOKU ALEKS BUDA: Dhe në qoftë se kemi bërë gjë gjer tani, kjo vjen se kemi pasur ndihmën e shoqi-shoqit, se vetë nuk kemi ditur gjithçka.

SHOKU ENVER HOXHA: Të gjithë nuk kemi ditur gjithçka në fillim, po Partia, sa herë që na ka cak-

tuar me përgjegjësi, na ka ndihmuar në çdo rast që detyrat t'i kryejmë me nder, sado të vështira që të kenë qenë. Mbështetja te Partia dhe bashkëpunimi i ngushtë me njëri-tjetrin në bazë të vijës së drejtë të saj, na ka bërë që lë arrijnë suksesë të mëdha. Kur bëjmë pasqyrën e jetës sonë dhe pyesim veten, del se në fillim të gjithë nuk kemi ditur asgjë. Të kuqtohem, as tani nuk dimë gjithçka, po veç dimë më shumë sesa kur ishim të rinj, për arsyse se në vendin tonë sot nuk ka më një numër shumë të kufizuar të diturish. Duke qenë të tërë të mësuar në drejtime të caktuara dhe duke përqendruar të gjitha këto dituri, të bashkuara ato përbëjnë një forcë të madhe. Aleks Buda, sjala vjen, ka një kulturë të gjerë në fushën e historisë dhe në atë të letërsisë, Kolë Popa ka një horizont të gjerë në fushën e shkencave të natyrës, Bedri Dedja në atë të shkençave pedagogjike, këshiu, po ta marrim, vetëm aty, në punët e kryesisë së akademisë, dijenitë e njërit plotësojnë boshllëqet e tjetrit. Kështu është edhe në fushën e organizimit. Njëri nga ju mund të jetë më pak organizator, po një tjetër që ka astësi më të mëdha organizative plotëson boshllëkun e të parit. Kështu, të gjithë të bashkuar mund ta çojmë punën përpëra. Fra, këto astësi të veçuara, duke i bashkuar, na jepin mundësi të kryhen detyrat me sukses dhe të shohim frytet e kësaj apo të asaj shkencë dhe të diturive tona. Për këtë ne jemi plotësisht të bindur.

SHOKU ALEKS BUDA: Eksperiencia tregon se njëri rritet duke e ngarkuar me detyra më të larta. Në këtë përfundim ne arritëm me rastin e përgatitjeve që bëni për zhvillimin e punimeve të Konferencës së

Studimeve Ilire dhe kjo është e drejtë. Në fillim kishim druajtje nëse do t'iia dilnim dot mbanë me sukses kësaj detyre, po jeta vërtetoi se mund t'i arrihet qëllimit, siç ia arritëm.

SHOKU ENVER HOXHA: Kur dëgjuam referatin e një niveli aq të lartë dhe të argumentuar me fakte të pakundërshtueshme të bazuara në shkencë, që mbajte ti në këtë konferencë, edhe ata të huaj që erdhën me mendime të tjera për vendin tonë, u çarmatosën. Nga ky fakt ndiejmë jo vetëm një krenari të ligjshme për shkencën tonë, që po ecën dita-ditës përpara, por kjo na nxit të ecim më me guxim e ta shohim më me besim të ardhmen. Tani kemi bindjen se në të tilla konferenca, cilido i huaj që do të parashtronë një tezë jo të drejtë, shumë nga shkencëtarët tanë të zotë zjarr për zjarr do t'i jepnin përgjigje të argumentuara, me të vërtetë shkencore dhe jo sa për të kaluar radhën.

Është e vërtetë se në akademi kanë rëndësi edhe çështjet e organizimit, për të cilat ti ke ca druajtje, po kur e vëmë në balance kulturën që nevojitet për të qenë në krye të kësaj detyre, në tërë gjerësinë e saj, çështjet e organizimit vijnë në radhë të dytë. Pastaj ne do të kemi atje një këshill, një kryesi prej katër vetash, prandaj të gjitha problemet, duke përfshirë edhe ato organizativet, që do të dalin përpara për t'u zgjidhur, me punë e përpjekje të përbashkëta, s'ka dyshim që do të zgjidhen.

SHOKU ALEKS BUDA: Unë jam i bindur për atë që thashë se njeriu rritet me detyra.

SHOKU RAMIZ ALIA: Çdo shkencëtar është një-kohësish edhe një organizator.

SHOKU ALEKS BUDA: Shkencat ekzakte janë më të sakta, kurse ne, punonjësit e shkencave humanitare, jo kurdoherë ua kemi vënë veshin parimeve të organizimit, përkundrazi, në shumë raste i kemi shkelur ato.

Sidoqoftë, ky hap nga ana jonë duhej bërë, Akademia e Shkencave duhej ngritur dhe ju themi me plot besim se do të përpinqemi ta realizojnië sa më mirë detyrën që na ngarkoni. Personalisht do të bëj çmos të punoj me të gjithë shokët, që do të jenë në radhët e para të përpjekjeve për realizimin e detyrave që na vihen.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne jemi të bindur se ju që do të jeni në kryesinë e akademisë, si dhe anëtarët e presidiumit dhe të asamblesë, jo vetëm do ta çoni punën përpara, por njëkohësisht do të punoni që të rritni, të edukoni e të përgatitni një numër gjithnjë më të madh kuadrosh shkencorë, që po shquhen vazhdimiشت në fushën e shkencave. Shumë nga këta tani mund të mos jenë anëtarë të akademisë, se numrin e tyre do ta kufizojmë ca në fillim. Këtij institucioni nuk do t'i japim menjëherë formën e një forumi të gjerë, jo se jemi sektarë, po me synimin e drejtë që anëtarë të akademisë të bëhen punonjësit më të afirmuar në fushën e shkencave, shkencëtarët tanë me të vërtetë të kualifikuar.

SHOKU ALEKS BUDA: Radhët e anëtarëve të akademisë do të shtohen me burimet e reja të kuadrove, të cilët do të dalin gjatë përpjekjeve që do të bëhen për ta çuar shkencën tonë nië përpara. Dëshira ime është që të merrja në radhët e akademisë disa nga

studentët më të mirë që kam pasur, për t'i përgatitur për atë qëllim që thoni Ju, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë e drejtë është kjo dëshirë, të cilën duhet ta kenë të gjithë shokët që punojnë në fushën e shkencave. Unë mund t'ju them me këtë rast se në bisedat që bëjmë herë pas here me shokët për probleme të ndryshme, ka qëlluar që të kemi zënë në gojë ty, profesor Çabejn dhe kuadro të tjerë shkencorë të vjetër. Unë kam pyetur nëse rreth jush janë caktuar të punojnë kuadro të rinj, njerëz të gjallë, me prirje, të zellshëm e me perspektivë, që të bashkëpunojnë dhe të dinë të përfitojnë nga kultura juaj e madhe dhe e të tjerëve si ju. Shokët më janë përgjigjur se për këtë qëllim janë caktuar të tillë kuadro, megjithatë kam marrë vesh se kjo punë nuk është organizuar si duhet.

Njerëzit tanë kanë metoda e metoda punc. Për shembull, ka nga ata që u jepet të shkruajnë, ka të tjerë që për arsyte të moshës nuk janë në gjendje të shkruajnë aq sa flasin e mendojnë gjatë ditës, por që mendimet i shfaqin orë e çast. E kam fjalën tani për punonjësit e shkencave.

Ja, le të marrim konkretisht shokun Aleks. U kam thënë shokëve nëse janë vendosur pranë Aleks Budës kuadro të rinj të profilit të tij, që të përfitojnë nga ai për çdo çështje për të cilat ai është kompetent dhe i gatshëm t'u flasë nga një deri në dy ose edhe tri orë me radhë.

Prandaj çështja e nxënësve, në kuptimin «disciple», ka rëndësi të madhe për këtë qëllim. Gjersa është kështu, atëherë të gjenden njerëzit e përshtatshëm, të

punohet me ta që të përgatiten sa më mirë nga ana juaj. Unë mendoj që disa shokëve mund t'u krijojmë lehtësira gjatë punës së tyre me aq vlerë. Atyre që janë të shkuar nga mosha, që kanë dituri të gatshme, po të pashkruara, të cilat kemi nevojë të madhe t'i evidençojmë dhe t'i kemi sa më të plota, do t'u humbisnim një kohë shumë të vlefshme nga puna po t'u kërkojmë t'i shkruajnë vetë. Prandaj mund të mendohet të gjenden mënyra si t'i ndihmojmë.

Nuk po ju mbaj më shumë. Edhe një herë ju uroj suksese në kryerjen e detyrave që ju ngarkohen.

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Për shkencën (Përmbledhje veprash)», vëll. I, f. 497

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Për shkencën
(Përmbledhje veprash)»,
vëll. I, f. 497*

ÇELIKUN E KALITIN NJEREZIT, KURSE NJEREZIT I KALIT PARTIA

*Nga biseda me delegacionin
e Ministrisë së Industrisë së Metalurgjisë
të RP të Kinës*

25 nëntor 1972

*Pasi u përshëndet me anëtarët e delegacionit kinez,
shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Kur na vijnë delegacione nga Kina, si përfaqësues të partisë, të rinisë, të bashkimeve profesionale, të organizatave ose institucioneve të tjera, ne gjëzohemi, sepse kjo flet jo vetëm për miqësinë tonë, por edhe ndihmon për forcimin e mëtejshëm të saj.

Rruja jonë për të shkuar në komunizëm është revolucionare, e lavdishme. Natyrisht, realizimet që popujt tanë gjëzojnë në frontin e brendshëm, si dhe fitoret mbi armiqëtë e jashtëm, imperialistët amerikanë, socialimperialistët sovjetikë dhe mbi gjithë kapitalizmin botëror, janë arritur nëpërmjet luftërash e përpjekjesh të mëdha.

Për të siguruar ndërtimin e socializmit, që është

objektivi ynë kryesor, ne duhet të jemi të fortë si çeliku i temperuar mirë, që, kur kontrollohet me anë të elektroskopit të fuqishëm elektronik, nuk ka në brendësi të tij as të çarën më të vogël. Çelikun e kalitin njerëzit, kurse njerëzit vetë i kalit Partia.

Gjatë luftës së tyre, partitë marksiste-leniniste spastrohen nga njerëzit e këqij. Ashtu si çelikut të porsaproduar i hiqen skoriet, edhe partitë marksiste-leniniste spastrohen nga tradhtarët, nga grevëthyesit e komplotistët, që maskohen dhe përpinqen të kthejnë mbrapsht kursin e drejtë të tyre. Por përpjekjet e tyre përballë forcës sonë, marksizëm-leninizmit, që ka dalë kurdoherë fitimtar, shkatërrohen dhe kurrë nuk do të kenë mundësi të fitojnë. Prandaj ne çdo ditë përpinqemi ta brunosim Partinë me marksizëm-leninizmin dhe ta kalitim atë ashtu siç bën farkëtari, që e vë hekurin në zjarr dhe, pasi e skuq, e kalit në kudhër. Duhet të jemi, pra, të fuqishëm pikërisht si çeliku.

Ju tani keni arritur të prodhoni 21-22 milionë tonë çelik në vit dhe me siguri në të ardhmen do të prodhani shumë më tepër, për arsy se vendi juaj ka një potencial të madh ekonomik dhe njerëzor. Unë vetë kam qenë në Kinë në vitin 1956 dhe e kam parë me sy industrinë metalurgjike të Anshanit. Tani, pas 16 vjetësh që kanë kaluar nga ajo kohë, ju keni ndërtuar Anshanë të tjerë.

Tashti po ndërtojmë edhe ne industrinë tonë të metalurgjisë së zezë. Ne i kuptojni shumë mirë përpjekjet e shokëve kinezë për të na ndihmuar, si edhe vështirësitë që keni hasur ju në këtë drejtim, por be-

sojmë se jo vetëm nuk do ta shtyni, por do ta afromi ca më tepër asatin e ndërtimit të këtij objekti të rëndësishëm. Vështirësitë që lindin, ne do t'i kapërcejmë me përpjekje të përbashkëta të specialistëve kinezë dhe shqiptarë, duke organizuar punën e ndërtimit në mënyrë të tillë që detyrat të realizohen në kohën e duhur, pa asnje vonesë.

Kryetari i delegacionit kinez, pasi falënderoi për pritjen e përzemërt dhe foli për përpjekjet e punëtorëve, teknikëve dhe inxhinierëve shqiptarë në ndërtimin e Kombinatit Metalurgjik të Elbasanit, vuri në dukje edhe disa vështirësi, të meta e gabime që ishin vërejtur në punën e disa dikastereve qendrore të RP të Kinës për të sigruar në kohën e duhur projektet dhe makineritë pët këtë objekt dhe që ishin bëtë pengesë e kishin sjellë vështirësi për ndërtimin e tij. Ndër të tjera, ai tha:

Ne nuk i kemi njohur sa duhet vështirësitë që janë hasur për ndërtimin e Kombinatit Metalurgjik në Elbasan dhe nuk jemi kapur fort pas këtyre problemeve, prandaj, si provat për mineralin e hekurit edhe vështirësitë teknike, që qëndrojnë në këtë drejtim, me gjithë disa suksese që kemi arritur, nuk i kemi kapërçyer dot plotësisht. Disa nga shokët tanë nuk i kanë bërë ndërtimet mbi baza tekniko-shkencore... Shumë mendime që kanë dhënë ata për projektet nuk janë të përshtatshme. Për këto çështje vetë Ministria jonë e Industrisë së Metalurgjisë nuk e kishte kapur si duhej problemi. Atëherë, kur filluam të diskutojmë me shokët shqiptarë që erdhën në Kinë në muajin korrik,

e kuptuam se kishim gabuar dhe kishim sjellë vështirësi në ndërtimin e Kombinatit Metalurgjik në Elbasan.

Pastaj shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Ju thatë se, nga sa patë në Elbasan gjatë vizitës suaj dyditore, punimet për ndërtimin e Kombinatit Metalurgjik po zhvillohen shumë mirë dhe me shpejtësi. Nuk ka asnje dyshim se punët atje do të rregullohen më së miri. Pesimistë ne nuk jemi, por jemi të ndërgjegjshëm se çdo punë që bëhet në Shqipërinë socialeste ka mundësi të shkojë më mirë. Për këtë qëllim körkohet kudo një organizim më i mirë i punimeve, një disiplinë më e fortë dhe një kualifikim më i madh në profesion nga ana e kuadrove. Të gjitha këto kërkesa të domosdoshme përbëjnë kujdesin e vazhdueshëm të Partisë dhe të Qeverisë sonë, si dhe të Ministrisë së Industrisë e të Minierave. Të meta, vështirësi e gabime gjatë punës, natyrisht, vërtetohen, por ne jemi optimistë dhe kemi besim të plotë në forcën e marksizëm-lininizmit, në fitoren përfundimitare të tij. Mbi këtë bazë do t'i kapércejmë të gjitha vështirësitë dhe do të fitojmë eksperiencë edhe në këtë drejtim.

Çdo lloj prodhimi ka teknologjinë e vet. Ünë nuk i njoh proceset teknologjike të prodhimeve metalurgjike, por më duket se zotërimi i këtyre proceseve nga njerëzit tanë është sa i nevojshëm, aq edhe i ndërlikuar. Në këtë drejtim punonjësit shqiptarë duhet të mësojnë e të përfitojnë gjithnjë e më shumë.

Edhe një herë ju falënderoj për vizitën tuaj. Me këtë rast ju stojmë që festat tona kombëtare të 28 e 29

Nëntorit t'i kalojmë së bashku të gjuar. Kjo do të jetë një kënaqësi e madhe për gjithë popullin tonë. Mirupafshim në Vlorë!!

*Botohet për herë të parë sëpas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim, që gjenden në AQP*

-
1. Në Vlorë shoku Enver Hoxha shkoi për të marrë pjesë në festimet që u organizuan më 27-29 nëntor me rastin e 60-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë dhe 28-vjetorit të Çlirimtës së Atdheut. Midis delegacioneve të huaja që morën pjesë në këto festa ishte edhe delegacioni i Ministrisë së Industrisë së Metalurgjisë të RP të Kinës.

POPULLI SHQIPTAR SOT LUFTON, PUNON DHE JETON I LUMTUR NË EPOKEN E PARTISË

*Fjala në pritjen e dhënë në qytetin e Vlorës
me rastin e 60-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë
dhe 28-vjetorit të Çlirimit të Atdheut*

28 Nëntor 1972

Sot ne festojmë me një gjëzim të madh 60-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë të Shqipërisë. Që më 1912 populli shqiptar e ka quajtur kurdoherë 28 Nëntorin ditën e flamurit dhe e ka lidhur me qytetin-hero të Vlorës, ku u shpall Pavarësia dhe u ngrit flamuri i kuq me shkabën dykrenare, simbol i lirisë, i sovranitetit të atdheut dhe i unitetit të të gjithë shqiptarëve, që kishin luftuar vazhdimisht me armë, me penë dhe me diplomaci për formimin e një Shqipërie të vetme, e cila të përmblidhte brenda kufijve të saj tokat shqiptare dhe gjithë popullin shqiptar me doket, zakonet, traditat dhe gjuhën e tij të përbashkët amtare. Të gjitha këto të drejta natyrore dhe të ligjshme i mohoheshin popullit shqiptar nga fuqitë imperialiste dhe shtetet e tjera kapitaliste satelite të tyre.

Edhe më parë, edhe pas vitit 1912, kur u shpall në

Vlorë shteti i pavarur shqiptar, tokat tona të shenjta, të vadirura me gjakun e popullit tonë luftëtar e të pa-përkulur kurrë përparrë robërisë, vazhdimisht qenë bërë plaçkë tregu e fuqive të huaja grabitqare. Harta e Shqipërisë, sipas interesit të njërit apo të tjetrit, merrte njyrrat e ndryshme të atyre shteteve që copëtonin e robëronin atdheun tonë.

Edhe pas përcaktimit të kufijve të Shqipërisë nga fuqitë e mëdha imperialiste, si rezultat i luftërave çlirimtare të pandërprera të paraardhësve tanë, që nga koha legjendare e Skënderbeut dhe deri në luftërat ballkanike kundër perandorisë së osmanëve, gjatë të cilave shqiptarët luajtën një nga rolet vendimitare në dobësimin e «të sëmurit të Bosforit», asgjë nuk ishte e sigurt për popullin tonë të shumëvuajtur.

Pas ngjarjes historike të Vlorës, patrioti i madh, burri i shtetit dhe diplomati i shquar Ismail Qemali, duke udhëtar për në Londër në krye të një delegacioni për mbrojtjen e të drejtave dhe të kufijve të atdheut, shoqërohej, midis të tjerëve, edhe nga trimi, patrioti i mençur e i flaktë shqiptar kosovar, Isa Boletini. Gojëdhëna tregon se Isa Boletinit, kur do të takohej me ministrin anglez të Punëve të Jashtme, para se të hynte në dhomën e tij, iu kërkua që të hiqte koburen nga brezi. Pas mbarimit të bisedës, kur ministri britanik po e përcillte, i tha me njëfarë mburrjeje Isait se deri atëherë askush nuk kishte mundur ta çarmatoste, po ja, kishte ardhur dita që të çarmatosej në Londër. Isa Boletini, pasi ngjeshi fort në brez koburen e argjendtë që i kishte lënë rojes, nxori nga xhepi i brendshëm i jekut të tij të qëndisur me ar një revole tjeter dhe, duke iu

përgjigjur ministrit anglez, i tha aty për aty: «Jo, besa, as në Londër jo!», duke i lënë të kuptohet me këtë se kurrë dhe asnjë shtet nuk mund t'i çarmatosë shqiptarët kur është fjala për të mbrojtur të drejtat e tyre.

Faktet historike treguan se edhe pas përcaktimit të kufijve të vendit tonë, traktatet e fshehta të Londrës e kishin copëtuar përsëri Shqipërinë në mes të fqinjëve të saj. Prapë më 1917, në kohën e Luftës së Parë të madhe Botërore, dokumentet historike vërtetojnë se fuqitë e Antantës i bënë të ditur Karlit të Habsburgut, perandorit që zëvendësoi Franc Jozefin, se pranonin armëpushimin e propozuar nga perandoria austro-hungareze në rast se kjo, në mes të kushteve të tjera, ishte dakord që Shqipërinë ta gllabëronte shteti serb. Dhe ky farë perandori ua akordoi këtë dhuratë sikur vendi ynë të ishte një shami duarsh që ai e blinte në dyqanet e Vjenës apo të Budapestit. Kjo ndodhi në histori njihet me emrin «Çështja Siksti i Burbonit».

Në këto kushte të rënda, në luftë me fuqitë imperialiste dhe me shovinizmin e shteteve fqinje, në luftë me intrigat e tyre të panumërtë e djallëzore që e pentgonin t'ua arrinte qëllimeve të tij të shenjta të çlirimt dhe të krijimit të Shqipërisë së lirë dhe të pavarur, populli ynë luftoi me dekada e me dekada, derisa ia arriti ditës së 28 Nëntorit, 60-vjetorin e së cilës festojmë sot.

Populli shqiptar anekënd, si faktori vendimtar që ka bërë dhe po bën historinë e tij, i krijoj vetë situatat e favorshme për arritjen e kësaj dite të madhe historike. Meritë kanë njëkohësisht patriotët e mëdhenj shqiptarë me Ismail Qemalin në krye, i cili diti të veprojë me

guxim dhe pjekuri në ato çaste vendimtare për fatet e atdheut.

Plaku i Vlorës me shokë, si Luigj Gurakuqi, Bajram Curri, Isa Boletini, Pandeli Cale e të tjera, u bënë shpirti i kryengritjeve çlirimtare që shpërthyen në vitet 1910-1912, i mbledhjeve luftarake të shqiptarëve për liri dhe pavarësi që zienin kudo, në Jug e në Veri të Shqipërisë, në Pejë e në Gjakovë, në Prizren e në Prishtinë, në Plavë e në Guci, në Dibër e në Shkup, në Rumani, në Francë, në Turqi e në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pikërisht në këto rrethana Ismail Qemali nisi marshimin e tij triumfal prej Stambollit në Bukuresht, në Vjenë, në Trieste dhe zbriti në Durrës, pastaj nëpër baltërat e Myzeqesë arriti, më në fund, në Vlorë, ku e pritnin përsaqësuesit e ardhur nga të gjitha viset e Shqipërisë për ngjarjen e madhe historike, për të plotësuar nisionin e lartë që i kishte ngarkuar të kryente populli — Shpalljen e Pavarësisë Kom-bëtare dhe krijimin e shtetit të pavarur shqiptar. Këtyre pishtarëve të mëdhenj të luftës për liri e pavarësi kombëtare populli dhe Partia e Punës e Shqipërisë u ngritën monumentin madhështor në Vlorë, pikërisht në të njëjtin vend ku 60 vjet më parë u ngrit flamuri më 28 Nëntor. Populli i pavdekshëm, brezat e tij të ardhshëm, do të vijnë valë-valë për të nderuar me admirim, respekt e mirënjojje të thellë përpjekjet vigane të paraardhësve të vet dhe të bijve të tij që luftuan përlirinë dhe pavarësinë e atdheut.

Por që prej 28 Nëntorit të vitit 1912 dhe deri më 29 Nëntor të vitit 1944 popullit shqiptar iu deshën plot 32 vjet luftë pa pushim me armiq të brendshëm e të

jashtëm, me urinë, me sëmundjet, me injorancën mesjetare. Popullit shqiptar iu desh të luftonte kundër satrapëve feudalë vendës dhe intrigave të panumërtë të fuqive imperialiste që i shtrëngonin litarin në grykë, iu desh të luftonte kundër regjimit të hurit e të litarit të kryeshelatit Ahmet Zogolli që e shiti gjithë Shqipërinë te fashistët italianë dhe përgatiti pushtimin e saj. Popullit shqiptar iu desh, më në fund, të bënte luftën e armatosur më të përgjakshme e më të lavdishme të historisë së tij, Luftën Nacionalçlirimtare, të udhëhequr nga Partia Komuniste e Shqipërisë, për të ngritur përsëri në Vlorë dhe anembanë Shqipërisë flamurin e kuq ngadhënjimtar të lirisë me shkabën e tij dykrenare, që tanë kishte në mes edhe yllin e ndritur të Partisë dhe të partizanëve. Një faqe e re hapej në vazhdimin e historisë së lavdishme të popullit tonë, hapej epoka e ndritur e socializmit dhe e komunizmit.

Çfarë mësoi populli dhe ç'konkluzione nxori ai nga të gjitha këto ngjarje që u rrokullisën brenda 32 vjetëve që përmenda më lart? Liria, pavarësia, sovraniteti dhe vetëqeverisja janë aspiratat më të shtrenjta për një popull, i cili duhet të luftojë me armë e me çdo mjet tjetër që ka në duar që t'i fitojë dhe, pasi t'i ketë fituar, të jetë vazhdimesht vigjilent dhe plotësisht i armatosur për t'i mbrojtur ato me çdo kusht kundër kujtdo që orvatet t'ia cenojë dhe t'ia zhdukë.

Fuqitë e ndryshme imperialiste dhe shtetet kaptalistë kanë qenë në çdo kohë armiq të betuar të popullit shqiptar. Ato gjithnjë i kanë bërë dëme, e kanë goditur, e kanë gjakosur, e kanë përçarë, e kanë mashtruar, copëtuar dhe robëruar. Prandaj asnjë besim nuk

duhet të ketë populli tek ata, asnjë iluzion nuk duhet të ushqejë për të ashtuquajturat ndihma të tyre, të jetë kurdoherë vigjilent dhe të mos bjerë kurrë në kurthin e demagogjisë së tyre, ta trajtojë me ta çdo problem si i barabartë dhe në asnjë rast të mos përkulet përpara kërcënimeve dhe shantazheve të tyre. Në qoftë se dikush do të përpinqet t'i tregojë forcën popullit tonë, atëherë ky t'i tregojë atij forcën e vet.

«Bashkimi bën fuqinë», thotë populli ynë. Prandaj në kohë të mirë e në furtunë ai duhet të ruajë unitetin e tij të çeliktë, si për të ecur përpara drejt mirëqenies dhe përparimit, ashtu edhe për t'i bërë ballë çdo furtune, në rast se ajo vjen. 32 vjet luftëra, vuajtje e mundime e mësuani popullin tonë se, për të qenë i bashkuar, duhen qëruar rrënjosht hesapet me armiqtë e tij të brendshiën, me feudalët, me agallarët, me bajraktarët, me fetë dhe klerikët reaksionarë, me banditët politikanë dhe kusarët e rrugëve, me fajdexhinjtë e me mashtruesit, të gjitha këto mikrobe të një plage të madhe të së kaluarës mesjetare, të imperializmit dhe të kapitalizmit të kohëve të reja.

Këta 32 vjet luftëra, vuajtje e mundime e mësuani, gjithashtu, popullin shqiptar t'i bënte një luftë të pamëshirshme paditurisë. Mësimi, arsimi, shkolla ishin të domosdoshme për t'i hapur atij sytë dhe për ta armatosur, pasi vetë duhej të përvishte mëngët në betejën e madhe për ndërtimin e një jete të re, plot lumburi e dinjitet, për të kapërcyer me shpejtësi shekujt që e kishin lënë prapa.

Në provën e madhe të këtyre viteve populli ndjeu ç'energji kolosale kishte në veten e tij, ai theu shtete

e fuqi të mëdha në beteja, me besim të plotë se do të çante male dhe atdheun do ta lulëzonte, shpirtin do ta zbuluron, pasi tanimë kishte marrë fuqinë në duart e veta dhe, pas gjithë këtyre provave tragjike, këtë fuqi nuk do ta lëshojë kurrë.

Më në fund dhe nga më kryesorët është mësimi i madh e i ndritur në histori që nxori populli, se rru-gën e vërtetë të çlirimit ia tregoi Partia e tij e Punës e Shqipërisë, pjella e tij e lavdishme, Parti heroik e sypatrembur në beteja, e mençur, e thjeshtë, e nder-shme si populli që e lindi në furtunë e në qamet, të cilën ai vetë e ushqeu në malc me thërrime e me gjak, Partia e komunistëve që mban e do të mbajë kurdoherë lart e të papërkulur flamurin e marksizëm-leninizmit. Partia ia gjallëroi popullit forcën e shpirtit dhe të trupit, i kaliti atij forcën e shpatës e të pushkës dhe ia ndezi zjarr dëshirën që të rrojë, të përtërihet dhe të më-sojë në atdheun e tij të lirë e sovran. Partia i mprehu atij zotësinë e mendjes dhe të krahëve për të ngritur pushtetin e vet popullor dhe për të ndërtuar sistemin socialist.

Që nga dita e Çlirimit, 29 Nëntorit të vitit 1944, dhe deri nesër, më 29 Nëntor 1972, mbushen plot 28 vjet. Gjatë kësaj periudhe të rëndësishme historike populli ynë, i udhëhequr nga Partia e tij marksiste-le-niniste, me forcën e armëve hodhi jashtë kufijve të atdheut pushtuesit e huaj, likuidoi tradhtarët dhe tradh-tinë, likuidoi pushtetin e vjetër të feudalëve e të kapita-listëve dhe vendosi pushtetin e tij të ri, likuidoi klasat armike, kaliti aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë dhe po ndërton shoqërinë socialiste. Populli shqiptar sot

lufton, punon dhe jeton i lumtur në epokën e Partisë.

Ç'i solli popullit tonë kjo epokë e ndritur, sido që nuk është shumë e gjatë? Të gjitha të mirat dhe asgjë të keqe. Populli sot është zot në vendin e vet, Shqipëria doli nga errësira në dritë, u rindërtua anembanë, me qytete e me fshatra, me rruge e me porte, u ngrit dhe vazhdon të ngrihet me vrull industria jonë, u hapën miniera të reja, u ndërtuan termocentrale dhe hidrocentrale madhështore, u elektrifikua i gjithë vendi, po ndërtohet industria e metalurgjisë së zezë, janë ndërtuar rrugë e hekurudha; bujqësia, në sajë të kolektivizimit, mekanizimit dhe zbatimit të agroteknikës moderne, ka bërë një hop të madh përpara. Arsimi është bërë si buka për popullin tonë. Kudo, s'ka fshat, s'ka qytet, s'ka fabrikë, s'ka repart pa shkolla të llojeve të ndryshme. Shkolla, shkolla dhe dritë kudo për mendjet dhe zemrat e njerëzve tanë. Anekënd Shqipërisë janë ndërtuar qendra kulturore, sportive, spitacl, klinika, maternitete etj. Niveli i jetesës së popullit tonë, në krahasim me periudhën e paraçlirimit, është ngritur dhe po ngrihet vazhdimesht. Duke pasur parasysh të kaluarën e mjeruar të popullit, ne dimë ta çmojmë drejt e realisht këtë ngritje të nivelit të jetesës, pasi dimë nga ku jemi nisur, kemi gjithashtu të qartë edhe se ku do të arrijmë. Këtë nivel jetese e kemi ngritur dhe do të vazhdojmë ta ngremë me forcat tona, me djersën tonë, pa robëruar atdheun dhe popullin, qoftë ekonomikisht, qoftë politikisht.

Partia e mëson popullin të jetë vigjilent përpara çdo rreziku që mund t'i turret nga jashtë, qoftë ky rrezik i një agresioni të armatosur, qoftë rrezik i humbjes

së lirisë e të pavarësisë, që mund t'i vijë nëpërmjet skllavërimit ekonomik nga ana e metropoleve imperialiste, me imperializmin amerikan në krye, dhe e metropoleve socialimperialiste, me revisionistët sovjetikë në krye. Për t'u bërë ballë të dy rreziqeve, populli shqiptar dhe Partia e tij duhet të jenë të armatosur dhe të mos lëshojnë në asnje mënyrë.

Ne jemi për bashkekzistencën paqësore në bazë të parimeve të njohura të Leninit të madh, duke mos i lejuar askujt dhe nëasnje moment të prekë të drejtat tona legjitime.

Dikush mund të thotë duke buzëqeshur: «Po pse, fuqitë imperialiste frikën Shqipërisë socialiste do t'ia kenë për të vepruar kundër saj?». Ne i përgjigjemi këtij se as populli shqiptar nuk ua ka frikën atyre. Imperializmi dhe socialimperializmi ua kanë frikën popujve, revolucionit dhe ideve të Marksit, që i frymëzojnë dhe i çojnë përpara. Shqipëria socialiste ecën në ballë të këtij revolucioni proletar dhe nuk është vetëm, miq të saj dhe shokë besnikë janë popujt e botës, është proletariati botëror, të cilët shtypen dhe shtrydhen nga imperializmi dhe nga socialimperializmi në mënyrën më barbare.

Popullin tonë duhet ta armatosim mirë kundër propagandës dhe demagogjisë së kapitalisto-revisionistëve, që pretendojnë se ne jemi gjoja të izoluar nga bota, nga shkenca përparimitare, nga «ndihmat e tyre bujare». Ç'është në fakt «ndihma» që ata pretendojnë të na jepin nëpërmjet kredive të tyre? Ajo do të thotë të shessim vendin tonë tek ata, t'i lejojmë imperialistët dhe revisionistët të investojnë kapitalet e tyre në Shqipëri

për të thithur gjakun dhe djersën e popullit tonë, që nc tē bëhem i satelitë të monopoleve dhe tē metropoleve tē mëdha, që tē adoptojmë mënyrën e degjeneruar tē jetesës së tyre, që te ne tē vendoset shoqëria e konsumit me përbindëshat e saj, që në vendin tonë tē ringjallen dhe tē forcohen klasat e vjetra shfrytëzues me tē gjitha tē këqijat e klasës kapitalisto-revisioniste aktuale. Populli shqiptar nuk i ha këto, pasi është i ndërgjegjshëm pér tē gjitha këto rreziqe, pasi Partia dhe ai vctë vigilojnë dhe nuk shkelin kurrë në dërrasë tē kalbur.

Nga i nxjerrin këta hajdutë modernë kapitalet mc tē cilët kürkojnë kaq «bujarisht» «tē ndihmojnë» popujt e tjerë tē prapambetur? Duke shfrytëzuar tmerrësisht klasën e tyre punëtore dhe popujt e tjerë. Mbivlera që shkon në xhepin e kapitalistit nga dita e punës prej 8 orësh e një punëtori, sigurohet nga përvetësimi i pjesës më tē madhe tē kësaj ditë-punc. Ç'fitime tē mëdha nxjerr ai nga djersa e punëtorëve! Edhe një sakrifisë tē vogël që kapitalistët detyrohen tē bëjnë nga e keqja e madhe në favor tē punëtorëve, kur këta shpërthejnë në greva e demonstrata tē përgjakshme, dhe këtë e bëjnë pasi dëshirojnë qetësinë pér ta vazhduar shfrytëzimin e egër, ata ua marrin punëtorëve nga ana tjetër nëpërmjet taksave tē rënda, ngritjes së çmimeve e tē qirave, tē pagesave tē larta pér ndjekjen e shkollës e pér kumin e sëmundjeve dhe tē tē gjitha formave tē tjera tē shumëlojta grabitëse, deri te dhënia e mallrave me kredi dhe mospagimi i rrogave punëtorëve pér disa muaj rreshjt, karakteristika këto tē shoqërisë së konsumit. Nga këto superfitime klasa punëtore varfërohet, ropatet në

punë, ndërsa kapitalisti krijon mundësi të investojë gjetkë kapitale për të shfrytëzuar dhe shtypur popujt e tjerë, për të kolonizuar vende të reja, gjoja në emër të progresit dhe të supertregjeve plot me mallra, që nuk arrihen të blihen dhe që kullojnë gjak e djersë të punëtorëve.

Jo! Populli shqiptar dhe Partia e tij nuk do të gënjen kurrë që ta ndërrojnë shoqerinë e tyre socialiste me këtë skëterrë. Në vendin tonë mund të mos ketë supertregje, sot mund të mungojnë akoma disa sende në dyqanet tona, por populli e di se në krahasim me të kaluarën ato janë shtuar shumë dhe ka bindjen e plotë se në të ardhmen, me punën e vet të palodhur, ai do t'i shtojë ato vazhdimesh, por në liri dhe në pavarësi.

Në vendin tonë çmimet e të gjitha sendeve, që prej Çlirimt e deri tani, jo vetëm nuk janë ngritur, siç ngjet në vendet kapitalisto-revizoniste, por përkundrazi, ato janë ulur vazhdimesh. Në një kohë që në këto vende qiratë e shtëpive janë ngritur në qzell, te ne janë jashtëzakonisht të ulëta; kur te ne arsimi i të gjitha niveleve dhe degëve është falas, tek ata taksat e shpenzimeve shkollore shtohen çdo ditë; kur te ne shërbimi mjekësor është falas dhe mjekimet e ilaqet në spitale jepen, gjithashtu, pa pagesë, tek ata shtrimi në spitale është dhe një operacion i thjeshtë, kushton qimet e kokës; kur te ne të gjitha taksat janë hequr, tek ata populli vuan nën peshën e taksave kolosale, e kështu me radhë. E tillë është shoqëria e tyre. Krejt ndryshe është shoqëria jonë socialiste.

Në vendet kapitalisto-revizoniste po shtohen hi-

pitë, përhapen narkotikët, xhazet dhe vallet seksuale, propagandohen nga të katër anët lloj-lloj teorish për të degjeneruar popullin dhe rininë. Të gjitha këto të këqija që po zhvillohen në këto vende, me propagandë dhe me demagogji përpiken të na i futin edhe në vendin tonë, por atyre ne u kemi mbyllur dyert, i luftojmë dhe zhvillojmë e përhapim gjérat tona të bukura, të pastra, përparimtare, revolucionare. Ne kemi, ruajmë dhe zhvillojmë virtytet e popullit tonë, virtytet e larta të moralit proletar, ruajmë dhe edukojmë një rini të shëndoshë, revolucionare, të gëzuar, optimiste, serioze dhe të mësuar për ta kryer me nder misionin e saj të madh.

Revisionistët sovjetikë flasin me të madhe se qenka «teorikisht e gabuar» që socializmi të ndërtohet me forcat e veta siç thonë shqiptarët. Në këtë çështje Partia e Punës e Shqipërisë nuk gabon aspak, as në teori as në praktikë. Kryesorja dhe vendimtarja për ndërtimin e socializmit në një vend socialist janë forcat e brendshme, forcat e veta të atij vendi. Ndihma që një vend socialist i jep një vendi tjetër socialist duhet të jetë vëllazërore, internacionliste, pa asnjë interes dhe pa asnjë kusht politik...

Revisionistët modernë, me ata sovjetikë në krye, me demagogjinë e tyre, përpiken të mashtrojnë popujt e tyre dhc popujt e botës kur thonë se vendet dhe sistemi i tyre janë gjoja socialistë. Kjo tanimë është një gjennjeshtër me bisht. Revisionistët modernë e kanë shkattëruar përfundimisht sistemin socialist në vendet e tyre, duke e shndërruar atë në një sistem kapitalist, ndërsa Bashkimin Sovjetik aktualisht e kanë kthyer në një shtet socialimperialist. As që mund të merret më-

me mend që të ekzistojë një bashkëpunim i vërtetë vëllazëror internasionalist dhe pa asnë interes e kusht politik në mes vendeve që e quajnë veten socialiste, si dhe në mes tyre dhe nesh, siç pretendojnë revizionistët sovjetikë dhe të tjerët pas tyre. E pretenduara «ndihmë» e tyre, gjoja socialiste, është njëloj si «ndihma» e imperializmit amerikan, i pretenduari «bashkëpunim reciprok socialist» i revizionistëve sovjetikë është njëloj si «bashkëpunimi i sinqertë» që pretendon imperializmi amerikan. Të dyja superfuqitë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, që përgatitin luftën e nxehë, me gjoja ndihmat e tyre bujare, përpiken të të skllavërojnë, të të futin nën kthetrat e tyre ekonomiko-politike, të të vënë në zonat e tyre të influencës dhe të kolonizojnë.

Revizionistët sovjetikë törbohen që Shqipëria po përparon. Miqve të rremë që u kthyen në armiq të egër ne kemi vite me radhë që po ua paguajmë të ashtuquajturat kredi të tyre, që përfaqësohen nga disa makineri punishtesh të vjetra të lyera me bojë.

Ne shqiptarët e njohëm mirë çfarë fshihej prapa të ashtuquajturave ndihma internasionaliste të revizionistëve sovjetikë. Karakterin imperialist të ndihmave të tyre po e provojnë sot popuj dhe shtete të tjera. Ishin këta revizionistë sovjetikë që sabotuan intensivisht zhvillimin e ekonomisë sonë, të industrisë e të minierave. Qëllimet e tyre shkonin larg — të robëronin vendin tonë socialist dhe ta kthenin në një satelit të tyre.

Po kjo Vlorë heroike pa edhe Hrushovin. Kur kyzenegat i marksizëm-leninizmit u gjend përpara gjirit

të mrekullueshëm të Vlorës, u mahnit dhe në një rast dëgjova bashkëpunëtorin e tij Malinovski që i pëshpëriste: «E kupton, Nikita Sergejeviç? Me raketat nga Berlini dhe Gjermania Lindore ne tani mund të godasim Gjibraltarin, kurse nga gjiri i Vlorës kemi në grusht gjithë Mesdheun». Në grusht ata patën erën, pasi Partia dhe Qeveria jonë ua shkatërruan planet. Kurrë Vlora nuk do të gjendet në duart e të huajve. Po ky Malinovski i tha përsëri Hrushovit në Butrint: «Liqen i bukur ky. Po të çahet bregu i detit, këtu afër mund të ndërtohej një bazë e mrekullueshme nëndërsesh e atëherë edhe Greqia do të bëhej jona». Më shkuam dridhma në trup dhe m'u kujtua ajo natë e errët në Tiranë, ku tok me Vasil Shanton shkruam në mure parullat «Poshtë fashizmi italian! Rroftë populli vëlla grek që lufton për liri!». Jo, Partia dhe Qeveria jonë nuk do të lejonin kurë që nga vendi i ullinjve t'i vinte e keqja popullit vëlla grek!

Këto dhe shumë të këqija të tjera kanë bërë kundër një vendi dhe një populli të vogël këta komunistë të rremë. Ata organizuan bllokadën kundër Republikës Popullore të Shqipërisë me shpresë që ta gjunjëzonin, por ngjau krejt e kundërtia. Shqipëria socialiste, e udhëhequr nga Partia e saj heroike, ecën me vrull përpara, ndërton me sukses socializmin dhe korr fitore pas fitoresh në të gjitha fushat e jetës, në industri, në bujqësi, në arsim e në kulturë, në forcimin e mbrojtjes së atdheut.

Para disa ditësh zhvilloi punimet historike Kongresi i Drejtshkrimit i gjuhës sonë të bukur. Kjo është një

fitore e pallogaritslme në mes të aq fitoreve të tjera madhështore që ka korrur populli ynë me luftë, me përpjekje e me zotësi.

Ne përshëndetim nga zenira bijat e bijtë e mësuar e të talentuar të popullit tonë që në atë kuvend historik dhe në rrugën e traditave të shkëlqyeshme të Frashërlinjve dhe të rilindësve tanë të tjerë, i dhanë një shkëlqim akoma më të madh gjuhës, thesarit më të madh të një populli!

Ne përshëndetim nxehësisht nga zenira veçanërisht dijetarët e shquar, vëllezërit tanë shqiptarë të Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi, që dhanë kontributin e tyre të çmueshëmi në vendosjen e drejtshkrimit të gjuhës së përbashkët amtare! Ne u urojmë nxënësve, studentëve, gjuhëtarëve, profesorëve e mësuesve vëllezër shqiptarë të Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi suksese akoma më të mëdha në përparimin e madh që kanë bërë në lëvrimin e gjuhës shqipe, gjë që e konsiderojnë si fitore të përbashkët!

Të dashur shokë dhe shoqe, miq e vëllezër,

Në këto ditë të mëdha historike, kur populli shqiptar feston me gjësim e hare të papërshkruar 60-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë dhe 28-vjetorin e Çlirimtë të Atdheut, le të ndjekim me besnikëri rrugën e pagabuar në të cilën na udhëheq Partia, të jemi të bashkuar, të realizojmë me sukses të gjitha planet që i kemi vënë vetes të kryejmë, sipas vendimeve historike të Kon-

gresit të 6-të të Partisë sonë të Punës dhe të ngremë dollinë:

Për lavdinë e popullit!

Për lavdinë e Partisë!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i popullit»,
nr. 286 (7578), 29 nëntor 1972*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Raporte e fja-
lime 1972-1973», f. 173*

BIR I NDRITUR I TRUALLIT SHQIPTAR

Telegram ngushëllimi dërguar Stilian Eftimiut

Bukuresht

Vlorë, 28 nëntor 1972

Me hidhërim të madh mësuam për vdekjen e vëllait tuaj të dashur, shkrimtarit dhe akademikut të shquar të RS të Rumanisë, Viktor Eftimiut.

Lajmi i vdekjes së Viktor Eftimiut, të këtij biri të ndritur të truallit shqiptar, që e ngriti aq shumë me penë dhe e deshi aq shumë me zemër vendlindjen e tij, ka pikëlluar thellë zemrat e gjithë popullit shqiptar.

Me këtë rast, në emër të popullit shqiptar dhe timin personal, ju lutem pranoni ngushëllimet tona më të thella.

Me veprimtarinë e tij, Viktor Eftimiut ka kontribuar fuqimisht në forcimin e lidhjeve miqësore midis popullit rumun dhe popullit shqiptar. Kujtimi dhe vepra e Viktorit tonë të dashur do të mbeten përjetë të

paharruara dhe do të ndritin si një yll i pashuar në
qiellin e patriotizmit shqiptar.

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i popullit»,
nr. 286 (7578), 29 nëntor 1972*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Letra të zogje-
dhura», vëll. 1, f. 269*

KUJTOJMË ME NDERIM SHOKËT E RENË, POR LUFTA VAZIIDON

*Nga biseda me pjesëtarët e familjes së dëshmorit
Halim Bejto Mersini*

29 nëntor 1972

Më 29 nëntor paradigmë, shoku Enver Hoxha, i cili ndodhej në Vlorë me rastin e 60-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë dhe 28-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, bëri vizita nëpër familje vlonjate për t'u uruar e përtë gjëzuar me to festat e mëdha. Udhëheqësi i shtrenjtë i Partisë dhe i popullit i nisi vizitat në lagjen me tradita revolucionare të njohura «Hajro Çakërrı», në familjen e dëshmorit Halim Bejto Mersini. Pasi u takua e u përshëndet me përzemërsi me pjesëtarë dhe të afërm të kësaj familjeje, shoku Enver Hoxha zhvilloi një bisedë të ngrohtë me ta:

SHOKU ENVER HOXHA: U thashë shokëve se dua të vete në shtëpinë e Halim Bejto Mersinit, pasi nuk kam vajtur ndonjëherë. Jam shumë i gjëzuar që ju gjej mirë. Babai juaj luftoi për popullin, për Partinë. Ty, Myrvete, të kemi partizane të vitit 1943, si je me shëndet?

SHOQJA MYRVETE MERSINI¹: Ju faleminderit, mirë, shoku Enver! Në kohën e luftës ishim 8 fëmijë në shtëpi, motra e madhe qe martuar dhe unë mbetesha më e madhja. Kur më bëri thirrje organizata e Rinisë Komuniste për të dalë partizane, babai më tha: «Të shkosh, moj bijë dhe të luftosh si burrëreshë». Ai më dha edhe një palë opinga dhe unë luftova deri në Sanxhak të Jugosllavisë si përgjegjëse e rinisë në një battalion. Babanë na e vranë më 1943.

SHOKU ASTRIT MERSINI²: Në shtëpinë tonë vinin shumë njerëz, ajo ishte bazë për shokët e Partisë. Këtu kanë qenë shoku Hysni dhe shokë të tjerë.

(*Shoku Enver Hoxha, duke vështruar në mur fotografinë e Halimit, ngrihet në këmbë, i afrohet dhe e nderon me grusht. Pastaj kthehet përsëri te bashkëbiseduesit.*)

SHOKU ENVER HOXHA: Duhej luftuar që të cilirohej Shqipëria. Ne i kujtojmë me nderim të madh shokët e rënë, por lufta vazhdon edhe sot për ndërtimin e socializmit. Ju që po punoni nën udhëheqjen e Partisë për të ardhmen tuaj të ndritur, jeni brezi i ri, kurse ne, që jemi më të moshuar, e ndiejmë veten të lumbtur për luftën që bëmë dje dhe përpjekjet që bëjmë sot për lulëzimin e atdheut.

SHOQJA MYRVETE MERSINI: Ju jeni gjithmonë i ri, shoku Enver dhe do të rroni shumë, siç dëshirojnë zemrat tona.

Vjehrë ime, nuk ju heq nga goja; ajo banon në El-

1. Vajza e dëshmorit.

2. Djali i dëshmorit.

basan, pranë shtëpisë së mëmë Hatixhesë¹ dhe ju mban mend shumë mirë, që atëherë kur u formua Qarkori.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë shtëpinë në Elbasan ju e paskeni pranë mëmë Hatixhesë. Mëmë Hatixheja është plakë e mirë, edhe me shëndet mirë është, por vetëm me sytë e ka keq, nuk shikon. Po ju si jeni²? Me sa shikoj ju jeni motra e madhe, apo jo?

SHOQJA ADILE ÇELO: Të lumtur e të gjëzuar jemi, shoku Enver, sot që na erdhët Ju për vizitë në shtëpi, jemi veçanërisht të gjëzuar.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe ne jemi shumë të gjëzuar, festa kaloi shumë bukur në Vlorë, koha mbajti shumë mirë. (*Duke ngritur gotën.*)

Në gjëzime! Të rrojë Partia! Të rroni ju, jetë të gjatë e të lumtur ju uroj të gjithëve!

SHOKU ASTRIT MERSINI: Jetë të gjatë Juve, shoku Enver, të rroni sa malet, të na rrojë Partia!

SHOKU ENVER HOXHA: Ju pëlqeu monumenti i pavarësisë që bënë skulptorët tanë? Ai duket i gjallë, madhështor, sikur është në lëvizje. Ky monument ka vlerë të madhe, sepse pasqyron realitetin historik të së kaluarës sonë dhe shërben si frysëzim për të ardhmen. Njerëzit që do të vijnë në Vlorë, nga të gjitha anët e Shqipërisë, do të frysëzohen nga luftërat e popullit për liri e për pavarësi, si dhe nga sakrificat e mëdha të të parëve tanë «për ta bërë Shqipërinë Zonjë». Nuk ka ngjarje historike në Shqipëri që të mos

1. Hatixhe Ekmekçi — agitatore dhe propagandiste e Ideve të Partisë, bashkëshortja e dëshmorit Fetah Ekmekçi.

2. I drejtohet Adile Çelos, vajzës së dëshmorit Halim Mersini.

jetë e lidhur edhe me emrin e Vlorës, me përpjekjet e bijve të saj nga qyteti dhe nga fshatrat. Vlora është një nga rrethet e Shqipërisë, që ka luftuar kurdoherë për lirinë dhe përvavarësinë e atdheut, prandaj meriton nderim e respekt. Edhe për sa i përket zhvillimit ekonomik, ajo nuk mbetet pas rretheve të tjera. Industria e bujqësia e saj janë zhvilluar, por duhet të punojmë akoma më tepër për një përparim më të madh sidomos të bujqësisë, të përfitojmë sa më shumë prej saj duke përqendruar forca më të mëdha, pse vetëm këshitu mund t'i plotësojmë nevojat që kemi.

Edhe nü arsim e kulturë Vlora ka ecur përpara. Kudo ka shkolla, vlonjatët janë arsimdashës, edhe të zgjuar, si gjithë populli ynë. Me këtë popull të mrekullueshëm do të ecim përpara. Elbasanin tuaj, shqoja Myrvete, e bëmë të bukur e do ta bëjmë akoma më të bukur. Atje po ndërtohet Kombinati i madh Metalurgjik, që është i domosdoshëm për ekonominë tonë. Tubat që i sjellin Vlorës ujë të pijshi, sot vijnë nga Jashtë, po nesër do t'i prodhojnë vetë në Elbasan.

Edhe te ju, Astrit, përgatiten kuadro të rinj për mbrojtjen e sigurt të aidheut. Ata mësohen më kujdes që ta kryejnë detyrën sa më mirë dhe populli të jetojë i qetë. Veç avionëve që janë, do të kemi edhe të tjerë, prandaj na nevojiten më shumë pilotë, të cilët duhen zgjedhur të zotë e të mirë si nga ana politike edhe nga ana shëndetësore. Duhet shumë kujdes në këtë drejtim, ju e dini sa delikate është puna e avionit.

SHOKU ASTRIT MERSINI: Nganjëherë në fluturim me avion piloti e ndien veten më të sigurt e më të lirë se nü tokë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju aviatorët e ndieni veten të lirë në qiel, sepse atje nuk keni asnjë pengesë, rruga, për ju, është hapësira e pafund e qielit, kurse në tokë është ndryshe, shoseri i automobilit do të mendojë të niset nga kjo ose ajo rrugë, që është më e shtruar ose që ka më pak njerëz.

Shokët mendonin të mos dilja sot për arsyet e gripit. Unë u thashë: «Edhe sikur të më zërë gripi, do të dal patjetër për t'u takuar me njerëzit. Në këtë rast nuk mund t'i bindem vendimit tuaj».

Ka gjëra të tjera që u bindem patjetër shokëve, se e do puna të veprohet si vendos shumica, por, kur dal nganjëherë për t'u parë me shokë e miq, s'mund të rri pa i takuar e pa u çmallur me ta.

Ju e kuptioni sa e vështirë është të shkosh shtëpi më shtëpi. Megjithëse dëshiron e kam të madhe për t'u bërë të tërëve nga një vizitë në shtëpi, por kjo më është e pamundur.

Ju, shoku gazetar, si e keni emrin.

SHOKU PAVLLO GJIDEDE: Më quajnë Pavllo Gjidede.

SHOKU ENVER HOXHA: A, ti qenke Pavlloja? Për gazetari ke mbaruar?

SHOKU PAVLLO GJIDEDE: Jo, kam mbaruar për gjuhë-letërsi shqipe.

SHOKU PETRO DODE: Ka qenë gazetar, korrespondent vullnetar. Tani e kemi korrespondent të «Zërit të popullit» për rrëthin e Vlorës e të Fierit.

SHOKU ENVER HOXHA: Shkruan mirë ti, i kam lexuar me kënaqësi shkrimet e tua, ti shkruan me ndjenjë dhe shkrime të tilla i pëlqen populli. Edhe sot së

bashku me Mehmet Elezin kishe një artikull¹ të shkruar me fryshtësim. Gazetari bën një punë të nderuar, delikate, por shumë të bukur. Gazeta ka një rol të madh edukativ për kuadrot dhe për popullin, ajo çdo ditë i mëson njerëzit të mendojnë e të punojnë sipas mësimave të Partisë, nganjëherë edhe i ngacmon, për t'i bërë më mirë punët, por ne nuk duhet të zemërohem.

Burri yt² nuk pi as cigare, as raki dhe bën shumë mirë. Asnjëherë mos e lër të pijë!

SHOQJA MYRVETE MERSINI: Kemi dëgjuar, shoku Enver, sikur nusen e djalit e keni këtej nga anët tonë.

SHOKU ENVER HOXHA: Nusja e djalit të dytë është nga Selenica, gjyshi i saj, minator i vjetër, ka qenë me luftën. Babai i saj ka qenë partizan dhe minator. Edhe nëna e nuses po ashtu ka qenë partizane, pas luftës ka qenë punëtorë dhe me funksione drejtuese, tanë është sekretare e organizatës-bazë të Partisë në kombinatin ushqimor «Ali Kelmendi» në Tiranë. Ajo vetë është nga Novosela. Duke marrë nuse të mirë, vajzë të zgjuar e me origjinë punëlore, që mbaron këtë vit degën e fizikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, djali më ka nderuar.

Edhe djali i madh është sejuar me një vajzë shumë të mirë, babanë e ka komunist dhe nënën grua të mençur.

1. «Vlorë, copozë prej stërralli, të ndrit shtati, të qesh ball...», «Zëri i popullit» nr. 236 (7578), 29 nëntor 1972.

2. I drejtobet shoqes Sofika Mersini, bashkëshortja e shokut Astrit Mersini.

SHOQJA MYRVETE MERSINI: Po si shumë të vegjël i ke fejuar djemtë, shoku Enver?

SHOKU ENVER HOXHA: Jo, nuk janë shumë të vegjël, i madhi mbaroi Fakultetin e Inxhinierisë këtë vit, i dyti mbaron sivjet, kurse vajza nuk ka vendosur akoma për fejesë.

Në radhë të parë, bijtë tanë dhe të tërë popullit duhet të jenë vajza e djem të vendosur për Partinë, për popullin, të bëhen të ndershëm dhe të mos na tur-përojnë. Fëmijët e mi, edhe gjithë të rinjtë e të rejet me të cilët kam pasur rastin të bisedoja, i kam këshilluar: «Zgjidhni vetë djalin ose vajzën që ju pëlqen, por të keni kujdes që vetë ata dhe prindërit e tyre, të jenë të ndershëm, të thjeshtë, punëtorë, patriotë dhe besnikë të Partisë. Për sa i përket pamjes, kjo është puna juaj». Për fejesën, të rinjtë duhet të këshillohen me prindërit, sepse këta kanë më tepër eksperiencë, prandaj dinë ta çmojnë më shumë të mirën e të keqen.

SHOQJA MYRVETE MERSINI: Na gëzuat shumë që na erdhët sot, shoku Enver. Për çështjen e Partisë e të popullit, për interesat e atdheut asgjë nuk kur-syem, as jetën tonë. Isha 17 vjeç kur dola malit të luf-toj. Edhe tani, po të jetë nevoja, jam gati të bëj sakri-ficën më të madhe bashkë me fëmijët.

(*Pastaj shoku Enver Hoxha doli në fotografi me pjesëtarët e familjes së Halim Bejto Mersinit.*)

SHOKU ENVER HOXHA: Mirupafshim, gëzuar e për shumë vjet festat! Të rrojë Partia, të rroni ju të gjithë!

FAMILJARËT E HALIM BEJTO MERSINIT: Mir-upafshim! Të rroni Ju, shoku Enver, të rrojë Partia!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimere të mbajtura në këtë
tekim, që gjenden në AQP*

FAMILJA ËSHTË VATËR E NGROHË DASKURIE DHE GËZIMI

Nga biseda në familjen e patriotit Sherif Hasani

29 nëntor 1972

SHOKU ENVER HOXHA: Jam shumë i gëzuar që erdha t'ju takoj dhe t'ju shikoj si jeni me shëndet.

SHOKU SHERIF HASANI: Edhe ne jemi shumë të gëzuar që na u dha rasti t'ju takojmë edhe një herë në shtëpinë tonë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju, xha Sherif, jeni një patriot besnik dhe i ndershëm nga Mazhari. Përpara keni vuajtur shumë, por tani dolët në dritë. se për këtë luftoi gjithë populli.

SHOKU SHERIF HASANI: Unë kam luftuar një vit, në kohën kur ju thërritnin «Usta Hasani nga El-basani».

SHOKU ENVER HOXHA: Natyrisht, atëherë i fshihnim emrat e vërtetë. sepse të atilla ishin kohët.

Mazhari atëherë kishte rreth 20 shtëpi. kurse tani, siç më kanë thënë, është zmadhuar dhe së bashku me disa fshatra të tjera është bërë një kooperativë e madhe bujqësore. Më kujtohet një ngjarje e bukur nga ajo kohë e lavdishme e luftës, xha Sherif, nga viti 1943, kur

erdha në krahinën tuaj. Bashkë me një shok, partizan, u nisëm nga Çeprati, kapërcyem Vaun e Shushicës dhe filluam t'u ngjiteshim kodrave midis Lubenjës e Peshkëpisë. Udhëtonim me shumë kujdes e me ndalesa për arsy se nga ana e Drashovicës, ku ishte një postbllok, kishte shumë lëvizje makinash të italiannëve. Na kishte marrë edhe uria, se s'kishim ngrënë asgjë. Në një çast, tek ishim ulur për t'u çlodhur, së largu na zuri syri një kasolle. Vajtëm atje dhe gjetëm një plakë.

«Mirë se më erdhët, more djem, por nuk kam gjë për t'ju dhënë të hani, vetëm bukë misri me pak djathë të tiganisur mund t'ju bëj».

— Po ku je moj nënë, se ma ke gjetur zemrën! Edhe unë atë kam qejf, nëna me bukë e me djathë më ka rritur, edhe bakllava të kisha, nuk do ta haja me kaq shije!, — iu përgjigja unë.

Hëngra aq shumë atë ditë, sa edhe sot e kujtoj. Nëna e pa veten ngushtë kur na tha se në shtëpinë e saj nuk kishte gjë tjetër për të ngrënë, por atë që kishte, ama, na e dha me gjithë zemr. Sot kohët kanë ndryshuar, mirëqenia e popullit është irritur, e tashmja nuk ka të krahasuar me të shkuarën.

Kjo është vajza që mëson në Shkollën e Partisë? Kur e fillove shkollën?

SHOQJA JETA HASANI¹: Sivjet e fillova, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Vajzat që vazhdojnë Shkollën e Partisë i kemi nga më të mirat. Brezi ynë

1. Vajza e Sherif Hasanit.

i ri e veçanërisht të rejat, duhet të studiojnë, se i kanë të gjitha mundësitë.

Kur shoku Enver Hoxha dëgjoi se ajo kishte qenë mësuese, vazhdoi:

Mësuesit janë njerëz të respektuar në vendin tonë, sepse ata përhapin dijen e kulturën në masat e popullit. Sot në Kosovë e në Dibër ata po kryejnë një mision fisnik për të mbajtur gjallë e të pastër gjuhën amtare, që është thesari më i madh i kombit.

Na bëni një fotografi bashkë me nënën¹ (*i drejtohet shoqëruesit*).

Gëzuar, të rrojë Partia, të rrojë Shqipëria, të rrojë populli! Të pimë për shëndetin tuaj nënë e xha Sherif, pleqëri të bardhë! Për shëndelin e të gjithëve!

Festat kaluan shumë bukur në tërë Shqipërinë, o xha Sherif, por ato u festuan me madhështi sidomos këtu, në Vlorë. Vlonjatët kanë marrë pjesë kurdoherë në luftërat që populli ynë ka bërë për të drejtat e tij; s'ka ngjarje historike që të mos jetë e lidhur edhe me Vlorën, me fshatrat e nje qytetin. Lustën dhe përpjekjet e popullit për lirinë dhe për pavarësinë duhet t'i përjetësojmë, duke i pasqyruar në shkrime të ndryshme, në veprat letrare, shkencore e artistike. Kur vendosen pllaka apo objekte të tjera përkujtimore, me raste përvjetorësh të ngjarjeve historike, për respektin që kemi ndaj luftës së popullit, duhet të gjejmë kohë e të vemi medoemos, edhe sikur të jetë duke rënë dëborë apo shi. Ato janë ngjarje me rëndësi të madhe që Partia dhe populli i vlerësojnë shumë.

1. Zonjë Hasani, bashkëshortja e Sherif Hasanit.

SHOKU SHERIF HASANI: Nuk do t'i harrojmë kurrë ato ditë të lavdishme të luftës sonë heroike. Më kujtohen shumë mirë ngjarjet e asaj kohe. Më 1945-ën, shoku Enver, nuk mbaj mend pse erdha në Vlorë. Një shok më dha fotografinë Tuaj. Kur u ktheva në shtëpi, ia tregova vëllait, Selamit. E njeh këtë? — i thashë. Pasi e shikoi mirë e mirë fotografinë, tha: «O, ky është ai, vëlla, që në behar të 43-së, bashkë me Besnikun u kthyen në stan, në Qafë të Mazharit dhe u dhashë dhalë, mban mend, të kam folur që atëherë për këtë». — Ee, i thashë, ky është shoku Enver Hoxha, Kryeministri i Shqipërisë, që atëherë fjeti në shtëpinë tonë. Mua ma tregoi Besniku se ky ishte i madhi i Partisë dhe komandanti i luftës, po unë s'të thashë gjë atëherë se e donte puna. Në shtëpinë tonë kanë vënë edhe një plakë përkujtimore.

— A dëshironi të pini një kafe, shoku Enver? (e pyeti një pjesëtar e familjes).

SHOKU ENVER HOXHA: Jo, saleminderit, se gjer tani kam pirë nja dy a tri, do të ha një mollë. Qëromati, nxënësja e Shkollës së Partisë! Këtë mollë do ta hamë së bashku, xha Sherif, një pjesë të saj merreni ju, një nëna dhe një unë.

Si gjirokastrit që jam, më pëlqen të jem i kurssyer, prandaj, ju lutem, mos më qëroni shumë mollë. Jepuni të tjerëve, Pavllo Gjidedes e Jeta Mitrushit, që është stenografja ime, se i kanë duart të zëna. Ky shoku tjetër, këtu, është Fiqri Vogli¹, gazetar i vjetër, ka qenë edhe partizan.

1. Në atë kohë drejtor i Agjencisë Telegrafike Shqiptare.

Përpara burrat sundonin si tiranë në familje dhe në shoqëri. Lindja e një vajze në të kaluarën konsiderohet si një fatkeqësi për të. Jeta e saj ishte një barrë e rëndë, një plagë e madhe. Gratë, megjithëse ishin më punëtore, për të mos thënë më të zgjuara, kanë qenë pjesa më e shtypur dhe më e vuajtur e shoqërisë, ato qëndronin të mbyllura brenda katër mureve të shtëpisë. Tani, në sajë të punës së madhe të Partisë, shumë burra janë bërë «shelegë». Partia i ka bërë të rrinë «sus», prandaj sukseset janë të mira në këtë drejtim, sidomë që mbetet akoma për t'u bërë. Për këtë arsyen gratë e duan aq shumë Partinë. Në kohën e Partisë dolën vajza me shkollë, ato u pajisën me dituri të mëdha e me guxim. Të gjitha këto sukseset janë gruas shqiptare ndikojnë në emancipimin e mëtejshëm të saj.

Po e marr një nga këto pjesët e mollës që po më jep vajza jote, xha Sherif, se «vajzës nuk duhet t'ia kthesh dorën». Është e sejuar kjo?

SHOKU SHERIF HASANI: Jo, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Fejohu vetë, por pyete edhe babanë. Vajza, xha Sherif, do ta zgjedhë të sejuarin djalë të mirë, të ndershëm, punëtor, pastaj të të thotë ty. Ti atëherë do ta pyesësh: «I kujt është ky? I ka nënën e babanë, kanë qenë me Partinë apo me Ballin, prindërit e tij?» etj. Kur ajo të thotë se prindërit e djalit janë me Partinë, se djali është i ndershëm, punëtor etj., ty do të të ngrohet zemra. Për sa i përket parqitjes, domethënë çështjes se si është djali nga «kashata», ajo është çështje e vajzës, këtë gjë e çmojnë vetëm ata që do të sejohen. Ne, baballarët, nganjëherë e marrim vesh në fund fare dashurinë e bijve tanë, atëherë

kur pothuajse ka mbaruar puna, kur «e ka marrë vesh Moreja», kurse nënët e mësojnë në fillim, sepse ato janë shumë të dashura dhe të afroara me fëmijët. Kështu ështëjeta, ndryshojnë kohët, ndryshojnë dhe zakonet. Më përpëra njerëzit krijonin familje pa u njohur e pa u dashruar me njëri-tjetrin, ata martoheshin pa e zgjedhur vetë bashkëshortin, pra, siç thoshte populli, «derr në thes». Martesa është një akt shumë i rëndësishëm në jetën e njeriut, sepse lidh përjetë dy njerëz, prandaj ajo duhet qmuar shumë, që familja të bëhet me të vërtetë vatër e ngrohtë dhe e shëndoshë dashurie dhe gjëzimi. Në qoftë se fejesa dhe martesa nuk merren me seriozitetin mië të madh, atëherë lumburia mund të kthehet në pikëllim.

Jam shumë i gjëzuar që erdha sot te ju. Nuk do ta harroj kurrë vizitën në këtë familje patrioti. Ju uroj jetë të gjatë, të ëmbël, vajzës i uroj suksese në mësime, djalit në Tiranë, gjithashtu, i uroj shumë suksese. Të gjithë nipat dhe mbesat le të bëhen patriotë si gjyshi i tyre.

Mirupafshim!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimere të mbajtura në këtë
takim, që gjenden në AQF*

SECILIT DUHET T'I RRAHË ZEMRA PËR POPULLIN

*Nga biseda me pjesëtarët e familjes së dëshmorit
Namik Osmani*

29 nëntor 1972

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë se ju gjeta!

SHOQJA VERA OSMANI¹: Mirë se na erdhë, o drithë e Partisë!

SHOKU ENVER HOXHA: Si ke qenë me shëndet tи, nënë Vera? Gëzohem që shtëpinë e ke plot me djem, me vajza, me nuse e me dhëndurë. T'ju rrojnë të gjithë! Të imbetet i paharruar kujtimi i Namikut.

SHOQJA VERA OSMANI: Të na rrojë Partia, në sajë të së cilës u rrilën me gjithë të mirat të tërë njerezit e mi.

Ky është djali, që Namiku ma la gjashtë muajsh kur u vra në përpjekje me bandat në Lushnjë, tanë është pedagog në Institutin e Lartë Pedagogjik të Shkodrës.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë. Ma kanë lavdëruar shumë këllë institut, sidomos për punën e mirë që bëhet aty për t'ua mësuar studentëve gjuhën let-

1. Bashkëshortja e dëshmorit Namik Osmani.

rare pa gabime. Kështu duhet vepruar, se gjuha është thesari i kombit.

SHOKU BUJAR OSMANI¹: Ky sukses është rezultat edhe i iniciativës së organizatës së rinisë të institutit.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë, të rinjtë kurdoherë kanë marrë iniciativa të vlefshme.

Pa hajde një çikë këtu ti, vajzë e vogël, si të quajnë?

DHURATA KOKALARI: Dhurata më quajnë, xha-xhi Enver. Babin e quajnë Luan Kokalari, mamin, Bali Kokalari.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë bukur! Ti, Luan, i kujt je nga Kokalarajt?

SHOKU LUAN KOKALARI: I Eqrem Kokalarit.

SHOKU ENVER HOXHA: E njoh Eqremin, e kam pasur shok. Edhe babanë e tij e njihja. Ti nuk e ke njo-hur gjyshin tënd. Atje ku punonte ai, ne kishim klubin tonë, që ishte me disa shkallë dhe me një dhomë. Kur ishim të rinj, në atë vend mësonim mandolinatë. Kështu nga pamja, ti, Luan, i ngjet më shumë gjyshit sesa Eq-remit, se ai e kishte ftyrën të gjatë.

Më kujtohet se këtu e 57 vjet përpara, në Gjirokastër pranë shtëpisë suaj ishte një furrxhi që quhej Daut; ai i mbante mustaqet si të kancelarit të Gjermanisë! Tek ai çonim teptsitë për të pjekur. Nëna ime më bënte ndonjë kokorrethe që e vija në kokë dhe mbi të vija tepsi-në që e çoja në furrë. Furrxhiu ishte nga familje e mirë. Shoku Haki Toska i njihte mirë këta njerëz.

Sa të bukura i ke këto rrobat moj Dhurata, më yje. Ke vajtur në Gjirokastër ti?

1. Djali i dëshmorit Namik Osmani.

DHURATA KOKALARI: Po, kam vajtur; atje kam parë Çerçizin me kobure në brez. Xhaxhi Enver, e duam ne Çerçizin?

SHOKU ENVER HOXHA: E duam, si nuk e duam? Bile ne e duam shumë se ai ishte burrë i mirë dhe trim, ka luftuar për lirinë e atdheut.

SHOQJA VERA OSMANI: Hajde këtu, Dhurata, se, duke i ndenjur në prehër, e lodhe xhaxhi Enverin.

SHOKU ENVER HOXHA: Jo, lëre se kam qejf ta mbaj vajzën në prehër, njëlloj siç do të mbaja me dëshirë edhe nipat ose mbesat e mia. Unë me Nexhmijen i kemi akoma të rinj fëmijët se jemi martuar me vonesë. E tillë ishte koha atëherë, lufta na pengonte.

Të më falni që nuk mund të ha më nga këto që më keni gostitur, se kam ngrënë edhe në familjet e tjera ku shkova për vizitë, prandaj këtë portokall dua t'ia jap Dhuratës. Merre, Dhurata.

Përveç sakrificës që bëri Namiku duke dhënë jetën për Shqipérinë, edhe ju, nënë Vera, keni bërë një shërbim shumë të madh për fuqizimin e atdheut, bëti atë çka mund të bëjë një nënë për Shqipérinë, për popullin.

SHOQJA VERA OSMANI: Fëmijët, që kam, m'i krritur dhe edukuar Partia me gjithë të mirat. Kjo vajza është Bali, martuar me Luan Kokalarin, ndërsa vajza tjetër Velesia është mësuese dhe e fejuar me Pjetrin, inxhinier nga Mirdita. Këta u fejuan pasi u njohën në Shkollën e Partisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Shiko se ç'ka bërë Partia, bashkoi vlonjatët, gjirokastritët dhe mirditorët në një familje. Të na rrojë Partia! Unë i këshilloj të rinjtë që të bëjnë jo nga një, por disa fëmijë, se atdheu ynë

ka nevojë për shumë njerëz. Sa kënaqësi ndien njeriu kur shikon që ju keni gjithë këta nipa e mbesa. S'ka gjë më të bukur se kjo! Ty, nënë Vera, të të rrojnë gjithë fëmijët, nipat e mbesat. Të ecim gjithmonë në rrugën e Partisë!

FAMILJARËT E VERA OSMANIT: Të rroni sa malet shoku Enver e t'ju lëmë prapa të gjithë!

SHOKU ENVER HOXHA: Mirditorët, djem e vajza, përgjithësisht janë njerëz shumë të zgjuar, por unë e kam fjalën veçanërisht për djemtë mirditorë. Këtë cilësi të mirditorit nuk po e përmend për t'i bërë qejsin dhëndrit tuaj, por sepse kjo është një e vërtetë.

I përsundove provimet në Shkollën e Partisë ti, Pjetër?

SHOKU PJETËR TARAZHI: Jo, kam akoma edhe dy provime.

SHOKU ENVER HOXHA: Ku ke punuar më përrpara?

SHOKU PJETËR TARAZHI: Kam punuar dhe vazhdoj të punoj në Minierën e Spaçit. Partia dhe Ju, shoku Enver, na nxorët në dritë. Miniera jonë e Spaçit sot prodhon në 6 ditë atë qëka prodhonte përrpara në 7 vjet.

SHOKU ENVER HOXHA: Atje është vend i pasur me mineralin e çmueshëm të bakrit. Partia i mësoi djemtë e saj që t'i zbulojnë dhe t'i marrin nëntokës pasuritë që lshen në gjirin e saj. Edhe atje ku «miqtë»¹ ta-

1. Është fjala për gjeologët e dërguar nga revolucionistët sovjetikë.

në thoshin se nuk ka mineral, «çeçot» e Shqipërisë e gjetën.

Ju, shoqe, ku punoni?

SHOQJA EVELINA SHESHI: Unë jam mjekë psikiatre, kam studiuar në Fakultetin e Mjekësisë në Tiranë dhe kohët e fundit isha disa muaj jashtë për kualifikim. Jam specializuar për psikiatrinë, por më shumë për fëmijët.

SHOKU ENVER HOXHA: Është një degë shumë e rëndësishme kjo e psikiatrisë.

Isha një ditë në një spital të Tiranës për të parë një të sëmurë nga zemra. Në dhomë gjeta edhe një plak, të cilin e njoha dhe më njohu. Ma bëri me shenjë, për të më treguar që nuk sliste dot, se ishte i paralizuar. I thashë: «Po të të fkas unë, më dëgjon»? Me shenjë më dha të kuptoj se më dëgjonte. Ishte nga lagjja Varosh e Gjirokastrës. i vjehrri¹ i shokut Pjetër Kosta. «Më thanë doktorët, se do të shërohesh e do të vemi bashkë në Gjirokastër» — i thashë. Ai silloi të qeshte. Unë, duke vazhduar bisedën, shtova: «Kur të shkojmë në Gjirokastër, do të kalojmë nga dyqani i Janaq Shkrapit». (Ky ka 50 vjet që ka vdekur.) Ai vazhdoi përsëri të qeshte. «Pastaj, shtova unë, do të kalojmë nga dyqani i Xhemali Shtinos, që shiste zarzavate, do të çlodhemi në kafenenë e Cile Mukës, ku do të na shërbejë garsoni». Ai qeshte dhe kënaqej nga këto kujtime të shkuara që i solla ndërmend. Dua të themi se kujtimet e së kaluarës i mallën-gjejnë dhie i përtërijnë njerëzit.

Dje dhe sot, në të katër anët e Shqipërisë, festat ka-

1. Ilia Duri.

luan shumë të gjëzueshme, por të tilla ishin veçanërisht këtu, në Vlorë, ku kishte shumë entuziazëm, se vlonjatët kanë qenë kurdoherë në ballë të luftërave historike. Ishte e natyrshme që këto dy ditë të shënuara të festoheshin me kaq gjëzim dhe entuziazëm, sepse sivjet ishte 60-vjetori i Shpalljes së Pavarësisë. Monumenti shumë i bukur që u inaugurua me këtë rast, u ngrit në kujtim të pionierëve të Pavarësisë, Ismail Qemalit dhe shokëve të tjerë.

Partia në krye të popullit dhe bashkë me popullin bën përpjekje që çdo vit e më shumë të përmirësohet jetesa e tij. Ajo drejton mirë, për arsyet se udhëhiqet nga një ideologji e drejtë që e mëson të mos ndahet për asnjë çast nga populli, të ecë tok me popullin dhe të vëré në jetë dëshirat dhe ëndrrat e tij. Partia i tregon popullit që të mirat nuk vijnë as nga qelli, as nga profetët, por nga puna e njerëzve, kur ata luftojnë e punojnë të lirë, prandaj ajo e mëson popullin që të zhvillohet nga ana e kulturës. Secilit duhet t'i rrahë zemra për popullin, për të gjithë e jo vetëm për vete. Pra, duke pasur mendjen dhe trupin të shëndoshë, frytet e punës sonë do t'i shikojmë me siguri çdo vit e më të mira.

Përpara, të mirat që gjëzojmë sot, nuk i kishim dhe as i mendonim. Ja, Pjetri, për shembull, ishte një fshatar i thjeshtë. Po të ishte ende në fuqi regjimi satrap i Zogut, ai do të ishte bërë çoban i dhive, nën urdhrat e Gjon Fushës, të Taf Kaziut ose të Gjon Marka Gjonit, që sundonin Mirditën dhe i trajtonin njerëzit e thjeshtë si skllevër; bile ata edhe mund t'i vritnin, po të donin dhe s'i prekte njeri. Sot puna është ndryshe. Jo vetëm që jeta e njerëzve është e siguruar, po tanë nga bijtë e

thjeshtë të popullit njëri drejton flotën, tjetri bëhet mësues, dikush inxhinier e kështu me radhë të gjithë. Tani po rritet një brez i ri, i fuqishëm, me të gjitha cilësitë që dëshiron populli. Kur kemi njerëz me të tilla cilësi, të gjitha punët do të na venë mirë dhe ne do të shkojmë përpara.

Dikur plakat gjirokastrite i mësonin vajzat të gatu-anin mirë dhe të qëndisnin, kurse sot Partia i mëson e i përgatit ato jo vetëm të gatuajnë, por si të shtojnë e të ruajnë më së miri pasuritë e popullit, të tokës e të nëntokës, ashtu siç bën dhëndri juaj, që punon për t'i nxjerrë këto pasuri nga thellësitë. Në sajë të punës vetëmohuese të popullit dhe të djemve e vajzave të tij që mësoi, edukoi dhe do të edukojë brez pas brezi Partia, e ardhmja e vendit tonë do të jetë e ndritur.

SHOQJA VERA OSMANI: Të rrojë Partia!

SHOKU ENVER HOXHA: Popullsia shqiptare në Veri ka vuajtur më shumë se ajo në Jug. Në Shqipërinë e Jugut zhvillimi ka filluar më përpara, më herët, sepse rezistenca kundër feudalëve, bejlerëve e agallarëve ka qenë më e ashpër. Ka qenë e zorshme, për shembull, për Myfit Libohovën, që të bënte ligjin në Gjirokastër. Bejlerët në Jug e kishin humbur davancë oë më përpara, fuqinë e kishin marrë në dorë agallarët, të cilët, ndonëse kishin pasuri, bagëti dhe tokë, megjithatë nuk kishin shumë fuqi që të zotëronin mbi jetën e njerëzve. Edhe ata me ligj të pashkruar e kishin të drejtën të vritnin njerëzit e thjeshtë, por nuk e ushtronin dot gjithnjë nga frika.

Pasi iku koha e agallarëve, dolën treglarët e mëdhenj, fajdexhinxjtë, që kishin fabrikat dhe nëpërmjet

tyre shfrytëzonin djersën e popullit, duke bërë kontrata pér të blerë fuqinë e krahut të punëtorëve. Në Veri ky zhvillim akoma nuk ishte arritur, prandaj populli vuante shumë, ashtu siç ndodhë në Jug 70-80 vjet përpara. Por, kur filloi lufta, Shqipëria e Veriut shpërtheu si një vuikan i madh. Pas Çlirimt kjo pjesë e atdheut tonë e kuptoi se, pér të dalë në dritë, duhej mësuar, punuar dhe luftuar kundër klerikëve reaktionarë, që populli i ka duruar me zor tërë jetën. Prandaj Partia tha: Në Veri duhen hapur shkolla, t'i çelen sytë popullit, të çohet kudo drita e Partisë, të ngrihen rë një nivel të barabartë gjithë masat e popullit. Dhe kështu u bë.

Tani ka mësues, doktorë, inxhinierë dhe kuadro të tjerë të lartë nga të gjitha rrethet e Shqipërisë. Me qindra të tjerë do të përgatiten në të ardhmen. Sot çdo rreth siguron kuadrot e vet, po kjo nuk do të thotë se ata nuk do të venë më nga një rreth në tjetrin, pse ideja e Partisë është që të mos kemi dallime krahinash, por të bashkohemi që të jemi sa më të fortë. Ja, për shembull, Pjetri e mori gruan nga Vlora, unë e kam marrë nga Dibra e kështu me radhë. Këto martesa i shërbijnë zhdukjes së lokalizmit. Kudo që të vemi në Shqipëri, është atdheu ynë, se të tërë shqiptarë jemi.

Do të më falni se, megjithëqë nuk iket nga kjo familje kaq e dashur dhe nga kjo bisedë kaq e ngrontë me ju, më duhet të ngriliem. Mirupafshim, gjëzuar të gjithëve, suksese e lumturi në punë, në jetë e kudo!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimave të mbajtura në këtë
takim, që gjenden në AQP*

PO LUHET ME GJAKUN E POPULLIT HEROIK VIETNAMEZ

Shënimë

Vlorë, 22 dhjetor 1972

Uashingtoni nuk pranoi më çka kishte pranuar në tetor, ai kërkon lëshime nga verivietnamezët dhe përkëtë është në ujdi të plotë me Sajgonin¹. Uashingtoni e ktheu Kissingerin nga tryeza e bisedimeve dhe e vuri të deklarojë publikisht se verivietnamezët nuk duan të

1. Në kuadrin e bisedimeve vietnamezo-amerikane në Paris, më 8 tetor 1972 RD e Vietnamit paraqiti një projektmarrëveshje për dhënien fund të luftës dhe rivendosjen e paqes në Vietnam, me të cilën pala amerikane qe dakord. Ajo u angazhua që më 18 tetor 1972 të ndalonte bombardimet dhe blokimin e Vietnamit të Veriut dhe më 26 tetor 1972 ministritë e Punëve të Jashtme të tij dy vendeve të nënshkruanin zyrtarisht marrëveshjen. Në momentin e fundit SHBA, në mënyrë të paskrupullt, ngritën si kusht bazë për zgjidhjen paqësore të problemit vietnamez tërheqjen e trupave verivietnameze nga Vietnami i Jugut dhe rivendosjen e zonës së çmilitarizuar. Duke shkelur mbi luftën heroike të popullit jugvietnamez, qeveria amerikane dhe qeveria kukull e Thieut kërkonin të përjetësonin kështu ndarjen e Vietnamit dhe kthimin e Vietnamit të Jugut në një koloni të tipit të ri të SHBA-së.

nënshkruajnë paqen dhe, për të bërë presion, amerikanët kanë filluar përsëri me forcë bombardimet. Me qindra avionë shkojnë këto ditë mbi Hanoi e Hajsfong dhe sasia e bombave që kanë lëshuar arrin në 20 000 tonelata brenda dy-tri ditëve.

Natyrisht, kjo ka bërë përshtypje të rëndë edhe në miqtë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilët pritnin diçka të nënshkruhej. Atëherë Niksoni, për ta ulur këtë «deziluzion» i dërgoi një mesazh Thieut se gjoja është ai dhe Hanoi që nuk duan të nënshkruajnë paqen, prandaj o Thieu do të vijë në «rrugën e amerikanëve, o këta do t'i presin ndihmën ekonomike». Me gjithë këto profka Shtetet e Bashkuara të Amerikës vetëm dëshirojnë t'i thonë opinionit botëror: «S'kemi ç'bëjmë, nuk jemi ne që nuk e duam paqen në Vietnam, janë vetë vietnamezët, të dy Vietnamet. Ne, amerikanët, jemi arbitri në mes tyre dhe bëjmë çdo gjë, që t'ia arrijmë pajtimit të tyre deri edhe me bombardimet e egra të Vietnamit të Veriut..».

Sajgoni po bën të tijën, vazhdon luftën, është dakord me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, merr ndihma prej tyre, forcohet dhe kërkon lëshime të mëtejshme, domethënë të mbarohet lufta në favorin e tij, të mos ketë veçse dy Vietnamese dhe Fronti të likuidohet.

Kina në dukje është që lufta në Vietnam të vazhdëjë deri në thyerjen e plotë të amerikanëve dhe të sajganezëve. Por në vetvete ajo do që lufta të marrë fund, domethënë nuk ka shumë besim në një fitore të plotë, por llogarit edhe përfitimet e saj, në rast se lufta ndalohet. Kina thotë se Bashkimi Sovjetik do që lufta në Vietnam të vazhdojë, pse kështu ai mendon që të dobë-

sohen Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të ndërpritet «miqësia kino-amerikane» etj.

Nga ana e tij s'ka asnjë dyshim se Bashkimi Sovjetik, në vija të përgjithshme, është në marrëveshje me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Bashkimi Sovjetik lëshon be e rruse për besnikërinë e tij. Betohet se do ta ndihmojë Vietnamin me çdo mjet në luftën që po bën, por, në fakt e ndihmon shumë pak.

Të tilla janë manovrat që po luhen në kurriz të popullit vëlla vietnamez, që ka kaq kohë që po lufton. Edhe ky vit u mbyll në turbullirë. Flitet se deri nga 20 janari nuk do të ketë «paqe».

Ne mendojmë se vetëm lufta e vërtetë dhe pa kompromise do të sjellë atje paqen e vërtetë. Edhe sikur diçka të nënshkruhet, në këto turbullira, kjo do të jetë një paqe e gënjeshtërt, e mbarsur me një luftë tjetër akoma edhe më të egër. Çdo pozë në këto situata të turbullta dhe të gënjeshtërtë është në favor të imperializmit dhe të kukullave të tij të Sajgonit. Në këto situata dhe me këto mënyra do të thotë ta shkrifësh luftën, ta demoralizosh dhe ta largosh popullin nga lufta për arritjen e fitores së vërtetë.

Betohet për herë të parë si pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

T R E G U E S I T

TREGUESI I LËNDËS

A

Akademia e shkencave e RPSH — 161-167, 496-506.

Aleanca dhe rivaliteti sovjeto-amerikan — 95-108, 128-145, 223.

Aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë dhe roli udhëheqës i klasës punëtore — 20, 21. *Aparati shtetëror, administrata* — përsosja e metodës së punës dhe lufta kundër burokratizmit — 7, 8, 435-437, 493.

Arbitrazhi i shtetit — 76.

Armatimi, çarmatimi; demagogjia e superfuqive për çarmatim — 104, 139-141.

Armiqtë — reprintaria armiqësore dhe lufta kundër tyre — 232-233, 235, 244.

Arsimi — zhvillimi i arsimit; roli i shkollës në edukimin e brezit të ri — 56, 169-170, 519;

— studentët, mësuesit, pedagogët — 83-85, 366, 416-417, 540.

Artet figurative — 277-279.

B

Bashkimet Profesionale të Shqipërisë — 352-353, 426-427, 429-430, 431;

— Kongresi i 7-të i BPSH — 1-26, 27, 29.

Bashkimi Sovjetik, rezionizmi sovjetik — 231-232, 444-445;

— sabotues i luftërave çlirimtare të popujve — 31, 98-100, 101-102, 135-136, 212-213, 225, 242-244, 246-247, 251-253, 554;

— qëndrimi armiqësor kundër Shqipërisë — 247, 291, 292, 524-525.

Blegtoria — zhvillimi i saj — 194, 196-197;

— lopa, bagëtitë e imëta, derri, shpendet. Bagëtitë e oborrit kooperativist — 70-71, 194, 195-196, 193-200;

— baza ushqimore, kullotat — 70-71, 197-198.

Bujqësia — zhvillimi dhe modernizimi i saj — 178-179, 180-182, 187, 233, 234-235,

- 281, 282, 450-455;
 — trajtimi shkencor i tokës dhe rritja e pjellorisë së saj; pedologjia. Ujita — 181, 182-186;
 — agroteknika, agrikultura dhe shërbimet në bujqësi. Rajonizimi, specializimi, rritja e rendimenteve — 175-177, 179-181, 186-187, 189-191, 451-452, 454-455;
 — drithërat, farërat — 191-194, 454-455;
 — punonjësit, specialistët, kuadrot e bujqësisë dhe të blegtorisë — 183-184, 187-188, 190, 198.

Eurokratizmi — lufa kundër shfaqjeve të tij — 12-13, 17, 263, 435-437.

G

Çmimet — politika e Partisë për uljen e tyre — 271, 331, 362-363, 409.

D

Demokracia socialiste — 247-248, 294-295, 305-309, 346, 446.

Disiplina proletare. Disiplina e punës, e planit dhe ajo financiare — 7-11, 70-71, 73-75, 180, 188, 316, 317, 343-344, 408-409;

- disiplina tekniko-shkençore, sigurimi teknik në punë — 182-187, 190-194, 425-432.

Drejtësia, organet e drejtësisë — 109-110, 115, 116.

B

- Edukimi komunist dhe lufa kundër shfaqjere të huaja* — 53, 118, 156-157, 235-236, 276, 279, 381, 385-387, 395, 401-403, 409-410, 462;
 — edukimi ideopolitik, arsimor e kulturor — 48-49, 54, 55-57, 58-63, 401, 410;
 — rrugël, format dhe mijetet e edukimit komunist të masave — 58-59, 403-405.

Egjipti — 231-232, 243-244.
Ekonomia popullore dhe rritja e efektivitetit të saj — 9-11, 14-16, 336, 407-410.

Enver Hoxha — të dhëna autoobiografike — 72, 175, 204, 227-228, 242, 276-277, 525, 534, 535, 536, 538-539, 545, 546, 548.

Europa — demagogjia e superfuqive për «sigurimin evropian» — 106-107, 138-139, 142, 233, 249, 293, 378.

F

Faktori objektiv dhe faktori subjektiv. Faktori i brendshëm

dhe faktori i jashtëm në shoqëri; mbështetja në forcat e rete — 7, 30-31, 149-150, 234, 385, 407-408, 523.

Familja — demokratizimi i marrëdhënieve familjare; bariqia e burrit me gruan — 50, 59-64;

- marrëdhëniet prindër-fëmijë. Rolli i prindërve për edukimin e fëmijëve — 53, 64-65, 111-112, 113-115, 168-169, 470, 542;
- dashuria, fejesa, martesa — 65-67, 530, 542-543.

Feja — lufta kundër mbeturinave fetare — 218-219.

Fëmijët — kujdesi i Partisë për mirërritjen dhe edukimin e tyre — 69-70, 547.

Francia — 253, 283-289, 292.

Fronti Nacionalçlirimtar — 216-218, 376.

Fshatarësia kooperativiste — 20-21, 483.

Fuqia punëtore — 267-268, 348-350, 351-352.

Furnizimi, shpërndarja e produkteve — 9-10, 200-201, 343;

- masat për parandalimin dhe evadimin e mallrave stoqe e me qarkullim të ngadalshëm — 270, 325-326, 327-328, 330-331;
- kontratat, kontraktimet — realizimi i tyre — 69-

-70, 76, 319.

G

Gruaja — politika e Partisë për emancipimin e grave dhe të rastave — 46-47, 49-52, 55-67, 260, 542.

GJ

Gjuhët e huaja — 146, 288, 416-417.

H

Historia e Shqipërisë

- luftërat e popullit shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut kundër pushtimit osman — 405-406;
- Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë (28 nëntor 1912) — 512-515;
- Shqipëria para Çlirimt — 206, 286-288, 515-518, 549, 550-551.

I

Industria — zhvillimi dhe mekanizimi i saj — 158, 236, 326, 327, 328, 490-491, 503-509;

- industria e lehtë dhe ushqimore — 72-73, 75, 81-82, 318, 490, 491.

Inteligjencë — roli i saj në ndërtimin e socialistëve — 3, 8, 54.

Interesi i përgjithshëm —

interesi vetjak — 336, 341, 396, 400, 405.

Internacionalizmi proletar — 25, 27-29, 33, 149-150, 373-379, 380.

Internacionalja e Tretë Komuniste (Kominterni) — 147-148, 150, 151.

J

Jugosllavia, revizionizmi jugosllav — 31-32, 219-220, 254-256, 296, 389;

— qëndrimi armiqësor kundër Shqipërisë — 227-228, 241-242, 389.

K

Kamboxhia — 203-204, 205, 208, 212-213, 226, 240-241, 244, 246, 247, 251-252, 253.

Kapitalizmi — shfrytëzimi kapitalist — 462, 521-523.

Këshillat popullorë, këshilltari — kompetencat, detyrat — 265, 303-308, 310, 492;

— karakteri demokratik, kontrolli i masave mbi këshillat popullorë — 293-301, 305-309;

— komitetet ekzekutive; epërsia e organeve të zgjedhura mbi ato ekzekutive — 303-305, 310-312, 329, 350-352.

Këshilli i Ministrave (Qeveria)

i RPSH — 5, 15, 16, 21, 40-41, 75-76, 119, 166, 311, 316, 327, 417, 453, 471, 473, 481, 484, 487, 490, 492, 493, 510.

Kina — 378, 333-334, 465, 592, 553.

Klasa punëtore në RPSH — roli udhëheqës i saj në ndërtimin socialist të vendit — 2-5, 6-7, 10, 16;

— cilësitet, virtytet moralopolitike; edukimi ideopolitik dhe profesional i saj, kategorizimi e atestimi i punëtorëve — 2, 3-4, 5, 7, 16, 18-19, 40-45, 275, 338-339, 349, 358-363, 425-432, 478, 484-488.

Klasa punëtore në vendet kapitaliste e revizioniste; misioni historik i saj — 22, 34-35, 461, 521-522.

Komunisti — cilësitet, detyrat, roli militant i tij — 52-53, 61-62, 172-174, 207-208, 217, 363-364, 381, 406-407, 408.

Kontradiktat në shoqërinë sociale; rrugët e zgjidhjes së tyre — 5-6, 48-49, 181, 234, 295.

Kontrolli i Partisë, i klasës punëtore dhe i masave punonjëse — 10, 12-13.

Kooperativat bujqësore — organizimi i punës në to. Kooperativat bujqësore të tipit të lartë — 189, 201, 267, 440, 451-453, 455, 458-459, 483, 490.

Kostoja e prodhimit — 407-
—408.

Krimet — shkaqet, parandalimi dhe dënim i tyre — 109-
—120.

Kuadrot — politika e Partisë
me kuadrin; detyrat e kuadrove — 11-12, 119, 263-266, 355-
—357, 365-366;

— lidhjet kuadër-masë; lu-
sta kundër shfaqjeve bu-
rokratike në radhët e
kuadrove — 12-13, 258-
—259, 295.

Kultura fizike dhe sportet;
zvillimi dhe masivizimi i tyre
— 411-424.

Kultura, kultura popullore;
truajtja dhe *mirëmbajtja* e ob-
jekteve kulturore — 158-159,
226-227, 277, 279, 456-457.

Kurendi Popullor, Presidiumi
*i Kurendit Popullor, deputet-
tët* — 109, 116, 117, 258, 264,
265, 294, 303, 305-314.

L

Lenin, Vladimir Iliq — 30, 96,
97, 146, 147, 150, 151, 294,
434, 444, 520.

*Letrat, kërkosat, ankesat e po-
pullit; puna me letrat* — 10,
309, 351, 396-400.

Lëvizja marksiste-leniniste
— lindja e partive të reja
m-l. Forcimi dhe konso-
lidimi i tyre. Puna e tyre

me rininë — 146-147, 148,
150-151, 153, 159, 368, 376-
—377, 379, 380, 385, 461,
464-465, 503;

— marrëdhëniet ndërmjet
partive m-l; forcimi i
unitetit të tyre — 30-31,
34, 35, 149-150, 367, 369-
—370, 372-380, 461;
— përkrahja e forcave m-l
për PPSh dhe RPSH — 30-
—31, 149-150.

Lëvizjet dhe *iniciativat revo-
lucionare* të masave. Përhapja
e përvojës së përparuar — 4-
—5, 117, 188-189, 269.

Ligjshimëria, ligjet; njojja,
mbrojtja dhe *zbatimi i tyre* —
6-7, 118-119, 262-263, 294,
301-303, 430.

Lindja e Mesme — pazarllëqet
dhe ndërhyrjet sovjeto-ameri-
kane në këtë rajon — 37-38,
101-102, 137-138, 210-211, 223-
—224, 238, 243.

*Lusta Antifashiste Nacional-
rintare e popullit shqiptar* —
376, 465-466, 516.

*Lusta e klasave. Lusta e klasa-
ve* në fushën politike dhe ideo-
logjike — 34, 112, 405-406.

Lusta kundër imperializmit — 24-25, 27-
—28, 29-30, 35-38, 143-145,
153, 155-156, 208-209, 222,
223, 231-232, 247, 369-370,
375, 384-385.

M

Marksizëm-lininizmi — armë dhe busull për udhëheqje e reprim; përvetësimi dhe zbatimi i tij — 28-29, 150-151, 207, 216, 219, 374, 376, 383, 384-385.

Marks, Karl — 35, 464, 520.

Masat popolare dhe individi — roli i tyre në histori — 205-206.

Mbrojtja e atdheut; përgatitja e ushtrisë dhe e popullit për nistrojtje — 38-39, 236-238, 384, 388, 391-393.

Metoda dhe stili në punë — 6, 258-262, 265-266.

Ministratë — detyrat e tyre — 266-268, 350-352;

- Ministria e Financave — 315, 316, 331;

- Komisioni i Planit të Shtetit — 348, 351, 356, 452;

- Ministria e Industrisë dhe e Minierave — 70, 331, 426, 427, 490, 491, 492, 510;

- Ministria e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore — 492;

- Ministria e Bujqësisë — 70, 76, 184, 186, 188, 192, 268, 448, 449-450, 451, 454, 458;

- Ministria e Ndërtimit — 206, 356, 365, 426;

- Ministria e Tregtisë — 69, 70, 72, 327, 329-330, 331, 332, 348;
- Ministria e Arsimit dhe e Kulturës — 365, 422-423;
- Ministria e Shëndetësisë — 78, 81, 85.

Mirëqenia materiale dhe ngrijtja e nivelit kulturor të masave — 45, 48, 49, 281, 481-483, 489-490, 519.

N

Ndërmarrjet industriale dhe ato bujqësore — 14-16, 201, 319, 351-352, 452.

Ndërtimet — politika e Partisë në këtë fushë; rritja e efektivitetit të ndërtimeve — 355-357, 453-454.

Ndërtimi i socialistit në Shqipëri — 2, 3, 6, 19-20, 25, 28, 47-48, 149-150, 153-154, 156-157, 220, 233-236, 256, 282-283, 296, 385-386, 387, 463-464, 507-508, 510, 518-520, 522, 523, 549, 550, 551.

Ngushtimi i dallimere ndërmjet fshatit dhe qytetit — 48-49, 51, 483.

O

Organizata-bazë e Partisë — roli udhëheqës dhe detyrat e saj — 57, 170, 275-276, 354, 363-364, 383, 397-398, 406,

426-427, 442-443.

Organizimi dhe drejtimi shkençor i punës — 6-11, 14-16, 73-75, 179, 329-330, 333-334, 346-353, 355-357, 407-408, 412-413, 417, 421-422, 449-455, 473-474, 490-492, 503.

P

Pagat — shpërblimi i punës në socializëm. *Politika e Partisë* në fushën e pagave. *Paga reale* dhe *nominale* — 18-19, 40-41, 42, 43, 44-45, 201, 335-338, 349-350, 353-359, 351-362, 471-490.

Paqja — luftha e popujve të botës për mbrojtjen e paqes — 24, 103-104, 131-132.

Paraja — qarkullimi monetar — 270, 315-317, 320, 322-323, 324-326, 327, 482.

Partia e Punës e Shqipërisë — roli udhëheqës; vendimet, direktivat, njohja dhe zbatimi i tyre — 1-2, 6, 47-48, 51-52, 53-54, 67-68, 259-260, 264, 341-342, 408, 409, 433-447, 549; — parimet e normat e Partisë; demokracia e brendshme në Parti; parimi i unitetit dhe i vijës së masave — 259-260, 264, 393-400, 433-447.

Partia e Punës e Shqipërisë

— organet udhëheqëse qendrore të saj

— Kongresi i 6-të i PPSH — 1-2, 14, 55, 174, 201;

— Komiteti Qendror, Byroja Politike dhe Sekretariati i KQ të Partisë — 40-41, 44, 72, 73-76, 119, 165, 166-167, 170, 316-317, 319, 347, 353, 399-400, 443, 449, 458, 493-494, 496, 497-498; — Plenumi i 2-të i KQ të PPSH (19-20 qershor 1972) — 167, 173-202.

Partia e Punës e Shqipërisë — solidariteti dhe përkrahja internacionliste për partitë m-l — 29, 156, 215-216, 220, 375-377.

Patriarkalizmi, konservatorizmi — luftha kundër tyre — 17, 64, 66, 112-113, 162-169.

Planifikimi i ekonomisë popullore; detyrat për plotësimin e planeve — 8-11, 70, 73-75, 188, 201.

Politika e jashtme

— parimet themelore m-l të politikës së jashtme. Qëndrimi parimor ndaj problemeve ndërkombëtare — 21-22, 36-38, 39, 209-210, 222, 238-239, 245-246, 248-250, 289-291, 292-293, 296, 367-368, 520-521;

— tritja e prestigjit dhe e

- autoritetit të PPSH dhe RPSH në botë — 22, 155, 211, 379;
 - marrëdhëniet me Kinën dhe me Korenë — 230-231, 245, 381-382, 460, 507-510;
 - marrëdhëniet me Francën, Italinë dhe Suedinë — 157-158, 159-160, 284-286, 289, 367, 368, 370-371;
 - marrëdhëniet me Jugosllavinë — 219-220, 227-228;
 - qëndrimi parimor dhe marrëdhëniet me Kosovën e popullsinë shqiptare që banon në trojet e veta në Jugosllavi — 227, 495-496, 526;
 - qëndrimi parimor dhe lufta për demaskimin e revizionistëve sovjetikë — 36, 524-525;
 - përkrahja e luftës së popullit të Vietnamit, të Kambozhias dhe të popujve arabë — 24, 203-204, 208, 213-214, 215-216, 221-222, 229, 240, 243-244, 251-254, 467, 554.
- Populli shqiptar* — luftërat e tij për liri, pavarësi e përparrim shoqëror — 28, 204-207, 232, 514-518.
- Prodhimi* — prodhimi i mall-
- rave të konsumit të gjërë — 69-70, 273-275, 282, 317-319, 320-321, 322-323, 325-326, 327-328, 481-482;
 - sasia dhe cilësia e produkteve. Asortimenti — 72-73, 75, 273-274, 320-322, 326, 330-331.
- Propaganda, agitacioni* — 270-271, 322, 352, 360-362.
- Propaganda borgjezo-revizioniste* — 35, 95-96, 104-105, 129-133, 134-135, 222, 235, 239, 244, 248-249.
- Psikologjia mikroborgjeze, individualizmi, indiferentizmi* — 52, 53, 54-55, 117-119, 391-396, 400, 402-403, 405, 435.
- Puna* — organizimi, kategorizimi, normimi i punës. *Normat* — 16-18, 40-45, 333-344, 345-348, 352-353, 472-473, 478, 484-489.
- Pushteti Popullor* — karakteri demokratik, kompetencat dhe përgjegjësitet e organeve të pushtetit — 11-12, 257-268, 492-493.

R

- Regjimi i kursimit* — 320, 321, 323, 453, 482.
- Rezisionizmi modern; lufta e tij kundër lëvizjes m-l* — 35, 151-153, 333-360, 523-524.
- Revolucioni proletar* — prob-

- lem i shtruar për zgjidhje — 22-23, 25, 28, 32, 207, 211, 231.*
Rinia dhe BPRSh — 65-66, 170;
 — edukimi komunist i rinisë dhe lufta kundër shfaqjeve të huaja. Roli i saj në ndërtimin e socializmit — 65-67, 110-111, 112-115, 168-169, 358, 360-361, 414-415, 416-417, 461-465;
 — Kongresi i 6-të i BPRSh — 168, 170-171, 456, 469.

S

- Sigurimet shoqërore, pensionet — 344-345, 431-432, 476.*
Socializmi, komunizmi — 25, 47, 232.
Stalin, Josif Visarionoviç — 31, 32, 146, 147, 233, 242, 291, 294, 434, 444.
Superfuqitë — politika e lustës dhe e agresionit — 24, 36-37, 97, 102-103, 106, 131-145, 248, 300, 524.

SH*Shëndetësia*

- profilaksia. Farmakologjia, diagnostikimi dhe mjekimi i sëmundjeve. Propaganda shëndetësore — 78-82, 87-88, 89, 91-92, 93;
 — laboratorët. Laborantët. Kuadrot e mjekësisë,

- mjekët; kualifikimi i tyre — 83-93, 289.
Shfaqjet e huaja dhe lufta kundër tyre — 114-115, 125, 360-361, 387.
Shkenca dhe teknika botërore — shfrytëzimi i arritjave të tyre — 164, 175-176.
Shkenca — politika e Partisë për zhvillimin e saj — 495-496, 503;
 — institutet kërkimore shkencore. Punonjësit shkencorë, shkencëtarët — 161, 162-163, 164-165, 166, 495-496, 498-499, 502, 503, 504, 505-506;
 — shkencat humanitare, natyrore e teknike — 163-164.

- Shtetet e Bashkuara të Amerikës — politika e lustës dhe e agresionit — 23, 32-33, 97-98, 101-102, 209, 467, 552-554.*

T

- Teoria dhe praktika, uniteti dialektik i tyre — 42, 395, 433-447.*
Teoritë revizioniste mbi ndryshimin e natyrës së imperializmit dhe mbi partinë politike të klasës punëtore — 129-131, 151-152.
Të huajt, miqtë për Shqipërinë — 155, 159-160, 211, 371.

Tregtia e brendshme — politika e Partisë për zhvillimin e saj. Furnizimi i popullsisë — 69-70, 72-75, 81, 174-175, 270-271, 275, 300, 325-327, 328-330, 403-409.

Tregtia e jashtme — eksporti, importi — 326, 327-328, 431-482.

U

Uniteti Parti-popull — 173, 207-208, 440.

Ushtria popullore — forcimi dhe përgatitja politiko-lufzatake — 382-383, 387-388, 391-392.

V

Vietnami — 23, 24, 32-34, 97-100, 135-136, 241, 252-253, 392-393, 467, 552-554.

Vigjilencia revolucionare — 386, 520-521.

Vija e masave — 5, 8, 13, 29, 259, 294-295, 436-437, 449, 445.

ZH

Zhvillimi dialektik, Zhvillimi i shoqërisë sonë socialiste — 5-6, 19-20, 48-49, 236, 294-295.

TREGUESI I EMRAVE

A

- Alia, Ramiz — 171, 367, 503.
Ajeti, Idriz — 490.
Aleksandri i Madh — 205.

B

- Boletini, Isa — 225, 513-514,
515.
Bozo, Miti — 458-459.
Brezlinjev, Leonid — 37, 97,
99, 106, 107, 135, 136, 137,
143, 251.
Buda, Aleks — 498, 499, 501,
503, 503, 504, 505.
Buçinari, Filip — 152.

C

- Cala, Pandeli — 515.
Cani, Nimet — 364.
Curri, Dajram — 515.

G

- Çarçani, Adil — 257.
Çërrava, Vangjel — 273.
Çabej, Eqrem — 495, 505.

Çaushesku, Nicolae — 251,
253.

Çelo, Adile — 532.
Çembërlen, Nevil — 132.

D

- Daladie, Eduard — 132.
Dedja, Bedri — 493, 502.
Dü Gol, Sharl — 223, 253, 289,
292.
Dü Kurvil, Ksavie — 287.
Diko, Filo — 71.
Dode, Petro — 534.
Duri, Ilia — 548.

E

- Eftimiу, Stilian — 526.
Eftimiу, Viktor — 523-529.
Ekmekçiu, Hatixhe — 532.
Elezi, Mehmet — 535.
Engelbrekt, Engelbrektson —
149.

F

- Franc Jozef — 514.
Fusha, Gjon — 549.

G

Gaçe, Petrit — 88.
 Grei, Eduard — 225.
 Gurakuqi, Luigj — 515.

GJ

Gjergjevica, Agush — 121-127.
 Gjide, Pavllo — 534-535, 541.
 Gjoni, Gjon Marka — 549.

H

Hoxha, Nexhmije — 546.
 Hanku, Rahman — 365.
 Hasani, Jeta — 539.
 Hasani, Sherif — 538, 540, 541,
 542.
 Hasani, Zonjë — 540.
 Hazbiu, Kadri — 123.
 Hitler, Adolf — 30, 132.
 Hrushov, Nikita — 99, 136, 291,
 524, 525.

J

Jaring, Gunar — 138.

K

Kapo, Hysni — 367, 399.
 Kapo, Vito — 257, 258.
 Kadare, Ismail — 237.
 Kanapari, Shyqyri — 5.
 Kao Ki — 246.
 Karli I i Habsburgut — 514.

Kaziu, Taf — 549.

Kisinger, Henri — 552.
 Koçulları, Fuat — 364.
 Kodheli, Riza — 124, 278.
 Kokalari, Dhurata — 545, 546.
 Kokalari, Eqrem — 545.
 Kokalari, Luan — 545.
 Kosigin, Aleksei — 98, 139.
 Kostallari, Androkli — 162,
 495.
 Kosta, Pjetër — 548, 549, 551.
 Kroï, Haxhi — 124.
 Kruja, Mustafa (Merlika) —
 264.
 Kupi, Abaz — 216.

L

Lavuazie, Antuan — 294.
 Lera, Spiro — 5.
 Libohova, Myfit — 550.
 Lon Nol — 203, 212, 213, 241,
 244, 246.

M

Marko, Rita — 332, 352, 356.
 Myftiu, Manush — 421.
 Maliani, Cirilio — 371.
 Malinovski, Rodion — 525.
 Mersini, Astrit — 531, 532, 533.
 Mersini, Halim — 530.
 Mersini, Myrvete — 530, 531,
 533, 535, 536.
 Mezini, Daut — 545.
 Mezini, Hysen — 5.
 Miliez, Pol — 284, 286, 289,

295-296, 297.

Mio. Vangjush — 276.

Miti, Liri — 57.

Mitrushi, Jeta — 541.

Muka, Cile — 548.

Murati II — 205.

Musolini, Benito — 206.

Myri, Zhilber — 284.

N

Nguyen Van Thieu — 553.

Ngjela, Kiço — 69, 72, 324,
325, 330, 331.

Nika, Ismail — 5.

Nikson, Riçard — 23, 32, 33,
95, 96, 97, 100, 103, 106, 107,
108, 128, 129, 130, 132, 133,
135, 136, 137, 139, 143, 245,
467, 553.

O

Osmani, Bujar — 545.

Osmani, Namik — 544, 546.

Osmani, Vera — 544, 546, 550.

P

Pak Çen Hi — 245.

Podgorni, Nikolai — 100, 102,
106, 225.

Pompidu, Zhorzh — 253, 292.

Popa, Kolë — 498, 501, 502.

Q

Qemali, Ismail — 513, 514-515,
549.

R

Radovicka, Petrit — 498.

Rankoviç, Aleksandër — 241.

S

Skënderbeu, Gjergj Kastrioti
— 205-206, 237, 513.

Sadat, Anvar — 231, 232, 243.

Sidki, Azis — 232.

Sihanuk, Norodom — 203, 221,
224, 226, 240, 250.

Sopi, Bajame — 469, 470.

Sopi, Gazmend — 469, 470.

Sopi, Islam — 469, 470.

Spahiu, Xhafer — 324.

SH

Shanto, Vasil — 525.

Sharra, Kristo — 173.

Shehu, Kudusi — 268.

Sheshi, Evelina — 548.

Shkrapi, Janaq — 175, 548.

Shtino, Xhemali — 175, 548.

T

Toska, Haki — 324, 365, 458,
545.

Tarazhi, Pjetër — 547.

Tito, Josip Broz — 31, 32, 37,
209, 219, 227, 228, 240, 241,

242, 251, 254, 255, 291, 296,
389, 467.

XII

Xhuvani, Aleksandër — 496.

V

Vasa, Gustav I — 149.

Verli, Aleks — 324.

Vogli, Fiqri — 541.

Z

Ziçishti, Mihallaq — 123.

Zogu, Ahmet — 206, 217, 516.

TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJIERA

D

- Afrikë — 24, 30, 243.
«Al Akbar» (gazeta ~) — 138.
Aleksandri (Egjipt) — 37.
Algjeri — 223.
Amerika Latine — 24, 30, 144.
Anshan (Kinë) — 508.
Azi — 24, 30.
- Dardanele (ngushtica ~) — 37.
Dibër — 118-119, 264, 269, 515, 551.
Dibër (Jugosllavi) — 515, 540.
Drashovicë (Vlorë) — 539.
Durrës — 171, 515.

B

- Ballaban (Përmjet) — 57.
Balli Kombëtar — 218.
Beneluks (shtetet ~) — 107.
Bon — 134.
Britania e Madhe — 144, 379.
Bukuresht — 515.
Bullgari — 234.
Butrini (Sarandë) — 524.

E

- Eibasan — 358, 510, 533.

- Fabrika e Konfeksjoneve —
Korçë — 338.
Fakulteti i Mjekësisë — 83,
84, 429.
Franmasoneria — 152.

C

- Çekoslovaki — 132, 234.
Çeprat (Vlorë) — 539.
«Çështja Siksti i Burbonit» — 514.

G

- Gregi — 241, 390, 466-467.
Grupi i këngëve karakteristike korçare — 456-457.
Guci (Jugosllavi) — 515.

GJ

- Gjakovë (Jugosllavi) — 515.
 Gjermania Lindore — 234.
 Gjibraltar — 37.
 Gjiri dhe baza detare e Vlorës — 36, 292, 524-525.
 Gjirokastër — 71, 175, 277, 545, 550.

II

- Hajsong (Vietnam) — 553.
 Hanoi — 553.
 Hekurudha Elbasan-Përrenjas — 282.
 Hidrocentrali i Fierzës (Hidrocentrali «Drita e Partisë») — 319-320, 355, 357, 358, 359, 364, 366.
 Hidrocentrali i Smokthinës — Vlorë — 356-357.
 Hidrocentrali i Vaut të Dejës — 263, 355, 356.
 Historia e PPSH (libri ~) — 159.
 Hungari — 234.

I

- Indokinë — 23, 93, 136, 225, 231, 246.
 Instituti i kulturës fizike «Vojë Kushi» — Tiranë — 417.
 Instituti i Lartë Pedagogjik — Shkodër — 544-545.
 Instituti i Studimeve Marksiste-

- te-Leniniste pranë KQ të PPSH — 166.
 Itali — 390.
 Izrael — 101, 102, 210, 243.

K

- Karboneria — 152.
 «Kështjella» (romani ~, I. Kadare) — 237.
 Klubi sportiv «Dinamo» — 421.
 Klubi sportiv «Partizani» — 421.
 Klubi sportiv «17 Nëntori» — 421.
 Kodi Penal — 116, 430.
 Kombinati i tekstileve «Stalin» — Tiranë — 321, 322, 331.
 Kombinati Metalurgjik (Kombinati metalurgjik «Çeliku i Partisë») — Elbasan — 236, 355, 357, 358, 361, 510, 533.
 Komiteti Shtetëror i Kulturës Fizike dhe i Sporteve — 411, 420.
 Konferenca e Londrës (1913) — 225, 227.
 Konferenca e Parë Kombëtare e Folkloristikës Shqiptare (26-27 maj 1972) — 227.
 Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (20-25 nëntor 1972) — 495, 525-526.
 Kooperativa Bujqësore e Plasës — Korçë — 280-281, 451, 458.

Korçë — 273, 276, 277, 278, 279,
282, 329.
Kore — 245-246.
Kosovë — 227-228, 495, 526,
540.
Krujë — 206.
Kukës — 257, 258, 259, 260,
261, 264, 268-270.
Kushtetuta e RPSH — 305.
Kuvendi i Parë i Studimeve
Ilire (15-20 shtator 1972) —
158-159, 285, 502-503.

L

Laos — 30.
Lekbibaj (Tropojë) — 358.
Liceu i Gjirokastrës — 286-
287.
Liceu i Korçës — 286-287.
Lindja e Largët — 144.
Londër — 224, 513.
Lubenjë (Vlorë) — 539.
Lufta e Parë Botërore — 514.

M

Mali i Gjerë (Gjirokastër) —
197.
Mali i Zi — 495, 526.
Maqedoni — 495, 526.
Mazhar (Vlorë) — 538.
Mesdhe (deti, zona ~) — 36-
37, 107, 238, 243, 248.
Miniera e Bakrit — Kurbnesh
— Mirditë — 428.
Miniera e Kromit — Bulqizë

— Dibër — 5.

Miniera e Qymyrgurit — Mbo-
rje-Drenovë — Korçë — 5, 472.
Miniera e Qymyrgurit — Me-
maliaj — Tepelenë — 5.
Mirditë — 549.
Monumenti i Pavarësisë —
— Vlorë — 549.
Moskë — 95, 98, 100, 104, 108,
128, 130, 132, 135, 136, 139,
140, 141, 219, 231.
Myzeqe — 515.

N

NATO — 37, 388-389.
Ndërmarrja Bujqësore e Mali-
qit — Korçë — 5.
Ndërmarrja bujqësore «Nën-
tori» — Sukth — Durrës — 5,
71.
Ndërmarrja bujqësore «Ylli i
kuq» — Kamëz — Tiranë —
5.
Ndërmarrja e Shpini-Kérki-
mit të Naftës Nr. 2 — Patos
— 5.
Ndërmarrja Pyjore — Tiranë
— 332.
Nikaj (Tropojë) — 358.

O

Organizata e Kombeve të Ba-
shkuara — 107, 379.

P

- Palestinë — 30.
 Paris — 204, 552.
 Pejë (Jugosllavi) — 515.
 Peshkëpi (Vlorë) — 539.
 Plavë (Jugosllavi) — 515.
 Pnom-Pen — 212.
 Policia Popullore — 118.
 Poloni — 234.
 Prishtinë (Jugosllavi) — 515.
 Prizren (Jugosllavi) — 515.
 Prokuroria e Përgjithshme e RPSH — 109.

R

- Revolucioni Demokratiko-Borqez Francez (1789) — 287-288.
 Revolucioni i Madh Socialist i Totorit (1917) — 97.
 Rumani — 234, 515.

RR

- Rruga automobilistike e Komunit — 357-358.

S

- SALT — 107, 144.
 SMT — Sarandë — 449.
 Stamboll — 515.
 Suedi — 148-149, 154, 158, 159-160.

SH

- Shishtavec (Kukës) — 176.
 Shkolla e Partisë «V. I. Lenin» — 435, 539, 547.
 Shkup (Jugosllavi) — 515.
 Shoqata e Miqësisë Francë-Shqipëri — 284.
 Shoqata e Miqësisë Itali-Shqipëri — 370.
 Shqipëria e Jugut — 515, 550.
 Shqipëria e Veriut — 515, 551.

T

- Takimi, bisedimet dhe marrëveshjet sovjeto-amerikane — Moskë (22-30 maj 1972) — 97, 98-99, 100-101, 102, 104-105, 106, 107, 128, 132, 133, 135, 137, 141, 142.
 Televizioni i Moskës — 132.
 Tirani — 74-75, 93, 235, 253, 351, 418, 421, 548.
 Traktati i fshehtë i Londrës (1915) — 514.
 Traktati (marrëveshja) i Münihut (shtator 1938) — 132.
 Traktati i Varshavës — 36, 388-389.
 Traktati (marrëveshja) sovje-to-amerikan mbi kufizimin e armëve strategjike (maj 1972) — 139, 140, 141.
 Tregu i Përbashkët Evropian — 292.
 Trieste (Itali) — 515.

Tropojë — 358.

Turqi — 515.

U

Universiteti i Prishtinës — 227.

Ushtria e Kuqe — 234.

Uzina e Superfosfatit (Kombinati kimiko-metalurgjik) —

— Laç — 5.

Uzina Metalike — Gjirokastër
— 5.

Uzina «Traktori» (Kombinati i
autotraktorëve «Enver Hoxha»)
— Tiranë — 5.

V

Varkizë (Greqi) — 466.

Vatikan — 134.

Vau i Shushicës (Vlorë) — 539.

Vendet Skandinave — 144.

Vjenë — 515.

Vlorë — 36, 292, 511, 512, 515,
524-525, 532-533, 549, 551.

Z

Zëmblak (Korçë) — 280-281.

«Zëri i popullit» (gazeta ~)
— 387.

L E N D A

PARATHENIE PËR VELLIMIN E 49-TË

V-IX

1972

FJALA E KLASËS PUNËTORE, MENDIMI DHE VEPRA E SAJ JANE VENDIMTARE NË GJITHË JETËN E VENDIT — Përshëndetje në emër të KQ të PPSH në Kongresin e 7-të të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë (8 maj 1972)

1—26

SOLIDARITETI INTERNACIONALIST KALITET NË LUFTË KUNDËR IMPERIALIZMIT DHE REVIZIONIZMIT — Nga biseda me delegacionet e huaja që morën pjesë në punimet e Kongresit të 7-të të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë (11 maj 1972)

27—39

PAGAT QË MERREN, TË MERITOHEN ME PUNË — Shënimë (17 maj 1972)

40—45

PËR THELLIMIN E DEMOKRACISË SOCIALISTE NË FAMILJE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (24 maj 1972)

46—68

TREGTIA VARET SHUMË EDHE NGA Ç'I JEP PRODHIMI — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 maj 1972)

69—77

PROFILAKSIA — FAKTOR MI RËNDËSI PËR RU-AJTJEN E SHËNDETIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 maj 1972)	78—94
NJË ETAPË E RE E STRATEGJISË GLOBALE SOVJETO-AMERIKANE KUNDER LIRISË E PAVARËSISË SË POPULLIT — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (27 maj 1972)	95—102
QDO NËNVLEHTIMI NË PUNËN PËR EDUKIMIN E RINISE ESHTË I DËMSHËM PËR TË ARDHMEN E ATDHEUT — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor (29 maj 1972)	103—120
CILIDO QË BEN PADREJTESI ZBULOHET, DHE VETË POPULLI E DEMASKON — Nga biseda me komunistin dhe veteranin e Luftës Nacionalelirimtare, shokun Agush Gjergjica (1 qershor 1972)	121—127
TË DEMASKOJMË DHE TË KUNDERSHTOJMË ME TË GJITHA FORCAT ALEANCËN KUNDERREVOLUCIONARE SOVJETO-AMERIKANE — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (4 qershor 1972)	128—145
PA PARTINË MARKSISTE-LENINISTE KLASA PUNËTORE NUK MUND TA BEJE DHE TA ÇOJE GJER NË FUND REVOLUCIONIN — Nga biseda me një mik nga Suedia (10 qershor 1972)	146—163
KA ARDHUR KOHA TA KRIJOJMË AKADEMINË E SHKENCAVE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (15 qershor 1972)	164—167
DISA VËREJTJE PËR RAPORTIN QË DO TI PARRAQITET KONGRESIT TË RINISE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (15 qershor 1972)	168—171

UNITETI KRIJOHET KUR KA NDESHEJE MENDIMESH — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (17 qershor 1972)	172—177
PËR FUTJEN E BUJQËSISE NË RRUGËN E MODERNIZIMIT DHE TË ZHVILLIMIT TË GJITHANSHËM TË SAJ — Fjala në Plenumin e 2-të të KQ të PPSH (20 qershor 1972)	178—202
FITORJA ËSHTË GJITHINJË ME POPUJT QË LUFTOJNE PËR LIRI — Nga biseda me Norodom Sihanukun (23 qershor 1972)	203—214
POLITIKA JONE NISËT NGA INTERESAT E LARTË TË POPULLIT — Nga biseda me një përfaqësues të PK të Kamboxhias (24 qershor 1972)	215—220
SHQIPËRIA NDJEK KURDOHERË NJË POLITIKË TË PAVARUR — Nga biseda me Norodom Sihanukun (27 qershor 1972)	221—229
SOCIALIZMI DO TË TRIUMFOJË, AI I HAP PERSPEKTIVA TË GJERA POPULLIT — Nga biseda me një delegacion të bujqësisë të RP të Kinës (12 korrik 1972)	230—239
NE JEMI ABSOLUTISHIT KUNDER ORTAKLLES KUT ME ARMIQTË E POPUJVE — Nga biseda me Norodom Sihanukun (24 korrik 1972)	240—256
EUROKRATIZMI — ARMIK I DEMOKRACISË SOCIALISTË — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH (7 shtator 1972)	257—272
KORÇEN E KAM DASHUR DHE E DUA, PSE KËTU KAM KALUAR NJË PJESE TË RINISË SIME — Nga biseda e gjatë vizitave në rrëthin e Korgjës (30 gusht 1972)	273—283

LIRINË E FITUAR ME AQ SAKRIFICA DO TA MBROJMË NË ÇDO KOHË DHE ME ÇDO ÇMIM — Nga biseda me kryetarin e Shoqatës së Miqësisë Francë-Shqipëri, profesor Pol Miliez (11 shtator 1972)	284—297
T'I MËSOJMË ZGJEDHËSIT SE PËR ÇFARË T'U DREJTOHEN PËRFAQËSUESVE TË TYRE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (18 shtator 1972)	298—314
QARKULLIMI I MONEDHËS VARET EDHE NGA PRODHIMI I MALLRAVE TË KONSUMIT TË GJERË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (18 shtator 1972)	315—323
QE TË MOS KRIJOHEN STOQE. T'I PRODHOJMË MALLRAT SIPAS GUSTOS SË NJEREZVE — Nga biseda me sekretarë të KQ të PPSH dhe me dy ministra (19 shtator 1972)	324—332
JO TEORIZIME, POR MASA KONKRETE PËR VENDOSJEN E NORMAVE TEKNIKE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (21 shtator 1972)	333—353
RININË E KEMI TË PASTER, POR PËR EDUKIMIN E SAJ DUHET PUNUAR VAZHDIMISHT — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (21 shtator 1972)	354—366
LUFTËN KUNDËR IMPERIALIZMIT DHE REVIZIONIZMIT NË ASNJË RAST NUK DUHET TA NËNVLEFTËSOJMË E TA ZBUTIM — Nga biseda me një shok të Partisë Komuniste të Italisë (m-1) (25 shtator 1972)	367—380

PARTIA JONË PUNON QË ATDHEUN TA MBROJË JO VETËM USHTRIA, POR TËRË POPULLI USH- TAR — Nga biseda me delegacionin e ushtrisë kineze (13 tetor 1972)	381—393
INDIVIDUALIZMI DHE INDIFERENTIZMI MBËSH- TETEN NË IDEOLOGJITË E KLASAVE SHFRY- TËZUESE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (28 tetor 1972)	394—410
TI BËJMË SA MË MASIVE KULTURËN FIZIKE E SPORTET DHE TË NGREMË MË LART MJESHTË- RINË SPORTIVE — Diskutim në mbledhjen e Se- kretariatit të KQ të PPSH (28 tetor 1972)	411—424
AKSIDENTET SHMANGEN PO U ZBATUAN RRE- GULLORET — Diskutim në mbledhjen e Sekreta- riatit të KQ të PPSH (28 tetor 1972)	425—432
ZBATIMI I DREJTË I DIREKTIVAVE KËRKON EDHE ZBËRTHIMIN E KUPTIMIN TEORIK TË TYRE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (30 tetor 1972)	433—447
NË KOOPERATIVAT E TIPIT TË LARTË, TË MA- RRIM RENDIMENTE TË LARTA — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (30 te- tor 1972)	448—455
KËNGA JONË PATRIOTIKE POPULLORE NË ÇDO KOHE KA PASQYRUAR BOTËN REALE SHQIPTA- RE — Letër drejtuar grupit të këngëve karakteristike korçare (31 tetor 1972)	456—457
STUDIMIN E GJEJ SHUMË TË THELLUAR DHE ME KONKLUZIONE TË DREJTA — Letër drejtuar shokut Miti Bozo (4 nëntor 1972)	458—459

PARTIA E MËSON RININË TË VEPROJE Ë ORGANIZUAR NË LUFTËN PËR NDERTIMIN E SOCIALIZMIT — Nga biseda me delegacionin e rinisë kineze (8 nëntor 1972)	460—468
JU KENI TË DREJTË TË JENI TË LUMTUR — Letër drejtuar Bajame e Islam Sopit, punëtorë në Fabrikën e Miellit (13 nëntor 1972)	469—470
PROBLEMET E PUNËS E TË PAGAVE TË NA PREOKUPOJNË VAZHDIMISHT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (22 nëntor 1972)	471—494
KRIJIMI I AKADEMISË SË SHKENCAVE — NGJARJE E SHËNUAR HISTORIKE — Nga biseda me drejtuesit e Akademisë së Shkencave (25 nëntor 1972)	495—506
ÇELIKUN E KALITIN NJERËZIT, KURSE NJERËZIT I KALIT PARTIA — Nga biseda me delegacionin e Ministrisë së Industrisë së Metalurgjisë të RP të Kinës (25 nëntor 1972)	507—511
POPULLI SHQIPTAR SOT LUFTON, PUNON DIHE JETON I LUMTUR NË EPOKËN E PARTISË — Fjalë në pritjen e dhënë në qytetin e Vlorës me rastin e 60-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë dhe 20-vjetorit të Çlirimtë të Atdheut (28 Nëntor 1972)	512—527
BIR I NDRITUR I TRUALLIT SHQIPTAR — Telegram ngushëllimi dërguar Stilian Estimiu (28 nëntor 1972)	528—529
KUJTOJMË ME NDERIM SHOKËT E RËNE, POR LUFTA VAZHDON — Nga biseda me pjesëtarët e familjes së dëshmorit Halim Bejto Mersini (29 nëntor 1972)	530—537

FAMILJA ËSHTË VATËR E NGROHTE DASHURIE DHE GËZIMI — Nga biseda në familjen e patriotit Sherif Hasani (29 nëntor 1972)	533—543
SECILIT DUHET TI RRAHË ZEMRA PËR POPU- LLIN — Nga biseda me pjesëtarët e familjes së dësh- morit Namik Osmani (29 nëntor 1972)	544—551
PO LUHET ME GJAKUN E POPULLIT HEROIK VIETNAMEZ — Shënime (22 dhjetor 1972)	552—554
Treguesi i lëndës	557
Treguesi i emrave	567
Treguesi gjografik dhe i emërtimeve të tjera	571